


BIOGRAFIA E PEJGAMBERIT A.S.

- version i shkurtuar -

Ibni Hisham



© LOGOS·A  
S H K U P  
P R I S H T I N Ě  
T I R A N Ě  
2 0 1 7

**Ibni Hisham**  
**BIOGRAFIA E PEJGAMBERIT A.S.**  
**(version i shkurtuar)**

**Boton: LOGOS-A**  
**Biblioteka: MENDIMI ISLAM**

**Për botuesin: Adnan Ismaili**  
**Kryeredaktor: Husamedin Abazi**  
**Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim**

**Redaktor gjuhësor: Arijan Koçi**  
**Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi**  
**Redaktor teknik: Halil Berisha**  
**Faqësës: Sedat Halimi**  
**Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili**  
**Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup**  
**Shtypi: Focus Print**  
**rr. Pellagonia 3 Shkup**

**ISBN 978-9989-58-662-0**

**[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)**

**Copyright©Logos-A, 2017**

**Tirazhi: 1000**

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.**  
**Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.**  
**Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për**  
**afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi,**  
**transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.**



# BIOGRAFIA E PEJGAMBERIT A.S.

- version i shkurtuar -

## Ibni Hisham

E PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:


**Miftar Ajdini**

TITULLI ORIGINALIT:

**Ibni Hisham,  
Siretu ibni Hisham,**

VERSIONI I SHKURTUAR:

**Abus-selam Harun,  
Tehdhibu Sireti ibni Hisham,  
Dar el-buhuth el-ilmij-jeh,  
Kuvajt, 1985**



MENDIMI ISLAM



## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	11
H Y R J E .....	13
Historia dhe biografia .....	13
Autorët e biografive.....	14
Biografia e Ibni Is'hakut.....	15
BIOGRAFIA E IBNI HISHAMIT (SIRETU IBNI HISHAM).....	17
Rëndësia e “Biografisë” së Ibni Hishamit.....	18
Redaktimi i biografisë së Ibni Hishamit .....	19
II. REDAKTIMI I BIOGRAFISË SË IBNI HISHAMIT .....	21
PREJARDHJA E PASTËR NGA MUHAMEDI A.S. DERI TEK ADEMI A.S. ....	23
GJENEALOGJIA E PASARDHËSVE TË ISMAILIT .....	24
ËNDRRA E REBIA BIN NASRIT .....	25
PUSHTIMI I MBRETËRISË SË JEMENIT NGA ANA E EBU KERIB TUBAN ESADIT DHE MARSHIMI I TIJ NË JETHRIB.....	28
FITORJA E ABISINASVE NDAJ JEMENIT .....	32
KONFLIKTI MES ERJATIT DHE EBREHASË .....	33
TREGIMI PËR PRONARËT E ELEFANTIT.....	34
PASARDHËSIT E NIZAR BIN MEADDIT .....	38
FËMIJËT E ABDULMUTTALIB B. HISHAMIT .....	39
PRINDËRIT E PEJGAMBERIT A.S.....	40
GËRMIMI I ZEMZEMIT DHE KUNDËRTHËNIET RRETH TIJ.....	41
PREMTIMI I ABDULMUTTALIBIT SE DO TË THERTE DJALIN E TIJ .....	43
ÇFARË U THA PËR AMINEN GJATË SHTATZËNISË ME PEJGAMBERIN A.S. ....	46
LINDJA E PEJGAMBERIT A.S. ....	47
TREGIMI I HALIMESË.....	48
NGJARJA E HAPJES SË GJOKSIT .....	51
NËN MBROJTJEN E GJYSHIT ABDULMUTTALIB .....	52
NËN MBROJTJEN E XHAXHAIT EBU TALIB .....	53
NGJARJA ME BEHIRËN .....	54
LUFTA MËKATARE .....	56
MARTESA ME HATIXHENË R.A. ....	57
DEKLARATA E VEREKA BIN NUFELIT .....	59

NDËRTIMI I QABESË .....	60
PARALAJMËRIMET E MAGJISTARËVE ARABË, RABINËVE HEBRENJ DHE PRIFTËRINJVE TË KRISHTERË .....	62
PËRSHKRIMI I PEJGAMBERIT A.S.....	63
PËRSHKRIMI I PEJGAMBERIT A.S. SIPAS UNGJILLIT.....	64
MISIONI I PEJGAMBERISË .....	65
FILLIMI I SHPALLJES SË KUR'ANIT.....	68
HATIXHE BINT HUVEJLIDI PRANON ISLAMIN .....	69
NDËRPRERJA E SHPALLJES .....	70
MUSLIMANËT E PARË .....	71
THIRRJA PUBLIKE NË ISLAM .....	73
ÇFARË THA PËR KUR'ANIN VELID B. MUGIRE.....	76
ÇFARË PËRJETOI PEJGAMBERI A.S. NGA POPULLI I TIJ .....	78
HAMZAI R.A. BËHET MUSLIMAN.....	80
ÇFARË I THA UTBE B. REBIA PEJGAMBERIT A.S. ....	81
ÇFARË NDODHI MES PEJGAMBERIT A.S. DHE LIDERËVE KUREJSHË .....	83
VEPRIMI I EBU XHEHLIT .....	86
FJALA E NADR B. HARITHIT .....	87
ARMIQËSIA E IDHUJTARËVE NDAJ MUSLIMANËVE TË PAMBROJTUR.....	88
MIGRIMI I PARË NË ABISINI .....	91
KUREJSHËT DËRGOJNË NË ABISINI NJË DELEGACION PËR TË KËRKUAR EKSTRADIMIN E EMIGRANTËVE .....	92
OMER BIN HATTABI BËHET MUSLIMAN .....	97
LAJMI I FLETËS .....	100
SHQETËSIMET QË PËRJETOI PEJGAMBERI A.S. NGA POPULLI I TIJ .....	101
KTHIMI I EMIGRANTËVE NGA ABISINIA.....	106
SHKELJA E VENDIMEVE TË FLETËS .....	107
IRASHIU QË I SHITI DEVENË EBU XHEHLIT .....	109
NDODHIA E ISRASË .....	111
TREGIMI I MIRAXHIT .....	113
VDEKJA E EBU TALIBIT DHE E HATIXHESË.....	115
PEJGAMBERI A.S. SHKON TE FISI THEKIF PËR TË KËRKUAR NDIHMË .....	117
XHINËT NGA NASIBINA.....	119
SHFAQJA E PEJGAMBERIT A.S. PARA FISEVE .....	120
FILLIMI I ISLAMIT TË ENSARËVE .....	122
BESËLIDHJA E PARË NË AKABE .....	124
BESËLIDHJA E DYTË NË AKABE .....	125
KUSHTET E BESËLIDHJES SË FUNDIT NË AKABE.....	130

<b>SHPALLJA E URDHËRIT PËR LUFTË</b> .....	131
<b>LEJIMI I MUSLIMANËVE PËR SHPËRNGULJE NË MEDINË</b> .....	132
<b>MUHAXHIRËT E PARË NË MEDINË</b> .....	133
<b>HIXHRETI I PEJGAMBERIT A.S.</b> .....	134
<b>MBËRRITJA NË KUBA</b> .....	141
<b>MBËRRITJA NË MEDINË</b> .....	142
<b>FJALIMET DHE KONTRATAT NË MEDINË</b> .....	145
<b>VËLLAZËRIMI MES MUHAXHIRËVE DHE ENSARËVE</b> .....	150
<b>ÇËSHTJA E EZANIT</b> .....	151
<b>SHOKËT E SËMURË TË PEJGAMBERIT A.S.</b> .....	152
<b>DATA E HIXHRETIT</b> .....	153
<b>BETEJA E PARË</b> .....	154
<b>EKSPEDITA E UBEJDE B. HARITH - FLAMURI I PARË I NGRITUR</b> <b>NGA PEJGAMBERI A.S.-</b> .....	155
Dalja e çetës së Hamzës në bregdet .....	155
Ekspedita në Buvat .....	155
Ekspedita në Ushajre .....	155
Ekspedita e Sa'd b. Ebi Vekkasit .....	156
Ekspedita në Safvan apo ekspedita e parë e Bedrit .....	156
Ekspedita e Abdullah b. Xhahshit.....	156
<b>RIORIENTIMI I KIBLES NË DREJTIM TË QABESË</b> .....	159
<b>BETEJA E MADHE E BEDRIT</b> .....	160
Ekspedita kundër fisit Benu Sulejm në Kuder .....	175
Ekspedita në Sevik .....	175
Ekspedita në Dhu Emer .....	176
Ekspedita në Furu' pranë Bahranit.....	176
<b>NGJARJA ME FISIN BENU KAJNUKA</b> .....	177
Ekspedita e Zejd b. Harithe në Karede, burim në Nexhd .....	178
<b>BETEJA E UHUDIT</b> .....	179
Ngjarja në Rexhi' (viti 3 h.).....	194
<b>NGJARJA TE PUSI MAUNE (SAFER, VITI 4 H.)</b> .....	199
<b>DËBIMI I BENI NADIRIT (VITI I 4 H.)</b> .....	201
Ekspedita në Dhatut- Rika (viti i 4 h.) .....	204
<b>BETEJA E DYTË NË BEDËR (SHABAN, VITI I 4 H.)</b> .....	207
Ekspedita Dumetul-Xhendul (rebiul-evvel, viti i 5 h.) .....	207
<b>BETEJA NË HENDEK (SHEVVAL, VITI I 5 H.)</b> .....	208
<b>BETEJA KUNDËR FISIT BENI KUREJDHA (VITI I 5 H.)</b> .....	217
Ekspedita në Beni Lihjan .....	225

Ekspedita në Dhu Kared .....	226
Ekspedita në Beni Mustalik .....	227
Rasti i shpifjes gjatë ekspeditës në Beni Mustalik (viti i 6 h.).....	231
NGJARJA NË HUDEJBIJE (NË FUND TË VITIT 6 H.) .....	237
Besëlidhja e Hudejbijes - Bej'atur-Ridvan (Betimi për besnikëri) - .....	241
MARRËVESHJA E PAQES NË HUDEJBIJE .....	242
DALJA NË HAJBER (MUHARREM, VITI I 7 H.) .....	246
ARDHJA E XHA FER B. EBI TALIBIT NGA ABISINIA DHE ADRESIMI I TIJ MUHAXHIRËVE .....	252
UMRA SUPLEMENTARE (DHUL-KADE, VITI I 7 H.) .....	253
BETEJA E MU'TES (XHUMADEL-ULA, VITI I 8 H.) .....	255
ÇLIRIMI I MEKËS (RAMAZAN, VITI 8 H.).....	259
BETEJA NË HUNEJN (VITI I 8 H. PAS ÇLIRIMIT TË MEKËS) .....	274
BETEJA E TAIFIT (VITI I 8 H.) .....	281
PLAÇKA E LUFTËS DHE ROBËRIT E HEVAZINIT .....	284
UMRA E PEJGAMBERIT A.S. NGA VENDI XHI'RANE.....	289
Rasti i Ka'b b. Zuhejrit pas tërheqjes nga Taifi .....	289
BETEJA E TEBUKUT (REXHEB, VITI I 9 H.) .....	292
PEJGAMBERI A.S. DËRGON HALID B. VELIDIN TE UKEJDIR DUME .....	298
DELEGACIONI I FISIT THEKIF DHE KALIMI I TYRE NË ISLAM (RAMAZAN, VITI 9 H.).....	300
VITI I DELEGACIONEVE (VITI I 9 H.) - SHPALLJA E SURES EL-FET' H - .....	304
Ardhja e delegacionit të Beni Temimit - dhe shpallja e sures el-Huxhurat - .....	304
Rasti i Amir b. Tufejlit dhe Erbed b. Kajsit në delegacionin e fisit Beni Amir .....	306
Ardhja e Xharudit në delegacionin e Abdul-Kajsit .....	307
Ardhja e Benu Hanifes, me ta ishte edhe Musejleme Kedhdhabi.....	308
Rasti i Adij b. Hatimit .....	309
Ardhja e Ferve b. Musejk Muradiut .....	311
Ardhja e Amër b. Ma'di Jekrebit me njerëz nga fisi Zubejd .....	312
Ardhja e Esh'ath b. Kajsit në delegacionin e Kindes .....	312
Ardhja e Sured b. Abdullah Ezdiut .....	313
Ardhja e të deleguarve të mbretërve të Himjerit me mesazhin e tyre .....	314
POROSIA E PEJGAMBERIT A.S. PËR MUADHIN, KUR E DËRGOI NË JEMEN.....	316
Pranimi i Islamit nga Beni Harith b. Ka'bi .....	316
DY PROFETËT E RREJSHËM: MUSEJLEME HANEFIU DHE ESVED ANSIU .....	320
DALJA E MËKËMBËSVE DHE AKTIVISTËVE PËR TË MBLEDHUR ZEKATIN.....	321
LETRA E MUSEJLEMIT PËR PEJGAMBERIN A.S. DHE PËRGJIGJA E PEJGAMBERIT A.S. ....	322

<b>HAXHI LAMTUMIRËS.....</b>	<b>323</b>
<b>Dërgimi i Usame b. Zejdit në Palestinë.....</b>	<b>324</b>
<b>Shkuarja e të deleguarve të Pejgamberit a.s.tek sundimtarët përreth .....</b>	<b>324</b>
<b>Ekspeditat e fundit (të ushtrisë) .....</b>	<b>326</b>
<b>FILLIMI I SËMUNDJES SË PEJGAMBERIT A.S. ....</b>	<b>327</b>
<b>GRATË E PEJGAMBERIT A.S. - NËNAT E BESIMTARËVE - .....</b>	<b>329</b>
<b>PËRSËRI RRETH SËMUNDJES SË PEJGAMBERIT A.S. ....</b>	<b>333</b>
<b>NJERËZIT NË NAMAZ I UDHËHEQ EBU BEKRI R.A. ....</b>	<b>336</b>
<b>NGJARJA NË ÇADRËN E FISIT BENI SA'ADE.....</b>	<b>340</b>
<b>PËRGATITJA E PEJGAMBERIT A.S. DHE VARRIMI I TIJ .....</b>	<b>345</b>



## PARATHËNIE

Një dritë u përhap në errësirat e injorancës dhe idhujtarisë pikërisht ashtu siç përhapen retë. Përudhja e Allahut e dërgoi atë për këtë njerëzim të shpërkëndur, të cilin e shpëtoi nga humbja dhe shkatërrimi. Drita e shpëtoi njerëzimin nga rënia në errësirat e thella dhe nga pasojat e humbjes.

Jeta e Muhamedit a.s. ishte një faqe e gjerë nga faqet e përpjekjes për shpëtimin e këtij njerëzimi. Ai ishte një shëmbëlltyrë e sinqertë nga shëmbëlltyrat e mirësisë dhe mëshirës. Ai kishte një jetëshkrim të lartë dhe të fisshëm në mirësjellje ndaj Krijuesit dhe ndaj krijesave.

Dritat e këtij jetëshkrimi shkëlqejnë në Librin e Allahut, që thotë:

*“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!”*

Shkëlqejnë edhe në horizontet e librave të shkruar që në kohët e hershme nga dijetarët, libra që përmbajnë ende diçka nga ajo aromë dhe vezullime nga ai ndriçim.

Paqja, shpëtimi, kënaqësia dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të! (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem)



## HYRJE

### Historia dhe biografia

Arabët gjatë kohës së xhahilijetit për historinë e tyre dinin vetëm atë që kishin trashëguar përmes transmetimeve gojore. Natyra e historisë atëbotë përputhej me natyrën e jetës arabe; aty kishte mburrje me baballarë dhe gjyshër, tregime mbi trimërinë, fisnikërinë dhe ndershmërinë; kishte lajme që flitnin për prejardhjen dhe koalicionet, legjenda për Qabenë dhe shërbyesit e saj, për burimin e Zemzemit, pastaj lajme për fisin Xhurhum dhe për liderët e fisit Kurejsh, për përpjekjet e nxitjes së përcarjes në popull, për lajmet rreth magjistarëve dhe magjive të tyre dhe gjëra të tjera të ngjashme të cilat pasqyrojnë jetën e tyre të përgjithshme fetare, politike dhe shoqërore.

Kur erdhi Islami, i gjeti ata duke i transmetuar dhe ritreguar ato lajme dhe informata. Pastaj, pas paraqitjes së thirrjes islame, kësaj lënde të pasur dhe të bollshme (që gjithashtu e përcillnin mes vete gojarisht) iu bashkëngjitën shenjat e çuditshme që paralajmëronin pejgamberinë, jetën e Pejgamberit a.s.<sup>1</sup> para Shpalljes, rritjen e tij fisnike, lajmet që e pasonin Shpalljen, lajmet e muslimanëve, të sahabëve të Pejgamberit, lajmet për armiqhtë e Pejgamberit, për raportet e tij me muslimanët, me idhujtarët, me të krishterët dhe me hebrenjtë. Kur'ani Famëlartë, Hadithi i Pejgamberit dhe fjalët e sahabëve gjithashtu paraqitnin një regjistër të pasur për atë jetë të re.

Kur'ani u shkrua, ndërsa Hadithi i Pejgamberit për një kohë të gjatë mbeti larg shkrimit, atë njerëzit e mësonin përmes transmetimeve të besueshme gojore. Në përgjithësi, askush nuk kishte guxim që ta shkruante hadithin duke vepruar sipas hadithit të transmetuar nga Ebu Seid el-Hudriu, se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Mos shkruani asgjë nga unë përveç Kur'anit. Çdokush që ka shkruar ndonjë gjë tjetër përveç Kur'anit, duhet ta fshijë atë!”*

Arsyeja e këtij qëndrimi ishte e qartë, ekzistonte frika se mos përzihej Shpallja që ishte duke zbritur me Hadithin e Pejgamberit. Shihet qartë se me këtë ndalesë u synua mbrojtja e qëllimit fisnik dhe pa dyshim kjo ndalesë ishte për aq kohë sa vazhdonte zbritja e Kur'anit.

<sup>1</sup> Shprehja arabisht “sal-lAllahu alejhi ve sel-lem”, që shqip do të thotë: “paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të”, në vazhdim të tekstit do të përdoret e shkruar me shkurtesën a.s.. Përkthyesi.

Kjo gjendje vazhdoi kështu deri në kohën e halifit Omer b. Abdulaziz<sup>2</sup>, i cili sundoi prej vitit 99 deri në vitin 101 të hixhretit. Theksohet se ai i ishte lutur Allahut për 40 ditë mbi çështjen e shkrimit të hadithit dhe Allahu e kishte udhëzuar se mund të shkruante, kështu që ky e kishte lejuar Ebu Bekër b. Muhammed b. Omer b. Hazmin, i cili i kishte shkruar të gjitha hadithet që dinte përmendsh në një përmbledhje, të cilën pastaj e kishte dërguar nëpër qendrat e vendit. Ky Ebu Bekri ishte gjykatës dhe guvernator i Medinës dhe kishte vdekur në vitin 120 h.

Omer b. Abdulazizi gjithashtu urdhëroi Muhammed b. Muslim b. Shihab Zuhriun<sup>3</sup>, mësuesin e Malikut, që t'i shkruante hadithet e Pejgamberit, dhe ai përpiloi një përmbledhje hadithesh.

Pas kësaj, muslimanët vazhduan të shënonin hadithe, por librat e tyre nuk kishin ndonjë plan dhe kriter të përbashkët, ata vetëm i tubonin ashtu siç u përshtatej atyre. Kështu p.sh., ndonjëri prej tyre përpilonte një libër vetëm për një temë të shariatit, më pastaj shkrimi fillon të nuancohet, kështu që librat e hadithit mund t'i shohim të ndarë në kapituj, si p.sh. duke ndarë kapitull të veçantë për hadithet që flasin për Pejgamberin a.s., për lindjen e tij, për fëmijërinë dhe të tjerat deri në ardhjen e Shpalljes, pastaj në kapitullin tjetër kanë vendosur hadithet që flasin për gjendjen e tij më vonë në Mekë, për thirrjen që u bëri Kurejshëve në fenë e Allahut, për durimin e tij ndaj torturave që iu bënë atij dhe sahabëve të tij, gjithashtu kanë hartuar tema mbi ekspeditat ushtarake, përgatitjet e ushtrisë dhe çështjet e tjera që lidhen me luftën.

Historianët morën një drejtim tjetër, disa duke shkruar libra nga historia e përgjithshme e disa duke u specializuar ekskluzivisht në historinë e jetës së Pejgamberit a.s., duke i ngopur kështu apetitet e posaçme fetare, të cilët në personalitetin e Pejgamberit pa dyshim shihnin shembullin për muslimanët dhe udhëzimin për të udhëzuarit.

#### Autorët e biografive<sup>4</sup>

Autori i parë që shkroi biografi<sup>5</sup> ka qenë Urve b. Zubejr b. Avvam (në vitin 92 h.), pastaj Ebban b. Osman (në vitin 105 h.), Vehb b. Munebbih (në vitin 110 h.), Sherhabil b. Sa'd (në vitin 123 h.), Ibn Shihab Zuhri (në vitin 124 h.) dhe Abdullah b. Ebi Bekër b. Hazm (në vitin 135 h.), etj.

<sup>2</sup> Shkurtesa *b.*, e cila do të përdoret në tekst, zëvendëson fjalën *ibn* dhe *bin* me kuptim *i biri* ose *djali*. Përkthyesi.

<sup>3</sup> Shprehja *el-*, e cila vendoset në fillim të fjalëve arabe, në pjesën dërrmuese tek emrat e përveçëm është nyje shquese, ku shkronja e dytë *l* shkrihet në shkronjën e parë të fjalës që i ngjitet, siç është vepruar me shkronjën *z* në këtë emër. Përkthyesi.

<sup>4</sup> Me fjalën biografi këtu nënkuptojmë vetëm biografite e Pejgamberit a.s. e jo biografi të tjera. Përkthyesi.

<sup>5</sup> Biografi kushtuar Pejgamberit a.s.. Përkthyesi.

Librat e të gjithë këtyre autorëve kanë humbur, nuk kanë mbetur prej tyre veçse fragmente të shpërndara që mund të gjenden në brendi të librave të historisë, siç është *“Historia”* e Taberit. Është ruajtur vetëm një pjesë e librit të Vehb b. Munebbehut dhe gjendet në qytetin Heidelberg, në Gjermani.

Pas tyre erdhi një plejadë autorësh, ndër të cilët më të famshmit ishin Musa b. Ukbe (në vitin 141 h.), Muammer b. Rashid (në vitin 150 h.) dhe Muhammed b. Is’hak (në vitin 152 h.).

Pastaj vjen gjenerata tjetër ku bënin pjesë Zijad Bekkai (në vitin 183 h.), Vaki-diu, autori i veprës *“El-Megazi”* (në vitin 207 h.), Ibni Hishami (në vitin 218 h.) dhe Muhammed b. Sa’d, autori i veprës *“Et-Tabekat”* (në vitin 230 h.).

### Biografia e Ibni Is’hakut

Nga të gjithë këta, libri më i rëndësishëm dhe më i besueshëm ishte *“Biografia e Ibni Is’hakut”*<sup>6</sup>, të cilin e ka shkruar në ditët e para të abasitëve. Transmetohet se ai kishte shkuar në Bagdad te Mensuri, para të cilit ndodhej edhe djali i tij Mehdiu, kurse Mensuri e kishte pyetur: *“A po e njeh këtë, o Ibni Is’hak?”* Ai ishte përgjigjur: *“Po, ky është djali i udhëheqësit të besimtarëve.”* Mensuri i tha: *“Shko dhe përpiloja atij një libër që nga koha kur Allahu e krijoi Ademin a.s.<sup>7</sup> e deri në ditët e sotme!”*

Ibni Is’haku e përpiloi këtë libër dhe halifi i tha: *“E paske zgjatur, o Ibni Is’hak, kthehu dhe shkurtoje!”*

Ai libër në format të madh mbeti në thesaret e udhëheqësit të besimtarëve.

<sup>6</sup> Ai është Muhammed b. Is’hak b. Jesar b. Hijar, Ebu Abdullah Medeniu Kureshiu, rob i liruar i Kajs b. Mahzeme b. Muttalib b. Abdu Menaf. Gjyshi i tij Jesari kishte rënë në robëri të Ajn Temrit, vend në perëndim të Kufes, andej nga brendia, të cilin e çliruan muslimanët gjatë halifatit të Ebu Bekrit në vitin 12 dhe me atë rast e sollën në Medinë. Atij i lindi nipi Muhammed në vitin 85, i cili aty kaloi edhe rininë. Pastaj udhëtoi nëpër qytete islame, ndër të cilat në vitin 115 shkoi në Aleksandri, ku la një shkrim mbi një grup egjiptianësh. Pastaj udhëtoi në Kufe, e vizitoi Gadishullin (Arab), Rejjin, Basrën dhe Bagdadin, në të cilin u vendos dhe aty e gjeti vdekja, në vitin 152 h.

Ibni Adiu për të thotë: *“Ibni Is’haku ka nderin e mjaftueshëm që ishte i pari i cili u tërhoqi vëmendjen sundimtarëve nga librat e padobishëm drejt preokupimit me ekspeditat e Pejgamberit a.s., me misionin e tij pejgamberik dhe me fillimin e krijimit të botës.”*

<sup>7</sup> Shprehja a.s. *“alejhis-selam”*, që shqip do të thotë: *“Paqja qoftë mbi të”* në vazhdim të tekstit do të përdoret e shkruar shkurt a.s.. Përkthyesi.



## BIOGRAFIA E IBNI HISHAMIT (Siretu Ibni Hisham)

Pas Ibni Is'hakut vjen Ibni Hishami<sup>8</sup>, i cili na e ka përcjellë gati një gjysmë shekulli më vonë "*Biografinë e Ibni Is'hakut*" në formë të redaktuar përmes një njeriu të vetëm, e ai është Zijad Bekaiu<sup>9</sup>.

Ky libër i Ibni Is'hakut, të cilin na e ka përcjellë Ibni Hishami, nuk ka qenë i këtitllë siç e kemi ne sot, sepse Ibni Hishami i ka bërë një redaktim duke hequr dhe duke shtuar, e nganjëherë e ka kritikuar dhe i është kundërvënë me transmetime të dijetarëve të tjerë. Në fillim të *Biografisë* ai ka sqaruar pjesërisht metodën e prezantimit të këtij libri.

Ne aspak nuk dyshojmë në atë se Ibni Hishami ka vepruar me besnikëri, përgjegjësi dhe profesionalizëm dhe se nuk ka ndryshuar asnjë fjalë të Ibni Is'hakut, as nuk ka shtuar ndonjë fjalë gjatë sqarimit të gabimit apo gjatë sqarimit të së pakuptueshmes apo gjatë kundërvënies së transmetimeve e që para saj të mos thotë: "Ibni Hishami thotë...".

Qëllimi themelor i tij ishte që transmetimin e tij të *Biografisë* ta bënte më konciz, kështu që ka eliminuar pjesët që kanë qenë para historisë së Ismailit birit të Ibrahimit (paqja qoftë mbi ata të dy), nga fillimi i krijimit, pastaj kapitujt që flitnin për djemtë e Ismailit si dhe të gjitha lajmet që nuk kishin lidhje me biografinë e Pejgamberit – sipas mendimit të tij – njëherazi ka larguar edhe shumë poezi për të cilat dyshonte në besueshmërinë e transmetuesve të tyre.

Kush e hulumton me kujdes principin e Ibni Hishamit në prezantimin e *Biografisë*, pa dyshim do ta vërejë përgjegjësinë e tij të theksuar dhe profesionalizmin e skajshëm, gjë që ishte karakteristikë e dijetarëve muslimanë në kohët e vjetra.

<sup>8</sup> Ai është Ebu Muhammed Abdulmelik b. Hisham b. Ejjub Himjeriu. Është rritur në Basra, pastaj shkoi në Egjipt, ku u takua me Imam Shafiun, ku i recituan njëri-tjetrit mjaft vargje nga poezia arabe. Ibni Hishami, përveç redaktimit të *Biografisë së Ibni Is'hakut*, përpiloi një libër mbi origjinën e fisit Himjer dhe mbretërve të tyre si dhe një libër mbi komentimin e poezive që gjenden në librat e biografive, të cilat nuk kanë bazë në poezinë arabe. Vdiq në qytetin Fustat, në vitin 218 h.

<sup>9</sup> Ai është Hafidh Ebu Muhammed Zijad b. Abdulmelik b. Tufejl Bekkaiu Amiriu Kufiu. Bekkaiu është emër që tregon prejardhjen e tij nga fisi Benu Bekka nga Benu Amir b. Sa'sa'. Kur erdhi Zijadi në Bagdad, u foli njerëzve mbi ekspeditat e Pejgamberit a.s. duke iu referuar Muhammed b. Is'hakut, siç u foli edhe për të drejtën trashëgimore duke iu referuar Muhammed b. Salimit. Pastaj u kthye në Kufe dhe aty vdiq gjatë halifatit të Harunit në vitin 183 h. Ibni Hishami shumë e çmonte këtë dijetar, kështu që në fillim të librit të tij thotë: "*Unë i kam lëshuar disa gjëra të cilat është keq të fliten, pastaj disa që lëndojnë disa njerëz si dhe disa që nuk na i ka konfirmuar Bekkaiu me transmetimin e tij!*"

## Rëndësia e “Biografisë” së Ibni Hishamit

Sido që të jetë, libri i Ibni Is’hakut ka qenë dhe mbetet deri në ditët e sotme vepër themelore për lexuesit e biografisë së Pejgamberit a.s.. Gati është e pamundur të gjendet dikush që sadopak është marrë me studimin e biografisë së Pejgamberit e që para vetes të mos ketë pasur librin e Ibni Is’hakut.

“Biografia” e Ibni Is’hakut në mesin e dijetarëve që nga kohërat e hershme ka qenë e njohur me emrin “*Biografia e Ibni Hishamit*” për faktin se ai ka bërë interpretimin dhe redaktimin e saj. Ibni Halkan thotë: “Ibni Hishami është ai që ka tubuar biografinë e Pejgamberit a.s., duke përfshirë ekspeditat ushtarake, lëvizjet dhe veprimet që ka shënuar Ibni Is’haku. Pastaj i ka redaktuar dhe saktësuar, kështu që sot përbëjnë biografinë ekzistuese, e cila është në dispozicion të njerëzve dhe njihet me emrin *Biografia e Ibni Hishamit*.”

Për këtë biografi, studiuesit dhe komentatorët kanë treguar interesim të madh. Kështu, Ebul-Kasim Abdurrahman Suhejliu<sup>10</sup> i bëri një komentim voluminoz në veprën e tij të quajtur *Err-Rrevdul-unuf* (Livadhi i paprekur).

Pas tij vjen Ebu Dherr Hasheniu<sup>11</sup>, i cili bëri sqarimin e vendeve më pak të njohura të këtij libri dhe një vështrim të vogël kritik, të cilat i përfshiu në veprën e tij me titull *Sherhus-Siretin-Nebevijeh* (Komentim i Biografisë së Pejgamberit), të cilin e ka publikuar dr. Bronle.

Edhe Bedruddin Muhammed b. Ahmed Ajniu i ka bërë një koment këtij libri, të cilin e ka quajtur *Keshful-litham fi sherhi sijreti Ibni Hisham* (Zbulimi i mbulesës në komentin e Biografisë së Ibni Hishamit), të cilin e ka kryer në vitin 805.

Nga ana tjetër, gjejmë edhe të tjerë të cilët kanë anuar nga shkurtimi i *Biografisë*; prej tyre Burhanuddin Ibrahim b. Muhammed, i njohur si Ibn Mirhal Shafiu, i cili e shkurtoi nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër i shtoi disa pjesë, të cilat ka menduar se i mungojnë, kështu librin e ka bërë me 18 kapituj dhe e ka quajtur *Edh-dhehijreh fi muhtesaris-Sijreh* (Thesar në Përmbledhjen e Biografisë), të cilin e përfundoi në vitin 611. Pastaj Ebul-Abbas Ahmed b. Ibrahim b. Abdurrahman Vasitiu, i cili gjithashtu e shkurtoi në një libër, të quajtur *Muhtesaru Sijreti Ibni Hisham*, të cilin e përfundoi në vitin 711.

Prej atyre që këtë libër e kanë thurur në poezi është Ebu Muhammed Abdulaziz b. Muhammed b. Seid Dumejriu Dejriniu, i cili ka vdekur në vitin 663, dhe Ebu Bekër Muhammed b. Ibrahim, i njohur si Ibni Shehid, i cili ka vdekur në

<sup>10</sup> Ai është Ebul-Kasim Abdurrahman b. Abdullah b. Ahmed b. Asbeg Hath’amiu Suhejliu Endelusiu Malikiu. Suhejl është emër i një lugine në Andaluzi, në provincen Malika. Gati krejt jetën e tij e ka kaluar në Andaluzi, ku edhe ka lindur në vitin 508 h., tre vitet e fundit të jetës tij i kaloi në Merakesh, ku edhe vdiq në vitin 581 h.

<sup>11</sup> Ai është Ebu Dherr Mus’ab b. Muhammed b. Mes’ud el-Xhejanij el-Hashenij, me prejardhje nga Hasheni, fshat në Andaluzi, nga një fis i Kuda’as. Ka lindur në vitin 532, ndërsa ka vdekur në vitin 604.

vitin 793. Ky librin e tij e quajti *El-Fet'hul-karib fi siretil-Habib* (Fitorja e afërt në biografinë e të dashurit), që përmbante disa mijëra vargje.

### Redaktimi i biografisë së Ibni Hishamit

Në rininë time të hershme jam përpjekur herë pas here ta lexoj këtë libër shumë të çmuar që nga fillimi deri në fund, por më pengonte paqartësia dhe mungesa e konsekuencës që shihja në hartimin e librit, që ma mundonte trurin dhe më shkaktonte mërzë, kështu që lexoja vetëm fragmente të shkëputura të cilat më dukeshin si kopshte në mes të shkretëtirës, që me madhësinë e mesazhit dhe bukurinë e shprehjes më joshnin për lexim.

Në realitet, unë në leximin e Biografisë ndieja një fetari të sinqertë dhe nënshtrim të përgjashëm me atë të leximit të Kur'anit dhe të hadithit të Pejgamberit a.s.. Ndoshta vetëm ndonjë fshehtësi më ka shtyrë që t'i kthehem përsëri leximit, pastaj edhe fakti se babai im ka qenë prej atyre që kanë shkruar Biografi. Ai ka hartuar një përmbledhje të cilën e ka quajtur *Telhisud-durusil-evvelijjeti fis-siretil-Muhammedijeh* (Përmbledhje e mësimëve fillestare në biografinë muhamedane), të cilën e ka përpiluar në tridhjetë mësimë. Ky libër për një kohë të gjatë ka shërbyer si tekst shkollor në institute fetare, ku me planprogramin mësimor kanë qenë të parapara ligjëratat të posaçme të quajtura *Mësimë nga Biografia e Pejgamberit*.

Mirëpo unë, përkundër kësaj, nuk arrita ta lexoja librin në tërësi, siç theksova, për shkak të paqartësisë në hartim dhe përhapjes së mungesës së konsekuencës. Lexuesin e *Biografisë* e pengojnë kapitujt e gjatë me emrat e robërve të Bedrit, emrat e pjesëmarrësve të Betejës së Bedrit, lista me emrat e pjesëmarrësve muslimanë në Bedër, nga Kurejshët dhe nga ensarët, kush prej tyre ka rënë shehid në Bedër, pastaj kush ka vlarë kënd nga mushrikët, poezitë që janë thurur për Betejën e Bedrit dhe shumë çështje të tjera të ngjashme me këto, siç janë poezitë e gjera, gjenealogjitë e gjata, llafologjitë gjuhësore, pjesë nga komentimi i Kur'anit, të cilat nuk kanë lidhje direkte me *Biografinë*, por as nuk janë jashtë saj.

Një çështje tjetër është zinxhiri i transmetuesve me të cilin fillon pjesa dërrmuese e kapitujve të *Biografisë*, që nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë përveçse për kritikët dhe ekspertët.

Unë në këtë redaktim jam përpjekur që nga libri të nxjerr vetëm atë që është më qenësore, vetëm të a.q. tekst themelor dhe t'ia ofroj lexuesit me një petk të ri, të lehtë për shikim dhe tërheqës për lexim. I kam kushtuar kujdesin maksimal tekstit autentik, që lexuesi të ketë mundësi ta shfrytëzojë dhe ta citojë njëjtë si në botimin e tij burimor. Unë në tekstin e librit nuk kam ndryshuar asnjë shkronjë

dhe deri në fund kam qenë konsekuent. Jam kujdesur që sa herë që kam cituar fjalët e Ibni Hishamit, gjithmonë para tyre kam vendosur emrin e tij ose e kam vendosur të veçantë në fusnotën e librit, ashtu siç kërkohej në kontekst. Ndërkaq, tekstet e tjera janë tekste të Ibni Is'hakut, të transmetuara nga Ibni Hishami. Zinxhirin e transmetuesve nuk e kam përmendur përveçse kur ka qenë e domosdoshme për citimin e tekstit, pavarësisht a ka qenë i theksuar nga Ibni Is'haku apo nga Ibni Hishami.

Jam përpjekur që të gjitha tekstet t'i redaktoj, pastaj të sqaroj ato që kanë pasur nevojë për sqarim duke u bazuar në komentatorët e *Biografisë* dhe në literaturën tradicionale.

Sido që të jetë, ky redaktim është një lloj lehtësimi për ata që nuk kanë pasur rastin ta lexojnë origjinalin si dhe është një lidhëz e shëndoshë që e lidh rininë e sotme me trashëgiminë e tyre të vjetër fisnike.

Mjafton që ti ke mundësi ta lexosh këtë libër vetëm për disa ditë dhe të fitosh prej tij shumë të mira të menjëhershme, ndërsa nëse e lexon origjinalin, do ta kesh shumë më vështirë dhe do të të marrë disa muaj kohë.

E lus Allahun që këtë libër ta bëjë të dobishëm. Gjithashtu konsideroj se me të i kam dhënë një kontribut të vogël shkencës, ndërsa ajo që kam dashur të arrij me këtë është kënaqësia e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij.

Kajro e Re, 2 rebiuth-thani 1396 – prill 1976.

*Abdusselam Harun*

**REDAKTIMI I BIOGRAFISË  
SË IBNI HISHAMIT**



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Në emër të Allahut, Mëshirëbërësit, Mëshiruesit!*

**PREJARDHJA E PASTËR NGA MUHAMEDI A.S. DERI TEK ADEMI A.S.**

Ebu Muhammed Abdulmelik Ibni Hishami ka thënë:

Ky është libri i biografisë së të Dërguarit të Allahut (*a.s.*): Muhamed bin Abdullah bin Abdulmuttalib (emri i Abdulmuttalibit është Shejbe) bin Hashim (emri i Hashimit është Amër) bin Abdi Menaf (emri i Abdi Menafit është Mugire) bin Kusaj (emri i Kusajit është Zejd) bin Kilab bin Murre bin Ka'b bin Luejj bin Galib bin Fihri bin Malik bin Nadr bin Kinane bin Huzejme bin Mudreka (emri i Mudrekes është Amir) bin Iljas bin Mudar bin Nizar bin Meadd bin Adnan bin Edd bin Mukavvim bin Nahur bin Tejrih bin Jarub bin Jashxhub bin Nabit bin Ismail bin Ibrahim Halilurrahman bin Tarih (ai është Azeri) bin Nahur bin Savirig bin Rauv bin Falih bin Ujbir bin Shalih bin Erfahshedh bin Sam bin Nuh bin Lemk bin Mettushelah bin Uhnuh (ai është Pejgamberi Idris sipas disave) bin Jerd bin Mehlil bin Kajnen bin Janush bin Shejth bin Adem (*a.s.*).

Ibni Hishami ka thënë:

Unë, nëse do Allahu, këtë libër po e filloj me Ismailin birin e Ibrahimit dhe do t'i theksoj të gjithë pasardhësit e tij një nga një, nga Ismaili deri te Pejgamberi *a.s.*, siç do t'i theksoj edhe fjalët që transmetohen prej tyre, ndërkaq për shkak shkurtese nuk do t'i theksoj ata pasardhës të Ismailit që nuk janë në këtë linjë. Pastaj do të kaloj te vetë biografia e Pejgamberit *a.s.*, ku kam lënë jashtë disa fragmente që ka theksuar Ibni Is'haku në libër, por në të cilat nuk përmendet Pejgamberi *a.s.* dhe nuk është shpallur ndonjë ajet nga Kur'ani. Fragmentet e lëna jashtë nuk kanë ndonjë rëndësi për librin, nuk sqarojnë apo argumentojnë ndonjë gjë, prandaj i kam hequr për shkak shkurtese, gjithashtu edhe disa poezi të theksuara prej tij, të cilat janë të panjohura për njohësit e poezisë. Pastaj, aty janë disa gjëra për të cilat është e papërshtatshme të flitet, ndërsa disa madje do të lëndonin dikë nëse thuheshin, kurse disa të tjera nuk i ka konfirmuar as Bekkai<sup>12</sup> në transmetimin e tij. Të gjitha të tjerat, nëse do Allahu, do t'i paraqes sipas materialit që kam në dispozicion dhe sipas diturisë që kam për të.

<sup>12</sup> Ai është mësuesi i Ibni Hishamit dhe nxënës i Ibni Is'hakut. Emri i tij është Zijad b. Abdullah b. Tufejl Bekkai. Vdiq në vitin 183. Bekka është një degë e fisit Benu Amir b. Sa'sa'.

## GJENEALOGJIA E PASARDHËSVE TË ISMAILIT

Ismaili biri i Ibrahimit a.s. pati dymbëdhjetë djem, emrat e të cilëve janë: Nabit, Kajdher, Edhbel, Misha, Musme'a, Mashi, Dima, Edher, Tima, Jatur, Nebesh dhe Kajdhum.

Nabiti biri i Ismailit lindi Jashxhubin, kurse Jashxhubi lindi Jarubin, Jarubi lindi Tejrihun, Tejrihu lindi Nahurin, Nahuri lindi Mukavvimin, Mukavvimi lindi Ededin dhe Ededi lindi Adnanin.

Nga Adnani u krijuan shumë fise, të cilat përbëjnë pasardhësit e Ismailit.

Adnani lindi dy djem: Me'add bin Adnan dhe Akk bin Adnan.

Akku shkoi në Jemen sepse u martua nga esh'arijët dhe mbeti atje. Kështu u bënë një edhe gjuha edhe atdheu i tij. Esh'arijët janë pasardhës të Esh'ar bin Nebt b. Eded b. Humejsi' b. Amër b. Urej b. Jashxhub b. Zejd b. Kehlan b. Jashxhub b. Ja'rub b. Kahtan.

Nga Meadd bin Adnani lindën katër djem: Nizari, Kuda'a, Kanesi dhe Ijadi. Kuda'a shkoi në Jemen dhe iu bashkua fisit të Himjer b. Sebe'. Fisi i Kanesit, sipas pohimeve të gjenealogëve të Meaddit, është zhdukur. Prej tyre ka qenë Nu'man b. Mundhir, mbreti i Hires.

## ËNDRRA E REBIA BIN NASRIT

Rebia bin Nasr ka qenë mbret i Jemenit, njëri nga shumë sundimtarët teba-bias, i cili njëherë kishte parë një ëndërr të tmerrshme, që e kishte frikësuar shumë. Ai kishte thirrur dhe kishte tubuar të gjithë parashikuesit, magjistarët, falltarët, astrologët e mbretërisë së tij dhe u kishte thënë: “Kam parë një ëndërr të tmerrshme dhe jam frikësuar. Më tregoni për të dhe ma komentoni!”

Ata i thanë: “Na e trego atë dhe ne do ta komentojmë.” Ai tha: “Nëse jua tregoj nuk jam i sigurt se do të ma komentoni drejt sepse komentimin e saj e di vetëm ai që e di para se t’ia tregoj unë.” Atëherë njëri prej tyre tha: “Nëse mbreti e do këtë, atëherë le të thirren Satihu dhe Shikku sepse nuk ka asnjë më të ditur se ata dhe ata të dy do t’ia japin përgjigjen e asaj që dëshiron!”

Atëherë mbreti dërgoi dikë për t’i thirrur ata të dy dhe Satihu erdhi para Shikkut.

Mbreti i tha: “Vërtet kam parë një ëndërr të tmerrshme dhe jam frikësuar, ma shpjego atë. Nëse e di, ti e di edhe komentimin!”

Satihu tha: *“Do ta bëj! Ti ke parë xixëllonja që dalin nga errësira dhe zbresin në ultësirë, pastaj hanë gjithçka që ka kafkë!”*

Mbreti i tha: “Asgjë nuk ke gabuar, o Satih, më thuaj komentimin e saj.”

Satihu tha: *“Të betohem për luginën mes dy guroreve të Haneshit, në tokën tuaj do të zbarkojë ushtria e Habeshit, dhe do t’i pushtojë të gjitha vendet mes Ebjenit dhe Xhureshit!”<sup>13</sup>*

Mbreti i tha: “Për babanë tënd o Satih, kjo për ne është shumë irrituese dhe e dhimbshme. Kur do të ndodhë, në kohën time apo pastaj?”

Tha: *“Jo, pas një kohe, më shumë se gjashtëdhjetë apo shtatëdhjetë vite do të kalojnë!”*

Mbreti i tha: “A do të zgjasë pushteti i tyre apo do të ndërpritet?”

Tha: *“Jo, pas shtatëdhjetë e disa vitesh do të ndërpritet, pastaj do të luftohen dhe prej aty duke ikur do të nxirren.”*

Mbreti i tha: “Po kush do t’i luftojë dhe do t’i dëbojë ata?”

Tha: *“Do t’i luftojë Irem bin Dhi Jezeni, ai do t’i sulmojë nga Adeni, askënd prej tyre nuk do ta lë te Jemeni!”*

Mbreti i tha: “A do të zgjasë pushteti i tij apo edhe ai do të ndërpritet?”

Tha: *“Do të ndërpritet.”*

Mbreti i tha: “Kush do ta ndërpresë?”

Tha: *“Një Pejgamber bujar, të cilit i vjen shpallja nga lart!”*

Mbreti i tha: “Nga ç’originë do të jetë?”

<sup>13</sup> Ebjen dhe Xhuresh janë emrat e dy qyteteve në Jemen.

Tha: *"Një burrë nga Galib b. Fihir b. Malik b. En-Nadr, do të jetë mbret në popullin e tij deri në fund të kohës!"*

Mbreti i tha: *"A e ka koha fundin e saj?!"*

Tha: *"Po, dhe të gjithë njerëzit atëherë do të tubohen, të parët dhe të fundit do të bashkohen, atëherë bamirësit do të shpërblehen, ndërsa keqbërësit do të ndëshkohen!"*

Mbreti i tha: *"A është e vërtetë kjo që po më thua?"*

Tha: *"Po, pasha agimin dhe natën kur errësohet!*

*Dhe pasha mëngjesin kur të plotësohet!*

*Ajo çfarë të kam thënë mund të vërtetohet!"*

Pastaj erdhi Shikku dhe mbreti edhe këtij i bëri të njëjtat pyetje sikurse Satihut, por nuk i tregoi se çfarë i kishte thënë Satihu, për të parë se a do të thonë të dy të njëjtën gjë apo jo.

Shikku tha: *"Po, ti ke parë xixëllonja, që dalin prej errësirës dhe bien mes livadhut e kodrinës, pastaj i hanë të gjitha gjallesat!"*

Kur e tha këtë, mbreti e kishte të qartë se ata të dy pajtoheshin dhe fjalët e tyre ishin të njëjta, vetëm se Satihu tha: *"... zbresin në ultësi, pastaj hanë gjithçka që ka kafkë!"* ndërsa Shikku tha: *"bien mes livadhut e kodrinës dhe i hanë të gjitha gjallesat!"*

Pastaj mbreti i tha atij: *"Asgjë nuk ke gabuar, o Shikk, tani ma thuaj komentimin e saj."*

Shikku tha: *"Betohem për sa ka mes dy guroreve fytyrë insani,  
në tokën tuaj do të zbarkojë ushtria nga Sudani,  
dhe do ta fitojë krejt argjilën nga benani,  
dhe do t'i pushtojë të gjitha vendet nga Ebjeni te Nexhrani!"*

Atëherë mbreti i tha: *"Për babanë tënd o Shikk, kjo për ne është shumë irrituese dhe e dhimbshme. Kur do të ndodhë, në kohën time apo pastaj?"*

Tha: *"Jo, pas një kohe ajo do të ndodhë,  
pastaj një vigan i fuqishëm ju do t'ju shpëtojë,  
kurse ata shumë keq do t'i poshtërojë!"*

Mbreti tha: *"Po kush është ky vigan i fuqishëm?"*

Tha: *"Një djalosh, as i përbuzur as i dobët s'do jetë,  
do të dalë nga familja Dhi Jezen,  
nuk do të lërë asnjërin prej tyre në Jemen!"*

Mbreti tha: *"A do të zgjasë pushteti i tij apo do të ndërpritet?"*

Tha: *"Do të ndërpritet nga një Pejgamber i dërguar,  
që do të vijë me të vërtetën dhe drejtësinë e konfirmuar,  
në mesin e besimtarëve dhe njerëzve të shquar,  
do të jetë mbret i popullit të vet, deri në ditën e daljes për t'u gjykuar!"*

Mbreti tha: *"Ç'është Dita e Gjykimit?"*

Tha: *“Dita në të cilën sundimtarët do të gjykohen,  
e thirrjet nga qielli do të dëgjohen,  
nga të vdekurit dhe të gjallët, e njerëzit do të tubohen,  
të devotshmit atë ditë me fitore do të shpërblehen!”*

Mbreti tha: *“A është e vërtetë kjo që po më thua?”*

Tha: *“Po, pasha Zotin e qiellit dhe tokës,  
dhe të asaj që mes tyre ndodhet,  
krejt ajo çfarë të kam thënë unë,  
është e vërtetë dhe aspak nuk dyshohet!”*

Ajo që i thanë këta të dy ndikoi fort tek Rebia. Ai pastaj u përgatit dhe familjen e tij e dërgoi në Irak. Përmes tyre i dërgoi edhe një letër mbretit persian të quajtur Sabur b. Hurzadh, i cili i vendosi për banim në Hire.

## PUSHTIMI I MBRETËRISË SË JEMENIT NGA ANA E EBU KERIB TUBAN ESADIT DHE MARSHIMI I TIJ NË JETHRIB

Pas shkatërrimit të Rebia b. Nasrit, e gjithë mbretëria e Jemenit iu nënshtrua Hassan b. Tuban Esad Ebu Keribit.

Babai i tij Tuban Esadi i hapi rrugën atij, meqë u nis nga lindja për në Medinë duke u kujdesur që mos t'i shqetësojë banorët e saj, aty madje la edhe djalin e tij, i cili u vra me mashtrim. Pastaj, përsëri erdhi në Medinë, por kësaj here kishte vendosur ta shkatërronte atë bashkë me banorët e saj, mirëpo banorët organizuan mbrojtjen me në krye Amër b. Tal-leh dhe filluan luftimet. Mbrojtësit pohojnë se luftonin kundër tij ditën, ndërsa natën i bënë mikpritje e gosti. Kjo atij i kishte pëlqyer, ndaj ishte shprehur: "Vallahi, populli ynë është shumë fisnik!"

Derisa Tubbeu<sup>14</sup> ishte në gjendje konflikti, tek ai erdhën dy dijetarë hebrej me njohuri të thella, pasi kishin dëgjuar se donte ta shkatërronte Medinën bashkë me banorët e saj, dhe i thanë: "O mbret, mos vepro ashtu! Sepse nëse nuk heq dorë nga ky synim i yti, do të të mbyllet rruga dhe ne nuk mund të të sigurojmë nga dënimi i shpejtë!"

Ai u tha atyre: "Përse të ndodhë kjo?"

Thanë: "Ajo do të jetë vendstrehim i një Pejgamberi, që do të paraqitet nga ky tempull nga fisi Kurejsh, në kohën e fundit, këtu do ta ketë shtëpinë dhe qëndrimin!"

Ai hoqi dorë nga synimi i tij paraprak pasi vërejti se këta të dy ishin dijetarë të mëdhenj, u impresionua shumë nga ajo që dëgjoi, pastaj e la Medinën dhe e pranoi fenë e tyre.

Tubbeu dhe populli i tij ishin adhures idhujsh. Ai u nis për në Mekë, të cilën e kishte rrugës për Jemen. Kur u ndodh mes Usfanit dhe Emexhit<sup>15</sup>, iu afrua një grup njerëzish nga fisi Hudhejl b. Mudrike dhe i thanë: "O mbret, a dëshiron të të udhëzojmë te një shtëpi që ka shumë begati, të cilën e kanë neglizhuar sundimtarët para teje? Është plot me margaritarë, rubinë, flori dhe argjend!" Tha: "Po, sigurisht!" Pastaj ata thanë: "Ajo është një shtëpi në Mekë, të cilën e adhurojnë banorët e saj dhe luten në të!"

Anëtarët e fisit Hudhejl dëshironin shkatërrimin e tij sepse e dinin se ishte shkatërruar çdo sundimtar që kishte ndërmarrë ekspeditë drejt saj apo kishte përdorur dhunë në afërsi të saj.

<sup>14</sup> Ai është Tuban Esad, prindi i Ebu Keribit.

<sup>15</sup> Emexh është një vend në rrëzë të Medinës.

Pasi tashmë ishte përgatitur për atë që i kishin thënë, dërgoi për të pyetur dy rabinët në lidhje me këtë dhe ata të dy i thanë: “Ata njerëz me këtë kanë dashur shkatërrimin tënd dhe të ushtrisë tënde sepse ne përveç Qabesë nuk dimë ndonjë shtëpi mbi tokë që Allahu e ka marrë për Vete. Nëse vepron atë për çfarë të kanë ftuar ata, me siguri do shkatërrohesh ti e bashkë me ty edhe të gjithë ata që do të gjenden aty!”

Tha: “Atëherë, çfarë më urdhëroni të bëj kur të shkoj tek ajo?”

Ata të dy i thanë: “Vepron ashtu siç vepronjë banorët e atyshëm; bëj tavaf rreth saj, madhëroje dhe nderoje, rruaje kokën dhe sillu me përlulje para saj për aq kohë sa të ndodhesh aty.”

Tha: “Po çfarë ju pengon që edhe ju të veproni kështu?”

Thanë: “Vallahi, ajo është shtëpia e gjyshit tonë Ibrahimit, mirëpo banorët e atyshëm na kanë ndërprerë rrugën me idhujt që kanë vendosur përreth saj dhe me gjakun që derdhin pranë saj. Ata janë të papastër, idhujtarë!”

Ai e dëgjoji këshillën e tyre dhe u besoi fjalëve të tyre, sakrifikoi një grup njerëzish të fisit Hudhjel duke ua prerë duart dhe këmbët, pastaj vazhdoi derisa arriti në Mekë. Pas mbërritjes aty, bëri tavaf rreth Qabesë, theri kurban dhe rroi kokën. Në Mekë qëndroi gjashtë ditë, gjatë asaj kohe theri kurbane, u ndau njerëzve ushqim dhe u dha mjaltë.

Ai pa në ëndërr se duhet ta mbulonte Qabenë, ndaj e mbuloi me një mbulesë të trashë, mirëpo përsëri pa në ëndërr se duhet ta mbulonte me një mbulesë më të mirë. Atëherë e mbuloi me një mbulojë nga pëlhura dhe tekstili jemenas.

Pohohet se Tubbeu është i pari që e ka mbuluar Qabenë dhe këtë ua ka porositur edhe mëkëmbësve të tij nga fisi Xhurhum; i ka urdhëruar që ta pastrojnë dhe mos t’ia vendosin afër gjakun dhe cofëtinat. Ai i bëri Qabesë një derë dhe një çelës.

Pastaj doli prej saj në drejtim të Jemenit bashkë me ushtrinë e tij dhe me dy rabinët. Kur arriti atje, e ftoi popullin e tij që ta pranojnë fenë që kishte pranuar ai. Ata e kundërshtuan, por vendosën që për këtë të gjykonte zjarri që gjendej në Jemen.

Ata i drejtoheshin zjarrit për gjykime sa herë që kishin mosmarrëveshje: zjarri e hante tiranin dhe nuk e dëmtonte të shtypurin.

Pastaj populli i tij doli me idhujt dhe me të gjitha ato gjëra që i afroheshin Zotit sipas besimit të tyre, ndërsa rabinët dolën me librat fetarë të varur në qafë. U ulën pranë grykës nga dilte zjarri, kur zjarri doli dhe i kaploi, ata iu kundërvunë atij dhe u frikësuan. Njerëzit e pranishëm i qortuan për këtë veprim të tyre dhe kërkuan që të durojnë. Pastaj ata duruan më tepër derisa zjarri i kaploi nga të gjitha anët dhe i gëlltiti idhujt dhe gjërat me të cilat ata i afroheshin Zotit, bashkë me njerëzit e fisit Himjer që i mbanin ato. Dy rabinët dolën me libra të varur në

qafe, ballin e kishin të mbuluar me djersë, por nuk i kishte dëmtuar zjarri. Fisi Himjeriu bashkua mbretit të tyre dhe e pranoi fenë e tij.

Prej asaj kohe dhe prej atij rasti filloi Judaizmi si fe në Jemen.

Pasi u bë mbret djali i tij, Hassan b. Tubban Esad u nis me banorët e Jemenit për të shkelur tokat arabe dhe joarabe. Kur arritën në Bahrej, fisi Himjer dhe disa fise të tjera refuzuan ta vazhdojnë rrugën me të. Ata deshën të ktheheshin në vendin e tyre dhe në familjet e tyre, prandaj iu drejtuan vëllait të mbretit të quajtur Amër – i cili ishte me ta në ushtri - dhe i thanë atij: “Vrite vëllanë tënd Hassanin dhe po të bëjmë ty mbret, kurse ti pastaj na kthe në vendin tonë!” Ai ra dakord dhe të gjithë e pranuan, përveç Dhu Ruajn el-Himjeriut, i cili e ndaloi këtë dhe nuk e pranoi. Me atë rast Dhu Ruajni recitoi këto vargje:

*Ai që e blen pagjumësinë për gjumë,  
është me fat dhe natën e kalon i lumtur.  
Nëse Himjeri mashtron dhe tradhton,  
Atëherë, o Zot, Ti fale Dhu Ruajnin!*

Këto vargje ai i shkroi në një letër dhe e vulosi, pastaj ia dha Amrit dhe i tha: “Le të mbetet kjo letër te ti!” Pastaj Amri e vrau vëllanë e tij Hassanin dhe bashkë me ushtrinë u kthye në Jemen.

Pasi u kthye Amër b. Tubban në Jemen, nuk mund të flinte dot dhe vazhdimisht vuante nga pagjumësia. Kur u dobësua shumë, iu drejtua mjekëve, parashikuesve dhe fallxhorëve për shërim. Njëri prej tyre i tha: “Vallahi, asnjëherë nuk ka ndodhur që dikush ta vrasë vëllanë e vet apo një të afërm të tij dhunshëm, ashtu siç e vrave ti vëllanë tënd, e të mos i ketë ikur gjumi dhe të mos ketë vuajtur nga pagjumësia!” Kur ia thanë këtë, ai filloi t’i vrasë të gjithë fisnikët e Jemenit që e patën këshilluar për vrasjen e vëllait, Hassanit.

Kur erdhi te Dhu Ruajni, ky i tha: “Unë kam një justifikim tek ti.”

Pyeti: “Cili është ai?”

Tha: “Letra që të kam dhënë.” Amri nxori letrën dhe në të gjeti dy vargjet e shkruara. E liroi Dhu Ruajnin pasi e kuptoi se ai e kishte këshilluar.

Amri pastaj vdiq. Pas tij, Himjerin e kapluan çrregullimet dhe u shpërndanë.

Atëherë u imponua një njeri nga Himjeri, por që nuk ishte nga familje mbretërore, i quajtur Lahnia Jenuf Dhu Shenatir. Ai i vrau fisnikët e tyre dhe i shkatëroi shtëpitë e familjes mbretërore.

Lahnia ishte njeri i pamoralshëm, kryente veprimet e popullit të Lutit. Ai dërgoi një njeri që të thërriste Dhur’a Dhu Nuvas b. Tubban Esedin, vëllanë e Hassanit, i cili kishte qenë fëmijë i vogël kur ishte vrasë Hassani, por tashmë ishte bërë një djalosh shtatmadh dhe mendjehollë. Kur i erdhi i dërguari i tij, ky e kup-

toi se çfarë dëshironte. Mori një thikë të hollë hekuri, e fshehu nën shputa, pastaj shkoi për t'iu përgjigjur thirrjes. Kur u vetmua me Lahnian, u vërsul mbi të dhe e goditi me thikë derisa e vrau, pastaj doli para njerëzve, të cilët i thanë: “Ne nuk duam tjetër mbret përveç teje sepse ti na shpëtove nga ky i prishur!”

Kështu e shpallën mbret të tyre dhe iu bashkua krejt fisi Himjer dhe fiset jemenase. Ai ishte mbreti i fundit i Himjerit. Ai pat urdhëruar që të hapen hendeqet (sahibul-uhdud). Qëndroi në fron një kohë të gjatë.

Në Nexhran<sup>16</sup> kishte mbeturina të pasuesve të fesë së Isait a.s., birit të Merjemes. Ata ishin njerëz të mirë dhe ndiqnin rrugën e drejtë. Në krye të tyre ishte Abdullah b. Thami. Kur erdhi Dhu Nuvasi me ushtrinë e tij, u bëri thirrje në Judaizëm dhe u ofroi të zgjedhin mes dy alternativave: Judaizmin ose vdekjen! Ai hapi për ta hendeqet e thella. Një numër prej tyre i dogji në zjarr, një numër i preu me shpatë, ndërsa një numër tjetër i masakroi, saqë numri shkoi në njëzet mijë.

Për Dhu Nuvasin dhe ushtrinë e tij, Allahu i Madhërishëm e njoftoi Pejgamberin a.s.: *“Mallkuar qofshin ata të zotët e hendeqeve, të zjarrit më plot lëndë djegëse, Kur ata rrinin ulur rreth tij, Dhe dëshmonin atë që bënin me besimtarët. E nuk patën pse t'i urrejë, përveç që e besuan Allahun, ngadhënjyesin, të lavdëruarin.”* (El-Buruxh, 4-8)<sup>17</sup>

Thuhet se në mesin e atyre që kishte vlarë Dhu Nuvasi ishte edhe Abdullah b. Thami, prijësi dhe udhëheqësi i tyre.

<sup>16</sup> Nexhran apo Texhran është një provincë në Jemen.

<sup>17</sup> Të gjitha citatat nga Kur'ani, të theksuara në këtë libër, me ndonjë përshtatje të vogël, janë përkthyer sipas *Përkthimit me komentim të Sherif Ahmetit, Allahu e mëshiroftë!*

## FITORJA E ABISINASVE NDAJ JEMENIT

Një njeri nga Sebe', i quajtur Devs Dhu Thu'luban, arriti të shpëtojë prej tyre duke ikur me kalë nëpër rërën e shkretëtirës, ku humbi gjurmët. Ai vazhdoi të kalërojë derisa arriti te Cezari, mbreti romak, të cilit i kërkoi ndihmë kundër Dhu Nuvasit dhe ushtrisë së tij duke e informuar se çfarë u kishte ndodhur.

Cezari i tha atij: "Vendi juaj është shumë larg nesh, por unë do t'i shkruaj një letër mbretit të Abisinisë sepse edhe ai është i kësaj feje. Ai është më afër vendit tuaj." Dhe i shkroi një letër, ku e urdhëroi që t'i ndihmojë dhe të hakmerret. Devsi me shkresën e Cezarit shkoi te Nexhashiu. Ky dërgoi me të shtatëdhjetë mijë ushtarë abisinas, kurse për komandant emëroi njërin prej tyre të quajtur Erjat, ndërsa në mesin e ushtarëve gjendej edhe Ebreha Eshrem.

Erjati u nis nëpër det duke lundruar deri në brigjet e Jemenit, bashkë me të ishte edhe Devs Thu'lubani. Përpara u doli Dhu Nuvasi me Himjerin dhe fiset jemenase që i nënshtroheshin. Kur u ndeshën dy ushtritë, Dhu Nuvasi me luftëtarët e tij pësoi humbje. Kur e pa Dhu Nuvasi se çfarë i ndodhi atij dhe popullit të tij, e drejtoi kalin e tij drejt detit, e rrahu me kamxhik dhe e detyroi të futej në ujë duke u futur gjithnjë thellë e më thellë derisa u mbyt plotësisht.

Këto ishin çastet e fundit të jetës së tij. Erjati hyri në Jemen dhe e pushtoi.

## KONFLIKTI MES ERJATIT DHE EBREHASË

Erjati sundoi disa vite në tokën e Jemenit, pastaj u zu me Ebreha Habeshiun për çështjen e abisinasve në Jemen dhe kështu abisinasit u ndanë në dy grupe. Me secilin prej të dyve u bashkua nga një grup dhe pastaj iu kundërvunë njëri-tjetrit. Kur dy grupet iu afruan afër njëri-tjetrit, Ebreha i dërgoi Erjatit këtë porosi: “Mos bëj që abisinasit të godasin njëri-tjetrin dhe të dobësohen. Dil para meje dhe unë po dal para teje dhe cili të fitojë nga ne të dy, atij le t’i bashkohet krejt ushtria!”

Erjati u përgjigj: “Ke thënë të vërtetën!”

Pastaj doli Ebreha, i cili kishte trup të shkurtër e të trashë, ndërsa me fe ishte i krishterë.

Doli edhe Erjati, i cili ishte njeri i pashëm, me trup të madh e të gjatë dhe në dorë mbante një shtizë.

Pas Ebrehasë shkante një djalosh me emrin Atvede, i cili i mbronte shpinën.

Erjati e ngriti shtizën dhe synoi ta godasë Ebrehanë në mes të kokës, mirëpo shtiza e qëlloi në ballë dhe ia çau ballin, hundën, syrin dhe buzën. Për këtë arsye ai më pas u quajt Ebrehal-Eshrem, njeri me hundë të çarë.

Atëherë nga pas Ebrehasë doli Atvede dhe iu vërsul Erjatit, të cilin e vrau. Ushtria e Erjatit iu bashkua Ebrehasë, kështu u bashkuan të gjithë abisinasit në Jemen.

## TREGIMI PËR PRONARËT E ELEFANTIT

Ebreha ndërtoi në qytetin San'a kishën e quajtur Kul-lejs<sup>18</sup>. Ajo ishte një kishë që nuk e kishte shoqen në botë në atë kohë. Pastaj i shkroi mbretit Nexhashi dhe i tha: "Unë të kam ndërtuar ty, o mbret, një kishë që asnjë mbreti më parë nuk i është ndërtuar dhe nuk do të pushoj derisa ta kthej haxhin e arabëve tek ajo!"

Ndër arabët filloi të përflitet shkresa e Ebrehasë për Nexhashiun, kështu që një njeri nga Nese'et<sup>19</sup>, i zemëruar shkoi në Kul-lejs, kreu nevojën aty dhe përsëri u kthye në vendin e vet.

Kur u njoftua Ebrehaja për këtë, pyeti: "Kush e bëri këtë?"

I thanë: "Këtë e ka bërë një arab, njëri prej atyre që i përkasin asaj shtëpie në Mekë, ku arabët kryejnë haxhin, pasi dëgjoi fjalët tuaja "...derisa ta kthej haxhin e arabëve tek ajo!" Ai u zemërua shumë dhe erdhi e kreu nevojën në të për të treguar se ajo nuk është e denjë për të.

Ebrehaja u zemërua shumë dhe u betua se do të shkonte te Qabeja dhe do ta rrëronte. Pastaj i urdhëroi abisinasit që të përgatiten e të pajisen dhe u nis duke marrë me vete një elefant. Kur arabët dëgjuan për këtë, i kaploi një shqetësim dhe frikë e madhe. Këtë marshim ata e konsideruan si sulm ndaj të drejtave të tyre, pasi dëgjuan se ai synonte rrënimin e Qabesë, Shtëpisë së Shenjtë të Allahut.

Kundër tij u ngrit njëri prej fisnikëve të Jemenit dhe mbret i tyre, që quhej Dhu Nefër. Ai e ftoi popullin e vet dhe të gjithë arabët për të luftuar kundër Ebrehasë dhe marshimit të tij kundër Shtëpisë së Shenjtë të Allahut. Me të gjithë ata që iu përgjigjën thirrjes së tij ai doli para Ebrehasë dhe e sulmoi. Megjithatë, Dhu Nefër dhe njerëzit e tij pësuan disfatë, ndërsa ai vetë u kap rob.

Ebrehaja e vazhdoi marshimin e tij në drejtimin e përcaktuar për të realizuar qëllimin e tij. Kur arriti në territorin e fisit Hatham, atij iu kundërvu Nufejl b. Habbib Hathamiu me dy degët e fisit Hatham: Shehran dhe Nahis, si dhe me disa fise arabe që iu bashkëngjitën atij, mirëpo Ebrehaja i mundi edhe këta, kurse Nufejlin e mori rob. Ai u pajtua me Ebrehanë dhe shkoi me të për t'i treguar rrugën.

<sup>18</sup> Kul-lejs ishte emri i kishës tek e cila Ebreha donte të kthente haxhin e arabëve.

<sup>19</sup> Nes'e është shumësi i fjalës nasi'. Këta janë ata që i vononin muajt. Në fakt, pasi ktheheshin nga Mina, ngrihej një njeri i tyre nga fisi Kinane dhe deklaronte: "Unë jam person i paprekshëm, nuk jam i detyruar të jap përgjegjësi dhe vendimi im është i padiskutueshëm!" Ata i përgjigjeshin: "Ashtu është! Atëherë, pra na e shtyj një muaj! Na e shtyj shenjtërinë e muajit Muharrem për muajin vijues Safer." Arabëve nuk u pëlqente të kishin tre muaj të shenjtë rresht në të cilët nuk kishin të drejtë të sulmonin e të plaçkitnin sepse prej saj ata siguronin ekzistencën. Dhe ai ua lejonte muajin Muharrem. Ky veprim quhej insa'.

Kur po kalonin nëpër Taif, përpara u doli Mesud b. Muattib me disa njerëz nga fisi Thekif, të cilët i thanë: “O mbret, ne jemi robërit e tu, të dëgjojmë, të nënshtrohemi dhe nuk të kundërshtojmë. Kjo shtëpia jonë, e Latit, nuk është ajo shtëpi që ti po synon. Ajo gjendet në Mekë! Ne po dërgojmë me ty një njeri që do të të tregojë rrugën!” Dhe Ebreha nuk i preku.

Me të dërguan Ebu Rigalin që t’u tregonte rrugën për në Mekë. Kur arritën në vendin e quajtur Mugammes<sup>20</sup>, Ebu Rigali vdiq. Arabët varrin e tij e goditën me gurë. Ky është ai varr të cilin edhe sot e kësaj dite njerëzit e gjuajnë me gurë në Mugammes.

Kur arriti në Mugammes, Ebreha dërgoi një abisinas që quhej Esved b. Mef-sud, që t’i hipte kalit deri në Mekë. Atij në Tihame iu dha pasuri e madhe e cila i takonte fisit Kurejsh dhe disa fiseve të tjera. Aty bënë pjesë edhe dyqind devetë e Abdulmuttalib b. Hashimit, i cili atëbotë ishte prijësi dhe lideri i fisit Kurejsh. Në fillim menduan që t’i kundërvihen Ebrehasë fiset Kurejsh, Kinane, Hudhejl dhe disa të tjera në afërsi të Qabesë, por pastaj kuptuan se nuk e kishin një mundësi të tillë, ndaj hoqën dorë nga kjo.

Ebrehaja dërgoi Hunat Hamjeriun në Mekë dhe i tha: “Pyet për njeriun më të shquar, më fisnik dhe më të rëndësishëm në këtë qytet, pastaj thuaji: “Mbreti të porosit: Unë nuk kam ardhur të luftoj me ju, por kam ardhur vetëm që të rrënoj këtë shtëpi. Nëse nuk na kundërshtoni me luftë, dijeni se nuk do ta derdh gjakun tuaj! Nëse të thotë se ai nuk do të luftojë me mua, atëherë ma sill këtu!”

Kur Hunati hyri në Mekë, filloi të pyeste për prijësin dhe liderin e Kurejshëve dhe ata i thanë: “Ai është Abdulmuttalib b. Hashim”. Menjëherë shkoi tek ai dhe i tregoi se çfarë e kishte urdhëruar Ebrehaja.

Abdulmuttalibi i tha: “Vallahi, ne nuk duam të luftojmë me të dhe as që kemi fuqi. Kjo është Shtëpia e Shenjtë e Allahut dhe shtëpia e të dashurit të Tij, Ibrahimit a.s.. Nëse Ai e ndalon prej saj, ajo është shtëpia dhe shenjtëria e Tij, e nëse e lejon Ai, vallahi, ne nuk mund ta mbrojmë!”

Hunati i tha: “Eja me mua sepse mbreti më ka urdhëruar që të shkojmë tek ai së bashku!”

Abdulmuttalibi u nis së bashku me disa djem të tij. Kur mbërritën te fushimi, ai pyeti për Dhu Nefrin, i cili ishte shok i tij. Sapo e mori vesh ku ndodhej, menjëherë u drejtua nga Dhu Nefri, i cili ishte në qelinë e tij, dhe i tha: “O Dhu Nefër, a po sheh ndonjë rrugëdalje nga kjo vështirësi?”

Dhu Nefri i tha: “Ç’rrugëdalje mund të shohë një njeri i robëruar, i cili gjendet në dorë të mbretit dhe çdo mëngjes e mbrëmje pret që të vritet prej tij?! Jo, vërtet unë nuk shoh ndonjë rrugëdalje prej kësaj. Megjithatë, drejtuesi i elefantit,

<sup>20</sup> Mugammes është emri i një vendi në afërsi të Mekës, rrugës për Taif.

Unejsi, është shoku im, do t'i dërgoj një porosi dhe do t'i tregoj se ti je i rëndësi-shëm, pastaj do të kërkoj prej tij që ai të ndërmjetësojë te mbreti që ti personalisht t'ia shprehësh atij mendimin tënd dhe nëse ka mundësi të ndërhyjë tek ai për ty."

Abdulmuttalibi i tha: "Kjo më mjafton!"

Dhu Nefri i dërgoi Unejsit porosi dhe i tha: "Vërtet Abdulmuttalibi është prijësi i Kurejshëve dhe pronari i karvanit të Mekës. Në ultësira ushqen njerëzit, ndërsa në kodrina egërsirat. Mbreti ka marrë prej tij dyqind deve. Kërko për të praniam tek ai dhe ndihmoje sa të kesh mundësi!" Ai i tha: "Do ta bëj!"

Unejsi bisedoi me Ebrehanë dhe i tha: "O mbret, para dyerve tuaja është prijësi i Kurejshëve, kërkon që ta pranosh. Ai është pronar i karvanit të Kurejshëve, në ultësira ushqen njerëzit, ndërsa në kodrina ushqen egërsirat. Lejoje të hyjë te ti dhe të flasë për hallin e tij!" Dhe Ebrehaja e lejoj.

Abdulmuttalibi ishte njeri i bukur, i pashëm nga jashtë dhe madhështor në karakterin e tij. Kur e pa Ebrehaja, i shprehu nderim dhe respekt të madh dhe nuk e fshehu simpatinë ndaj tij. I shprehu nderin që të ulet afër tij. Pasi nuk kish-te dëshirë që abisininat ta shihnin atë të ulur në fronin e tij mbretëror, vetë ai zbriti prej tij dhe u ul në një shtrojë, ku uli edhe Abdulmuttalibin pranë vetes. Pastaj i tha përkthyesit të tij:

"Pyete çfarë po dëshiron!" Përkthyesi ia tha këtë. Atëherë ai i tha:

"Unë dëshiroj që mbreti të më kthejë dyqind devetë e mia që më ka marrë!"

Atëherë Ebrehaja i tha përkthyesit: "Thuaji atij: Kur të pashë, më pëlqeve shumë, kurse tani u ftoha prej teje. Po më përmend dyqind deve që të kam marrë, por nuk po përmend Shtëpinë, e cila është simbol i fesë tënde dhe fesë së të parëve të tu, të cilën unë erdha që ta shemb?!"

Abdulmuttalibi i tha: "Unë jam pronar i deveve, ndërsa Qabeja e ka Zotin e saj, që e mbron!"

Ebreha tha: "Nuk ka kush që ta mbrojë atë përballë meje!"

Abdulmuttalibi tha: "Atëherë, do ta shohësh a mundet!"

Ebrehaja ia ktheu Abdulmuttalibit devetë e tij, kurse ky u kthye te Kurejshët dhe i informoi për çfarë i kishte ndodhur. Pastaj i urdhëroi që të largoheshin nga Meka dhe të strehoheshin nëpër kodra dhe gryka mali sepse frikësohej nga ashpërsia e ushtrisë. Pastaj Abdulmuttalibi u kap te hallka e derës së Qabesë dhe me të u ngritën edhe një grup Kurejshësh dhe filluan t'i luten Allahut dhe të kërkojnë ndihmë kundër Ebrehasë dhe ushtrisë së tij. Duke mbajtur të kapur hallkën e derës së Qabesë, Abdulmuttalibi recitoi:

*"O Zoti im, njeriu po e mbron kafshën e vet,  
prandaj, mbroje edhe Ti këtë grupin Tënd!  
Kryqi i tyre, as forca e tyre mos të triumfojnë,*

*mbi forcën Tënde ata mos të dominojnë!  
Nëse Ti ata i refuzon dhe ne na pranon  
na thua, të lutemi, ne çfarë duhet të veprojmë!"*

Pas kësaj, Abdulmuttalibi e lëshoi hallkën e derës dhe bashkë me Kurejshët e pranishëm u nisën në drejtim të kodrave për t'u strehuar, prej nga do të shihnin se çfarë do të bënte Ebrehaja kur të hynte në Mekë.

Ebrehaja që në mëngjes u përgatit për të hyrë në Mekë. E përgatiti elefantin e tij dhe organizoi edhe ushtrinë. Elefanti quhej Mahmud. Ebrehaja ishte i vendosur që ta rrëronte Qabenë dhe pastaj të kthehej në Jemen. Kur e drejtuan elefantin në drejtim të Mekës, iu afrua Nufejl b. Habibi, e kapi elefantin për veshi dhe i tha: "Shtrihu ose kthehu andej nga ke ardhur! Ti gjendesh në vendin e shenjtë të Allahut!" Pastaj ia lëshoi veshin, ndërsa elefanti ra në gjunjë. Më tej Nufejli me nxitim u largua dhe u ngjit në kodër. Ata e rrahën elefantin që të ngrihet, por ai refuzoi. E goditën në kokë me tabrezin<sup>21</sup>, i vendosën grremça në pjesën e poshtme të stomakut, edhe gjakun ia derdhën, por ai nuk u çua. Ndërkaq, kur e drejtuan nga Jemeni, menjëherë u ngrit dhe vrapoi. Pastaj e drejtuan nga Shami dhe veproi në mënyrë të njëjtë, kurse kur e kthyen përsëri nga Meka, ra në gjunjë.

Atëherë, Allahu i Madhërishtëm dërgoi mbi ta shpendë nga deti, të ngjashëm me dallëndyshet e detit dhe shturat dhe secili shpend bartte nga tre gurë: një në sqep dhe dy në kthetra. Gurët kishin madhësinë e qiqrës dhe thjerrrës dhe cilindo që godisnin, ai shkatërrohej. Ata që nuk ishin goditur me nxitim iknin rrugës nga kishin ardhur, binin në të gjitha rrugët, rrëzoheshin në çdo rrëpirë dhe mbyteshin në çdo burim. Edhe vetë Ebrehaja u godit në trup dhe vdiq.

Ibni Is'haku thotë:

*"Kur Allahu i Madhërishtëm e dërgoi Muhamedin a.s., Ai përmendi njëren nga begatitë dhe mirësitë e Tij ndaj Kurejshëve, që ishte dëbimi i abisinasve dhe kështu ua zgjati jetën. Allahu i Madhërishtëm thotë: "A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit? A nuk ua bëri përpjekjen e tyre të dështuar? Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë-tufë! Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar! Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!" (El-Fil)*

<sup>21</sup> Tabrezin ishte një vegël me maja të lakuara nga të dyja anët, një lloj sëpate.

## PASARDHËSIT E NIZAR BIN MEADDIT

Nizar bin Meaddi lindi tre djem: Mudarin, Rebian dhe Enmarin<sup>22</sup>.

Mudari lindi dy djem: Iljasin dhe Ajlanin.

Iljasi lindi tre djem: Mudreken, Tabihan dhe Kamean.

Mudreka lindi dy djem: Huzejmen dhe Hudhejlin.

Huzejme lindi katër djem: Kinanen, Esedin, Esedetin dhe Elhunin.

Kinane lindi katër djem: Nadrin, Malikun, Abdu Menatin dhe Milkanin.

Nadri lindi dy djem: Malikun dhe Jahludin.

Malik b. Nadri lindi Fihri b. Malikun.

Fihri lindi katër djem: Galibin, Muharibin, Harithin dhe Esedin.

Galibi lindi dy djem: Luejin dhe Tejmin.

Lueji lindi katër djem: Ka'bin, Amirin, Samin dhe Avfin.

Ka'bi lindi tre djem: Murren, Abdiun dhe Husajsin.

Murre lindi tre djem: Kilabin, Tejmen dhe Jekdhan.

Kilabi lindi dy djem: Kusajjin dhe Zuhren.

Kusajji lindi katër djem: Abdu Menafin, Abdudدارin, Abduluzzan dhe Abdu Kusajjin.

Abdu Menafi lindi katër djem: Hashimin, Abdu Shemsin, Muttalibin dhe Nufelin.

<sup>22</sup> Ibni Hishami shton edhe një, të katërtin, e ai është Ijad b. Nizari.

## FËMIJËT E ABDULMUTTALIB B. HISHAMIT

Ibni Hishami thotë:

Abdulmuttalibi lindi dhjetë djem dhe gjashtë vajza. Ata janë: Abbasi, Hamza, Abdullahu, Ebu Talibi, Zubejri, Harithi, Hixhla, Mukavvimi, Dirari, Ebu Lehebi (quhej Abduluzza), Safijja, Ummu Hakim Bejda, Atika, Umejma, Erva dhe Berra.

### PRINDËRIT E PEJGAMBERIT A.S.

Abdullah bin Abdulmuttalibi është babai i të Dërguarit të Allahut, zotërisë së bijve të Ademit, Muhamed bin Abdullah bin Abdulmuttalib, paqja, shpëtimi, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!

Nëna e tij është Amine bint Vehb bin Abdu Menaf b. Zuhre b. Kilab b. Murre b. Ka'b b. Luej b. Galib b. Fihir b. Malik b. Nadr.

Nëna e saj ishte Berra bint Abduluzza b. Osman b. Abduddar b. Kusajj b. Kilab b. Murre b. Ka'b b. Luej b. Galib b. Fihir b. Malik Nadr.

I Dërguari i Allahut a.s. për nga prestigji është djali më i ndershëm i Ademit nga origjina, më i zgjedhuri për nga prejardhja si nga ana e babait ashtu edhe e nënës. Pastaj, ai të tjerët i ka bërë të ndershëm, fisnikë, të famshëm dhe të mëdhenj.

## GËRMIMI I ZEMZEMIT DHE KUNDËRTHËNIET RRETH TIJ

Një ditë, kur Abdulmuttalibi po flinte në Hixhr<sup>23</sup>, në ëndërr iu urdhërua që të niste gërmimin e Zemzemit.

Abdulmuttalibi tregon: “Unë fjeta në Hixhr, kur dikush erdhi e më tha: “Gërmo Tiben!” Unë i thashë: -Ç’është Tiba? Pastaj u largua nga unë.

Të nesërmen përsëri u ktheva dhe fjeta në shtratin tim, kur ai prapë më erdhi e më tha: “Gërmo Madnunen!” Unë i thashë: -Ç’është Madnuna? Ai përsëri shkoi.

Ditën tjetër u ktheva te shtrati im dhe fjeta aty, ndërsa ai më erdhi përsëri dhe më tha: “Gërmo Zemzemin!” Unë i thashë: -Ç’është Zemzemi? Tha: “Asnjëherë nuk shteron e as nuk i pakësohet uji! Do të pinë ujë prej tij haxhilerët madhështorë, gjendet mes plendësit dhe gjakut<sup>24</sup>, tek gropa e korbit me krahë të larmë.”

Pasi iu sqarua çështja, madje edhe vendndodhja iu dëftua, e kuptoi se ëndrra ishte e vërtetë.

Menjëherë, të nesërmen në mëngjes, me djalin e tij Harithin, atëbotë të vetëm, shkoi në atë vend dhe filloi gërmimin. Kur u shfaqën gurët e murit të pusit, Abdulmuttalibi klithi: -Allahu ekber! Allahu është më i madhi! Atëherë Kurejshët morën vesh se e kishte gjetur atë që po kërkonte. Iu afruan dhe i thanë: “O Abdulmuttalib, ky është pusi i stërgjyshit tonë Ismailit, edhe ne kemi të drejtë, ndaj na inkuadro edhe ne si pronarë të tij!”

Ai tha: “Jo, nuk mund ta bëj, vetëm unë jam zgjedhur për të!”

Ata i thanë: “Bëhu i drejtë sepse ne nuk do të të lejojmë, qoftë edhe me çmimin e armiqësimit me ty!”

Ai tha: “Caktoni kë të dëshironi që të gjykojë mes nesh!”

Ata propozuan: “Le të jetë parashikuesja e Benu Sa'dit, Hudhejme!”

Ai tha: “Mirë, le të jetë!”

Parashikuesja e përmendur jetonte në kodrat e Shamit. Abdulmuttalibi u nis duke kalëruar me disa njerëz nga fisi Benu Abdi Menaf dhe me ta u nisën edhe përfaqësues nga të gjitha fiset Kurejshe.

Rrugët atëherë ishin të vështira për t'u kaluar dhe kur u gjendën në një shkretëtirë, diku mes Hixhazit dhe Shamit, Abdulmuttalibi me shokët e tij mbetën pa ujë dhe aq shumë kishin etje, saqë i humbën shpresat e shpëtimit. Ata kërkuan

<sup>23</sup> Hixhr (hixhrul-Ka'beh) është themeli i Ibrahimit a.s., të cilin Kurejshët e kishin lënë me rastin e ndërtimit.

<sup>24</sup> Transmetohet se Abdulmuttalibi duke u nisur për të gërmuar pa një si fole milingonash dhe një çerdhe korbi, por nuk e pa plendësin dhe gjakun. Duke qenë në këtë gjendje, një kasapit i kishte ikur një lopë, të cilën nuk e kishte arritur dot derisa kishte hyrë në Qabe. Ai e kishte therur pikërisht në vendin e përshkuar dhe aty kishte rrjedhur gjak. Atëherë Abdulmuttalibi filloi të gërmonte në vendin e përshkuar.

ujë nga njerëzit e fiseve Kurejshe, por ata refuzuan duke u thënë: “Jemi në shkretëtirë dhe kemi frikë se edhe neve mund të na ndodhë ajo që ju ndodhi juve!”

Duke e parë Abdulmuttalibi këtë dhe nga frika për veten dhe për popullin e tij pyeti: “Çfarë po mendoni ju?” Ata thanë: “Mendimi ynë është si mendimi yt, na urdhëro çfarë të duash!” Ai tha: “Unë po mendoj se çdonjëri prej nesh duhet të hapë varrin e vet derisa ka ende fuqi, në mënyrë që kur njëri prej nesh të vdesë, të tjerët ta varrosin në varrin e tij dhe ta mbulojnë me rërë, derisa në fund të mbetet një njeri i vetëm. Humbja e një njeriu është më pak e dhimbshme se humbja e të gjithë udhëtarëve!” Shokët e tij thanë: “Sa urdhër i mirë është ky!”

Secili prej tyre filloi të hapte varrin e vet, pastaj u ulën dhe po pritnin vdekjen nga etja. Pastaj Abdulmuttalibi u tha shokëve të tij: “Vallahi, kjo lloj hedhjeje në vdekje me duart tona, pa u përpjekur për të gjetur një rrugëdalje, është shenjë e dobësisë. Ndoshta Allahu në ndonjë vend do të na furnizojë me ujë! Lëvizni!”

Atëherë ata u shpërndanë, ndërsa pjesëtarët e fiseve Kurejshe i shikonin me habi se çfarë po bënin. Abdulmuttalibi iu afrua devesë së tij dhe i hipi, mirëpo sapo ajo u nis, nën këmbët e saj shpërtheu një burim me ujë të pijshëm! Abdulmuttalibi me zë të lartë bëri tekbir (Allahu ekber- Allahu është më i madhi!), e bashkë me të edhe shokët e tij. Pastaj zbriti nga deveja dhe piu ujë, pinë edhe shokët e tij, derisa e shuan etjen dhe i mbushën enët prej lëkure.

Abdulmuttalibi pastaj i ftoi fiset Kurejshe duke u thënë: “Ejani edhe ju, Allahu na dha ujë neve, pini edhe ju dhe jepuni edhe kafshëve tuaja!”

Ata erdhën, pinë ujë dhe u dhanë të pinë edhe kafshëve të tyre e pastaj thanë:

“Vallahi, çështja u gjykua në favorin tënd, o Abdulmuttalib! Ne kurrë nuk do të armiqësohemi me ty për Zemzemin. Vërtet, Ai që të dha ujë në këtë shkretëtirë është po Ai që ta dha edhe Zemzemin. Kthehu te burimi yt!”

Kështu që ata u kthyen dhe hoqën dorë nga shkuarja tek parashikuesja.

## PREMTIMI I ABDULMUTTALIBIT SE DO TË THERTE DJALIN E TIJ

Abdullmuttalib b. Hashimi, pasi përjetoi atë që përjetoi nga Kurejshët gjatë gjermimit të Zemzemit, premtoi se në qoftë se do t'i lindnin dhjetë djem dhe do të jetonin aq sa ta ndihmonin, njërin prej tyre do ta bënte kurban te Qabeja në emër të Allahut! Kur me të vërtetë i lindën dhjetë djem dhe e kuptoi se ata ishin në gjendje ta ndihmonin, i mblodhi dhe ua komunikoi premtimin e tij dhe kërkoi prej tyre që mos ta kundërshtojnë për premtimin që i kishte dhënë Allahut.

Pa e kundërshtuar fare, djemtë i thanë: “Por si do ta realizojmë këtë?”

Ai tha: “Secili prej jush le të marrë nga një shigjetë, pastaj të shkruajë në të emrin e tij dhe të ma sjellë mua!”

Ata vepruan ashtu dhe pastaj erdhën tek ai. Ai hyri bashkë me ta te Hubeli<sup>25</sup>, i cili ishte i vendosur në një gropë brenda Qabesë, në të cilën tubonin dhuratat që i dhuroheshin Qabesë.

Aty, te Hubeli, ishin shtatë shigjeta, në secilën prej tyre ishte vendosur nga një fletë.

Në njëren shigjetë ishte shkruar “Pagesa e gjakut – dëmshpërblimi për vrasje”, dhe kur ata nuk mund të binin dakord se kush duhet ta kryente, hidhnin short me ato shtatë shigjeta. Nëse dilte shigjeta ku ishte shkruar “Pagesa e gjakut”, atëherë dëmshpërblimin për vrasje do ta bënte ai të cilit i dilte kjo shigjetë.

Në shigjetën e dytë ishte shkruar “Po”, dhe ajo shërbente për diçka që planifikonin të bënin. Edhe për këtë hidhej shorti me shigjeta.

Në shigjetën tjetër ishte shkruar “Jo”. Kur donin të ndërmermin diçka, i hidhnin shigjetat dhe në qoftë se dilte kjo shigjetë, nuk e zbatonin.

Në shigjetën e katërt ishte shkruar “Nga ju”, në të pestën “I lidhur”, në të gjashtën “Nuk është nga ju” dhe në të shtatën ishte shkruar “Ujërat”. Nëse dëshironin të gërmonin për ujë, hidhnin short me shigjeta dhe aty ishte edhe kjo shigjetë, kështu që nëse dilte kjo shigjetë, vepronin sipas saj.

Kur ata dëshironin të bënin synet ndonjë djalë, të kurorëzonin një të pakurorëzuar, të varrosnin një të vdekur apo nëse dyshonin për origjinën e ndonjërit prej tyre, gjithmonë shkonin te Hubeli.

Ata depozitonin njëqind dërhëmë dhe devenë apo delen e therur dhe ia jepnin pronarit të shigjetave, i cili u hidhte shortin. Pastaj sillnin personin për të cilin kërkonin sqarim përmes shortit. Ata thoshin: “O Zoti ynë, ky është filani, ne lidhur me të duam këtë e këtë, ndaj na trego të vërtetën që po kërkojmë!”

<sup>25</sup> Hubel, emri i idhullit.

Pastaj i thoshin pronarit të shigjetave: “Hidhe!”

Nëse dilte shigjeta në të cilën shkruhej “Nga ju”, ata do ta pranonin atë dhe do ta konsideronin me origjinë të pastër, ndërsa nëse dilte shigjeta ku shkruhej “Nuk është nga ju”, e konsideronin aleat, por në qoftë se dilte shigjeta me shkri-min “I lidhur”, ai nuk ishte nga origjina e tyre e as nuk ishte aleat. Nëse dilte shigjeta ku shkruhej “Po”, ata do të vazhdonin ta trajtonin si më parë, por në qoftë se dilte “Jo”, atë rast do ta shtynin atë vit dhe do ta linin për herën tjetër. Kështu në çështjet e tyre të rëndësishme ata vepronin sipas udhëzimit të shigjetave.

Abdulmuttalibi i tha pronarit të shigjetave: “Hidhu short këtyre djemve të mi me këto shigjeta!” Pastaj e informoi atë për premtimin që kishte bërë dhe secili prej tyre vendosi shigjetën ku kishte emrin e vet. Abdullahu ishte djali më i vogël i Abdulmuttalibit<sup>26</sup> dhe më i dashuri i babait të tij. Abdulmuttalibi mendoi se në qoftë se shigjeta e anashkalonte atë, kishte anashkaluar atë që duhej.

Kur pronari i shigjetave i mori shigjetat dhe u përgatit për hedhjen e tyre, Abdulmuttalibi qëndroi pranë Hubelit dhe i lutej Zotit. Pastaj pronari i shigjetave i hodhi dhe shorti i ra Abdullahut! Atëherë Abdulmuttalibi e kapi për dore, mori thikën dhe u nis në drejtim të Isafit dhe Nailes, që ta therte aty.

Kurejshët, kur e panë, u ngritën nga vendet e tyre të mbledhjes, iu afruan atij dhe e pyetën:

“Çfarë ke ndër mend të bësh, o Abdulmuttalib?”

Ai u përgjigj: “Dua ta ther!”

Kurejshët bashkë me djemtë e tij i thanë: “Pasha Zotin, nuk do ta bësh, por do të gjesh ndonjë justifikim. Në qoftë se ti e bën këtë, atëherë gjithmonë dikush do ta sjellë djalin e tij dhe do ta therë dhe kështu njerëzit nuk do të jenë në gjendje të mbijetojnë!”

Mugire b. Abdullah b. Omer b. Mahzum, i cili ishte nga fisi i vëllazëruar, tha: “Betohem në Zotin, se ti kurrë nuk do ta bësh një gjë të tillë, por do ta gjesh një justifikim! Nëse pagesë e tij janë pasuritë tona, ne do ta blejmë!”

Kurejshët dhe bijtë e tij i thanë: “Mos e bëj o Abdulmuttalib, por shko me të në Hixhaz! Atje është një fallxhore, e cila ka shërbëtor xhin. Pyete së pari atë dhe pastaj bëj atë që dëshiron. Nëse ajo të urdhëron për therje, there atë, e nëse ajo të tregon ndonjë rrugëdalje, pranoje!”

Ata shkuan në Medinë dhe e gjetën në Hajber. Abdulmuttalibi ia shpjegoi asaj rastin e tij dhe të djalit të tij. I tregoi asaj se çfarë synoi të bënte me djalin e tij dhe se si ishte zotuar.

<sup>26</sup> Domethënë në kohën kur dëshiroi ta bënte kurban. Më vonë, Hamza ka qenë më i vogël se ai. Edhe Abbasi ka qenë më i vogël. Abbasi madje ka qenë më i vogël edhe se Hamza.

Ajo u tha: “Sot kthehuni mbrapsht, derisa të vijë shërbëtori im (xhin) dhe unë ta pyes atë!”

Ata u kthyen nga ajo, por pasi dolën Abdulmuttalibi menjëherë filloi t’i lutet Allahut. Të nesërmen në mëngjes, ata përsëri u gjetën para fallxhores, e cila iu tha:

“Më ka ardhur lajmi. Sa është tek ju dëmshpërblimi për njeriun e vrarë?”

Ata iu përgjigjën: “Dhjetë deve!”

Tha: “Kthehuni në vendin tuaj, merrni djaln tuaj dhe dhjetë deve, pastaj hidhni short me shigjeta. Po i ra shorti djalit tuaj, atëherë shtoni numrin e deveve derisa të jetë i kënaqur Zoti juaj. Nëse shorti bie mbi devetë, atëherë therini ato sepse ashtu do të jetë i kënaqur Zoti juaj dhe do të shpëtojë djali!”

Ata dolën prej saj dhe u kthyen në Mekë. Pasi të gjithë ranë dakord me atë që u tha fallxhorja, Abdulmuttalibi u ngrit dhe i lutej Allahut. Atëherë prunë Abdullahun dhe dhjetë deve. Abdulmuttalibi qëndronte te Hubeli dhe i lutej Allahut të Plotfuqishëm.

Në atë moment hodhën shortin. Shorti i parë mes Abdullahun dhe dhjetë deveve i ra Abdullahun. Pastaj shtuan edhe dhjetë deve dhe shorti i ra përsëri Abdullahun. Dhe kështu vazhdoi të binte shorti gjersa numri i deveve u bë njëqind.

Atëherë, shorti u ra deveve.

Thuhet se për të qenë krejtësisht i sigurt, Abdulmuttalibi e përsëriti shortin tri herë dhe të tria herët u ra deveve. Abdulmuttalibi u ngrit në këmbë dhe e falënderoi Allahun që ia shpëtoi djaln. Edhe të pranishmit nga gëzimi thirrën: Allahu ekber! Allahu është më i madhi!

Pastaj Abdulmuttalibi bëri kurban njëqind deve dhe mishin e tyre e shpërndau si lëmoshë dhe dhuratë.

## ÇFARË U THA PËR AMINEN GJATË SHTATZËNISË ME PEJGAMBERIN a.s.

Thuhet se, të paktën ashtu flasin njerëzit, e Allahu e di më së miri, se Amine bint Vehbi, nëna e të Dërguarit a.s., kishte treguar:

“Kur kam mbetur shtatzënë me Pejgamberin a.s., erdhi dikush dhe më tha: “Ti je shtatzënë me zotërinë e këtij umeti, prandaj kur ta lindësh, thuaj: “I lutem për mbrojtje të Vetmit nga e keqja e çdo ziliqari! Pastaj vërja emrin Muhamed!”<sup>27</sup>

Ajo ka rrëfyer se duke qenë shtatzënë kishte parë një dritë, në sajë të së cilës kishte parë kështjellat e Busras në Sham.

Nuk kaloi shumë kohë kur Abdullah b. Abdulmuttalibi, babai i Pejgamberit a.s., vdiq, ndërsa nëna e tij ishte ende shtatzënë me të.

<sup>27</sup> Vetëm tre persona para tij e kanë pasur këtë emër. Ata janë: Muhamed b. Sufjan b. Muxhashi', stërgjyshi i Fezdekut; Muhamed b. Uhajha b. Xhelah dhe Muhamed b. Hamran b. Rebia. Baballarët e tyre kishin shkuar te disa liderë të disa fiseve të cilët kishin njohuri mbi librat e shpallur. Ata u kishin treguar për afrimin e kohës së dërgimit të një Pejgamberi dhe për emrin e tij (Muhamed). Gratë e tyre i kishin lënë shtatzëna dhe secili prej tyre ishte zotuar se nëse i lindte djalë, do ta emërtonin me emrin Muhamed. Ashtu vepruan, duke shpresuar secili se pikërisht djali i tij do të ishte Pejgamberi i paralajmëruar.

## LINDJA E PEJGAMBERIT a.s.

Pejgamberi a.s. ka lindur ditën e hënë, natën e dymbëdhjetë të muajit rebiul-evvel, në vitin e elefantit<sup>28</sup>.

Kajs b. Mahzeme ka thënë: “Unë dhe i Dërguari i Zotit kemi lindur në vitin e elefantit, kështu që jemi moshatarë.”

Hassan b. Thabiti transmetohet se ka thënë:

“Vallahi, unë kam qenë shtatë apo tetë vjeç, kuptoja çdo gjë që thuhej. Një herë kam dëgjuar një hebre duke thirrur me zë të lartë nga një kala në Jethrib: “O hebrej!” Kur ata u tubuan rreth tij, i thanë: “Çfarë ke, çka ndodhi?!” Ai u tha atyre: “Sonte u shfaq ylli i Ahmedit, me të cilin tregohet se ai ka lindur!”

Kur e lindi, nëna e tij i dërgoi lajm gjyshit të tij, Abdulmuttalibit: “Të ka lindur një djalë, eja dhe shikoje!” Abdulmuttalibi erdhi menjëherë dhe e shikoi. Ajo i tregoi atij se çfarë kishte parë gjatë shtatzënisë me të, çka i ishte thënë rreth tij dhe si ishte urdhëruar për t’ia vënë emrin.

Thuhet se Abdulmuttalibi e mori dhe hyri me të në Qabe. Aty iu lut Allahut dhe e falënderoi për këtë dhuratë. Pastaj doli dhe e ktheu te nëna e tij dhe menjëherë u nis për të kërkuar një mëndeshë. Ai gjeti një grua nga fisi Sa’d b. Bekër me emrin Halime bint Ebi Dheib.

<sup>28</sup> Sipas një mendimi, kjo ngjarje ka ndodhur një Ramazan para lindjes së tij.

## TREGIMI I HALIMESË

Halimeja ka rrëfyer se ajo ishte nisur nga vendi i saj me burrin dhe me djalin e vogël<sup>29</sup>, të cilit i jepte gj, për tek gratë e fisit Benu Sa'd për të kërkuar foshnjë në gj. Kjo ndodhi në një vit shumë të thatë, i cili nuk na la asgjë. Unë dola me një gomaricë ngjyrë lepur, me vete kishim edhe një deve të plakur, e cila më nuk vlente për asgjë. Për Zotin, atë natë nuk fjeti askush prej nesh nga vaji i fëmijës, i cili qante nga uria. Në gjirin tim nuk kisha me çka ta qetësoja, por as në deve nuk kishim diçka për ta ushqyer atë. Vetëm po pritnim retë dhe shiun. Unë i hipa gomaricës, në një udhëtim i cili na kishte mërëzitur dhe ishim dobësuar nga lodhja, saqë mezi qëndronim.

Kështu duke kërkuar foshnjë në gj arritëm në Mekë. Secilës prej nesh që patëm shkuar për të kërkuar foshnjë na u ofrua i Dërguari a.s., por secila e refuzonte kur i thuhej se ishte jetim.

Në fakt, ne pritnim shpërblim nga babai i foshnjës dhe mendonim: “Çfarë mund të bëjë nëna e tij dhe gjyshi?”

Prandaj, ne nuk e dëshironim.

Megjithatë, të gjitha gratë tashmë kishin marrë nga një foshnjë në gj, përveç meje. Kur po përgatiteshim për t'u kthyer, unë i thashë burrit tim<sup>30</sup>: “Pasha Zotin, unë nuk dua të jem e vetmja ndër shoqet e mia që kthehem pa foshnjë në gj. Pasha Zotin, do të shkoj tek ai jetimi dhe do ta marr!”

Ai tha: “Vepro si të duash, ndoshta Allahu do të na japë bereqet përmes tij!”

Ajo vazhdon tregimin: “Pastaj unë shkova dhe e mora dhe ajo që më shtyu për ta marrë ishte vetëm shkaku se nuk gjeta tjetër. Pasi e mora dhe u ktheva te kafsha ime, kur e vendosa në prehrin tim, gjinjtë e mi u mbushën me qumësht me bollëk. Ai thithi derisa u ngop e bashkë me të thithi edhe vëllai i tij derisa u ngop. Pastaj të dy fjetën, ndonëse ne nga djali ynë natën e kaluar nuk fjetëm fare. Burri im pastaj iu afrua devesë sonë të lodhur, kur papritmas pa se edhe gjinjtë e devesë ishin mbushur plot me qumësht. Ai e moli devenë, pastaj piu qumësht, piva edhe unë derisa u ngopëm. Pastaj kaluam një natë të mirë!”

Ajo në vazhdim tha: “Kur u zgjuam, burri im më tha: -Oj Halime, vallahi, dije se ti ke marrë një krijesë të bekuar! Unë ia ktheva: -Vallahi, edhe unë këtë shpresoj!”

Pastaj u nisëm dhe unë hipa mbi gomaricë duke e mbajtur fëmijën me vete. Gomarica, pasha Zotin, ecte aq shpejt sa asnjë tjetër nuk mund ta ndiqte. Shoqet e

<sup>29</sup> Emri i tij ishte Abdullah b. Harith b. Abduluzza.

<sup>30</sup> Pra, burrit tim, Harith b. Abduluzza.

mia më thanë: -Për hir të Zotit, o bija e Ebu Dheibit, na prit edhe ne! A nuk është e njëjta gomaricë me të cilën erdhëm këndeje? Unë u thashë atyre: -Po, betohem në Zotin, ajo është! Ato thanë: -Vallahi, në të ka diçka!

Pastaj erdhëm në shtëpinë tonë, në zonën e fisit Beni Sa'd, dhe unë nuk di se ka ndonjë tokë më shterpë se ajo. Mirëpo, pasi ne e sollëm atë, vazhdimisht kafshët tona vinin të ngopura dhe me plot qumësht. Ne i milnim dhe e pinim qumështin e tyre, ndërsa të tjerët në gjinjtë e kafshëve të tyre nuk gjenin as edhe një pikë të vetme. Ata barinjve të tyre u thoshin: "Për Zotin, kullotini edhe ju bagëtitë tuaja aty ku po i kullot bariu i bijës së Ebu Dheibit!" Megjithatë, bagëtitë e tyre edhe më tutje ktheheshin të uritura, pa dhënë asnjë pikë qumësht, ndërsa bagëtitë tona ishin të ngopura dhe me qumësht të bollshëm.

Kështu, ne vazhdimisht patëm tepricë dhe bollëk për dy vjet, derisa ai ishte me ne. Ai rritej shumë më shpejt sesa djemtë e tjerë. Ende nuk kishte mbushur dy vjeç, por ishte djalë i fuqishëm. Pastaj e kthyem te nëna e tij, por kishim dëshirë të madhe që të qëndronte te ne, duke parë se çfarë bereqeti na solli. Ne folëm me nënën e tij dhe unë i thashë asaj: "Sikur ta lini tek ne derisa të rritet sepse kam frikë për të në Mekë!" Vazhduam ta bindnim, derisa ra dakord që ta merrnim me vete.

Dhe përsëri u kthyem me të.

Një ditë, disa muaj më vonë, derisa ai me vëllanë e tij nga qumështi po ruanin bagëtitë e imta prapa shtëpive tona, papritmas erdhi vëllai i tij duke u dridhur i tëri dhe na tha: "Atë vëllanë tim nga fisi Kurejsh e morën dy burra të veshur me të bardha, e kanë shtrirë përtokë, ia kanë çarë barkun dhe vazhdimisht po e fërkojnë!"

Atëherë dolëm unë dhe babai i tij me nxitim në drejtim të tij. E gjeta në këmbë, me fytyrë të shqetësuar nga frika. Iu afrova unë, iu afrua edhe babai i tij dhe i thamë: "Çfarë ke, o bir?" Tha: "Më erdhën dy burra me rroba të bardha, më shtrinë përtokë, ma çanë barkun, pastaj kërkuan diçka në të, nuk e di se çka."

Pastaj u kthyem me të në çadrën tonë dhe babai i tij më tha: "Oj Halime, unë po frikësohem se mos është sëmure ky djalë. Dërgoja familjes së tij para se kjo të vërehet tek ai!"

Menjëherë e morëm dhe e çuam tek e ëma e tij. Ajo tha: "Pse e prure, oj mëndeshë? Ti u angazhove aq shumë për qëndrimin e tij me ju?" Unë i thashë: "Allahu më dha djalin tim dhe unë e kreuva detyrën time. Ndërkaq, u frikësova se mos i ndodh ndonjë gjë atij, kështu që ta solla ty, se edhe ti ke dëshirë!"

Ajo tha: "Ti nuk do të veproje kështu. Më trego të vërtetën!" Ajo nuk më la të qetë derisa i tregova. Më pyeti: "A u frikësove se mos po e dëmton shejtani?"

Unë i thashë: "Po!"

Ajo tha: "Në asnjë mënyrë! Vallahi, shejtani nuk ka qasje tek ai. Djali im është me të vërtetë i veçantë. A do të të tregoj diçka në lidhje me të?"

I thashë: "Po, gjithsesi."

Ajo më tha: "Kur isha shtatzënë me të, unë pashë një dritë që doli nga unë dhe ndriçoi kështjellat e Busras në Sham. Pastaj shtatzënia përparoi ndërsa unë vallahi nuk kam parë shtatzëni më të lehtë se ajo. Kur e linda, ai i vuri duart e tij mbi tokë, me kokë të ngritur nga qielli. Lëre dhe të qoftë rruga e mbarë!"

## NGJARJA E HAPJES SË GJOKSIT

Ibni Is'haku thotë:

Më ka treguar Thevr b. Jezid nga disa njerëz të ditur, por unë i përmbahem vetëm asaj që më ka thënë Halid b. Ma'dan Kelaiu:

Një grup sahabësh e kishin lutur Pejgamberin a.s. duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut, na trego për veten tëndel!” Ai kishte thënë:

*“Po, unë jam lutja e gjyshit tim Ibrahimit dhe sihariqi i vëllait tim Isait. Nëna ime kur ishte shtatzënë me mua ka parë duke dalë prej saj një dritë e cila kishte ndriçuar kështjellat e Shamit. Jam ushqyer me gji në fisin Benu Sa’d b. Bekër.*

*Derisa unë isha me vëllanë tim nga qumështi, pas shtëpive tona, duke ruajtur bagëtinë, papritmas më erdhën dy burra të veshur me të bardha, me një enë prej ari plot me ujë bore. Pastaj më kapën dhe ma çanë barkun, pastaj ma nxorën zemrën dhe ma ndanë, nxorën prej saj një droçkë gjaku të zi dhe e hodhën. Pastaj zemrën dhe barkun ma lanë me ujin e borës derisa i pastruan mirë. Pastaj njëri prej tyre i tha tjetrit: “Mate atë me dhjetë nga umeti i tij!” Atëherë më mati me ta dhe unë rëndova më tepër. Pastaj tha: “Mate me njëqind të umetit të tij!” Më mati dhe përsëri unë rëndova më tepër. Pastaj tha: “Mate me një mijë të umetit të tij!” Dhe më mati dhe përsëri unë rëndova më tepër. Atëherë tha: “Lëre të shkojë sepse edhe sikur ta matesh me tërë umetin e tij, ai përsëri do të rëndonte më shumë!”*

## NËN MBROJTJEN E GJYSHIT ABDULMUTTALIB

Pejgamberi a.s. me nënën e tij Amine bint Vehb dhe me gjyshin Abdulmuttalib b. Hashim ishin nën strehimin dhe mbrojtjen e Allahut. Allahu bëri që ai të rritet mirë, pasi donte t'i shfaqte atij një nder të veçantë.

Kur Pejgamberi a.s. mbushi gjashtë vjeç, i vdiq e ëma në vendin Ebva, mes Mekës dhe Medinës. Ajo e kishte marrë me vete atë për të vizituar dajallarët e tij nga fisi Benu Adij b. Nexhxhar dhe kishte vdekur gjatë kthimit për në Mekë.

Pejgamberi a.s. mbeti me gjyshin e tij, Abdulmuttalib b. Hashimin. Abdulmuttalibit i kishin vendosur një minder në hijen e Qabesë, ku nuk ulej asnjëri nga të bijtë, duke shfaqur kështu respekt të veçantë për të atin. Ndërsa ata rrinin në këmbë përreth të atit, Pejgamberi a.s. shkonte e ulej lirshëm në minderin e gjyshit. Kur xhaxhallarët donin ta ngrinin nga minderi, Abdulmuttalibi u thoshte: "Lërmani djalin! Vallahi, ky do të bëhet i shquar dhe i famshëm!"

Duke thënë kështu e afronte më pranë dhe ia fërkonte kurrizin. Çdo gjë që bënte nipi i bukur, i pëlqente të gjyshit!

Kur Pejgamberi a.s. mbushi tetë vjeç, Abdulmuttalibi vdiq. Ai ishte viti i tetë pas vitit të elefantit.

## NËN MBROJTJEN E XHAXHAIT EBU TALIB

Pas Abdulmuttalibit, Pejgamberi a.s. qëndroi me xhaxhanë e tij Ebu Talibin.

Në fisin Benu Lihb ishte një njeri i njohur për parashikime (Aif) dhe kur vinte në Mekë, Kurejshët i çonin para tij djemtë e tyre që t'i shihte dhe t'u parashikonte të ardhmen e tyre.

Edhe Ebu Talibi me djemtë e tjerë solli edhe Pejgamberin a.s.. Ai e shikoi, pastaj për pak çaste u mor me diçka tjetër. Por kur u lirua, tha:

“Djaloshin! Ma sillni djaloshin!” Kur e vërejti Ebu Talibi interesimin e tij të madh, e fshehu prej tij.

Ai thoshte: “Për hir të Zotit, ma ktheni atë djalë që pashë më parë! Vallahi, ai do jetë një person shumë i rëndësishëm!”

## NGJARJA ME BEHIRËN

Pas kësaj, Ebu Talibi u nis me një karvan për të tregtuar në Sham. Kur mbaroi përgatitjet dhe mori gjithçka që i nevojitej për udhëtim, Pejgamberi a.s. filloi ta përkëdhelë dhe ky nuk mundi t'i rezistojë. Atëherë Ebu Talibi tha: "Vallahi, do ta marr me vete, askund nuk do të ndahem prej tij!"

Dhe e mori me vete.

Kur karvani zbriti në Busra, hasën një eremit të quajtur Behira, i cili rrinte në qelinë e tij. Ai kishte njohuri mbi mësimet e Krishterimit dhe në atë qeli qëndronte qysh se ishte bërë kallogjer. Ata pretendonin se njohuritë e tij ai i merrte nga një libër që mbante në qelinë e tij dhe përcillej nga brezi në brez.

Në vitet e mëparshme ata shpesh kishin kaluar pranë tij, por ai asnjëherë nuk ishte paraqitur e as nuk kishte dalë para tyre.

Atë vit, kur ata iu afruan qelisë së tij, ai u përgatiti atyre një drekë të begatshme.

Ata thonë se ai e bëri këtë për shkak se kishte parë diçka nga qelia e tij. Në karvanin që po vinte ai kishte njohur Pejgamberin a.s. dhe kishte parë një re që mbulonte vetëm atë.

Karvani pastaj arriti dhe u ndal në hijen e një peme jo shumë larg tij. Ai e shikoi renë që mbulonte pemën, pastaj pa degët e pemës duke iu afruar Pejgamberit a.s., se si ai po kërkonte hije nën to.

Kur e pa këtë Behira, doli nga qelia e tij dhe u dërgoi një porosi duke u thënë:

"Unë kam përgatitur ushqim për ju o Kurejshë dhe kam dëshirë që të më vini të gjithë – i madh e i vogël, edhe robërit dhe njerëzit e lirë!"

Njëri prej tyre i tha: "Vallahi, o Behira, sot je i veçantë! Më parë nuk ishe i këtyllë me ne, edhe pse ne kemi kaluar shpesh këtupari. Pra, çfarë është sot më e veçantë?"

Behira u përgjigj: "Është e vërtetë kjo që po thua, por ju jeni mysafirë. Unë pata dëshirë t'ju nderoj, t'ju përgatis ushqim dhe të hani të gjithë!"

Dhe të gjithë u mblodhën rreth tij, përveç Pejgamberit a.s., që nuk ishte në mesin e tyre. Ai në fakt ishte fëmijë, kështu që qëndroi nën pemë për të vëzhguar kafshët e karvanit. Por, kur Behira i shikoi me kujdes të pranishmit dhe nuk e pa shenjën që priste, tha:

"O Kurejsh, askush mos të mungojë nga ushqimi!"

Ata i thanë: "O Behira, nuk mungon askush nga ata që duhej të vinin, me përjashtim të një djali të vogël. Ai është më i riu midis nesh, e kemi lënë që të kujdeset për kafshët tona."

Ai u tha: “Mos veproni kështu, ftojeni të vijë për të ngrënë me ju!”

Një nga Kurejshët e pranishëm tha: “Pasha Latin dhe Uzzan, është turp ta lëmë larg ushqimit pikërisht djalin e Abdulmuttalibit!” Pastaj ai u ngrit, e mori ngrykë dhe e uli bashkë me të tjerët.

Kur e pa Behira, filloi ta vëzhgojë me kujdes, duke kërkuar ato tipare të trupit të tij të cilat i kishte gjetur në libra.

Pasi hëngrën ushqimin të ftuarit dhe u shpërndanë, Behira iu afrua dhe i tha:

“O djalosh, po të pyes diçka dhe po të betohem në Latin dhe Uzzan, që të më përgjigjesh.” Behirau u shpreh kështu sepse i kishte dëgjuar njerëzit që betohehin për këta dy emra.

Thuhet se Pejgamberit a.s. i tha: “*Mos m’u beto në Latin dhe Uzzan sepse vallahi asgjë nuk urrej më shumë se këta të dy!*”

Behira ia ktheu: “Atëherë, për Allahun, m’u përgjigj në atë që do të pyes.”

I tha: “*Më pyet çfarë të duash!*”

Behira filloi ta pyeste për disa gjëra rreth gjendjes së tij në gjumë, për përmbajtjen dhe formën e ëndrrave të tij. Pejgamberi a.s. i përgjigjej dhe ato përputheshin plotësisht me tiparet që Behira kishte gjetur në libra. Pastaj e shikoi në shpinë dhe aty i pa vulën e pejgamberisë në mes të shpatullave, ashtu siç ishte i paralajmëruar.

Kur e përfundoi këtë, iu kthye xhaxhait të tij, Ebu Talibit, dhe e pyeti: “Çfarë e ke ti këtë djalë?”

Ebu Talibi u përgjigj: “Është djali im.”

Behira i tha: “Ky nuk është djali yt, ky djalë nuk duhet ta ketë gjallë babanë!”

Ebu Talibi atëherë i tha: “Ai është djali i vëllait tim.”

Behira tha: “Çfarë ka ndodhur me babanë e tij?”

Tha: “Ai ka vdekur kur nëna e tij ishte shtatzënë me të!”

Behira tha: “Të vërtetën ke thënë! Kthehu me djalin e vëllait në vendin e tij dhe kujdesu për të nga hebrejët! Vallahi, nëse e shohin ata dhe kuptojnë atë që kuptova unë, me siguri do ta dëmtojnë atë. Këtij djalit të vëllait tënd do t’i ndodhin gjëra të mrekullueshme!”

Ebu Talibi menjëherë nxitoi me të për në Mekë.

## LUFTA MËKATARE

Kur ndodhi lufta mëkatore (harbul-fixhar), Pejgamberi a.s. ishte në moshën njëzetvjeçare<sup>31</sup>. Kjo ditë është quajtur dita e mëkatit për arsye se dy bashkësi fisnore, Kinane dhe Kajs Ajlan, e shkelën shenjtërinë, që ishte e ndaluar rreptësisht.

Udhëheqësi i Kurejshëve dhe Kinane ishte Harb b. Umejje. Në mëngjes iniciativën e kishte fisi Kajs, por në mesditë situata u përmbys dhe iniciativa kaloi në favor të Kinanes ndaj Kajsit.

<sup>31</sup> Ibni Hishami thekson se Pejgamberi a.s. ka qenë dëshmitar i disa ditëve të së ashtuquajturës luftë mëkatore. Atë e kishin marrë me vete xhaxhallarët e tij. Vetë Pejgamberi a.s. për këtë kishte thënë: *“Unë u jepja shigjetat xhaxhallarëve të mi”*, d.m.th. shigjetat e armiqve, kur ato binin rreth tyre. Kjo luftë mëkatore është lufta e fundit. Para saj kanë ndodhur edhe tri luftëra: e para mes fiseve Kinane dhe Havazin; e dyta mes Kurejshëve dhe Havazinit dhe e treta mes Kinanes dhe Havazinit. Më gjerësisht për këto luftëra flitet në veprat *“El-Ikdul-Ferid”* dhe *“El-Egani”*.

## MARTESA ME HATIXHENË r.a.

Hatixhe bint Huvejlid ishte një grua tregtare, e respektuar dhe e pasur. Ajo punësonte njerëz që të tregtonin me pasurinë e saj dhe u paguante një përqindje të caktuar. Kurejshët ishin një popull tregtar. Kur Hatixhesë i treguan për sinqeritetin e Pejgamberit a.s., për besnikërinë e madhe dhe për moralin e tij fisnik, ajo i dërgoi porosi dhe i propozoi që ai të shkonte me pasurinë e saj në Sham për tregti dhe ajo do ta shpërblente më shumë se tregtarët e tjerë. Me të do të shkonte edhe shërbëtori i saj Mejsere. Pejgamberi a.s. e pranoi këtë ofertë dhe me pasurinë e saj së bashku me Mejseren u nis për udhëtim dhe mbërriti në Sham.

Pejgamberi a.s. u ul në hijen e një peme, jo shumë larg nga qelia e një murgu<sup>32</sup>. Murgu e shikoi Mejseren, pastaj i tha:

“O Mejsere, kush është ai personi nën atë pemë?”

“Është një person nga fisi Kurejsh, nga banorët e vendit të shenjtë!” - iu përgjigj Mejsere.

Murgu i tha: “Nuk është ulur nën hijen e asaj peme askush tjetër përveç Pejgamberëve!”

Pejgamberi a.s. i shiti të gjitha mallrat që kishte sjellë nga Meka, pastaj bleu çdo gjë që kishte shkuar për të blerë. Pastaj me këtë ngarkesë u kthye me karvanin në Mekë. Në mesditë, në kohën e vapës më të madhe, Mejsere kishte parë dy engjëj të cilët i bënë hije atij duke ia mbuluar diellin derisa ai ecte i hipur mbi deve. Pasi arriti në Mekë, ia dorëzoi Hatixhesë mallin e saj, të cilin ajo pastaj e shiti duke fituar dyfish ose gati sa dyfishi.

Mejsere i tregoi asaj çfarë i kishte thënë murgu, gjithashtu edhe atë se vetë ai kishte parë dy engjëj duke i bërë hije atij. Hatixheja ishte një grua e vendosur, e zgjuar dhe e ndershme. Allahu e kishte nderuar dhe stolitur me shumë virtyte. Pasi u njoftua nga Mejsere, ajo dërgoi njerëz për ta ftuar Pejgamberin a.s., të cilit i tha:

“Unë të dëshiroj ty për shkak të farefisit tënd, për shkak të reputacionit që gëzon në popullin tënd, për shkak të besnikërisë dhe moralit të bukur dhe për shkak të sinqeritetit.” Pastaj i ofroi që të bëhet gruaja e tij.

Hatixheja për nga origjina ishte një grua e vlerësuar Kurejshe. Gëzonte prestigj të madh dhe ishte ndër gratë më të pasura. Çdo banor i Mekës do të ishte i nderuar nëse do të mund të martohej me të.

<sup>32</sup> Ai murg quhej Nestura.

Kur ajo ia tha këto fjalë, Pejgamberi a.s. u tregoi xhaxhallarëve të tij. Xhaxhai i tij, Hamza, doli me të dhe shkoi te Huvejlid b. Esedi<sup>33</sup>, kreu fejesën dhe pastaj edhe martesën<sup>34</sup>.

Ajo lindi të gjithë fëmijët e Pejgamberit a.s., përveç Ibrahimit<sup>35</sup>. Kasimin, sipas të cilit e kishte marrë edhe pseudonimin, Ebul-Kasim, babai i Kasimit, Tahirin dhe Tajjibin<sup>36</sup>, Zejneben, Rukijen, Ummu Kulthumin dhe Fatimen, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të gjithë.

Kasimi, Tajjibi dhe Tahiri vdiqën në periudhën paraislame, ndërsa të gjitha vajzat e arritën Islamin, u bënë muslimane dhe emigruan me Pejgamberin a.s. në Medinë.

<sup>33</sup> Ai është Huvejlid b. Esed b. Abduluzza b. Kusajj b. Kilab b. Murre b. Ka'b b. Luejj.

<sup>34</sup> Për mehr, dhuratë martesore, Pejgamberi a.s. i dha asaj njëzet deve të reja. Ajo ishte gruaja e parë e tij dhe nuk u martua me asnjë grua tjetër deri në vdekjen e saj.

<sup>35</sup> Nëna e Ibrahimit ishte Maria, kopte nga Egjipti i Epërm, të cilën ia kishte dhuruar Mukavkisi, funksionar i lartë kopt.

<sup>36</sup> Tahir dhe Tajjib ishin pseudonime, ndërsa emri i vërtetë i tij ishte Abdullah.

## DEKLARATA E VEREKA BIN NUFELIT

Hatixheja i kishte treguar djalit të xhaxhait, Vereka b. Nufel b. Esed b. Abdul-uzza, gjithçka që kishte dëgjuar nga Mejsere, si fjalët e murgut ashtu edhe atë që kishte parë vetë ai, kur dy engjëj i bënë atij hije. Ai ishte i krishterë, kishte studiuar librat e krishterë dhe ishte shoqëruar me njerëz të ditur. Kur e dëgjoi, Vereka tha:

“Nëse kjo është e vërtetë, oj Hatixhe, atëherë me siguri Muhamedi është Pejgamber i këtij populli! Unë kam mësuar se nga ky popull do të shfaqet një Pejgamber, i cili po pritet. Kjo është koha e tij!”

Vereka këtë e kishte pritur me padurim. Ai shpesh thoshte: “Deri kur?”, madje e kishte shprehur edhe me vargje:

*Kam pritur me këmbëngulje për shkak të nostalgjisë,  
derisa më erdhi lajmi me përshkrimet një nga një të Hatixhesë.*

*E gjatë ishte pritja, derisa në gjirin e Mekës, oj Hatixhe,  
unë i prisja fjalët e tua, që në to të shihja rrugëdalje!*

*Ti na i tregove fjalët e murgut, vetmitar,  
se Muhamedi lideri ynë do të mposhtë çdo kundërshtar!*

*Se ai këtë vend me dritë do ta ndriçojë,  
dhe do të ndërtojë një botë që do të dallgëzojë!*

*Kushdo që e sulmon, disfatë do t'i shkaktojë,  
ndërsa fitoren do t'ia japë atij që do ta ndihmojë!”*

*Ah, sikur të kisha fatin për ta mirëpritur atë njeri,  
dhe nga të gjithë ju, unë t'i besoj i pari!*

## NDËRTIMI I QABESË

Pejgamberi a.s. mbushi tridhjetë e pesë vjeç kur Kurejshët u mblodhën për ndërtimin e Qabesë. Në fakt, ata dëshironin të ndërronin çatinë sepse kishin frikë mos po shembej, pasi e gjithë ndërtesa e mësipërme mbi themele ishte e ndërtuar vetëm me gurë pa suvatim.

Në bregdetin e Mekës deti kishte hedhur në breg një anije të një tregtari romak, e cila ishte shkatërruar, kështu që Kurejshët morën dërrasat e saj dhe i përgatitën për kulm. Në Mekë jetonte edhe një marangoz kopt, i cili u dha atyre disa materiale për riparimin e kulmit.

Nga skuta e Qabesë, ku ishin vendosur dhuratat, çdo ditë dilte një gjarpër dhe rrezitej në murin e Qabesë. Mes gjërave nga të cilat njerëzit kishin frikë ishte edhe kjo, sepse kur dikush i afrohej, ai çonte kokën, fëshfërinte me trupin e tij dhe hapte gojën.

Dhe derisa një ditë ai po rrezitej në murin e Qabesë, siç bënte zakonisht, Allahu dërgoi një zog, i cili e kapi dhe e çoi diku. Kurejshët thanë:

“Shpresojmë që kjo të jetë një tregues se Allahu është i kënaqur me qëllim tonë. Ne kemi punëtorë të mirë, kemi edhe dërrasat, kurse tani Allahu na shpëtoi edhe nga gjarpri!”

Kur të gjithë ranë dakord për rrënimin dhe rindërtimin e saj, u ngrit Ebu Vehbb. Amër b. Aiz b. Abd b. Imran b. Mahzum dhe mori një gur të Qabesë, mirëpo guri i ra nga dora dhe ai u kthye në vendin e tij e tha:

“O Kurejshë! Mos përziëni në ndërtimin e Qabesë atë gjë që s’është fituar në mënyrë të pastër e të bekuar! Në të nuk duhet të futet mall i fituar me rrugë të paligjshme, para kamate ose para e marrë pa të drejtë nga ndonjëri kushdo qoftë ai!”

Kurejshët pastaj e ndanë Qabenë. Pjesa në të cilën gjendet dera i takoi Benu Abdi Menafit dhe Zuhres, pjesa në mes këndit të zi dhe këndit jemenas i takoi Benu Mahzumit dhe disa fiseve të Kurejshëve. Pastaj pjesa e prapme e Qabesë i takoi Benu Xhumehit dhe Sehmit, kurse pjesa Hixhr (në veriperëndim të Qabesë) iu dha Benu Abdudhar b. Kusajit, Benu Esed b. Abduluzza dhe Benu Adij b. Ka’b.

Megjithatë, njerëzit kishin frikë nga prishja e saj dhe frikësoheshin të fillonin punimet. Velid b. Mugire tha:

“Unë i pari do ta nis rrënimin e saj!” Pastaj e mori kazmën, iu afrua asaj dhe tha: “O Zoti im, ne nuk devijojnë nga besimi Yt! O Zoti im, ne duam vetëm të mirën!”

Pastaj e rrënoi nga ana e dy qosheve. Njerëzit e kaluan natën në pritje duke thënë:

“Në qoftë se atij i ndodh diçka, nuk do të vazhdojmë rrënimin dhe do ta rikthejmë ashtu siç ishte. E në qoftë se atij nuk i ndodh asgjë, kjo do të thotë se Allahu është i kënaqur me atë që po bëjmë dhe atëherë do ta vazhdojmë prishjen!”

Velidi atë natë fjeti i qetë dhe në mëngjes vazhdoi punën. Ai rrëronte, e me të edhe njerëzit e tjerë. Kur arritën në themel, në themelet e Ibrahimit a.s., hasën në disa lloj gurësh të gjelbër që i përngjanin gungës së devesë dhe ishin të lidhur fort me njëri-tjetrin.

Pastaj fiset Kurejshe i mblodhën këta gurë për ndërtimin e saj. Secili fis mbli-dhte gurë për vete dhe vazhduan ndërtimin derisa arritën te vendi ku duhej vendosur guri i zi. Atëherë shpërthyen grindjet. Secili fis dëshironte që ta vendoste ai gurin në vendin e vet. Në fund, të gjithë u larguan mënjanë, formuan aleanca mes tyre dhe u përgatitën për betejë.

Disa transmetues pohojnë se Ebu Umejje b. Mugire, i cili në atë kohë ishte Kurejshe më i vjetër, tha:

“O Kurejshë, lejoni të gjykojë njeriu i parë që hyn në derën e këtij tempulli!”

Dhe ata pranuan. I pari që hyri ishte Pejgamberi a.s.. Kur e panë, ata thanë:

“Ai është njeri i besueshëm, ne jemi dakord. Ky është Muhamedi!”

Kur ai u afrua, ata e njoftuan për vendimin që kishin marrë, atëherë Pejgamberi a.s. tha:

“*Më sillni një pëlhurë!*” Dhe kur ia sollën, ai pastaj me dorën e tij vuri aty gurin e zi. Pastaj tha: “*Le ta kapë secili fis nga një skaj të pëlhurës dhe të gjithë së bashku le ta ngrenë!*” Kështu vepruan. Kur arritën te vendi i tij, ai e vendosi me dorën e tij në vend dhe pastaj vazhdoi ndërtimi.

## PARALAJMËRIMET E MAGJISTARËVE ARABË, RABINËVE HEBRENJ DHE PRIFTËRINJVE TË KRISHTERË

Rabinët hebrej, priftërinjtë e krishterë dhe magjistarët arabë kanë folur për Pejgamberin a.s. qysh para dërgimit të tij, duke pohuar se ishte afruar koha e ardhjes së tij.

Rabinët hebrej dhe priftërinjtë e krishterë bazoheshin tek ajo që kishin gjetur në librat e tyre, mbi karakteristikat e tij dhe karakteristikat e kohës së tij si dhe të kohës së Pejgamberëve të tyre.

Magjistarëve arabë këtë ua kishin mësuar shejtanët nga xhinët, të cilët kishin përgjuar në qiell. Në fakt, atyre ende nuk u ishte ndaluar përgjimi, duke i gjuajtur me yje. Magjistarët shpesh përmendnin diçka në lidhje me të, por arabët nuk u kushtonin rëndësi. Mirëpo, kur Allahu e dërgoi Pejgamberin a.s. dhe kur ndodhën ato që kishin përmendur, i njohën ato.

Kur koha u afrua shumë dhe kur ndodhi dërgimi i Pejgamberit a.s., shejtanëve iu pamundësua përgjimi. Ndërmjet tyre dhe pritës që kishin zënë për të përgjuar u vendos pengesë, ndërsa ata u gjuajtën me yje. Kështu xhinët e kuptuan se kjo po ndodhte për shkak të ndonjë dispozite të Allahut që ka të bëjë me njerëzit.

## PËRSHKRIMI I PEJGAMBERIT a.s.

Ibni Hishami thotë:

Kjo është pamja e Pejgamberit a.s. sipas fjalëve të Omer Mevla Gufre nga Ibrahim b. Muhammed b. Ali b. Ebi Talib, i cili ka thënë:

“Kur Ali b. Ebi Talibi r.a.<sup>37</sup> e përshkruante Pejgamberin a.s., ai thoshte:

“Ai kishte shtat mesatar, duke mos qenë as shumë i gjatë, as shumë i shkur-tër. Flokët nuk i kishte shumë kaçurrela apo shumë të drejtë, por ashtu të valë-zuar. Ai nuk ishte as shumë i shëndoshë, por as i dobët. Shtati i tij ishte mesatar, shpatullgjerë. Fytyra e tij ishte me çehre të bardhë, e bukur dhe tërheqëse. Sytë i kishte të mëdhenj dhe të zinj, me qerpikë të dendur dhe të gjatë. Kishte kocka të mëdha në kyçe dhe supe, me qime të holla nga gjoksi gjer në kërthizë, me duart dhe këmbët e forta me pak qime.

Ecte drejt, me hapa të sigurt e të shpejtë; kur i duhej, kthehej mbrapa me gjithë trupin.

Ndërmjet shpatullave kishte vulën e pejgamberisë. Ai ishte vula e pejgambe-risë, ishte Pejgamberi i fundit. Ai ishte njeriu më bujar, më i guximshëm, më i sinqertë, më i besueshëm, më i butë dhe me sjelle më të bukura. Kur dikush e sheh për herë të parë, ndien respekt ndaj tij, ndërsa kush rri me të, e do atë.”

Përshkruesi i tij thotë: “Asnjëherë, as më parë e as më vonë, nuk kam parë dikë të ngjashëm me të. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!”

<sup>37</sup> Shkurtesa r.a., e cila do të përdoret në tekst, zëvendëson fjalën *radijAllahu anhu*, që do të thotë: Allahu qoftë i kënaqur me të. Përkthyesi.

## PËRSHKRIMI I PEJGAMBERIT a.s. SIPAS UNGJILLIT

Ibni Is'haku thotë:

Sipas njohurive që unë kam, Isai biri i Merjemes, në mesin e asaj që i është shpallur nga Allahu në Ungjill, pasuesve të tij u ka komunikuar edhe përshkrimin e Pejgamberit a.s., të cilin e ka shkruar edhe apostulli Gjon me rastin e kopjimit të Ungjillit nga koha e Isait birit të Merjemës a.s. për Pejgamberin i cili do t'u vijë atyre. Ai thotë:

*“23 - Kush më urren mua, urren edhe Atin tim. 24 - Po të mos kisha bërë në mes tyre vepra që askush tjetër nuk ka bërë, nuk do të kishin faj; por tani, përkundrazi, e kanë parë, dhe më kanë urryer mua dhe Atin tim. 25 - Por kjo ndodhi që të përmbushet fjala e shkruar në ligjin e tyre: “Më kanë urryer pa shkak”. 26 - Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t’ju dërgoj prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ati im, ai do të dëshmojë për mua. 27 - Edhe ju, gjithashtu, do të dëshmoni, sepse ishit me mua që nga fillimi.”<sup>38</sup>*

Ngushëlluesi (në Ungjillin e Gjonit) në gjuhën sirianije është shprehur me fjalën ‘Munhamenna’, që do të thotë Muhamedi, ndërsa në gjuhën greke është ‘Paraklitis’.

<sup>38</sup> Shih: Ungjilli i Gjonit 15: 23-27.

Cituar sipas: <https://www.biblegateway.com/passage/?search=Gjoni%2016&version=ALB>

## MISIONI I PEJGAMBERISË

Kur Muhamedi a.s. mbushi dyzet vjeç, Allahu i Madhërishëm e dërgoi si mëshirë për botët dhe si lajm të mirë për mbarë njerëzimin.

Allahu i Lartmadhërishëm prej të gjithë Pejgamberëve që janë dërguar para tij (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të gjithë ata) mori premtimin se do t'i besojnë Atij, do ta pranojnë Atë dhe do ta ndihmojnë kundër kundërshtarëve. Ai gjithashtu mori premtimin se ata këtë mision do ta përcjellin tek të gjithë ata që u besojnë dhe i pasojnë. Dhe të gjithë Pejgamberët e përmbushën këtë premtim të dhënë.

Transmetohet nga Aishja r.anha se ka thënë:

“Kur Allahu i Madhërishëm deshi ta nderojë Pejgamberin a.s. dhe ta dërgojë mëshirë për njerëzimin, e para gjë me të cilën filloi misioni i pejgamberisë ishin ëndrrat e vërteta. Çdo ëndërr që shihte në gjumë Pejgamberi a.s., i vinte si agimi i mëngjesit. Allahu ia kishte bërë të dashur vetminë. Ai nuk kishte asgjë më të preferuar sesa të qëndronte i vetëm.”

Transmetohet nga Abdulmelik b. Ubejdullah se ka thënë:

“Vërtet Pejgamberi a.s. një kohë para se Allahu t'i shprehte respekt të veçantë dhe të fillonte misionin e pejgamberisë, kur dilte për diçka, shkonte aq larg nga shtëpitë, sa që nuk shiheshin me sy. Ai shkonte në gryka mali të Mekës dhe në brendi të luginave të saj. Atëherë çdo gurë dhe çdo dru pranë të cilit kalonte i thoshte: “Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut!” Pejgamberi a.s. kthehej rreth vetes, shikonte djathtas, majtas dhe pas tij, por nuk shihte tjetër vetëm se drutë dhe gurët. Kështu një kohë, sa deshi Allahu, vetëm shikonte dhe dëgjonte. Pastaj i erdhi Xhibrili a.s. dhe i solli nderimin e Allahut, ndërsa ai ishte në shpellën Hira, në muajin Ramazan.”

Transmetohet nga Ubejd b. Umejri se ka thënë:

“Pejgamberi a.s. çdo vit kalonte nga një muaj në shpellën Hira. Ky ishte një zakon i Kurejshëve në periudhën paraislame (xhahilijet)<sup>39</sup>. Pejgamberi a.s. këtë e bënte çdo vit nga një muaj, duke ushqyer çdo të varfër që kalonte atypari.

Pasi e përfundonte qëndrimin e tij njëmuajor, Pejgamberi a.s. shkonte së pari në Qabe para se të shkonte në shtëpi. Ai bënte shtatë apo më shumë tavafe rreth saj, pastaj shkonte në shtëpi. Kur hyri muaji të cilin Allahu e caktoi që t'i shprehte nderimin, e ky ishte muaji Ramazan, Pejgamberi a.s. shkoi përsëri në shpellën Hira dhe me të ishte edhe familja e tij. Kur erdhi nata në të cilën Allahu e nderoi me shpallje, tek ai erdhi Xhibrili a.s. me mesazhin e Allahut.

<sup>39</sup> Për t'u angazhuar për devotshmëri, larg nga statujat.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Pastaj më erdhi Xhibrili, ndërsa unë isha duke fjetur, me një shtrojë prej mëndafshi në të cilën kishte një shkrim.*

*Më tha: “Lexo!” Unë i thashë:*

*“Unë nuk lexoj!”<sup>40</sup>*

*Ai pastaj më shtrëngoi aq shumë, sa që filloi të më zihej fryma. Mendova se ishte vdekja. Atëherë më lëshoi dhe përsëri më tha: “Lexo!”*

*Unë i thashë: “Nuk lexoj!”*

*Ai përsëri më kapi dhe më shtrëngoi sa që unë mendova përsëri se ishte vdekja, por ai më lëshoi dhe më tha: “Lexo!”*

*Unë i thashë: “Çfarë të lexoj?”*

*Ai më shtrëngoi përsëri dhe unë përsëri mendova se ishte vdekja. Pastaj më liroi dhe më tha: “Lexo!”*

*Unë i thashë: “Çfarë të lexoj?” Pastaj ai më tha:*

*‘Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar! Është Ai që ua mësoi penën. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.’*

*Pastaj unë e lexova atë, ai heshti dhe u largua prej meje. Unë u zgjova nga gjumi me ndjenjën se në zemrën time është shkruar një libër!*

*Pastaj dola dhe kur isha në mes të kodrës dëgjova një zë nga qielli duke thënë:*

*‘O Muhamed! Ti je i Dërguar i Allahut, ndërsa unë jam Xhibrili!’*

*Unë ngrita kokën dhe shikova nga qielli. Në horizont pashë Xhibrilin në formën e një njeriu me këmbë të bashkuara duke më thënë:*

*‘O Muhamed! Ti je i Dërguar i Allahut, ndërsa unë jam Xhibrili!’*

*Unë qëndrova duke shikuar atë pa lëvizur as para as prapa. Pastaj e hoqa shikimin prej tij dhe shikova horizontin. Mirëpo, ngado që shikoja, atë e shihja atje! Unë qëndrova aty pa lëvizur, as nuk eca para as nuk kthehesha prapa, derisa dërgoi Hatixheja njerëz për të më kërkuar. Ata shkuan deri në majë të Mekës dhe u kthyen pas, kurse unë qëndroja në vendin tim. Pastaj Xhibrili u largua.*

*Edhe unë u ktheva për te njerëzit e mi.*

*Kur arrita te Hatixheja, u ula pranë saj dhe u mbështeta tek ajo. Ajo më tha:*

*‘O Ebul-Kasim, ku ke qenë? Vallahi, unë dërgova njerëz për të të kërkuar dhe ata shkuan deri në Mekë e pastaj u kthyen tek unë!’*

*Unë i tregova se çfarë kisha parë, kurse ajo tha:*

*‘Gëzohu dhe bëhu i fortë! Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Hatixhesë, unë me të vërtetë shpresoj se ti mund të jesh Pejgamberi i këtij populli!’*

*Pastaj ajo u ngrit, mblodhi rrobat e saj dhe shkoi te Vereka b. Nufel, i cili ishte djali i xhaxhait të saj. Ai kishte pranuar Krishterimin, kishte lexuar libra dhe kishte*

<sup>40</sup> Sipas transmetimit tjetër: “Unë nuk di të lexoj.”

dëgjuar nga pasuesit e Teuratit dhe Ungjillit. Ajo i tregoi atij të gjitha ato që i kishte treguar Pejgamberi a.s., se çfarë kishte parë dhe dëgjuar ai. Vereka tha:

“I shenjtë, i shenjtë! Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Verekas, në qoftë se më ke thënë të vërtetën, oj Hatixhe, me siguri i paska ardhur meleku më i zgjedhur, i cili i vinte Musait<sup>41</sup>! Ai me siguri është Pejgamberi i këtij populli. Thuaj atij le të bëhet i qëndrueshëm!”

Hatixheja pastaj u kthye te Pejgamberi a.s. dhe e njoftoi se çfarë tha Vereka. Pejgamberi a.s., pasi e mbaroi vetminë e tij, shkoi në Qabe dhe bëri veprimet që kishte zakon të bënte.

Vereka i tha atij: “O djali i vëllait, më trego për çdo gjë që ke parë dhe dëgjuar!”

Pejgamberi a.s. i tregoi, ndërsa Vereka i tha: “Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, ti me të vërtetë je Pejgamberi i këtij populli. Ty të ka ardhur meleku më i zgjedhur – po ai që i kishte ardhur Musait. Ty me siguri do të të përgënjeshtronjë, me siguri do të të ofendojnë, me siguri ti do të emigrosh dhe me siguri do të të luftojnë. Në qoftë se do ta arrij unë atë ditë, me siguri do ta ndihmoj fenë e Allahut. Ai e di se si!”

Pastaj uli kokën e tij dhe e puthi në ballë.

Pejgamberi a.s. më pas shkoi në shtëpinë e tij.

<sup>41</sup> Suhejliu thotë: “Vereka e kishte përmendur Musain a.s. dhe jo Isain a.s., edhe pse ky ishte më afër, për arsye se Vereka ishte bërë i krishterë dhe të krishterët për Isain a.s. nuk pohojnë se ishte Pejgamber dhe i kishte ardhur Xhibrili, por besojnë në doktrinën e trinitetit.”

## FILLIMI I SHPALLJES SË KUR'ANIT

Pejgamberit a.s. shpallja e Kur'anit i ka filluar në muajin Ramazan.

Allahu i Lartmadhërishëm thotë: *“Muaji i Ramazanit, në të (filloi të) shpallet Kur'ani, është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtër)...”* (El-Bekare, 185)

*“Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në Natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dish se ç'është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëj dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit.”* (El-Kadr, 1-5)

*“Ha, Mim. Pasha librin sqarues (të së drejtës nga e kota)! Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar (në Natën e begatshme të Kadrit). Ne dëshiroam t'u tërheqim vërejtjen, e njerëzit të jenë të gatshëm. Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë. Urdhër i përcaktuar nga Vetë Ne. S'ka dyshim se Ne dërguam të Dërguar.”* (Ed-Duhan, 1-5)

*“... Nëse keni besuar Allahun, dhe atë (Kur'anin) që ia zbritëm robit Tonë (Muhamedit) ditën e furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembra), ditën e konfrontimit të dy grupeve...”* (El-Enfal, 41)

Konfrontimi ishte ai mes Pejgamberit a.s. dhe idhujtarëve në Bedër.

## HATIXHE BINT HUVEJLIDI PRANON ISLAMIN

Hatixhe bint Huvejlidi i besoi Pejgamberit a.s. dhe i konsideroi të vërteta të gjitha ato që i erdhën nga Allahu. Ajo e ndihmoi atë në misionin e tij dhe qe e para që besoi në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në vërtetësinë e asaj që vinte prej Tij. Me këtë, Allahu ia lehtësoi punën Pejgamberit të Tij, paqja e Allahut qoftë mbi të. Të gjitha shqetësimet që dëgjonte dhe të gjitha përgënjeshttrimet, që e dëshpëronin shumë, Allahu ia largonte kur kthehej tek ajo. Ajo e përkrahte, e ngushëllonte, i shprehte besimin e saj të palëkundur si dhe e zvogëlonte rëndësinë e asaj që thoshin njerëzit për të. Allahu e mëshiroftë!

Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Jam urdhëruar që ta përgëzoj Hatixhenë për një shtëpi me margaritarë të lëmuar, në të cilën nuk ka as zhurmë as rrëmujë.”*

## NDËRPRERJA E SHPALLJES

Pejgamberit a.s. iu ndërpre shpallja për një kohë, prandaj ai u tensionua dhe u dëshpërua shumë. Pastaj i erdhi Xhibrili me suren Duha, në të cilën Zoti i tij, që e nderoi me shpallje, u betua se nuk e ka braktisur e as nuk e ka përbuzur:

*“Pasha paraditen! Pasha natën kur shtrin errësirën! Zoti yt nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur.”* Allahu i thotë se nuk e ka braktisur dhe nuk e ka lënë, nuk e ka urreyer dhe përsëri e ka dashur.

*“Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para.”* D.m.th. ajo që Unë kam për kthimin tënd tek Unë me të vërtetë është më e mirë sesa nderimi që të kam dhënë më parë në këtë botë.

*“E Zoti yt do të të japë ty e ti do të kënaqesh.”* D.m.th. do të të japë fitoren në këtë botë dhe shpërblimin në botën tjetër.

*“A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri vend (të dha përkrahje)? Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzo? Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi?”* Allahu ia kujton atij se që në fillim i ka shprehur nderim, pastaj i ka dhënë begati duke qenë jetim, e më pastaj me mëshirën e Tij e ka nxjerrë nga varfëria në begati dhe nga injoranca në besim të drejtë.

*“Pra, mos e përul jetimin! As lypësin mos e përzë!”* D.m.th. mos u bëj tiran e as mendjemadh, as i neveritshëm e as i vrazhdë ndaj robërve të pafuqishëm të Allahut.

*“E me të mirat që të dha Zoti yt, trego (udhëzo njerëz)!”* D.m.th. flit për begatitë dhe nderimet në formë të pejgamberisë që të kanë ardhur nga Allahu, përmendi ato dhe fto në to.

Pejgamberi a.s. filloi të fliste për begatitë që Allahu i kishte dhënë atij e me të edhe njerëzve të tjerë. Ai u foli në mënyrë të fshehtë të afërmve tek të cilët kishte besim.

## MUSLIMANËT E PARË

Mashkulli i parë që i besoi Pejgamberit a.s., u fal bashkë me të dhe besoi në atë që i erdhi atij nga Allahu i Madhërishëm ishte *Ali b. Ebi Talibi*, kënaqësia dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, kur ai ishte vetëm dhjetë vjeç.

Njëra nga begatitë e Allahut ndaj Ali b. Ebi Talibit është edhe qëndrimi i tij në shtëpinë e Pejgamberit a.s.. Njëherë, Kurejshët i kaploi një krizë e madhe dhe Ebu Talibi kishte shumë anëtarë në familje. Në këtë situatë, Pejgamberi a.s. i tha xhaxhait të tij Abbasit, i cili ishte nga njerëzit më të pasur të Beni Hashimëve:

*“O Abbas, vëllai yt Ebu Talibi ka shumë anëtarë familjeje dhe siç po sheh njerëzit i ka kapluar kriza, ndaj eja të shkojmë dhe t’ia lehtësojmë pak barrën: ta marr unë një nga djemtë e tij, edhe ti merre njërin nga djemtë dhe t’ia lehtësojmë!”*

Abbasi tha: “Mirë.”

U nisën dhe shkuan tek Ebu Talibi, pastaj i thanë atij: “Ne duam të të lehtësojmë pak derisa të kalojë kjo krizë që ka kapluar njerëzit.”

Ebu Talibi tha: “Vetëm Ukajlin ma lini mua, pastaj ju bëni çfarë të doni!”

Pejgamberi a.s. e mori Aliun dhe e afroi afër vetes, ndërsa Abbasi mori Xhaferin dhe e afroi afër vetes. Kështu Aliu mbeti me Pejgamberin a.s. deri kur Allahu i Madhërishëm ia dërgoi pejgamberinë. Atëherë Aliu r.a. e pasoi, i besoi dhe pranoi gjithçka që i ishte shpallur.

Disa dijetarë theksojnë se Pejgamberi a.s., sa herë që hynte koha e namazit, shkonte në një qafë mali të Mekës, e me të gjithmonë shkonte edhe Ali b. Ebi Talibi, fshehtazi babait të tij, xhaxhallarëve dhe njerëzve të tjerë. Atje ata falnin namazet së bashku, ndërsa në mbrëmje ktheheshin në shtëpi.

Kështu ata vepruan për ditë të tëra, derisa një herë i takoi Ebu Talibi duke qenë në namaz. Atëherë e pyeti Pejgamberin a.s.:

*“O djali i vëllait, çfarë është kjo fe që po praktikon?”*

Pejgamberi a.s.: *“O xhaxha, kjo është feja e Allahut, feja e engjëjve të Tij, e Pejgamberëve të Tij, feja e gjyshit tonë Ibrahimit. Allahu më ka dërguar Pejgamber për njerëzit, kurse ti, o xhaxha, e meriton më shumë këshillën dhe thirrjen time për udhëzim. Gjithashtu, ti je më i afërmi për të m’u përgjigjur dhe për të më ndihmuar.”*

Ebu Talibi tha: “O djali i vëllait, unë nuk mund të ndahem nga feja e baballarëve tanë dhe nga rruga e tyre, por vallahi, sa të jem unë, asgjë e keqe nuk do të bëhet ty!”

Pastaj Islamini e pranoi Ibn Shurahbil b. Ka'b b. Abduluzza (Zejd b. Harithe). Atë e kishte sjellë nga Shami si rob Hakim b. Hizam b. Huvejlid. Kur shkoi tek ai halla e tij, Hatixhja, tashmë gruaja e Pejgamberit (a.s.), ai i tha asaj:

“Zgjidh oj halla ime, njërin prej këtyre djelmohave dhe merre!” Ajo zgjodhi Zejdin dhe e mori.

Kur e pa Pejgamberi a.s., i kërkoi që t’ia dhurojë atij dhe ajo ia dhuroi. Ky pastaj e liroi dhe e birësoi. Kjo kishte ndodhur para fillimit të Shpalljes.

Pastaj Islamin e pranoi *Ebu Bekër b. Ebi Kuhafe*. Emri i tij i vërtetë ishte Atik, ndërsa emri i Ebu Kuhafes ishte Othman. Pasi e pranoi Islamin Ebu Bekri r.a., ai e shfaqti atë publikisht dhe filloi t’i ftojë njerëzit në besim në Allahun dhe Pejgamberin e Tij. Ai ishte i afërt me popullin e tij dhe shumë i dashur. Ai ishte njohësi më i mirë i gjenealogjisë së Kurejshëve dhe dinte më tepër rreth tyre, si të mirat edhe të këqijat. Ai ishte tregtar, i njohur për moralin dhe bamirësinë e tij. Njerëzit shkonin tek ai dhe shoqëroheshin me të për shkak të diturisë së tij për punë tregtare dhe për biseda të këndshme. Ai ftonte në Islam ata tek të cilët kishte besim.

Përmes thirrjes së tij, Islamin e pranoi Othman b. Affani, Zubejr b. Avvami, Abdurrahman b. Avfi, Sa'd b. Ebi Vekkasi dhe Talha b. Ubejdullahu. Këta të tetë<sup>42</sup> ishin të parët që e pranuan Islamin para njerëzve të tjerë. Këta falnin namazin dhe jepnin lëmoshë.

Pastaj Islamin e pranuan: Ebu Ubejde b. Xherrah, Ebu Seleme b. Abduleded, Erkam b. Ebi Erkam<sup>43</sup>, Osman b. Medh’un dhe dy vëllezërit e tij Kudame dhe Abdullah, Ubejde b. Harith, Seid b. Zejd b. Amër, gruaja e tij Fatime, motra e Omer b. Hattabit, Esmā bija e Ebu Bekrit, Aishja bija e Ebu Bekrit, e cila atëherë ishte e vogël, Habbab b. Eretti, Umejr b. Ebi Vekkas, Abdullah b. Mesud, Mesud b. Karijj, Selit b. Amër, Ajjash b. Ebi Rebia dhe gruaja e tij Esmā bint Selame, Hunejs b. Hudhāfe, Amir b. Rebia, Abdullah b. Xhahsh dhe vëllai i tij Ahmedi, Xhafer b. Ebi Talibi dhe gruaja e tij Esmā bint Umejs, Hatib b. Harithi dhe gruaja e tij Fatime bint Muxhel-lil, vëllai i tij Hattabi dhe gruaja e tij Fukejhe bint Jesar, Muammer b. Harith, Saib b. Osman b. Medh’un, Muttalib b. Ez’her dhe gruaja e tij Remle bint Ebi Avf, Nuhham (emri i tij ishte Neim) b. Abdullah, Amir b. Fuhejre, Halid b. Se’id b. As dhe gruaja e tij Amine bint Halef, Hatib b. Amër, Ebu Hudhejfe b. Utbe b. Rebia, Vakid b. Abdullah, Halid b. Amir, Akil dhe Ijjas benu Bekir b. Abd Jalil, Ammar b. Jasir dhe Suhejb b. Sinan Rumi<sup>44</sup>.

<sup>42</sup> Ata janë: Aliu, Zejdi, Ebu Bekri dhe ata që e pranuan Islamin përmes tij.

<sup>43</sup> Në shtëpinë e tij Pejgamberi a.s. është fshehur nga Kurejshët e Mekës dhe në të thërriste njerëzit në Islam. Kjo shtëpi ishte në Safa. Kështu zgjati derisa numri i muslimanëve arriti në dyzet, kur e pranoi Islamin edhe Omeri. Pasi u plotësua ky numër, ata dolën nga ajo shtëpi.

<sup>44</sup> Suhejbi ka qenë arab, mirëpo që fëmijë romakët e kishin marrë rob, ishte rritur atje dhe gati e kishte harruar gjuhën arabe. Pastaj e kishte blerë një njeri nga fisi Kelb dhe e kishte shitur në Mekë. Atë e kishte blerë Abdullah b. Xhud’an dhe e kishte liruar. Në një hadith ekziston shprehja: “Suhejbi është pararendës i romakëve.”

## THIRRJA PUBLIKE NË ISLAM

Menjëherë pas kësaj, njerëzit filluan të hyjnë në Islam në grupe, burrat dhe gratë. Në qytetin e Mekës po flitej me të madhe për Islamin, bisedat rreth tij u përhapen gjithandej.

Pastaj Allahu i Lartmadhërishtëm e urdhëroi Pejgamberin a.s. që ta shfaqë publikisht atë që po i shpallej dhe t'i ftojë njerëzit që ta ndjekin atë. Periudha e thirrjes së Pejgamberit a.s. në fe fshehtas e deri në këtë urdhër për ta shpallur fenë publikisht zgjati tre vjet, pastaj Allahu i Madhërishtëm i tha atij:

*“Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh e hiq idhujtarëve.”* (El-Hixhr, 94)

*“Dhe tërhiq vërejtjen farefisit tënd më të afërt. E të jesh i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty.”* (Esh-Shuara, 214-215)

*“Dhe thuaj: Unë jam qortues i hapët (për dënimin nga Zoti për ata që kundërshtojnë).”* (El-Hixhr, 89)

Shokët e Pejgamberit a.s., kur donin të falnin namaz, shkonin në një qafë mali dhe faleshin fshehurazi nga populli i tyre. Njëherë, derisa Sa'd b. Ebi Vekkasi me një grup shokësh të Pejgamberit a.s. ishin duke u falur në një qafë mali të Mekës, para tyre u shfaq një grup idhujtarësh dhe filluan t'i provokojnë e t'i fyejnë për atë që po bënin dhe më në fund Sa'd b. Ebi Vekkasi e goditi një idhujtar me ashtin e nofullës së devesë dhe ia theu qafën. Kjo qe përballja e parë në Islam.

Kur Pejgamberi a.s. filloi ta ftojë publikisht popullin e tij në Islam, ashtu siç e kishte urdhëruar Allahu, mekasit as nuk u distancuan prej tij dhe as nuk e kundërshtuan, derisa nuk i sulmonte hyjnitë e tyre. Kur ai e bëri këtë, ata filluan t'ia vështirësojnë thirrjen dhe ta kundërshtojnë më seriozisht. Ata u bashkuan dhe u kthyen kundër tij dhe i shprehën armiqësinë e tyre. Përjashtim nga kjo bënin vetëm ata që Allahu i mbrojti me Islam, por ata ishin pakicë dhe fshiheshin.

Xhaxhai i tij, Ebu Talibi, shprehu simpati ndaj Pejgamberit a.s.. Ai e mbrojti dhe u angazhua për të derisa Pejgamberi a.s. vazhdoi sipas urdhrit të Allahut duke bërë thirrje publikisht në Islam; nga kjo asgjë nuk mund ta zmbrapste.

Kur Kurejshët e kuptuan se Pejgamberi a.s. nuk po pranonte asnjë nga kundërshtimet e tyre në lidhje me ndarjen e tij nga ata dhe ofendimin e hyjnive të tyre, pastaj kur e panë se xhaxhai i tij Ebu Talibi po e simpatizonte dhe nuk pranonte t'ua dorëzonte atyre, një grup njerëzish të zgjedhur shkuan tek Ebu Talibi dhe i thanë:

*“O Ebu Talib, djali i vëllait tënd po i shan zotat tanë, fenë tonë po e fyen, po i konsideron të marra pikëpamjet tona, ndërsa paraardhësit tanë po i shpall të lajthitur. Prandaj, ose ndaloje atë ose na e lër neve!”*

Ebu Talibi bisedoi me ta me edukatë, iu përgjigj me dashamirësi dhe ata u shpërndanë paqësisht.

Pejgamberi a.s. ende vazhdonte duke bërë punën e tij – e shpjegonte fenë e Allahut dhe i ftonte njerëzit në të. Çarja në mes tij dhe Kurejshëve vinte duke u rritur, saqë të dy grupet u larguan nga njëri-tjetri dhe përbuzeshin mes vete. Kurejshët filluan ta shtojnë përmendjen e Pejgamberit a.s. në mesin e tyre, madje e inkurajonin dhe e nxitnin njëri-tjetrin kundër tij.

Pastaj ata u kthyen përsëri tek Ebu Talibi dhe i thanë:

“O Ebu Talib, ti je njeri serioz, i nderuar dhe i respektuar në mesin tonë. Ne të kërkuam që ta ndalosh djalin e vëllait tënd, por ti nuk e ndalove. Ne, pasha Zotin, nuk mund të tolerojmë të na shajë paraardhësit tanë, t’i quajë të marra pikëpamjet tona dhe të na i nënçmojë zotat tanë! Ose ti ndaloje, ose ne me të dhe me ty do t’i qërojmë hesapet derisa të shkatërrohet njëra palë!”

Ebu Talibi pastaj i dërgoi lajm Pejgamberit a.s. dhe i tha:

“O djali i vëllait, më erdhën populli yt dhe më thanë këtë dhe këtë” – dhe ia tregoi tërë bisedën. “Prandaj, më shpëto mua dhe veten! Mos më ngarko me atë që nuk mund ta përballoj!”

Pejgamberi a.s. mendoi se xhaxhai i tij kishte ndryshuar mendim, se nuk do t’i ofronte më mbrojtje dhe do ta dorëzonte. Atëherë, i Dërguari a.s. i tha:

“O xhaxha, edhe nëse ma vendosin Diellin nga krahu i djathtë dhe Hënën në krahun e majtë, un nuk heq dorë nga thirrja në besimin në Allahun derisa ta forcojë Allahu ose unë të shkatërrohem në këtë rrugë!” Pastaj Pejgamberit a.s. i rrodhën lotët, u shkreh në vaj dhe u ngrit. Kur u nis, Ebu Talibi e thirri dhe i tha:

“Kthehu, o djali i vëllait!” Pejgamberi a.s. u kthye.

“Shko dhe flit çfarë të dëshirosh, o djali i vëllait! Beto hem për Zotin se për asgjë nuk të jap!”

Kur Kurejshët e kuptuan se Ebu Talibi kishte refuzuar të largohej nga Pejgamberi a.s. dhe t’ua linte atyre dhe që nuk ishte solidarizuar me ta në armiqësinë e tyre kundër tij, sërisht shkuan tek ai, por kësaj here kishin marrë me vete Ummare ibn Mugiren dhe i thanë atij:

“O Ebu Talib, ky është Ummare b. Velid, djaloshi më i fortë dhe më i bukur i Kurejshëve. Merre për vete si ndihmesë dhe si pagesë e gjakut, birësoje atë. Ja, i yti është dhe na dorëzo djalin e vëllait tënd, i cili po e kundërshton fenë tënde dhe të etërve tuaj, i cili po e prish unitetin e popullit tënd dhe po pohon se pikëpamjet e tyre janë të marra, që ne ta vrasim atë! Pra, një për një!”

Ebu Talibi tha: “Është për të ardhur keq kjo që po më ofroni! Po ma jepni djalin tuaj që unë ta ushqej, ndërsa unë t’ju jap djalin tim e ju ta vrisni? Vallahi, kjo nuk ka për të ndodhur kurrë!”

Atëherë Mut'im b. Adiu tha:

“Për Zotin, o Ebu Talib, populli yt me ty ka vepruar drejt dhe janë munduar shumë për të larguar prej teje atë që urren, por nuk shoh se dëshiron të pranosh ndonjë gjë prej tyre!”

Ebu Talibi i tha Mut'imit: “Jo, vallahi, ata nuk janë sjellë me drejtësi ndaj meje, por ti je angazhuar me tërë fuqinë tënde që të më lësh në baltë dhe ta kthesh popullin kundër meje. Por, bëj çfarë të duash!”

Marrëveshja nuk u arrit. Konflikti gjithnjë e më tepër po ndizej, njerëzit po armiqësoheshin mes vete, kurse sulmet mbi njëri-tjetrin ishin bërë më të shpesh-ta. Kurejshët kërkonin me forcë që të zbulohet çdo njeri nga fisi i tyre i cili i ishte afruar Pejgamberit a.s. dhe kishte pranuar Islamin. Çdo fis pastaj nxitonte t'i ndëshkonte të gjithë ata që ishin bërë muslimanë nga mesi i tyre dhe t'i kthente përsëri në fenë e tyre.

Allahu i Madhërishëm e mbrojti Pejgamberin a.s. prej tyre përmes xhaxhait të tij, Ebu Talibit.

Kur e pa se çfarë po bënin Kurejshët, Ebu Talibi vizitoi fiset Benu Hashim dhe Benu Muttalib dhe u kërkoi atyre që ta mbronin Pejgamberin a.s. dhe të qëndronin përkrah tij. Ata u bashkuan me të, i dhanë mbështetje atij dhe iu përgjigjën ftesës që u bëri. I vetmi përjashtim ishte Ebu Lehebi, armiku i mallkuar i Allahut.

## ÇFARË THA PËR KUR'ANIN VELID B. MUGIRE

Velid b. Mugire ishte një mekas me autoritet. Kur erdhi sezoni i haxhit, tek ai u mblodhën një grup Kurejshësh, të cilëve u tha: “O Kurejshë, ja erdhi ky sezon, shumë delegacione arabe do të vijnë tek ju. Ata me siguri kanë dëgjuar për çështjen e Muhamedit. Tani ju duhet të keni një qëndrim unik nga i cili nuk do të tërhiqeni, në mënyrë që mos ta kundërshtoni apo përgënjeshtroni njëri-tjetrin e të dilni me deklaratatë të ndryshme.”

Ata i thanë: “Atëherë, o Ebu Abdi Shems, na thuaj çfarë qëndrimi të marrim dhe çfarë të themi!”

Ai tha: “Jo, ju flisni, ndërsa unë po ju dëgjoj.”

Ata thanë: “Të themi se ai është parashikues!”

Ai tha: “Jo, vallahi, ai nuk është parashikues! Ne i kemi parë parashikuesit, ajo nuk është murmuritje e parashikuesit e as gugatje e tij.”

Ata thanë: “Atëherë, le të themi se është i çmendur!”

Ai tha: “Ai nuk është i çmendur! Ne i kemi parë dhe kemi njohur të çmendur. Ajo çfarë ka ai nuk i shkakton gulçim, dridhje apo jerm.”

Ata vazhduan: “Të themi se është poet!”

Ai tha: “Ai nuk është as poet! Ne i njohim mirë të gjitha llojet e poezisë, si rexhez<sup>45</sup>, hezexh<sup>46</sup>, karid<sup>47</sup>, siç i dimë edhe poezitë e gëzimit dhe të hidhërimit. Pra, ajo nuk është poezi.”

Thanë: “Të themi se është magjistar!” Tha: “Jo, ai nuk është magjistar! Të gjithë ne i kemi parë magjistarët dhe magjitë e tyre. Ajo nuk është frymë e as nyjë e tyre!”

Thanë: “E pra, çfarë po thua ti, o Ebu Abdi Shems?”

Tha: “Për Zotin, vërtet në fjalët e tij ka një ëmbëlsi të çuditshme! Druri i tyre është hurmë e vërtetë, ndërsa kurora është fryt i porsavjelë! Çfarëdo që thoni, ajo do të shihet se nuk është. Megjithatë, më e afërt me të do të jetë nëse thoni se është magjistar, se ai flet magji me të cilat bën ndarjen e vëllait nga vëllai, të burrit nga gruaja dhe të njeriut nga familja e tij.”

<sup>45</sup> Metri poetik arab gjashtëkëmbësh, ‘bahur-rxhez’ – ‘mustefilun’ (shën. i përkth.).

“Rexhez: Në metrikën arabe, rexhez është emërtimi i një forme të tipologjisë “bahr”. Për shkak se në këtë formë bashkohen në mënyrë të theksuar dhe ritmike përshpejtimi dhe ngadalësimi, është e përshtatshme për t’u shoqëruar me melodi instrumentale dhe të lërë gjurmë të thella në mendje e në ndjenja. Kjo formë e përshtatshme për shprehjen edhe të gëzimit, edhe të hidhërimit, thuhet se ka rreth 15 variante. Cituar nga libri: Hz. Muhammed Mustafa 1., Osman Nuri Topbash, fq. 263, fusnota 214. Përkthyesi.

<sup>46</sup> Metri poetik arab katërkëmbësh, ‘bahur-hezexh’ – ‘mefajilun’. Përkthyesi.

<sup>47</sup> ‘Karid’ quhet lloji i poezisë që nuk është ‘rexhez’. Përkthyesi.

Me këtë qëndrim u ndanë prej tij. Pastaj ata zunë pritat në të gjitha hyrjet për në Mekë dhe të gjithë njerëzit që vinin për haxh i paralajmëronin për Pejgamberin a.s. dhe secilit prej tyre i tërhiqnin vëmendjen për çështjen e tij.

Në lidhje me Velid b. Mugiren, Allahu i Madhërishtëm ka shpallur në Kur'an:

*“Ti më lë Mua dhe atë që e krijova të vetmuar. Dhe bëra këtë pasuri të madhe. E bëra edhe me djem që i ka me vete. Dhe Unë i lashë në disponim të gjitha mundësitë. E ai lakmon që t'i shtoj edhe më tepër. E jo, se ai vërtet ishte mohues i fakteve tona!”* (El-Muddeththir, 11-16)

Kështu ky grup Kurejshësh filluan të thoshin këto gjëra për Pejgamberin a.s. me çdo njeri që e takonin. Në këtë mënyrë, shumë arabë në këtë haxh për herë të parë dëgjuan për Pejgamberin a.s. dhe lajmi u përhap në të gjitha vendet arabe.

## ÇFARË PËRJETOI PEJGAMBERI a.s. NGA POPULLI I TIJ

Kurejshët po e përballonin gjithnjë e më me vështirësi situatën dhe gjithnjë e më shumë i mundonte armiqësia që ushqenin ndaj Pejgamberit a.s. dhe ndaj atyre që kishin pranuar Islamin. Njerëzit e thjeshtë ata shpesh i nxitnin kundër tij, e paraqitnin si gënjeshtar dhe ushtronin tortura të ndryshme. Ata i atribuuan atij poezinë, magjinë, profecinë dhe çmendurinë. Ndërkohë, Pejgamberi a.s. vazhdonte duke e përhapur publikisht urdhrin e Allahut, pa e fshehur prej askujt. Ai gjithashtu në mënyrë të hapur theksonte edhe mangësitë e fesë së tyre, bënte thirrje për largim nga statujat që ata adhuronin dhe distancohej nga mosbesimi i tyre.

Abdullah b. Amër b. Asi ka thënë:

“Unë isha me ta një ditë dhe te këndi i Qabesë u takuan të gjithë autoritetet e tyre. Filloi biseda në lidhje me Pejgamberin a.s. dhe ata thanë: “Nuk kemi parë ndonjëherë diçka që ngjan me këtë njeri, duke sharë pikëpamjet tona dhe duke ofenduar zotat tanë. Ne jemi duke duruar një çështje shumë të madhe!”

Derisa ata ishin duke folur kështu, u paraqit Pejgamberi a.s., i cili eci në drejtim të tyre dhe u ndal te Guri i Zi. Pastaj kaloi pranë tyre duke bërë tavaf rreth Qabesë. Pasi kaloi pranë tyre, ata e fyen me fjalë të këqija. Këtë e kuptova nga fytyra e Pejgamberit a.s.. Kur kaloi pranë tyre herën e dytë, ata përsëri bënë të njëjtin veprim, këtë e kuptova nga fytyra e Pejgamberit a.s.. Pastaj kaloi pranë tyre edhe për herë të tretë, kurse ata përsëri e fyen në mënyrë të njëjtë. Ai pastaj u ndal dhe u tha:

*“Dëgjoni o Kurejshë, për Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nëse nuk më besoni, unë do t’ju sjell shkatërrim!”*

Fjalët e tij bënë përshtypje të fortë tek të pranishmit, saqë të gjithë shtangën. Madje edhe ai që deri atëherë u shqua për fyerje, tash iu drejtua me fjalët më të mira:

“Shko, o Ebul-Kasim, se vallahi ti asnjëherë nuk ke qenë injorant!”

Dhe Pejgamberi a.s. shkoi. Mirëpo, ata përsëri të nesërmen u mblodhën te këndi i Qabesë dhe unë isha me ta. Ata i thoshin njëri-tjetrit: “Përkujtoni se çfarë ndodhi dje, madje edhe kur ju tha atë që ju e urreni, ju e lëshuat!”

Derisa ata ishin duke folur kështu, përsëri u shfaq Pejgamberi a.s.. Të gjithë kërcyen përnjëherë dhe e rrethuan duke i thënë:

“A je ti që po thua kështu, kështu?” – ia përsëritën fjalët që kishte deklaruar duke fyer zotat e tyre dhe fenë e tyre.

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Po, unë jam ai që i ka thënë këto!”*

Tha: “Atëherë e pashë njërin prej tyre duke e kapur për palën e pelerinës së tij, kurse Ebu Bekri r.a. i doli përpara dhe duke qarë i tha:

“A doni ta vrisni njeriun vetëm pse po thotë *Zoti im është Allahu?!*”

Pastaj ata u larguan prej tij. Kjo është gjëja më e keqe që kam parë nga Kurejshët duke i bërë atij.”

## HAMZAI R.A. BËHET MUSLIMAN

Më ka treguar një njeri që e kishte pranuar Islamin dhe që kishte kujtesë të mirë:

“Ebu Xhehli në Safa kishte kaluar pranë Pejgamberit a.s., ku e kishte qortuar dhe ofenduar rëndë, pastaj kishte sulmuar me energji fenë dhe sjelljet e tij. Pejgamberi a.s. nuk i kishte kthyer asnjë fjalë. Këtë e kishte dëgjuar zonja e Abdullah b. Xhudan nga shtëpia e saj. Pastaj Ebu Xhehli ishte kthyer dhe kishte shkuar te një grup Kurejshësh, të cilët ishin ulur pranë Qabesë dhe ishte ulur me ta.

Pas pak kohe, aty vjen Hamza b. Abdulmuttalibi r.a., i cili po kthehej nga gjuetia me harkun e tij. Ai kishte një hobe bakri me të cilën gjuante gurë dhe frikësonte egërsirat. Ai e kishte shprehi që kur kthehej nga gjuetia ndalej pranë grupit të Kurejshëve, i përshëndeste dhe bisedonte me ta. Ai ishte djaloshi më i respektuar dhe më i guximshëm në mesin e Kurejshëve.

Kur kaloi pranë zonjës së Abdullahut, Pejgamberi a.s. tashmë ishte kthyer në shtëpinë e tij. Ajo i tha: “O Ebu Ummare, sikur të kishe parë se çfarë ka përjetuar djali i vëllait tënd Muhamedi pak më herët nga Ebu Hakem b. Hishami<sup>48</sup>! E ka takuar këtu ulur, pastaj e ka qortuar dhe ofenduar shumë rëndë dhe e ka fyer me fjalë të ndyra, ndërsa Muhamedi nuk i tha asnjë fjalë.”

Hamza r.a. u zemërua shumë, nxitoi menjëherë pa u ndalur aspak tek askush. U përgatit për ta ndëshkuar Ebu Xhehlin sapo ta takonte. Pasi hyri në tempull, e pa të ulur në mesin e njerëzve. Menjëherë u drejtua drejt tij dhe kur u afrua, e nxori harkun dhe e goditi në kokë duke i shkaktuar plagë të madhe, pastaj i bërtiti: “Si po e fyen atë kur edhe unë jam në fenë e tij? M’u kthe mua nëse guxon!”

Njerëzit nga fisi Benu Mahzum u ngritën kundër Hamzait për të ndihmuar Ebu Xhehlin, por Ebu Xhehli u tha atyre:

“Lëreni Ebu Ummaren, se vallahi unë e kam fyer rëndë djalin e vëllait të tij!

Hamzai r.a. kështu pranoi Islamin dhe pasoi Pejgamberin a.s.. Pasi e përqafoi Islamin, Kurejshët e kuptuan se Pejgamberi a.s. kishte fituar një ndihmë dhe mbrojtje të madhe sepse e dinin se Hamzai gjithmonë do të qëndronte në mbrojtje të tij. Prandaj, kjo i ndali nga shumë veprime që bënin më parë kundër tij.

<sup>48</sup>Ebu Hakem ishte një pseudonim tjetër për Ebu Xhehlin. Emri i tij i vërtetë ka qenë Amër b. Hisham b. Mugire b. Abdullah b. Mahzum.

## ÇFARË I THA UTBE B. REBIA PEJGAMBERIT a.s.

Transmetohet se Utbe b. Rebia, i cili ishte një njeri i shumë i respektuar, në një rast ishte duke qëndruar në mesin e Kurejshëve, ndërsa Pejgamberi a.s. ndodhej i vetëm në tempull. Ai kishte thënë:

“O Kurejshë, a të shkoj te Muhamedi dhe të flas me të, t’i bëj disa propozime, ndoshta e pranon ndonjërin? Çfarëdo që të pranojë, t’ia japim, vetëm të na hiqet qafe!”

Kjo ndodhi pasi Hamzai kishte përqaftuar Islamin dhe kur numri i muslimanëve po shtohej. Ata i thanë:

“Po, sigurisht o Ebu Velid! Shko tek ai dhe foli atij!”

Utbe menjëherë u ngrit, shkoi dhe u ul pranë Pejgamberit a.s. dhe i tha:

“O djali i vëllait tim, siç e di, ti je një anëtar shumë i respektuar i fisit tonë dhe sipas origjinës që ke gëzon një vend të rëndësishëm në mesin tonë. Mirëpo, ti i ke prurë popullit tënd një gjë shumë të rrezikshme; e ke prishur unitetin e tyre, i ke nënçmuar botëkuptimet e tyre, dhe po i fyen zakonet e të parëve të tyre! Prandaj më dëgjo mua! Unë po t’i ofroj disa propozime, ti mendo mirë rreth tyre dhe shpresoj se të paktën do ta pranosh ndonjërin!”

Pejgamberi a.s. i tha: *“Thuaj, o Ebu Velid, unë po të dëgjoj!”*

Ai i tha: “O djali i vëllait, në qoftë se me këtë që po i ofron popullit dëshiron të fitosh pasuri, ne do të mbledhim nga pasuria jonë në mënyrë që të bëhesh më i pasuri midis nesh. Por në qoftë se dëshiron pozitë, do të të emërojmë lider tonin dhe asgjë nuk do të bëjmë pa ty! Në qoftë se dëshiron pushtet, ne do të të shpallim mbretin tonë! Ndërsa, në qoftë se ajo që po të vjen është djall, të cilin ti e sheh, por nuk je në gjendje ta largosh nga vetja, ne do të kërkojmë mjekim dhe do të investojmë pasurinë tonë derisa të të shërojmë prej tij. Ai ndoshta është xhin-shoqëruer, i cili e ka mundur njeriun dhe të trashet në llogari të tij!”

Gjatë gjithë kohës sa fliste Utbe, Pejgamberi a.s. e dëgjoji dhe pastaj i tha: *“A e mbarove, o Ebu Velid?”* Ai tha: “Po.”

Pejgamberi a.s. i tha: *“Tani më dëgjo mua!”*

Tha: “Po, do të dëgjoj.”

Pejgamberi a.s. filloi të lexonte: *“Me emrin e Allahut, Mëshirëbërësit, Mëshiruesit! Ha, Mim. Zbritje prej Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Libër që ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kur’an arabisht për një popull që di ta kuptojë. Është përgëzues dhe qortues, po shumica e tyre ia kthyen shpinën, andaj ata nuk dëgjojnë. Ata thanë: “Zemrat tona janë të mbyllura nga ajo që ti na thërret ...”* (Fussilet, 1-5)

Pejgamberi a.s. vazhdoi më tutje leximin e kësaj sureje, ndërsa Utbe e dëgjonte. Ai ia vendosi duart pas shpinës dhe i mbështetur tek ai e dëgjonte. Kur arriti tek ajeti i sexhdes<sup>49</sup>, bëri sexhden, pastaj tha: *“Tashmë dëgjove, o Ebu Velid, këtë që dëgjove! Bëj çfarë dëshiron!”*

Utbe pastaj u kthye te shokët e tij, ndërsa ata në mes vete komentnin: *“Beto-hemi në Zotin se Ebu Velidi po kthehet me çehre tjetër nga ajo me të cilën shkoi!”*

Kur u ul midis tyre, ata i thanë: *“Çfarë ka o Ebu Velid?”*

Tha: *“Unë kam dëgjuar fjalë të atilla që nuk i kam dëgjuar kurrë më parë! Vallahi, ato nuk janë poezi, as magji, as fall. O Kurejshë, më dëgjoni dhe më bëni një nder, mësoni atë njeri me gjithë atë që ka dhe largohuni! Vallahi, këto fjalë që dëgjova prej tij do të depërtojnë larg! Nëse arabët e tjerë e pengojnë në përhapjen e fesë re, edhe ju shpëtoni prej tij pa u përzier fare, por në qoftë se ai ngadhënjën mbi arabët, atëherë pushteti i tij është edhe pushtet i juaji, fama e tij është edhe famë e juaja dhe kështu ju do të jeni njerëzit më të lumtur!”*

Ata i thanë: *“Vallahi, të paska bërë magji me gjuhën e tij, o Ebu Velid!”*

Ai tha: *“Ky ishte mendimi im, ndërsa ju veproni si të doni!”*

<sup>49</sup> Ky është ajeti i 37 i kësaj sureje (Fussilet).

## ÇFARË NDODHI MES PEJGAMBERIT a.s. DHE LIDERËVE KUREJSHË

Islami kishte filluar të përhapej gjithandej Mekës ndër fiset Kurejshe, si ndër burra ashtu edhe ndër gra. Kurejshët arrestonin ata muslimanë që kishin mundësi si dhe zmbrahnin nga Islami atë që kishin mundësi për ta zmbrahnur.

Pastaj u mblohdën liderët e çdo fisi të Kurejshëve: Utbe b. Rebia, Shejbe b. Rebia, Ebu Sufjan b. Harb, Nadr b. Harith, Ebu Bahtari b. Hisham, Esved b. Mutalib, Zemea b. Esved, Velid b. Mugire, Ebu Xhehl b. Hisham, Abdullah b. Ebi Umejje, As b. Vail, Nubejh dhe Munebbeh. Ata vendosën ta thërrasin Muhamedin a.s. që të bisedojnë dhe ta kërcënojnë.

Dërguan për ta thirrur dhe i thanë: “Njerëzit më të nderuar të popullit tënd janë tubuar, po të ftojnë për bisedë, ndaj eja!”

Pejgamberi a.s. iu përgjigj menjëherë thirrjes së tyre. Ai mendoi se ata më në fund do ta pranonin atë në të cilën ai po i thërret. Ai ishte i kujdesshëm për ta, e dëshironte udhëzimin e tyre dhe me vështirësi i përballonte fyerjet e tyre. Kur u ul afër tyre, ata i thanë:

“O Muhamed, ne të kemi ftuar për të biseduar. Vallahi, ne nuk dimë që ndonjë burrë arab e ka sulmuar popullin e vet siç ke bërë ti me popullin tënd! Ti ke ofenduar të parët tanë, ke nënçmuar fenë tonë, ke sharë zotat tanë, ke nënçmuar botëkuptimet tona, ke futur përçarje në bashkësi. Me një fjalë, nuk ka mbetur asgjë e keqe që ti nuk e ke futur në marrëdhëniet tona. Prandaj na thuaj, në qoftë se ti me këtë që po bën dëshiron pasuri, ne do të mbledhim nga pasuritë tona dhe do të të bëjmë njeriun më të pasur mes nesh! Por në qoftë se ti dëshiron pozitë, ne do të të caktojmë për lider tonin. Ndërkaq, në qoftë se ti do pushtet, ne do të të shpallim për mbret tonin! Por, në qoftë se ai që po të vjen ty është djall, të cilin ti po e sheh dhe të ka mposhtur, ne do të paguajmë nga pasuria jonë në kërkim të mjekimit derisa të të shërojmë prej tij apo ta frenojmë atë prej teje.”

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Unë nuk po kërkoj asgjë nga ato që po thoni! Me atë që po ju sjell juve unë nuk po kërkoj pasurinë tuaj, as pozitë midis jush, as pushtet mbi ju. Por, mua Allahu tek ju më ka dërguar Pejgamber, më ka zbritur Libër dhe më ka urdhëruar që t’ju përcjell përgëzime dhe paralajmërimë. Unë po ju përcjell juve shpalljen e Zotit tim dhe po ju këshilloj. Nëse e pranoni atë që po ju sjell, do të jetë lumturia juaj në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërsa nëse më refuzoni, unë do të duroj dhe vazhdoj sipas urdhrut të Allahut, derisa Ai të gjykojë mes nesh!”*

Ata i thanë: “O Muhamed, nëse nuk pranon asnjë nga propozimet tona, ti e di mirë se nuk ka vend më të ngushtë se ky i yni, as me më pak ujë, dhe askush

nuk jeton më vështirë se ne. Atëherë lute Zotin tënd, i Cili të ka dërguar me atë që të ka dërguar, le të na lirojë nga këto kodra që na kanë ngushtuar, le të na e zgjerojë vendin tonë dhe nëpër të le të shpërthejnë lumenj si ata të Shamit dhe Irakut. Pastaj le të na ringjallë disa nga paraardhësit tanë, në mesin e tyre le të jetë Kusajj b. Kilabi, sepse ai ka qenë mbështetësi më i madh i së vërtetës, kështu që t'i pyesim ata për këtë që po flet ti - a është e vërtetë apo gënjeshtër? Nëse ata e konfirmojnë dhe nëse ti e bën këtë që po të kërkojmë, ne do të të besojmë dhe do ta dimë vendin tënd tek Allahu, se vërtet Ai të ka dërguar Pejgamber siç po thua!"

Pejgamberi a.s. u tha atyre: *"Unë nuk jam dërguar tek ju për këtë, por tek ju kam ardhur me atë që më ka dërguar Allahu, unë tashmë ju kam përcjellë atë me çka jam dërguar. Nëse e pranoni nga unë atë që po ju sjell, do të jetë lumturia juaj në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërsa nëse më refuzoni, unë do të duroj dhe vazhdoj sipas urdhrit të Allahut, derisa Ai të gjykojë mes nesh!"*

Ata i thanë: "Nëse nuk e bën dot këtë për ne, atëherë kërko nga Zoti yt që të dërgojë me ty një engjëll që ta konfirmojë këtë që po thua dhe që do të na kthejë nga ti! Gjithashtu, kërko që të të japë kopshte e kështjella dhe thesare me ar dhe argjend! Le t'i përmbushë nevojat e tua, për të cilat po shohim se edhe ti ke nevojë sepse edhe ti sikurse ne po shkon në treg, edhe ti sikurse ne ke nevoja jetësore, derisa ta shohim vlerën dhe pozitën tënde te Zoti yt, nëse je i Dërguar siç po pretendon."

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *"Unë nuk e bëj këtë. Unë nuk kërkoj nga Zoti im gjëra të tilla, as nuk jam dërguar te ju për këtë. Allahu më ka dërguar për të sjellë përgëzime dhe paralajmërime. Nëse e pranoni atë që po ju sjell, do të jetë lumturia juaj në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërsa nëse më refuzoni, unë do të duroj dhe vazhdoj sipas urdhrit të Allahut, derisa Ai të gjykojë mes nesh!"*

Ata i thanë: "Atëherë rrëzoje qiellin mbi ne copa-copa, le të shembet, meqë po pretendon se Zoti yt, nëse do, mund ta bëjë këtë! Ne nuk do të të besojmë derisa nuk e bën këtë!"

Pejgamberi a.s. tha: *"Kjo i takon Allahut, nëse dëshiron ta bëjë për ju, e bën!"*

Ata i thanë: "O Muhamed! A nuk e ka ditur Zoti yt se ne do të ulemi me ty dhe do të të pyesim për këto që të pyetëm dhe do të të kërkojmë çfarë të kërkuam!? Pra, a nuk ka mundur të të mësojë ty se si të shpëtosh nga ne dhe, a nuk ka mundur të të thotë ty se çfarë do të bëjë me ne, nëse ne nuk e pranojmë atë që ke sjellë ti?! Ne kemi dëgjuar se ty po të mëson një njeri nga Jemame, që quhet Rrahman<sup>50</sup>, dhe vallahi ne atij kurrë nuk do t'i besojmë. Ne, o Muhamed, mjaft të kemi duruar, prandaj nuk do të të lejojmë që të veprosh në mesin tonë, derisa të shkatërrohemi ne ose ti!"

<sup>50</sup> Ai është Musejleme b. Hubejb Hanefiu, i njohur si Musejlemetul-Kedhdhabi, i cili në periudhën e xhahilijetit ishte quajtur Rrahman.

Njëri prej tyre shtoi: “Ne adhurojmë engjëjt, ato janë vajzat e Allahut!”

Një tjetër madje tha: “Ne nuk do të të besojmë ty derisa të na sjellësh Allahun dhe engjëjt këtu përballë nesh!”

Kur ata ia thanë këtë Pejgamberit a.s., ai u ngrit. Me të u ngrit edhe Abdullah b. Ebi Umejje b. Mugire, që ishte djalë i hallës së tij<sup>51</sup>, i cili i tha:

“O Muhamed, populli yt të bëri shumë propozime dhe ti nuk pranove asgjë. Pastaj ata kërkuan disa gjëra për të parë se çfarë pozite gëzon tek Allahu – siç po thua ti – në mënyrë që pastaj të të besojnë dhe të të pasojnë, por ti nuk e bërë dot. Pastaj ata kërkuan që të kërkosh për veten tënde diçka me çka do ta tregosh vlerën tënde dhe pozitën më të lartë se ata tek Allahu, por përsëri nuk e bërë. Vallahi, unë nuk do të të besoj ty derisa të vendosësh shkallë deri në qiell, pastaj të ngjitesh deri në qiell dhe prej atje të kthehesh me katër engjëj të cilët do të dëshmojnë se me të vërtetë je ashtu si po pohon! Vallahi, edhe nëse e bën këtë, përsëri nuk mendoj se do të të besoj ty!”

Pastaj u nda nga Pejgamberi a.s. dhe u largua. Edhe Pejgamberi a.s. shkoi te familja e tij i pikëlluar, i pezmatuar, për shkak se nuk e realizoi atë që shpresonte të bënte kur e thirrën dhe se pa që mes tij dhe atyre ishte një boshllëk i madh.

<sup>51</sup> Abdullahu e pranoi Islamit para çlirimit të Mekës.

## VEPRIMI I EBU XHEHLIT

Kur Pejgamberi a.s. u largua prej tyre, Ebu Xhehli tha:

“O Kurejshë! Ja, Muhamedi i refuzoi të gjitha, por prapë vazhdon ta ofendojë fenë tonë, t’i shajë paraardhësit tanë, t’i nënçmojë botëkuptimet tona dhe t’i shajë zotat tanë. Prandaj, unë zotohem në Allahun, se nesër do ta pres me gurin më të madh që mund të mbaj dhe kur ai të bjerë në sexhde në namazin, do t’ia thyej kokën! Pas kësaj ose më dorëzoni ose më mbroni, kurse Benu Abdi Menafët le të bëjnë çfarë të duan!”

Ata i thanë: “Vallahi, ne kurrë nuk do të të dorëzojmë! Vepro çfarë ke ndër mend!”

Të nesërmen, Ebu Xhehli mori një gur siç e përshkroi dhe u ul për ta pritur Pejgamberin a.s.. Pejgamberi a.s. si zakonisht, erdhi herët. Edhe pse ishte në Mekë, ai në lutje kthehej nga Shami, kështu që kur falej, falej midis dy këndeve-këndi i Jemenit dhe këndi i Gurit të Zi, kështu që Qabeja ndodhej mes tij dhe Shamit. Ai filloi të falet, ndërsa Kurejshët ishin ulur në vendet e tyre dhe po pritnin se çfarë do të bënte Ebu Xhehli. Kur Pejgamberi a.s. ra në sexhde, Ebu Xhehli e mori gurin dhe u nis në drejtim të tij. Mirëpo, kur u afrua afër tij, u tërhoq me shpejtësi i tëri i zverdhur nga frika. Duart nuk ia mbanin dot gurin, ndaj e hodhi.

Në atë moment Kurejshët e rrethuan dhe e pyetën: “Çfarë të ndodhi, o Ebu Hakem?”

Ai tha: “U nisa drejt tij për të bërë atë që ju thashë dje dhe kur iu afrova atij, më doli përpara një deve mashkull, shumë e madhe! Vallahi, asnjëherë më parë nuk kam parë deve me një kokë të tillë, me qafë të tillë dhe me dhëmbë të tillë! Deshi të më gëlltiste!”

## FJALA E NADR B. HARITHIT

Kur Ebu Xhehli u tregoi çfarë pa, u ngrit Nadr b. Harithi dhe tha:

“O Kurejshë! Vallahi, ju ka ndodhur diçka që ende nuk po ia gjeni zgjidhjen. Muhamedi ka qenë djalosh shembullor, njeri i dashur, i sinqertë dhe jashtëzakonisht i besueshëm. Tani, kur u thinj dhe erdhi me atë që erdhi, ju i thatë magjistar.

Jo, vallahi, ai nuk është magjistar! Ne kemi parë shumë magjistarë, i kemi parë magjitë dhe nyjat e tyre. Ju i thatë fallxhor.

Jo, vallahi, ai nuk është fallxhor! Ne i kemi parë fallxhorët si dhe dridhjet e gugatjet e tyre. Pastaj i thatë poet.

Jo, vallahi, ai nuk është poet! Ne e njohim shumë mirë poezinë dhe i kemi dëgjuar të gjitha llojet e saj, si hezexh, rexhez. Gjithashtu i thatë i çmendur.

Jo, vallahi, ai nuk është i çmendur! Ne e dimë ç’është çmenduria. Ai nuk ka as tërbim, as vesvese e as jermi.

O Kurejshë, mendoni mirë për veten tuaj, sepse vallahi ju ka goditur një punë e madhe!”

Nadr b. Harithi ishte një zemërak i madh dhe ndër ata që e shqetësonin Pejgamberin a.s. dhe i shfaqnin armiqësi. Ai kishte shkuar në Hire dhe atje kishte mësuar shumë legjenda për mbretërit persianë dhe për Rustemin dhe Isfendijarin. Kur Pejgamberi a.s. ulej në mesin e njerëzve, për t’i paralajmëruar në lidhje me Allahun dhe me dënimin e Allahut që kishte goditur popujt e mëparshëm, pasi ai largohej, ky ulej në vendin e tij dhe u thoshte:

“O Kurejshë, vallahi unë ju flas më bukur se ai! Afrohuni tek unë, do t’ju tregoj histori të bukura!” Pastaj u tregonte legjenda për mbretërit persianë, për Rustemin dhe Isfendijarin. Në fund thoshte: “Me çka është Muhamedi në të folur më i mirë se unë?!”

Ibni Abbasi r.a. thoshte:

“Në lidhje me të janë shpallur tetë ajete të Kur’anit. Ato janë këto fjalë të Allahut të Madhërishëm: “Kur atij i lexohen ajetet Tona, ai thotë: “Legjenda të të parëve!” Dhe të gjitha ajetet në të cilat përmenden legjendat.

## ARMIQËSIA E IDHUJTARËVE NDAJ MUSLIMANËVE TË PAMBROJTUR

Kurejshët pastaj filluan të sulmonin të gjithë ata që përqaфонin Islamin dhe e pasonin Pejgamberin a.s.. Çdo fis sulmonte të konvertuarit e vet në muslimanë. Ata i arrestonin, i torturonin me rrahje, me uri dhe etje, sidomos gjatë zhegut të ditës kur në Mekë nxehtësia ishte e padurueshme. Ata që arrinin t'i thyenin, i kthenin në fenë e tyre. Midis të torturuarve pati të atillë që nuk mundën t'i përballonin torturat, ndaj hoqën dorë nga feja e re, por pati edhe të atillë që ishin të palëkundur dhe Allahu i mbrojti.

Bilali ishte nën mbikëqyrjen e Ebu Bekrit r.a. dhe rob i çliruar i tij. Bilal b. Rebbahu pra ishte njëri nga ata që u edukuan nga anëtarët e fisit Benu Xhumeh. Nëna e tij quhej Hamame. Ishte musliman i sinqertë dhe me zemër të pastër. Umejje b. Halef b. Vehb b. Hudhafe b. Xhumeh, gjatë kohës së zhegut të mesditës, e nxirrte jashtë në rrafshinën e Mekës, e shtrinte në shpinë, pastaj urdhëronte t'i vihej një gur i madh në gjoks e pastaj thoshte:

“Vallahi, kështu do të qëndrosh derisa të vdesësh ose të heqësh dorë nga Muhamedi dhe të adhurosh Latin dhe Uzzan!”

Bilali edhe në atë gjendje torture thoshte: *“Ai është Një ... është Një!* (Ehadun, Ehad..)”

Njëherë, derisa ai ishte duke u torturuar dhe shqiptonte fjalët: *“Ai është Një ... është Një!”*, aty kaloi Vereka b. Nufel dhe tha:

“Vallahi, o Bilal, Ai është Një!” Pastaj u kthye nga Umejje b. Halef dhe torturuesi tjetër nga Benu Xhumehu dhe u tha:

“Ju betohem në Allahun, nëse e vrisni në këtë gjendje, unë do ta konsideroj dëshmor në emër të Zotit!”

Një ditë derisa ata po vazhdonin ashtu, pranë tyre kaloi Ebu Bekër Siddiku r.a. dhe i tha Umejje b. Halefit:

“A nuk ke frikë nga Allahu për këtë të gjorë, deri kur kështu?”

Umejje tha: “Ti je ai që e ke mashtruar, ndaj ti shpëtoje nga kjo gjendje!”

Ebu Bekri r.a. i tha: “Do ta bëj! Unë kam një djalosh të zi që është më i qëndrueshëm dhe më i fortë se ky, i cili është në fenë tënde. Do të ta jap në vend të tij!”

Umejje tha: “Po, pranoj, ja pra, merre!”

Ebu Bekri r.a. ia dha djaloshin e tij, e mori Bilalin dhe pastaj e liroi nga robëria.

Ai liroi edhe gjashtë robër të tjerë që ishin konvertuar në Islam, para se të shpërngulej në Medinë, Bilali ishte i shtati. Ata janë: Amir b. Fuhejre, Ummu

Ubejs, Zinnira, e cila menjëherë pasi fitoi lirinë, kishte humbur shikimin e saj, saqë Kurejshët thanë:

“Askush tjetër nuk ia ka marrë shikimin përveç Latit dhe Uzzas!”

Ajo tha: “Po gënjejnë pasha Qabenë! Lati dhe Uzza nuk mund të sjellin as dëm e as dobi!” Pas një kohe Allahu ia ktheu përsëri shikimin.

Ai liroi Nehdijen dhe vajzën e saj, të cilat ishin robëresha të një gruaje nga fisi Benu Abduddar. Në fakt, pronarja e tyre i kishte dërguar për miell dhe duke kaluar aty Ebu Bekri r.a. e kishte dëgjuar duke u thënë atyre:

“Vallahi, unë kurrë nuk do t’ju jap lirinë!”

Ebu Bekri r.a. i thotë: “Tërhiqe betimin!”

Ajo tha: “Ta tërheq kur ti i ke mashtruar? Liroji pra!”

Ebu Bekri r.a. tha: “Sa po kërkon për të dyja?”

Ajo tha: “Kaq dhe kaq!”

Ebu Bekri r.a. tha: “Në rregull, po i marr ato! Tani jeni të lira, kthejani asaj miellin e saj!”

Ato të dyja thanë: “A ta bluajmë së pari e pastaj t’ia kthejmë?”

Tha: “Si të doni!”

Një herë tjetër, duke kaluar pranë një robëreshe të fisit Benu Mu'emmeh, e cila gjithashtu ishte muslimane, pa se po e torturonte Omer b. Hattabi që ta braktiste Islamin sepse ai ende ishte idhujtar. Ai e kishte rrahur, pastaj kur ishte lodhur i kishte thënë:

“Unë po ndalem vetëm për shkak të lodhjes!”

Ndërsa ajo i ishte përgjigjur: “Kështu veproftë edhe Allahu me ty!” Pastaj atë e bleu Ebu Bekri dhe i dhuroi lirinë.

Ebu Kuhafe i kishte thënë Ebu Bekrit r.a.: “O biri im, po të shoh se ti po liron vetëm robërit e dobët. Pasi tashmë po e bën këtë, sikur të kishe liruar burra të fortë, të cilët pastaj mund të të ndihmojnë dhe mbrojnë ty!”

Ebu Bekri i tha: “O baba, unë këtë që po bëj, e bëj vetëm për hir të Allahut të Madhërishëm!”

Anëtarët e fisit Benu Mahzum, gjatë zhegut të mesditës, Ammar b. Jasirin dhe dy prindërit e tij muslimanë i nxirrnin dhe i torturonin me rërën e nxehtë mekase.

Pranë tyre kishte kaluar Pejgamberi a.s. dhe u kishte thënë: “*Duroni oj familja e Jasirit! Ju është premtuar xheneti!*” Nënë e tij e kishin vrarë dhe ajo deri në frymën e fundit nuk kishte pranuar tjetër fe përveç Islamit.

Ebu Xhehli i pacipë, i cili i inkurajonte fuqimisht Kurejshët, sa herë që dëgjonte se kishte pranuar Islamin ndonjëri prej atyre që gëzonin prestigj dhe kishin fuqi, shkonte e shante dhe e qortonte duke i thënë:

“Ti ke braktisur fenë e babait tënd, i cili ka qenë më i mirë se ti, por ne do ta tregojmë marrëzinë tënde, do ta dëshmojmë palogjikshmërinë tënde dhe do të të lëmë pa nder!”

Nëse ndonjëri ishte tregtar, ai i thoshte: “Do t’i dëbojmë blerësit dhe do ta shkatërrojmë pasurinë!” E nëse ishte i varfër, e rrihte dhe e provokonte.

Nga Seid b. Xhubejr transmetohet të ketë thënë:

“E kam pyetur Abdullah b. Abbasin: Shokët e Pejgamberit a.s. a torturoheshin deri në atë masë saqë të kishin justifikim për ta lënë fenë e tyre?!”

Tha: “Po, vallahi! Ata i kanë rrahur, i kanë lënë të uritur dhe të etur në mënyrë aq të ashpër saqë ata pastaj nuk ishin në gjendje të ngriheshin për t’u ulur. Këtë e kanë bërë për aq kohë derisa kur ndonjëri prej tyre ka pranuar atë që kanë kërkuar prej tij. Ka ndodhur që dikujt i është thënë:

“A janë Lati dhe Uzzaja zotat e tu përpos Allahut?” Dhe ai thoshte: “Po!” Ka pasur raste kur pranë tyre ka kaluar zhuzhinga dhe ata i thoshin: “A është ky zoti yt përpos Allahut?” Dhe ai përgjigjej: “Po!” Duke sakrifikuar gjithçka vetëm që t’i pakësoheshin vuajtjet!”

## MIGRIMI I PARË NË ABISINI

Pejgamberi a.s. kur e pa se çfarë torturash po përjetonin pasuesit e tij, ndërsa ai ishte i kursyer prej tyre falë pozitës që kishte tek Allahu, por edhe mbrojtjes nga xhaxhai i tij Ebu Talibi, dhe duke parë se nuk mund t'i mbronte nga torturat, u tha atyre:

*“Çfarë po mendoni, sikur të shkoni në Abisini? Sepse atje është një sundimtar që nuk i bën padrejtësi popullit. Ai është vend i drejtësisë dhe ndershmërisë. Qëndroni atje gjersa Allahu i Lartë t’ju falë një rrugë shpëtimi nga vështirësitë ku ndodhëni!”*

Menjëherë pas kësaj pasuesit e tij muslimanë u nisën për në Abisini duke u frikësuar nga sprovat dhe për t’u kujdesur për fenë e tyre. Ky ishte migrimi, hixhreti i parë në Islam.

Të parët që shkuan në Abisini ishin: Osman b. Affan, e shoqja Rukije, bija e Pejgamberit a.s., Ebu Hudhjeje b. Utbe, e shoqja e tij Sehle bint Suhejl, Zubejr b. Avvam, Mus’ab b. Umejr, Abdurrahman b. Avf, Ebu Seleme b. Abdul-Eded, e shoqja e tij Ummu Seleme bint Ebi Umejje, Osman b. Medh’un, Amir b. Rebia, shoqja e tij Lejla bint Ebi Hathme, Ebu Sebre b. Ebi Ruhm dhe Suhejl b. Bejda'. Këta qenë dhjetë muslimanët e parë që shkuan në Abisini.

Pastaj atje shkoi edhe Xhafer b. Ebi Talibi r.a., ndërsa pas tij edhe muslimanët e tjerë dhe të gjithë u bashkuan në Abisini. Disa shkuan me familjet e tyre, ndërsa disa të vetëm pa familje.

Numri i gjithëmbarsëm i burrave që shkuan në Abisini, pa llogaritur fëmijët e vegjël si dhe ata që kanë lindur atje ishte 83 burra.

## KUREJSHËT DËRGOJNË NË ABISINI NJË DELEGACION PËR TË KËRKUAR EKSTRADIMIN E EMIGRANTËVE

Kur Kurejshët mësuan se sahabët e Pejgamberit a.s. ishin sigurt dhe të qetë në tokën e Abisinisë, ku kishin fituar strehim, u mblodhën dhe morën vendim për të dërguar dy burra të pushtetshëm nga Kurejshët për t'i kërkuar Nexhashiut t'i ekstradonte emigrantët, në mënyrë që t'i kthejnë nga feja e tyre dhe t'i largojnë nga vendi i sigurt ku ishin siguruar dhe strehuar. Për ta bërë këtë zgjodhën Abdullah b. Ebi Rabian dhe Amër b. As b. Vailin. Ata mblodhën shumë dhurata për Nexhashiun dhe për patriarkët e tij.

Ummu Seleme bint Ebi Umejje b. Mugire, gruaja e Pejgamberit a.s., transmetohet se ka thënë:

“Kur arrita në tokën e Abisinisë, na priti një nikoqir i mrekullueshëm, Nexhashiu. Aty u siguruam për fenë tonë, e adhuronim Allahun, askush nuk na shqetësonte as nuk dëgjonim diçka të shëmtuar. Kur ky lajm arriti te Kurejshët, u mblodhën dhe vendosën që të dërgojnë te Nexhashiu dy nga njerëzit e fuqishëm prej tyre që t'i dhurojnë Nexhashiut dhurata të përbëra nga dekoratat më të shtrenjta të Mekës dhe punimet më të bukura të lëkurës. Ata kishin tubuar një sasi të madhe lëkurësh dhe për çdo patriark individualisht kishin paraparë dhuratë të veçantë. Pastaj ato i dërguan përmes Abdullah b. Ebi Rabias dhe Amër b. Asit dhe u dhanë atyre udhëzime të sakta.

Atyre të dyve u thanë:

“Jepini çdo patriarku dhuratën e tij para se të filloni të bisedoni me Nexhashiun në lidhje me ta. Pastaj dorëzoni Nexhashiut dhuratat e tij dhe kërkoni që t'ua dorëzojë ata para se të flasë me ta!”

Kështu ata arritën te Nexhashiu, ndërsa ne ishim tek ai në një shtëpi të bukur, te një fqinj i mrekullueshëm. Ata së pari i dorëzuan çdo patriarku dhuratën e tij para se të bisedonin me Nexhashiun. Secilit prej tyre ata bashkë me dhuratën i thoshin:

“Në vendin e mbretit tuaj janë strehuar një grup djelmoshash budallenj, ata braktisën fenë e etërve të tyre, por as fenë tuaj nuk e morën. Ata kanë shpikur një fe të re, të cilën nuk e njohim as ne as ju. Ne te mbreti na kanë dërguar njerëzit më autoritativë të popullit të tyre me lutje që t'i kthejë tek ata. Kur të flasim ne me mbretin rreth tyre, ju lutemi, sugjerojini mbretit që të na i dorëzojë dhe kurrësi të mos flasë me ta sepse fisi i tyre i njeh ata më mirë se kushdo tjetër dhe ua kuptojnë gabimet më mirë se të tjerët!”

Ata u thanë: "Po!"

Pastaj, ata të dy ua dorëzuan atyre edhe dhuratat për Nexhashiun, të cilat i pranuan. Më pas iu drejtuan mbretit:

"O mbret! Një sërë të rinjsh të papjekur nga tanët janë strehuar në vendin tënd. Ata braktisën fenë e etërve të tyre, por as fenë tënde nuk e morën. Ata kanë shpikur një fe të re. Farefisi i tyre na dërguan ne që t'i ktheni pas ata sepse fisi i tyre i njeh ata më mirë se kushdo tjetër dhe ua kuptojnë gabimet më mirë se të tjerët!"

Ajo (Ummu Seleme) tha: "Abdullah b. Rebia dhe Amër b. Asi druheshin se mos Nexhashiu i pyet dhe i dëgjon thëniet e Xhaferit dhe shokëve të tij dhe mbetet nën ndikimin e tyre. Prandaj i kërkuan Nexhashiut t'ua dorëzonte emigrantët pa i pyetur e pa i gjykuar.

Edhe priftërinjtë e Nexhashiut përreth tij i thoshin: "Imzot, këta njerëz flasin drejt. Fisi i tyre i njeh ata më mirë. Dorëzuoja ata këtyre që t'i çojnë në vendin e vet!"

Nexhashiu u nxeh dhe tha:

"Jo, vallahi, nuk ua dorëzoj atyre të dyve! Ata sapo kanë arritur tek unë, kanë ardhur në vendin tim, më kanë zgjedhur pikërisht mua, nuk i dorëzoj derisa t'i pyes për atë që po deklarojnë këta të dy në lidhje me ta. Nëse çështja është siç po thonë, do t'ua dorëzoj këtyre të dyve dhe do t'i kthej te populli i tyre. Mirëpo, nëse çështja nuk është ashtu, unë do t'i mbroj prej këtyre të dyve, do t'i mirëpres dhe do t'u ofroj gjithçka që ju nevojitet!"

Ajo tha: "Pastaj u çoi fjalë sahabëve të Pejgamberit a.s. të shkonin tek ai në pallat.

Para se të shkonin, ata u mblodhën dhe diskutuan me njëri-tjetrin: "Çfarë do t'i themi kur të shkojmë para tij?"

Thanë: "Vallahi, do t'i themi çfarë kemi mësuar! Atë çfarë na ka urdhëruar Pejgamberi a.s., pastaj le të bëhet çfarë të bëhet!"

Kur erdhën aty, ai i kishte ftuar edhe priftërinjtë e vet që u ulën përreth Nexhashiut me librat e hapur në prehër.

Nexhashiu iu drejtua emigrantëve duke u thënë:

"Ç'fe është kjo që keni pranuar ju, për shkak të së cilës e keni braktisur popullin tuaj, ndërsa nuk keni pranuar fenë time apo ndonjë fe të ndonjë populli tjetër?!"

Fjalën e mori Xhafer b. Ebi Talibi. Ai tha:

"O mbret! Ne ishim një fis injorant. Adhuronim idhujt e bërë prej guri dhe druri duke i quajtur zota. Hanim mishin e kafshëve të ngordhura, kryenim pandershmëri. Nuk i njihnim detyrat ndaj të afërmeve dhe të drejtat e komshiut. Të fuqishmit shtypnin të dobëtit, të pasurit fitonin në kurriz të të varfërve. Nuk e njihnim se ç'është e drejta mes nesh. Ne ishim në këtë gjendje derisa Allahu dërgoi të Dërguarin e Tij nga radhët tona. Ai është një njeri fisnik, i pastër nga soji e nga fisi. Ai na ftoi të besonim në Allah dhe na mësoi si të bënim adhurim. Na shpëtoi prej idhujve të gjyshërve tanë.

*Na urdhëroi të drejtën, mbajtjen e fjalës, sjelljen e mirë ndaj fisit dhe komshiut, mbrojtjen e nderit të femrës dhe jetës së vajzave. Na largoi prej të gjitha imoraliteteve. Ai na i ndaloi gjakderdhjen, gënjeshtërinë, grabitjen e pasurisë së jetimëve dhe shpifjen ndaj grave të ndershme.*

*Ai na ka urdhëruar që të adhurojmë vetëm Allahun dhe asgjë mos t'i shoqërojmë, na ka urdhëruar faljen e namazit, dhënien e zekatit dhe agjërimin."*

Ajo tha: "Ai ia numëroi edhe dispozitat e tjera islame, ndërsa ne të gjitha këto i konfirmonim dhe i besonim."

*"Të gjitha ato që na ka thënë se i kanë ardhur nga Allahu, ne i kemi besuar dhe zbatuar. Ne vetëm Allahun e kemi adhuroar dhe asgjë nuk i kemi shoqëruar. Jemi ndaluar nga ato që na i ka ndaluar, ndërsa e kemi bërë të lejuar atë që ai na e ka lejuar.*

*Por kjo u bë shkak që të fitojmë armiqtësinë e Kurejshëve. Pësuam shumë tortura e mundime e nuk mundëm të durojmë sepse edhe prej fesë sonë s'deshëm të largoheshim e të rikthehemi nga adhurimi i Allahut në adhurimin e idhujve, që përsëri të kryejmë vepra të shëmtuara siç kemi bërë më parë. Dhe kur ata na u vërsulën me forcë dhe filluan të na bëjnë dhunë, kur na i vështirësuan të gjitha mundësitë, kur u vendosën mes nesh dhe fesë sonë, ne atëherë erdhëm në vendin tënd. O mbret, ne të zgjodhëm ty mes sundimtarëve, erdhëm në vendin tënd. Ne u strehuam nën mbrojtjen tënde duke shpresuar se nuk do të pësojmë padrejtësi në vendin tuaj!"*

Nexhashiu, i cili i dëgjoji në qetësi thëniet e Xhaferit r.a., pyeti:

"A dini gjë përmendësh nga ajo që i është zbritur Pejgamberit tuaj nga Allahu?"

Xhaferi r.a. tha: "Po."

Nexhashiu përsëri i tha: "Ma lexo mua atë!"

Xhaferi ia lexoi atij fillimin e sures Merjem: "*Kaf Ha Ja Ajn Sad!*"

Kur e dëgjoji leximin e tij, Nexhashiu vallahi qau aq fort sa edhe mjekra iu lag nga lotët. Me të qanë edhe patriarkët e tij, saqë lotët u pikuan në librat e tyre.

Pastaj Nexhashiu tha: "Vallahi, këto fjalë janë prej burimit të fjalëve hyjnore të zbritura Isait. Shkoni ju të dy se unë nuk mund t'jua dorëzoj juve këta emigrantë në asnjë mënyrë!"

Tha (Ummu Seleme): "Pasi u largua nga prania e Nexhashiut, Amër b. Asi tha:

"Vallahi, nesër do të vij me diçka që do t'ua shkul rrënjët që këtu!" Ndërsa Abdullah b. Ebi Rebia, i cili ishte më i devotshëm se ai, tha:

"Mos e bëj sepse ata kanë edhe të afërmit e tyre, edhe në qoftë se nuk pajtohen me ne!"

Amri tha: "Vallahi, do t'u them se ata pretendojnë se Jezusi, biri i Merjemes, është rob!"

Dhe të nesërmen doli në audiencë te Nexhashiu dhe tha:

“O mbret! Ata thonë një fjalë shumë të rëndë për Isain, të birin e Merjemes! Po deshe, thirri dhe pyeti ç’thonë për të!”

Mbreti dërgoi tek ata për t’i pyetur për të.

Ummu Seleme thotë: “Kjo ishte për ne pjesa më e vështirë. Përsëri u mblodhëm për të diskutuar e thamë në mes vete: “Çfarë do të themi nëse na pyet ai çfarë thoni ju për Jezusin, birin e Merjemes?”

Thanë: “Vallahi, do të themi, atë që ka thënë Allahu dhe atë që na ka sjellë Pejgamberi ynë s.a.v.s dhe le të bëhet çfarë të bëhet!”

Kur ata hynë te mbreti, ai u tha: “Çfarë thoni në lidhje me Jezusin, birin e Merjemes?”

U përgjigj Xhafer b. Ebi Talibi, duke thënë:

“Ne e njohim atë siç na ka mësuar Pejgamberi ynë a.s., i cili thotë:

*“Ai është rob i Allahut dhe i dërguari i Tij, Shpirti i Tij dhe Fjala e Tij, e cila është futur tek Merjemja e virgjër.”*

Atëherë, duke marrë një shkop të vogël prej toke, Nexhashiu tha:

“Vallahi, Isai i biri i Merjemes nuk është tjetër veç ashtu siç e përshkrove ti! Mes thënies suaj dhe të vërtetës mbi Isanë nuk ka ndonjë ndryshim as sa ky shkop!”

Kur tha kështu Nexhashiu, patriarkët përreth nisën të mërmërisnin me pakënaqësi.

Nexhashiu u tha atyre: “Vallahi, sado që të pëshpëritni ju, kjo është e vërteta! “Kurse emigrantëve u tha kështu:

“Shkoni! Jeni në siguri të plotë në vendin tim! Kush e zgjat gjuhën kundër jush, do të ndëshkohet. Edhe sikur të më japin një mal me flori, unë s’dua t’i shkaktoj mundime asnjërit prej jush! Dhe këtyre dy njerëzve kthejuani dhuratat që prunë. Unë s’kam nevojë për to!”

Ummu Seleme tha: “Ata të dy dolën të dekurajuar dhe pa përfunduar punë. Ne mbetëm aty duke iu gëzuar mikpritjes së mirë.”

Ne jetuam ashtu për një kohë, pastaj papritmas u shfaq një njeri abisinas, i cili tentoi ta përmbyste mbretin nga froni. Vallahi, nuk e di nëse jemi shqetësuar ndonjëherë më tepër se atëherë sepse u frikësuam se ky njeri mos po e mposhte Nexhashiun dhe pastaj do të vinte dikush që nuk dinte për ne atë që dinte ai.

Nexhashiu eci në drejtim të tij derisa distanca në mes tyre ishte sa gjerësia e lumit Nil. Sahabët e Pejgamberit a.s. pyetën: “Kush do të shkojë deri te vendi i ngjarjes dhe prej andej të na sjellë ndonjë lajm?” Zubejr b. Avvami, i cili ishte më i vjetri në mesin e tyre, tha: “Unë!” Ata ia frynë një shakull të cilën e vendosi në gjoks, pastaj notoi në anën tjetër të Nilit, ku zhvillohej beteja, pastaj vazhdoi derisa u afrua.”

Tha (Ummu Seleme): “Ne i luteshim Allahut për fitoren e Nexhashiut që ta mposhte kundërshtarin e tij dhe ta forconte pushtetin e tij. Vallahi, ne qëndronim dhe pritnim epilogun përfundimtar, kur u shfaq Zubejri, i cili nxitonte dhe bënte me shenjë me rrobën e tij, duke bërëtitur: -Gëzohuni se fitoi Nexhashiu!

Allahu e shkatërroi kundërshtarin e tij dhe e forcoi pushtetin e tij në vend. Mbarë Abisinia ishte me të. Për aq kohë sa qëndruam tek ai, ne kaluam momente të mira, derisa u kthyem në Mekë te Pejgamberi a.s..”

## OMER BIN HATTABI BËHET MUSLIMAN

Pasi u kthyen Amër b. Asi dhe Abdullah b. Ebi Rabia te Kurejshët pa e realizuar qëllimin ndaj shokëve të Pejgamberit a.s. dhe me dhuratat të cilat ua kishte refuzuar Nexhashiu, Islamin e pranoi Omer b. Hattabi, i cili ishte njeri krenar dhe i vendosur. Me të dhe me Hamzën, pasuesit e Pejgamberit a.s. fituan mbështetje të fortë, madje edhe i tejkaluan Kurejshët.

Abdullah b. Mesudi thoshte: “Ne nuk mund të faleshim te Qabeja derisa e pranoi Islamin Omer b. Hattabi. Pasi e pranoi ai Islamin, iu kundërvu Kurejshëve dhe falej te Qabeja, pastaj edhe ne faleshim me të. Omeri e pranoi Islamin pas shkuarjes së shokëve të Pejgamberit a.s. në Abisini.

Me sa di unë, Omeri e pranoi Islamin pasi motra e tij Fatime bint Hattab dhe burri i saj Seid b. Zejdi ishin bërë muslimanë, por ata e fshihnin besimin nga Omeri. Gjithashtu, Nuajm b. Abdullah Nehham, një anëtar nga fisi i tij Benu Addij b. Ka'b, e kishte pranuar Islamin, por e mbante fshehur se frikësohej nga populli i tij.

Habbab b. Eretti shkonte shpesh te Fatime bint Hattabi dhe ia mësonte Kur'anin.

Një ditë, në një mënyrë krejt indiferente, Omeri ngjeshi shpatën në brez dhe doli në rrugë për të vlarë Pejgamberin a.s. dhe një grup sahabësh, për të cilët u tha se ishin tubuar në një shtëpi në Safa. Grupi përbëhej nga afro dyzet burra dhe gra dhe në mesin e tyre ishte edhe xhaxhai i Pejgamberit a.s., Hamza b. Abdulmuttalibi, pastaj Ebu Bekër Sidiku, Ali b. Ebi Talibi dhe të tjerë të cilët kishin mbetur në Mekë me Pejgamberin a.s. kur të tjerët kishin shkuar në Abisini.

Në rrugë u takua me Nuajm b. Abdullahun, i cili e pyeti: “O Omer, ku po shkon?”

Omeri iu përgjigj: “Po shkoj te Muhamedi, ai renegat, i cili i ka përçarë Kurejshët, i ka fyer ata, e ka turpëruar fenë e tyre, i ka ofenduar zotat e tyre! Unë po shkoj ta vras atë!”

Nuajmi i tha: “O Omer, vallahi, ty të ka mashtruar vetvetja! A mos pandeh se po ta vrasësh atë kanë për të të lënë të gjallë të bijtë e Abdi Menafit? Ti bën mirë sikur të shohësh më parë punën e familjes tënde!”

Duke u zemëruar rëndë, Omeri e pyeti: “Për kë e ke fjalën?”

Nuajmi u përgjigj: “Për motrën tënde Fatime bint Hattabin dhe për burrin e saj, Seid b. Zejdin. Vallahi, që të dy janë bërë muslimanë dhe po e ndjekin fenë e Muhamedit! Shko në fillim tek ata!”

Dhe vërtet Omeri u kthye dhe shkoi te motra e tij dhe burri i saj. Me ta ishte edhe Habbab b. Eretti, i cili kishte një fletë në të cilën ishte surja “Ta Ha”, të cilën

ua lexonte atyre të dyve. Kur i dëgjuan hapat e Omerit, Habbabi me shpejtësi u fsheh në një kthinë tjetër apo në një pjesë të shtëpisë. Fatime bint Hattabi e mori fletën e Kur'anit dhe e fshehu. Omeri kur u afrua te shtëpia, e dëgjoi leximin e Habbabit dhe kur hyri, i pyeti:

"Çfarë është kjo murmurisje që dëgjova?!"

Ata i thanë: "Ti nuk ke dëgjuar asgjë!"

Omeri kundërshtoi: "Jo! Vallahi, e mësova se që të dy ju jeni bërë ndjekës të Muhamedit!" Dhe iu sul dhëndrit, kurse të motrën që hyri në mes, e qëllloi në fytyrë dhe asaj i rrodhi gjaku.

Pasi e bëri këtë, ajo dhe burri i saj i thanë atij: "Po, ne kemi pranuar Islamin dhe i kemi besuar Allahut dhe Pejgamberit të Tij! Bëj çfarë të duash!"

Omeri kur e pa gjakun te motra e tij, i erdhi keq që e bëri atë, u mblodh pak dhe pastaj i tha motrës: "Ma jep mua atë fletën që ju dëgjova duke lexuar më parë, të shoh se çfarë është ajo që ka sjellë Muhamedi!" Omeri dinte të lexonte.

Kur i tha këtë, motra iu përgjigj: "Ne frikësohemi për të nga ti!"

Tha: "Mos u frikëso!" Pastaj iu betua asaj për zotat e tij se do t'ia kthente sapa ta lexonte. Kur e tha këtë, ajo duke dashur që ai ta pëlqejë Islamin, i tha:

"O vëllai im, ti me shirkun tënd je i papastër! Atë fletë mund ta prekë vetëm njeriu i pastër!"

Atëherë Omeri u ngrit dhe u la, pastaj ajo ia dha fletën në të cilën ishte surja "Ta Ha" dhe ai e lexoi.

Pasi e lexoi fillimin e saj, tha: "Sa të bukura këto fjalë! Sa të çmuara!"

Habbabi r.a., që i kishte dëgjuar fjalët e Omerit, doli nga vendi ku ishte fshehur dhe i tha:

"O Omer! Vallahi, lutja e të Dërguarit të Allahut do të të bjerë ty në pjesë. Dje ai u lut kështu:

*"O Zot, forcoje Islamin me Ebul Hakem bin Hishamin ose Omer bin Hattabin!"* O Omer, ki frikë Allahun!"

Me atë rast, Omeri i tha: "O Habbab, më çoj atje ku ndodhet Muhamedi që të bëhem musliman!"

Habbabi i tha: "Ai është në një shtëpi në Safa, me të është edhe një grup i pasuesve të tij."

Omeri e mori, e ngjeshi shpatën e tij dhe menjëherë u nis në drejtim të Pejgamberit a.s. dhe shokëve të tij. Kur trokiti në derë dhe kur e dëgjuan zërin e tij, njëri prej tyre u ngrit dhe shikoi nëpër çarjen e derës. Pasi e pa atë me shpatë të ngjeshur, i frikësuar u kthye te Pejgamberi a.s. dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, te dera është Omer b. Hattabi me shpatë!"

Hamza b. Abdulmuttalibi i tha: "Lëre, nëse dëshiron ndonjë të mirë, ne ia japim, por në qoftë se dëshiron ndonjë të keqe, do ta vrasim me shpatën e tij!"

Pejgamberi a.s. i tha: “Lëre!” Dhe ai e lejoi.

Pejgamberi a.s. u ngrit dhe eci drejt Omerit. Ata u takuan në një dhomë ku ai e kapi për rripi apo për rrobash, pastaj e tërhoqi me forcë nga vetja dhe i tha:

*“Ç’gjë e mirë të solli, o biri i Hattabit? Pasha Allahun, me sa po shoh, kjo do të jetë një ngjarje e madhe!”*

Omeri tha: “O i Dërguari i Allahut, erdha te ti për të besuar Allahun, të Dërguarin e Tij dhe caktimin e Allahut !”

Me atë rast Pejgamberi a.s. tha: *Allahu Ekber! (Allahu është më i madhi!)* Nga ky tekmbir të pranishmit menjëherë kuptuan se Omeri e pranoi Islamin.

Të gjithë u zhvendosën nga vendet e tyre dhe në vetvete ndjenin gëzim të madh sepse ata e dinin shumë mirë se tani Omeri dhe Hamza do ta mbrojnë Pejgamberin a.s. dhe se me kalimin e në radhët e tyre do të barazohen me armiqtë.

Omeri më vonë tregon: “Pasi e pranova Islamin, që atë natë mendova se kush nga mekasit është armiku më i përbetuar i Pejgamberit a.s., në mënyrë që të shkoj dhe t’i tregoj se jam bërë musliman. Thashë me vete: Ebu Xhehli!

Kur u bë mëngjes, shkova dhe trokita në portën e tij. Doli Ebu Xhehli dhe më pyeti:

*“Mirë se erdhe, o djali i motrës!<sup>52</sup> Ç’ të reja na solle?”*

I thashë: “Erdha të të them se besova Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe se i vërtetova të gjitha gjërat e sjella prej tij!”

Atëherë ma mbylli derën sikur të ma përplaste syve dhe më tha: “Zoti të shëmtoftë ty dhe atë me të cilën erdhe!”

<sup>52</sup> Nëna e Omerit, Hantema bint Hisham b. Mugire, ka qenë motra e Ebu Xhehl b. Hishamit.

## LAJMI I FLETËS

Kur Kurejshët e panë se pasuesit e Pejgamberit a.s. shkuan në një vend ku gjetën qetësi e siguri, se Nexhashiu i mori nën mbrojtje ata që u strehuan tek ai, kur e panë se Omeri e pranoi Islamit dhe ai bashkë me Hamzën u pozicionuan me Pejgamberin a.s., se Islami po përhapej nëpër fise, ata u mblodhën dhe vendosën të hartonin një dokument me të cilin do t'i këputnin të gjitha marrëdhëniet njerëzore me muslimanët dhe bijtë e Hashimit që i mbronin ata, nga marrëdhëniet tregtare e gjer tek të gjitha lidhjet qytetare, si dhënia dhe marrja e vajzave, etj.

Kur ata ranë dakord, e shkruan në një fletë, pastaj e varën në muret e Qabesë.

Akt-betimin e kishte shkruar Mensur b. Ikrime. Atë ditë që e shkroi, si rezultat i lutjes së Pejgamberit a.s., iu paralizuan disa gishta.

Pas veprimit të Kurejshëve, të gjithë anëtarët e Benu Hashimit dhe Benu Mutalibit shkuan tek Ebu Talibi dhe të gjithë u tubuan në një vend. Nga Benu Hashimët u veçua vetëm Ebu Lehebi, Abduluzza b. Abdulmuttalib, i cili kaloi te Kurejshët dhe i ndihmoi pa masë. Ai foli sa foli, ndër të tjera tha edhe këtë:

“Muhamedi më premtonte gjëra që nuk i shoh, pretendon se ato do të jenë pas vdekjes, po çfarë më dha në dorë?!” Pastaj fryu në duart e tij dhe tha: “Qofshi të mallkuara, unë nuk po shoh te ju asgjë nga ato që po thotë Muhamedi!”

Atëherë Allahu i Madhërishtëm shpalli: *“Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai më është shkatërruar...!”*<sup>53</sup>

Në këtë gjendje ata kaluan dy apo tre vjet, derisa u dërmuan krejtësisht. Asgjë nuk mund të arrinte tek ata, përveç në fshehtësi të plotë, nga disa Kurejshë që dëshironin t'i vazhdonin lidhjet me ta.

<sup>53</sup> Disa thonë se shkak i zbritjes së këtij ajeti është se pas zbritjes së ajetit: *“Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt”* (Esh-Shuara, 214), Pejgamberi a.s. doli dhe shkoi në Safa. U ngjit në lartësi dhe tha: *“Ejani, afrohuni tek unë!”* Pasi u tubuan rreth tij, tha: *“Çfarë mendoni nëse ju informoj se në atë luginë gjenden kalorës të cilët duan t'ju sulmojnë, a do të më besoni?”* Ata u përgjigjën: *“Asnjëherë nga ti ne nuk kemi dëgjuar gënjeshtër!”* Tha: *“Atëherë pra unë po ju paralajmëroj për një dënim të ashpër i cili ju pret!”* Ebu Lehebi tha: *“Mallkuar qofsh, për këtë na ke tubuar!”* Atëherë, Allahu i Madhërishtëm shpalli: *“Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai më është shkatërruar...!”*

## SHQETËSIMET QË PËRJETOI PEJGAMBERI a.s. NGA POPULLI I TIJ

Kur Allahu i Madhërishëm e mbrojti Pejgamberin a.s. nga Kurejshët dhe kur xhaxhai i tij dhe njerëzit e tij nga fisi Benu Hashim dhe Benu Muttalib u vendosën në anën e tij dhe i dilnin në mbrojtje kundër Kurejshëve, atëherë ata filluan të tallen me të, ta përqeshin dhe të grinden, kurse Kur'ani duke zbritur trajtonte ngjarjet brenda tyre, veçanërisht armiqësinë ndaj Pejgamberit a.s.. Disa prej tyre janë theksuar me emër, ndërsa për disa është aluduar duke folur për jobesimtarët në përgjithësi.

Në mesin e atyre që janë theksuar me emër ndër Kurejshët për të cilët ka zbritur Kur'ani janë:

- *Ebu Leheb, Abdulmuttalibi, xhaxhai i Pejgamberit a.s. dhe gruaja e Ebu Lehebit, Ummu Xhemil bint Harb b. Umejje, "bartësja e druve".* Ajo bartte thera dhe i hidhte në rrugën ku kalonte Pejgamberi a.s.. Në lidhje me ata të dy Allahu i Madhërishëm shpalli:

*"Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra), e në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur."* (El-Mesed)

Ibni Is'haku ka thënë:

"Më është thënë mua se kur Ummu Xhemil kishte dëgjuar se çfarë ka zbritur në Kur'an rreth asaj dhe burrit të saj, menjëherë kishte shkuar te Pejgamberi a.s., i cili ishte ulur pranë Qabesë bashkë me Ebu Bekër Siddikun, ndërsa në dorë mbante një gur sa madhësia e dorës. Kur u ndal para tyre, Allahu ia kishte marrë aftësinë për ta parë Pejgamberin a.s. dhe kishte parë vetëm Ebu Bekrin.

Ajo tha: "O Ebu Bekër, ku është shoku yt? Unë kam dëgjuar se ai është tallur me mua! Vallahi, kur ta gjej, do t'ia thyej gojën me këtë gur!" Pastaj ishte larguar.

Ebu Bekri r.a. pyeti: "O i Dërguari i Allahut, a nuk të pa ajo ty?"

Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Nuk më pa. Allahu për të më bëri të padukshëm!"

- *Umejje b. Halef b. Vehb b. Hudhafe b. Xhumeh* sa herë që e shihte Pejgamberin a.s., tallej me të dhe shpifte. Për të Allahu i Madhërishëm ka shpallur:

*"Mjerë për secilin që e ofendon e përqesh (njerëzit)! Që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet. E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm. Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai pa tjetër do të hidhet në Hutame. E çka di ti se ç'është Hutame? Është zjarri i Allahut i ndezur fort. Që depërton deri në loçkë të zemrës. Ai i mbyll ata, ua zë frymën. Ata janë të lidhur në pranga."* (El-Humeze)

- *As b. Vail Sehmiu.* Habbab b. Eretti, shok i Pejgamberit a.s., ishte farkëtar shpatash, kështu që i kishte farkuar shpata edhe As b. Vailit, sipas porosisë që i bënte. Pasi i kishte porositur, kishte shkuar për ta paguar borxhin duke e pyetur:

“O Habbab, a nuk po pretendon Muhamedi, shoku juaj, në fenë e të cilit je edhe ti, se në xhenet ata do të kenë sa të dëshirojnë ar dhe argjend, veshje dhe shërbëtorë?!”

Habbabi i përgjigjet: “Po!”

Ai i thotë: “Atëherë më prit deri në Ditën e Gjykimit, o Habbab, dhe kur të hyj në xhenet, atje do të ta paguaj borxhin! Vallahi, nuk do të jesh ti dhe shoku yt, o Habbab, më të zgjedhur se unë tek Allahu, e as nuk do të fitoni shpërblim më të madh!”

Në lidhje me të Allahu i Madhërishëm ka shpallur:

“A je i njoftuar për atë që mohoi argumentet Tona e tha: “Mua gjithqysh do të më jepet pasuri e fëmijë (në botën tjetër)?” A, mos ai ka mësuar për atë që nuk është parë, ose ka marrë obligim nga i Gjithëmëshirshmi? Jo, nuk është ashtu, po Ne do të shënojmë atë që po e thotë ai dhe do të vazhdojmë atij dënim pas dënimi. Dhe Ne e trashëgojmë atë (në pasuri e fëmijë) që të thotë ai, e ai ka për të na ardhur i vetmuar.” (Merjem, 77-80)

Sipas një tregimi, Ebu Xhehl b. Hishami ishte takuar me Pejgamberin a.s. dhe i kishte thënë: “Vallahi, o Muhamed, ose do ta ndërpresësh fyerjen e zotave tanë ose ne do të fillojmë ta fyejmë Zotin që ti adhuron!” Në lidhje me këtë, Allahu i Madhërishëm shpalli:

“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij)...” (El-En’am, 108)

Më është thënë se Pejgamberi a.s. pastaj nuk ka folur kundër zotave të tyre, por vetëm i ka thirrur njerëzit tek Allahu.

- *Nadr b. Harith b. Keledeh b. Abdi Menaf b. Abdiddarb. Kusajj.* Kur Pejgamberi a.s. ulej në mesin e njerëzve dhe bënte thirrje tek Allahu, lexonte Kur’an, pastaj i paralajmëronte Kurejshët për pasojat dhe dënimin që u kishte ardhur popujve të mëparshëm, ai menjëherë pasi shkante Pejgamberi a.s. ngrihej në vendin e tij dhe u fliste njerëzve për Rustemin e ndritshëm dhe Isfendijarin si dhe për shumë mbretër të tjerë persianë. Pastaj thoshte: “Vallahi, Muhamedi nuk flet më mirë se unë. Fjalët e tij janë vetëm legjenda të popujve të lashtë, të cilat i ka mbledhur Muhamedi ashtu siç i kam mbledhur edhe unë!”

Edhe në lidhje me këtë Allahu i Madhërishëm ka shpallur në Kur’an:

“Edhe thanë: “(për Kur’anin) Janë legjenda të të parëve, që ai (Muhamedi) kërkoi t’i shkruhen ato, e i lexohen atij mëngjes e mbrëmje.” Thuaj: “Atë e shpall Ai, që e di të fshehtë në qiej e në tokë, Ai është që fal shumë, është mëshirues.” (El-Furkan, 5-6)

Gjithashtu për të ka zbritur edhe: “Kur atij i lexohen ajetet Tona, ai thotë: “Legjenda të të parëve!” (El-Kalem, 15)

Si dhe: *“Çdo gënjeshtar e shumë mëkatar është i shkatërruar. Që i dëgjon ajetet e Allahut, të cilat lexohen, e pastaj vazhdon prapë si mendjemadh sikur nuk i ka dëgjuar ato. Atë lajmëroje për një vuajtje të dhembshme.”* (El-Xhathije, 7-8)

-Ahnës b. Shurejk b. Vehb Thekafiu ishte i respektuar nga njerëzit dhe i dëgjohej fjala. Ai shpesh e ofendonte Pejgamberin a.s. dhe e kundërshtonte, kështu që Allahu i Madhërishëm edhe në lidhje me të ka shpallur:

*“Mos e respekto askënd që betohet shumë dhe është i poshtër! Që është përgojues e bën fjalë ndër njerëz. Shumë koprrac ndaj rrugës së mbarë, i pafrenueshëm, mëkatar. Që është shumë i vrazhdë! Më në fund edhe kopil (nuk i dihet babai).”* (El-Kalem, 10-13)

-Velid b. Mugire me një rast kishte thënë:

*“A po i shpallet Muhamedit e jo mua, që jam më i madhi dhe më fisniku i Kurejshëve? Dhe a të anashkalohet Ebu Mesud Amër b. Umejr Thekafiu, lideri i Thekifit, kur ne jemi më të mëdhenjtë e Mekës dhe Taifit?!”*

Në lidhje me ta Allahu i Madhërishëm ka shpallur:

*“Pastaj thanë: “Përse të mos i ketë zbritur ky Kur’an një njeriu të madh nga dy qytete?” A thua ata e përcaktojnë mëshirën (pejgamberllëkun) e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime. E mëshira (caktimi për pejgamber) e Zotit tënd është shumë më e dobishme se ajo që ata grumbullojnë.”* (Ez-Zuhruf, 31-32)

-Ubej b. Halef dhe Ukbe b. Ebi Mu’ajt. Këta të dy ishin miq të ngushtë dhe kishin marrëdhënie vëllazërore. Njëherë, Ukbe ishte ulur pranë Pejgamberit a.s. dhe kishte dëgjuar prej tij, por kur mori vesh për këtë Ubej menjëherë nxitoi tek ai dhe i tha:

*“A është e mundur që je ulur me Muhamedin dhe ke dëgjuar prej tij?” Pastaj u betua fort para tij. “Unë as nuk do të të shikoj ty, e lëre më të flas me ty nëse ulesh me të dhe dëgjon prej tij apo kalon pranë tij dhe nuk e pështyn në fytyrë!”*

Kështu veproi armiku i Allahut, Ukbe b. Ebi Mu’ajt, Allahu e mallkoftë! Në lidhje me të Allahu i Madhërishëm ka shpallur:

*“Atë ditë zullumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: “I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!” O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar.”* (El-Furkan, 27-29)

Ubej b. Halef shkoi te Pejgamberi a.s. duke mbajtur në dorë një kockë të kalbur, e cila me të prekur bëhej pluhur, dhe i tha: *“O Muhamed, ti po pretendon se Zoti do ta ringjallë këtë kockë të kalbur!”* E shtrëngoi me grushtin e tij dhe pastaj i fryri në ajër në drejtim të Pejgamberit a.s.

Pejgamberi a.s. i tha: *“Po, Allahu do t’i ringjallë ato edhe ty pasi të bëhesh i tillë dhe pastaj do të të fusë në zjarr!”*

Allahu i Madhërishëm atëherë shpalli:

*“Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: “Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur? Thuaj: “I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim. Ai që prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndizni.” (Jasin, 78-80)*

Me një rast, sipas informatave që kam, derisa Pejgamberi a.s. po bënte tavaf në Qabe, *Esved b. Muttalib b. Esed b. Abduluzza, Velid b. Mugire, Umejje b. Ebi Halef dhe As b. Vail Sehmiu*, që të gjithë liderë të fiseve të tyre, i kishin thënë Pejgamberit a.s.:

*“O Muhamed, eja të adhurojmë çfarë po adhuron ti dhe të bashkohemi ne dhe ti në këtë çështje. Nëse ajo që po adhuron ti është më e mirë se ajo që po adhurojmë ne, atëherë edhe ne po bashkohemi, mirëpo nëse ajo që po adhurojmë ne është më e mirë, atëherë edhe ti bashkohu me ne!”*

Allahu i Madhërishëm në lidhje me ta ka shpallur:

*“Thuaj: “O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni! As ju nuk jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj! Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!” (El-Kafirun)*

- *Ebu Xhehl b. Hishami*. Kur Pejgamberi a.s. e përmendi drurin e Zekkumit me të cilin i kërcënonte ata, ai i thotë:

*“O Kurejshë, a e dini çfarë është druri i Zekkumit, me të cilin po ju frikëson Muhamedi?”*

Ata u përgjigjën: *“Jo, nuk e dimë!”*

Ai tha: *“Janë hurmat më të mira të Jethribit, yndyrore dhe me tul. Vallahi, nëse i shtimë në dorë, me kënaqësi do t'i kapërdijmë!”*

Në lidhje me këtë Allahu i Madhërishëm shpalli: *“Është e vërtetë se pema e Zekkumit, do të jetë ushqim i mëkatarëve. Vlon si katran (si pezhgeja) në barqet. Ashtu si vlon uji i valë.” (Ed-Duhan, 43-46)*. Pra, nuk është si pretendon ai.

-*Velid b. Mugire* njëherë ishte ndalur me Pejgamberin a.s. dhe po bisedonin. Pejgamberi a.s. dëshironte që ai ta pëlqente Islamin. Duke qenë në këtë gjendje, aty kaloi Ibn Ummu Mektum, që ishte i verbër. Ai foli me Pejgamberin a.s. dhe kërkoi prej tij që t'i lexojë diçka nga Kur'ani. Kjo i shkaktoi shqetësim Pejgamberit a.s. dhe e zemëroi, për arsye se e pengoi kur ishte duke bërë përpjekje për ta bindur Velidin që ta pëlqejë dhe ta pranojë Islamin. Pasi ai këmbëngulte në kërkesën e tij, Pejgamberi a.s. ia ktheu shpinën me zemërim dhe e la.

Më pas Allahu i Madhërishëm i shpalli:

*“Ai vrenjti (fytyrën) dhe u kthye. Ngase atij i erdhi i verbri. E ku mund ta dish ti, ndoshta ai do të pastrohet. Apo do të këshillohet dhe këshilla do t'i bëjë dobi! E ai që nuk*

*ndien nevojë (për Zotin) pse ka pasuri, Ti atij i vë veshin (i drejtohesh)! Po ti nuk ke përgjegjësi, pse ai nuk pastrohet. Ndërsa ai që nxiton dhe vjen te ti, dhe meqë ai frikësohet, e ti nuk e zë asgjë (dhe nuk ia vë veshin fjalës së tij). Jo ashtu! Në të vërtetë këto janë këshilla. Kush do merr mësim nga kjo (nga Kur'ani). Është këshillë në fletë të çmueshme. Me vlerë të lartë e të ruajtur.” (Abese, 1-14). Kuptimi është se Unë të kam dërguar si përgëzues dhe paralajmërues, askënd nuk e kam veçuar me të drejtë më tepër se tjetrin. Prandaj mos e pengoj atë që me të vërtetë e dëshiron Islamin për shkak të atij i cili nuk e dëshiron.*

Disa prej tyre Pejgamberin a.s. e ngacmuan edhe në shtëpinë e tij. Ata ishin Ebu Lehebi, Hakem b. Ebi Asi, Ukbe b. Ebi Mu'ajt, Adij b. Hamra Thekafiudhe Ibn Asda' Hedheliu. Të gjithë ishin fqinjët e tij dhe nga të gjithë ata më vonë Islamin e pranoi vetëm Hakem b. Ebi Asi.

Teksa Pejgamberi a.s. falej, ata i hidhnin mbi shpinë të brendshmet e deles ose ia vendosnin në poçen e tij prej balte. Për këtë arsye, Pejgamberi a.s. u detyrua të kërkojë strehim në ndonjë vend ku do të fshihej prej tyre gjatë namazit.

Kur ata i shkaktonin shqetësime të tilla, ai i largonte ato me ndonjë shkop, pastaj ndalej në derën e tij dhe thoshte: *“Çfarë fqinjësh jeni ju o bijtë e Abdi Menafit?!”* Pastaj i hidhte ato tej.

## KTHIMI I EMIGRANTËVE NGA ABISINIA

Shokët e Pejgamberit a.s., të cilët ndodheshin në tokën e Abisinisë, dëgjuan se banorët e Mekës kishin pranuar masivisht Islamin. Në bazë të këtij lajmi, ata nxituan që të ktheheshin në shtëpitë e tyre, por kur iu afruan Mekës, kuptuan se ajo që thuhej, se banorët e Mekës e kanë pranuar Islamin, nuk ishte e vërtetë. Kështu që vetëm disa prej tyre mundën të hyjnë në Mekë nën mbrojtjen e dikujt ose fshehurazi.

Numri i përgjithshëm i sahabëve që ishin kthyer nga Abisinia në Mekë ishte 33 burra.

Ata që kishin hyrë nën mbrojtjen e dikujt, emrat e të cilëve i dimë, janë: Osman b. Medh'un b. Habib Xhumehiu, i cili hyri nën mbrojtjen e Velid b. Mugires, pastaj Ebu Seleme b. Abduled b. Hilal b. Abdullah b. Omer b. Mahzum, i cili hyri nën mbrojtjen e Ebu Talibb. Abdulmuttalibit, që ishte daja i tij dhe Ummu Ebi Seleme Birre bint Abdulmuttalib.

## SHKELJA E VENDIMEVE TË FLETËS

Një grup Kurejshësh i shkeli vendimet e miratuara nga Kurejshët e të shkruara në fletë kundër fiseve Benu Hashim dhe Benu Muttalib. Në këtë veprim priu Hisham b. Amër, i cili ishte djalë i vëllait të Nadle b. Hisham b. Abdi Menafit nga ana e nënës. Hishami ishte me Benu Hashimët në lidhje miqësie, ndërsa në fisin e vet ishte i vlerësuar shumë. Sipas informatave të mia, ai vinte natën me një deve të ngarkuar me ushqime të Benu Hashimët dhe Benu Muttalibët, të cilët qëndronin në një qafë mali. Kur mbërrinte në grykë të qafës malit, e hiqte kapistrën nga qafa e devesë dhe kështu e lëshonte nga njëra anë deri tek ata. Pastaj kthehej dhe bënte të njëjtën gjë me ngarkesën tjetër me rroba.

Pastaj shkoi te Zuhejr b. Ebi Umejje b. Mugire, nëna e të cilit ishte Atike bint Abdulmuttalib, Hisham bin Amër i tha Zuhejr b. Ebi Umejjes:

“O Zuhejr! Si të bën zemra të hash e të pish ç’të duash, të vishesh e të mbathesh si të duash, ndërsa dajallarët e tu janë izoluar dhe përpëliten në ngushticë dhe papasje për të blerë e shitur diçka apo për t’u martuar? Vallahi, po të ishte fjala për dajallarët e Ebu Hakem b. Hishamit dhe sikur ta kishe ftuar ti atë, për çfarë të ka ftuar ai ty, ai kurrë nuk do të përgjigjej!”

Zuhejri i tha: “Për hir të Zotit, o Hisham! Çfarë mund të bëj? Unë jam një njeri i vetëm, vallahi, po të ishte edhe një njeri tjetër me mua, do ta shkelja marrëveshjen!”

Hishami i tha: “E ke edhe një njeri krah teje!” Tha: “Kush është ai?” Hishami tha: “Unë!”

Zuhejri i tha: “Kërko edhe njeriun e tretë!” Pastaj shkoi te Mutim b. Adiu dhe i tha:

“O Mutim, a je i kënaqur që të shkatërrohen dy degët e fisit Abdumenafor para syve të tu vetëm për t’i kënaqur Kurejshët?! Vallahi, nëse ju këtë ua mundësoni, do të shihni se ata shumë shpejt edhe ndaj jush do të veprojnë të njëjtën gjë!”

Mutimi i tha: “Për Zotin! Po çfarë të bëj? Unë jam i vetëm.” Hishami tha: “E ke edhe një njeri krah teje!” Mutimi tha: “Kush është ai?” Hishami tha: “Unë.” Mutimi tha: “Na e gjej edhe një të tretë!” Hishami tha: “Tashmë e kam bërë!” Mutimi tha: “Kush është ai?” Hishami tha: “Zuhejr b. Ebi Umejje.” Mutimi tha: “Na e gjej edhe të katërtin.”

Pastaj shkoi tek Ebul-Bahterib. Hishami i tha atij ngjashëm me atë që i tha Mutim b. Adiut. Ai e pyeti:

“A është dikush tjetër që na mbështet?” Hishami u përgjigj: “Po.” Tha: “Kush është ai?”

Hishami i tha: “Zuhejr b. Ebi Umejje, Mutim b. Adiu dhe unë. ”Tha: “Na e gjej edhe të pestin!”

Pas kësaj ai shkoi te Zem'ab, Esved b. Muttalibi, foli me të dhe ia kujtoi atij lidhjet familjare dhe detyrimet, pastaj i tha:

Zem'a e pyeti: “A është edhe ndokush që pajtohet me këtë që po më fton?”  
Tha: “Po, sigurisht.” Pastaj ia tregoi me emër njerëzit e tij.

Këta pesë veta u mblodhën natën në zonën Haxhun të Mekës së sipërme dhe biseduan se ç' duhej të bënin dhe u morën vesh të bënin përpjekje gjersa të prishej Pakti i Bojkotimit.

Zuhejri tha: “Unë do ta filloj këtë, unë do të flas i pari.”

Kur erdhi mëngjesi, shkuan në vendin e tyre të zakonshëm të takimit. Zuhejr b. Umejje kishte veshur pelerinën e tij. E bëri tavafin shtatë herë rreth Qabesë, pastaj iu drejtua njerëzve:

“O mekas! Ne të hamë e të pimë si të duam, të vishemi e mbathemi si të duam, kurse Benu Hashimët të izoloohen nga marrëdhëniet dhe të shkatërrohen? Punë që bëhet është kjo? Beto hem në Allahun se nuk do të rri gjersa të grisët kjo fletë mizore që pret lidhjet farefisnore!”

Ebu Xhehli, i cili ishte në një skaj të Haremit, tha: “Po gënjen, vallahi, nuk do ta grisësh!”

Zem'a b. Esvedi tha: “Vallahi, ti po gënjen më shumë! Ne me këtë fletë nuk kemi qenë të kënaqur qysh kur u shkrua!”

Ebu-l-Bahteriu tha: “Mirë e ka Zem'a, ne nuk pajtohemi me atë që është shkruar në të, as nuk e pranojmë atë!”

Mutim b. Adiu tha: “Ju të dy thatë të vërtetën! Kush thotë ndryshe, gënjen! Allahu na shpëtoftë prej saj dhe prej asaj që shkruhet në të!”

Edhe Hisham b. Amri reagoi në mënyrë të ngjashme.

Pastaj Ebu Xhehli tha: “Kjo është një çështje që është vendosur natën, në një vend tjetër.”

Ebu Talibi gjatë gjithë kësaj kohe qëndronte ulur në një cep të Haremit.

Pastaj Mutimi u ngrit dhe ia mësyu fletës për ta grisur, por kur iu afrua, ai gjeti vetëm një pjesë ku lexonte: “*Bismikallahumme – Me emrin tënd po e filloj, Allahu im*”, krimbi e kishte ngrënë çdo fjalë tjetër që shprehte padrejtësi, dhunë dhe fyerje.

Fletën e kishte shkruar Mensur b. Ikrime dhe thuhet se atij pastaj i ishte paralizuar dora.

## IRASHIU QË I SHITI DEVENË EBU XHEHLIT

Ibni Is'haku ka thënë: “Më ka treguar Abdulmelik b. Abdullah b. Ebi Sufjan Thekafiu, i cili këtë e dinte shumë mirë:

“Erdhi një burrë nga Irashi në Mekë me devenë e tij, të cilën e bleu Ebu Xhehli. Mirëpo, ai hezitonte për t’ia paguar. Irashiu eci nëpër Mekë, pastaj u ndal para një vendi ku rrinin Kurejshët, ndërsa Pejgamberi a.s. ishte ulur në një cep të Haremit. Atëherë ai tha:

“O Kurejshë! Kush prej jush mund të më ndihmojë kundër Ebu Hakem b. Hishamit? Unë, siç po shihni, jam një njeri i huaj, një udhëtar, dhe ai po më privon nga e drejta ime.”

Njerëzit e ulur aty i thanë:

“A po e sheh atë njeriun atje ulur – duke aluduar për Pejgamberin a.s. dhe duke u tallur me të, sepse e dinin armiqësinë që ekzistonte mes tij dhe Ebu Xhehli – shko tek ai, sepse ai do të të ndihmojë!”

Dhe Irashiu menjëherë shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha:

“O robi i Allahut, Ebu Hakem b. Hishami më ka mashtruar dhe nuk po më jep atë që më takon, kurse unë jam një njeri i huaj, udhëtar. Unë kërkova nga këta njerëz se kush mund të më ndihmojë kundër tij dhe të marrë nga ai çfarë më takon, kurse ata më udhëzuan për tek ti. E pra, eja, merrja atij hakun tim, Allahu të mëshiroftë!”

Pejgamberi a.s. i tha: “*Shko tek ai!*”, ndërsa edhe vetë Pejgamberi a.s. u nis me të. Kur e panë Kurejshët, njerit prej tyre i thanë:

“Ndiqe dhe shiko çfarë do të bëjë!”

Pejgamberi a.s. shkoi dhe trokiti në portën e Ebu Xhehli.

Ebu Xhehli (nga brenda) tha: “Kush është?”

U përgjigj: “*Muhamedi, dil tek unë!*”

Ai doli, ndërsa fytyra i ishte zverdhur dhe i kishte ikur çehrrja.

Pejgamberi a.s. i tha: “*Jepja këtij njeriu të drejtën e tij!*”

Ebu Xhehli tha: “Po, menjëherë do t’ia jap atë që i takon.” Pastaj hyri në shtëpi dhe doli e ia pagoi borxhin atij.

Pastaj Pejgamberi a.s. u kthye dhe i tha Irashiut: “*E more hakun tënd, tani shko!*”

Dhe Irashiu u nis. Kur arriti te vendi ku ishin Kurejshët, u ndal para tyre dhe tha:

“Allahu e shpërbleftë me të mirë, vallahi ai e mori hakun tim!”

Në atë çast arriti personi që dërguan për ta ndjekur Pejgamberin a.s. dhe i thanë:

“Hë, na trego çfarë pe aty!”

Tha: “Çudi mbi çudira! Vallahi, vetëm i trokiti në derë dhe ai doli i tëri i zbehur.

I tha: “Jepja këtij të drejtën e vet!”

Tha: “Po, menjëherë do t’ia jap atë që i takon.” Pastaj hyri në shtëpi dhe doli e ia pagoi borxhin.

Pas pak, aty erdhi edhe Ebu Xhehli, të cilit i thanë:

“Për hir të Zotit, çfarë të ndodhi? Nuk e dimë se ndonjëherë ke vepruar kështu!”

Tha: “M’u hiqni! Vallahi, kur ka trokitur në portën time dhe sapo dëgjova zërin e tij, më kaploi një frikë e paparë, pastaj dola tek ai. Mbi kokën time pashë një deve të madhe mashkull me kokë dhe qafë që nuk e kam parë kurrë në jetën time, kishte dhëmbë të tmerrshëm! Vallahi, nëse do ta refuzoja, do të më kishte gëlltitur!”

## NDODHIA E ISRASË

Pastaj Pejgamberit a.s. i ndodhi Israja, kur u transferua natën prej Mesxhidi Haramit, Qabesë, nga Meka, deri në Mesxhidi Aksa, në Jerusalem<sup>54</sup>, d.m.th. në tempullin në Ilija'. Islami tashmë ishte zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme në Mekë, si në fisin Kurejsh ashtu edhe midis të gjitha fiseve të tjera.

Sipas informatave që më kanë arritur, Abdullah b. Mesudi thoshte:

“Pejgamberit a.s. i sollën burakun. Ai ishte një kafshë me të cilën janë bartur Pejgamberët para tij. Thundrat i vendoste në pikën e fundit që shihte para vetes. Ai hipi mbi të, kurse me të shkoi edhe shoku i tij (Xhibrili). Ai vrojtoi shumë shenja mes qiellit dhe Tokës. Kur mbërriti në Bejtul-Makdis, gjeti Ibrahimin, Musain dhe Isain (paqja qoftë mbi ta), që ishin në mesin e një grupi Pejgamberësh të cilët u mbledhën për ta përshëndetur. Ai e fali namazin me ta. Pastaj atij iu ofruan tri kupa: në njërin kishte qumësht, në tjetrën verë dhe në të tretën kishte ujë.

Pejgamberi a.s. në lidhje me këtë ka thënë:

*“Kur m’i ofruan këto kupa, unë dëgjova një zë: “Nëse merr ujin, do të përmytet ai dhe umeti i tij, nëse merr verën, do të lajthisë ai dhe umeti i tij, e nëse merr qumështin, do të udhëzohet ai dhe umeti i tij! Pastaj mora kupën e qumështit dhe e piva. Ndërsa Xhibrili (a.s.) më tha: “Do të jesh i udhëzuar ti dhe do të do të jetë i udhëzuar umeti yt, o Muhamed!”*

Ibni Is'haku ka thënë:

*“Është transmetuar nga Hasani se ai ka thënë: “Ka thënë i Dërguari a.s.: “Derisa unë isha duke fjetur në një qoshe, papritmas më erdhi Xhibrili dhe më preku me shputën e tij. Unë u ula, por nuk pashë asgjë, përsëri u ktheva në shtrat. Ai u kthye dhe përsëri më preku me shputën e tij. Unë u ula, por përsëri nuk pashë asgjë, përsëri u ktheva në shtrat. Ai erdhi tek unë edhe të tretën herë dhe më preku me shputën e tij. Unë u ula, kurse ai më kapi për muskuj dhe unë u ngrita. Më çoi deri te dera e xhamisë, kur pashë një kafshë të bardhë, diçka ndërmjet mushkut dhe gomarit. Në ijë kishte dy krahë me të cilët shtrëngonte këmbët. Këmbët e para i kishte vendosur në pikën e fundit deri ku mbërrinte shikimi. Më hipën mbi të dhe u nis me mua, as nuk më tejkalonte e as unë nuk e tejkaloja.”*

Hasani ka thënë në tregimin e tij:

“Pejgamberi a.s. u nis, me të u nis edhe Xhibrili a.s., derisa arritën në Bejtul-Makdis. Aty e gjetën Ibrahimin, Musain dhe Isain bashkë me një grup Pejgamberësh dhe së bashku e falën namazin, ndërsa Pejgamberi a.s. ishte imam i tyre. Pastaj i prunë dy enë: njërin me verë dhe tjetrën me qumësht. Pejgamberi a.s. mori enën me qumësht dhe piu prej saj, ndërsa enën e verës e la.

<sup>54</sup> Suhejliu ka thënë: “Thuhet se kjo ka ndodhur një vit para hixhretit.”

Xhibrili a.s. i tha: “I je drejtuar fesë së natyrshme, e po ashtu edhe umeti yt, o Muhamed! Ndërsa vera për ju është e ndaluar!”

Pejgamberi a.s. pastaj u kthye në Mekë. Pas agimit shkoi te Kurejshët dhe u tregoi atyre se çfarë i kishte ndodhur, por shumica e tyre thanë:

“Kjo është e çuditshme dhe e pakonceptueshme! Vallahi, karvani duke u nxituar shkon nga Meka deri në Sham për një muaj të tërë dhe për një muaj përsëri kthehet prej andej! Si ka mundur Muhamedi të shkojë brenda një nate dhe të kthehet në Mekë!”

Si rezultat, shumë njerëz që e kishin pranuar Islamin, përsëri u kthyen në fenë e tyre të vjetër. Njerëzit shkuan tek Ebu Bekri dhe i thanë:

“Çfarë mendon ti o Ebu Bekër për shokun tënd? Ai po pretendon se mbrëmë ka shkuar në Bejtul-Makdis, është falur në të dhe përsëri është kthyer në Mekë!”

Ebu Bekri u tha atyre: “Ju jeni duke gënjyer për të!”

Ata thanë: “Jo, jo nuk po gënjejmë! Ja, ai është atje në xhami duke folur me njerëzit!”

Ebu Bekri tha: “Vallahi, nëse ai ka thënë kështu, ka thënë të vërtetën! Përse po çuditeni? Vallahi, ai mua më tregon se lajmi nga Allahu i vjen nga qielli në Tokë në një pjesë të natës apo ditës dhe unë e besoj atë! Kjo është shumë më e madhe se ajo çfarë po çuditeni ju.”

Pastaj shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O Pejgamberi i Zotit, a u ke thënë njerëzve se mbrëmë natën ke shkuar në Bejtul-Makdis?”

Tha: “Po.”

Ebu Bekri tha: “O Pejgamber i Allahut, ma përshkruaj mua sepse unë kam qenë atje.”

Atëherë Pejgamberi a.s. tha: “Ai po priste, ndërsa unë e shikoja atë (Mexhidi Aksanë).” Pejgamberi a.s. ia përshkruante, ndërsa Ebu Bekri ia konfirmonte: “Të vërtetën ke thënë, unë dëshmoj se ti je i Dërguari i Allahut!”

Kur e mbaroi, Pejgamberi a.s. i tha: “Ti, o Ebu Bekër, me të vërtet je i sinqert (siddiku).” Dhe prej atëherë u quajti “Siddik”.

Transmetohet nga Seid b. Musejib se Pejgamberi a.s. shokëve të tij ua përshkroi Ibrahimin, Musain dhe Isain, të cilët i kishte parë atë natë. U kishte thënë:

“Nuk kam parë njeri më të ngjashëm me mua sesa Ibrahimimi, as unë nuk i përngjaj dikujt më tepër se atij, ndërsa Musai ishte zeshkan, i gjatë, i hollë, kaçurrel, hundëshqiponjë, si të ishte një nga njerëzit e fisit Shenu'e. Isai, biri i Merjemes, ishte njeri me çehre të bardhë, me trup me gjatësi mesatare, me flokë të buta, me shumë lytha në fytyrë, sikur të kishte dalë nga banja dhe sikur nga koka pikon ujë. Ndër ju më i ngjashëm me të është Urve b. Mesud Thekafiu.”

## TREGIMI I MIRAXHIT

Ibni Is'haku ka thënë:

“Më ka treguar mua ai për të cilin nuk kam asnjë dyshim, se atij Ebu Seid Hudriu r.a. i ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë:

*“Pasi përfundova gjithçka në Bejtul-Makdis, fillova Miraxhin. Unë kurrë nuk kam parë ndonjë gjë më të bukur se ai! Tek ai i vdekuri e ngulit shikimin në shtratin e vdekjes. Atje më ngriti miku im dhe më çoi deri te një derë e qiellit, e cila quhet Babu-l-Hafedha. Në të qëndron një engjëll me emrin Ismail, kurse nën dorën e tij qëndrojnë dymbëdhjetë mijë engjëj. Nën duart e secilit prej tyre ka nga dymbëdhjetë mijë engjëj të tjerë!”* Pastaj Pejgamberi a.s. lexoi: “... E ushtrinë e Zotit tënd nuk e di kush pos Atij...!”

Kur më shpiu mua, tha: “Kush është ky, o Xhibril?” Tha: “Ky është Muhamedi.”

I thanë: “A është dërguar tashmë?!” Tha: “Po.” Tha: “Pastaj nga Allahu kërkoi çdo të mirë.

Kur hyra në qiellin e dunjasë, pashë një njeri të ulur të cilit i ekspozoheshin shpirtrat njerëzorë. Për disa prej tyre, kur i ekspozoheshin, thoshte: “I mirë!”, gëzohej shumë dhe thoshte: “Shpirti i mirë ka dalë nga trupi i mirë!” Ndërkaq, për disa të tjerë, kur i ekspozoheshin para tij thoshte: “Off!”, mrrolej në fytyrë dhe thoshte: “Shpirti i keq ka dalë nga trupi i keq!”

Unë i thashë: “Kush është ky, o Xhibril?”

Tha: “Ky është stërgjyshi juaj Ademi! Atij i ekspozoheshin shpirtrat e pasardhësve të tij. Dhe kur kalonte para tij shpirti i besimtarit, ai gëzohej dhe thoshte: “Shpirti i mirë ka dalë nga trupi i mirë!” Ndërsa kur kalonte para tij shpirti i jobesimtarit, psherëtinte, e përçmonte dhe pa disponim thoshte: “Shpirti i keq ka dalë nga trupi i keq!”

Pastaj unë pashë njerëz të cilët buzët i kishin si turinj të deveve. Në duar mbanin copa zjarri, me madhësi të guralecëve të cilat i futnin në gojë dhe ato u dilnin jashtë nga prapa. Unë i thashë: “Kush janë këta, o Xhibril? Tha: “Këta janë ata të cilët padrejtësisht kanë ngrënë pasurinë e jetimëve.”

Pastaj unë pashë njerëz me stomakë tejet të mëdhenj, që nuk kisha parë kurrë, para tyre kalonin ithtarët e Faraonit dhe përderisa ata i digjte zjarri i xhehenemit, këta shkelnin mbi ta si deve të etura. Ata i shkelnin, kurse këta nuk ishin në gjendje të lëvizin nga vendet e tyre. Thashë: “Kush janë këta, o Xhibril?” Tha: “Këta janë ata që hanin kamatën.”

Pastaj pashë njerëz para të cilëve kishte mish të majmë e të freskët, ndërsa pranë tyre kishte mish të lig e të qelbur. Ata hanin nga mishi i lig e i qelbur, ndërsa e linin mishin e majmë dhe të freskët. Thashë: “Kush janë këta, o Xhibril?” Tha: “Këta janë ata të cilët i kanë lënë gratë që Allahu ua ka lejuar dhe kanë shkuar tek ato që Allahu ua ka ndaluar!”

Pastaj pashë gra të varura për gjirin e tyre. Thashë: “Kush janë këto, o Xhibril?” Tha: “Këto janë gratë të cilat burrave të vet u kanë mveshur fëmijët e huaj!”

Pastaj më ngritën në qiellin e dytë, aty takova dy djem teze mes tyre: Isain, birin e Merjemës dhe Jahjanë birin e Zekerijas.

Pastaj më ngritën në qiellin e tretë. Aty ishte një njeri shumë i bukur si hëna e plotë. Thashë: “Kush është ky, o Xhibril?” Tha: “Ky është vëllai yt Jusufi biri i Jakubit.”

Ndërkaq, për qiellin e katërt është transmetuar në hadithe të tjera se ai kishte takuar Idrisin a.s..

“Pastaj më ngritën në qiellin e pestë. Aty ishte një njeri me moshë mesatare, me kokë e mjekër të bardhë e të gjatë. Asnjëherë nuk kam parë njeri më të bukur! Thashë: “Kush është ky, o Xhibril?” Tha: “Ky është i preferuari i popullit të tij, Harun ibn Imrani.”

Pastaj më ngritën në qiellin e gjashtë. Aty ishte një njeri zeshkan, i gjatë hundëshqiponjë, si të ishte nga fisi Shenu’e. I thashë atij: “Kush është ky, o Xhibril?” Tha: “Ky është vëllai yt Musa ibn Imrani.”

Pastaj më ngritën në qiellin e shtatë. Aty ishte një njeri me moshë mesatare, i cili ishte i ulur në një karrige në derë të Bejtul-Ma’mūrit (“shtëpi e banuar”). Aty hyjnë çdo ditë nga shtatëdhjetë mijë engjëj dhe nuk kthehen në të deri në Ditën e Gjykimit. Nuk kam parë njeri më të ngjashëm me mua sesa ai, as unë nuk i përngjaj dikujt më tepër se atij. Thashë: “Kush është ky, o Xhibril?” Tha: “Ky është stërgjyshi yt Ibrahim.”

Pastaj më futën në xhenet. Aty pashë një vajzë të re me buzë të kuqe të errëta. E pyeta atë: “Për kë je ti? - sepse më magjepsi kur e pashë. Ajo më tha: “Unë jam për Zejd bin Harithen.”

Pejgamberi a.s. pastaj e përgëzoi me këtë lajm Zejd b. Harithen.

Pastaj Pejgamberi a.s. tha: “Pastaj unë u ktheva. Kur kalova pranë Musa b. Imranit, sa mik i mirë që ishte! Ai më pyeti: “Sa namaze të janë urdhëruar?” I thashë: “Nga pesëdhjetë namaze në ditë.” Tha: “Vërtet namazi është i vështirë, ndërsa populli yt është i dobët, kthehu te Zoti yt dhe kërko që të ta lehtësojë ty dhe popullit tënd!” Dhe unë u ktheva dhe kërkova nga Zoti im të ma lehtësojë mua dhe popullit tim. Dhe Ai ma pakësoi me dhjetë. Pastaj kur u ktheva dhe kalova pranë Musait, ai përsëri më tha të njëjtën gjë. Unë përsëri u ktheva dhe e luta Zotin dhe ai ma pakësoi edhe me dhjetë. Ai vazhdimisht më thoshte të njëjtën, sa herë që kthehesha tek ai. Më tha: “Kthehu dhe lutu!” Derisa namazet e mia u reduktuan në pesë namaze brenda ditës dhe natës. Pas kësaj, kur u ktheva tek ai, ai përsëri më tha të njëjtën gjë. I thashë: “Unë u ktheva te Zoti im dhe e luta derisa u turpërova prej Tij, më nuk mund ta bëj dot!”

Kush nga ju i kryen këto pesë namaze, me bindje dhe me vëmendje ndaj tyre, do të ketë shpërblimin sa pesëdhjetë namaze të urdhëruara!”

## VDEKJA E EBU TALIBIT DHE E HATIXHESË

Hatixhe bint Huvejlidi dhe Ebu Talibi vdiqën në të njëjtin vit.

Me vdekjen e Hatixhesë, Pejgamberit a.s. filluan t'i paraqiten vështirësi të ndryshme. Në fakt, ajo ishte ndihmësja e tij kryesore për Islamin, asaj i besonte të gjitha shqetësimet e tij. Edhe vdekja e xhaxhait të tij, Ebu Talibit, ishte humbje e madhe për të. Ai ishte një mbështetje e fortë dhe strehim për misionin e tij, njëherazi ai e mbronte dhe ndihmonte kundër popullit të tij. Kjo ndodhi tre vjet para migrimit të tij në Medinë.

Pas vdekjes së Ebu Talibit, Kurejshët i intensifikuan armiqtë e tyre kundër Pejgamberit a.s. dhe filluan t'i kurdisin komplete të ndryshme, të cilat gjatë jetës së Ebu Talibit nuk kishin guxuar. Ata shkuan deri në atë masë sa që një nga primitivët e Kurejshëve një herë i hodhi pluhur mbi kokë dhe ashtu me pluhur në kokë Pejgamberi a.s. hyri në shtëpinë e tij. Njëra nga vajzat e tij ia lante pluhurin nga koka dhe qante. Pejgamberi a.s. i tha asaj: *"Mos qaj, o bija ime, me të vërtetë Allahu do ta mbrojë babanë tënd!"* Më pas ai tha: *"Kurejshët nuk më kanë bërë asgjë të keqe derisa vdiq Ebu Talibi."*

Pasi Ebu Talibin e kaploi sëmundja, Kurejshët filluan të flasin me njëri-tjetrin: *"Hamza dhe Umeri e përqaftuan Islamin, feja e Muhamedit ka arritur në të gjitha fiset e Kurejshëve, ndaj ejani të shkojmë tek Ebu Talibi, le ta thërrasë djalin e vëllait të tij dhe t'i japë garancitë tona. Vallahi, nuk jemi të sigurt, ndoshta ai ka për të pasur epërsi mbi ne!"*

Ibn Abbasi ka thënë: *"Ata shkuan tek Ebu Talibi dhe biseduan me të. Të gjithë ishin nga paria e popullit, si: Utbe b. Rebia, Shejbe b. Rebia, Ebu Xhehl b. Hisham, Umejje b. Halef dhe Ebu Sufjan b. Harb. Ata i thanë atij: "O Ebu Talib, ti e di se çfarë pozite ke te ne dhe siç po sheh, ne jemi të shqetësuar për gjendjen tënde. Gjithashtu, ti i di raportet tona me djalin e vëllait tënd. Thirre atë dhe jepi garancitë tona e njëherazi merr garanci për ne, që të na lërë rehat, edhe ne do ta lëmë atë. Ai të mos merret me fenë tonë dhe ne nuk do të merremi me fenë e tij."*

Pastaj Ebu Talibi e thirri Pejgamberin a.s. dhe i tha: *"O djali i vëllait, paria e popullit tënd janë tubuar për të të dhënë garanci dhe për të marrë garanci nga ti."*

Pejgamberi a.s. tha: *"Në rregull, le të më japin vetëm një fjalë, me të cilën do t'i fitojnë të gjithë arabët e do t'i pranojnë edhe të huajt."*

Ebu Xhehli tha: *"Po, për babanë tënd, jo një por dhjetë!"*

Pejgamberi a.s. tha: *"Thoni: La ilahe il-Allah dhe largohuni nga adhurimi i tjetërkujt përveç Atij!"*

Ata duartrokitën e pastaj thanë: “A po do ti o Muhamed që ne zotat tonë t’i reduktojmë në një zot? Vërtet çështja jote është e çuditshme!” Pastaj i thanë njëri-tjetrit: “Vallahi, ky njeri me siguri nuk do t’ju japë atë që jeni duke kërkuar! Shkoni e vazhdoni të ndiqni fenë e etërve tuaj derisa Allahu të vendosë midis jush dhe atij!”

Pastaj ata u larguan, ndërsa Ebu Talibi i tha Pejgamberit a.s.: “Vallahi, o djali i vëllait, ti nuk kërrove shumë prej tyre!” Kur Ebu Talibi e tha këtë, Pejgamberi a.s. shpresoi se ndoshta mund ta pranonte Islamin, ndaj i tha:

*“O xhaxhai im, thuaji këto fjalë, në Ditën e Gjykimit ato do të të mundësojnë ndër-mjetësimin (shefa’atin)!”*

Duke parë dëshirën e madhe të Pejgamberit a.s., ai tha: “O djali i vëllait, po të mos kisha frikë se do të fyhesh ti dhe pasardhësit e babait tënd pas meje dhe se Kurejshët do të mendojnë se e kam thënë nga frika e vdekjes, vërtet do t’i kisha thënë. Kështu, mund t’i shqiptoj vetëm për të të kënaqur ty!”

Kur Ebu Talibit iu afrua vdekja, Abbasi e vërejti atë duke lëvizur buzët. Ia vuri veshin mirë, pastaj tha: “O djali i vëllait, vallahi, vëllai im e shqiptoi atë fjalën që e urdhërove të thoshte!”

Pejgamberi a.s. tha: “Nuk e dëgjova!”

Allahu i Madhërishëm në lidhje grupin që u mbledhën tek Ebu Talibi dhe thanë çfarë thanë mes tyre shpalli:

*“Sad. Pasha Kur’anin që është përplot përkujtime (është i famshëm dhe s’ka dyshim se është mrekulli). Por ata që nuk besuan janë në kryeneçësi e kundërshtim. Sa gjenerata para tyre i kemi asgjësuar, të cilët u lutën për shpëtim, po nuk ishte koha e shpëtimit. Ata (idhujtarët) habiten, ngase u erdhi Pejgamberi nga mesi i tyre e jobsimtarët thanë:*

*“Ky është magjistar, rrenës. A mendon ai t’i bëjë zotat një Zot? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme!” Paria nga mesi i tyre shkoi duke i thënë njëri-tjetrit: “Vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adhurimin e zotave tuaj, pse kjo është një gjë e kurdisur. Ne nuk kemi dëgjuar diçka të këtillë në popullin (në fenë) e fundit;- këtu mendohet për të krishterët të cilët thonë: “Allahu është i treti i të treve”- kjo nuk është tjetër, pos një trillim!” (Sad, 1-7)*

Pastaj Ebu Talibi dha shpirt.

## PEJGAMBERI a.s. SHKON TE FISI THEKIF PËR TË KËRKUAR NDIHMË

Pas vdekjes së Ebu Talibit, Kurejshët e intensifikuan armiqësinë e tyre kundër Pejgamberit a.s. dhe filluan t'i shkaktonin vuajtje të ndryshme, ndërsa kur ishte gjallë Ebu Talibi nuk kishin guxuar. Pejgamberi a.s. doli për në Taif për të kërkuar ndihmë nga fisi Thekif, që ta mbronin nga populli i tij. Ai shpresoi se ata do ta pranonin shpalljen që i vinte nga Allahu i Madhërishëm. Në Taif u nis i vetëm.

Kur mbërriti Pejgamberi a.s. në Taif, iu drejtua një grupi të fisit Thekif, të cilët ishin personalitete të shquara të fisit. Ata ishin vëllezërit Abd Ja'lil b. Amër b. Umejr, Mesud b. Amër b. Umejr dhe Habib b. Amër b. Umejr. Njëri prej tyre kishte një grua kurejshite nga fisi Benu Xhume. Pejgamberi a.s. u ul me ta dhe i ftoi në Islam. Ai iu shpjegoi atyre se kishte ardhur tek ata që ta ndihmonin rreth Islamit dhe t'i dilnin në ndihmë kundër atyre që e kundërshtonin nga populli i tij.

Njëri prej tyre i tha: "Unë do ta heq mbulesën e Qabesë nëse ty vërtet të ka dërguar Allahu!"

I dyti tha: "A nuk gjeti Allahu tjetërkënd për të dërguar, por të gjeti ty?!"

I treti tha: "Vallahi, unë nuk do të flas fare me ty! Nëse je me të vërtetë i Dërguar i Allahut siç po thua, atëherë ti je shumë i rrezikshëm që unë të përgjigjem, por në qoftë se po gënjen për Allahun, atëherë nuk më ka hije të flas me ty!"

Atëherë Pejgamberi a.s. u ngrit prej tyre, pastaj u tha: "*Vepruat çfarë vepruat me mua, atëherë mos flisni për këtë!*" Në fakt, ai nuk dëshironte që ta merrte vesh populli i tij, sepse pastaj kjo do t'i trimëronte edhe më shumë.

Ata megjithatë nuk e dëgjuan, por përkundrazi, i nxitën horrat dhe sklevërit e tyre duke sharë dhe bërtitur pas tij, kështu që aty së shpejti u mblodhën shumë njerëz.

Disa e strehuan në një kopsht që i përkiste Utbe b. Rebias dhe Shejbe b. Rebias, të cilët ndodheshin aty. Vagabondët e Thekifit u kthyen, ndërsa ai shkoi dhe u ul nën hije të një hardhie rrusi afër një muri, ndërkohë që dy djemtë e Rebias, të cilët kishin qenë dëshmitarë të gjithë asaj çfarë i kishte ndodhur nga vagabondët e popullit të Taifit, po e vështronin.

Pejgamberi a.s. takoi atë gruan nga Benu Xhumehi dhe i tha: "*Shiko se çfarë na gjeti nga farefisi yt!*"

Pasi u qetësua, siç më është thënë, Pejgamberi a.s. tha:

*"O Allahu im, Ty po të ankoem dhe po ta parashtroj dobësinë time dhe poshtërimin në sy të njerëzve! O më mëshiruesi i mëshiruesve! Ti je Zot i të pafuqishmëve dhe të varfërve, Ti je Zoti im. Në dorë të kujt po më lë mua? Në dorë të të huajve që më hedhin*

*jashtë apo në dorë të armiqve, që më mundojnë në qytetin tim? Nëse nuk do të më ndëshkosh mua, nuk u kushtoj rëndësi vuajtjeve e ngatërresave që po heq!*

*Le të jetë mëshira Jote me mua. Unë kërkoj mbrojtje në dritën Tënde. Ti je Ai i Cili e zhdruk errësirën nga bota, u dhuron paqen të gjithëve në këtë botë dhe në tjetrën. Mos lejo, që hidhërimi dhe zemërimi Yt të bien mbi mua. Nuk ka fuqi dhe mbrojtje në botë, përveç Teje."*

Kur e panë dy djemtë e Rebias, Utbe dhe Shejbe, se çfarë përjetoi, ndjenë keqardhje. Ata e thirrën robin e tyre, djaloshin e krishterë me emrin Addas, dhe i thanë:

"Vendos një kalavesh rrushi në pjatë dhe çoja atij njeriu atje dhe thuaji të hajë!"

Addasi e bëri këtë, pastaj shkoi dhe e vendosi para Pejgamberi a.s. dhe i tha: "Ha!"

Duke e zgjatur dorën drejt pjatës, Pejgamberi a.s. tha: "*Bismil-lahi (me emrin e Allahut)* dhe pastaj filloi të hajë.

Addasi e shikoi në fytyrë, pastaj tha: "Vallahi, këto fjalë nuk i thonë banorët e këtij vendi!"

Pejgamberi a.s. e pyeti: "*Nga cili vend je ti o Addas dhe çfarë besimi ke?*"

Ai u përgjigj: "Unë jam i krishterë nga Niniva."<sup>55</sup>

Pejgamberi a.s. tha: "*Ti qenke nga fshati i njeriut të mirë Junus b. Mettes!*"

Addasi e pyeti: "A e di ti se kush ishte Junus b. Metta?"

Pejgamberi a.s. u përgjigj: "*Ai është vëllai im. Ai ishte Pejgamber, edhe unë jam Pejgamber!*"

Addasi u kërrus dhe ia puthi kokën, duart dhe këmbët e Pejgamberit a.s.!

Njëri nga bijtë e Rebias i thotë tjetrit: "Ai atje ta prishi djaloshin!"

Kur Addasi erdhi tek ata, ata i thanë: "Vaj për ty, o Addas! Pse ia puthe atij njeriu kokën, duart dhe këmbët?"

Addasi tha: "O zotëri, ky njeri është person që nuk ekziston sot në Tokë. Ai më tregoi diçka që nuk mund ta dijë askush që nuk është Pejgamber!"

Që të dy i bërtitën: "I mjeri ti, o Addas! Nga feja jote do të të fusë në fenë e vet, e feja jote është më e mirë se e tij!"

<sup>55</sup> Niniva, fshat afër Mosulit, në Irak.

## XHINËT NGA NASIBINA

Pejgamberi a.s. pastaj nga Taifi u nis për t'u kthyer në Mekë, duke e humbur shpresën për ndonjë e mirë nga fisi Thekif. Kur arriti në vendin Nahle<sup>56</sup>, natën vonë u ngrit për t'u falur. Në atë moment aty kaloi një grup xhinësh, të cilët i ka përmendur Allahu i Madhërishëm – siç më është thënë – ata ishin shtatë grupe nga Nasibina<sup>57</sup>. Ata u ndalën dhe dëgjonin leximin e Kur'anit. Ndërsa kur e përfundoi namazin, nxituan te populli i tyre për ta paralajmëruar - ata besuan në atë që dëgjuan dhe iu përgjigjën thirrjes e cila iu drejtua.

Lajmin e tyre Allahu i Madhërishëm ia përcolli Pejgamberin a.s. përmes Kur'anit:

*“(Përkujto) Kur disa prej xhinëve u drejtuam te ti që të dëgjojnë Kur'anin dhe kur u afruan dhe e dëgjuan atë, thanë: “Heshtni!” dhe kur u krye, u kthyen te populli i vet dhe e këshilluan. Thanë: “O populli ynë, ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë para tij, që udhëzon në të vërtetën dhe në rrugën drejtë!” O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besoni atij! Ai ju fal mëkatet tuaja dhe ju shpëton prej një dënimi plot vuajtje.” (El-Ahkaf, 29-31)*

Gjithashtu ka thënë:

*“Thuaj: “Mua më shpallet se një grup i vogël nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur'anin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: “Ne kemi dëgjuar një Kur'an që mahnit...”, deri në fund të rrëfimit për ta, në suren El-Xhinn.*

<sup>56</sup> Nahle, njëra nga dy luginat, një natë udhëtimi larg nga Meka. Njëra quhet Nahle Shamije, kurse tjetra Nahle Jemanije.

<sup>57</sup> Nasibin është qytet në rajonin e Gadishullit, që gjendet në rrugën e karvanit nga Mosuli për në Siri.

## SHFAQJA E PEJGAMBERIT a.s. PARA FISEVE

Pejgamberi a.s. pastaj erdhi në Mekë, ndërsa populli i tij shprehte kundërshtim të ashpër ndaj tij dhe besimit të tij, me përjashtim të një grupi të vogël të pafuqishëm të cilët i kishin besuar. Prandaj, Pejgamberi a.s. me rastin e ceremonive që mbaheshin kohë pas kohe, dilte para fiseve arabe dhe u bënte thirrje në fenë e Allahut. I njoftonte ata se ai është Pejgamber i dërguar, kështu që kërkonte prej tyre që të besojnë tek ai dhe ta marrin në mbrojtje derisa ai t'u shpjegojë atyre atë për të cilën e ka dërguar Allahu.

Rebia b. Ubad ka thënë:

- Unë kam qenë djalë i ri dhe isha në Minë me babanë tim. Pejgamberi a.s. qëndronte në vendin ku zbritnin fiset arabe dhe u thoshte: *“O bijtë e filan fisi, vërtet unë jam i Dërguar i Allahut te ju, ju porosis që ta adhuronit Allahun dhe të mos i shoqëroni Atij asgjë, të më besoni mua dhe të më mbrojnë derisa ta zbatoj atë me të cilën më ka dërguar Allahu.”*

Pas tij shkonte një njeri i vëngër, por i rregulluar, i cili i kishte dy gërsheta me një pelerinë adenase. Kur Pejgamberi a.s. e përfundonte ligjërimin e tij, ky njeri thoshte: *“O bijtë e filan fisi, ky dëshiron prej jush që ta braktisni Latin dhe Uzzan, të hiqni dorë nga aleatët tuaj Benu Malik b. Ukajsh<sup>58</sup> dhe t'u besoni atyre gjërave të reja dhe mashtruese që ka sjellë. Prandaj mos e dëgjoni dhe mos iu bindni atij!”*

Unë i thashë babait: *“Kush është ky që po e ndjek dhe po u përgjigjet fjalëve të tij?”* Tha: *“Ky është xhaxhai i tij, Abduluzza b. Abdulmuttalib, Ebu Lehebi.”*

Ibni Is'haku ka thënë:

*“Na ka treguar Ibni Shihab Zuhriu se Pejgamberi shkoi te Benu Kindet, në krye të cilëve ishte njëfarë Mulejhi dhe i ftoi ata ta besojnë Allahun dhe ta pranojnë atë, por ata e refuzuan.*

Pastaj shkoi te Benu Amir b. Sa'sa'a, të cilët i ftoi ta besojnë Allahun dhe ta pranojnë atë. Një njeri prej tyre i quajtur Bejhare b. Firas, tha: *“Vallahi, sikur ta merrja këtë të ri Kurejsh, me të arabët do t'i haja të gjallë!”* Pastaj, ai shtoi: *“Çfarë mendon o Muhamed, nëse ne ty të njohim dhe të pranojmë, e pastaj Allahu të ndihmon e i mposht kundërshtarët, a do të kemi ne pushtet pas teje?”*

Tha: *“Pushtet ka Allahu, Ai jep ku dëshiron!”*

Ai tha: *“Domethënë ne vihemi në shënjestër të arabëve, kështu që kur të bëjë të fortë Allahu, pastaj pushteti u takon të tjerëve?! Një gjë e tillë nuk na nevojitet.”* Dhe e refuzuan.

<sup>58</sup> Kjo është një lagje xhinësh, së cilës i përshkruhen Devetë e Ukajshit. Këto deve janë të egra dhe ikin nga çdo gjë.

Kur u kthyen në shtëpitë e veta, i treguan prijësit të tyre, i cili për shkak të pleqërisë nuk mund të shkonte në panaire. Kështu që ata kur ktheheshin prej andej, shkonin tek ai dhe i tregonin për çdo gjë që kishin parë atje. Kur erdhën tek ai atë vit dhe ata pikërisht ishin kthyer nga haxhi, ai i pyeti çfarë kishte ndodhur aty. Ata i thanë: “Na erdhi një i ri nga fisi Kurejsh, prej Benu Abdulmuttalibit, i cili veten e konsideronte si Pejgamber. Na thirri që ta mbrojmë dhe ta marrim me vete në vendin tonë!”

Plaku u kap për koke, pastaj tha: “O bijtë e Amirit, a mundet kjo disi të kompensohet!? Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, diçka të tillë kurrë nuk do të trillonte një ismailit (me origjinë nga Ismaili). Ai ka folur të vërtetën. Ku e keni pasur mendjen?”

Është transmetuar nga Abdullah b. Ka'b se Pejgamberi a.s. ka shkuar te Benu Hanifet, të cilët i ftoi ta besojnë Allahun dhe ta pranojnë atë, por askush prej arabëve nuk e ka refuzuar më vrazhdë se ata.”

Megjithatë, Pejgamberi a.s. i vazhdonte përpjekjet e tij. Sa herë që tuboheshin njerëzit për ndonjë festë, ai shkonte dhe i ftonte fiset që ta besojnë Allahun e ta pranojnë Islamin, ua prezantonte udhëzimin dhe mëshirën që i kishin ardhur nga Allahu. Ai çdo arabi të famshëm dhe të respektuar që vinte në Mekë, i dilte përpara dhe e ftonte që të besonte Allahun dhe ta pranonte atë!

Kështu kishte ardhur në Mekë për haxh apo umre Suvejd bin Samit nga fisi i Beni Amër b. Avf. Kur dëgjoji për të, Pejgamberi a.s. menjëherë shkoi për ta kërkuar.

Kur ai e ftoi në Islam, ky u përgjigj: “Ndoshta ajo që posedon ti është e njëjtë me atë që posedoj unë!”

Kurse Pejgamberi a.s. i tha: “E çka posedon ti?” Ai tha: “Urtësinë e Lukmanit!” Pejgamberi a.s. i tha: “Më thuaj çka di!” Dhe ai i tha atë që dinte.

Pejgamberi a.s. tha: “Vërtet ky fjalim është i bukur, por ajo që posedoj unë është më e vlefshme se kjo, unë kam ajetet kur'anore të cilat m'i ka shpallur Allahu i Plotfuqishëm. Ai është udhëzim dhe dritë.” Pastaj Pejgamberi a.s. i lexoi një pjesë nga Kur'ani dhe e thirri në Islam dhe nuk u largua prej tij. Kurse ai tha: “Vërtet këto janë fjalë të mrekullueshme!” Pastaj ai u largua. Së shpejti u kthye te populli i tij në Medinë, por pak pas kësaj u vra nga fisi Hazrexh.

Populli i tij për të thonë: “Ne mendojmë se ai është vlarë si musliman.”

Vrasja e tij kishte ndodhur para luftës midis Evsit dhe Hazrexhit, e cila u zhvillua në Buath, në njërën anë të Medinës.

## FILLIMI I ISLAMIT TË ENSARËVE

Kur Allahu i Madhërishëm vendosi që ta shfaqë fenë e Tij e ta forcojë Pejgamberin e Tij, duke ia përmbushur premtimin, në sezonin e haxhit Pejgamberi a.s. u takua me një grup ensarësh. Ai edhe në këtë sezon ua prezantoi veten fiseve arabe, siç bënte edhe më parë, dhe kur ishte në Akabe<sup>59</sup>, u takua me një grup njerëzish nga fisi Hazrexh, të cilëve Allahu dëshiroi t'u japë një të mirë të madhe<sup>60</sup>.

Kur i takoi Pejgamberi a.s., u tha atyre: *"Kush jeni ju?"*

Ata thanë: *"Ne jemi një grup nga Hazrexhi."*

Pejgamberi a.s. tha: *"A jeni aleatë të hebrenjve?"*

Thanë: *"Po."* Ai tha: *"A doni të ulemi të bisedojmë?"* Thanë: *"Po."*

Pastaj u ulën dhe Pejgamberi a.s. i ftoi të besojnë në Allah, ua prezantoi Islamin dhe u lexoi Kur'an.

Një nga arsytet që ata shpejt e pranuan Islamin ishte se në vendin e tyre jetonin hebrenjtë, të cilët ishin trashëgimtarë të shpalljes dhe diturisë, ndërsa këta ishin idhujtarë dhe adhuronin idhujt. Ndonjëherë mes tyre kishte edhe konflikte. Dhe kur ndodhte një gjë e tillë, hebrenjtë u thoshin atyre:

*"Së shpejti do të shfaqet një Pejgamber, koha e tij tashmë ka ardhur. Ne do ta pasojmë dhe së bashku me të do t'ju luftojmë juve, ashtu siç është luftuar populli i Adit dhe Iremit!"*

Kur Pejgamberi a.s. bisedoi me këtë grup dhe i ftoi të besojnë në Allahun, ata biseduan mes vete:

*"Ky, vallahi, është ai Pejgamberi me të cilin hebrenjtë po na kërcënojnë. Ata në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë më të shpejtë se ne!"*

Kështu ata iu përgjigjën thirrjes së tij dhe i premtuan se do t'i besojnë të gjitha dhe do ta pranojnë komplet Islamin të cilin ai ua paraqiti. Ata thanë:

*"Vërtet, ne kemi lënë pas popullin tonë, në mesin e të cilit mbretëron një armiqësi dhe e keqe e paparë që nuk ekziston në asnjë popull tjetër. Ndoshta Allahu do t'i bashkojë ata përmes teje. Ne edhe ata do t'i ftojme dhe do t'ua sqarojmë këtë fe që kemi pranuar prej teje. Nëse ata i bashkon Allahu me ty, nuk do të ketë njeri më të nderuar sesa ti!"*

Pastaj ata u ndanë nga Pejgamberi a.s. për t'u kthyer në vendet e tyre, por tanimë si anëtarë të fesë së re. Me aq sa kam dituri, ata ishin gjashtë persona nga fisi Hazrexh.

<sup>59</sup> Akabe është vend mes Minës dhe Mekës. Është larg nga Meka rreth dy milje. Prej aty hidhen gurët e Akabesë.

<sup>60</sup> Kjo ndodhi në vitin e 11 të pejgamberisë.

Kur arritën në Medinë te populli i tyre, ata u folën për Pejgamberin a.s. dhe u bënë thirrje në Islam. Lajmi u përhap jashtëzakonisht shpejt dhe nuk mbeti gati asnjë shtëpi në të cilën nuk përmendej Pejgamberi a.s..

## BESËLIDHJA E PARË NË AKABE

Një vit më pas, në haxh erdhën 12 burra nga ensarët dhe u takuan me Pejgamberin (a.s.) në Akabe. Ishte ky takimi i parë në Akabe, në të cilin Pejgamberit a.s. i dhanë betimin e besnikërisë sikurse betimi i grave<sup>61</sup>. Kjo kishte ndodhur para se të përcaktohej lufta. Në këtë grup ndër të tjerët ishin edhe: Esad b. Zurare, Rafi b. Malik, Ubade b. Samit dhe Ebu Hejthem b. Tejjehan.

Nga Ubade b. Samit transmetohet se ka thënë:

“Isha në mesin e atyre që morën pjesë në Besëlidhjen e Parë në Akabe. Ishim 12 veta. I dhamë besë Pejgamberit a.s. sikurse besa e grave. Kjo ndodhi para se të përcaktohej lufta. U betuam se nuk do t’i shoqërojmë Allahut asnjë rival, nuk do të vjedhim, nuk do të bëjmë prostitucion, nuk do t’i vrasim fëmijët tanë, nuk do të përhapim shpifje në mes nesh dhe se nuk do të jemi të padëgjueshëm në asnjë të mirë.”

Ai na tha: *“Në qoftë se ju i përmbani kësaj, do të keni xhenetin, por nëse tradhtoni për ndonjë prej këtyre, çështja juaj i kalon Allahut të Madhërishëm. Nëse do, ju dënon, e nëse do, ju fal.”*

Ibni Is'haku thotë:

Pasi u larguan njerëzit prej tij, Pejgamberi a.s. me ta dërgoi Musab b. Umejr b. Hashim b. Abdi Menafin dhe e urdhëroi që t’ua lexojë Kur’anin, t’ua mësojë dispozitat e Islamit dhe t’i udhëzojë në zbatimin e fesë. Për këtë arsye ai në Medinë u quajt mukri’ (mësues).

Ai u printe edhe në namaz sepse pjesëtarët e fisit Evs dhe Hazrexh nuk dëshironin që t’u printe dikush që ishte nga njëri apo nga fisi tjetër.

<sup>61</sup> Do të thotë në mënyrë të njëjtë. Betimi i grave ka ndodhur në ditën e dytë të çlirimit të Mekës, në kodrën Safa, pas betimit të burrave.

## BESËLIDHJA E DYTË NË AKABE

Pastaj Musab b. Umejri u kthye në Mekë. Në këtë haxh në Mekë kishin ardhur edhe disa muslimanë ensarë, së bashku me haxhilerët e tjerë nga populli i tyre, të cilët ishin ende idhujtarë. Kur arritën në Mekë, ata i premtuan Pejgamberit a.s. se do të gjenden në Akabe në ditën e mesme të tharjes (ejjamut-teshrik)<sup>62</sup>, dita në të cilën Allahu ua shprehu atyre nderin e Tij duke e ndihmuar Pejgamberin e Tij dhe duke e forcuar Islamin dhe muslimanët.

Kab b. Malik ka thënë:

“Ne u nisëm me haxhinjtë e popullit tonë, të cilët ishin idhujtarë. Ne u falëm dhe e kuptuam fenë. Me ne ishte edhe Bera b. Marur, i pari dhe fisniku ynë. Kur u nisëm për rrugë dhe dolëm nga Medina, Berau na tha: “A e dini çfarë? Unë kam menduar një gjë, por nuk e di se a do të pajtoheni me mua apo jo.” I thamë: “Çfarë është?” Tha: “Unë po mendoj që këtë ndërtesë –d.m.th. Qabenë- mos ta lë pas shpine, por të kthehem nga ajo gjatë faljes.” Ne i thamë: “Me sa dimë, Pejgamberi a.s., kur falet, kthehet në drejtim të Shamit<sup>63</sup> dhe ne nuk duam që ta kundërshtojmë.” Tha: “Unë, megjithatë, do të kthehem nga ajo!” Ne i thamë: “Kurse ne nuk do ta bëjmë atë gjë!”

Dhe kështu kur hynte koha e namazit ne faleshim në drejtim të Shamit, kurse ai në drejtim të Qabesë. Ne e qortuam për këtë, por ai nuk u tërhoq nga vendimi i tij. Kur arritëm në Mekë, ai më tha: “O djali i vëllait tim, eja me mua tek i Dërguari a.s. dhe ta pyesim për veprimin tim gjatë rrugës sepse vallahi unë nuk po ndihem i qetë pasi ju vepruat ndryshe.”

Tha: “Dhe ne dolëm për ta kërkuar Pejgamberin a.s. ndonëse nuk e njihnim dhe nuk e kishim parë ndonjëherë më parë. Gjatë rrugës takuam një burrë nga Meka dhe e pyetëm për të Dërguarin a.s.. Ai na tha: “A e njihni ju të dy atë?” Ne i thamë: “Jo.” Tha: “Po Abbasin, a e njihni? Abbas b. Abdulmuttalibin, xhaxhanë e tij?” Thamë: “Po, sepse ne e njihnim Abbasin, ai ishte tregtar.” Tha: “Kur të hyni në xhami, është ai burri i ulur me Abbasin. Dhe ne hymë në xhami, ku pamë Abbasin ulur, e me të ishte edhe Pejgamberi a.s.. Ne u dhamë selam dhe u ulëm me ta. Pejgamberi a.s. i tha Abbasit: “A po i njeh këta të dy, o *Ebul-Fadl*?”

Tha: “Po, ky është Bera b. Marur, i madhi i popullit të tij, kurse ky është Kab b. Maliku.”

<sup>62</sup> Ejjamut-teshrik kanë qenë tri ditët pas flijimit (kurbanit). Gjatë atyre ditëve ata e thanin në diell mishin e kafshëve të therura.

<sup>63</sup> Në drejtim të Bejtul-Makdisit, në Jerusalem.

Vallahi, unë kurrë nuk do t'i harroj fjalët që tha Pejgamberi a.s.: *"A je poet?"*

Unë i thashë: *"Po."*

Bera b. Maruri tha: *"O Pejgamber i Allahut, unë kam dalë në këtë udhëtim deri këtu dhe Allahu tashmë më ka udhëzuar në Islam. Mendova që kësaj ndërtese të mos ia kthej shpinën dhe në namaz jam kthyer kah ajo, mirëpo shokët e mi më kanë kundërshtuar dhe unë nuk po ndihem i qetë, ndaj kam dëshirë të më tregosh, o i Dërguari i Allahut, çfarë mendon ti për këtë?"*

Pejgamberi a.s. i tha: *"Ti e kishe kiblen, vetëm të kishe bërë durim dhe t'i ishe përmbajtur asaj!"*

Berau iu kthye sërish kibles së Pejgamberit a.s. dhe së bashku me ne u fal në drejtim të Shamit.

Pastaj filluam ritualin e haxhit. Me Pejgamberin a.s. u patëm marrë vesh që të takoheshim në Akabe ditën e mesme të teshrikut. Kur e përfunduam haxhin dhe erdhi nata kur kishim takim me Pejgamberin a.s., me ne ishte edhe Abdullah b. Amër b. Haram Ebu Xhabiri, njëri nga kryeparët tanë, njeri bujar dhe i nderuar nga populli. E morëm me vete duke e fshehur këtë gjë nga idhujtarët që kishin ardhur me ne. Ne e njoftuam atë për mbledhjen dhe i thamë: *"O Ebu Xhabir, ti je njëri nga kryeparët tanë, je i ndershëm dhe i respektuar. Kemi frikë për ty se nesër do të jesh lëndë djegëse e zjarrit!"* Pastaj e ftuam në Islam dhe e njoftuam për takimin tonë në Akabe me Pejgamberin a.s.. Ai menjëherë e pranoi Islamit dhe së bashku me ne mori pjesë në Akabe, madje ishte prijësi ynë.

Kabi tregon: *"Atë natë ramë të flinim së bashku me haxhilerët e tjerë. Kur kaloi një e treta e parë e natës, u përvodhëm nga çadra një nga një dhe duke përgjuar arritëm në luginën e Akabesë. Ne ishim shtatëdhjetë e tre burra dhe dy gra: Nusejba bint Kab dhe Esma bint Amër b. Adiu<sup>64</sup>.*

U tubuam aty në luginë dhe pritnim ardhjen e Pejgamberit a.s.. Kur ai erdhi, me të ishte edhe xhaxhai i tij Abbas b. Abdulmuttalibi, i cili atëherë ishte ende në besimin e popullit të tij. Megjithatë, ai shprehu dëshirën që të merrte pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme të djalit të vëllait të tij për ta mbështetur atë. Kur u ul, i pari foli Abbas b. Abdulmuttalibi, i cili tha:

*"O populli i Hazrexhit - arabët ensarët i quanin hazrexhas, ku fusnin edhe evsasit – ju e dini mirë se Muhamedi është njeriu ynë. Ne e kemi mbrojtur nga populli ynë. Për të gjitha cilësitë që posedon, ai ka autoritet, por edhe mbrojtjen në mjedisin e vet. Mirëpo, ai nuk dëshiron asgjë prej këtyre, por dëshiron të shpërngulet tek ju dhe t'ju shoqërojë nëse mendoni se ju jeni në pajtim me të dhe me atë që është duke kumtuar. E nëse do ta mbronin nga ata që nuk pajtohen me*

<sup>64</sup> Ibni Is'haku thotë: *"I Dërguari a.s. nuk ua kapte dorën grave, por vetëm i dëgjonte dhe pastaj u thoshte: "Shkoni, e pranova betimin tuaj!"*

të, atëherë përgjegjësinë e merrni mbi vete. Nëse megjithatë, mendoni ta braktisni dhe ta tradhtoni pasi të largohet prej këndeje, unë që tani i them: “Mos shko, ke autoritet, respekt dhe mbrojtje nga njerëzit e tu në vendin tënd!”

Ne i thamë Abbasit: “Dëgjua se çka the ti. Tani fol ti, o Pejgamber i Zotit dhe zgjidh për vetën dhe për Zotin tënd atë që dëshiron.”

Pastaj foli Pejgamberi a.s., lexoi pjesë nga Kur’ani, u bëri thirrje për besim në Allahun, i inkurajoi për Islamin dhe pastaj tha:

*“Prej jush kërkoj besën që do të më mbroni nga të gjitha gjërat nga të cilat mbroni gratë tuaja dhe fëmijët tuaj.”*

Pastaj Bera b. Maruri e mori për dore e tha: “Po, pasha Atë që të dërgoi me të vërtetën, do të të mbrojmë nga të gjitha ato prej të cilave mbrojmë gratë dhe fëmijët tanë! Ta lidhim marrëveshjen o Pejgamber i Zotit, ne vërtet jemi bijtë e luftës, popull që mban armë, që e kemi trashëguar brez pas brezi.”

Derisa Berau i fliste kështu Pejgamberit a.s., ndërhyri Ebu Hejthem b. Tihani, i cili tha: “O i Dërguari i Allahut, mes nesh dhe disa të tjerëve është tendosur litari. Ne dëshirojmë ta presim atë. Ata janë hebrenjtë. A do ta ndërrosh mendimin nëse e bëjmë këtë, të na braktisësh e t’i kthehesh popullit tënd?”

Pejgamberi a.s. duke buzëqeshur tha: “Jeta është jetë e vdekja është vdekje, unë jam i juaji e ju jeni të mitë, do të luftoj kundër atyre që luftoni ju dhe do të jem në paqe me ata me të cilët ju jeni në paqe.”

Ai gjithashtu ka thënë: “Zgjidhni mes jush dymbëdhjetë eprorë që të jenë në ballë të popullit tuaj.” Dhe ata zgjodhën dymbëdhjetë eprorë, prej tyre nëntë nga fisi Hazrexh dhe tre nga Evsi.<sup>65</sup>

I pari që ia zgjati dorën Pejgamberit a.s. dhe i dha besën ishte Bera b. Marur, pastaj shembullin e tij e ndoqën të tjerët.

Kur ne i dhamë besën të Dërguarit a.s., u paraqit shejtani, i cili nga maja e Akabesë me një zë të lartë që nuk është dëgjuar gjer atëherë filloi të bërtasë: “O banorë të Minës, a e doni Mudhemmemin<sup>66</sup> dhe shoqërinë e tij të gjallë? Ja ku janë të gjithë së bashku dhe janë ngritur kundër jush.”

I Dërguari a.s. tha: “Kjo do të thotë fatkeqësi për Akabenë. Ky është Ibn Ezjebi<sup>67</sup>. Shpërndahuni dhe shkoni në kampet tuaja.”

Me atë rast Abbas b. Ubade b. Nadle i tha: “Për Zotin që të ka dërguar me të vërtetën, nëse do ti, nesër do t’i sulmojmë banorët e Minës me shpata.”

<sup>65</sup> Nga Hazrexhi janë zgjedhur: Esad b. Zurare, Sa’d b. Rebij’, Abdullah b. Revaha, Rafi’ b. Malik, Bera b. Marur, Abdullah b. Amër b. Haram, Ubade b. Samit. Kurse nga Evsi ishin: Usejd b. Hudajr, Sa’d b. Hejthema, Rifa’ a Mundhir.

Ibni Hishami ka thënë: Dijetarët në mesin e tyre llogarisin Ebu Hejthem b. Tejhanin në vend të Rifa’as.

<sup>66</sup> Mudhemmem, i qortuar, idhujtarët kështu e quanin Pejgamberin a.s..

<sup>67</sup> Ezebb b. Ezjeb, emër i shejtanit.

Pejgamberi a.s. tha: *“Nuk na është urdhëruar diçka e tillë, por shpërndahuni në kampet tuaja!”*

Dhe ne u kthyem në shtretërit tanë, ku kaluam natën. Pasi u zgjuam, na erdhën paria e Kurejshëve, të cilët thanë: *“O hazrexhas, jemi informuar se keni ardhur te ky njeriu ynë me qëllim që ta shpëtoni prej nesh dhe t’i jepni përkrahje kundër nesh. Dijeni, pasha Zotin, se prej të gjithë arabëve, ne më së paku do të donim të shpërthente lufta mes nesh dhe jush!”*

Duke qenë se idhujtarët e popullit tonë nuk e dinin se për çfarë ishte fjala, filluan të betohen në Zot se nuk dinë asgjë dhe se në realitet këtu nuk ka asgjë. Ata në fakt thanë të vërtetën sepse vërtet për këtë asgjë nuk dinin. Kurse ne vetëm shikonim njëri-tjetrin.

Njerëzit pastaj filluan të largohen nga Mina. Disa shkuan gjurmëve të lajmit që kishte rrjedhur dhe së shpejti e kuptuan se ishte i vërtetë. Pastaj dolën në kërkim të pjesëmarrësve dhe gjetën S'ad b. Ubaden në vendin Edhahir, jo larg Mekës, gjithashtu edhe Mundhir b. Amrin, të dy eprorë. Mundhiri ia doli të shpëtonte prej tyre, kurse Sadin e zunë. Ia lidhën duart pas qafe e pastaj e lidhën te deveja dhe filluan ta rrihnin derisa mbërritën në Mekë. Pasi i kishte flokët e gjata, shpesh e tërhiqnin për flokësh.

Sa'di ka thënë:

*“Vallahi, unë isha në duart e tyre, kur papritmas para meje u paraqit një grup Kurejshësh, në mesin e të cilëve ishte një njeri i pastër dhe i bardhë, me pamje të bukur, një nga njerëzit e mirë në shikim të parë. Thashë me vete: “Nëse në mesin e tyre ka ndonjë njeri të mirë, atëherë pa dyshim është ky.” Mirëpo, pasi m’u afua, e ngriti dorën dhe më ra me shuplakë.*

Pastaj thashë me vete: *“Vallahi, pas këtij nuk ka në mesin e tyre të mirë!”* Dhe kështu derisa më mbanin të robëruar, njëri prej tyre me përzemërsi u afua dhe më tha: *“Mjerë për ty! A është kush në mesin e Kurejshëve që është në fqinjësi me ty apo që ke ndonjë marrëveshje?”*

Unë i thashë: *“Po, vallahi, kam. Unë kam mbrojtur tregtinë e Xhubejr b. Mut'im b. Adij b. Nufel b. Abdi Menaf dhe i kam penguar njerëzit e vendit tim që mos t’i bëjnë ndonjë padrejtësi. Të njëjtën gjë kam bërë edhe për Harith b. Harb b. Umejje b. Abdi Shems b. Abdi Menafin.”*

Tha: *“E pra, për hir të Zotit, përmendi emrat e tyre dhe trego lidhjen mes teje dhe atyre të dyve!”*

Unë menjëherë fillova ta them, ndërsa ai burri shkoi tek ata të dy. I gjeti ata të dy në tempull te Qabeja dhe u tha: *“Një burrë nga fisi Hazrexh është duke u rrahur i shtrirë për tokë dhe thotë se është në fqinjësi me ju të dy.”*

Ata thanë: “Cili është ai?” Tha: “Sa’d b. Ubade.” Thanë: “Vallahi, të vërtetën ka thënë. Ai ka mbrojtur tregtinë tonë dhe na ka mbrojtur që mos të na ndodhë ndonjë e keqe në rrethin e tij!”

Tha: “Kështu Sa'di shpëtoi nga duart e tyre dhe u lejua të shkojë në rrugën e tij.”

## KUSHTET E BESËLIDHJES SË FUNDIT NË AKABE

Kjo besëlidhje është quajtur edhe Bej'atul-harb (marrëveshje e luftës) sepse ndodhi në kohën kur Allahu ia lejoi të Dërguarit të Tij luftën. Kjo marrëveshje, për dallim nga besëlidhja e parë, kishte disa kushte të reja. Besëlidhja e parë në Akabe nënkupton besëlidhjen me gratë sepse Allahu i Madhërishëm ende nuk ia kishte lejuar luftën të Dërguarit a.s.. Por kur Allahu ia lejoi atë, i Dërguari a.s., në takimin e fundit në Akabe lidhi marrëveshje me ta për luftë kundër arabëve e joarabëve. Edhe vetë u obligua, kurse ata i kushtëzoi me Zotin e tyre, duke u premtuar xhenetin, në qoftë se e mbajnë fjalën e dhënë.

Ubade b. Samit thotë:

“Ne i dhamë besën të Pejgamberit a.s. për bindje në aspektin e luftës. Ne iu zotuam për dëgjueshmëri dhe bindje si në vështirësi edhe në lehtësi, si në vuajtje edhe në rehati. U zotuam për vetëmohim dhe se askujt nuk do t’i merrnim të drejtën, se gjithmonë dhe kudo do të flisnim vetëm të vërtetën dhe se kur të ishte fjala për Allahun, nuk do t’i frikësoheshim qortimit të askujt.”

## SHPALLJA E URDHRIT PËR LUFTË

Pejgamberit a.s. para Besëlidhjes në Akabe nuk i qe lejuar as lufta e as derdhja e gjakut të dikujt. Ai ishte urdhëruar vetëm të bënte thirrje për besim në Allahun, të bënte durim në përballimin e torturave dhe të shmangej nga injorantët. Në të njëjtën kohë, Kurejshët i sulmonin brutalisht muhaxhirët, të cilët ndiqeshin me qëllim që t'i largojnë nga besimi i tyre ose t'i dëbojnë nga shtëpitë e tyre. Ata kishin vetëm dy zgjedhje: ose të torturoheshin rëndë nga ata ose të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Kështu disa ikën në Abisini, disa në Medinë e disa në anë të tjera. Kur Kurejshët i tejkaluan të gjithë kufijtë me paturpësitë e tyre ndaj Allahut të Madhërishëm, kur ata e refuzuan nderimin që Ai donte t'u shprehte, kur e përgënjeshtroan Pejgamberin a.s., kurse ata të cilët e adhuruan dhe deklaruan besimin tek Ai e pasuan të Dërguarin a.s. dhe u kapën pas fesë së tyre i persekutuan dhe torturuan, atëherë Allahu i Madhërishëm ia lejoi Pejgamberit a.s. luftën dhe hakmarrjen kundër atyre që kishin torturuar dhe sulmuar.

Ajetet e para që zbritën me të cilat iu lejua lufta, gjakderdhja dhe beteja, sipas tregimeve të Urve b. Zubejr dhe dijetarëve të tjerë, ishin këto fjalë të të Lartmadhërishmit:

*“Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtë, e Allahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre (muslimanëve). (U lejua të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: “Allahu është Zoti ynë!” u dëbuan pa kurrfarë të drejte. E sikur Allahu të mos i zmburpste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i Allahut. E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se Allahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues. (Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. Allahut i takon përfundimi i çështjeve.” (El-Haxh, 39-41)*

Pra, u është lejuar lufta për shkak se u ishte bërë padrejtësi, ndonëse ata nuk kishin bërë ndonjë mëkat në raportet e tyre me njerëzit e tjerë. Nga ana tjetër, fjala ishte për njerëz të cilët nëse fitonin, do të falnin namazin, do të jepnin zekatin, do të urdhëronin për të mirë dhe do të ndalonin nga e keqja. Pra, kishte të bënte me Pejgamberin a.s. dhe shokët e tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta!

Pastaj Allahu i Madhërishëm i shpalli atij: *“Vritini ata derisa të zhduket fitneja”, d.m.th. derisa besimtarët të mos pengohen me dhunë nga feja e tyre “dhe të aplikohet feja vetëm për Allahun...” (El-Bekare, 193), d.m.th. derisa të adhurohet vetëm Allahu dhe askush tjetër me Të.*

## LEJIMI I MUSLIMANËVE PËR SHPËRNGULJE NË MEDINË

Pasi Allahu i Madhërishëm ia lejoi Pejgamberit a.s. luftën dhe pasi ky grup ensarësh i dhanë fjalën se do t'i përmbahen Islamit dhe do ta ndihmojnë atë dhe muslimanët që e pasojnë, Pejgamberi a.s. i urdhëroi sahabët muhaxhirë nga populli i tij dhe muslimanët e tjerë që mbetën në Mekë për t'u shpërngulur në Medinë dhe kështu të bashkohen me vëllezërit e tyre ensarë. Ai tha: *“Vërtet Allahu i Madhërishëm ju ka siguruar vëllezër dhe strehim (shtëpi), në të cilat do të jeni të sigurt!”*

Dhe ata filluan të dalin në grupe njëri pas tjetrit, ndërsa Pejgamberi a.s. mbeti në Mekë duke pritur lejen nga Zoti për t'u shpërngulur nga Meka në Medinë.

## MUHAXHIRËT E PARË NË MEDINË

I pari nga sahabët e Pejgamberit a.s. që u shpërngul në Medinë ishte Ebu Seleme b. Abdul-Esed, i cili ishte Kurejsh nga fisi Benu Mahzum. Ai shkoi në Medinë një vit para Besëlidhjes në Akabe. Nga Abisinia së pari u kthye në Mekë te Pejgamberi a.s., por pasi Kurejshët e shqetësuan shumë dhe pasi dëgjoi se Islamin e kishin pranuar shumë ensarë, u shpërngul për në Medinë.

Pas Ebu Selemes u shpërngul Amir b. Rebia dhe gruaja e tij Lejla bint Ebi Hathme, ndërsa pas tyre Abdullah b. Xhahsh, i cili kishte vuajtur shumë, me familjen e tij dhe me vëllanë Abd b.Xhahsh (i cili quhej Ebu Ahmed). Ebu Ahmedi kishte shikimin e dëmtuar, por pavarësisht kësaj i dilte Mekës fund e krye pa udhëheqës, madje ishte edhe poet.

Pastaj për në Medinë u shpërngulën Omer b. Hattabi dhe Ajjash b. Ebi Rabia Mahzumi, ndërsa më vonë arritën edhe muhaxhirët e tjerë.

## HIXHRETI I PEJGAMBERIT a.s.

Pejgamberi a.s. mbeti në Mekë pas sahabëve të tij muhaxhirë duke pritur lejen për hixhret. Me të në Mekë, përveç muhaxhirëve të burgosur dhe atyre që ishin kthyer nga feja e tyre, kishte mbetur vetëm Ali b. Ebi Talibi dhe Ebu Bekër b. Ebi Kuhafe Siddiku, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Ebu Bekri shumë herë nga Pejgamberi a.s. kërkoi leje për hixhret, por ai gjithmonë i thoshte: *“Mos u ngut! Ndoshta Allahu do të të japë bashkudhëtar!”* Ebu Bekri, natyrisht, dëshironte që pikërisht ai të ishte bashkudhëtar i tij.

Kur Kurejshët e panë se rreth Pejgamberit a.s. janë tubuar edhe njerëz të tjerë jo nga vendi i tyre dhe kur panë se shokët e tij muslimanë po shpërngulen tek ata, e kuptuan se ata kishin gjetur vendqëndrim dhe mbrojtje të sigurt. Kështu ata filluan ta vëzhgojnë Pejgamberin a.s. dhe shpërnguljen e tij eventuale sepse e kishin të qartë se ai tashmë ishte përgatitur për luftë kundër tyre.

Për këtë qëllim ata organizuan një takim në Darun-Nedve, që ishte shtëpia e Kusajj b. Kilabit, në të cilën Kurejshët merrnin të gjitha vendimet e rëndësishme, në mënyrë që të konsultohen se çfarë duhet të bëjnë në lidhje me Pejgamberin a.s., pasi filluan t’i frikësohen.

Nga Ibni Abbasi transmetohet të ketë thënë:

*“Kur ata vendosën për këtë dhe u pajtuan për ditën e takimit në Darun-Nedve, në mënyrë që të konsultohen se çfarë duhet të bëjnë në lidhje me Pejgamberin a.s., në mëngjesin e asaj dite ata shkuan atje. Ajo ditë quhej dita e turmës (jev-muz-zahmeh). Në atë moment para tyre doli Iblisi në formën e një plaku, i veshur me një mbulesë të vrazhdë me kapelë. U ndal para derës së shtëpisë dhe kur e panë, e pyetën se kush ishte dhe ai tha: “Unë jam një plak nga Nexhdi<sup>68</sup>. Dëgjo-va për këtë tubim, ndaj erdha të dëgjoj çfarë do të thoni. Ndoshta mund të kem ndonjë opinion apo mund t’ju jap ndonjë këshillë.” Ata i thanë: “Në rregull, hyr.” Dhe ai hyri. Aty ishin tubuar Kurejshët më eminentë.*

Filluan diskutimet duke thënë: *“Ju të gjithë jeni dëshmitarë për veprimtarinë e këtij njeriu dhe ne vallahi nuk jemi të sigurt se ai nuk do të ngrihet kundër nesh me ata njerëzit e tjerë që po e pasojnë. Prandaj, në lidhje me të, ne duhet të marrim një qëndrim të vendosur!”*

Ata pastaj filluan trajtimin e problemit.

<sup>68</sup> Suhejli thotë: *“Ai u tha atyre unë jam nga Nexhdi sepse ata kishin thënë “nuk do të lejojmë të hyjë në konsultime asnjë njeri nga Tihame”, pasi ata kishin simpati për Muhamedin. Prandaj iu përfytyrua atyre si një shejh nga Nexhdi.”*

Njëri prej tyre propozoi: “Mbylleni në një qeli të hekurt dhe mbylleni derën me dry, e pastaj shikoni se si do ta gjejë kobi, siç i ka gjetur edhe ata poetë, si Zuhejrin e Nabigan, përpara tij, e ata vdiqën. Edhe ai do të vdesë kur ta gjejë e keqja siç i gjeti edhe ata.”

Plaku nga Nexhdi reagoi: “Jo, vallahi, kjo nuk është zgjidhje, sepse nëse e burgosni atë, siç thoni, nuk do të mund ta lidhni edhe frymën e tij, mendimet e tij dhe idetë e tij. Ato do të dalin përtej dyerve të mbyllura dhe do të arrijnë tek shokët e tij. Ata do t’ju sulmojnë e do ta marrin atë nga duart tuaja dhe atëherë edhe të tjerët do të ngrihen kundër jush gjersa t’ju mposhtin. Pra, kjo nuk është zgjidhje për ju. Kërkoni ndonjë zgjidhje tjetër!”

Pastaj vazhduan diskutimet dhe njëri prej tyre<sup>69</sup> tha: “Do ta lëçitim dhe do ta përzëmë nga vendi ynë. Nuk mërzitemi se nga do të shkojë dhe ku do të vendoset. Në këtë mënyrë do ta përmirësojmë situatën tonë dhe do të jetë sikurse ishte edhe më parë!”

Plaku i Nexhdit tha: “Jo, vallahi! Ky nuk është mendimi i të gjithëve! Që të gjithë ju e dini se sa bukur flet dhe me ç’urtësi logjikon. Vallahi, nëse veproni kështu, nuk do të jeni të sigurt prej asnjë populli arab! Kudo që do të jetë, ata do ta pranojnë e pastaj do të kthehen kundër jush. Do t’ju mposhtë dhe atëherë do të bëjë me ju ç’të dojë. Andaj, kërkoni zgjidhje tjetër!”

Pastaj fjalën e mori Ebu Xhehl b. Hishami, i cili tha: “Vallahi, unë e kam një zgjidhje, të cilën asnjëri prej jush nuk e tha.” Ata thanë: “Cila është ajo, o Ebul-Hakem?” Ai u përgjigj: “Konsideroj se duhet të zgjedhim nga një të ri të fuqishëm prej çdo fisi që të na përfaqësojë, të cilëve do t’u japim nga një shpatë vdekjeprurëse, të shkojnë e ta vrasin në vend. Vetëm atëherë do të shpëtojmë nga ai. Nëse veprojmë kështu, gjaku i tij do të shpërndahet në të gjitha fiset dhe Benu Abdi Menafët nuk do të mund të hakmerren ndaj të gjithëve. Kështu që do të detyrohen të pranojnë shpagimin e gjakut, të cilin me kënaqësi do ta paguajmë!”

Plaku nga Nexhdi tha: “Le të bëhet ashtu siç thotë ky njeri. Në fakt, kjo është zgjidhja e vetme, nuk ka zgjidhje më të mirë!” Për këtë ranë dakord të gjithë të pranishmit, pastaj u shpërndanë.

Atëherë Pejgamberit a.s. i erdhi Xhibrili a.s. dhe i tha: “*Sonte mos fli në shtratin tënd!*”

Atë natë, kur u terr mirë, të rinjtë u mblodhën përpara shtëpisë së tij dhe e ndiqnin kur do të flinte, në mënyrë që t’i vërsuleshin. Kur i vërejti Pejgamberi a.s., i tha Ali b. Ebi Talibit:

“*Ti fli në shtratin tim. Mbulohu me këtë pelerinën time të gjelbër nga Hadramevti dhe fli qetë në të, asgjë e keqe nuk do të të ndodhë prej tyre!*”

<sup>69</sup> Ai ishte Ebul-Esved Rebia b. Amir.

Pejgamberi a.s. mbulohej me atë pelerinë kur flinte.

Muhammad b. Ka'b Kuradhiu thotë: "Në grupin që ishte përballë shtëpisë së Pejgamberit ishte edhe Ebu Xhehli b. Hishami, i cili u tha: "Muhamedi mendon se do të bëheni mbretër të arabëve dhe të të huajve, nëse e pranoni fenë e tij, se do të ringjalleni pas vdekjes suaj, se për ju janë përgatitur kopshte sikurse kopshtet e Jordanisë. E nëse nuk pranoni, thotë se do të vdisni si kafshë e pas ringjalljes do të hyni në zjarr, ku do të digjeni."

Pastaj Pejgamberi a.s. doli nga shtëpia dhe në dorë mori një grusht pluhur. "Pikërisht ashtu them", tha ai, "ndërsa ti je një nga ata!" Allahu ua verboi pamjen dhe ata nuk e panë, ndërsa ai i derdhi pluhur në kokë secilit prej tyre duke thënë disa ajete nga fillimi i sures Jasin:

*"Jâ Sîn. Pasha Kur'anin e pacenueshëm në urtësinë e tij të lartë. S'ka dyshim se ti (Muhamed) je prej të Dërguarve. Je në një rrugë të drejtë. (Kur'ani është) Zbritje e të Plotfuqishmit, e Mëshiruesit. Për t'ia tërhequr një populli, që të parët e tyre nuk u është tërhequr, e për atë shkak ata janë të hutuar. Për Zotin tashmë ka marrë fund (thënia) shumicës së tyre, andaj ata edhe nuk besojnë. Ne u kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me koka lart. Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë edhe mbrapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin."*

Duke përfunduar këto ajete i derdhi edhe të fundit prej tyre pluhur në kokë, pastaj u largua.

Pastaj vjen dikush që nuk ishte nga grupi i tyre dhe tha: "Çfarë po prisni këtu?!" Ata thanë: "Muhamedin!" Tha: "Zoti ju shkatërroftë! Vallahi Muhamedi ka dalë, madje secilit prej jush i ka hedhur pluhur në kokë dhe ka shkuar rrugës së vet. A nuk po shihni se çfarë ju ka ndodhur?! Secili prej tyre pastaj vuri dorën e tij mbi kokë dhe e vërejti pluhurin. Ata menjëherë nxituan për ta kërkuar, por kur e panë Aliun që ishte shtrirë në shtrat i mbuluar me pelerinën e Pejgamberit a.s., thanë: "Vallahi, ky është Muhamedi duke fjetur i mbuluar me pelerinën e tij!" Kështu ata pritën deri në agim. Kur nga shtrati u ngrit Aliu r.a., thanë: "Vallahi, paska pasur të drejtë ai që na foli më parë!"

Ibni Is'haku thotë:

"Ebu Bekri r.a. ishte njeri shumë i pasur. Kur kërkoi leje nga Pejgamberi a.s. për shpërngulje dhe kur ai i tha: "Mos u ngut! Ndoshta Allahu do të të japë bashkudhëtar", ai shpresoi se me të Pejgamberi a.s. po mendonte për veten kur e tha këtë, prandaj menjëherë bleu dy deve të cilat i ushqente të mbyllura në shtëpinë e tij.

Aishja r. anha ka thënë: "Pejgamberi a.s. vinte vetëm në fillim ose në fund të ditës, në mëngjes ose në mbrëmje. Atë ditë, kur u lejua të bënte hixhret dhe të shkonte nga Meka në Medinë, erdhi tek ne në mes të zhegut të ditës, kohë në të cilën kurrë nuk na kishte vizituar më parë. Kur e pa atë, Ebu Bekri tha: "I Dërgu-

ari a.s. në këtë orë ka ardhur për ndonjë çështje të rëndësishme!" Pasi hyri, Ebu Bekri i habitur u ngrit nga shtroja e tij. Pejgamberi u ul, ndërsa me Ebu Bekrin ishim vetëm unë dhe motra ime Esma.

Pastaj Pejgamberi a.s. tha: *"Le të dalin jashtë kush janë tek ti!"* Ebu Bekri tha: "O i Dërguari i Allahut, ato janë dy vajzat e mia. Çfarë është ajo, nënë e babë t'u bëfshin kurban, o i Dërguari i Allahut?" Tha: *"Allahu më ka lejuar të dal dhe të bëj hixhret!"* Ebu Bekri tha: "Së bashku, o i Dërguari i Allahut?!" Tha: *"Së bashku!"*

Aisha ka thënë: "Vallahi, kurrë më parë nuk kisha parë që dikush të qante nga gëzimi. Atë ditë pashë Ebu Bekrin!"

Pastaj tha: "O Pejgamber i Allahut, vërtet këto dy deve unë i kam përgatitur enkas për këtë!"

Pastaj ata morën me pagesë Abdullah b. Erkatin, i cili ishte idhujtar, për të qenë udhërrëfyes i tyre në rrugë. Atij ia dhanë edhe dy devetë, që t'i ushqente derisa të niseshin.

Ibni Is'haku thotë:

"Me sa di unë, për nisjen e Pejgamberit a.s. ka qenë në dijeni vetëm Ali b. Ebi Talibi, Ebu Bekri dhe familja e Ebu Bekrit. Aliun, me sa kam dëgjuar unë, Pejgamberi a.s. e kishte njoftuar për shkuarjen e tij dhe e kishte urdhëruar të qëndronte në Mekë për t'ua ndarë njerëzve gjërat e tyre që kishin lënë tek ai. Në fakt, kushdo në Mekë që kishte frikë për diçka të tijën, e linte te Pejgamberi sepse ai ishte i njohur për ndershmërinë dhe besueshmërinë e tij.

Kur Pejgamberi a.s. i përfundoi të gjitha përgatitjet për nisje, shkoi tek Ebu Bekër b. Ebi Kuhafe dhe së bashku dolën nga një deriçkë nga ana e prapme e shtëpisë së tij. Pastaj ata u nisën për në shpellën Thevr<sup>70</sup> dhe hynë aty. Ebu Bekri e urdhëroi djalin e tij Abdullahun që të mësonte se çfarë po thoshin njerëzit rreth tyre gjatë ditës, pastaj të vinte në mbrëmje dhe t'u sillte lajmet e ditës. Ndërsa djaloshin Amir b. Fuhejrin, shërbëtorin e tij, e porositi që gjatë ditës të ruante bagëtinë, ndërsa në mbrëmje të kalonte pranë shpellës dhe t'i vizitonte natën. Esma, bija e Ebu Bekrit, ua sillte ushqimin gjithashtu natën<sup>71</sup>.

Në shpellë ata qëndruan tri ditë. Kur e panë se i humbën gjurmët e Pejgamberit a.s., Kurejshët ofruan njëqind deve shpërblim për atë që do t'ua sillte. Djali i Ebu Bekrit, Abdullahu, qëndronte gjatë ditës në mesin e tyre dhe dëgjonte se çfarë po përgatitej kundër Pejgamberit a.s. dhe çfarë po diskutonin në lidhje me ata të dy, ndërsa natën u raportonte. Fuhejri, nga ana e tij, kulloste bagëtinë së bashku me barinjte mekas dhe në mbrëmje i kalonte pranë tyre që ata të milnin

<sup>70</sup> Gjendet në një kodër rrëzë Mekës.

<sup>71</sup> Ibni Hishami transmeton nga Hasan Basriu: "I Dërguari i Allahut a.s. dhe Ebu Bekri r.a. në shpellë arritën natën. Ebu Bekri hyri i pari në mënyrë që të kontrollonte se mos ndoshta kishte ndonjë bishë apo gjarpër. Me trupin e tij ai ka mbrojtur të Dërguarin a.s."

qumësht. Në mëngjes, kur Abdullahu i linte dhe shkante në Mekë, Fuhejri mbi gjurmët e këmbëve të tij kalonte bagëtinë për të mbuluar gjurmët.

Pas tri ditësh, kur njerëzit filluan të mos i përmendin, erdhi njeriu që kishin marrë me pagesë me dy devetë e tyre dhe një deve për vete. Erdhi edhe e bija e Ebu Bekrit, Esma dhe ua solli ushqimin për rrugës, mirëpo ajo kishte harruar të merrte litarin për të lidhur bohçen te deveja, ndaj e shqeu fundin e vet në dy pjesë. Me njëren pjesë përforcoi ushqimin, kurse me pjesën tjetër u mbështoll vetë. Për këtë arsye Esma bint Ebi Bekri u quajt "pronarja e shokës" (dhatun-nitak)<sup>72</sup>.

Kur Ebu Bekri r.a. i afroi devetë te Pejgamberi a.s., ia ofroi atij më të mirën, pastaj i tha: "Hip, o i Dërguari i Allahut, nënë e babë t'u bëfshin kurban!" Pejgamberin a.s. tha: "Unë nuk hipi në devenë që nuk është e imja!"

Ebu Bekri tha: "Por ajo është e jotja dhe e askujt tjetër!" Tha: "Jo, por më thuaj sa e ke blerë?"

Ebu Bekri tha: "Kaq e kaq." Tha: "Atëherë po e blej me atë çmim!"

Ebu Bekri tha: "Atëherë të dyja janë të tuat, o i Dërguari i Allahut!"

Më pas hipën dhe u nisën. Ebu Bekri me vete mori edhe shërbëtorin e tij Amir b. Fuhejrën, që t'u shërbente gjatë rrugës.

Esma bint Ebi Bekër ka thënë:

"Pasi Pejgamberi a.s. dhe Ebu Bekri tashmë kishin shkuar, na erdhi një grup Kurejshësh, në mesin e të cilëve ishte dhe Ebu Xhehl b. Hishami. U ndalën para derës së Ebu Bekrit. Kur unë dola, ata më thanë: "Ku është babai yt, oj vajza e Ebu Bekrit?" Unë u thashë: "Vallahi, nuk e di ku është babai im." Tha: "Atëherë ngriti dorën - ishte aq i pështirë - më dha një shuplakë sa edhe vathi më ra nga veshi!"

Pastaj ata u larguan, ndërsa ne në tre netët e ardhshme nuk dinim asgjë për Pejgamberi a.s.. Pastaj erdhi një xhin nga rrëza e Mekës, këndonte vargje që këndohen në mesin e arabëve, kurse njerëzit i shkonin pas dhe e dëgjonin zërin e tij edhe pse nuk e shihnin, derisa kaloi në pjesën e sipërme të Mekës duke kënduar:

*I shpërbleftë Allahu, sunduesi i njerëzve, me shpërblimin më të mirë,  
dy shokët tek dy çadrat e Ummi Mabedit<sup>73</sup> që mbërritën.*

*Erdhën me mirësi, e me mirësi ata edhe vajtën,  
i shpëtuar është ai që si shok i Muhamedit kaloi natën.*

*Benu Ka'bët le t'ia urojnë bijës së vet,  
vendin e nderit që ajo ka tek besimtarët.*

<sup>72</sup> Ibni Hishami ka thënë: "Kam dëgjuar prej më shumë dijetarëve duke thënë 'pronarja e dy shokave' (Dhatun-nitakajni). Këtë e shpjegojnë me faktin se ajo e ndau shokën e saj në dy pjesë: me njëren lidhi ushqimin, kurse me tjetrën u mbështoll vetë."

<sup>73</sup> Ummu Mabed: Emri i saj ishte Atike bint Halid, një grua nga fisi Beni Ka'b. Tek ajo u kthyen Pejgamberi a.s., Ebu Bekri r.a., Amir b. Fuhejre dhe Abdullah b. Erkat. Ata kërkuan për të blerë prej saj mish dhe hurma, por nuk gjetën asgjë. Aty Pejgamberi a.s. pa një dele afër çadrës. Kërkoj leje për ta mjelë, pastaj e fërkoj me dorë gjirin e deles dhe gjiri iu mbush me qumësht. Pastaj gruaja iu zotua për Islam.

Pasi i dëgjua fjalët e tij, atëherë e kuptua se në cilin drejtim është Pejgamberi, domethënë e kuptua se ai po shkonte në drejtim të Medinës.”

Suraka b. Malik b. Xhushum ka thënë:

“Kur Pejgamberi a.s. e lëshoi Mekën duke u shpërngulur për Medinë, Kurejshët ofruan njëqind deve për këdo që do t’ua kthente. Derisa unë isha ulur në vendin ku ne zakonisht rrinim, erdhi njëri prej njerëzve tanë dhe tha:

“Vallahi, pak më parë i pashë tre udhëtarë hipur të cilët kaluan pranë meje dhe unë jam i sigurt se ishte Muhamedi me shokët e tij!” Unë i shkela syrin duke e paralajmëruar që të heshtë, pastaj thashë:

“Ata kanë qenë njerëz nga filan fis në kërkim të ndonjë deveje që u ka humbur!”

Ai tha: “Ndoshta!” dhe heshti.

Unë qëndrova edhe pak dhe pastaj nxitova për në shtëpi. Aty urdhërova që të më përgatisin kalin, të cilin ma prunë prapa bregores. Pastaj kërkova edhe armët, të cilat m’i sollën nga dalja e pasme. Më në fund i mora shigjetat e mia me të cilat hodha shortin dhe pasi i ngjësua armët, u nisa. Pastaj i nxora shigjetat dhe fillova të hidhja short. Doli shigjeta në të cilën shkruante ‘nuk do ta dëmtojë’, prandaj aspak nuk më erdhi mirë, sepse unë dëshiroja t’ua dorëzoja Kurejshëve dhe për kompensim të merrja ato njëqind devetë.

Megjithatë, i hipa kalit dhe u nisa pas gjurmëve të tyre. Derisa kali ishte duke vrapuar, papritmas u pengua dhe më rrëzoi nga shala. Thashë: “Çfarë është tani?!” Pastaj unë i tërhoqa përsëri shigjetat dhe hodha shortin, por përsëri doli ajo në të cilën shkruante ‘nuk do ta dëmtojë’. Unë, megjithatë, isha këmbëngulës, i hipa kalit dhe vazhdova të ndiqja gjurmët e tij.

Kur i pashë ata, kali im rrëshqiti përsëri. Këmbët e përparme iu fundosën gjer në gjunjë dhe unë përsëri u rrëzova. Ai pastaj i tërhoqi këmbët e tij, kur papritmas gufoi rëra, pluhuri i së cilës u ngrit lart si tym.

Kur e pashë këtë, e kuptova se nuk do të mund ta rrëmbeja dhe se ai do të ishte fitues. Atëherë i thirra:

“Unë jam Suraka ibn Xhushum, prisni, dëshiroj të bisedoj, nuk ju mashtroj e as nuk do t’ju bëj dëm.” Pejgamberi a.s. i tha Ebu Bekrit: “Thuaj atij: *Ç’kërkon prej nesh?*” Ebu Bekri r.a. ia tha këtë Surakës e ky ia ktheu: “Dua të më shkruash një dokument, të jetë argument mes meje dhe teje.”

Pejgamberi a.s. i tha Ebu Bekrit: “*Shkruaja, o Ebu Bekr!*”

Ebu Bekri m’i shkroi disa fjalë në një kockë, në një copë ene prej balte apo flete, nuk e mbaj mend saktësisht dhe ma hodhi mua. Unë e mora atë, e vendosa në torbë dhe u ktheva. Asnjë fjalë nuk i thashë askujt mbi atë që më ndodhi.

Kur ndodhi çlirimi i Mekës dhe kur Pejgamberi a.s. e mbylli çështjen e Hunejnit dhe Taifit, unë mora shkresën dhe dola për t’ia treguar dhe e takova në

Xhiarrane<sup>74</sup>. Unë hyra në skuadrën e kalorësve të ensarëve, ndërsa ata më shtynin me shtiza duke më thënë: “Ik! Ik! Çfarë do?!” Megjithatë, u afrova te Pejgamberi a.s., i cili ishte i hipur mbi një deve. Pasha Zotin, sikur po i shoh këmbët e tij në yzengji, si palcë palme! E ngrita dorën duke mbajtur fletën në dorë dhe thashë: “O i Dërguari i Allahut, ja fleta që më ke dhënë ti, unë jam Suraka b. Xhushum!”

Pejgamberi a.s. tha: “*Sot është dita e besnikërisë dhe bamirësisë, afrohu!*”

Unë iu afrova dhe aty e pranova Islamin. Pastaj desha ta pyesja diçka Pejgamberin a.s., por nuk m’u kujtua se çfarë. Megjithatë unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, një deve e humbur ka pirë ujë në koritën të cilën e kam mbushur për devetë e mia, a do të kem shpërblim nëse i jap edhe asaj të pijë?” Tha: “*Po, për çdo gjë të gjallë do të kesh shpërblim përkatës!*” Pas kësaj unë u ktheva te populli im dhe dhashë kontributin tim për Pejgamberin e Zotit.

Ibni Is’haku thotë:

“Udhëzuesi i tyre, Abdullah b. Erkat, i nxori ata poshtë Mekës dhe pastaj vazhdoi me ta përreth bregdetit, ku pastaj atje poshtë rrëzë Usfanit e prenë rrugën dhe vazhduan të shkojnë luginës së Emexhit. Pastaj u konsultua me ta dhe përsëri kur kaluan Kudejdin, e prenë rrugën. Pastaj kaluan nëpër Harrar, pastaj nëpër Likfë dhe kanalën e saj, pastaj nëpërmjet kanalit të Mehaxhit, e pastaj edhe përmes kodrinave të Mehaxhit. Më pas kanë dalë thellë në kodrën e Dhul-Gadavejn, kurse prej aty në brendi të Dhu Kishrit. Pastaj, udhëzuesi i tyre, i kaloi ata në Xhedaxhid e pastaj në Exhred. Pastaj i kaloi nëpërmjet Dhu Selem, zonë e armiqve Ti’hin, pastaj në Ababid dhe pastaj kaloi nëpërmjet Faxhxhes.”

Ibni Hishami thotë:

“Pas kësaj zbriti në Arexh, ku disa deve filluan të ngadalësohen. Pejgamberin a.s. aty takoi një njeri musliman të quajtur Evs b. Haxher<sup>75</sup> dhe e vendosi mbi devenë e tij të quajtur Ibnur-Rida’. Hipur mbi të shkoi deri në Medinë. Me të dërgoi edhe shërbëtorin e tij Mesud b. Hunejd. Pastaj udhëzuesi i tyre doli me ta nga Arxhi duke kaluar përmes kopshtit Air, nga ana e djathtë e Rukubes, dhe pastaj u lëshua në thellësitë Rimës. Pastaj arritën në Kuba, te fisi Benu Amër b. Avf. Kjo ishte të hënën, natën e dymbëdhjetë të muajit rebiul-evvel, në kohën kur nxehtësia e ditës filloi të ashpërsohet, kur dielli pothuajse kishte pozitë vertikale.”

<sup>74</sup> Xhiarrane është një vend me ujë në mes Taifit dhe Mekës.

<sup>75</sup> Ky Evs b. Haxheri është sahabij, për dallim prej Evs b. Haxherit, i cili ka qenë poet paraislamik.

## MBËRRITJA NË KUBA

Transmetohet nga Abdurrahman b. Uvejmir b. Sa'ade të ketë thënë: “Disa njerëz nga populli im, sahabë të Pejgamberit a.s., më kanë treguar si vijon:

“Kur dëgjuam se Pejgamberi a.s. kishte dalë nga Meka, ne vazhdimisht qëndronim në pritje të mbërritjes së tij. Në mëngjes, pasi falnim namazit e sabahut, dilnim në shkretëtirë të hapur dhe aty pritnim Pejgamberin a.s.. Vallahi, ne nuk lëviznim nga atje derisa dielli të na detyronte të kërkonim strehim në hije. Nëse diku afër nuk kishte asnjë hije, ktheheshim në shtëpi sepse ditët ishin shumë të nxehta. Edhe atë ditë kur erdhi Pejgamberi a.s., qëndruam si zakonisht, por pasi askund nuk kishte hije, ne u kthyem në shtëpi. Pikërisht atëherë erdhi Pejgamberi a.s. dhe i pari që e pa ishte një hebre. Ai e dinte se çfarë po bënim dhe e dinte se ne po pritnim ardhjen e Pejgamberit Muhamed a.s.. Sapo e pa atë, me zë të lartë bërtiti: “O Benu Kajle<sup>76</sup>! Ja, po ju vjen lumturia juaj!”

Ne të gjithë i dolëm përpara Pejgamberit a.s. dhe e pritëm në hijen e palmave. Me të ishte Ebu Bekri r.a., i cili ishte në moshë të njëjtë me të, ndërsa shumica prej nesh nuk e kishim parë më herët Pejgamberin a.s.. Njerëzit ishin mbledhur rreth Ebu Bekrit, duke mos ditur se kush është kush prej tyre. Vetëm kur Pejgamberi a.s. mbeti i pambrojtur nga dielli dhe kur Ebu Bekri i bëri hije me pelerinën e tij, vetëm atëherë e kuptuam se cili prej tyre ishte Pejgamberi!”

Ibni Is'haku thotë:

“Pejgamberi a.s., siç thuhet, së pari shkoi te Kulthum b. Hidmi, megjithëse disa thonë se së pari shkoi te Sa'd b. Hejthemi. Ata që thonë se së pari shkoi te Kulthum b. Hidmi thonë: “Pejgamberi a.s. vetëm pasi doli nga Kulthum b. Hidmi shkoi në shtëpinë e Sa'd b. Hejthemit sepse ai ishte i pamartuar, nuk kishte familje dhe shtëpitë e njerëzve të tillë zakonisht u caktoheshin shokëve muhaxhirë të Pejgamberit.”

Ebu Bekri megjithatë qëndroi te Hubejb b. Isafi. Dikush thotë se shtëpia e tij ishte e Harixhe b. Zejdit.

Ali b. Ebi Talibi r.a. qëndroi në Mekë edhe tri ditë e tri net. Gjatë kësaj kohe ua ndau njerëzve të gjitha gjërat që ata kishin lënë te Pejgamberi a.s.. Pasi i dorëzoi ato, ai iu bashkëngjiti Pejgamberit a.s. dhe së bashku me të qëndroi te Kulthum b. Hidmi.

Pejgamberi a.s. qëndroi në Kuba te fisi Benu Amër b. Avf katër ditë: të hënën, të martën, të mërkurën dhe të enjten. Gjatë kësaj kohe themeloi xhaminë e tij.

<sup>76</sup> Ata ishin të gjithë ensarët. Kajle quhej gjyshja (paraardhëse) e tyre.

## MBËRRITJA NË MEDINË

Pejgamberi a.s. me përcjellje madhështore u nis prej Kubasë të premtën. Xhumaja e zuri te fisi Benu Salim b. Auf, të cilën e fali aty në një xhami në brendi të luginës Ranuna'. Kjo ishte xhumaja e parë që fali në Medinë.

Pas xhumasë iu afruan Itban b. Malik dhe Abbas b. Ubade b. Nadle dhe në emër të fisit Beni Salim b. Avf i thanë: "O i Dërguari i Allahut! Rri te ne. Ne jemi të shumtë, të pasur dhe të fortë!" *"Lëreni të ecë vetë, ajo është e urdhëruar!"* – tha për devenë e tij dhe ata ia hapën rrugën.

Ajo eci dhe kur erdhi pranë shtëpisë së Beni Bejada, para tyre doli Zijad b. Lebijd dhe Ferve b. Amër nga fisi Beni Bejada, të cilët thanë: "O i Dërguari i Allahut, eja te ne! Ne jemi në numër, të pasur dhe të fortë!" Tha: *"Lëreni të ecë vetë, ajo është e urdhëruar!"*

Dhe deveja u nis përpara dhe kaloi pranë shtëpisë së Beni Sa'ade, doli përpara Sa'd b. Ubade dhe Mundhir b. Amër në emër të fisit Benu Sa'ade thanë: "O i Dërguari i Allahut, eja te ne! Ne jemi në numër, të pasur dhe të fortë!" Tha: *"Lëreni të ecë vetë, ajo është e urdhëruar!"*

Ata ia hapën rrugën dhe deveja u nis përpara derisa kaloi pranë shtëpisë së Beni Harith b. Hazrexh, doli Sa'd b. Rebi', Harixhe b. Zejd dhe Abdullah b. Reva-ha, si përfaqësues të fisit Beni Harith b. Hazrexh dhe i thanë: "Eja te ne, o i Dërguar i Allahut! Ne jemi të shumtë, të pasur dhe të fortë!" Tha: *"Lëreni të ecë vetë, ajo është e urdhëruar!"*

Ata ia hapën rrugën dhe deveja bëri përpara derisa kaloi pranë shtëpisë së Beni Adijj b. Nexhxhar, të afërm të dajallarëve të Pejgamberit a.s. - sepse Ummu Abdulmuttalib Selma bint Amër ishte një nga gratë e tyre. Aty u dolën përpara Selit b. Kajs dhe Ebu Selit Usejre b. Ebi Harixhe në emër të fisit Beni Adijj b. Nexhxhar dhe u thanë: "O i Dërguari i Allahut! Eja te dajallarët e tu, ne jemi të shumtë, të pasur dhe të fortë!" Tha: *"Lëreni të ecë vetë, ajo është e urdhëruar!"*

Ata ia hapën rrugën dhe deveja u nis përpara. Kur erdhi te shtëpia e Beni Malik b. Nexhxharit, aty u gjuhëzua te dera e xhamisë së Pejgamberit a.s.. Ai vend atëherë ishte lëmë ku thanin hurmat dhe ishte pronë e dy jetimëve nga fisi Beni Nexhxhar – Sehi dhe Suhejli bijtë e Amrit, që ishin nën kujdestari të Muadh b. Afra's.

Ashtu e gjuhëzuar qëndroi disa çaste, ndërsa Pejgamberi a.s. i hipur në të qëndronte pa lëvizur vendit. Pastaj ajo përsëri u ngrit dhe u largua pak nga atje. Pejgamberi a.s. as nuk e pengoi as nuk e drejtoi. Deveja pastaj shikoi prapa saj

dhe përsëri u kthye në vendin ku u gjuhëzua fillimisht. Aty u gjuhëzua edhe këtë herë, pastaj u lëkund, pëlliti dhe u lëshua poshtë në tokë.

Atëherë Pejgamberi a.s. zbriti, kurse plaçkat e tij i mori Ebu Ejjub Halid b. Zejd dhe i çoi në shtëpinë e tij. Edhe Pejgamberi a.s. së pari u kthye tek ai dhe menjëherë pyeti se pronë e kujt ishte lëmi. Muadh b. Afra' u përgjigj: "O i Dërguari i Allahut, lëmi është i Sehlit dhe Suhejlit, dy djemve të Amrit. Ata janë dy jetimët e mi dhe unë do t'i bind ata që të pranojnë për ta ndërtuar aty xhaminë!"

Dhe vërtet Pejgamberi a.s. urdhëroi që aty të ndërtohet një xhami. Ndërkohë, derisa u ndërtua ajo dhe shtëpia, ai banoi tek Ebu Ejjubi. Vetë Pejgamberi a.s. ka marrë pjesë në ndërtimin e xhamisë në mënyrë që t'i inkurajonte muslimanët e tjerë në të. Kështu, në ndërtimin e saj kanë punuar edhe muhaxhirët edhe ensarët dhe kanë dhënë shumë mund. Një musliman në lidhje me të ka thënë:

*Kur punon Pejgamberi, ne si mund të rrimë?*

*Vërtet i gabuar do ishte për ne ky veprim!..*

Muslimanët duke ndërtuar xhaminë këndonin këtë varg:

*"Nuk ka jetë të vërtetë, përveç jetës në ahiret,  
o Allah, mëshiroji ensarët dhe muhaxhirët!"*

Ndërsa Pejgamberi a.s. thoshte:

*"Nuk ka jetë të vërtetë, përveç jetës në ahiretit,  
o Allah, mëshiroji muhaxhirët dhe ensarët!"*

Pejgamberi a.s. qëndroi tek Ebu Ejjubi derisa u ndërtua xhamia dhe shtëpia e tij, në të cilën pastaj u zhvendos, mëshira dhe kënaqësia e Allahut qoftë mbi të.

Ebu Ejjubi ka thënë:

"Kur erdhi Pejgamberi a.s. tek unë, u vendos në pjesën e poshtme të shtëpisë, ndërsa unë dhe gruaja ime jetonim në pjesën e sipërme. Unë i thashë: "O Pejgamberi i Allahut, nënë e babë t'u bëfshin kurban, unë vërtet po ndihem keq dhe po më vjen rëndë që unë të jem më lart, kurse ti të je më poshtë. Eja ti kalo lart, ndërsa ne po zbresim poshtë!"

Ai më tha: "O Ebu Ejjub, për mua dhe për këta që po më shoqërojnë është më e përshatshme të jemi në pjesën e poshtme të shtëpisë."

Pastaj tha: "Kështu që Pejgamberi a.s. mbeti në katin e poshtëm, ndërsa ne në të lartin. Një herë na u thye shtamba e madhe e mbushur me ujë dhe unë me Ummu Ejjubin (bashkëshorten) nxituam që ta mbledhim ujin nga frika se mos pikonte mbi Pejgamberin dhe e shqetësonte. Ujin e mbledhëm me një copë kadife me theka, sepse nuk kishim ndonjë gjë tjetër.

Ne i gatuanim darkën dhe ia dërgonim në katin e poshtëm. Kur na e kthente enën me pjesën e mbetur të ushqimit, unë dhe Ummu Ejjubi e preknim vendin ku

kishin mbetur gjurmët e dorës së tij, pastaj e hanim ushqimin e mbetur duke kërkuar me këtë fitimin e bereqetit.

Ka ndodhur që ne njëherë ia dërguam atij darkën në të cilën kishte qepë apo hudhër, nuk e mbaj mend mirë, dhe Pejgamberi a.s. na e ktheu. Në ushqim nuk vëreja asnjë gjurmë të duarve të tij. Shkova i shqetësuar dhe i thashë: “O i Dërguari i Allahut, na e ke kthyer darkën, kurse në ushqim unë nuk vëreja gjurmë të dorës tënde. Kur ti na e ktheje atë, unë dhe Ummu Ejjubi e preknim vendin ku kishin mbetur gjurmët e dorës tënde duke insistuar me këtë fitimin e bereqetit.”

Ai tha: *“Sonte në ushqim unë ndjeva aromën e kësaj bime dhe unë natën në vetmi i drejtohem Zotit. Ndërsa, sa u përket juve, ju mund të hani!”*

Tha: “Dhe ne vërtet e hëngrëm atë ushqim, por pas kësaj atij asnjëherë nuk i përgatitëm gjellë me qepë!”

Ibni Is'haku ka thënë:

“Pejgamberit a.s. vazhdimisht i bashkëngjiteshin muhaxhirët, kështu që në Mekë nuk kishin mbetur të tjerë përveç të arrestuarve dhe atyre që e kishin braktisur Islamin. Ata të cilët në emër të Allahut e pasuan Pejgamberin a.s. dhe e lëshuan Mekën megjithatë nuk i kishin marrë me vete krejt familjet e tyre dhe as tërë pasurinë. Të paktë ishin ata që e kishin bërë këtë, si: Benu Medhunët nga fisi Benu Xhumeh, pastaj Benu Xhahshët aleatët e Benu Umejjes, dhe Benu Bukejr nga fisi Benu Sa'd b. Lejth, aleatë të Benu Adijj b. Ka'bit. Shtëpitë e tyre në Mekë mbetën të mbyllura, pa asnjë njeri të gjallë në to.”

## FJALIMET DHE KONTRATAT NË MEDINË

Pejgamberi a.s., prej mbërritjes së tij në muajin rebiul-evvel e deri në muajin safer të të njëjtit vit, tërë kohën e kaloi në Medinë. Në këtë periudhë u ndërtua xhamia dhe shtëpia e tij dhe rreth tij u mblodhën të gjithë muslimanët. Në atë pjesë të Medinës nuk mbeti asnjë shtëpi jomuslimane. Kishin mbetur vetëm pjesëtarët e Hatmit, Vakifit, Vailit dhe Umejjes, të cilët i përkisnin fisit Evs dhe jetonin në lagjen e tyre. Ata edhe më tutje ngelën në idhujtari.

Hutbeja e parë e Pejgamberit a.s. - siç kam dëgjuar nga Ebu Seleme b. Abdurrahman dhe Allahu na ruajt që t'i atribuojmë diçka që nuk e ka thënë – kishte qenë kur ai ishte ngritur para tyre, pastaj i kishte shprehur falënderim Allahut dhe kishte thënë:

*“O njerëz, përgatituni mirë për veten dhe dijeni se çdo kush nga ju do të vdesë dhe do ta lërë kopenë e tij pa bari. Pastaj Zoti i tij do t'i thotë, i Cili nuk do të ketë as përkthyes e as ndërmjetës: “A nuk të erdhi i Dërguari Im për ta sjellë Shpalljen? A nuk të dhashë pasuri dhe të nderova? Nga e gjithë kjo, çka ke përgatitur për vete? Njeriu do të shikojë djathtas e majtas dhe nuk do të shohë asgjë. Pastaj do të shikojë para vetes dhe do të shohë xhehenemin. Kush mundet të shpëtojë nga zjarri, le ta bëjë këtë së paku edhe me një gjysmë hurme. Nëse nuk e ka edhe këtë, le të flasë ndonjë fjalë të mirë. Shpërblimi për çdo veprë të mirë është nga dhjetë deri në shtatëqind herë nga vepra e bërë. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju!”*

Në një hutbe tjetër Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“I tërë falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderoj dhe prej Tij ndihmë kërkoj. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s'ka kush e devijon dhe kë e largon nga rruga e vërtetë s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç Allahut që është një dhe nuk ka shok.*

*Fjalimi më i mirë është Libri i Allahut të Madhërishëm, ndërsa i shpëtuar është ai të cilit Allahu ia zbukuron zemrën dhe e fut në Islam pas mosbesimit si dhe e zgjedh këtë libër nga të gjitha fjalimet e njerëzve. Ky vërtet është fjalimi më i bukur dhe më i rrjedhshëm. Doni atë që e do Allahu dhe doni Allahun me gjithë zemër. Asnjëherë mos t'ju bëhet i mërzitshëm të folurit e Allahut dhe përmendja e Tij dhe asnjëherë zemrat tuaja mos të tregojnë arrogancë ndaj Tij. Allahu në mes të gjithave që ka krijuar, zgjedh dhe përzgjedh. Ai ato i quan vepra më të mira<sup>77</sup>, njerëz të zgjedhur dhe fjalim të mirë e të bukur i cili në vetvete i përmban të gjitha të lejueshmet dhe të palejueshmet që u janë dhënë njerëzve.*

<sup>77</sup> Do të thotë dhikri dhe leximi i Kur'anit. Duke iu referuar ajetet kur'anor: “Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë...” (El-Kasas, 68)

*Vetëm Allahun adhuroni dhe asgjë mos i shoqëroni! Kini frikë prej Tij në mënyrë të denjë dhe jini të sinqertë ndaj Allahut në të gjitha ato që thoni me gojën tuaj! Le të mbretërojë mes jush dashuria me shpirtin hyjnor. Vërtet Allahu zemërohet nëse shkelet marrëveshja me Të. Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ju!”*

\* \* \*

Pejgamberi a.s. hartoi një dokument me shkrim ndërmjet muhaxhirëve dhe ensarëve. Në të njëjtën kohë ai përgatiti edhe një marrëveshje me hebrejtë, e cila ua siguronte atyre lirinë e fesë dhe të pronësisë dhe theksonte të drejtat dhe detyrimet e tyre. Ja teksti i marrëveshjes:

*“Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*

*- Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.*

*Ky është dokument të cilin e proklamoi Pejgamberi Muhamed për të gjithë besimtarët dhe muslimanët kurejshë dhe jethribas dhe për njerëzit që i pasojnë, shoqërohen dhe luftojnë së bashku me ta; të gjithë ata janë një popull (ummet), në krahasim me njerëzit e tjerë.*

*Muhaxhirët nga fisi Kurejsh do të mbeten në atë gjendje siç i ka gjetur Islami, në mënyrë të njëjtë do të paguajnë gjakun dhe pengjet e veta ndërmjet tyre do t'i lirojnë apo blejnë në mënyrë të bukur dhe të drejtë.*

*Pjesëtarët e fisit Benu Aof, njësoj sikur edhe deri më tash dhe siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.*

*Edhe fisi Benu Sa'ade, siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute si deri më tash. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.*

*Edhe fisi Benu Harith, siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute si deri më tash. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.*

*Edhe fisi Benu Xhushem, siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute si deri më tash. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.*

*Edhe fisi Benu Nexhhar, siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute si deri më tash. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.*

*Edhe fisi Benu Amër ibn Aof, siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute si deri më tash. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.*

*Edhe fisi Benu Nebijt, siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute si deri më tash. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.*

Edhe fisi Benu Evs, siç është zakon tek ata, do të tubojnë kontribute si deri më tash. Çdo bashkësi nga bamirësia dhe drejtësia që mbretëron mes besimtarëve do të paguajë blerjen e pengjeve të vet.

Besimtarët nuk do ta lënë asnjë anëtar të tyre të ngarkuar me obligime të rënda, por nga bamirësia ndaj tij ose do ta blejnë (nëse është rob) ose do të paguajnë vlerën e gjakut.

Besimtari nuk do të formojë aleancë me robin e besimtarit tjetër në dëm të tij.

Të gjithë besimtarët e devotshëm patjetër duhet t'i kundërvihen tiranit ose atij i cili është i gatshëm për të kryer padrejtësi e krime, i cili i shkel të drejtat apo fut hutim mes besimtarëve. Të gjithë bashkërisht le t'i kundërvihen atij, madje edhe nëse është djali i ndonjërit prej tyre!

Besimtari nuk guxon ta vrasë besimtarin tjetër për shkak të jobesimtarit, e as ta përkrahë jobesimtarin kundër besimtarit.

Jomuslimanët (dhimmetullah) në shtetin islam, të cilët janë në mbrojtjen e Allahut, janë të gjithë të barabartë - edhe njeriu i tyre do të jetë i mbrojtur.

Besimtarët janë miq të njerit-tjetrit kundër të tjerëve.

Hebrenjtë, të cilët lidhen me ne, fitojnë të drejtën e ndihmës dhe përkrahjes sonë; askush nuk do t'i shtypë e as do t'i ndihmojë armiqtë e tyre.

Paqja mes besimtarëve është unike dhe e pandarë, asnjë besimtar nuk guxon të lidhë paqe me besimtarët e tjerë kur është fjala për luftën në rrugën e Allahut, aty do të jenë të barabartë dhe të drejtë mes vete.

Të gjitha njësitë luftarake, të cilat luftojnë në anën tonë, patjetër duhet të ndihmohen mes tyre.

Besimtarët, për çdo anëtar të tyre të vvarë, për gjakun e atij që ka rënë në rrugën e Allahut, për kompensim do të vrasin nga një armik.

Besimtarët e devotshëm do t'i përmbahen udhëzimit më të mirë dhe më të drejtë.

Idhujtari nuk mund t'u ofrojë Kurejshëve ndihmë materiale e as personale, as nuk bën të nxisë kundër besimtarëve.

Nëse dikush e vret besimtarin pa ndonjë bazë dhe pa arsye, mbi të do të aplikohet ligji i hakmarrjes, përveç nëse familja e të vvarit ia fal atij. Përndryshe, të gjithë besimtarët do të ngrihen kundër tij dhe janë të detyruar ta sulmojnë.

Asnjë besimtar i cili ka pranuar atë që gjendet në këtë dokument dhe i cili beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit nuk i lejohet ta ndihmojë e as strehojë novatorin. Kush e ndihmon dhe e strehon atë, mbi të bie mallkimi dhe hidhërimi i Allahut në Ditën e Gjykimit dhe nuk pranohet prej tij dëmshpërblim e as pendim.

Ju sa herë që të mos pajtoheni mes vete për çështjet diskutabile, përsëri duhet t'i ktheheni Allahut të Madhërishëm dhe Pejgamberit të Tij.

Hebrenjtë duhet të ndajnë fonde së bashku me besimtarët, për aq kohë sa janë në luftë.

Hebrenjtë e fisit Benu Avf formojnë një bashkësi me besimtarët. Ata ndjekin fenë e tyre, kurse muslimanët të vetën, qofshin vetë ata apo miqtë e tyre, përveç atij i cili bën krime dhe mëkat, ai dëmton vetëm veten dhe familjen e tij.

Hebrenjve të fisit Benu Nexhxhar u takojnë po ato të drejta sikur edhe atyre të fisit Benu Avf.

Hebrenjve të fisit Benu Harith u takojnë po ato të drejta sikur edhe atyre të fisit Benu Avf.

Hebrenjve të fisit Benu Sa'ade u takojnë po ato të drejta sikur edhe atyre të fisit Benu Avf.

Hebrenjve të fisit Benu Xhushem u takojnë po ato të drejta sikur edhe atyre të fisit Benu Avf.

Hebrenjve të fisit Evs u takojnë po ato të drejta sikur edhe atyre të fisit Benu Avf.

Hebrenjve të fisit Benu Thalebe u takojnë po ato të drejta sikur edhe atyre të fisit Benu Avf. Përjashtim bën ai i cili bën krime dhe mëkat, ai dëmton vetëm veten dhe familjen e tij.

Xhefnët janë degë e Thalebes. Ata kanë të njëjtin status si vetë Thalebe.

Edhe Benu Shutejbëve u takojnë po ato të drejta sikur edhe atyre të fisit Benu Avf, kurse bamirësia duhet të jetë mbrojtje nga e keqja.

Miqtë e fisit Thalebe janë të barabartë me ta, përndryshe, edhe bashkësia hebreje konsiderohet si edhe vetë hebrenjtë.

Asnjë prej tyre nuk mund të dalë (në luftë) me muslimanët përveç me leje të Muhamedit a.s..

Askujt nuk do t'i ndalohet të hakmerret për plagët e shkaktuara sepse kush e mbyl tjetrin, në fakt ai mbyl vetveten dhe familjen e tij, përveç atij të cilit i bëhet dhunë. Të gjitha këto Allahu m'i ka pranuar dhe miratuar.

Hebrenjtë në luftë do të marrin pjesë me pasuritë e tyre, edhe muslimanët me pasuritë e tyre. Ata do të ndihmohen mes tyre kundër atij i cili i lufton nënshkruesit e këtij dokumenti. Ata duhet të këshillohen mes tyre dhe të kenë marrëdhënie miqësore ku e mira bëhet mburojë ndaj së keqes.

Nuk do të dëmtohet aleati. Do t'i ofrohet ndihmë të dëmtuarit.

Hebrenjtë do t'i mbulojnë shpenzimet e luftës, së bashku me muslimanët, derisa janë në luftë<sup>78</sup>.

I gjithë territori i Jethribit është i shenjtë dhe i pacenueshëm për të gjitha subjektet e këtij dokumenti.

Fqinji është si vetë personi, nuk guxon t'i bëhet atij asnjë dëm as mëkat.

<sup>78</sup> Kjo ka qenë para se të përcaktohej xhizja, derisa Islami ishte ende i dobët. Hebrenjtë atëherë kishin pjesën e tyre në plaçkën e luftës, sa herë që luftonin bashkë me muslimanët. Prandaj, ky dokument i obligon ata për pjesëmarrje materiale në luftëra.

*Ajo që nuk është pronë private mund të tregtohet vetëm me lejen e poseduesit të saj.*

*Për çdo gjë që ndodh mes subjekteve të këtij dokumenti, ndonjë rast apo grindje që mund të shkaktojë rrëmujë, duhet të kthehet tek Allahu i Plotfuqishëm dhe te Pejgamberi i Tij, Muhamedi a.s..*

*Me të vërtetë, çdo gjë që është në këtë dokument Allahu e ka pranuar dhe miratuar!*

*Me Kurejshët dhe ndihmësit e tyre nuk do të ketë kurrfarë tregtie dhe të gjithë do të ndihmojnë njëri-tjetrin kundër atyre që sulmojnë Jethribin.*

*Nëse u kërkohet (hebrenjve) armëpushim që ta respektojnë dhe t'i përmbahen, ata do ta pranojnë dhe respektojnë, edhe ndaj tyre do të veprohet në të njëjtën mënyrë. Po ashtu nëse ata kërkojnë diçka të ngjashme (nga muslimanët), muslimanët do ta pranojnë atë dhe do ta respektojnë, përveç atij i cili lufton për shkak të fesë.*

*Të gjithë njerëzit e kanë zonën e tyre të përgjegjësisë në anën dhe në fushën ku jetojnë.*

*Hebrenjtë e fisit Evs dhe përkrahësit e tyre kanë trajtim të njëjtë si të gjithë të tjerët që janë të përfshirë në këtë dokument, me kushtin e respektimit të plotë. Marrëdhëniet e mira do të jenë mbrojtje ndaj së keqes.*

*Kush bën diçka jashtë kësaj, do t'i bartë vetë pasojat e saj. Me të vërtetë, çdo gjë që është në këtë dokument Allahu e ka pranuar dhe miratuar, andaj kjo do të aplikohet edhe ndaj çdo shtypësi dhe kriminel. Kush dëshiron të dalë nga Medina është i sigurt, sikurse edhe ai që mbetet në të, përveç atij që bën ndonjë krim apo tirani. Me të vërtetë Allahu është me atë i cili është vepërmirë dhe i devotshëm, gjithashtu edhe i Dërguari i Tij, Muhamedi a.s."*

## VËLLAZËRIMI MES MUHAXHIRËVE DHE ENSARËVE

Ibni Is'haku thotë:

“I Dërguari i Allahut a.s. pastaj bëri vëllazërimin mes muhaxhirëve dhe ensarëve. Me atë rast, siç kam dëgjuar, dhe Allahu na ruajt që t’i atribuojmë diçka që nuk e ka thënë, kishte thënë:

“*Vëllazërohuni në emër të Allahut, dy nga dy!*” Pastaj ia kapi dorën Ali b. Ebi Talibit dhe tha: “*Ky është vëllai im!*” Kështu, Pejgamberi a.s., prijësi i Pejgamberëve, lideri i të devotshmëve, i dërguar prej Zotit të të gjitha botëve, i Cili nuk ka as të barabartë e as të ngjashëm ndër krijesat e Tij, u vëllazërua me *Ali b. Ebi Talibin*, Allahu qoftë i kënaqur me të!” Pastaj u vëllazërua *Hamza b. Abdulmuttali*, ‘Luani i Zotit dhe i Pejgamberit të Tij’ dhe xhaxhai i Pejgamberit, me *Zejd b. Harithen*, robin e liruar të Pejgamberit a.s.. Hamza më vonë, në betejën e Uhudit, e kishte porositur që në qoftë se vdes, ai t’ia kryejë testamentin. U vëllazëruan po ashtu edhe *Xhafer b. Ebi Talibi*, i cili, sipas asaj që Pejgamberi kishte parë në xhenet, kishte dy krahë, dhe *Muadh b. Xhebeli*, vëllai prej gjaku i Beni Selemes.

Janë vëllazëruar gjithashtu edhe: Ebu Bekër Siddik b. Ebi Kuhafe dhe Harixhe b. Zuhejr; Omer b. Hattab dhe Itban b. Malik; Ebu Ubejde b. Xherrah dhe Sa’d b. Muadhi; Abdurrahman b. Avf dhe Sa’d b. Rebij’; Zubejr b. Avvam dhe Seleme b. Selame b. Vaksh; Osman b. Affan dhe Evs b. Thabit b. Mundhir; Talha b. Ubejdullah dhe Ka’b b. Malik; Seid b. Zejd b. Amër b. Nufejl dhe Ubej b. Ka’b; Mus’ab b. Umejr dhe Ebu Ejjub Halid b. Zejd; Ebu Hudhejfe b. Utbe dhe Ubad b. Bishr; Ammar b. Jasir dhe Hudhejfe b. Jeman; Ebu Dherr Gifarij dhe Mundhir b. Amër; Hatib b. Ebi Beltea’ dhe Uvejm b. Sa’ade; Selman Farisiu dhe Ebu Derda’ dhe Bilali, rob i liruar i Ebu Bekrit dhe Ebu Ruvejha.

Këta janë emrat e disa prej sahabëve të Pejgamberit a.s., të cilët Pejgamberi i ka vëllazëruar mes tyre.

## ÇËSHTJA E EZANIT

Pasi Pejgamberi a.s. u stabilizua në Medinë, kur rreth tij u mblohdën të gjithë muhaxhirët, kur u bashkuan ensarët, kur Islami u forcua, kur po falej namazi, u urdhëruan zekati dhe agjërimi, kur u vendosën masat juridike ndëshkuese të sheriatit, kur u rregullua çështja e urdhëresave dhe ndalesave (hallallit dhe haramit), kur Islami u vendos në mesin e tyre, kjo zonë ku banonin ensarët u bë e mbushur plotësisht me iman.

Në fillim, pas ardhjes së Pejgamberit a.s. në Medinë, njerëzit shkonin tek ai për namaz pa ndonjë thirrje të veçantë. Kështu ai filloi të mendojë për të futur një bori, sikurse ajo e hebrenjve, pas zërit të së cilës ata do të nxitonin në lutjen e tyre, por pastaj hoqi dorë. Pastaj, ai urdhëroi që të gdhendet një kambanë dhe me të goditur të saj muslimanët do të njoftoheshin për namaz.

Derisa kambana ishte në përgatitje e sipër, Abdullah b. Zejd b. Thalebe, vëllai i Belharith b. Hazrexh, kishte parë një ëndërr interesante në të cilën kishte dëgjuar një thirrje. Menjëherë kishte shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i kishte thënë:

“O i Dërguari i Allahut, mbrëmë në ëndërr një njeri është sjellë rreth meje, i veshur me dy rroba të gjelbra dhe në dorë mbante një kambanë, ndërsa unë i thashë: “O robi i Zotit, a po ma shet mua atë kambanë?”

Tha: “Çfarë do të bësh me të?” I thashë: “Të thërrasim me të për namaz.” Ai më tha: “A do të të udhëzoj për diçka më të mirë?”

Unë i thashë: “Cila është ajo?” Tha: “Të thuash: *Allahu ekber, Allahu ekber; Allahu ekber, Allahu ekber. Eshhedu en la ilahe il-lallah, eshhedu en la ilahe il-lallah. Eshhedu enne Muhammeden resulullah, eshhedu enne Muhammeden resulullah. Hajje ales-salah, hajje ales-salah. Hajje alev-felah, hajje alev-felah. Allahu ekber, Allahu ekber. La ilahe il-lallah!*”

Kur ia tregoi këtë Pejgamberit a.s., ai tha: “Njëmend, ajo është një ëndërr e vërtetë, me vullnetin e Allahut! Shko e tregoji Bilalit dhe ai kështu le të bëjë thirrje për namaz, sepse ai ka zë më të lartë dhe më tingëllues se ti!”

Derisa Bilali po këndonte ezanin, e dëgjoi Omer b. Hattabi nga shtëpia e tij, i cili menjëherë, duke tërhequr zvarrë pelerinën e tij, nxitoi për tek Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O Pejgamber i Zotit, pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, edhe unë pashë në ëndërr të njëjtën gjë si ai!” Ndërsa Pejgamberi a.s. i tha: “Allahut i qoftë falënderimi për këtë!”

## SHOKËT E SËMURË TË PEJGAMBERIT a.s.

Aishja r.a. transmetohet të ketë thënë:

“Kur Pejgamberi a.s. erdhi në Medinë, ajo zonë ishte prekur nga një epidemi e madhe ethesh, kështu që shumë sahabë ishin sëmurë prej saj, ndërsa Pejgamberin a.s. Allahu e kishte ruajtur prej saj. Ebu Bekri dhe dy robërit e liruar të tij, Bilali dhe Amir b. Fuhejre, jetonin në një shtëpi dhe që të tre i kishin prekur ethet. Unë shkova për t’i vizituar para se të urdhërohej mbulesa e femrave. Kur shkova, ata ishin të sflitur nga dhembjet e forta. Iu afrova Ebu Bekrit dhe i thashë: “Si je, o baba?” Ai u përgjigj:

*“Secili njeri gdhihet në familjen e tij,  
ndërsa vdekjen e ka më afër se lidhëza e këpucës së tij!”*

Unë thashë: “Vallahi, babai im nuk di çfarë flet!” Pastaj iu afrova Amir b. Fuhejres dhe e pyeta: “Si je, o Amir?” Ai m’u përgjigj:

*“Unë e gjeta vdekjen para se ta shijoja,  
ndërsa fundi i frikacakut vigjilon mbi të!  
Secili njeri mundohet brenda forcës që ka,  
sikurse demi i cili mbrohet me brirët e tij!”*

Unë thashë: “Vallahi, as Amiri nuk di çfarë flet!” Bilalin kur e kaplonin ethet shtrihej në oborrin e shtëpisë dhe kur shkova tek ai, me zë të lartë tha:

*“Ah sikur ta di: - a do ta kaloj natën  
edhe ndonjëherë në Fehh<sup>79</sup>,  
në mes të vegjetacionit me kallam aromatik dhe mendër,  
dhe a do të pi ndonjëherë ujin e Mexhennes<sup>80</sup>,  
dhe a do ta shikoj edhe një herë Shammen dhe Tafilen!?”<sup>81</sup>*

Këto që dëgjova prej tyre unë menjëherë ia tregova Pejgamberit a.s. duke i thënë: “Ata me të vërtetë po flasin pa lidhje për shkak të temperaturës së lartë, nuk e dinë çfarë janë duke thënë!” Atëherë Pejgamberi a.s. tha:

*“O Allahu im, na bëj ta duam Medinën ashtu siç e duam Mekën, madje edhe më shumë! Na jep bereqet në gjithçka që peshohet me mudd dhe sa’ë<sup>82</sup> dhe zhvendose këtë epidemi në Xhuhfe!”<sup>83</sup>*

<sup>79</sup> Fehh, emër vendi jashtë Mekës.

<sup>80</sup> Mexhenne është emri i një tregu të arabëve paraislamike që gjendej në pjesën e poshtme të Mekës, në një largësi rreth 12 milje.

<sup>81</sup> Shamme dhe Tafile janë dy kodra në Mekë.

<sup>82</sup> Mudd dhe sa’ a janë dy lloje masash.

<sup>83</sup> Xhuhfe është vend në mes të Mekës dhe Medinës.

## DATA E HIXHRETIT

Pejgamberi a.s. në Medinë mbërriti të hënën, në kohën e të nxehtit më të ashpër të ditës, kur dielli qëndronte pothuajse vertikalisht, pas 12 netëve të muajit rebiul-evvel. Pejgamberi a.s. atëherë ishte 53 vjeç, pra 13 vjet pas shpalljes së parë nga Allahu i Madhërishëm. Në Medinë ai kaloi pjesën tjetër të muajit rebiul-evvel, muajin rebiu-lahir, xhumadel-ula, xhumadel-uhra, rexheb, shaban, ramazan, shevval, dhul-kade, dhul-hixhxhe dhe muharrem.

## BETEJA E PARË

Në muajin safer, në fillim të muajit të dymbëdhjetë nga ardhja e tij në Medinë, Pejgamberi a.s. ndërmori fushatën e tij të parë ushtarake. Ajo ishte në Veddan, e a.q. Beteja në Ebva. Objektivi ishin Kurejshët dhe Benu Dumre b. Bekr b. Abd Menat b. Kinane. Me atë rast, Benu Dumre bëri marrëveshje paqeje me Pejgamberin a.s. dhe ai pastaj u kthye në Medinë në mënyrë të sigurt, pa ndonjë befasi apo konspiracion. Aty kaloi pjesën tjetër të muajit safer dhe pjesën e parë të muajit rebiul-evvel.

## **EKSPEDITA E UBEJDE B. HARITH** **- Flamuri i parë i ngritur nga pejgamberi a.s.-**

Pejgamberi a.s. nisi nga Medina një çetë prej 60 apo 80 kalorësish të udhëhequr nga Ubejde b. Harith b. Muttalib b. Abd Menaf b. Kusajj, e cila e tëra përbëhej vetëm prej muhaxhirëve pa asnjë ensar. Ubejde marshoi derisa mbërriti te një burim, në pjesën e poshtme të grykës Murre, ku u përball me një numër të madh Kurejshësh. Megjithatë, konflikti mes tyre nuk ndodhi. E vetmja gjë që ndodhi ishte se Sa'd b. Ebi Vekkas u godit me një shigjetë. Ajo ishte shigjeta e parë e hedhur në Islam.

Pastaj të dy grupet u shpërndanë, ndërsa muslimanët u zbrapsën.

### **Dalja e çetës së Hamzës në bregdet**

Nga vendi i njëjtë, Pejgamberi a.s. dërgoi Hamza b. Abdulmuttalib b. Hashimin në krye të një çete prej tridhjetë kalorësish, të gjithë ishin muhaxhirë, nuk kishte asnjë ensar. Hamza i udhëhoqi ata në bregdet nga drejtimi i Ijsit. Në atë bregdet takoi Ebu Xhehl b. Hishamin, i cili kishte 300 kalorës nga Meka. Megjithatë, mes tyre ndërmjetësoi Mexhdi b. Amër Xihniu, i cili me të dyja palët kishte raporte miqësore. Kështu të dy grupet u shpërndanë dhe mes tyre nuk pati luftime.

### **Ekspedita në Buvat**

Pejgamberi a.s. pastaj në muajin rebiul-evvel u nis me ushtri në drejtim të Kurejshëve<sup>84</sup> dhe arriti në vendin Bevat<sup>85</sup> nga ana e Radvas, pastaj u kthye në Medinë pa pasur përleshje dhe qëndroi aty pjesën e mbetur të muajit rebiul-ahir dhe një pjesë të xhumadel-ula.

### **Ekspedita në Ushajre**

Pastaj Pejgamberi a.s. ua mësyu Kurejshëve<sup>86</sup> nëpër rrugën malore të Benu Dinarëve e pastaj nëpër rrafshinën e Habbarit derisa u ndal nën një pemë palme të Ibn Ez'herit. Aty fali namazin, kurse tani aty gjendet xhamia e tij. Në atë vend

<sup>84</sup> Në Medinë si zëvendës të tij la Saib b. Osman b. Medhunin.

<sup>85</sup> Buvat dhe Redva janë dy nga bjeshkët e Xhuhejnes, në afërsi të Jenbuas.

<sup>86</sup> Në Medinë si zëvendës të tij la Ebu Seleme b. Abdulesedin.

iu përgatit ushqimi dhe ai hëngri së bashku me njerëzit e tjerë. Aty ku është gatuar ushqimi ende janë të dukshëm gurët në të cilën janë vendosur qypat. Ndërkaq, ujin ia sollën nga burimi i Mushtereb.

Pejgamberi a.s. pastaj vazhdoi rrugën duke e lënë Halaikun<sup>87</sup> në anën e majtë, duke depërtuar nëpër ngushticën e njohur si ngushtica e Abdullahut. Pastaj u kthye majtas dhe zbriti në Jeljel, e prej aty bashkë me njerëzit e tij dhe njerëzit nga Dabbua' zbriti edhe më poshtë te një pus dhe aty pinë ujë. Pastaj vazhdoi fushës, nëpër fushën Melel, derisa doli në rrugë në zonën e enklavave të vogla shkretinore të Jemames. Pastaj rruga e çoi drejt për në Ushajre në brendi të Jenbuas. Ai aty kaloi tërë muajin xhumadel-ula dhe disa net të xhumadel-uhras. Gjatë asaj kohe lidhi disa marrëveshje miqësore me fisin Benu Mudelexh dhe aleatët e tyre nga fisi Benu Damre. Së fundi, pa luftuar u kthye në Medinë.

### **Ekspedita e Sa'd b. Ebi Vekkasit**

Ndërkohë, Pejgamberi a.s. dërgoi në ekspeditë Sa'd b. Ebi Vekkasin me tetë grupe muhaxhirësh. Ata shkuan deri në Harrar të Hixhazit, por u kthyen pa zhvilluar luftë.

### **Ekspedita në Safvan apo ekspedita e parë e Bedrit**

Pejgamberi a.s. pas kthimit nga ekspedita në Ushajre, qëndroi në Medinë vetëm disa net, gjithsesi më pak se dhjetë. Kur kafshët e Medinës i kishte sulmuar Kurz b. Xhabir Fihriu, Pejgamberi a.s. menjëherë u nis në ndjekje të tij<sup>88</sup> dhe arriti deri te lugina e quajtur Safvan në afërsi të Bedrit. Kurz b. Xhabirit ia doli të ikte, ndërsa ekspedita trajtohet si 'Ekspedita e parë e Bedrit'. Pas saj, Pejgamberi a.s. u kthye në Medinë dhe aty kaloi pjesën e mbetur të muajit xhumadel-ahir, rexhebin dhe shabanin.

### **Ekspedita e Abdullah b. Xhahshit**

Pejgamberi a.s. dërgoi Abdullah b. Xhahshin, të besuarin e tij nga ekspedita e parë e Bedrit, në muajin rexheb me tetë çeta të përbëra tërësisht nga muhaxhirët. I dorëzoi edhe një letër dhe e urdhëroi që ta lexonte vetëm pas dy ditësh udhëtim. Ai u nis sipas asaj që e urdhëroi, por askënd nuk e detyroi që të shkonte me të.

<sup>87</sup> Halaik, tokë në Medinë, e cila ishte pronë e Abdullah b. Ahmed b. Xhahsh.

<sup>88</sup> Në Medinë si zëvendës të tij la Zejd b. Harithe.

Pas dy ditë udhëtimi Abdullah b. Xhahshi hapi letrën. Aty lexoi: *“Kur ta lexosh letrën time, vazhdo tutje derisa të arrish në Nahle, në mes Mekës dhe Taifit. Nga atje, vëzhgoji Kurejshët dhe na mblidh të gjitha informatat e mundshme në lidhje me ta!”*

Pasi e lexoi Abdullahu letrën, tha: *“E kuptova dhe u bindëm!”* Pastaj u tha shokëve të tij: *“Pejgamberi a.s. më ka urdhëruar që të shkoj deri në Nahle dhe prej andej t’i vëzhgoj Kurejshët dhe ta informoj për këtë. Më ka ndaluar që ndonjërin nga ju ta detyroj për këtë. Prandaj, kush nga ju e dëshiron shehidllëkun, le të nisët për atje, ndërsa kush nuk dëshiron, le të kthehet! Ndërsa unë, personalisht, po shkoj sipas urdhrit të Pejgamberit a.s..”*

Dhe ai u nis e me të u nisën edhe të gjithë shokët e tij, asnjëri prej tyre nuk hoqi dorë.

Kështu ai hyri në Hixhaz. Mirëpo, në një pllajë pranë burimit të quajtur Bahran, Sa'd b. Ebi Vekkasi dhe Utbe b. Gazvan humbin devenë e tyre, së cilës i hipnin me ndërrime. Kështu, ata të dy mbetën duke e kërkuar atë, ndërsa Abdullah b. Xhahshi me të tjerët vazhduan rrugën derisa arritën Nahle. Aty pranë tyre kaloi një karvan i Kurejshëve i ngarkuar me rrush të thatë, me lëkurë dhe me mallra të tjera tregtare të Kurejshëve. Në karvanë gjendeshin Amër b. Hadremiu, Osman b. Abdullah b. Mugire dhe vëllai i tij Nufel b. Abdullah dhe Hakem b. Kejsan.

Kur i panë ata aq afër, u frikësuan. Ata i vërejti Ukkashe b. Muhsan, i cili e kishte rruar kokën dhe kishte dalë përpara me qëllim që të hetonte gjendjen. Kur e panë atë, ata u qetësuan dhe thanë: *“Janë vendorë, mos u frikësoni!”*

Atëherë filluan të konsultohen rreth tyre. Kjo ishte në ditën e fundit të muajit rexheb. Njerëzit thanë: *“Vallahi, nëse i lini këta njerëz sonte, ata do të hyjnë në muajt e ndaluar (të shenjtë) dhe nuk do të mund t’u bëni asgjë, ndërsa në qoftë se i vrisni, pa dyshim do t’i vrisni në muajt e ndaluar!”*

Kështu ata u gjendën në dilemë, kishin frikë të vërsuleshin mbi ta. Pastaj e inkurajuan veten dhe ranë dakord që t’i sulmojnë dhe të vrasin kë të munden, ndërsa mallrat t’i konfiskojnë. Atëherë, Vakid b. Abdullah Temimiu gjuajti një shigjetë, me të cilën qëlloi Amër b. Hadremijun dhe e vrau. Osman b. Abdullahu dhe Hakem b. Kejsani u kapën robër, ndërsa Nufel b. Abdullahu u shpëtoi dhe iku. Abdullah b. Xhahshi me karvanin dhe dy robërit u kthye në Medinë te Pejgamberi a.s..

Pasi u kthyen te Pejgamberi a.s. në Medinë, ai u tha: *“Unë nuk ju kam urdhëruar që të vrisni në muajin e ndaluar!”* Ai e ndali karvanin dhe dy robërit dhe refuzoi të marrë ndonjë gjë nga malli i konfiskuar. Pasi i tha këto fjalë, njerëzit shprehën keqardhjen e tyre dhe menduan se janë shkatërruar. Vëllezërit e tyre muslimanë i qortuan ashpër për veprimin që kishin bërë.

Kurejshët thanë: “Muhamedi dhe njerëzit e tij e kanë shkelur shenjtërinë e muajit të ndaluar! Ata në këtë muaj kanë bërë vrasje, kanë rrëmbyer pasuri dhe kanë robëruar njerëz!”

Muslimanët që ende ndodheshin në Mekë u përgjigjeshin: “Kjo që kanë bërë ata ka ndodhur në muajin shaban!”

Kur njerëzit filluan të flasin me të madhe për këtë, Allahu i Madhërishëm i shpalli të Dërguarit të Tij:

*“Të pyesin për luftën në muajin e shenjtë, thuaj: “Lufta në të është e madhe (mëkat i madh), por pengimi nga rruga e Allahut, mosbesimi ndaj Tij, pengimi nga xhamia e shenjtë (Qabeja) dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo janë mëkate edhe më të mëdha tek Allahu.”*

Do të thotë se nëse ju keni vrarë në muajin e shenjtë, ata ju kanë penguar ju nga rruga e Allahut, kanë bërë kufër dhe ju kanë penguar nga xhamia e shenjtë (Qabeja). Nxjerrja juaj prej saj, duke qenë ju pronarë të saj, është më e rëndë tek Allahu sesa vrasja që keni bërë ju.

*“E fitneja është edhe më e madhe se mbyjtja.”* Kjo do të thotë se ata i kanë torturuar muslimanët për ta lënë fenë e tyre e të kthehen në mosbesim pasi kanë besuar, kjo tek Allahu është më e madhe se vrasja.

*“Ata do t’u luftojnë ju vazhdimisht për t’ju zbrapsur, nëse munden, nga feja juaj.”* (El-Bekare, 217). Do të thotë se ata vazhdimisht do të bëjnë veprimet më të neveritshme dhe më të tmerrshme, pa u larguar e as pa u penduar për to.

Pasi u shpallën këto ajete, me të cilat Allahu i lehtësoi muslimanët dhe ua largoi shqetësimin dhe frikën që i kishte kapluar, Pejgamberi a.s. vendosi ta mbajë karvanin dhe dy të robëruarit. Ndërkohë, Kurejshët dërguan një ofertë për të blerë Osman b. Abdullahun dhe Hakem b. Kejsanin, por Pejgamberi a.s. u përgjigj:

*“Jo, nuk do t’ua dorëzojmë ata, derisa të na vijnë dy njerëzit – d.m.th. Sa’d b. Ebi Vekkasi dhe Utbe b. Gazvani – për të cilët kemi frikë nga ju. Nëse ju i vrisni ata, edhe ne do t’i vrasim këta të dy!”*

Së shpejti erdhën Sa’di dhe Utbe, kështu që Pejgamberi a.s. në këmbim të tyre i liroi dy robërit.

Hakem b. Kejsani më vonë e pranoi Islamin dhe u bë musliman i mirë. Ai mbeti me Pejgamberin derisa vdiq si shehid në betejën e Bi’r Maune, ndërsa Osman b. Abdullahu mbeti në Mekë, ku vdiq si jobesimtar.

## RIORIENTIMI I KIBLES NË DREJTIM TË QABESË

Pohohet se riorientimi i kibles në drejtim të Qabesë ka ndodhur në muajin shaban, në fillim të muajit të 18-të të shpërnguljes së Pejgamberit a.s. në Medinë.

## BETEJA E MADHE E BEDRIT

Pejgamberi a.s. mori vesh se Ebu Sufjan b. Harbi po kthehej nga Siria me një karvan të madh të Kurejshëve, i cili kishte një pasuri të madhe dhe mallra tregtie. Me karvanin ishin edhe 30-40 njerëz, në mesin e të cilëve ishin Mahzeme b. Nufel dhe Amër b. 'As, ndaj menjëherë i drejtoi muslimanët në drejtim të tyre. Ai tha: *“Ky është një karoan i Kurejshëve me mallrat e tyre. Shkoni në drejtim të tij, ndoshta Allahu do të na e dhurojë.”*

Dhe njerëzit u nisën në drejtim të tij, disa me lehtësi, disa të hutuar, sepse nuk besonin se Pejgamberi a.s. mund të niste një luftë.

Ebu Sufjani kur iu afrua Hixhazit, përgjonte lajmet dhe nga frika për njerëzit e tij konsultohej me kalimtarët. Disa prej tyre e informuan duke i thënë: “Muhamedi ka mbledhur njerëzit dhe ka për qëllim të të sulmojë ty dhe karvanin!” Kjo edhe më shumë ia shtoi kujdesin. Ai menjëherë angazhoi me pagesë Damdam b. Amër Giffariun dhe e dërgoi në Mekë, duke e urdhëruar që të shkojë te Kurejshët e t'u thotë atyre se pasuria e tyre është në rrezik dhe t'u tregojë se Muhamedi dhe njerëzit e tij kanë dalë për t'i kapur. Damdam b. Amri menjëherë nxitoi për në Mekë.

Tri net para se të mbërrinte Damdami në Mekë, Atika bint Abdulmuttalib kishte parë një ëndërr të tmerrshme, nga e cila ishte frikësuar shumë. Ajo dërgoi menjëherë lajm tek vëllai i saj Abbas b. Abdulmuttalibi dhe i tha: “O vëlla, unë mbrëmë pashë një ëndërr që më frikësoi shumë, ndaj kam frikë se popullin tënd mund ta godasë ndonjë bela. Mos i trego askujt këtë që do të të them!” Ai i tha: “Trego, çfarë pe?”

Ajo i tregoi kështu: “Erdhi një burrë i hipur mbi deve, qëndroi në Ebtah (mes Muhassabit dhe Mekës) dhe thirri me zë të lartë tri herë:

“O njerëz të pabesë! Brenda tri ditësh shkoni e arrini në fushën e betejës, në vendin ku keni për t'u shtrirë përtokë!” Njerëzit që e panë dhe e dëgjuan, iu mblodhën përreth. Pastaj burri hyri në Harem, në zonën e paprekshme të Qabesë. Njerëzit e ndiqnin pas. Ashtu, i rrethuar nga njerëzit, qëndroi pas Qabesë dhe përsëri thirri po ashtu. Pastaj u ngjit në malin Ebu Kubejs, ku bëri të njëjtën gjë. Pastaj kapi një shkëmb dhe e lëshoi të rrokullisej poshtë. Shkëmbi ra dhe u copëtua në rrëzë të malit dhe mbi shtëpitë. Nuk mbeti shtëpi e mëhallë e Mekës që të mos goditej nga copat e shkëmbit!”

Abbasi tha: “Vallahi, kjo qenka një ëndërr me shumë rëndësi! Kujdes, mos t'ia tregosh askujt këtë ëndërr!” Pastaj Abbasi doli dhe takoi Velid b. Utbe b. Rebian, një shokun e tij, të cilit menjëherë ia tregoi atë që kishte dëgjuar duke kërkuar

prej tij që mos t'ia tregonte tjetërkujt. Velidi i tregoi babait të tij Utbes dhe lajmi u shpërnda në mbarë Mekën, kështu që Kurejshët flitnin për të në vendtubimet e tyre.

Abbasi tha:

"Të nesërmen në mëngjes unë shkova për të bërë tavaf rreth Qabesë, ndërsa Ebu Xhehl b. Hishami ishte ulur me një grup Kurejshësh dhe po diskutonin ëndrrën e Atikes. Kur më pa mua, ai tha: "O Ebu Fadl, pasi ta mbarosh tavafin, eja te ne." Pasi e kreu tavafin, iu afrova dhe u ula në mesin e tyre, ndërsa Ebu Xhehli më tha:

"Oj familja e Abdulmuttalibit, kur është shfaqur në mesin tuaj kjo profete (parashikuese)?" I thashë: "Çfarë doni të thoni?"

Ai tha: "Ajo ëndrra që ka parë Atikja."

Unë i thash: "Çfarë ka parë ajo në ëndërr?"

Ai tha: "Oj familja e Abdulmuttalibit, a nuk po ju mjafton që burrat po thonë profeci, tani edhe gratë kanë filluar të merren me këtë? Atika pretendon se në ëndërr ka dëgjuar duke thënë: "Çohuni, o ju të pabesë, largojuni masakrave tuaja në këto tri ditë!" Ne, pra, do t'i presim këto tri ditë dhe në qoftë se është e vërtetë ajo që ka thënë, ajo do të ndodhë, por nëse kalojnë tri ditë dhe asgjë nuk ndodh, do të shkruajmë për ju si familja më gënjeshtare në mesin e arabëve!"

Abbasi tha: "Vallahi, nuk ishte e vështirë të tregohej ëndrra e Atikes, por megjithatë, unë e refuzova. Unë mohova që Atikeja të kishte ëndërruar ndonjë gjë, pastaj u ndamë.

Atë natë në shtëpinë time gati nuk mbeti asnjë grua pa ardhur e të më thotë: "Si e lejuat këtë të prishur të neveritshëm që t'i ofendojë njerëzit tuaj, e pastaj edhe gratë? Ti i ke dëgjuar të gjitha, a nuk pate xhelozit për atë që dëgjoje?"

Unë i thashë: "Vallahi, e kam bërë, edhe pse nuk e kisha vështirë t'i tregoja. Por, vallahi, do t'i kundërvihem nëse edhe një herë i kthehet kësaj teme, vërtet do t'ju mbroj prej tij!"

Në ditën e tretë pas ëndrrës së Atikes u zgjova shumë i zemëruar. M'u duk se e humba rastin që doja ta shfrytëzoja në takim me të. Hyra në tempull dhe e pashë. Vallahi, menjëherë shkova në drejtim të tij që ta takoja e ndoshta përsëri do të më fliste diçka të ngjashme, kështu që t'ia merrja hakun. Ai ishte një burrë i hollë, me fytyrë të mprehtë, me gjuhë të shkathët dhe me shikim të ashpër, mirëpo ai me ngut eci kah dera e tempullit. Unë thashë më vete: "Zoti e mallkoftë! Mos rastësisht po e bën këtë që unë mos ta qortoj?!"

Megjithatë, ai kishte dëgjuar atë që unë nuk kisha dëgjuar: zërin e Damdam b. Amër Giffariut, i cili po bërtiste nga lugina hipur mbi devenë e tij, së cilës ia kishte prerë hundën, e kishte kthyer samarin mbrapsht, e kishte grisur këmishën dhe në atë gjendje mu në mes të Mekës bërtiste me sa i hante zëri që sipër devesë:

“O Kurejshë! Karvani! Karvani! Muhamedi me shokë i sulmoi mallrat tuaja te karvani i Ebu Sufjanit! S’më besohet se do të mund ta arrini! Ndihmë! Ndihmë!”

Kështu, kjo gjë që na ra mbi krye na pengoi edhe mua edhe Ebu Xhehlin që të merreshim me njëri-tjetrin.”

Së shpejti njerëzit u përgatitën dhe thanë: “A mendon Muhamedi dhe njerëzit e tij se këtë herë do të jetë sikurse rasti i karvanit të Ibni Hadremiut?<sup>89</sup> Kurr-sesi! Vallahi, tani do të shohin diçka tjetër!”

Kështu ata u ndanë në dyshe: ose dolën vetë ose dërguan tjetërkënd në vend të vet. Kështu për në betejë u nis krejt fisi Kurejsh, nga liderët e fisit nuk mbeti asnjëri përveç Ebu Leheb b. Abdulmuttalibit, i cili në vend të vet dërgoi 'Asij b. Hisham b. Mugiren, të cilit si kompensim i shleu katër mijë derhemë nga borxhi që ai i kishte.

Umejje b. Halefi, që ishte një plak trupmadh, i mblodhi përreth vetes ata që kishin mbetur. Derisa ai ishte duke ndenjtur në harem me njerëzit, erdhi tek ai Ukbe b. Ebi Mu'it me një mangall me prush në dorë me një dru të vogël nga pema aloe, me të cilën parfumohej, të cilin e lëshoi para tij dhe i tha: “Parfumohu, o Ebu Ali! Edhe ashtu ti je si grua!”

Ky i tha: “Zoti të shëmtoftë ty dhe atë që solle!” Pastaj u ngrit, u përgatit dhe doli me njerëzit.

Kur u tubuan Kurejshët dhe u bënë gati për t'u nisur, u ra ndër mend beteja që kishin zhvilluar me Benu Bekr b. Abdi Menat e thanë: “Ne po frikësohemi se ndoshta do të na sulmojnë nga prapa!” Kjo gati i bëri të hamendeshin. Atëherë u paraqit Iblisi në figurën e Suraka b. Malik b. Xhushum Medlexhiut, i cili u tha: “Unë ju garantoj se Kenanijët nuk do t’ju bëjnë asnjë të keqe nga prapa.” Dhe ata dolën menjëherë.

Pejgamberi a.s. bashkë me sahabët e tij u nis pas disa netësh të muajit raman. Për t'i udhëhequr njerëzit në namaz ai caktoi Amër b. Ummi Mektumin, ndërsa Ebu Lubaben e ktheu nga Revha dhe e caktoi guvernator të Medinës. Flamurin me ngjyrë të bardhë ia dorëzoi Musab b. Umejrit. Para Pejgamberit valëviteshin dy flamuj të zi; njërin e mbante Ali b. Ebi Talibi, ndërsa tjetrin disa ensarë.

Shokët e Pejgamberit a.s. atëherë kishin gjithsej 70 deve dhe u hipnin me ndërime. Kështu, Pejgamberi a.s., Ali b. Ebi Talibi dhe Merthed b. Ebi Merthed Ganeviu hipnin në mënyrë alternative në një deve, kurse Hamza b Abdulmuttalibi, Zejd b. Harithe, Ebu Kepshe dhe Enesi robi i çliruar i Pejgamberit a.s., hipnin në një deve tjetër. Në devenë e tretë me ndërime hipnin Ebu Bekri, Omeri dhe Abdurrahman b. Avfi.

<sup>89</sup> Ai është Amër b. Hadremiu, i cili u vra në ekspeditën e Abdullah b. Xhahshit. Shih për këtë tek Ekspedita e Abdullah b. Xhahshit.

Nga Medina u nisën rrugës malore drejt Mekës. Pastaj kaluan nëpër Akik, Dhul-Hulejfe, pastaj nëpër Evlatul-Xhejsh, Turban, Melel, Gamisul-Hamam, pastaj nëpër një shkretëtirë të vogël të Jemames, pastaj nëpër Sejale, kanioni Revhae dhe Shenuke. Në vendin e quajtur Irkudh-Dhabje takuan një beduin, të cilin e pyetën për karvanin, por prej tij nuk mundën të mësojnë asgjë. Disa sahabë i thanë atij: “Përshëndete (jepi selam) Pejgamberin!” Tha: “Pse, a në mesin tuaj është Pejgamberi?” Thanë: “Po!” Atëherë ai e përshëndeti, pastaj tha: “Nëse ti je i Dërguar i Allahut, atëherë më trego mua çfarë ka në stomakun e devesë sime!” Atëherë ndërhyri Seleme b. Selame b. Vakshi dhe i tha: “Mos e pyet Pejgamberin, eja tek unë dhe unë të tregoj ty për të. Ti ke kërcyer mbi të dhe tani në barkun e saj ka një qengj!”

Pejgamberi a.s. tha: *“Ik, se e turpërove njeriun!”*

Pastaj Pejgamberi a.s. vazhdoi rrugën dhe zbriti në Sexhsexhe, që ishte një pus në Revha, pastaj vazhdoi tutje deri në Munsaref, prej nga rrugën për në Mekë e la nga ana e majtë dhe vetë u kthye në të djathtë nga Nazejja, në drejtim të Bedrit, duke e kaluar me shpejtësi luginën Ruhkan, diku në mes Nazejjes dhe grykës Safra'. Por kur iu afrua kësaj gryke, e dërgoi Besbes b. Amër Xhuheniun dhe Adijj b. Ebi Zagba Xhuheniun për të mbledhur informacione rreth Sufjan b. Harbit dhe të tjerëve. Në të njëjtën kohë ai me njerëzit e tij ndoqi rrugën.

Menjëherë pas kësaj i mbërriti lajmi për marshimin e Kurejshëve, të cilët po vinin për ta mbrojtur karvanin e tyre. Ai menjëherë për këtë i njoftoi njerëzit e tij dhe filloi konsultimin me ta.

I pari u ngrit Ebu Bekër Siddiku, i cili foli bukur dhe mençur.

Pastaj ai u ngrit Mikdad b. Amër, i cili tha: “O i Dërguari i Allahut! Shko rrugës të cilën ta ka treguar Allahu. Ne jemi me ty. Vallahi, çkado që të ndodhë ty, ne nuk do të themi ty siç i thanë Benu Israilët Musait: *“Shko ti dhe Zoti yt e luftoni, e ne do të rrimë këtu.”* (El-Maide, 24) Mirëpo, ne ty të themi: Shko ti me Zotin tënd, e luftoni, e ne do të luftojmë së bashku me ju. Pasha Atë që të ka dërguar Pejgamber, po qe se niseshe edhe në pjesën më të skajshme të Jemenit (Berkul-Gamad), ne do të luftonim së bashku me ty përderisa ta pushtosh.”

Pejgamberi a.s. e falënderoi për këto fjalë dhe iu lut Allahut për të, pastaj tha: *“O njerëz, më jepni ndonjë këshillë, më tregoni se çfarë të bëj!”*

Me këtë kryesisht u drejtohej ensarëve sepse ata ishin më të shumtë dhe kur i dhanë besën në Akabe i patën thanë: “O i Dërguari i Allahut, ne nuk mund të ofrojmë ty siguri pa ardhur në shtëpinë tonë dhe kur të vish, atëherë je nën mbrojtjen tonë. Aty do të të mbrojmë nga gjithçka që ne mbrojmë fëmijët tanë dhe gratë tona!” Pejgamberi a.s. kishte frikë se ensarët do ta mbrojnë vetëm nëse dikush e sulmon në Medinë dhe jo edhe në rastin nëse i çon kundër ndonjë armiku jashtë rajonit të tyre.

Pasi e tha këtë Pejgamberi, u ngrit Sa'd b. Muadhi dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, më duket se dëshiron të flasim edhe ne?"

Pejgamberi tha: "Ashtu është."

Sa'di vazhdoi: "Ne të kemi besuar dhe të jemi bindur, të tërën e kemi thënë atëherë kur pranuan se ti je Pejgamber dhe kur vërtetuam se shpallja që kumton ti është e vërteta, kur pranuan Islamin, kur dhamë betimin dhe premtimin tonë se do të jemi të dëgjueshëm dhe të bindur. Shko, o Pejgamber i Allahut, ngado që të dëshirosh, se ne do të vijmë me ty! Pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, edhe nëse do t'ia mësysh detit, edhe ne do të vijmë pas teje dhe dije se askush prej nesh nuk do të zbrapset. Ne nuk kemi frikë që nesër të ballafaqohemi me armikun. Ne jemi të durueshëm në luftë dhe të singërtë në takim. Ndoshta Allahu do të na paraqesë të atillë çfarë ke dëshirë të na shohësh. Na udhëhiq përpara, me ndihmën e Allahut!"

Këto fjalë të Sa'dit e gëzuan pa masë Pejgamberin a.s. dhe i dhanë vullnet për aksion.

Ai tha: "Nisuni dhe po ju jap sihariqin se Allahu më ka premtuar njërin prej dy grupeve<sup>90</sup>! Pasha Allahun, po më bëhet sikur jam duke e parë vendin e vdekjes së tyre."

Pastaj Pejgamberi a.s. zbriti afër Bedrit. Ai me njërin nga njerëzit e tij<sup>91</sup> hipi në deve dhe u nisën derisa takuan një plak të cilin e pyetën për Kurejshët, për Muhamedin dhe shokët e tij dhe çka dinte për ta.

Plaku tha: "Unë nuk do të them asgjë, derisa ju dy nuk më tregoni mua, kush jeni!"

Pejgamberi a.s. tha: "Nëse më tregon se kush je, atëherë edhe ne do të tregojmë ty!"

Ai tha: "Përgjigje për përgjigje?" Pejgamberi i tha: "Po!"

Atëherë plaku tha: "Kam dëgjuar se Muhamedi me shokët e vet ka dalë prej Medinës në këtë e këtë ditë. Nëse e ka thënë të vërtetën ai që më ka njoftuar mua, atëherë sot do të duhej të gjendeshin në këtë vend", duke precizuar vendin ku me të vërtetë Pejgamberi a.s. ishte ndalur.

"Unë gjithashtu jam informuar se Kurejshët janë nisur në këtë e këtë ditë, e nëse e ka thënë të vërtetën ai që më ka njoftuar mua, atëherë ata sot do të duhej të ishin në këtë e këtë vend", duke treguar vendin ku me të vërtetë gjendeshin Kurejshët.

Kur mbaroi plaku pyeti: "Më tregoni tani, ju të dy kush jeni?"

Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Ne jemi nga uji!", dhe pastaj u largua. Plaku mbeti duke pyetur: "Çfarë do të thotë kjo nga uji, a mos jeni nga uji i Irakut?!"

<sup>90</sup> Njëri grup, në fakt, ishte karvani i madh tregtar i Kurejshëve, në të cilin ishte Ebu Sufjani dhe Ebu Amër b. As. Ndërsa grupi i dytë ishte ai i kryesuar nga Ebu Xhehli, i cili ishte i shumtë në numër dhe mirë i armatosur.

<sup>91</sup> Ai ishte Ebu Bekër Siddiku.

Pejgamberi pastaj u kthye te njerëzit e tij. Kur u bë mbrëmja, dërgoi një grup shokësh të tij, të përbërë nga Ali b. Ebi Talibi, Zubejr b. Avvami dhe Sa'd b. Ebi Vekkasi që të shkojnë tek burimi i Bedrit dhe ta vëzhgojnë gjendjen rreth tij. Atje takuan dy djelmosha duke nxjerrë ujë për Kurejshët, njëri syresh ishte Eslemi, djalosh nga Benu Haxhxhaxhi dhe Arid Ebu Jesari, djalosh nga fisi Benu As b. Seid. Ata i sollën para Pejgamberit a.s., i cili ishte duke u falur, ndaj këta i pyetën fëmijët. Ata thanë: "Ne jemi ujëbartës të Kurejshëve, ata na dërguan që të sjellim ujë nga burimi."

Njerëzve nuk u pëlqeu përgjigjja e tyre sepse shpresonin se ata mund të jenë njerëz të Ebu Sufjanit. Kështu ata filluan t'i rrahin dhe ata filluan të flasin e thanë: "Ne jemi të Ebu Sufjanit!" Pastaj i lanë rehat. Pejgamberi a.s. kreu rukunë, dy sexhdet, dha selam dhe pastaj tha: "Kur ata thanë të vërtetën, ju i rrahët, kurse kur gënijen nuk i rrahët, si bën kështu? E thanë të vërtetën. Pasha Allahun, ata janë kurejshitë. Më tregoni për Kurejshët!"

Ata të dy u përgjigjën: "Vallahi, ata janë pas kësaj kodre të fundit."

Pejgamberi a.s. i pyeti: "Sa janë ata, sa është numri i tyre?" Ata thanë: "Nuk e dimë."

Pejgamberi a.s. tha: "Sa therin çdo ditë?" Thanë: "Një ditë nëntë, e ditën e dytë dhjetë deve."

Pejgamberi a.s. tha: "Numri i tyre është midis 900 dhe 1000!"

Përsëri iu drejtua djelmoshave: "Kush është nga paria e Kurejshëve?"

Thanë: "Utbe b. Rebia, Shejbe b. Rebia, Ebu Buhtarij b. Hisham, Hakim b. Hazam, Nufel b. Huvejlid, Harith b. Amir b. Nufel, Tu'ajme b. Adij b. Nufel, Nadr b. Harith, Zemea b. Esved, Ebu Xhehl b. Hisham, Umejje b. Halef, pastaj dy bijtë e Haxhxhaxhit Nebih dhe Munebbih, pastaj Suhejl b. Amri, Amër b. Abdu Vudd."

Pastaj Pejgamberi a.s. u kthye nga njerëzit dhe tha: "Ja, Meka ju dërgon njerëzit më të mirë që ka!"

Ndërkohë, Besebs b. Amër dhe Adij b. Ebi Zagba' vazhduan derisa arritën në Bedër. Ata u strehuan në një kodër, jo larg nga burimi i Bedrit dhe pinë ujë me calikun e tyre. Te burimi ishte edhe Mexhdi b. Amër Xhuhenui. Adiu dhe Besbesi dëgjuan dy vajza të cilat pranë burimit grindeshin për borxhin. Debitorja i thoshte shoqes së saj: "Nesër ose pasnesër mbërrin karvani, kështu që unë u kryej ndonjë shërbim dhe ta paguaj ty borxhin." Mexhdi tha: "Mirë e ke!" Dhe i ndau ato të dyja. Kur e dëgjuan këtë, Adiu dhe Besbesi menjëherë iu hipën deveve të tyre dhe u nisën për te Pejgamberi a.s. të cilin e informuan se çfarë kishin dëgjuar.

Atëherë te burimi vjen Ebu Sufjan b. Harbi, që si masë paraprake të vëzhgoonte situatën para ardhjes së karvanit. Ky e pyeti Mexhdi b. Amrin: "A ke hetuar dikë këtu në afërsi?"

Ai tha: “Nuk kam parë askënd të panjohur, në fakt, kam parë dy kalorës të cilët qëndronin atje pas asaj kodre. Ata pinë ujë nga caliku i tyre dhe shkuan.”

Ebu Sufjani menjëherë shkoi në vendin për të cilin ai i tha se po qëndronin aty, i mori jashtëqitjet e deveve të tyre, i shpërbëri dhe vërejt i farërat. Ai tha: “Vallahi, kjo është nga tagjia e Medinës!”

Menjëherë nxitoi për tek njerëzit e vet, pastaj devenë e ktheu në drejtim tjetër dhe u drejtua kah bregdeti. Lëvizi me shpejtësi duke e lënë Bedrin në anën e tij të majtë.

Kur e pa Ebu Sufjani se e kishte siguruar mirë karvanin, dërgoi te Kurejshët këtë mesazh: “Ju keni dalë për ta mbrojtur karvanin tuaj, njerëzit tuaj dhe pasuritë tuaja. Zoti e shpëtoi atë, andaj kthehuni!”

Ebu Xhehl b. Hishami tha: “Pasha Zotin, nuk do të kthehemi derisa të shkojmë në Bedër.” Bedri atëherë ishte njëri ndër panairët arabe, në të cilin çdo vit ekspozoheshin të gjitha llojet e mallrave. “Aty do të kalojmë tri ditë, do të therim kafshë, do të ndajmë ushqim, do të pimë verë dhe do të na argëtojnë këngëtarët. Të gjithë arabët do të dëgjojnë për ne, për marshimin dhe për fuqinë tonë. Pastaj, gjithsesi, të gjithë do të na respektojnë përherë! Përpara!”

Kurejshët u nisën dhe kështu arritën deri në fund të luginës. Allahu i Madhërishëm e dërgoi një re dhe toka u bë e butë. Kjo bëri që dhe nën këmbët e Pejgamberit a.s. dhe njerëzve të tij të ngjitet për ta, por megjithatë nuk i pengoi për të ecur. Ndërkaq, Kurejshët nuk mund ta vazhdonin udhëtimin. Prandaj, Pejgamberi a.s. mbërriti përpara tyre dhe u ndal te burimi që ishte më afër Bedrit.

Hubab b. Mundhiri tha: “O i Dërguari i Allahut, a mendon të qëndrojmë këtu? A të ka urdhëruar Allahu që të jemi në këtë vend dhe se nuk guxojmë të shkojmë as përpara as prapa, apo kjo është çështje e mendimit të lirë, luftë dhe taktikë?”

Pejgamberi tha: “*Kjo është çështje e mendimit të lirë, luftë dhe taktikë.*”

Atëherë Hubabi tha: “O i Dërguari i Allahut! Ky vend këtu nuk është i përshatshëm për fushim. Të shkojmë pranë një burimi që të jetë më afër Kurejshëve dhe aty të vendosemi. Pastaj, të gjitha burimet e tjera t’i mbyllim. Te burimi ku do të qëndrojmë, të hapim një gropë që të mbushet me ujë, vetëm atëherë do të nisemi në sulm. Ne do të kemi ujë për të pirë, e ata jo!”

Pejgamberi a.s. tha: “*Mendim shumë i mirë!*”

Pejgamberi a.s. e ngriti ushtrinë dhe u nisën gjer tek pusi më i afërt me Kurejshët. Aty u ndalën dhe Pejgamberi urdhëroi që të mbulohen pusët. Buzë burimit hapën një basen, i cili së shpejti u mbush me ujë dhe hodhën në të enët e tyre.

Sa'd b. Muadhi tha: “O i Dërguar i Allahut, le të ndërtojmë për ty një tendë, ku do të qëndrosh. Edhe devetë e tua të shalës të t’i sjellim pranë, pastaj ne të shkojmë e të përleshemi me armikun. Po qe se Allahu na jep fuqi dhe na e mun-

dëson fitoren, do të ndodhë ajo që ne duam. Në të kundërt, hipi devesë dhe kthehu te vëllezërit tanë që kemi lënë pas (në Medinë)! Prapa teje, o Pejgamber i Allahut, ka mbetur populli i cili të do po kaq sa ne. Po ta dinin ata se ti do të futeshe në luftë, kurrsesi s'do të mbeteshin pa ardhur! Allahu le të të mbrojë për hir të tyre. Ata janë të lidhur me shpirt me ty dhe janë gati të luftojnë krahe teje!”

Pejgamberi e falënderoi dhe u lut për të. Pastaj muslimanët e ndërtuan tendën dhe ai qëndroi aty.

Kur u zgjuan, Kurejshët kishin lëvizur. Ata u afruan dhe kur i pa Pejgamberi a.s. duke u zdirgjur teposhtë nëpër Aknakal – kjo ishte një kodër nga e cila ata kishin zbritur në luginë - tha: *“O Allahu im, këta janë Kurejshët, arritën me kalorësinë e tyre dhe me famën e tyre. Të kundërshtojnë Ty dhe përgënjeshtrojnë Pejgamberin Tënd. O Allahu im, ma ofro ndihmën Tënde, të cilën ma ke premtuar! O Allahu im, mposhti ata sot!”*

Duke u zdirgjur njerëzit, një grup i Kurejshëve, ku ishte edhe Hakim b. Hizami, u drejtuan drejt basenit të Pejgamberit. Pejgamberi a.s. tha: *“Lërin! Cilido prej tyre që pi ujë sot prej tij do të vritet, përveç Hakim b. Hizamit.”*

Vetëm ai nuk u vra, pastaj e pranoi Islamit dhe u bë musliman i mirë. Kështu që më vonë, kur i lodhej dora e djathtë duke luftuar, thoshte: *“Jo, pasha Atë që më shpëtoi në ditën e Bedrit!”*

Pasi u qetësuan njerëzit, dërguan Umejr b. Vehb Xhumehiun që të vëzhgojë Muhamedin a.s. dhe njerëzit e tij. Ai hipur mbi kalë vrapoi rreth ushtrisë muslimane dhe menjëherë u kthye tek ata dhe tha: *“Janë rreth treqind burra, ndonjë më shumë ose më pak. Por më lejoni të shoh mos kanë ndonjë pritë apo përforcim!”* Pastaj u hodh poshtë luginës dhe përparoi shumë larg. Pasi nuk pa asgjë, përsëri u kthye tek ata dhe tha:

*“O Kurejshë, unë nuk gjeta ndonjë gjë, por pashë kafshët duke bartur mbi shpinë fatet: i pashë devetë medinase duke bartur vdekjen; njerëz që nuk kanë kurrfarë mbrojtjeje as strehim përpos shpatave të tyre! Vallahi, unë mendoj se asnjëri prej tyre nuk do të vritet para se t'i vrasë dy nga ne. Dhe në qoftë se ata ju vrasin ju sa numri i tyre, atëherë pas kësaj në jetë nuk ka mirësi! Andaj, mendoni se si do të veproni!”*

Kur e dëgjoi këtë, Hakim b. Hizami menjëherë shkoi në mes të njerëzve. Kur erdhi tek Utbe, i tha atij: *“O Ebu Velid, ti je i madhi i Kurejshëve dhe sundimtari i tyre, fjala jote dëgjohet. A do të bësh diçka e të përmendesh për mirë sa të jetë bota dhe jeta!”*

Tha: *“Çfarë është ajo, o Hakim?”*

Ai u përgjigj: *“Ktheji njerëzit prapa, ti mban përgjegjësinë për vrasjen e aleatit tënd Amër b. Hadremiut, i cili u vra në Nahël nga patrulla muslimane e Abdullah b. Xhahshit!”*

Tha: “Po, do ta bëj!” Unë këtë e kam bërë me garancinë tënde. Unë garantoj për të dhe unë do të paguaj vlerën e gjakut të tij dhe tërë atë që ka humbur nga pasuria. Mirëpo, ti shko tek Ibni Handhaliu<sup>92</sup>, se kam frikë që njerëzit do të bëjnë diçka pa dijen e tij.

Pastaj Utbe b. Rebia u ngrit dhe filloi të flasë: “O Kurejshë, ju vallahi, kurr gjë nuk do të arrini me takimin e Muhamedit dhe shokëve të tij! Vallahi, nëse e vrisni, edhe më tej njerëzit do ta shikojnë njëri-tjetrin me urrejtje për shkak se ua ka vrarë djalin e xhaxhait, djalin e dajës ose cilindo nga kushërinjtë e tij. Prandaj kthehuni dhe lëreni Muhamedin në dorën e arabëve të tjerë. Nëse ata e vrasin, kjo është edhe dëshira juaj, por nëse del ndryshe, atëherë ai do t’ju kalojë ju dhe nuk do të arrini atë që dëshironi!”

Hakimi vazhdoi: “Prej tij pastaj shkova tek Ebu Xhehli, i cili kur e takova, e kishte nxjerrë shpatën e tij nga këllëfi dhe po e lyente me vaj. Unë i thashë: “O Ebu Hakem! Utbe më dërgoi tek ti të të them këtë dhe këtë ...!” dhe ia thashë të gjitha që më tha Utbe.

Ai tha: “Vallahi, ka filluar të frikësohet kur e pa Muhamedin dhe shokët e tij! Jo, Jo! Vallahi, nuk do të kthehemi derisa të gjykojë Allahu në mes nesh dhe Muhamedit, as Utbe nuk e mendon atë që ka thënë, por ai e ka parë se Muhamedi ka pak njerëz dhe në mesin e tyre është edhe djali i tij, prandaj për të ka frikë.”

Pastaj Ebu Xhehli dërgoi të thërrisnin Amir b. Hadremiun (vëllanë e Amrit të vrarë në ekspeditën e Abdullah b. Xhahshit), të cilit i tha: “Ky aleati yt po dëshiron t’i kthejë njerëzit, ndërsa ti personalisht e ke parë vrasjen. Ngrihu dhe kërko të drejtën tënde dhe përkujtoje varrin e vëllait tënd!”<sup>93</sup>

Amir b. Hadremiu menjëherë u ngrit, doli në një vend të dukshëm dhe filloi të vajtonte me tërë zërin: “Vaj medet, o Amër, ty nuk të kam më!” Kështu u ndez atmosfera për luftë, njerëzit u zemëruan, u mbloodhën dhe i bashkoi të gjithë e keqja që kishin në vetvete. Kjo e mënjanoi fare thirrjen që u drejtoi Utbe.

Pastaj Esve.d b. Abdilesed Mahzumi, një njeri i keq dhe i lig, doli përpara dhe tha: “Unë zotohem para Zotit se me çdo kusht do të pi ujë nga baseni i tyre apo do ta rrënoj atë ose do ta vras atë që më del përpara!”

Kur ai u nis, përpara i doli Hamza b. Abdulmuttalibi. Kur u takuan, Hamza e goditi aq fort, sa që nga gjysma e nëngjurit ia fluturoi këmbën. Kjo ndodhi afër burimit. Ai ra me kurriz, ndërsa nga këmba e tij shpërtheu me vrull gjaku, i cili shkante në drejtim të shokëve të tij. Pastaj zvarrë shkoi deri te baseni dhe hyri në të për të përmbushur betimin e tij. Hamza shkoi pas tij, e goditi dhe e la të vdekur në basen.

<sup>92</sup> Ai është Ebu Xhehl b. Hishami, nëna e tij ishte nga Handhale b. Malik.

<sup>93</sup> Domethënë kërko nga Kurejshët që t’i përmbahen marrëveshjes me ty sepse ai ka qenë fqinji dhe aleati i tyre.

Menjëherë pas kësaj, doli Utbe b. Rebia në mes vëllait të tij Shejbe dhe djalit të tij Velid b. Utbe. Me të dalë para rreshtit të parë, bëri thirrje për dyluftim. Para tyre dolën tre të rinj ensarë, Avfi dhe Muavvidhi, dy bijtë e Harithit, dhe një tjetër burrë me emrin Abdullah b. Revaha.

Ata të tre i pyetën: "Kush jeni ju?" Ensarët thanë: "Ne jemi ensarë!"

Ata thanë: "Ne me ju nuk kemi asgjë!" Pastaj një thirrës i tyre bërtiti: "O Muhamed, na sill njerëzit e rangut tonë dhe të sojit tonë!"

Atëherë Pejgamberi a.s. tha: "Ngrihu o Ubejde b. Harith, edhe ti Hamza, edhe ti Ali!"

Kur këta të tre u afruan, Kurejshët i pyetën: "Kush jeni ju?" Këta u treguan: Ubejde tha: Ubejde. Hamza tha: Hamza dhe Aliu tha: Aliu.

Ata thanë: "Ashtu, ju na përgjigjeni edhe sipas originës edhe sipas dinjitetit."

Ubejde, i cili ishte më i moçmi në mesin e tyre, doli para Utbe b. Rabias, Hamza doli para Shejbe b. Rabias kurse Aliu para Velid b. Utbes. Hamza menjëherë e vrau Shejben, edhe Aliu e vrau Velidin, ndërsa Ubejde dhe Utbe shkëmbyen nga një goditje të rëndë dhe e plagosën njëri-tjetrin. Atëherë Hamza dhe Aliu iu vërshulën Utbes dhe e vranë, ndërsa Ubejden e ngritën dhe e bartën deri te shokët.

Pastaj njerëzit u trazuan dhe dy palët iu afruan njëra-tjetrës. Pejgamberi a.s. i urdhëroi shokët e tij që të mos fillonin derisa ai t'u jepte urdhër. Dhe tha:

*"Nëse bëjnë përpjekje t'ju rrethojnë, atëherë gjuani me shigjeta!"* Ai ishte në tendë së bashku me Ebu Bekrin.

Beteja e Bedrit u zhvillua ditën e premte në mëngjes, më 17 ramazan.

Pejgamberi a.s. së pari rregulloi rreshtat e ushtrisë, pastaj u kthye në tendën e tij. Me të hyri vetëm Ebu Bekër Siddiku, askush tjetër. Pejgamberi a.s. i drejtohej dhe i lutej Allahut të Madhërisëm që t'i dërgonte ndihmën e premtuar dhe fitoren.

Ai lutej: "O Zoti im, nëse e pëson ky grup njerëzish sot, atëherë nuk do të jetë tjetër-kush që do të të adhurojë." Ndërsa Ebu Bekri i thoshte: "O Pejgamberi i Allahut, pse po përgjërohesh kaq shumë? Allahu me siguri do të të japë atë që të ka premtuar!"

Pejgamberin a.s. për një çast e zuri gjumi në tendën e tij. Pastaj e ngriti kokën dhe tha: "Gëzohu, o Ebu Bekër, ja po arrin ndihma e Allahut. Ja, Xhibrili po e tërheq kalin për freri, në krah po i shihet pluhuri!"

Pastaj Pejgamberi a.s. doli para njerëzve dhe filloi t'i inkurajojë. Ai u tha atyre:

*"Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, çdo njeri që merr pjesë sot në këtë betejë dhe lufton me durim të madh e nuk ikën nga lufta që të mos vritet, me siguri do të hyjë në xhenet."*

Atëherë Umejr b. Humami, vëllai i gjakut i Benu Selemes, i cili po mbante disa hurma në dorë dhe po hante, tha: "Oh, oh! A me të vërtetë ndërmjet meje dhe xhenetit është vetëm që të më vrasin këta?!" Pastaj i hodhi hurmat nga dora, e kapi shpatën dhe vazhdoi luftën derisa u vra.

Pejgamberi a.s. pastaj mori një grusht rërë, u kthye nga Kurejshët dhe tha:

*“Ju shëmtofshin fytyrat!”* Pastaj i fryu rërës në drejtim të tyre dhe tha: *“Ngjishni radhët dhe godisni me tërë fuqinë!”* Dhe ndodhi disfata e mekasve. Allahu i vrau shumë prej parisë së Kurejshëve si dhe një numër liderësh të tyre u zunë robër.

Ibn Abbasi r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. atë ditë u ka thënë njerëzve të tij:

*“Unë jam njoftuar se shumë njerëz nga fisi i Benu Hashimit dhe disa fiseve të tjera janë sjellë kundër vullnetit të tyre sepse ata nuk kanë asnjë arsye për të luftuar. Prandaj, kur dikush të takojë cilindo nga Benu Hashimët, të mos e vrasë. Kush e takon Ebu Bahteri b. Hisham b. Harith b. Esedin, të mos e vrasë. Kush e takon Abbas b. Abdulmuttalibin, të mos e vrasë, sepse ai është sjellë kundër vullnetit të tij!”*

Ebu Hudhejfe me atë rast tha: *“A t’i vrasim etërit tanë, vëllezërit dhe familjet tona, e mos ta vrasim Abbasin?! Vallahi, nëse unë e takoj, do ta godas me shpatë në fytyrë!”*

Fjalët e tij arritën deri tek Pejgamberi a.s., i cili i tha Omer b. Hattabit: *“O Ebu Hafs, a mund të goditet me shpatë fytyra e xhaxhait të Pejgamberit?!”*

Omeri r.a. ia ktheu Pejgamberit: *“Më lejo, o i Dërguari i Allahut, që unë t’ia pres qafën atij me shpatë sepse vallahi ai është bërë hipokrit!”*

Ebu Hudhejfe më vonë kishte deklaruar: *“Unë ende jam i shqetësuar nga ajo fjalë që pata thënë atëherë dhe edhe tani kam frikë. Ndoshta këtë do të ma lajë vdekja si shehid!”* Dhe vërtet ra shehid në betejën e Jemames.

Bedri është i vetmi vend ku kanë luftuar edhe engjëjt. Ata edhe në betejat e tjera kanë qenë të pranishëm në numër të madh, por nuk kanë luftuar.

Kur beteja përfundoi, Pejgamberi a.s. urdhëroi që midis të vdekurve të gjen-det Ebu Xhehli.

Ibn Mesudi thotë: *“Ia preva kokën atij, pastaj ia solla Pejgamberit a.s. dhe i thashë: “O i Dërguari i Allahut, ja koka e armikut të Allahut, Ebu Xhehli!”*

Pejgamberi a.s. tha: *“Pasha Allahun, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër!”* dhe ky ishte betimi i tij i përhershëm. *“Po, vallahi, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër!”* Pastaj kokën e tij e hodha para Pejgamberit a.s., i cili e falënderoi Allahun!

Pas kësaj, Pejgamberi a.s. urdhëroi që të vrasin të hidhen në një pus dhe ashtu ndodhi. Përrjashtim bëri vetëm Umejje b. Halef. Ai ishte ënjtur në parzmoren e tij dhe kur kishin filluar t’ia hiqnin parzmoren, kishte filluar t’i binte mishi. Atë e kishin lënë aty dhe e kishin mbuluar me rërë dhe gurë.

Kur të gjithë i hodhën në një pus, njerëzit natën vonë e dëgjuan Pejgamberin a.s., i cili duke qëndruar mbi ta kishte thënë:

*“O ju poshtë në pus! O Utbe b. Rebia, o Shejbe b. Rebia, o Umejje bin Halef, o Ebu Xhehl! ...!”* - dhe kështu i numëroi të gjithë ata që ishin në pus - *“A e gjetët të vërtetë atë që ju ka premtuar Zoti juaj? Unë e gjeta të drejtë e të vërtetë atë që më premtoi Zoti im!”*

Atëherë muslimanët e pyetën: “O i Dërguari i Allahut! A po flet me kufomat pa shpirt?!”

Kurse Pejgamberi a.s. u tha: *“Ata i dëgjojnë thëniet e mia më mirë se ju, pavarësisht se s’kanë mundësi të japin përgjigje!”*

Pas kësaj, Pejgamberi a.s. urdhëroi që të tubohet i tërë malli që kishin kapur njerëzit dhe ashtu ndodhi, mirëpo muslimanët rreth kësaj patën mospajtime. Ata që e kishin tubuar mallin thanë: “Ky është i yni!” Ata që kishin luftuar, e kërkonin për vete duke u arsyetuar: “Po mos të kishim luftuar ne, ju nuk do të kishit mundur ta merrni!” Ndërsa ata që e kishin ruajtur Pejgamberin nga frika se mund t’i afrohej armiku thoshin: “Vallahi, ju nuk keni aspak të drejtë mbi ne sepse edhe ne synuam ta luftonim armikun, por Allahu papritmas na dhuroi mbështetjen e Tij. Edhe ne mund të kapnim plaçkë lufte, kur atje nuk i ruante askush, por ne kishim frikë për Pejgamberin, mos i ndodhte ndonjë e keqe nga armiku, ndaj qëndruam me të. Kështu që ju aspak nuk keni të drejtë mbi ne!”

Pas kësaj fitoreje, Pejgamberi a.s. e dërgoi Abdullah b. Revahan që të çonte lajmin e gëzimit të banorët e Alijes<sup>94</sup> dhe t’u tregonte atyre se çfarë fitoreje i kishte dhuruar Allahu atij dhe muslimanëve. Ndërkaq, te banorët e pjesës së poshtme dërgoi Zejd b. Harithe. Pastaj, ai vetë me karvanin u nis për në Medinë, duke marrë me vete edhe robërit idhujtarë, në mesin e të cilëve ishte Ukbe b. Ebi Mu'ajt dhe Nadr b. Harith. Me vete kishin gjithashtu edhe plaçkën e luftës, kujdestar të së cilës kishte emëruar Abdullah b. Ka'b b. Amër b. Avfin.

Gjatë kthimit, Pejgamberi a.s. e kaloi ngushticën e verdhë dhe u lëshua nëpër një kodrinë mes asaj ngushtice dhe Nazejjes. Aty ai të gjithë muslimanëve ua ndau në mënyrë të barabartë plaçkën e luftës.

Pastaj ata vazhduan udhëtimin. Kur erdhën në Revha, para Pejgamberit a.s. dolën muslimanët lokalë për t’ia uruar fitoren që Allahu ia dhuroi atij dhe muslimanëve që ishin me të. Seleme b. Selame u tha atyre: “Për çfarë po na përgëzoni? Vallahi, ne jemi ballafaquar me pleq të dobësuar si deve të lidhura, kështu që vetëm i kemi therur!”

Pejgamberi a.s. buzëqeshi, pastaj tha: *“O djali i vëllait, ata ishin të zgjedhurit!”*

Kur Pejgamberi a.s. arriti në Safra', aty u ekzekutua Nadr b. Harith. Atë e ekzekutoi Ali b. Ebi Talibi. Pastaj vazhduan rrugën. Kur arritën në Irke-Dhabje, u ekzekutua edhe Ukbe b. Ebi Mu'ajt. Kur Pejgamberi a.s. urdhëroi vrasjen e tij, Ukbe pyeti: “Kush do t’u mbetet fëmijëve, o Muhamed? Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Zjarri!”* Ukben e ekzekutoi Asim b.Thabit b. Ebi Akleh Ensariu. Pastaj Pejgamberi a.s. e vazhdoi udhëtimin e tij dhe arriti në Medinë një ditë para

<sup>94</sup> Alije është një zonë në Arabi, rrafshnaltë mes Nexhdit dhe Tihames.

robërve. Të nesërmen, kur arritën robërit, ai i ndau nga sahabët e tij dhe i porosi: *“Silluni mirë me robërit!”*

Në anën tjetër, i plagosuri i parë i Kurejshëve që u kthye në Mekë ishte Hajsuman b. Abdullah.

Kurejshët së pari vajtuan të vdekurit e tyre dhe pastaj thanë: *“Mos veproni kështu sepse nëse e merr vesh Muhamedi dhe shokët e tij, do t’ju fyejë! Gjithash-tu, mos i kërkoni robërit tuaj. Le të jenë një kohë atje sepse kështu nuk do të mund t’ju kërkojë shpërblim të madh!”*

Esved b. Muttalibi në Bedër humbi tre djem: Zemea b. Esved, Ukajl. b. Esved dhe Harith b. Zemea. Ai dëshironte të vajtonte djemtë e tij. Një natë, duke qenë në atë gjendje, dëgjon vajtimin e një gruaje dhe për shkak se ishte i verbër, e urdhëroi djaloshin e tij: *“Shiko nëse ajo e ka të justifikuar vajtimin e saj! A po i vajtojnë Kurejshët të vdekurit e tyre? Edhe unë me kënaqësi do të vajtoja për Ebu Hukejmin – d.m.th. Zemean – sepse për të po digjem nga brenda!”*

Kur u kthye djaloshi i tha: *“Ajo grua vajton për devenë e humbur.”*

Esvedi nuk mundi më të duronte dhe filloi të vajtonte:

*“A mos vallë po qan për devenë e humbur,  
e për shkak të saj nuk bën gjumë të thellë?*

*Jo, mos qani për të, por qani për Bedrin,  
në të cilin neve na u dënuan gjyshërit.*

*Bedri e turpëroi Benu Husajsin,  
Benu Mahzumin dhe Ebul Velidin.*

*Ti vajto për Akilin, sepse vajtimi e ka rendin,  
kurse unë për Harithin luanin e Esvedit!*

*Ti ata vajtoji, por edhe të tjerët përmendi,  
sepse askush nuk është si Ebu Hukejmi!*

Pas një kohe Kurejshët ofruan pagesë për njerëzit e tyre të zënë robër. Së pari këtë e bëri Mikrez b. Hafs, i cili kërkonte shpagimin e Suhejl b. Amrit. Pasi bisedoi Mikrezi me ta dhe mori pëlqimin e tyre, ata i thanë: *“Mirë, na jep atë që na takon!”* Ai tha: *“Më lejoni që në vend të tij të vendoset një njeri i imi, kurse atë lëshojeni të shkojë e ta sjellë shpagimin e tij!”* Dhe ata e lëshuan Suhejlin, ndërsa aty në vend të tij ndalën Mikrezin!

Por, më parë, Omer b. Hattabi i kishte thënë Pejgamberit: *“O i Dërguari i Allahut, më lejo që Suhejl b. Amrit t’ia zhbij fytn dhe t’ia nxjerr gjuhën që kurrë më të mos flasë kundër teje!”*

Pejgamberi a.s. i tha: *“Nuk dua ta shëmtoj e pastaj të më shëmtojë Allahu mua, ndonëse unë jam Pejgamber!”*

Në mesin e robërve ishte edhe Ebul-As b. Rebi b. Abduluzza, dhëndër i Pejgamberit, burri i vajzës së tij Zejnebes. Islami e kishte ndarë Zejneben prej tij, kur ajo pranoi Islamin, por Pejgamberi a.s. nuk mundi t'i ndajë. Kështu që ajo mbeti me të, pavarësisht faktit që ishte muslimane, ndërsa ai ishte idhujtar. Ajo qëndroi në Mekë madje edhe pas hixhretit të Pejgamberit a.s. në Medinë. Kur Kurejshët u nisën për në Bedër, me ta shkoi edhe Ebul-As b. Rebi dhe atje u zu rob.

Kur mekasit dërguan para për pagesën e robërve të tyre, edhe Zejnebja, vajza e Pejgamberit a.s., dërgoi para për burrin e saj Ebul-As b. Rebi. Aty ishte edhe gjerdani i saj, të cilin asaj ia kishte dhuruar Hatixheja me rastin e martesës së saj. Kur e pa atë gjerdan, Pejgamberi a.s. u emocionua shumë dhe tha: *“Nëse mund ta lëshoni të robëruarin e saj dhe t’ia ktheni pagesën për të, bëjeni!”*

Ata thanë: *“Po, o i Dërguari i Allahut!”*, pastaj e liruan burrin e saj dhe ia kthyen pagesën.

Ebul-Asi shkoi në Mekë, ndërsa Zejnebja mbeti në Medinë te Pejgamberi a.s., pra, Islami i ndau.

Pak para pushtimit të Mekës, Ebul-Asi, si një njeri i besueshëm, shkoi në Sham për tregti. Së bashku me pasurinë e tij ai mori edhe një sasi të pasurisë së Kurejshëve. Pasi e përfundoi tregtinë dhe kur po kthehej, atë e takoi një çetë e Pejgamberit a.s., e cila ia konfiskoi tërë karvanin, ndërsa ai vetë arriti të shpëtonte. Pasi grupi me mallin e konfiskuar po kthehej në Medinë, Ebul-Asi nëpër errësirën e natës iu afrua shtëpisë së Zejnebes dhe i kërkoi strehim, të cilën ajo e pranoi. Ai sigurisht kishte ardhur për të kërkuar mallin e tij. Atë mëngjes, kur Pejgamberi a.s. doli për namazin e sabahut, pasi bëri nijet dhe mori tekbir bashkë me njerëzit, Zejnebja nga vendi i grave me zë të lartë bërtiti: *“O njerëz, unë i kam ofruar strehim Ebul-As b. Rebiut!”*

Kur e përfundoi namazin, Pejgamberi a.s. u kthye nga të pranishmit dhe tha: *“O njerëz, a dëgjuat edhe ju çfarë dëgjova unë?”*

Ata thanë: *“Po dëgjuam.”* Ai tha: *“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, unë nuk kam ditur asgjë për të derisa dëgjova atë çfarë dëgjuat edhe ju! Por, secili prej muslimanëve ka të drejtë për të ofruar mbrojtje!”* Pastaj ai u kthye dhe shkoi drejt e te vajza e tij.

*“Oj bija ime, përgatitja mirë dhomën, por në asnjë mënyrë nuk duhet të të afrohet! Ti më nuk je e lejuar për të!”*

Sipas rrëfimit të Abdullah b. Ebi Bekrit, Pejgamberi a.s. e thirri grupin që konfiskoi mallrat e Ebul-As b. Rebiut dhe u tha atyre:

*“Ky njeri, siç e dini, tani është te ne, kurse ju ia keni konfiskuar mallrat. Ne do të donim që ju të silleni mirë me të dhe t’ia ktheni atë që i keni marrë, mirëpo, në qoftë se ju*

*nuk jeni dakord, atëherë ajo është pre e Allahut që jua ka dhënë juve dhe ju në të keni më shumë të drejtë!”*

Ata thanë: “O i Dërguari i Allahut, ne do t’ia kthejmë atij!”

Dhe menjëherë filluan. Njëri mbante një kovë, tjetri një calik të vjetër, i treti një enë të vogël lëkure, e madje edhe thuprat e parapara për mbërtheckat e thesit. Kështu që atij iu kthye i tërë malli, pa i munguar as gjëja më e vogël. Ai me të gjitha këto shkoi në Mekë dhe secilit i dha atë që i takonte, d.m.th. ua dha pjesën e tyre që i kishin dhënë për tregti. Pastaj ai tha: “O Kurejshë, a është ndokush që nuk e ka marrë pjesën e tij?” Ata u përgjigjën: “Jo, Zoti të shpërbleftë me të mira! Ne po shohim se ti je njeri i ndershëm e i besës!”

Ebul-Asi u tha: “Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Allahut! Vallahi, gjëja që më pengoi të bëhesha musliman në Medinë para se të vija këtu ishte se kisha frikë mos mendonit se kisha hyrë në Islam me qëllim për të marrë mallrat tuaja. Prandaj Islamin po e pranoj tani, pasi Allahu ua dorëzoi pasuritë tuaja dhe kur unë u lirova prej tyre!”

Pastaj ai la Mekën dhe shkoi te Pejgamberi a.s..

Në mesin e robërve që u liruan pa pagesë janë këta: Ebul-As b. Rebi, Muttalib b. Hantab Sajfij b. Ebi Rufa'a, Ebu Azzet Amër b. Abdullah b. Osman b. Uhejb b. Hudhafe b. Xhume, i cili ishte shumë i varfër dhe kishte shumë vajza. Ai iu drejtua Pejgamberit a.s.: “O i Dërguari i Allahut, ti e pe sa pasuri kam, mua më nevojiten të ardhura sepse kam familje të madhe, ndaj të lutem më ndihmo!” I Dërguari i Allahut, e veçoi mallin e tij, pasi ai u zotua se për këtë nuk do t’u fliste të tjerëve. Në lidhje me këtë Ebu Azzet ka thurur vargje për lavdërimin e Pejgamberit a.s., ku vë në pah reputacionin e tij në popullin e tij:

*Kush do ta njoftojë Pejgamberin Muhamed, në emrin tim,  
dhe t’i thotë: Ti je e vërteta dhe i denjë për lavdërim!*

*Ti je njeriu që thërret për të vërtetën dhe rrugën e mbarë,  
andaj për këtë tek Allahu, ti ke shumë dëshmitarë!*

*Ti je njeriu që në mesin tonë ka një vend të artë,  
kurse pozita jote në mesin tonë është shumë e lartë.*

*Kundër kujt lufton ti, ai vërtet është i pafat,  
ndërsa kush është me ty, jeton i lumtur dhe në paqe!*

Kundërpagesa për idhujtarët ishte prej 4.000 deri në 10.000 dërhëmë për person, përveç atyre që i ka falur Pejgamberi a.s. dhe janë liruar pa kompensim, në mesin të cilëve ishte edhe Ebu Azzet.

Numri i përgjithshëm i muhaxhirëve, të cilët Pejgamberi a.s. i mori me vete në Bedër, ishte 83 burra. Nga fisi Evs, me Pejgamberin a.s. në Bedër morën pjesë

gjithsej 61 burra. Ndërsa numri i gjithëmbarshtëm i atyre që ishin me Pejgamberin a.s. në Bedër nga fisi Hazrexh ishte 170 burra.

Kështu, të gjithë së bashku, muhaxhirë dhe ensarë, që morën pjesë në Betejën e Bedrit, si ata që luftuan, ashtu edhe ata që u vranë dhe u shpërblyen, numri i tyre ishte 314 burra.

### **Ekspedita kundër fisit Benu Sulejm në Kuder**

Kur Pejgamberi a.s. u kthye në Medinë, aty mbeti vetëm shtatë net, pastaj përsëri personalisht e drejtoi ushtrinë kundër fisit Benu Sulejm<sup>95</sup> dhe i çoi deri te burimi i tyre me emrin Kuder<sup>96</sup>. Aty qëndroi për tri net dhe pastaj pa luftë përsëri u kthye në Medinë, ku qëndroi pjesën e mbetur të muajit shevval dhe muajin dhulka'de. Gjatë asaj kohe u bë kundërpagesa për shumicën e robërve të Kurejshëve.

### **Ekspedita në Sevik**

Pejgamberi a.s. pastaj, në muajin dhul-hixhxe, u nis për në Sevik<sup>97</sup>, në ndjekje të Ebu Sufjan b. Harbit. Atë vit ritualet e haxhit i kryen vetëm idhujtarët. Ebu Sufjani së bashku me Kurejshët e mundur nga Bedri kur u kthye në Mekë, u zotua se nuk do ta lante kokën me ujë nga papastërtia, xhunubllëku<sup>98</sup>, gjersa të sulmonte Muhamedin a.s..

Për ta përmbushur zotimin e tij, ai mblodhi 200 kalorës ndër Kurejshë dhe u drejtua nëpër Nexhdijje dhe zbriti në një kanal që gjendej pranë malit të quajtur 'Thejb', në një distancë prej rreth 12 milje prej Medinës. Atë natë, nën mbrojtjen e natës së errët, ai u fut në lagjen Benu Nadir dhe trokiti në derën e Hujejj b. Ahtabit, por ai nuk ia hapi derën nga frika për jetën dhe familjen. Pastaj vajti tek Selam b. Mishkem, i cili ishte prijës i fisit tjetër hebre Benu Nadir, ishte edhe ruajtësi i thesarit të tyre, dhe kërkoi që të hynte tek ai. Ky e pranoi, e ushqeu me ushqim të paraparë për musafirët dhe i dha për të pirë. Pastaj e njoftoi me lajmet e reja në mjedisin e tyre.

Po atë natë, Ebu Sufjani nëpër errësirën e natës u kthye mbrapa tek njerëzit e tij. Menjëherë dërgoi një grup për në Medinë dhe ata iu afruan asaj nga një shpat

<sup>95</sup> Gjatë kohës së mungesës së tij, Pejgamberi a.s. la në Medinë si zëvendës të tij Saba' b. Urfete Giffariun, ndërsa disa mendojnë se ka emëruar Ibn Umri Kulthumin.

<sup>96</sup> Kuder është vend i fisit Benu Sulejm në Nexhd, në veri të rrugës tregtare mes Mekës dhe Shamit.

<sup>97</sup> Sevik është quajtur kështu sepse në atë vend njerëzit e Ebu Sufjanit kishin hedhur pjesën më të madhe të pajisjeve të tyre, të cilat pastaj ishin konfiskuar nga muslimanët. 'Sevik' është quajtur mielli i fërguar i grurit ose elbit, i cili hahet i përzier me qumësht, mjaltë dhe gjalpë ose vetëm me ujë.

<sup>98</sup> Edhe në kohën e xhahilijetit pastrimi nga xhunubllëku praktikohet, sikurse haxhi dhe kurorëzimi (nikah).

i quajtur Urejd. Aty zbarkuan në një zabel me palma, ku në një arë takuan një ensarij me shokun e tij dhe të dy i vrasin dhe pastaj kthehen. Njerëzit megjithatë i vunë re dhe Pejgamberi a.s. menjëherë u nis në kërkim të tyre. Në Medinë la si zëvendës Beshir b. Abdul-Mundhirin. Ai i ndoqi deri në vendin e quajtur 'Karkaretul-Kuder', mirëpo u kthye pa përfunduar punë sepse Ebu Sufjani dhe njerëzit e tij arritën të iknin. Në arën ku u vranë dy ensarët ata gjetën pajisjet dhe ushqimin që sulmuesit kishin hedhur për të mos i penguar gjatë ikjes.

Kur u kthyen në Medinë, njerëzit e pyetën Pejgamberin a.s.: "O i Dërguari i Allahut, a mund ta quajmë ne këtë ekspeditë ushtarake?" Ai tha: "Po, mund ta quajmë!"

### **Ekspedita në Dhu Emer**

Pas kthimit nga ekspedita në Sevik, Pejgamberi a.s. kaloi në Medinë pjesën tjetër të muajit dhul-hixhxe, ose pjesën më të madhe të tij, dhe pastaj u nis për Nexhd, përkatësisht për Gatafan. Kjo ekspeditë është e njohur si Dhu Emer<sup>99</sup>.

Aty kaloi tërë muajin safer ose diçka më pak se kaq dhe pastaj pa luftë u kthye në Medinë, ku qëndroi gati tërë muajin rebiul-evvel.

### **Ekspedita në Furu' pranë Bahranit**

Pejgamberi a.s. u nis përsëri me ushtrinë e tij kundër Kurejshëve dhe shkoi deri në Bahran - minierë në Hixhaz nga ana e Furu'it. Atje ai qëndroi dy muaj, rebiul-ahir dhe xhumadel-ula, dhe pastaj gjithashtu pa luftë u kthye në Medinë<sup>100</sup>.

<sup>99</sup> Gjatë kësaj kohe në Medinë si mbikëqyrës caktoi Osman b. Affanin.

<sup>100</sup> Kësaj here në Medinë si mbikëqyrës caktoi Ibn Ummi Mektumin.

## NGJARJA ME FISIN BENU KAJNUKA

Një grua arabe një ditë shkon në tregun e fisit Benu Kajnuka<sup>101</sup> për të shitur mall. Ajo kishte zënë vend pranë një artari. Hebrejtë u tubuan rreth saj dhe i kërkuan që të zbulonte fytyrën. Ajo refuzoi ta bënte këtë, kurse artari i afrohet dhe ia mbërthen një kind të rrobës pas shpinës së saj. Kur u ngrit, asaj iu zbulua një pjesë e trupit. Të gjithë filluan të qeshin me zë të lartë, ndërsa ajo klithi. Një musliman e sulmoi artarin hebre dhe e vrau. Hebrejtë pastaj iu vërsulën muslimanit dhe e vranë. Faresi i këtij muslimani i thirri muslimanët e tjerë kundër hebrejve. Muslimanët u zemëruan shumë dhe kështu filloi përleshja mes tyre dhe hebrejve të fisit Benu Kajnuka.

Hebrejtë e fisit Benu Kajnuka janë të parët që e shkelën marrëveshjen e arritur mes tyre dhe Pejgamberit a.s.. Për këtë arsye, Pejgamberi a.s. i rrethoi dhe ata u detyruan ta pranojnë autoritetin e tij. Në atë moment u afrua Abdullah b. Ubej b. Seluli, pasi Pejgamberi a.s. ngadhënjeu mbi ta, dhe i tha:

“O Muhamed, bëhu i mëshirshëm ndaj të afërmve të mi!” Pejgamberi a.s. nuk iu përgjigj, e ky e përsëri tha: “O Muhamed, bëhu i mëshirshëm ndaj të afërmve të mi.” Pastaj u kthye nga Pejgamberi a.s. dhe ia futi dorën në xhep të këmishës, kurse Pejgamberi a.s. i tha:

*“Ik prej meje!”* Aq shumë u hidhërua saqë hidhërimi iu duk në fytyrë e tha: *“Vaj halli për ty, ik prej meje!”*

Tha: “Jo, vallahi, nuk do të lëshoj, përderisa nuk lëshon pe ndaj ndëshkimit të tyre: katërqind rojtarë dhe treqind të armatosur më kanë mbrojtur nga armiku i kuq dhe i zi (aludohet për arabët dhe joarabët) e ti dëshiron t’i vrasësh për një ditë. Kam frikë se do të ketë pasoja të rënda pas kësaj!”

Pejgamberi a.s. tha: *“Ja ku i ke, ata janë tuajt!”*

Pastaj Pejgamberit a.s. iu afrua Ubade b. Samit, nga aleati i të cilit i erdhi reagim i ngjashëm si edhe nga Abdullah b. Ubejj. Ai me atë rast hoqi dorë prej tyre në prani të Pejgamberit a.s. dhe nga vetja hoqi çdo përgjegjësi që ka tek Allahu dhe i Dërguari i Tij për veprimet e tyre. Ai tha: “O i Dërguari i Allahut, prej tani unë jam mik vetëm me Allahun, me të Dërguarin e Tij dhe me besimtarët dhe heq dorë nga aleanca ime me këta jobesimtarë dhe nga miqësia e tyre!”

Për të dhe për Abdullah b. Ubejjin është shpallur tregimi vijues në suren Maide:

<sup>101</sup> Benu Kajnuka ishte njëri nga fiset hebreje që jetonin në Medinë.

*“O ju që besuat! Mos zini miq as hebrenjtë e as të krishterët. Ata janë miq të njëritjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtetë Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar.*

*E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh se ngarendin te ta (për miqësi) duke thënë: “Po frikësohemi se mos po na sillet ndonjë e keqe”. Po Allahu do të sjellë fitoren, ose diç tjetër nga ana e Tij, e atëherë do të pendohen për atë që e mbanin fshehtë në shpirtin e tyre.*

*Ata që besuan u thonë: “A këta ishin që u betuan në Zotin me betimin më të fortë të tyre se ishin me ju?” I shkatërruan veprat e veta dhe aguan të dëshpëruar.*

*O ju që besuat! Kush largohet nga feja e vet (i bën dëm vetes) s’ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo (cilësi e atij populli) është dhuratë e Allahut që i jep atij që do. Allahu është dhurues i madh, i dijsëm.*

*Mik (i afërt) juaji është vetëm Allahu, është i Dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zekatin duke bërë rukuë (duke qenë respektues).” Pastaj, më poshtë, theksohet mbështetja e Ubade b. Samitit vetëm tek Allahu, tek i Dërguari i Tij dhe besimtarët dhe hejja dorë nga Benu Kajnuka, nga aleanca me ta dhe nga mbrojtja e tyre:*

*“E kush ka për mik Allahun, të Dërguarin e Tij dhe ata që besuan, s’ka dyshim se ana (pala-krahu) e Allahut është ngadhënjyese.” (El-Maide, 51-56)*

### **Ekspedita e Zejd b. Harithe në Karede, burim në Nexhd**

Kurejshët, pas asaj që u ndodhi në Bedër, i frikësoheshin rrugës nga ku shkonin për në Sham. Për këtë arsye, ata zgjodhën rrugën që çonte në Irak. Asaj rruge ishin nisur disa prej tregtarëve të tyre, ndër të cilët ishte edhe Ebu Sufjan b. Harbi, i cili me vete kishte një sasi të madhe argjendi, që përbënte boshtin e tregtisë së tyre të përgjithshme. Për udhërrëfyes kishin angazhuar me pagesë një njeri nga fisi Benu Bekr b. Vail, i quajtur Furat b. Hajjan.

Pejgamberi a.s. kundër tyre dërgoi Zejd b. Harithen, i cili i takoi ata tek burimi i quajtur ‘Karede’ në Nexhd dhe arriti ta robërojë tërë karvanin me gjithë thesarin. Njerëzit e karvanit, megjithatë, arritën të iknin, ndërsa plaçka e sekuestruar iu dorëzua Pejgamberit a.s..

## BETEJA E UHUDIT

Pas tragjedisë së jobesimtarëve Kurejshë, ‘banorëve të pusit’ në Bedër dhe kthimit të forcave të tyre të mundura në Mekë si dhe pasi Ebu Sufjan b. Harbi e ktheu karvanin e tij në mesin e Kurejshëve, të cilët në betejën e Bedrit kishin humbur baballarët, djemtë dhe vëllezërit e tyre, Abdullah b. Ebi Rebia, Ikrime b. Ebi Xhehli dhe Safvan b. Umejje së pari biseduan me Ebu Sufjan b. Harbin e pastaj edhe me të tjerët dhe u thanë: “O kurejshitë, Muhamedi ju bëri padrejtësi dhe i vrau bijtë tuaj më të mirë. Na ndihmoni me këto mjete në luftë kundër tij. Është e mundur të marrim hak.” Dhe ata u pajtuan.

Kurejshët u mblodhën për luftë kundër Pejgamberit a.s., por përveç arabëve kishte edhe të tjerë, si njerëzit nga disa fise të Kinanes dhe Tihames. Kështu ata u nisën duke marrë me vete edhe gratë, me qëllim që luftëtarët të jenë më të ashpër në betejë dhe të mos ikin nga fusha e betejës.

Udhëheqës i tyre ishte Ebu Sufjan b. Harbi, i cili mori me vete Hind bint Utben. Ikrime b. Ebi Xhehlin e shoqëronte Ummu Hakim bint Harith b. Hisham b. Mugire. Harith b. Hisham b. Mugire shoqërohej nga Fatime bint Velid b. Mugire, ndërsa Safvan b. Umejjen e shoqëronte Berze bint Mesud Thekafijje dhe me Amër b. Asin ishte Rejta bint Munebbih b. Haxhxhaxh.

Ata ecën derisa zbritën në dy burime në një kodër në brendi të Sebhas, nëpër një kanal buzë luginës kundrejt Medinës. Kur dëgjoi për ardhjen e tyre, Pejgamberi a.s. dhe muslimanët zbritën aty ku ishin, ndërsa i Dërguari a.s. iu drejtua atyre:

*“E pashë një ëndërr, pasha Allahun, një ëndërr të mirë. Pashë se si thereshin bagëtia e trashë dhe shpatën time të prerë në majë dhe pashë se dorën time e vura në mburojë. Që mendoj se ka të bëjë me Medinën<sup>102</sup>, prandaj nëse dëshironi qëndroni në Medinë, ndërsa ata lërin aty ku janë ndalur. Nëse ata qëndrojnë aty, do të jenë në një pozitë shumë të keqe, ndërsa nëse vijnë te ne, do t’i luftojmë këtu në Medinë!”*

Me këtë mendim të Pejgamberit a.s., domethënë se nuk kanë nevojë për të dalë në takim, u pajtua dhe Abdullah b. Ubej b. Seluli. Vetë Pejgamberi a.s. e urrente daljen, mirëpo disa muslimanë, të cilët Allahu do t’i nderojë me shehid-llëk në Betejën e Uhudit dhe në beteja të tjera dhe që e patën humbur rastin e Bedrit, thanë:

<sup>102</sup> Bagëtia e trashë në ëndërr ka kuptimin se do të vritet një numër sahabësh, tehu i shpatës do të thotë se do ta pësojë njëri nga anëtarët e familjes sime.

“O i Dërguari i Allahut, na udhëhiq kundër armikut, që të shohin se nuk jemi qyqarë e frikacakë!”

Ndërsa Abdullah b. Ubej b. Selul këmbënguli duke thënë:

“O i Dërguari i Allahut, qëndro në Medinë dhe mos u dil përballë atyre! Vallahi, sa herë që kemi dalë prej saj para armiqve tanë, ne jemi dëmtuar dhe sa herë që ata na kanë sulmuar këtu, ne i kemi dëmtuar ata! Prandaj, lëri të shkojnë, o i Dërguari i Allahut - në qoftë se qëndrojnë aty do të jenë në një burg të shëmtuar, e nëse nisën për te ne, njerëzit do t'i godasin në fytyrë, ndërsa gratë dhe fëmijët mund t'i godasin me gurë nga lart! E nëse kthehen prapa, do të kthehen të zhgënjyer, siç kanë ardhur!”

Ata që dëshironin të dilnin para armikut e bindnin Pejgamberin a.s., derisa ai më në fund hyri në shtëpinë e tij dhe i ngjeshi armët. Kjo ndodhi ditën e premte pas përfundimit të namazit të xhumasë. Atë ditë vdiq një ensarij i quajtur Malik b. Amër. Pejgamberi a.s. së pari fali namazin e xhenazes, pastaj doli para njerëzve. Ata tashmë kishin filluar të ndjenin pendim dhe thoshin se e ekspozuam ndaj rrezikut të Dërguarin a.s., pa pasur nevojë.

Kur ai u shfaq para tyre, ata i thanë atij: “O Pejgamber i Allahut, nuk duhet të kishim kundërshtuar në atë mënyrë, prandaj vepro siç ke dëshirë vetë. Nëse do të qëndrosh këtu, ti qëndro, Zoti të bekoftë!”

Atëherë Pejgamberi a.s. tha: *“Nuk i lejohet Pejgamberit të Allahut, pasi ta ketë veshur njëherë parzmoren, që të çarmatoset para se të luftojë.”*

Kështu që Pejgamberi a.s. u nis me një mijë shokë të tij. Mirëpo, kur shkuan në Shevt, vend në mes Medinës dhe Uhudit, u nda prej tij Abdullah b. Ubej b. Selul, i cili mori me vete edhe një të tretën e njerëzve, pastaj tha: “Ai dëgjoi ata, jo mua! Ne nuk e dimë pse duhet të vritemi këtu, o njerëz!”

U kthyen dyfytyrëshat dhe dyshuesit që e pasuan atë. Me ta shkoi edhe Abdullah b. Amër b. Haram, i cili u tha: “O njerëz, ju përkujtoj Allahun. Kur njerëzit tuaj dhe Pejgamberi juaj të kthehen nga armiku i tyre, ju mos u ndani prej tyre!”

Ata thanë: “Sikur ta dinim se ju do të luftonit, ne nuk do ta prananim Islam-in! Ne kemi menduar se nuk do të ketë luftë!”

Kur ata nuk e dëgjuan dhe insistuan në ndarjen e tyre, ai u tha: “Allahu ju largoftë, o armiq të Allahut! Allahu do ta shpëtojë Pejgamberin e Vet edhe pa ndihmën tuaj!”

Para Betejës së Uhudit ensarët pyetën: “O i Dërguari i Allahut, sikur të kërkonim ndihmë nga aleatët tanë hebrej?” Ai u tha: *“Jo, ne nuk kemi nevojë për ta!”*

Pejgamberi a.s. me pjesën tjetër të njerëzve vazhdoi tutje dhe u ndal në grykën e Uhudit, në fund të luginës pranë kodrës. Uhudin e kishin pas shpine. Ai porositi: *“Askush të mos fillojë sulmin derisa ne ta urdhërojmë për sulm!”*

Kurejshët i lëshuan devetë dhe kuajt e tyre të kullosin lirisht në fushat e Samges (në afërsi të Uhudit), në anën tjetër të kanalit, përballë muslimanëve. Kur Pejgamberi a.s. dha urdhër për ndalimin e sulmit, një nga ensarët tha: “Vallë, a duhet t’i kullosin në fushat e Benu Kajles<sup>103</sup> ndërsa ne vetëm të shikojmë!”

Pejgamberi a.s. e mobilizoi ushtrinë e tij të përbërë prej 700 luftëtarësh dhe e organizoi. Komandant të harkëtarëve caktoi Abdullah b. Xhubejrin, i cili me atë rast veshi rroba të bardha. Kjo çetë përbëhej prej 50 vetash.

Ai i urdhëroi ata: *“Ju me shigjeta ndaloni kalorësinë, në mënyrë që mos të na vijjnë nga prapa dhe nga ajo anë të jemi të sigurt. Mos i lini të depërtojnë nga ana juaj!”*

Vetë Pejgamberi a.s. u vesh me dy parzmore, ndërsa flamurin ia besoi Musab b. Umejrit, vëllait të Beni Abdud-Darit.

Pejgamberi a.s. ua lejoi pjesëmarrjen në betejë edhe dy të miturve, Semure b. Xhendeb dhe Rafi b. Hadixh, vëllezër të Beni Harithes, edhe pse ishin vetëm nga 15 vjeç. Fillimisht ai i ndaloi, por pasi i thanë: O i Dërguari i Allahut, Rafiu është shenjëtar!”, e lejoi Rafiun.

Kur Pejgamberi a.s. e lejoi Rafiun t’i bashkohej ushtrisë, ata i thanë atij: “Semure e mund Rafiun në mundje!” Atëherë, ai e lejoi edhe atë.

Pejgamberi a.s. ktheu pas: Usame b. Zejdin, Abdullah b. Omer b. Hattabin, Zejd b. Thabitin, Berra b. Azibin, Amër b. Hazmin dhe Usejd b. Dhuhejrin. Ata më vonë i lejoi të merrnin pjesë në betejën e Hendekut, megjithëse gjithashtu ishin vetëm 15-vjeçarë.

Edhe Kurejshët bënë mobilizimin e trupave të tyre, të cilët ishin më shumë se 3000 burra, me 200 kalorës. Një pjesë e kalorësisë në anën e djathtë i ishte besuar Halid b. Velidit, ndërsa ata në të majtë Ikrime b. Ebi Xhehlit.

Pejgamberi a.s. pyeti: *“Kush dëshiron ta marrë këtë shpatë së bashku me detyrat e saj?”*

Menjëherë u ngritën dhe iu afruan shumë njerëz, por nuk ia dha asnjërit derisa u ngrit edhe Ebu Duxhane Simmak b. Hareshe dhe pyeti: “E ç’duhet të bëjë kjo shpatë, o Pejgamber i Allahut?” Pejgamberi a.s. tha: *“Me të duhet të godasësh derisa të shtrembërohet!”* Ebu Duxhane tha: *“Unë e marr me këtë kusht, o i Dërguari i Allahut!”* Dhe Pejgamberi ia dha atij.

*Ebu Duxhane* ishte njeri jashtëzakonisht trim dhe virtuoz i vërtetë në luftë. Kur ai e lidhte kokën e tij me shami të kuqe, njerëzit menjëherë e dinin se ai do të hynte në luftë. Edhe kësaj here, pasi e mori shpatën nga dora e Pejgamberit a.s., e nxori shaminë dhe e mbështolli rreth kokës së tij. Pastaj duke u krekosur ecte mes rreshtave. Duke e parë kështu Ebu Duxhanen, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Këtë mënyrë sjelljeje dhe ecjeje Allahu nuk e do, përpos në këso rastesh.”*

<sup>103</sup> Ata janë fisi Evs dhe fisi Hazrexh. Kajle e kishte emrin stërgjiyshja e tyre.

Në anën tjetër, Ebu Sufjani, për të nxitur urrejtjen luftarake tek ata iu drejtua flamurtarit: “O Beni Abdud-Dar, ju e bartët flamurin edhe në Bedër dhe na ndodhi ajo që e patë edhe vetë. Njerëzve u jepet sipas flamurit të tyre. Nëse bie flamuri, bie edhe fitorja. Prandaj ose na kënaqni me flamurin tonë ose na e lini ne dhe ne me të ju kënaqim ju!” Ata reagues me zemërim dhe pastaj i premtuan: “Ne do ta japim flamurin tonë, ndërsa nesër, kur të përleshemi, do të shohësh se çfarë jemi në gjendje për të bërë!” Ebu Sufjani pikërisht atë dëshironte.

Kur dy ushtritë u përballën dhe iu afruan njëra-tjetrës, u ngrit Hind bint Utbe në mesin e grave që e rrethonin, morën defat dhe filluan t’u binin duke shkuar prapa burrave për t’i nxitur për luftë. Ajo recitonte këto vargje:

*Përpara, përpara o Beni Abdud-Dar!  
Përpara, o mbrojtës të prapavijës!  
Godisni me tehun e shpatave me ashpërsi!*

Gjithashtu recitonte:

*Përpara, përpara ne ju përqafojmë,  
Dhe shtratin e butë juve ju ofrojmë!  
Nëse ju zmbropseni, atëherë ndarja,  
ju pret juve, një ndarje e hidhur!*

Shenjë e njohjes me të cilën thirreshin mes vete luftëtarët e Pejgamberit a.s. në Betejën e Uhudit ishin fjalët: “Emit, Emit!”

Atëherë, filloi beteja, konflikti u ndez. Ebu Duxhane luftoi dhe depërtoi thellë në anën e kundërt. Kush i dilte përpara nuk shpëtonte pa u vvarë. Edhe në mesin e idhujtarëve ishte një njeri i cili nuk kishte rivalë. Ata të dy po afroheshin me njëri-tjetrin dhe unë i lutesha Allahut që ata të përballeshin. Dhe në fakt, së shpejti ata u takuan dhe shkëmbyen dy goditje. Idhujtari e goditi Ebu Duxhanen, por ai u mbrojt me mburojën e tij prej lëkure me të cilën njëherazi ia bllokoi shpatën e tij. Atëherë e goditi Ebu Duxhane dhe e vrau. Pastaj e pashë duke e vringëlluar shpatën e tij sipër kokës së Hind bintu Utbes dhe përsëri e tërhoqi prapa<sup>104</sup>.

Edhe *Hamza b. Abdulmuttalibi* luftoi ashpër. Kur e vrau Urtat b. Abd Shurahbil b. Hashim b. Abdi Menaf b. Abdud-Darin njërin nga flamurtarët, pranë tij kaloi Siba b. Abduluzza Gubshaniu, i cili kishte pseudonimin Ebu Nijar. Kur e pa atë, Hamza i bërtiti: “Eja këtu biri i gruas që i bën synet fëmijët!” Nëna e tij, në fakt, kryente synetinë e fëmijëve femra në Mekë!

<sup>104</sup> Ebu Duxhane thotë: “E pashë një person që me tërë fuqinë u jepte kurajë ushtarëve, ndaj vendosa ta vrisja. Kur ngrita shpatën ta godisja, konstatova se ishte femër. Për shkak të nderit të madh ndaj shpatës së Pejgamberit a.s., nuk desha ta ndotja atë me gjakun e kësaj femre.”

*Vahshiu*, shërbëtori i Xhubejr b Mutimit, thotë: “Vallahi, unë e pashë Hamzën i cili me shpatën e tij i priste njerëzit dhe nuk linte asgjë para tij, si deve e përhimtë. Papritmas para meje doli Siba b. Abduluzza dhe Hamza i bërtiti: “Eja këtu (i biri i gruas e cila i bën synet fëmijët).” Pastaj e goditi aq fort, saqë dukej sikur kokën nuk e kishte pasur në vendin e duhur. Unë në atë moment e mora në shenjë me shtizën time dhe e qëllova. E qëllova në pjesën e poshtme të stomakut dhe shtiza doli në anën tjetër ndërmjet këmbëve të tij. Ai u nis drejt meje që të hakmerrej, por nuk mundi të qëndrojë dhe u rrëzua. E lashë me shtizë gjersa vdiq. Pastaj iu afrova, e nxora shtizën nga trupi i tij dhe vajta në kamp. Unë kisha vetëm atë detyrë, që ta vrisja atë. E vrava vetëm që të lirohesh nga robëria dhe vërtet, kur u ktheva në Mekë, isha i lirë.”

Në Mekë kam qëndruar deri kur e pushtoi Pejgamberi a.s., atëherë kam ikur në Taif dhe kam qëndruar atje. Mirëpo, kur prej aty u nis një delegacion për të shkuar dhe për ta pranuar Islamin para Pejgamberit a.s., mua m’u vështirësuan rrugët. Thashë më vete: “Të shkoj në Sham, ose në Jemen apo në ndonjë vend tjetër...”, kështu isha i hutuar gjatë gjithë kohës, kur një njeri njëherë më tha: “Çfarë ke? Ai, vallahi, nuk e vret askënd që hyn në besimin e tij dhe e dëshmon dëshminë e tij!” Kur ai ma tha këtë, unë menjëherë u nisa për Medinë, te Pejgamberi a.s..

Ai ndaj askujt nuk ishte aq i ftohtë sikur ndaj meje derisa po qëndroja pranë tij dhe shqiptoja dëshminë e së vërtetës.

Kur më njohu, më pyeti: “*Vahshiu je ti!?*” I thashë: “Po, o i Dërguari i Allahut!”

Ai më tha: “*Ulu dhe më trego se si e vrave Hamzën!*”

Kur unë e përfundova tregimin, ai më tha: “*Mjerë për ty! Largoje nga unë fytyrën tënde, që mos ta shoh kurrë!*”

Që atëherë unë gjithmonë jam fshehur nga Pejgamberi a.s., në çdo vend, që të mos më shihte përsëri, derisa e mori Allahu!”

*Musab b. Umejri* ka luftuar duke e mbrojtur Pejgamberin a.s. derisa vdiq. Atë e vrau Ibnu Kame Lejthiu, i cili mendoi se ai ishte Pejgamberi a.s. dhe ai menjëherë vrapoi tek Kurejshët duke bërtitur: “Vrava Muhamedin!”

Pasi u vra Musabi, Pejgamberi a.s. ia dha flamurin Ali b. Ebi Talibit, i cili, së bashku me ushtarët e tjerë muslimanë vazhdoi të luftojë.

Kur beteja u ashpërsua, Pejgamberi a.s. u ul nën flamurin e ensarëve dhe dërgoi për të thirrur Ali b. Ebi Talibin me urdhër që ta sjellë flamurin, të cilin ia dorëzoi.

Kur arriti para tij, Aliu tha: “Unë jam Ebul-Kusam!”<sup>105</sup> Dhe ftoi Ebu Sa'd b. Ebi Talhan, i cili mbante flamurin e idhujtarëve.

<sup>105</sup> “Unë jam Ebul-Kusam!” Me fjalë të tjera: “Unë jam fatkeqësia e madhe!” Ai e tha këtë si përgjigje ndaj fjalëve të Ebu Sa’dit, i cili kishte thënë: “Unë jam fatkeqësia e madhe. Kush guxon të më dalë mua në dyluftim?!”

“O Ebul-Kusam, a do të dalim në dyluftim?” Aliu i përgjigjet: “Po, natyrisht!” Dhe doli mes rreshtave. Aty shkëmbyen goditjet dhe Aliu e godet dhe e rrëzon poshtë. Pastaj ai kthehet duke u larguar prej tij, pa e prekur.

Kur sahabët e pyetën pse nuk e godite, ai u përgjigj: “Ai më priti me pjesën e turpshme të tij, kështu që unë u largova nga keqardhja. E kuptova se Allahu i Madhërishëm tashmë e kishte vrarë!”

Luftëtar i shkëlqyer ishte edhe *Asim b. Thabit b. Ebi Akleh*. Ai vrau Musafi b. Talhan dhe vëllanë e tij Xhulas b. Talha. Të dy ata i goditi me shigjetë. Musafiu, ashtu i goditur, shkoi te nëna e tij dhe ia vuri kokën në prehër, ndërsa ajo i tha: “Kush të goditi o biri im?” Ai u përgjigj: “Ai që më gjuajti e kam dëgjuar duke thënë: “Ja merre, se unë jam ibn Ebi Akleh!” Ajo u zotua se po ta merrte kokën e tij, do të pinte verë prej saj!

*Handhale b. Ebi Amir Gasijl* u ballafaqua me Ebu Sufjanin. Iu vërsul atij dhe për pak sa nuk e mposhti, por ndërkohë e pa Sheddad b. Esvedi –d.m.th. Ibn Shaub, i cili ngarendi ta ndihmonte Ebu Sufjanin, kështu që e goditi Handhalen dhe e vrau.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Vërtet këtë shokun tuaj – e kishte fjalën për Handhalen – pikërisht tani po e lajnë engjëjt!” Njerëzit filluan të pyesin: “Për çfarë arsye?” Kur e pyetën gruan e tij, ajo tha: “Ai doli pa u pastruar (xhunub), sapo e dëgjoi kushtrimin për në betejë!”

Pastaj Allahu zbriti ndihmën e Tij për muslimanët dhe kështu e përmbushi premtimin që ua dha atyre. Ata e shkatërruan armikun tërësisht, kështu që depërtuan deri në tendën komanduese. Humbja e tyre tanimë ishte e padiskutueshme.

Zubejri ka thënë: “Vallahi, unë i pashë shërbëtorët e Hind bint Utbe dhe shogët e saj duke ikur me shpejtësi pa marrë asnjë send me vete, as të madh e as të vogël. Papritmas shigjetarët tanë u grumbulluan në tendën komanduese, kështu që ua lanë të lirë kalorësve të armikut rrugën prapa shpinës sonë.

Atëherë kalorësia na erdhi nga pas. Dikush bërtiste: “Muhamedi është vrarë!” Dhe ne kur u kthyem, ata u vërsulën mbi ne në momentin kur ne i patëm vrarë të gjithë bartësit e flamurit dhe asnjëri prej tyre nuk mund të afrohej. Flamuri qëndroi i hedhur në tokë deri sa e mori Umrete bint Alkame Harithije. Ajo e ngriti flamurin për Kurejshët dhe ata përsëri u mblodhën rreth tij.

Muslimanët në këtë mënyrë u zbuluan dhe armiku arriti t’i kapë. Kjo për ta ishte dita e vështirësisë dhe e sprovës së madhe. Allahu shumë muslimanë i nderoi me vdekje në rrugën e Tij. I palënduar nuk shpëtoi as vetë Pejgamberi a.s.. Utbe b. Ebi Vekkasi e qëlloi me një gur në fytyrë, duke ia prerë nofullën dhe thyer një dhëmb. Gjaku i rrodhi në fytyrë, ndërsa ai duke e fshirë gjakun tha:

*“Si do të ketë sukses një popull që ia plagos fytyrën Pejgamberit të Zotit, i cili i thërrret tek Zoti i tyre!”*

Në lidhje me këtë Allahu i Madhërishëm ka zbritur: *“Ty nuk të takon asgjë rreth çështjes se a do t’u pranojë Ai pendimin apo do t’i dënojë ata, në të vërtetë ata janë zullumqarë.”* (Alu Imran, 128)

Nga Ebu Seid Hudriu transmetohet se Utbe b. Ebi Vekkasi e qëllloi Pejgamberin me një gur në fytyrë, duke ia prerë nofullën e poshtme, buzën e poshtme dhe ia theu një dhëmb të përparmë. Abdullah b. Shihab Zuhriu e plagosi në ballë, ndërsa Ibni Kume ia lëndoi pjesën e sipërme të fytyrës. Atij iu ngulën në fytyrë dy hallka të helmetës.

Pejgamberi a.s. ra në një nga gropat që kishte gërmuar dhe kamufluar Ebu Amiri me qëllim që aty të binin muslimanët. Atëherë ia kapi dorën Ali b. Ebi Talibi, ndërsa nga gropa e nxori Talha b. Ubejdullah dhe ai u ngrit në këmbë. Gjakun nga plagët e fytyrës së Pejgamberit a.s. ia thithte Malik b. Sinan, babai i Ebu Seid Hudriut, pastaj e gëlltiti.

Pejgamberi a.s. tha: *“Kushdo që e prek gjakun tim, gjakun e tij nuk do ta prekë zjarri!”*

Kur Kurejshët iu vërsulën atij me të gjitha forcat, Pejgamberi a.s. tha: *“Ai që i dëbon ata prej nesh do të jetë i shpërblyer me xhenet!”* Atëherë u ngrit Zijad b. Sekene me pesë ensarë dhe u sulën drejt armikut në mbrojtje të Pejgamberit a.s.. Kështu ata njëri pas tjetrit vdiqën. Zijadi ose Imare b. Jezid b. Sekene ishte i fundit. Ai luftoi derisa u plagos rëndë, kur erdhi grupi tjetër i muslimanëve i ndihmoi dhe e përzuri armikun.

Pejgamberi a.s. tha: *“Ma afroni mua!”* Dhe ata e afruan. Ai nën kryet e tij vendosi këmbën dhe kështu vdiq me fytyrë në këmbën e Pejgamberit a.s..

Pejgamberin a.s. e ka mbrojtur edhe Ebu Duxhane me trupin e tij. Kur e goditi shigjeta në shpinë, ai u ngrit mbi të, kështu që shumë shigjeta të tjera u ngulën në të. Sa'd b. Ebi Vekkasi shigjetat i dërgonte në drejtim të kundërt dhe kështu mbronte të Dërguarin a.s.. Ai tregon: *“Ebu Duxhane m’i jepte shigjetat dhe më thoshte: “Gjuaj! Vetëm gjuaj! T’u bëfshin kurban babai dhe nëna ime!”*

Së fundi më zgjati edhe një shigjetë që nuk kishte majë dhe më tha: *“Gjuaj me të!”*

I pari që e njohu Pejgamberin a.s. pas kësaj disfate dhe pas lajmit se Pejgamberi ishte vvarë ishte Ka'b b. Maliku. Ai thotë: *“Ja njoha sytë që i shkëlqenin nën mburojën e kokës!”* Pastaj bërtita me zë të lartë: *“Gëzohuni, o muslimanë! Ja ku është i Dërguari i Allahut!”* Mirëpo, ai më bëri shenjë që unë të heshtja!

Kur e panë muslimanët, e ngritën në duart e tyre dhe ai u nis me ta kah gryka. Bashkë me të ishin Ebu Bekër Siddiku, Omer b. Hattabi, Ali b. Ebi Talibi,

Talha b. Ubejdullahu, Zubejr b. Avvami, Allahu qoftë i kënaqur me ta, pastaj edhe Harith b. Simme dhe një grup tjetër muslimanësh.

Kur Pejgamberi a.s. doli në grykën e Uhudit, atë e pa Ubej b. Halef, i cili i tha: “Ku është Muhamedi? Jam betuar se unë nuk kam shpëtim nëse shpëton ai!” Shokët e tij që ishin me të i thanë: “O i Dërguari i Allahut, a të zbavitemi pak me të?”

Ai u përgjigj: “*Lëreni!*”

Pastaj, i Dërguari a.s. mori shtizën nga Harith b. Simme dhe - siç më është treguar - disa njerëz për të kanë rrëfyer: “Kur e mori Pejgamberi a.s. shtizën, u shkundullua saqë ne jemi shpërndarë prej tij sikurse mizat nga kurrizi i devesë. Pastaj u kthye kah ai dhe e qëlloi fort në qafë, kurse Ubej u rrokullis mbi kalin e tij.”

Ebu Ubej kur ishte në Mekë e kishte takuar Pejgamberin a.s. dhe i kishte thënë: “O Muhamed, unë kam Avdhin<sup>106</sup> tim, të cilin çdo ditë e ushqej me nga një çanak (12 kilogramë) misër. Do të të vras duke kalëruar me të.”

Pejgamberi a.s. i ishte përgjigjur: “*Dashtë Allahu, unë do të të vras ty!*”

Kështu, kësaj here kur u kthye te Kurejshët, me një gërvishtje jo të madhe në qafë, nga e cila i rridhte gjaku, murmuriti: “Më vrau Muhamedi, vallahi!” Ata iu përgjigjën: “Vallahi, mori fund zemra jote, do të vdesësh! E ishe aq i fuqishëm!”

Ai tha: “Qysh në Mekë Muhamedi më pat thënë: ‘*Unë do të të vras ty!*’ Vallahi, vetëm të më kishte pështyrë, do të më mbyste!”

Kështu vdiq armiku i Allahut në Serif<sup>107</sup>, kurse Kurejshët me karvan e dërguan në Mekë.

Kur Pejgamberi a.s. arriti në fund të grykës, Ali b. Ebi Talibi zbriti poshtë për të mbushur mataranë e vet të lëkurës me ujë nga burimi i quajtur Mihras. Ai i solli Pejgamberit a.s. për të pirë prej këtij uji, mirëpo ai ndjeu një erë të pakëndshme dhe në heshtje u tërhoq nga pirja. Me atë ujë vetëm lau gjakun nga fytyra dhe e lagu kokën e pastaj tha: “*Allahu është shumë i zemëruar me atë që e ka përgjakur fytyrën e Pejgamberit të Tij!*”

Kur Pejgamberi a.s. u tërhoq në mal, para tij ishte një gur i madh të cilin nuk mund ta kapërcente sepse tashmë ishte i shtyrë në moshë, fizikisht i dobët dhe i rënduar nga dy parzmore. Atëherë Talha b. Ubejdullahu shtriu shpinën, ai hipi mbi të, pastaj mbi gurë dhe kështu e kaloi pengesën. Në këtë rast, Pejgamberi a.s. tha: “*Talha b. Ubejdullahu e ka fituar xhenetin për gjithë atë çfarë ka bërë për të Dërguarin!*”

Në mesin e atyre që kanë vdekur në betejën e Uhudit ishte edhe *Muhajriku*, pjesëtar i fisit të Benu Thalebe b. Fitjevn.

Ai, në ditën e betejës së Uhudit, ka thënë: “O hebrenj, duhet ta dini se e kemi borxh ta ndihmojmë Muhamedin!” Ata u përgjigjën: “Por sot është ditë e shtunë.”

<sup>106</sup> Emri i kalit të tij.

<sup>107</sup> Serif është vend gjashtë milje larg nga Meka.

Ai u përgjigj: “Nuk ka kurrfarë të shtune për ju.” Pastaj ai mori shpatën dhe pajisjen e vet e tha: “Nëse vritem, tërë pasurinë time ia lë Muhamedit, le të bëjë me të çfarë të dojë.” Ai hyri në luftë dhe luftoi në anën e muslimanëve me tërë fuqinë që pati, gjer në frymën e fundit.

Pejgamberi a.s. ka thënë për të: *“Muhajriku është hebreu më i mirë.”*

Ebu Hurejra thoshte: “A e dini një njeri i cili ka hyrë në xhenet dhe nuk ka falur asnjë namaz?!”

Pasi asnjëri prej tyre nuk e dinte, ata e pyetën atë: “Po kush është ai?” Kurse ai përgjigj: “Ai është Usajrim Beni Abdul-Eshhel, d.m.th. Amër b. Thabit b. Vaksh.”

Husajn b. Abdurrahmani ka thënë: “E kam pyetur Mahmud b. Esedin: “Si ka qenë puna e Usajrimit?” Ai më tha: “Ai refuzoi që populli i tij ta pranonte Islamin, por kur Pejgamberi a.s. doli për Uhud, Islami iu duk më ndryshe dhe ai e pranoi. Ai menjëherë e mori shpatën, vrapoi dhe hyri në mes të njerëzve. Me ta luftoi derisa plaga që mori nuk e dobësoi plotësisht. Kur njerëzit nga fisi Benu Abdul-Eshhel nëpër fushën e betejës i kërkonin të vdekurit e tyre, e gjetën edhe atë. Atëherë thanë: “Vallahi, ky është Usajrimi, çfarë e ka sjellë atë këtu? Ai e mohonte këtë fjalim.” Ata pyetën: “Çfarë të solli ty këtu, o Amër? Dashuria ndaj popullit tënd apo dëshira për Islamin?” Ai u përgjigj: “Dëshira për Islamin! Unë kam besuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe e kam përqaftuar Islamin. Pastaj e mora shpatën, iu bashkova Pejgamberit a.s. dhe luftova me të derisa më goditi kjo!” Pas pak ai vdiq në duart e tyre.

Kur ia treguan Pejgamberit a.s., ai tha: *“Me të vërtetë Usajrimi është nga banorët e xhenetit!”*

Amër b. Xhamuh ishte njeri shumë i çalë dhe kishte katër djem si katër luaj, të cilët me Pejgamberin a.s. kishin marrë pjesë në shumë beteja. Në ditën e Uhudit ata deshën ta ndalnin duke i thënë: “Vërtet Allahu të ka dhënë justifikim”, por ai shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “Bijtë e mi duan të më pengojnë mua nga kjo dhe të më ndalojnë që të vij me ty, ndërsa unë vallahi dëshiroj që me këtë çalimin tim të eci në xhenet!”

Pejgamberi a.s. i tha: *“Ty Allahu të ka dhënë arsytim dhe nuk je i obliguar për të luftuar!”*

Ndërsa bijve të tij u tha: *“Ju mos e pengoni, ndoshta Allahu e shpërblen me vdekje në rrugën e Tij!”* Pastaj, ai shkoi me Pejgamberin a.s. dhe vdiq në Betejën e Uhudit.

Hind bint Utbe dhe gratë që ishin me të kanë masakruar luftëtarët e vvarë të Pejgamberit a.s. dhe ua kanë prerë veshët dhe hundët e tyre. Hinda, për më tepër, nga veshët dhe hundët e prera kishte bërë byzylyk dhe gjerdane, ndërsa byzylykët e saj, gjerdanin dhe vathët ia kishte dhënë Vahshiut, shërbëtorit të

Xhubejr b. Mu'timit. Ajo Hamzës ia kishte nxjerrë mëlçinë dhe e kishte përtypur me dhëmbë, por pasi nuk kishte mundur ta gëlltiste, e kishte hedhur.

*Hulejs b. Zebban*, i cili në betejën e Uhudit ishte prijës i Ehabishve, kur kaloi pranë Ebu Sufjanit, e pa atë që po godiste nofullën e Hamzës me majë të shigjetës dhe i thoshte: "Shijo, o i pabindur!" Hulejsi i tha: "O Beni Kinane, shikoni çfarë po bën lideri i Kurejshëve me xhaxhanë e vet të vdekur, i cili nuk është në gjendje të mbrohet!"

Ebu Sufjani i tha: "Hesht! Mos i fol askujt për këtë! Ky ishte një moment i dobësisë sime!"

Para largimit nga fushëbeteja, Ebu Sufjan b. Harbi u ngjit në kodër dhe bërtiti me zë të lartë: "Fitove, ndaj ngrihu lart! Lufta është garim, herë ashtu, herë kështu! Prandaj madhëroje Hubelin (d.m.th. fenë tënde)!"<sup>108</sup>

Pejgamberi a.s. tha: "Ngrihu o Omer dhe përgjigju! Thuaj: Allahu është më i madh dhe më i fuqishëm! Nuk jemi të barabartë, të vrarët tanë do të hyjnë në xhenet, kurse tuajt do të hyjnë në zjarr." Kur Omeri i tha këtë, Ebu Sufjani bërtiti: "Dil para meje, o Omer!"

Pejgamberi a.s. i tha Omerit: "Shko e shih se ç'do?" Omeri doli, e Ebu Sufjani e pyeti: "Të përbej me Allahun, o Omer, a e kemi vrarë Muhamedin?"

Omeri tha: "Vallahi, jo! Ja ku është këtu dhe po dëgjon se ç'po thua ti."

Ebu Sufjani tha: "Për mua ti je më i sinqertë e më i ndershëm se Ibni Kame", duke iu referuar fjalëve të Ibni Kames që pat deklaruar: "E kam vrarë Muhamedin!"

Pastaj Ebu Sufjani bërtiti: "Në mesin e të vrarëve tuaj ka të masakruar. Unë, vallahi, për këtë as nuk gëzohem e as nuk zemërohem. Unë as nuk e kam ndaluar as nuk e kam urdhëruar!"

Duke shkuar me njerëzit e tij gjithashtu bërtiti: "Takimi ynë i ardhshëm, pas një viti në Bedër!"

Pejgamberi a.s. i tha njerëzit nga njerëzit e tij: "Thuaji atij: Po, mes nesh është bërë marrëveshja për përballje!"

Pastaj Pejgamberi iu drejtua Ali b. Ebi Talibit dhe i tha: "Shko pas gjurmëve të tyre dhe shih se ç'janë duke bërë dhe çfarë synojnë. Nëse kanë zbritur nga kuajt dhe u kanë hipur deveve, atëherë kanë vendosur të kthehen në Mekë. Por, nëse u kanë hipur kuajve e devetë i kanë prapa, atëherë kanë vendosur të shkojnë në Medinë. Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, nëse kanë ndër mend Medinën, do të shkojmë pas tyre e atëherë do të luftojmë me ta!"

Ka thënë Aliu r.a.: "Unë shkova pas tyre duke i përcjellë se çfarë do të bëjnë. Ata iu hipën deveve, kurse kuajt i tërhiqnin pranë vetes dhe u nisën drejt Mekës." Njerëzit u përkushtuan ndaj të vdekurve.

Pejgamberi a.s. pyeti: "Kush do të shikojë e të më thotë se çfarë ka ndodhur me Sa'd b. Rebian? A është në mesin e të gjallëve apo të vdekurve?"

<sup>108</sup> Hubel ishte njëri nga idhujt e arabëve paraislamikë.

Një njeri nga ensarët tha: “Unë do të shikoj për ty o i Dërguari i Allahut, se çfarë ka ndodhur me Sa'din!”

Pastaj ai shkoi dhe e gjeti të plagosur në mesin e të vrarëve, duke dhënë shpirt dhe i tha atij: “Pejgamberi a.s. më urdhëroi të shikoj se a je ti në mesin e të gjallëve apo të vdekurve!”

Ai tha: “Unë jam në mesin e të vdekurve! Pejgamberit a.s. bëji selam nga unë dhe thuaji atij: Sa'd b. Rebia të porositi: Allahu të shpërbleftë me shpërblimin më të mirë që i ka dhënë ndonjë Pejgamberi nga umeti i tij! Përcilli selamin edhe popullit tim dhe thuaju atyre: Sa'd b. Rebia ju porositi: Nuk do të keni kurrfarë arsyesimesh para Allahut nëse i bëjnë diçka (idhujtarët) Pejgamberit tuaj, përderisa ekziston dikush i gjallë prej jush.” Pas këtyre fjalëve dha shpirt. Pastaj unë u ktheva tek Pejgamberi a.s. dhe i tregova se çfarë ndodhi.”

Pastaj Pejgamberi a.s. doli për të kërkuar Hamza b. Abdulmuttalibin dhe e gjetën në mes të luginës me stomak të hapur, me mëlçi të nxjerra dhe të masakruara, me hundë dhe veshë të prerë. Duke e parë kështu, Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Sikur të mos pikëllohej Safijja dhe unë të mos frikësohesha se do të bëhej zakon, do ta kisha lënë kështu që të shkojë në barkun e bishave dhe gushën e zogjve! Nëse ma mundëson Allahu ndonjëherë t'i mposht Kurejshët, në ndonjë vend, do t'i masakroj tridhjetë njerëz të tyre!*”

Duke parë muslimanët pikëllimin e tillë të Pejgamberit a.s. dhe zemërimin e tij për atë çfarë i kishin bërë xhaxhait të tij, thanë: “Vallahi, nëse Allahu na jep fitore mbi ta, do t'i masakrojmë në atë mënyrë që kurrë nuk i është bërë asnjë arabi!”

Transmetohet nga Ibn Abbasi se në lidhje me këto fjalë të tyre, Allahu i Lartësuar ka zbritur:

*“Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju; e nëse duroni pa dyshim ai është më i mirë për ata që durojnë. Pra, të jesh i durueshëm! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Ti mos u pikëllo për ata, as mos u brengos për dredhitë që bëjnë ata!”* (El-Nahl, 26-27)

Pejgamberi a.s. pas kësaj ua fali dhe e ndaloi masakrimin.

Më pas, ai urdhëroi që trupi i Hamzës të mbulohet me pelerinën e tij dhe pastaj ia fali namazin e xhenazes duke marrë shtatë tekbiere. Ai pastaj urdhëroi që edhe trupat e të rënëve të tjerë të vendosen pranë tij dhe kështu të gjithëve ua fali namazin e xhenazes. Në këtë mënyrë, Hamzës i fali 72 namaze të xhenazes.

Ibn Is'haku thotë:

“Siç kam dëgjuar, Safijja bint Abdulmuttalib ishte nisur për ta parë atë sepse ai ishte vëllai i saj, por Pejgamberi a.s. i tha djalit të saj Zubejr b. Avvamit:

*“Shko para saj dhe ktheje prapa, që mos të shohë se çfarë është bërë me vëllanë e saj!”*

Djali i tha: “Oj nënë, Pejgamberi a.s. të urdhëron që të kthehesh!” Ajo tha: “Përse? Unë e di se vëllai im është masakruar, por ai vdiq në emër të Allahut. A

ka gëzim më të madh për ne se kaq? Pa dyshim unë do të përmbahem dhe do të duroj, dashtë Allahu!”

Kur Zubejri u kthye te Pejgamberi a.s. dhe i tregoi për këtë, ai tha: *“Lejojeni të shkojë!”*

Atëherë, ajo shkoi deri tek ai, e pa dhe qetësisht tha: *“Ne jemi të Allahut dhe vetëm tek Ai kthehemi!”*, pastaj bëri lutje për faljen e mëkateve dhe më pastaj Pejgamberi a.s. urdhëroi që të varrosët.

Njerëzit disa nga të vrarët i bartën për në Medinë dhe i varrosën atje, por Pejgamberi a.s. i ndaloi duke thënë: *“Varrosini në vendin ku kanë rënë!”*

Transmetohet nga Abdullah b. Thalebe se Pejgamberi a.s., duke qëndruar mbi personat e vrarë në Betejën e Uhudit, ka thënë:

*“Unë jam dëshmitar për këta! Nuk ka asnjë të plagosur që merr plagë në rrugën e Allahut e që Allahu në Ditën e Gjykimit të mos e ringjallë me atë plagë e cila do të rrydhë gjak. Ngjyra do të jetë e gjakut, ndërsa aroma e miskut. Shikoni kush prej tyre dinte më shumë Kur’an, atë vendoseni përpara, që të jetë imam i shokëve të tij në varr!”*

Janë varrosur nga dy ose nga tre në një varr.

Pastaj Pejgamberi a.s. u nis për t’u kthyer në Medinë. Gjatë rrugës i takoi Hamne bint Xhahsh dhe njerëzit e njoftuan për vdekjen e vëllait të saj Abdullah b. Xhahsh. Ajo u përgjigj: *“Ne jemi të Allahut dhe vetëm tek Ai kthehemi!”* Dhe bëri lutje për faljen e mëkateve. Pastaj ajo në mënyrë të njëjtë veproi kur e njoftuan për vdekjen e dajës së saj Hamza b. Abdulmuttalib. Mirëpo, kur e njoftuan për vdekjen e burrit, ajo bërtiti dhe kukati.

Kur e pa Pejgamberi a.s. përmbajtjen e saj pas përmendjes së vdekjes së vëllait dhe xhaxhait të saj, ndërsa pas përmendjes së burrit të saj ajo bërtiti dhe kukati, ai tha: *“Burri ka vend të posaçëm tek gruaja!”*

Pejgamberi a.s. pastaj kaloi pranë një shtëpie ensarësh nga fisi Beni Abdul-Eshhel dhe Dhafer. Nga ajo dëgjoji vajtimin për të vrarët e tyre, kështu që i lotuan sytë dhe qau Pejgamberi a.s., pastaj tha: *“Mirëpo, për Hamzën nuk ka vajtues!”* Pasi u kthyen Sa’d b. Muadhi dhe Usejd b. Hudajr te shtëpia e Beni Abdul-Eshhel, i urdhëruan gratë e tyre që të përgatiten dhe të shkojnë për ta vajtuar xhaxhanë e Pejgamberit a.s..

Kur Pejgamberi a.s. e dëgjoji vajin e tyre për Hamzën, doli dhe i pa ato në derën e xhamisë së tij duke vajtuar, pastaj tha: *“Kthehuni, Allahu ju mëshiroftë, sepse ju keni ngushëlluar!”*

Pastaj Pejgamberi a.s. kaloi afër një gruaje të fisit Benu Dinar. Në Uhd i ishte vrarë burri, vëllai dhe babai. Kur e informuan për këtë, ajo pyeti: *“E Pejgamberi a.s., si është ai?”* Iu përgjigjën: *“Ai është mirë, ai është mirë, falënderimi i qoftë Allahut, ashtu siç dëshiron edhe ti.”* Ajo tha: *“Më tregoni ku është! Dua ta shoh!”*

Ata i treguan, e ajo kur e pa tha: “Çdo fatkeqësi e cila është shmangur nga ti është më e vogël!”

Me të arritur Pejgamberi a.s. në shtëpi, shpatën e tij ia dha vajzës së tij Fatimes dhe i tha: “Laje gjakun nga shpata, vajza ime, ajo sot, pasha Allahun, ka shërbyer mirë!”

Edhe Ali b. Ebi Talibi ia dha asaj shpatën e tij dhe i tha: “Laje gjakun nga kjo shpatë, ajo edhe mua sot më ka shërbyer mirë.” Pejgamberi a.s. i tha Aliut: “Ti sot ishe luftëtar i vërtetë, por edhe Sehël b. Hunejfi edhe Ebu Duxhane.”

Beteja e Uhudit u zhvillua ditën e shtunë, në gjysmën e muajit shevval.

Të nesërmen, ditën e diel, më 16 shevval, muezini i Pejgamberit a.s. i ftoi njerëzit që të dalin në kërkim të armikut. Ai tha: “Me ne nuk bën të niset asnjë që dje nuk ishte në betejë!” Në atë moment Pejgamberit a.s. iu drejtua Xhabir b. Abdullah b. Amër b. Haram, i cili tha: “O i Dërguari i Allahut, babai im më la me shtatë motrat e mia. Më tha: “O biri im, as ti as unë nuk duhet t’i lëmë këto gra vetëm, pa asnjë mashkull në mesin e tyre. Unë, megjithatë, nuk mund të vendos para vetes kur është fjala për pjesëmarrjen në luftë me Pejgamberin a.s.. Prandaj, ti qëndro me motrat e tua! Dhe ja, unë qëndrova!” Pejgamberi a.s. e lejoi dhe ai shkoi me ta.

Qëllimi i daljes së Pejgamberit a.s. në fakt ishte frikësimi i armikut, d.m.th. që kur të dëgjonte këtë lajm të mendonte se ata janë të fortë dhe se humbja nuk i ka dobësuar fare.

Në këtë marshim, Pejgamberi a.s. mbërriti deri në Hamraul-Esed, rreth tetë milje larg nga Medina. Gjatë kohës së mungesës së tij si zëvendës në Medinë la Ibn Ummi Mektumin. Atje qëndroi tri ditë: të hënën, të martën dhe të mërkurën, pastaj u kthye në Medinë.

Pranë tij kaloi Mabed b. Ebi Mabed Huzaiu, fisi i të cilit Huza'a, si muslimanët edhe idhujtarët, të gjitha sekretet e tyre ia besuan Pejgamberit a.s. që prej takimit të tyre në Tihame. Prej tij asgjë nuk kishin fshehur, ndërsa Mabedi atëherë ende ishte idhujtar.

Ai tha: “O Muhamed, na erdhi keq, vallahi, kur dëgjuam se ç’të ndodhi ty! Dëshirojmë që Allahu të të kthejë shëndetin dhe të të forcojë.”

Pastaj Pejgamberi a.s. shkoi dhe derisa ende ishte në Hamraul-Esed, ai u takua me Ebu Sufjan b. Harbin dhe njerëzit e tij. Kjo ndodhi në Revha<sup>109</sup>, pikërisht aty ku ranë dakord që të kthehen përsëri te Pejgamberi a.s. dhe shokët e tij. Ata thanë:

“Ne ia vramë njerëzit e tij më të rrezikshëm, fisnikët dhe udhëheqësit e tyre, atëherë pse të shkojmë para se t’i shkatërrojmë në rrënjë?! Gjithsesi duhet të kthehemi që edhe pjesës tjetër t’i japim fund!”

<sup>109</sup> Revha, fshat në Mezhene, dy net larg Medinës.

Kur e pa Mabedin, Ebu Sufjani e pyeti: “Kush janë ata prapa teje, o Mabed?” Ai tha: “Muhamedi me ushtrinë e vet, së cilës nuk i dihet as numri. Është duke thirrur për luftë. Do t’ju shkatërrojë tërësisht. Atij i janë bashkuar edhe të gjithë ata të cilët patën munguar në Uhud, të dëshpëruar dhe të penduar që nuk morën pjesë në betejë. Janë të hidhëruar dhe të mllefosur kundër jush si kurrë më parë.”

Ebu Sufjani tha: “Vaj halli për ty, ç’je duke thënë?”

Mabedi tha: “Vallahi, mendoj se nuk duhet të shkosh derisa të shohësh pluhurin nga kuajt!”

Ebu Sufjani tha: “Ne, për Zotin, u morëm vesh që t’i sulmojmë e t’i shkatërrojmë ata!”

Mabedi tha: “Unë nuk të këshilloj të veprosh kështu. Vallahi, ajo që kam parë, më ka shtyrë që atyre t’u kushtoj edhe një poezi.

Ebu Sufjani tha: “Çfarë ke thënë në atë poezi?”

Mabedi tha: “Unë i recitova:

*Deveja ime gati u rrëzua, e frikësuar nga zërat që dëgjoji  
kur marshuan nëpër tokë grupe të mëdha kalorësish,  
për t’u hedhur mbi luanët fisnikë,  
të cilët nuk janë të shkurtër në takim,  
as nuk janë të ngathët për shalim e armatim!  
Edhe unë nxitova, duke menduar se toka ka anuar,  
kur ata u ngjitën deri tek ne,  
me udhëheqësin e pabraktisur!  
Dhe unë i thashë: Vaj halli për ty, o Ibni Harb!  
Prej takimit me të kur të dridhet Bat’ha<sup>110</sup>  
me njerëzit në të!  
Unë i paralajmëroj njerëzit e Haremit, prej tyre  
çdonjërin nga ata që ka mendje dhe arsye,  
i paralajmëroj ata për ushtrinë e Ahmedit  
dhe për kalorësit e tij të fuqishëm, që nuk ta lënë vendin!”*

Kjo poezi dyvargëshe ishte një paralajmërim për Ebu Sufjanin dhe njerëzit e tij.

Në ato momente kaluan aty disa kalorës nga fisi Abdul-Kajs. Ebu Sufjani i pyeti: “Ku po shkoni?” Ata thanë: “Po shkojmë në Medinë. Po shkojmë për artikuluj ushqimorë.”

Tha: “A dëshironi t’ia dërgoni Muhamedit një porosi prej meje dhe unë do t’i mbush devetë tuaja me rrush të thatë në Ukkadh?”

<sup>110</sup> Bat’ha’, emri i vendit ku atëherë ndodhej Ebu Sufjani.

Ata u përgjigjën: “Po.” Ebu Sufjani tha: “I thoni Muhamedit se ne jemi tubuar që të gjithë dhe jemi nisur për ta shkatërruar atë dhe shokët e tij.”

Më vonë kur ky karvan kaloi pranë Pejgamberit a.s. në Hamraul-Esed dhe ia përcollën porosinë e Ebu Sufjanit, ai vetëm tha: *“Neve na mjafton Allahu dhe Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”*

Gjatë kthimit për në Medinë, Pejgamberi a.s. zuri rob Muavije b. Mugire b. Ebil-As dhe Ebu Izzet Xhumehiun, njeriun i cili pat qenë në mesin e të robëruarve në Bedër dhe që e kishte liruar vetë Pejgamberi a.s.. Ky i tha: “O i Dërguari i Allahut, më lësho!” Pejgamberi a.s. i tha: *“Kurrë nuk do të shëtitësh më rrugëve të Mekës e të thuash: “E mashtrova Muhamedin dy herë!”*<sup>111</sup> Pastaj Pejgamberi a.s. urdhëroi Zubejrin që ta vriste.

Pastaj Pejgamberi a.s. u kthye në Medinë. Abdullah b. Ubej b. Seluli kishte një vend të posaçëm gjatë kohës së namazit të xhumasë, të cilin askush nuk ia kontestonte. Ky ishte një nder i veçantë për të dhe njerëzit e tij, në mesin e të cilëve ai vlerësohej jashtëzakonisht. Kur Pejgamberi a.s. ditën e premte ulej duke u mbajtur njerëzve fjalim, ai ngrihej dhe thoshte: “O njerëz! Para jush është i Dërguari i Allahut, Allahu me të ju ka nderuar dhe ju ka forcuar, ndaj ndihmoni dhe mbështeteni, dëgjojeni mirë dhe zbatoni atë që kërkon prej jush!” Pastaj ulej dhe vazhdonte të dëgjonte.

Pas betejës së Uhudit, në namazin e xhumasë ai u ngrit dhe foli të njëjtat fjalë. Megjithatë, muslimanët nga të gjitha anët e kapën nga rrobat dhe i thanë: “Ulu poshtë, armiku i Allahut! Ti nuk je i denjë për këtë, pasi ke bërë atë çfarë ke bërë!” Atëherë ai u ngrit, duke kapërcyer mbi njerëzit dhe u nis drejt daljes duke thënë: “Vallahi, sikur të kisha thënë diçka të keqe, për faktin se unë u ngrita dhe e mbështeta!”

Në derë të xhamisë atë e takoi një burrë nga ensarët, i cili e pyeti: “Çfarë ke, vaj halli për ty?!” Ai i tha: “Unë u ngrita për ta mbështetur atë, ndërsa njerëzit e tij nga të gjitha anët kërcyen mbi mua, filluan të më tërheqin për rrobash dhe të më qortojnë, sikur të kisha thënë diçka të keqe, për faktin se unë u ngrita dhe e mbështeta!”

Ensari i tha: “Vaj halli për ty! Kthehu dhe i Dërguari a.s. le të bëjë një lutje për falje!”

Ai tha: “Për Zotin, unë nuk dua që ai të lutet për faljen time!”

Ibni Is'haku thotë:

“Beteja e Uhudit ishte një vuajtje e madhe, fatkeqësi dhe sprovë. Allahu me të i ka sprovuar besimtarët dhe i ka provuar hipokritët, të cilët besimin e tyre e

<sup>111</sup> Sipas një transmetimi tjetër, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Besimtarin nuk bën ta kafshojë gjarpri dy herë nga zgavra e njëjtë.”* Pastaj urdhëroi Asim b. Thabiti që ta vriste.

shfaqën vetëm me gjuhë, ndërsa në zemër kanë fshehur pabesi. Ishte një ditë në të cilën Allahu i Madhërishëm i ka nderuar shumë të dashur të Tij me vdekjen në rrugën e Tij.”

### Ngjarja në Rexhi' (viti 3 h.)

Pas Betejës së Uhudit, te Pejgamberi a.s. erdhi një delegacion nga fisi Adal dhe Karre dhe i thanë:

“O i Dërguari i Allahut, në mesin tonë ka Islam, ndaj kemi ardhur që të na dërgosh disa njerëz, të cilët do të na mësojnë fenë dhe këndimin e Kur'anit.”

Pejgamberi a.s. dërgoi me ta personat e mëposhtëm: Murthed b. Ebi Murthed, Halid b. Bekijr, Asim b. Thabit, Hubejb b. Adiun, Zejd b. Dethine dhe Abdullah b. Tarik. Udhëheqës të tyre, Pejgamberi a.s. caktoi Murthed b. Ebi Murthedin. Mirëpo, kur arritën në vendin Rexhi', burim uji i fisit Hudhejl, i cili gjendej në fillim të Hudes<sup>112</sup>, ata i tradhtuan dhe kërkuan ndihmë nga fisi Hudhejl. Derisa ata po qëndronin hipur në devetë e tyre, papritmas u dolën burra me shpata në duar. Kur e panë se janë mashtruar, edhe këta i kapën shpatat e tyre për t'iu kundërvënë duke u thënë: “Ne, për Zotin, nuk duam t'ju vrasim, vetëm duam që nga mekasit të përfitojmë diçka për ju! Ju zotohemi para Zotit se nuk do t'ju vrasim!”

Murthed b. Ebi Murthedi, Halid b. Bekijr, Asim b. Thabiti thanë: “Vallahi, ne nuk pranojmë asnjë marrëveshje e as obligim nga idhujtarët. Asim b. Thabiti recitoi vargjet vijuese:

*Çfarë faji kam unë që jam harkëtar i ashpër,  
ndërsa harku i shigjetës sime i shtrirë dhe i fortë?!  
Nga drejtimi i tij shtizat kthehen!  
Vdekja është e vërtetë, ndërsa jeta gënjeshtër.  
Çdo gjë që Zoti cakton te njeriu realizohet,  
edhe njeriu shkon tek Ai dhe aty takohet!*

Pastaj u sul mbi ta dhe luftoi derisa u vra, së bashku me të, u vranë edhe dy shokët e tij.

Kur u vra Asimi, njerëzit nga fisi Hudhejl deshën ta merrnin kokën e tij për t'ia shitur Sulafe bint Sa'd b. Shuhejd, e cila në Betejën e Uhudit kishte humbur dy bijtë e saj dhe ishte zotuar se nëse ia mundësonte Allahu që ta merrte kokën e tij, do të pinte verë prej kafkës së tij, mirëpo kjo nuk iu lejua nga reja e bletëve dhe grerëzave. Pasi bletët u vendosën mes tij dhe atyre, ata thanë: “Lëreni aty de-

<sup>112</sup> Hude, vend në mes të Asfanit dhe Mekës.

risa të bjerë mbrëmja dhe kur të shpërndahen bletët, shkoni e merreni!" Papritmas Allahu dërgoi një rrebesh shiu, i cili mori ç'gjeti para dhe kufoma e Asimit humbi.

Asimi më parë i ishte zotuar Allahut në mënyrë të vendosur se kurrë nuk do të lejonte ta prekte idhujtari, as ai vetë s'do t'i prekte ata, në mënyrë që të mos ndotej nga ajo prekje.

Kur Omer b. Hattabi dëgjoi se atë e kanë mbrojtur bletët dhe grerëzat, tha: "Allahu e mbron robin e Tij besimtar! Asimi ishte zotuar se sa të jetë gjallë, nuk do të lejohet ta prekë idhujtari, e as ai vetë s'do t'i prekë ata, kështu që Allahu e ka mbrojtur ngaqë është ruajtur gjatë jetës!"

Zejd b. Dethine, Hubejb b. Adiu dhe Abdullah b. Tarik lëshuan pe, u zbutën dhe e deshën jetën më shumë. I shtrinë duart dhe ata i robëruan. Pastaj i morën në Mekë, me qëllim për t'i shitur atje. Mirëpo, kur ata ishin në Dhahran, Abdullah b. Tariku i nxori duart nga litari me të cilin ishte i lidhur dhe mori shpatën, por ata ishin prapa tij dhe e gjuajtën me gurë. Varri i tij, Allahu e mëshiroftë, ende gjendet në Dhahran.

Hubejb b. Adiun dhe Zejd b. Dethinen i çuan në Mekë dhe i këmbyen me Kurejshët për dy të robëruar nga fisi Hudhejl që gjendeshin tek ata.

Hubejbini e këmbëu Huxhej b. Ebi Ihab me Ukbe b. Harith b. Amir për ta vvarë në shenjë hakmarrjeje për të atin, kurse Zejd b. Dethinen e mori Safvan b. Umejje për ta vvarë për babanë e tij. Umejje b. Halef. Safvani përmes djaloshit të quajtur Nistas e dërgoi në Tenim<sup>113</sup>. Atje e nxorën nga haremi për ta vvarë. Aty u mblodhën një grup Kurejshësh, në mesin e të cilëve ishte edhe Ebu Sufjan b. Harbi. Kur e sollën Zejdin për ta ekzekutuar, ai e pyeti:

"Për Zotin, o Zejd, a do të gëzoheshe sikur Muhamedi të ishte këtu e ta vrisnim, e ty të të lironim të shkoje në shtëpinë tënde?"

Ai u përgjigj: "Jo, vallahi, nuk do të gëzohesha fare që unë të isha te familja ime e Muhamedi të ishte në këtë vend, bile as ta shponte një gjemb."

Ebu Sufjani tha: "S'kam parë në botë njeri që të duhet nga shokët kaq shumë sa ç'duhet Muhamedi!" Pastaj atë e ekzekutoi Nistasi. Allahu e mëshiroftë Zejdin!

Transmetohet nga Mu'avijje, robëreshë e Huxhejr b. Ebu Ihabit, e cila tashmë e kishte pranuar Islamin, se ka thënë: "Hubejbi ishte tek unë, ishte i burgosur në shtëpinë time. Një herë përgjova nëpër një vrimë në dhomën e tij dhe e pashë tek mbante në dorë dhe po hante një kalavesh rrushi sa një kokë njeriu, e në atë kohë nuk e shihje askënd duke ngrënë rrush. Kur u afrua koha e ekzekutimit të tij, ai më tha: "Më dërgo ndonjë hekur të mprehtë, që të rregullohem me të para vrasjes!" Unë një djali nga lagjja i dhashë një brisk dhe i thashë: "Çoja këtë atij njeriut atje në shtëpi!" Kur djaloshi shkoi atje, mendova: Çfarë bëra unë, o Zot, ai do ta

<sup>113</sup> Tenim quhet vendi mes Mekës dhe Serifit, gjashtë milje larg Mekës.

vrasë djaloshin, kështu që e barazon llogarinë: kokë për kokë! Megjithatë, kur djaloshi ia dha atij briskun, ai e mori pastaj tha: "Për jetën tënde, o djalosh, nëna jote kur ma dërgoi briskun, a nuk pati frikë nga mashtrimi im?!" Pastaj në heshtje e lejoi të shkojë."

Hubejb in së shpejti e nxorën dhe e dërguan në Tenim për ta ekzekutuar, kurse ai u tha: "Nëse doni, më lejoni të fal dy rekate namaz!" Ata ia lejuan. Pastaj ai i fali dy rekate, në mënyrë të mirë dhe të plotë, pastaj u kthye në vendin e tij dhe tha: "Vallahi, po ta dija se nuk do të pandehnit se po frikësohem nga vdekja, do të falesha më gjatë!" Në këtë mënyrë, Hubejb b. Adiu u bë personi që filloi zakonin për çdo musliman për të falur dy rekate namaz para ekzekutimit.

Pastaj atë e ngritën në një dërrasë. Kur e lidhën, ai tha: "O Zoti im, unë e përcolla shpalljen e të Dërguarit Tënd, ndaj informoje atë nesër se çfarë është bërë me ne!" Pastaj tha: "O Zoti im, pakësoji në numër dhe mbyti me fuqinë Tënde, që askush prej tyre të mos mbetet!" Pastaj ata e ekzekutuan, Allahu e mëshiroftë!

Muavije b. Ebi Sufjani ka thënë: "Unë kam qenë atë ditë në mesin e të pranishmëve së bashku me Ebu Sufjanin! Ai më gjuajti për tokë nga frika e kësaj duaje të Hubejb it. Njerëzit thoshin: "Kur për një njeri kërkohet dënimi i Allahut dhe ai shtrihet në tokë, atëherë ai largohet prej tij!"

Më vonë, Omer b. Hattabi r.a. e emëroi Seid b. Amir b. Hidhjem Xhamahiun si administrator në disa pjesë të Shamit. Atij i ndodhte që papritmas i binte të fikët para njerëzve. Edhe Omer b. Hattabit i thanë se ai ishte i sëmurë. Kur njëherë e vizitoi atë, Omeri e pyeti: "O Seid, çfarë është ajo që po të godet?" Seidi i tha: "O udhëheqës i besimtarëve, unë nuk jam fare i sëmurë. Unë kam qenë i pranishëm kur u ekzekutua Hubejb b. Adiu dhe e kam dëgjuar lutjen që i bëri Allahut. Prej atëherë e deri më sot, në cilindo tubim që më bie ndër mend, mua më bie të fikët!" Kjo te Omeri pati rëndësi të madhe.

Ibni Abbasi ka thënë:

"Kur u godit grupi në të cilin ishte Merthedi dhe Asimi në Rexhi', disa hipokritë thanë: "Mjerë ata që u mashtruan, si u shkatërruan, as nuk mbetën në familjet e tyre, e as nuk e përcollën shpalljen e njeriut të tyre!" Në lidhje me këtë, Allahu i Madhërisëm zbriti shpallje për hipokritët:

*"Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (pse në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat)", d.m.th. e shfaqin besimin e tyre vetëm me gjuhë, "kurse për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmuës", d.m.th. kjo është në kundërshtim me atë që thonë me gjuhë, "e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë", d.m.th. polemizojnë më së shumti kur flasin me ty dhe kur të drejtohen ty.*

*"E posa të kthehet", d.m.th. kur të largohet prej teje, "ai në tokë vepron të bëjë shkatërrim në te, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do*

çrregullimin (fesadin).” D.m.th. nuk e dëshiron veprimin e tij dhe nuk është i kënaqur me të.

*“Dhe kur i thuhet atij: “Ki frikë Allahun!”, atë e kap euforia për punë mëkati. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (xhehenemi). Ka nga njerëzit, që për hir të Allahut e flijojnë vetveten, e edhe Allahu është shumë i mëshirshëm për robërit e Vet.” (El-Bekare, 204-207)*

D.m.th. ata e kanë blerë veten e tyre prej Allahut me luftë në rrugën e Tij dhe me veprim sipas dispozitave të Tij, derisa në këtë kauzë kanë humbur jetën e tyre. Këta janë grupi i lartpërmendur.

Në mesin e vargjeve në lidhje me këtë ngjarje janë edhe ato që ka shprehur edhe vetë Hubejb b. Adiu, kur ka dëgjuar se Kurejshët kishin vendosur që ta kryqëzonin:

*Ata u tubuan të gjithë përreth meje,  
i tubuan edhe fiset e tyre,  
pra, ata të gjithë u mblodhën.  
Secili prej tyre shprehte armiqësi dhe angazhohej  
kundër meje, e unë i lidhur me pranga,  
i hedhur në gijotinë.  
Ata i tubuan bijtë e tyre, por edhe gratë,  
dhe mua më afruan te një tra i gjatë,  
dhe ashtu i përforcuar.  
Allahut i ankoem për vetminë time, pastaj edhe për mjerimin,  
dhe për gjithçka që ata  
më kanë përgatitur mua me rastin e rrëzimit.  
O Zoti i Arshit, më bëj të durueshëm, për atë çfarë janë  
duke përgatitur për mua, ma kanë këputur mishin,  
dhe nga ushqimi më kanë privuar.  
Dhe e gjithë kjo, në emër të Qenies Hyjnore!  
Por Ai nëse do, ka për t'i bekuar  
pjesët e trupit tim të shqyer.  
Më kërkuan nga unë që të zgjedh;  
vdekjen ose mosbesimin!  
Sytë e mi lotuan, por jo nga frika as nga pikëllimi!  
Nuk kam frikë nga vdekja, sepse gjithqysh unë i vdekur jam,  
Por unë frikësohem nga zjarri i madh,  
që nga çdo anë është ndezur flakë.  
Unë nuk kam frikë, pasha Allahun!  
nëse vdes si musliman, se në cilën anë rrëzohem,*

*sepse rënia ime Atij i dedikohet!*

*Para armikut nuk do të tregoj frikë*

*as nënshtrim, sepse, me të vërtetë,*

*vetëm Allahut, unë përsëri do t'i kthehem!*

Hassan b. Thabiti duke vajtuar për Hubejbin ka thënë:

*Çfarë ka syri yt që nuk derdh lot me shumicë mbi gjoks,*

*ashtu si margaritarë të shqetësuar,*

*për Hubejbin, djaloshin trim mbi trima?!*

*Kur e panë se në takim me vdekjen nuk është i dobët as i nxituar.*

*Shko, Hubejb, Allahu të shpërbleftë me të mira,*

*dhe me xhenetin e përjetshëm, me hyri i shoqëruar!*

*Çfarë do të thoni në pyetjen e Pejgamberit,*

*dhe kur engjëjt e mirë në horizont do të shfaqen:*

*Pse e vratë dëshmorin e Allahut,*

*për shkak të një njeriu keqbërës,*

*i cili ka shkaktuar rrëmuje,*

*me shumicë dhe gjithandej!*

## NGJARJA TE PUSI MAUNE

(Safer, viti 4 h.)

Pejgamberi a.s. e kaloi në Medinë pjesën e mbetur të muajit shevval, pastaj muajin dhul-kade, dhul-hixhxe- sepse atë vit haxhin e kryen idhujtarët- dhe muharrem. Në muajin safer, në fillim të muajit të katërt nga Beteja e Uhudit, Pejgamberi a.s. i dërgoi njerëzit e tij deri te pusi i quajtur Maune.

Në Medinë te Pejgamberi a.s. kishte ardhur Ebu Bera' Amir b. Malik b. Xhafer me nofkën 'mulaibul-esinneh' (luftëtar i shkathët me shtizë) nga Nexhdi. Pejgamberi a.s. e kishte thirrur që ta pranonte Islamin, kurse ai as nuk e kishte pranuar as nuk e kishte mohuar, por kishte thënë: "O Muhamed, dërgo shokët e tu te populli i Nexhdit që t'ua shpjegojnë Islamin, besoj se do ta pranojnë atë."

Pejgamberi a.s. tha: *"Kam frikë për ta. Banorët e Nexhdit mund t'u bëjnë ndonjë të keqe."*

Ebu Bera' u përgjigj: "Unë do t'i mbroj ata. Dërgo ata, le t'i thërrasin njerëzit në Islam!"

Dhe Pejgamberi a.s. e dërgoi Mundhir b. Amrin nga fisi Beni Sa'd, i a.q. 'el-munik li jemute' (ai që ngutet në vdekje) bashkë me dyzet njerëz të zgjedhur nga shokët e tij. Në mesin e tyre ishte Harith b. Simme, Haram b. Milhan, Urve b. Esmā, Nafi' b. Bedil b. Verka' dhe Amir ibn Fuhejre, robi i liruar i Ebu Bekër Siddikut. Këta ishin njerëzit më të mirë të muslimanëve, të cilët shkuan deri te një pus me emrin Maun, që gjendej në territorin ndërmjet fisit Benu Amir dhe shkëmboret së Benu Sulejmit. Të dy këto vende janë në afërsi të pusit, edhe pse shkëmborja e Benu Sulejmit është pak më afër.

Pasi arritën në atë vend, e dërguan Haram b. Milhanin me një letër nga Pejgamberi a.s. për armikun e Allahut, Amir b. Tufejlin. Mirëpo, sapo erdhi ky, ai u vërsul mbi të dhe e vrau pa shikuar fare letrën. Pastaj kundër tyre për ndihmë thirri edhe fisin Benu Amir, por ata nuk iu përgjigjën atij.

Ata thanë: "Ne kurrë nuk do ta shkelim marrëveshjen e Ebu Beras! Ai me ta ka bërë marrëveshje dhe u ka premtuar mikpritje!" Ai pastaj ftoi për ndihmë fiset e Sulejmit dhe ata iu përgjigjën pozitivisht. Kështu që dolën me numër të madh dhe i rrethuan derisa ata ende ishin hipur në kafshët e tyre. Kur i panë duke u afruar, i nxorën shpatat dhe filluan të luftojnë. Të gjithë vdiqën përveç Ka'b b. Zejdit, Allahu i mëshiroftë! Atë e lanë sepse ishte duke dhënë shpirt. Ashtu u mor bashkë me të vdekurit. Megjithatë, ai mbijetoi dhe më vonë ra shehid në Betejën e Hendekut. Allahu e mëshiroftë.

Këtë grup e kishte zbuluar Amër b. Umejje Damriu dhe një ensarij nga fisi Benu Amër b. Avf<sup>114</sup>. Atyre u kishin tërhequr vëmendjen shpendët që fluturonin mbi ushtarët e vrarë. Ata të dy thanë: “Vallahi, atje ka diçka!” Dhe shkuan në atë drejtim për të parë. Aty i gjetën ata të shtrirë në pellg gjaku, pranë tyre ende qëndronin kuajt me të cilët kishin sulmuar mbi ta. Ensariu i tha Amër b. Ummejes: “Çfarë po mendon?” Ai tha: “Unë mendoj se duhet të shkojmë te Pejgamberi a.s. dhe ta informojmë për këtë.” Ensariu tha: “Unë, për vete, nuk do të largohem nga vendi ku u vra Mundhir b. Amri. Nuk dua që të tjerët të më flasin për të.” Pastaj u sul mbi vrasësit e tyre dhe kështu edhe ai vdiq.

Amër b. Umejje u kap rob, mirëpo kur u tha se është nga fisi Mudar, Amir b. Tufejli e la të shkojë. Ia qethi pjesën e përparme të flokëve dhe e liroi në emër të një borxhi të pretenduar të nënës së tij.

Amri pastaj u nis të kthehej dhe kur u gjend në Karkare<sup>115</sup>, në fillim të luginës, iu afruan dy njerëz nga fisi Benu Amir dhe u strehuan nën hijen ku ai qëndronte. Mes këtij fisi dhe Pejgamberit a.s. kishte marrëveshje dhe mbaheshin kontakte, por këtë nuk e dinte Amër b. Umejje. Kur ata iu afruan, ai i pyeti: “Prej nga jeni ju të dy?” Ata iu përgjigjën: “Ne jemi nga fisi Benu Amir.” Ai i lejoi aty derisa ranë në gjumë, por pastaj i sulmoi dhe i vrau që të dy. Ai konsideroi se kështu ishte hakmarrë ndaj Benu Amirit për atë që ata kishin vepruar me njerëzit e Pejgamberit a.s..

Kur Amir b. Umejje erdhi tek Pejgamberi a.s. dhe e informoi për këtë, Pejgamberi a.s. tha: *“Ke vrarë dy vetë të cilët duhet t’i dëmshpërblejmë!”* Dhe pastaj shtoi: *“Kjo është vepër e Ebu Beras! Për këtë arsye unë nuk doja dhe frikësohesha për pasojat!”*

Kur e dëgjoi Ebu Bera', shprehu keqardhje të madhe që Benu Amiri e kishin shkelur fjalën e dhënë dhe që për këtë kishin vdekur kaq shumë njerëz të Pejgamberit a.s..

Ndër të vdekurit ishte edhe Amir b. Fuhejre.

Transmetohet nga Hisham b. Urve, ai nga babai i tij, se Amir b. Tufejli kishte pyetur: “Cili është njëri prej tyre që, kur u vra, e pushë lart, mes qiellit dhe tokës, dhe pastaj edhe mbi qiell?” Ata i thanë: “Ai ka qenë Amir b. Fuhejre!”

<sup>114</sup> Ai ishte Mundhir b. Muhammed b. Ukbe.

<sup>115</sup> Karkare, një vend larg Medinës për tetë stacione postare.

## DËBIMI I BENI NADIRIT

(viti i 4 h.)

Pejgamberi a.s. shkoi te fisi Benu Nadir për të kërkuar ndihmë për dëmshpërblimin e dy personave të vrarë të fisit Beni Amir, të cilët i vrau Amër b. Umejje Damriu, sipas marrëveshjes që kishte Pejgamberi a.s. për marrëdhënie të mira fqinjësore. Në fakt, edhe në mes Beni Nadirit dhe Beni Amirit ka ekzistuar një marrëveshje dhe aleancë.

Kur Pejgamberi a.s. shkoi tek ata dhe kërkoi ndihmë për dëmshpërblimin e gjakut të dy të vrarëve, ata thanë: "Po, o Ebul-Kasim, ne do të të ndihmojmë për ndihmën që po kërkon nga ne."

Pastaj biseduan mes vete duke thënë: "Ju nuk mund ta gjeni këtë njeri në gjendje më të mirë se kjo. -Pejgamberi a.s. ishte ulur pranë murit të shtëpisë së tyre.- Kush prej nesh do ta marrë këtë shkëmb, të hipë në mur e ta hedhë mbi kokën e tij, që ta heqim qafe?"

Në atë çast menjëherë u paraqit Amër b. Xhiihash b. Ka'bi dhe tha: "Unë do ta bëj këtë!" Dhe shkoi për të hipur lart siç tha. Pejgamberi a.s. ishte me një grup të shokëve të tij, mes të cilëve ishin Ebu Bekri, Omeri dhe Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Në atë çast Xhibrili besnik e informoi Pejgamberin a.s. për qëllimin e tyre, ndaj ai u ngrit shpejt dhe vajti në Medinë. Shokët e tij së pari e ngadalësuan, por pastaj edhe vetë shkuan për ta kërkuar. Gjatë rrugës ata takuan një njeri që po vinte nga drejtimi i Medinës dhe kur e pyetën për Pejgamberin, ai u tha: "Po, unë e pashë atë duke hyrë në qytet." As'habët u nisën me të shpejtë dhe kur erdhën tek ai, e pyetën: "Ti u ngrite e shkove e ne as që të vërejtëm." Pejgamberi a.s. u tregoi mbi lajmin që kishte marrë për tradhtinë që kishin përgatitur hebrenjtë.

Prandaj, Pejgamberi a.s. menjëherë urdhëroi përgatitjen për luftë dhe marshimin drejt tyre. Njerëzit u ngritën dhe së shpejti arritën tek hebrenjtë. Ndërkohë ata ishin fortifikuar, kështu që Pejgamberi a.s. urdhëroi që të priten palmat dhe t'u vihet zjarri fortesave të tyre. Ata filluan të thërrasin: "O Muhamed! Ti më parë pate ndaluar të bëhen çrregullime dhe i pate qortuar ata që e bënin këtë! Çfarë është kjo që po bën duke i prerë palmat dhe duke i djegur ato?!"

Një grup njerëzish nga fisi i Benu Avf b. Hazrexh, ndër të cilët ishin Abdullah b. Ubejj b. Selul, Vedia, Malik b. Ebi Kukal, Suvejdi dhe Da'isi, i dërguan Beni Nadirit një përfaqësues dhe i porositën: "Duronit dhe rezistonit sepse ne nuk ju lëmë vetëm. Nëse ju sulmojnë, edhe ne do të luftojmë me ju, e në qoftë se ju përzënë, edhe ne do të dalim me ju!"

Hebrenjtë në çdo moment e pritnin ndihmën e tyre, por ajo nuk u erdhi. Pastaj Allahu në zemrat e tyre vendosi frikë, kështu që më në fund ata kërkuan nga Pejgamberi a.s. që t'i dëbojë, por mos ta derdhë gjakun e tyre. Ata ofruan që nga pasuria të marrin vetëm aq sa mund të bartin devetë e tyre, duke përfshirë edhe të gjitha pajisjet luftarake që kishin, që Pejgamberi a.s. e pranoi.

Kështu ata morën të gjitha gjërat që mundën t'ua ngarkonin deveve. Disa prej tyre madje e thyen pragun mbi derë të shtëpisë, e vendosën mbi deve dhe shkuan. Pjesa më e madhe e tyre shkuan në Hajber, ndërsa të tjerët vazhduan për Sham. Nga paria e tyre që kishin shkuar për Hajber ishin Sel-lam b. Ebi Hukajk, Kinane b. Rebi' b. Ebi Hukajk dhe Hujejj b. Ahtab. Sapo mbërritën atje, banorët lokalë u afruan me ta.

Më ka thënë Abdullah b. Ebi Bekër se si flitej që ata në deve kishin vendosur, përveç pasurisë, edhe gratë dhe fëmijët, të cilët mbanin dajre dhe fyej, ndërsa prapa tyre shkonin këngëtarët dhe këndonin këngë. Në mesin e tyre ishte edhe Ummu Amër, e cila kishte qenë në posedim të Urve b. Verd Absiut, por e kishin blerë prej tij<sup>116</sup>.

Ata shkuan me aq shkëlqim e krenari sa që nuk ishte parë deri atëherë!

Pasuritë e mbetura ia lanë Pejgamberit a.s.. Ato i takonin vetëm atij dhe ai kishte të drejtë të bënte me to si të donte, kështu që ai ua ndau vetëm muhaxhirëve të parë. Ensarët nuk morën pjesë, përveç Sehl b. Hunejfit dhe Ebu Duxhane Simak b. Hareshe, të cilët përmendën varfërinë e tyre, ndaj Pejgamberi a.s. u dha edhe atyre.

Në lidhje me Beni Nadirin ka zbritur e tërë surja El-Hashr, e cila flet për dënimin me të cilin i ka dënuar Allahu, pastaj se si ua ka imponuar Pejgamberin dhe çfarë ka bërë ai me ta. Allahu i Madhërishtëm thotë:

*"Ai është që në dëbimin e parë i nxori prej shtëpive të tyre ata nga ithtarët e librit, të cilët nuk besuan. Ju nuk menduat se fortesat e tyre do t'i mbronin prej ndëshkimit të Allahut, po Allahu u erdhi atyre nga nuk e kishin menduar dhe në zemrat e tyre hodhi frikën ashtu që me duart e veta dhe me duart e besimtarëve të rrëzonin shtëpitë e veta", d.m.th. i rrënonin dyert e shtëpive të tyre, i hiqnin pragjet mbi dyer dhe i ngarkonin në deve.*

<sup>116</sup> Ajo quhej Selma dhe ishte e martuar në Mezjene. Ata i kishte sulmuar Urve b. Verd, duke e robëruar Selmën. Ai shpesh shkonte te Beni Nadiri dhe sa herë që i nevojitej diçka, merrte hua te hebrenjtë, gjithashtu atyre ua shiste mallin që grabiste. Kështu ata patën mundësi ta shohin dhe të mahnitën me bukurinë e saj. Ata kishin kërkuar që t'ua shiste, por ai kishte refuzuar. Mirëpo, ata e kishin mashtruar duke e dehur me alkool. Atëherë e kishin blerë dhe për të kishin edhe dëshmitarë. Urve këtë ngjarje e shpreh me vargje:

Më dehën me verë, armiqtë e Allahut,  
e pastaj më rrethuan, me shpifje e gënjeshtër.  
O ju njerëz! Po si bindet shpirti im,  
për diçka që ma urren ndërgjegjja!?

*“Pra merrni përvojë o ju të zotët e mendjes. Sikur Allahu të mos u kishte caktuar atyre shpërnguljen”, që ishte shprehje e zemërimit të Allahut. “Ata do t’i ndëshkonte në këtë jetë”, d.m.th. me shpata. “Kurse në jetën tjetër ata e kanë dënimin e zjarrit.” Përveç kësaj që i ka goditur...*

*“Ju nuk këputët asnjë nga hurmat e buta (fidanët) ose atë e keni lënë të ngritur në rrënjët e tyre, vetëm se me lejen e Allahut”, pra, janë prerë me urdhër të Allahut, kështu që prerja e tyre nuk mund të konsiderohet si keqbërje, por në fakt ishte shprehje e zemërimit të Allahut.*

*“Për t’i shtypur kundërshtarët. E atë (pasuri) që prej tyre Allahu ia ktheu të Dërguarit të Vet”, d.m.th. nga Beni Nadiri. “Ju për të nuk i keni ngarë as kuajt, as devetë, por Allahu i bën mbizotëruesit të Dërguarit e Vet kundër kujt të dojë, Allahu ka fuqi mbi çdo send.*

*Atë që Allahu nga banorët e vendeve (jobesimtare) ia dha pa luftë të Dërguarit të Vet, ajo i takon Allahut, të Dërguarit”, d.m.th. krejt ajo që muslimanët e fitojnë me luftë, duke nxituar me kuaj e me deve, ajo i takon Allahut dhe të Dërguarit të Tij, pastaj edhe “të afërmve, jetimëve, të varfërve, kurbetçinjve. (Kështu veprohet) Që ajo të mos ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj. Çka t’ju japë Pejgamberi, atë merreni e çka t’ju ndalojë, përmbajuni...!” (El-Hashr, 2-7)*

*Kjo është ndarja e dytë mes muslimanëve e asaj që është fituar me luftë, ashtu siç e ka përcaktuar Allahu i Madhërishëm.*

*Pastaj Allahu i Madhërishëm thotë:*

*“A nuk e ke ditur se ata që u bënë hipokritë”, d.m.th. Abdullah b. Ubejj, shokët e tij dhe të gjithë të ngjashmit me ta, “u thoshin vëllezërve të vet nga ithtarët e librit që nuk kishin besuar”, d.m.th. pjesëtarëve të fisit Beni Nadir, “Nëse ju dëboheni, edhe ne do të dalim me ju, për çështjen tuaj, ne kurrë nuk do t’i bindemi askujt (t’ju luftojmë ose t’ju nënshtrojmë), e nëse luftoheni prej dikujt, ne gjithqysh do t’u ndihmojmë. Allahu dëshmon se ata janë rrenacakë!*

*Sikur të dëbohen ata (ithtarët e librit), nuk do të dilnin me ta edhe sikur të luftoheshin, nuk do t’u ndihmojnë atyre, po edhe sikur t’u ndihmonin atyre, ata do të iknin prapa, e ata do të mbesin pa ndihmën e tyre.*

*Ju (besimtarët) në zemrat e tyre (ta munafikëve) jeni frikë më e fortë se Allahu (frika nga Allahu). Kjo për shkak se ata janë popull që nuk kuptojnë.*

*Ata të gjithë së bashku nuk kanë guxim t’ju luftojnë, vetëm kur gjenden në ndonjë vend të fortifikuar ose kur janë pas ndonjë muri. Armiqësia ndërmjet tyre është e ashpër. Mund të mendohet për ta se janë të bashkuar, e në realitet zemrat e tyre janë të përçara, sepse janë njerëz që nuk logjikojnë.*

*Si shembull i atyre jo fort moti që përjetuan të keqen e punës së vet, edhe ata kanë një dënim të rëndë.” Këtu mendohet për fisin Benu Kajnuka.*

*Ata (hipokritët) janë shembull si djalli, kur i thotë njeriut: “Refuzo besimin!”, e kur ai të ketë refuzuar, ai (djalli) tërhiqet prej teje; unë i frikohem Allahut, Zotit të gjithësisë!”*

*Dhe ashtu, ata të dy do të përfundojnë në zjarr përgjithmonë. Ai është ndëshkim i zullumqarëve.” (El-Hashr, 11-17)*

### **Ekspedita në Dhatut- Rika (viti i 4 h.)**

Pas marshimit të Beni Nadirit, Pejgamberi a.s. qëndroi në Medinë tërë muajin rebiul-ahir dhe një pjesë të muajit xhumada. Pastaj me ushtrinë u nis në drejtim të Nexhdit, ku kishte për synim fiset Benu Muharib dhe Benu Thalebe - dy degët e fisit Gatafan. Gjatë kësaj kohe administrimin e Medinës ia besoi Ebu Dherr Giffariut, ndërsa ai me ushtrinë zbriti në Nahl<sup>117</sup>. Kjo është ekspedita Dhatut-Rika<sup>118</sup>. Pejgamberi a.s. aty hasi një ushtri shumë të madhe të fisit Gatafan. Të dyja ushtritë iu afruan njëra-tjetrës, por nuk pati përballje. Palët ia kishin frikën aq shumë njëra-tjetrës, saqë Pejgamberi a.s. me njerëzit e tij falën namazin e frikës. Pastaj me njerëzit e tij u kthye.

Transmetohet se Xhabir b. Abdullahu ka thënë:

*“Shkova me të Dërguarin e Allahut a.s. në ekspeditën Dhatut-Rika në Nahl, hipur mbi devenë time të dobët. Pejgamberi a.s. i përcolli të gjithë njerëzit, të cilët ecnin përpara, por unë fillova të ngecja prapa, ndaj më arriti Pejgamberi a.s., i cili më pyeti: “Çfarë është me ty, o Xhabir?”*

*Unë u përgjigja: “Kjo deveja ime po më ngadalëson, o i Dërguari i Allahut!”*

*Ai më tha: “Le të bjerë në gjuhë!” Deveja ime ra në gjuhë, ndërsa Pejgamberi a.s. zbriti nga deveja e tij dhe më tha: “Më jep atë shkop, ose më thyej një shkop nga druri!” Unë ia dhashë shkopin.*

*Ai e mori shkopin dhe me të e goditi disa herë, pastaj më tha: “Hip!”*

*Unë i hipa dhe ajo u nis. Pasha Atë që e ka dërguar me të vërtetën, pas këtij momenti madje deveja e tij e pengonte devenë time gjatë ecjes!”*

*Unë gjatë rrugës bisedova me Pejgamberin a.s., kur në një moment më pyeti:*

*“O Xhabir, a ma shet mua këtë devenë tënde?”*

*Unë iu përgjigja: “Jo, por unë po ta dhuroj ty atë.”*

*Ai më tha: “Unë nuk dua ashtu, por ti ma shit mua!”*

*Unë e pyeta: “Sa po më jep për të, o i Dërguari i Allahut?”*

*Ai u përgjigj: “Unë po ta blej atë për një dërhem!”*

*Unë i thashë: “Pak është, o i Dërguari i Allahut!”*

<sup>117</sup> Nahl, vend në Nexhd, në territorin e fisit Gatafan.

<sup>118</sup> Dhatut-Rika është quajtur kështu (dhatut-rika – ‘me arna’) sepse ata në këtë vend i arnonin flamujt e tyre. Disa pohojnë se kjo ekspeditë është quajtur me këtë emër sipas një druri që ishte në atë vend dhe e kishte këtë emër. Megjithatë, ekziston edhe një mendim i cili thotë se aty gurët ua patën rrafshuar shputat e këmbëve dhe ata i kishin lidhur me arna.

*Ai më tha: "Atëherë, për dy dërhëmë!*

*Unë përsëri nuk pranova as për dy dërhëmë.*

*Kështu ai e rriti çmimin derisa arriti në një okë.*

*Unë e pyeta: "A jeni dakord me këtë çmim, o i Dërguari i Allahut?"*

*Ai u përgjigj: "Po, jam dakord!"*

*I thashë: "Atëherë ta shita!"*

*Kurse ai tha: "Atëherë unë e bleva!"*

*Pastaj më pyeti: "O Xhabir, a je i martuar?"*

*I thashë: "Po, o i Dërguari i Allahut."*

*Ai përsëri më pyeti: "A me grua të martuar më parë apo me vajzë?"*

*Unë u përgjigja: "Ishte e martuar më parë."*

*Pastaj më pyeti: "Po përse nuk je martuar me një vajzë të re, kështu që ta intrigoni njëri-tjetrin?"*

*Unë u përgjigja: "O i Dërguari i Allahut, babai im u vra në betejën e Uhudit dhe la pas vetes shtatë vajza, për këtë arsye unë u martova me një grua të pjekur, e cila mund t'i mbledhë rreth vetes shtatë vajza dhe të kujdeset për to."*

*Ai më tha: "Ke bërë mirë, në dashtë Allahu! Kur të arrijmë në Sirar<sup>119</sup>, do të urdhërojmë të na therin ndonjë kafshë dhe aty do ta kalojmë atë ditë. Ajo do të dëgjojë për ne dhe aty do t'ua shkund pluhurin jastëkëve të saj!"*

*Unë reagoval: "Vallahi, o i Dërguari i Allahut, ne nuk kemi jastëkë!"*

*Ai u përgjigj: "Do të ketë, kur të arrish atje, bëj diçka të bukur!"*

*Kur arritëm në Sirar, Pejgamberi a.s. me të vërtetë urdhëroi që të theren disa kafshë dhe aty kemi kaluar gjithë ditën. Kur erdhi mbrëmja, Pejgamberi a.s. hyri në shtëpi, e pastaj hymë edhe ne. Unë gruas sime ia shpjegoval gjithë bisedën dhe çfarë më tha mua Pejgamberi a.s..*

*Ajo më tha: "Ja pra, të dëgjoj dhe të bindem!"*

*Në mëngjes, e mora devenë time dhe kur shkova para derës së xhamisë së Pejgamberit a.s., e detyroval të bjerë në gjunjë. Pastaj në xhami u ula afër tij. Kur doli nga xhamia dhe e pa devenë, Pejgamberi a.s. pyeti: "Çfarë është kjo?" Ata u përgjigjën: "O i Dërguari i Allahut, këtë deve e pruri Xhabiri."*

*Ai pyeti: "Po ku është ai tani?" Kur më ftuan për tek ai, më tha: "O djalë i vëllait, merre atë deve sepse ajo është e jotja!" Pastaj e thirri Bilalin dhe i tha: "Shko me Xhabirin dhe jepja një okë!"*

*Unë shkova me të dhe ai më dha një okë dhe shtoi pak më tepër. Vallahi, vazhdimisht ajo rritej dhe ndihej mirë në shtëpinë tonë, deri dje kur neve na ndodhi kjo që ndodhi (d.m.th. në Betejën e Harres)!"*

<sup>119</sup> Sirar, vend rreth tre milje afër Medinës.

Nga ai gjithashtu transmetohet se ka thënë:

*“Ne shkuam me Pejgamberin a.s. në ekspeditën Dhatut-Rika në Nahl, ku një nga njerëzit tanë plagosi një grua të një idhujtari. Kur Pejgamberi a.s. shkoi prej aty me karvanin e tij, erdhi burri i saj i cili ishte diku larg dhe kur mori vesh për këtë, u betua se nuk do të kalojë pa kryer gjakderdhje në mesin e njerëzve të Muhamedit! Dhe menjëherë u nis pas gjurmëve të Pejgamberit a.s..*

*Pejgamberi a.s. ndërkohë u ndal në një vend dhe tha: “Kush do të na mbrojë këtë natë?”*

*Menjëherë u paraqitën dy njerëz – njëri muhaxhir dhe tjetri ensar. Ata thanë: “Ne, o i Dërguari i Allahut.”*

*Pejgamberi a.s. tha: “Qëndroni atje në hyrje të grykës!”*

*Kur arritën ata të dy atje në hyrje të grykës, ensariu e pyeti muhaxhirin: “Cilën pjesë të natës do të ta lë: pjesën e parë apo të dytën?”*

*Ai tha: “Ma lë mua pjesën e parë.”*

*Pastaj muhaxhiri u shtri dhe fjeti, ndërsa ensariu u ngrit dhe filloi të falet.*

*Në atë moment erdhi ai njeriu. Kur e pa ensariun, kuptoi se ai ishte roje e tyre, kështu që e gjuajti me shigjetë dhe e qëlloi. Pastaj e tërhoqi dhe përsëri e goditi me të, mirëpo ai edhe më tutje qëndronte në këmbë. Pastaj e shpoi edhe të tretën herë dhe përsëri e tërhoqi dhe prapë e shpoi. Ky atëherë bëri ruku’, pastaj sexhde dhe pastaj e zgjoi shokun e tij dhe i tha: “Çohu, se unë mora fund!”*

*Ky u çua dhe kur ai njeri i pa se këta ishin dy, e kuptoi se është në një situatë të vështirë dhe iku.*

*Kur e pa ensariun ashtu të përgjakur, muhaxhiri bërtiti: “Subhanallah! Allahu na ruajt! Pse nuk më zgjove kur të goditi për herë të parë?!”*

*Ensariu u përgjigj: “Isha duke lexuar një sure (të Kur’anit) dhe nuk desha ta ndërprisja pa e përfunduar, por kur më goditi shumë herë, bëra ruku’ dhe ja të lajmërova! Vallahi, mos të kisha frikë për kufirin që më ka urdhëruar Pejgamberi a.s. për ta ruajtur, më parë do të më kishte dalë shpirti sesa do të kisha ndërprerë leximin e sures pa e përfunduar!”*

Ibni Is'haku thotë:

*“Pas kthimit nga ekspedita Dhatut-Rika, Pejgamberi a.s. në Medinë kaloi pjesën e mbetur të muajit xhumadel-ula, muajin xhumadel-ahire dhe rexheb.”*

## BETEJA E DYTË NË BEDËR (Shaban, viti i 4 h.)

Pejgamberi a.s. në muajin shaban shkoi në Bedër, ashtu siç ishte marrë vesh me Ebu Sufjanin.

Aty e priti Ebu Sufjanin plot tetë net. Ebu Sufjani me njerëzit e tij u nis nga Meka dhe arriti në Mexhenne<sup>120</sup> nga ana e Dhahranit, mirëpo filloi të hezitojë dhe mendoi që të kthehet. Ai iu drejtua njerëzve të vet: “O Kurejshë, juve ju leverdis vetëm viti pjellor në të cilin mund të kultivoni pemë dhe të pini qumësht. Ndërkaq, ky vit, është i thatë dhe shterpë, unë do të kthehesha, ndaj kthehuni edhe ju!”

Dhe njerëzit u kthyen. Mekasit i quajtën “Ushtria e Sevikut”.<sup>121</sup> Ata thanë: “Ju keni dalë vetëm për të pirë sevik!”

Pejgamberi a.s. priti në Bedër ardhjen e Ebu Sufjanit. Në atë kohë i kishte ardhur Mahshij b. Amër Damriu, me të cilin ai më herët në ekspeditën e Veddanit kishte bërë marrëveshje që me fisin Benu Damre të ruanin marrëdhëniet paqësore. Ai pyeti: “O Muhamed, a ke ardhur të takohesh me Kurejshët tek ky burim uji?”

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Po, o vëlla nga fisi Benu Damre! Mirëpo, në qoftë se ju dëshironi, ne mund ta tërheqim marrëveshjen që kemi mes nesh dhe t’ju godasim e pastaj çfarë të gjykojë Allahu mes nesh!”*

Ai tha: “Jo, vallahi, o Muhamed, ne nuk e kemi këtë nevojë!”

Pejgamberi a.s. vazhdoi të priste Ebu Sufjanin. Atypari kaloi Mabed b. Ebi Mabed Huzaiu dhe duke e parë Pejgamberin a.s. dhe devenë që nxitonte, ia kishte kushtuar dhe i kishte recituar disa vargje të rastit.

## Ekspedita Dumetul-Xhendul (rebiul-evvel, viti i 5 h.)

Pejgamberi a.s. u kthye në Medinë dhe aty kaloi muajin vijues deri në fund të dhul-hixhxes. Atë vit haxhin e kryen idhujtarët. Ky ishte viti i katërt i ardhjes së Pejgamberit a.s. në Medinë.

Me ushtrinë e tij Pejgamberi a.s. vazhdoi për në Dumetul-Xhendul<sup>122</sup>, por u kthye para se të arrinte atje pa pasur asnjë veprim luftarak. Pjesën tjetër të vitit e kaloi në Medinë.

<sup>120</sup> Për administrator në Medinë, Pejgamberi a.s. caktoi Abdullah b. Abdullah b. Ubejj b. Selul Ensariun.

<sup>121</sup> Sevik ishte një lloj ushqimi.

## BETEJA NË HENDEK (Shevval, viti i 5 h.)

Beteja në Hendek u zhvillua në muajin shevval, viti i pestë pas hixhretit.

Ngjarja e Hendekut ndodhi pasi një grup hebrenjsh, në mesin e të cilëve ishin edhe Sel-lam b. Ebil-Hukajk Nadariu, pastaj Hujejj b. Ahtab Nadariu, Kinane b. Ebil-Hukajk Nadariu, Hevdhe b. Kajs Vailiu dhe Ebu Ammar Vailiu, me një grup njerëzish nga Beni Nadiri dhe një grup nga Beni Vaili, të cilët patën organizuar fushatën kundër Pejgamberit a.s., shkuan te Kurejshët në Mekë për t'i ftuar në luftë kundër Pejgamberit a.s.. Ata thanë: "Ne do të jemi me ju, derisa ta shkatërrojmë atë!"

Kurejshët iu përgjigjën atyre: "O hebrenj! Ju jeni pasuesit e librit të parë dhe ju e dini mirë se për çfarë ne nuk pajtohemi me Muhamedin. Na thoni, a është feja jonë më e mirë apo feja e Muhamedit?"

Hebrenjtë u përgjigjën: "Feja juaj është më e mirë se feja e tij dhe për këtë arsye ju keni më shumë të drejtë se ai!"

Rreth këtij grupi hebrenjsh Allahu i Madhërishtëm shpalli këto ajete:

*"A nuk u vure re atyre që iu është dhënë pjesë nga libri? Besojnë idhuj e djallëzi dhe për ata që nuk besuan thonë: "Këta janë në rrugë më të drejtë, se ata që besuan!" Ata janë që Allahu i mallkoi, e atë që e mallkon Allahu, për të nuk ka ndihmëtarë. A mos kanë ata ndonjë pjesë të pushtetit? Ata nuk do t'u jepnin njerëzve as sa grimca. A u kanë zili atyre njerëzve për atë që Allahu u dha nga mirësitë e Tij?", d.m.th. pejgamberllëkun. "Ne u patëm dhënë pasardhësve të Ibrahimit librin e shariatit dhe u patëm dhënë atyre pushtet të madh. Po disa prej tyre i besuan atij (Muhamedit), e disa e refuzuan. Për ta mjafton zjarri i xhehenemit." (En-Nisa, 51-55)*

Kur ua thanë këtë Kurejshëve, ata mbetën të kënaqur dhe menjëherë filluan të angazhohen rreth propozimit të tyre për luftë kundër Pejgamberit a.s..

Grupi i lartpërmendur i hebrenjve pastaj u nis për tek fisi Gatafan, të cilët gjithashtu i ftuan për luftë kundër Pejgamberit a.s.. Atyre u thanë se do të qëndrojnë në anën e tyre kundër tij dhe se për këtë çështje kanë marrë edhe pëlqimin e Kurejshëve. Kështu e bënë për vete edhe fisin Gatafan.

Menjëherë pas kësaj Kurejshët u nisën në luftë nën udhëheqjen e Ebu Sufjan b. Harbit. U nis edhe fisi Gatafan; në krye të Beni Fezares ishte Ujejne b. Husn, në

<sup>122</sup> Dumetul-Xhendul është një rrugë komunikacioni për Medinë, 15 net bujtje larg nga Medina. Me atë rast për administrator të Medinës Pejgamberi a.s. kishte caktuar Suba b. Urfeten.

krye të Beni Murren ishte Harith b. Avf b. Ebi Harithe, dhe një grupi të njerëzve nga fisi Eshxha' u printe Musar b. Ruhajle.

Sapo dëgjoi Pejgamberi a.s. rreth tyre dhe synimeve të tyre, menjëherë urdhëroi që të hapen hendeqe rreth Medinës. Në këtë punë mori pjesë edhe vetë Pejgamberi a.s. për t'u dhënë shtytje muslimanëve për shpërblim. Edhe muslimanët e tjerë punuan dhe morën pjesë në aksion. Nuk mori pjesë në aksion vetëm një pjesë e vogël hipokritësh, të cilët përmendën dobësinë dhe tinëzishit shkuan në shtëpitë e tyre pa dijeninë dhe lejen e Pejgamberit a.s.. Muslimanët e tjerë, kur kishin ndonjë nevojë të domosdoshme, shkonin te Pejgamberi a.s., e njoftonin dhe kërkonin leje, të cilën e merrnin rregullisht, dhe menjëherë pas kryerjes së punës ktheheshin me dëshirë dhe bindje për të fituar shpërblim. Rreth këtyre besimtarëve Allahu i Madhërishtëm ka shpallur:

*“Besimtarë janë ata që i besuan Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kur janë me të (të Dërguarin) për ndonjë çështje të përbashkët (të rëndësishme), nuk largohen pa i kërkuar leje atij. S’ka dyshim se ata që kërkojnë leje prej teje, ata i besojnë Allahut dhe të dërguarit të Tij. E kur të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, lejo kë duash, e kërkoj falje Allahut për ata, se vërtet, Allahu fal shumë dhe është mëshirues.”* (En-Nur, 62)

Ky ajet u referohet atyre muslimanëve që kujdeseshin për obligimet e tyre dhe dëshironin të bënin sa më shumë vepra të mira. Ata ishin të përlulur ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Pastaj Allahu i Plotfuqishëm, duke iu drejtuar hipokritëve që i shmangeshin punës dhe largoheshin nga puna pa lejen e Pejgamberit a.s., thotë:

*“Thirrjen e të Dërguarit mos e konsideroni si thirrjen tuaj ndaj njëri-tjetrit. Allahu i di ata që tërhiqen prej jush tinëzishit, prandaj, le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të Dërguarit) se ata do t’i zë ndonjë telashe, ose do t’i godasë dënimi i hidhët.*

*Vini re, se vetëm në pushtetin e Allahut është çka ka në qiej dhe në tokë. Ai e di gjendjen tuaj (besimin apo hipokrizinë), e ditën kur i kthehen Atij, Ai do t’u kallëzojë atyre për atë që vepruan. Allahu është i dijshtëm për çdo send.”* (En-Nur, 63-64)

Sapo përfundoi Pejgamberi a.s. gërmimin e hendeqeve përreth Medinës, mbërrijnë Kurejshët me dhjetë mijë njerëz nga fise të ndryshme, në mesin e të cilëve ishte një pjesë e Beni Kinanes dhe Tihames, dhe zbritën në komunitetin fisnor të Esjalit, ndërmjet Xhurufit dhe Zugabes.

Fisi Gatafan dhe njerëzit e Nexhdit që iu bashkuan atyre erdhën nga ana tjetër dhe zbritën në Dheneb Nakma nga drejtimi i Uhudit.

Pejgamberi a.s. u nis me tre mijë muslimanë. Ata u vendosën në atë mënyrë që mali Sel u mbetej pas shpine. Aty Pejgamberi a.s. vendosi edhe çadrën e tij, kështu që mes tij dhe armiqve të tij ishte vetëm hendeku. Ai urdhëroi që gratë dhe fëmijët të strehohen në fortesa.

Ndërkohë armiku i Allahut, Hujejj b. Ahtab Nadariu, shkoi te Ka'b b. Esed Kuradhiu, i cili në emër të fisit Benu Kurejdha bëri marrëveshje miqësie, ndër-kohë që kishte marrëdhënie paqësore edhe me Pejgamberin a.s. dhe popullin e tij. Kur dëgjoi Ka'bi për ardhjen e Hujejj b. Ahtabit, e mbylli derën e fortesës së tij dhe nuk iu përgjigj trokitjes së tij. Atëherë Hujejj bërtiti: "Vaj halli për ty, o Ka'b! Hape derën!" Ka'bi i përgjigjet: "Vaj halli për ty, o Hujejj, ti je njeri fatzi, ndërsa unë me Muhamedin kam marrëveshje dhe nuk dua që ta thyej. Nga ai gjithmonë kam pasur vetëm saktësi dhe ndershmëri!"

Hujejj këmbënguli: "Vaj halli për ty, hape derën të flasim!" Ka'bi tha: "Jo, nuk e bëj dot!"

Hujejj përsëri insistoi: "Vallahi, ti e ke mbyllur derën e fortesës vetëm për shkak se nuk do të qerasësh me xheshish!"<sup>123</sup> Ai ia hapi derën dhe Hujejj i tha: "Ç'është me ty, o Ka'b?! Unë të kam ardhur me lavdinë e përjetësisë dhe detin e trazuar! T'i kam sjellë Kurejshët me të gjithë parinë dhe fisnikët e tyre, të cilën kanë zbarkuar në Esjal të Rumes. T'i kam sjellë gjithashtu Gatafanët me parinë dhe fisnikët e tyre, të cilët kanë zbarkuar në Dheneb Nakma, pranë Uhudit. Ata më kanë premtuar dhe nënshkruar se nuk do të shkojnë derisa ta shkatërrojmë krejtësisht Muhamedin dhe ata që janë me të!"

Ka'bi i tha: "Më ke ardhur, për Zotin, me turpin e përjetësisë dhe me re pa shi, të cilat e kanë derdhur ujin e tyre, ato murmurojnë dhe vetëtojnë, por në to nuk ka gjë! Për hir të Zotit, o Hujejj! Më lejo mua kështu si jam sepse nga Muhamedi unë, gjithmonë kam pasur vetëm korrektësi dhe ndershmëri!"

Megjithatë, Ka'bi vazhdoi përpjekjet për ta bindur atë, kështu që më në fund i dha garanci dhe fjalën e nderit se në rast se kthehen Kurejshët dhe Gatafanët pa e shkatërruar Muhamedin, ai me të do të mbyllet në fortesën e tij dhe çfarëdo që t'i ndodhë njerit, do t'i ndodhë edhe tjetrit.

Kështu Ka'b b. Esedi e shkeli marrëveshjen e tij dhe hoqi dorë nga raportet miqësore me Pejgamberin a.s..

Kur arriti lajmi për këtë te Pejgamberi a.s. dhe te muslimanët, Pejgamberi a.s. e ftoi Sa'd b. Muadh b. Numanin, i cili atëherë ishte lider i fisit Evs, pastaj Sa'd b. Ubade b. Dulejmin, liderin e fisit Hazreth, e bashkë me ta edhe Abdullah b. Revahan dhe Huvvat b. Xhubejr dhe u tha atyre:

*"Shkoni dhe kontrolloni vërtetësinë e këtij informacioni, nëse është e saktë ajo çfarë dëgjuam për këta njerëz apo jo! Nëse është e vërtetë, më informoni mua në një mënyrë që do ta kuptoj vetëm unë, kështu që të mos dekurajohen njerëzit. Por në qoftë se konstatooni se ata po i përmbahen marrëveshjes që ekziston midis nesh, atëherë thojeni hapur!"*

<sup>123</sup> Xheshish është një ushqim i shijshëm që përgatitet nga gruri i bluar trashë.

Dhe këta shkuan atje, mirëpo gjendja ishte shumë më e keqe sesa informacioni që kishte arritur te Pejgamberi a.s.. Ata i pritën me fjalët: “Kush është i Dërguari i Allahut? Midis nesh dhe Muhamedit nuk ka asnjë kontratë apo marrëveshje!”

Sa'd b. Muadhi, që ishte gjaknxehtë, filloi me ta një grindje të ashpër dhe pati sharje të forta reciproke. Sa'd b. Ubade i tha: “Largoju sharjeve të tyre sepse ajo që është midis nesh është edhe më shumë se kaq!”

Pastaj ata u kthyen te Pejgamberi a.s. dhe pasi i dhanë selam, i thanë: “Adal dhe Karre!” duke aluduar me këtë për mashtrimin që kishin bërë këto dy fise ndaj Hubejbit dhe njerëzve të tij<sup>124</sup>.

Pejgamberi a.s. tha: “*Allahu ekber! (Allahu është më i madhi!) Gëzohuni, o muslimanë!*”

Sprova ishte shumë e madhe, ndërsa frika e ashpër. Armikun e kishin edhe nga ana e sipërme, edhe nga ana e poshtme. Besimtarët mendonin për çdo gjë. Te disa hipokritë hipokrizia ishte njaft e dukshme. Kështu Mu'attib b. Kushejr tha: “Muhamedi na ka premtuar se do të kemi thesaret e Kisras, perandorit persian, dhe të perandorit romak, kurse sot askush prej nesh nuk është i sigurt për të shkuar deri në tualet!” Ndërsa Evs b. Kajdhiu, para një grupi njerëzish nga fisi i tij tha: “O i Dërguari i Allahut, shtëpitë tona janë të pambrojtura nga armiku. Na lejo të dalim dhe të shkojmë atje, se ato janë jashtë qytetit!”

Një rrethim të tillë idhujtarët e mbajtën mbi njëzet net, gati një muaj, dhe në mes tyre nuk pati ndonjë konflikt të madh. Kishte vetëm gjuajtje sporadike me shigjeta dhe bllokadë.

Kur njerëzve iu bë gjendja e padurueshme, Pejgamberi a.s. i dërgoi një mesazh Ujejne b. Husnit dhe Harith b. Avf Murriut – të dy ishin komandantë të Gatafanit – se do t'u jepte 1/3 e frutave të Medinës me kusht që ata dhe njerëzit e tyre të tërhiqeshin nga lufta kundër Pejgamberit dhe sahabëve të tij. Për më tepër, u arrit edhe një lloj marrëveshje paqeje, për të cilën madje u shkrua edhe një dokument, megjithatë ai ende nuk ishte konfirmuar dhe nuk e kishte marrë formën finale. Ai ishte në fakt një draft që do shtrohej për diskutim. Duke synuar këtë, Pejgamberi a.s. e thirri Sa'd b. Muadhin dhe Sa'd b. Ubaden, të cilëve ua paraqiti dhe e kërkoi mendimin e tyre në lidhje me të.

Ata të dy i shtruan pyetjen: “O i Dërguari i Allahut, a po e dëshiron ti këtë dhe po do që edhe ne ta bëjmë apo të ka urdhëruar Allahu dhe ne duhet patjetër ta zbatojmë apo është diçka që dëshiron ta bësh për ne?!”

Pejgamberi a.s. tha: “*Është diçka që po dua ta bëj për ju. Pasha Allahun, unë po e bëj këtë vetëm për shkak se po shoh se të gjithë arabët janë ngritur kundër jush dhe nga të*

<sup>124</sup> Për këtë të shikohet: “Ngjarja në Rexhî’ në vitin e tretë h.”

*gjitha anët ju kanë shtrënguar. Po dua që sadopak t'jua lehtësoj dhe atyre t'ua topit tehun deri në një kohë."*

Sa'd b. Muadhi tha: "O i Dërguari i Allahut, ne me këta njerëz kemi qenë së bashku në idhujtari dhe në adhurimin e idhujve, kur ende nuk e adhuronim Allahun dhe nuk dinim asgjë rreth Tij, ata as atëherë nuk hanin asnjë hurmë, përveç ndoshta si musafir i dikujt apo përmes tregtisë. E pra, tani kur na ka nderuar Allahu me Islamin, kur na ka udhëzuar me të dhe na ka forcuar me ty, a t'ua japim atyre pasurinë tonë?! Vallahi, ne për këtë nuk kemi nevojë. Vallahi, nuk mund t'u japim përveç shpatës dhe le të gjykojë Allahu mes nesh!"

Pejgamberi a.s. tha: "E pra, le të jetë ashtu!"

Sa'd b. Muadhi pastaj e mori fletën e shkruar dhe i fshiu të gjitha shkrimet në të, pastaj tha: "Le të mundohen pak për ne!"

Kështu Pejgamberi a.s. dhe muslimanët edhe më tutje ngelën në të njëjtën gjendje, nga të gjitha anët të rrethuar nga armiku. Por ende nuk kishte luftime. Njëherë një grup kalorësish Kurejshë, mes të cilëve ishin Amër b. Abdu Vudd, Ikrime b. Ebi Xhehl dhe Hubejre b. Ebi Veheb (të dy nga fisi Mahzum), pastaj poeti Darrar b. Hattab, u përgatitën për sulm. Ata u hipën kuajve të tyre dhe kaluan pranë shtëpive të Benu Kinanes duke bërtitur: "O Beni Kinane, përgatituni për luftë! Sot do të shihni se kush janë kalorësit e vërtetë!"

Pastaj u kthyen, i nxituan kuajt e tyre kah Medina, por së shpejti u ndalën para hendekut. Kur e panë hendekun, thanë: "Vallahi, ky është një kurth që arabët nuk e kanë ditur më parë<sup>125</sup>!"

Pastaj ata u drejtuan në një vend të ngushtë në hendek, i goditën kuajt dhe kështu e kapërcyen. Pastaj duke qenë hipur në kuaj trokthi endeshin andej-këndej nëpër vendin e braktisur, ndërmjet hendekut dhe malit Sel'. Në ato momente doli Ali b. Ebi Talibi r.a. me disa muslimanë dhe ua zuri kalimin në hendek. Kalorësit u kthyen dhe u sulën në drejtim të tyre.

Amër b. Abdu Vudd kishte luftuar më parë në Betejën e Bedrit, mirëpo pasi atje ishte plagosur rëndë, nuk kishte qenë në Uhud. Për këtë betejë ai ishte veshur posaçërisht për t'u vënë re vendi i tij. Pasi e ndaloi kalin e tij, tha: "Kush po më del në dyluftim?"

Atij i doli Ali b. Ebi Talibi dhe i tha: "O Amër, a nuk i je zotuar Allahut, se nëse dikush nga Kurejshët të fton për njërën nga dy gjëra, njërën patjetër do ta pranosh?!"

Amri u përgjigj: "Po, jam zotuar!"

Aliu r.a. i tha: "Unë po të thërras për tek Allahu, tek i Dërguari i Tij dhe në Islam!"

<sup>125</sup> Ibni Hishami thotë: "Thuhet se këtë ide Pejgamberit a.s. ia kishte dhënë Selman Farisiu, nga Persia.

Ai u përgjigj: “Unë nuk kam nevojë për ta!”

Aliu r.a. i tha: “Atëherë po të ftoj për të luftuar!”

Amri e pyeti: “Përse o djali i vëllait? Vallahi, unë nuk dua të të vras ty!”

Aliu i tha atij: “Ndërsa unë, pasha Zotin, dua të të vras ty!”

Atëherë Amri u ndez, u hodh nga kali i tij, së pari e mbajti pak, pastaj e goditi në turi dhe u nis drejt Aliut. Kështu filloi dueli. Ata silleshin rreth njëri-tjetrit dhe më në fund Aliu e vrau Amrin.

Kuajt filluan të ikin dhe duke vrapuar e kapërcyen hendekun duke ikur prapa.

Atëherë, Ikrima b. Ebi Xhehli, i dekurajuar nga humbja e Amrit, i hodhi shtizat e tij. Në lidhje me këtë poeti Hassan b. Thabiti ka recituar vargjet vijuese:

*Ike dhe shtizat e tij na i hodhi neve*

*o Ikrime, apo ndoshta, këtë nuk e bëre?!*

*U ktheve dhe porsi struci vrapove,*

*Me shumë shpejtësi sapo rrugën devijove.*

*Ti nuk e ktheve kurrizin si shenjë mirësjelljeje,*

*kurse zverkun e kishe sikur hienë e re!*

Fjalëkalimi i shokëve të Pejgamberit a.s. dhe pjesëtarëve të Beni Kurejdhes gjatë Betejës së Hendekut ishte: “Ha, Mim. Nuk do të fitojnë.”

Pejgamberi a.s. dhe shokët e tij përjetuan gjithë atë frikë dhe ankth për shkak të demonstrimit armiqësor të forcës dhe pranisë së tyre gjithandej rreth e rrotull.

Në një moment, Pejgamberit a.s. iu afrua Nu'ajm b. Mesud dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, unë e kam përqaftuar Islamin, por populli im nuk e di. Më thuaj çfarë mund të bëj?”

Pejgamberi a.s. tha: “Ti në mesin tonë je një individ i vetëm. Nëse mundësh, largoji ata nga ne. Në realitet, lufta është mashtrim!”

Nu'ajm b. Mesudi shkoi te Benu Kurejdha, me të cilët në periudhën paraislame kishte raporte shumë të ngushta, dhe u tha: “O Benu Kurejdha, ju e dini mirë se sa shumë ju dua dhe i dini mirë raportet tona!”

Ata u përgjigjën: “Po, e dimë shumë mirë dhe nuk dyshojmë aspak te ti.”

Atëherë ai u tha: “Kurejshët dhe ata të fisit Gatafan nuk janë në të njëjtën pozitë si ju. Ky vend është në të vërtetë vendi juaj dhe këtu është pasuria juaj, fëmijët tuaj dhe gratë tuaja dhe ju nuk mund të transformoheni në diçka tjetër. Kurejshët dhe Gatafanët këtu erdhën vetëm për të luftuar kundër Muhamedit dhe shokëve të tij dhe ju i keni mbështetur. Mirëpo vendi i tyre, pasuria e tyre dhe gratë e tyre janë tjetërkund. Pra, nuk janë në të njëjtën pozitë si ju. Nëse atyre u jepet mundësia, ata do ta shfrytëzojnë, por nëse jo, do të kthehen në vendet e tyre dhe do t’ju lënë ju këtu me Muhamedin. Në këtë rast ju jeni të humbur sepse të vetëm nuk mund të rezistoni. Prandaj nuk do të duhej të luftonit bashkë me këta

të ardhurit derisa të mos merrni peng disa nga paria e tyre, që të jenë në duart tuaja si garanci për të luftuar kundër Muhamedit deri në rrëzimin e tij.”

Ata i thanë: “Mirë ke thënë, ashtu duhet të jetë.”

Pastaj ai shkoi te Kurejshët dhe i tha Ebu Sufjan b. Harbit dhe atyre që ishin me të: “Ju e njihni mirë simpatinë time për ju si dhe mospajtimin tim me Muhamedin. Unë mora vesh për një gjë të rëndësishme, ndaj mendova se e kam obligim t’ju komunikoj si këshillë, por me kusht, të mos më publikoni!”

Ata i thanë: “Jo, ne nuk do të të bëjmë publik, na thuaj!”

Ai vazhdoi: “Ta dini se hebrenjtë janë penduar që e kanë shkelur marrëveshjen e tyre me Muhamedin dhe për këtë tashmë e kanë informuar. I kanë thënë atij: “Ne jemi penduar për atë çfarë kemi bërë, a je i kënaqur nëse nga Kurejshët dhe Gatafanët marrim disa prej liderëve të tyre dhe t’i dorëzojmë ty t’i vrasësh, pastaj ne të bashkëngjitemi ty dhe së bashku i rregullojmë të tjerët?!” Ai u tha atyre se pajtohet. Prandaj, nëse hebrenjtë ju kërkojnë si pengje disa njerëz, mos u jepni asnjë!”

Pastaj ai shkoi edhe te Gatafanët. Atyre u tha: “O Gatafanë, ju jeni prejardhja ime dhe familja ime dhe jeni njerëzit më të dashur, kështu që nuk mendoj se keni ndonjë dyshim tek unë!”

Ata u përgjigjën: “Po, e dimë shumë mirë këtë dhe aspak nuk dyshojmë te ti.”

Ai i pyeti: “Atëherë tek askush nuk do të më tradhtoni!”

Ata thanë: “Jo, nuk do të të tradhtojmë.” Dhe ai u tha atyre ngjashëm me atë që u tha Kurejshëve dhe i paralajmëroi në mënyrë të njëjtë.

Kur erdhi e shtuna në mbrëmje, muaji shevval, viti i pestë i hixhretit, Allahu i Madhërisëm e ndihmoi të Dërguarin e Tij, kur bëri që Ebu Sufjan b. Harbi dhe paria e fisit Gatafan të dërgojnë te fisi Benu Kurejdha pikërisht Ikrime b. Ebu Xhehlin, në krye të delegacionit të Kurejshëve dhe Gatafanit, me detyrë që t’ua përcjellë mesazhin: “Ne ne nuk jemi në vendin tonë, ndërsa kuajt dhe devetë po na shkatërrohen. Prandaj, nisuni në betejë, që ta përfundojmë punën me Muhamedin!”

Këta iu kthyen përgjigje: “Sot është e shtunë, dita në të cilën ne nuk punojmë asgjë. Ju e dini se disa prej nesh kanë provuar për të bërë diçka në këtë ditë, por për këtë u ka ardhur dënimi. Përveç kësaj, ne nuk duam të luftojnë me ju kundër Muhamedit derisa të na jepni disa nga njerëzit tuaj si pengje për të na garantuar derisa ta shkatërrojmë Muhamedin. Ne kemi frikë se ju, nëse ngushtoheni dhe nuk mund të përballoni, ktheheni në vendin tuaj me nxitim dhe na lini ne vetëm me të, e atëherë ne nuk mund t’i rezistojmë!”

Kur të deleguarit u kthyen me këtë mesazh nga Benu Kurejdha, Kurejshët dhe Gatafanët arritën në këtë konkludim: “Vallahi, ajo çfarë na tha Nu’ajm b. Mesudi qenka e vërtetë!” Dhe Beni Kurejdhes i dërguan përgjigjen: “Ne nuk do

t'ju dërgojmë asnjë njeri nga njerëzit tanë dhe nëse dëshironi që të luftoni, dilni dhe luftoni!" Benu Kurejdha thanë: "Është e vërtetë ajo që tha Nu'ajmi! Këta dëshirojnë me çdo kusht që të luftojnë, kështu që nëse ju paraqitet rasti i volitshëm e shfrytëzojnë, e nëse ndodh e kundërta, do t'ia mbathin në vendet e tyre dhe na lënë në vendin tonë me të!" Pastaj Kurejshëve dhe Gatafanit i dërguan këtë mesazh: "Ne, vallahi, nuk do të luftojmë në anën tuaj kundër Muhamedit në qoftë se ju nuk na jepni pengjet tuaj!" Këta nuk u dakorduan për këtë dhe kështu Allahu e ndërpreu bashkëpunimin e tyre. Në netët e ftohta të dimrit Allahu u dërgoi një erë jashtëzakonisht të ftohtë, e cila ua përmbysi kusitë dhe ua rrëzoi enët e tyre.

Kur dëgjoi Pejgamberi a.s. për mosmarrëveshjet dhe ndarjen që u bëri Allahu, e thirri Hudhejfe b. Jemanin dhe e dërgoi për t'i spiunuar ata se çfarë po bënin natën.

Transmetohet nga Muhammed b. Ka'bKuredhiu se ka thënë: "Një njeri nga Kufa i kishte thënë Hudhejfe b. Jemanit: "O babai i Abdullahut, a e keni parë ju të Dërguarin e Allahut dhe a jeni shoqëruar me të?!"

Ky ishte përgjigjur: "Po, o djali i vëllait!"

Pastaj e pyeti sërish: "Çfarë keni vepruar?"

Ky u përgjigj: "Vallahi, angazhoheshim!"

Ai tha: "Vallahi, sikur ne të ishim me të, nuk do ta linim të ecte në tokë, por do ta bartnim mbi shpatullat tona!"

Hudhejfe i tha: "O djali i vëllait, ne ishim me të Dërguarin e Allahut në Betejën e Hendekut dhe ai kaloi një pjesë të natës duke u falur. Pastaj u kthye nga ne dhe pyeti: "Cili nga ju do të shkojë të shohë se çfarë janë duke bërë, por përsëri të kthehet te ne (duke e theksuar kthimin pas), i lutem Allahut që ai të jetë shoqëruesi im në xhenet?" Megjithatë, asnjëri nga të pranishmit nuk u paraqit, sa nga frika e madhe, sa nga uria dhe sa nga të ftohtët. Pasi nuk doli asnjëri, atëherë Pejgamberi a.s. më thirri mua dhe unë nuk kisha zgjidhje tjetër pos që të ngrihesha. Më tha:

*"O Hudhejfe, shko hyr mes tyre dhe shiko se çfarë po bëjnë ata, por mos bëj asnjë veprim derisa të kthehesh!"* Dhe unë shkova dhe hyra në mesin e tyre, ndërsa era dhe ushtria e Allahut me ta bënin atë që bënin, nuk ua la të qetë as kusitë, as zjarrin e as ndërtesat.

Ebu Sufjani u ngrit dhe tha: "O Kurejshë, le të shikojë secili nga ju se me kë është ulur!" Hudhejfe tha: "Unë kapa për dore njeriun që ishte pranë meje dhe e pyeta: "Kush je ti?" Ai m'u përgjigj: "Unë jam filani i biri i filanit."<sup>126</sup>

<sup>126</sup> Në veprën "Sherhul-Mevahib thuhet: "I rashë dorës së atij nga ana ime e djathtë, e kapa për dore dhe e pyeta: "Kush je ti?" Ai tha: "Unë jam Muavije b. Ebi Sufjan." Pastaj i rashë dorës së atij që e kisha në anën e majtë dhe e pyeta: "Kush je ti?" Ai tha: "Unë jam Amër ibnul-Asi."

Ebu Sufjani pastaj tha: "O Kurejshë, vallahi, ju nuk jeni në një vend në të cilin mund të qëndroni. Neve na u shkatërruan edhe kuajt edhe devetë, Benu Kurejdha na braktisi dhe prej tyre dëgjuam atë që e urrejmë, pastaj siç po shihni, as era nuk po na i lë të qetë as kusitë, as zjarrin nuk po na e lë, as tendat nuk mund të qëndrojnë. Prandaj, ejani të shkojmë! Unë po shkoj!"

Pastaj iu afrua devesë së tij, e cila ishte lidhur, u ul mbi të dhe e goditi, ashtu që ajo u hodh mbi tri këmbët, ndërsa lidhëzën me të cilën e kishte të lidhur këmbën e katërt e lëshoi vetëm kur ajo u ngrit në këmbë. Vallahi, të mos ishte urdhri i Pejgamberit a.s.: "*Mos bëj asnjë veprim derisa të na kthehesh!*", mund ta vrisja atë me shigjetë, po të doja."

Hudhejfe më tutje vazhdon:

"Unë u ktheva te Pejgamberi a.s., të cilin e gjeta duke u falur me një pelerinë shumëngjyrëshe, të cilën e vishnin disa nga gratë e tij. Kur më vërejti mua, më afroi afër këmbëve të tij dhe më mbuloi me një pjesë të pelerinës, pastaj bëri rukunë dhe sexhden, ndërsa unë isha ashtu nën pelerinë. Pastaj unë ia tregova atij tërë ndodhinë."

Kur anëtarët e fisit Gatafan dëgjuan për atë që kishin bërë Kurejshët, edhe ata me nxitim morën rrugën për në vendet e tyre.

Pejgamberi a.s. dhe muslimanët me të në mëngjes u larguan nga hendeku dhe u kthyen në Medinë.

## BETEJA KUNDËR FISIT BENI KUREJDHA (viti i 5 h.)

Në mesditë, te Pejgamberi a.s. erdhi Xhibrili i mbështjellë me një çallmë nga armaçi<sup>127</sup>, i kishte hipur mushkut, mbi shpinën e të cilit shala ishte e mbuluar me kadife nga armaçi i mëndafshit dhe e pyeti: *“A mos i ke zgjeshur armët e tua, o i Dërguari i Allahut?”*

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Po, i kam zgjeshur!”*

Xhibrili pastaj i tha: *“Dije se engjëjt nuk i kanë zgjeshur armët e tyre dhe unë tani jam kthyer vetëm me kërkesë të tyre. O Muhamed! Allahu i Madhërishëm të urdhëron që të marshosh për tek Beni Kurejdha. Edhe unë do të shkoj atje para teje dhe do t’ua tund fortesat e tyre!”*

Pastaj Pejgamberi a.s. i urdhëroi muezinit që t’i shpallte popullit: *“Kush është i dëgjueshëm dhe i bindur, menjëherë le të ngrihet, namazin e ikindisë mos ta falë askund tjetër pos te Beni Kurejdhët.”*

Pastaj e nisi Ali b. Ebi Talibin me flamur, i cili e udhëhoqi ushtrinë drejt Beni Kurejdhës.

Kur Aliu u afrua pranë fortesave të tyre, i dëgjoi ata duke folur keq për Pejgamberin a.s., ndaj u kthye dhe në rrugë e takoi Pejgamberin a.s., të cilit i tha: *“O i Dërguari i Allahut, mos u afro afër këtyre të prishurve!”* Pejgamberi a.s. i tha: *“Përse, a mos i ke dëgjuar ndoshta duke më ofenduar?”*

Aliu r.a. u përgjigj: *“Po, o i Dërguari i Allahut!”* Atëherë Pejgamberi a.s. i tha: *“Nëse do të më shihnin mua, sigurisht nuk do të flisnin ashtu!”* Dhe pastaj duke iu afruar fortesave të tyre, Pejgamberi a.s. bërtiti: *“O vëllezërit e majmunit! A nuk ju ka poshtëruar Allahu dhe a nuk e ka zbritur mbi ju zemërimin e Tij!?”*

Ata iu përgjigjën: *“Kjo për ty nuk është e panjohur, o Ebul-Kasim!”*

Kur doli në vendin e tyre, Pejgamberi a.s. u ndal në një nga pusët e tyre të quajtur Enna, atje në anën ku ishin pasuritë e tyre, pas tij arritën edhe njerëzit e tjerë. Aty erdhën disa njerëz të cilët ktheheshin nga namazi i jacisë (el-isha el-ahire), mirëpo ende nuk e kishin falur ikindinë, duke respektuar fjalët e Pejgamberit: *“... Namazin e ikindisë mos ta falë askund tjetër pos te Beni Kurejdhët.”*

Mirëpo, pasi ishin të preokupuar me angazhime luftarake, nuk deshën ta falnin atë namaz vetëm se te Beni Kurejdha, siç tha Pejgamberi a.s. *“Derisa të vini te Beni Kurejdha!”* Prandaj këtë namaz e kanë falur tek ata vetëm pas namazit të

<sup>127</sup> Armaç, mëndafsh i qëndisur me ar e me argjend.

jacisë (el-isha'), për të cilin Allahu në Librin e Tij nuk i qortoi, as Pejgamberi nuk u zemërua me ta.

Pejgamberi a.s. e mbajti Beni Kurejdhën nën rrethim 25 net, kështu që kjo bllokadë i rraskapiti krejtësisht, ndërsa Allahu i Madhërishëm futi frikën në zemrat e tyre.

Hujej b. Ahtab, siç kishte premtuar, pas ndarjes së Kurejshëve dhe Gatafanit mbeti me Beni Kurejdhën në fortesat e tyre. Kjo ishte përmbushje e zotimit që i pat dhënë Ka'b b. Esedit.

Kur ata tashmë formuan bindjen se Pejgamberi a.s. nuk do të tërhiqet prej tyre pa i shkatërruar, Ka'b b. Esedi u ngrit dhe tha: "O hebrenj, ju ka ndodhur ajo që po shihni, ndaj unë po ju propozoj tri mundësi dhe ju zgjidhni cilën të doni."

Ata i thanë: "Cilat janë ato mundësi?"

Ai tha: "Ta pasojmë këtë njeri dhe ta pranojmë, sepse vallahi ju u bindët se ai është Pejgamber i dërguar e për këtë tregon edhe Libri juaj i Shenjtë! Do ta shpëtoni edhe veten edhe pasurinë, fëmijët dhe gratë tuaja!"

Ata thanë: "Ne kurrë nuk do t'i braktisim dispozitat e Tevratit dhe nuk e zëvendësojmë me asgjë!"

Ai vazhdoi: "Nëse nuk pranoni, atëherë ejani që me duart tona t'i vrasim fëmijët tanë dhe gratë tona e pastaj me shpata t'i sullemi Muhamedit dhe shokëve të tij, të pangarkuar nga familjet, derisa Allahu të gjykojë mes nesh dhe Muhamedit! Nëse vdesim, vdesim e pas vetes nuk lëmë trashëgimtarë për të cilët frikësohemi! Ndërsa, nëse fitojmë, pasha jetën time, do të gjejmë për vete gra dhe fëmijë!"

Ata thanë: "A t'i mbysim këta të mjerë! Çfarë do të ishte jeta pas tyre?"

Ai vazhdoi: "Nëse e refuzoni edhe këtë, atëherë sonte është nata e së shtunës, me siguri Muhamedi dhe shokët e tij mendojnë se janë të sigurt! Ejani t'i sulmojmë, ndoshta do t'i kapim në befasi!"

Ata u përgjigjën: "A ta prishim vetë të shtunën tonë dhe të veprojmë diçka që nuk e ka vepruar askush para nesh, përveç asaj që ti e di, për shkak të së cilës u shndërruan në majmunë?!"

Atëherë Ka'b b. Esedi i zemëruar tha: "Asnjëri nga ju, që kur ju ka lindur nëna e gjer më tani, asnjë natë nuk keni pasur vendosmëri!"

Pastaj i dërguan Pejgamberit a.s. një mesazh: "Na dërgo Ebu Lubabe b. Abdul-Mundhirin për t'u konsultuar me të në lidhje me çështjen tonë!"

Pejgamberi a.s. menjëherë e dërgoi tek ata dhe kur e panë një grup njerëzish, gra dhe fëmijë, i dolën përpara duke qarë, për çka ai shprehu keqardhje. Ata e pyetën: "Si mendon ti, o Ebu Lubabe, a të pranojmë që të na gjykojë Muhamedi?"<sup>128</sup>

<sup>128</sup> Për shkak të bllokadës të ashpër, kur kuptuan se do të jenë të humbur, ata dërguan She's b. Kajsin, i cili i propozoi Pejgamberit a.s. që të veprojnë me ta sikurse me Beni Nadirin, d.m.th. që t'i lënë pronat dhe armatimin e të

Ky u përgjigj: “Po”, pastaj e ngriti dorën në fyt, duke u treguar me këtë gjest se i priste likuidimi<sup>129</sup>.

Ebu Lubabe thotë: “Vallahi, ende pa lëvizur nga vendi e kuptova se e kisha tradhtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij!”

Pastaj ai u kthye duke mos shkuar te Pejgamberi a.s., por hyri drejt e në xhami, e lidhi veten te një shtyllë e xhamisë dhe tha: “Nuk do të dal nga ky vend derisa të më falë Allahu për atë që kam bërë! I jam betuar Allahut se kurrë më këmba ime nuk do të shkelë në tokën e Beni Kurejdheve dhe kurrë më nuk do të shfaqem në vendin ku e kam tradhtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij!”

Kur dëgjoi për këtë Pejgamberi a.s., i cili e kishte pritur gjatë, tha: “*Sikur të kishte ardhur tek unë drejtpërdrejt, unë do t’ia kisha falur gabimin, por pasi veproi ashtu, unë nuk do ta liroj përderisa Allahu nuk e fal.*”

Nga Ummu Seleme transmetohet që Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Ebu Lubabe është falur!*” Ajo pastaj e pyeti: “A ta përgëzoj, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “*Po, nëse do!*”

Pastaj ajo u ndal te porta e dhomës së saj - para urdhëresës për mbulesën e femrave – dhe tha: “Gëzohu, o Ebu Lubabe, se Allahu të ka falur ty!”

Ummu Seleme vazhdon: “Njerëzit menjëherë nxituan për ta liruar, por ai nuk i lejoi duke thënë: “Jo, vallahi, derisa të vijë Pejgamberi a.s. të më lirojë me dorën e tij!” Dhe kur kaloi Pejgamberi a.s. pranë tij duke shkuar në namazin e sabahut, e liroi.

Ibni Hishami thotë:

“Ebu Lubabe qëndroi i lidhur në shtyllë gjashtë net. Gjatë kohëve të namazit, gruaja e tij vinte e zgjidhte dhe pas faljes së namazit e lidhte përsëri në shtyllë.”

Në mëngjes Benu Kurejdha e pranuan gjykimin e Pejgamberit a.s.. Me atë rast, Pejgamberin a.s. e rrethuan njerëz nga fisi Evs dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut, ata janë vetëm aleatët tanë, jo edhe të fisit Hazrexh, dhe ti e di si ke vepëruar dje me aleatët e vëllezërve tanë!” Në fakt, Pejgamberi a.s. para Beni Kurejdhes i pat vendosur bllokadë edhe fisit Beni Kajnuka, të cilët ishin aleatë të fisit Hazrexh. Kur ata e kishin pranuar gjykimin e tij, për ta kishte kërkuar falje Abdullah b. Ubej b. Seluli dhe Pejgamberi a.s. i kishte falur. Kur tash iu drejtuan fisi Evs, Pejgamberi a.s. i pyeti: “*A dëshironi që t’i gjykojë njeriu juaj?*”

largohen me gratë dhe fëmijët, ndërsa me vete të marrin nga pasuria vetëm aq sa mund t’ua ngarkojnë deveve, përveç armëve. Kur Pejgamberi a.s. e refuzoi, ai tha: “Ti vetëm na fal jetën dhe na i dorëzo gratë dhe fëmijët tanë, ndërsa për gjëra të tjera nuk kemi nevojë!” Pejgamberi a.s. as këtë nuk e pranoi. Ai insistoi vetëm në gjykimin e tij! Atëherë She’si u kthye tek ata me këtë mesazh.” (Cituar nga vepra *Sherhul-Mevahib* nga Zerkaniu)

<sup>129</sup> Në *Sherhul-Mevahib* më tutje thuhet: “Ebu Lubabe sikur e kuptoi se refuzimi i Pejgamberit a.s. kishte të bënte me faljen e jetës së tyre. Ai e kuptoi se Pejgamberi a.s. do t’ua priste kokat nëse ata e praninin gjykimin e tij, prandaj ia tregoi fytin Benu Kurejdhes.

Ata thanë: "Po, ne duam!" Atëherë Pejgamberi a.s. tha: "*Mirë pra, le të jetë Sa'd b. Muadhi!*"

Sa'd b. Muadhin e kishte vendosur Pejgamberi a.s. në një tendë të një grua nga fisi Eslem, e quajtur Rufejde, e cila ishte vendosur në kuadër të xhamisë së tij. Kjo grua i shëronte të plagosurit dhe kujdesej për gjërat e humbura të muslimanëve. Pejgamberi a.s., kur goditej dikush me shigjetë në hendek, thoshte: "*Dërgojeni në tendën e Rufejdes, kështu që mos ta kemi larg për ta vizituar!*"

Kur Pejgamberi a.s. e caktoi Sa'din si gjykatës për Beni Kerejdhen, erdhën njerëzit e fisit të tij, e morën dhe e vendosën në një gomar në të cilin kishte një jastëk lëkure. Ai ishte një njeri i madh dhe i bukur. Kështu ata u nisën për te Pejgamberi a.s.. Gjatë rrugës i thoshin: "O Ebu Amër, bëhu i mirë ndaj bashkëvendësve të tu. Pejgamberi a.s. të ka caktuar që të bëhesh i mirë!" Kur ata e mërzitën duke i folur, ai tha: "Edhe Sa'dit i erdhi koha të ruhet, në emër të Allahut, nga protestat e të nënshtruarve." Kur e dëgjuan këtë, disa njerëz të tij që ishin me të u kthyen në shtëpinë e Beni Abdil-Eshhel dhe ai kur dëgjoi se çfarë tha Sa'di, i vajtoi njerëzit e Beni Kurejdhes para se të shkonte Sa'di tek ata<sup>130</sup>.

Kur Sa'di arriti te Pejgamberi a.s. dhe te muslimanët, Pejgamberi a.s. tha: "*Ngrihuni në këmbë kryeparit tuaj!*" Muhaxhirët Kurejshë menduan: "Pejgamberi a.s. me këtë po mendon për ensarët!" Ndërsa ensarët menduan: "Pejgamberi a.s. me këtë ka menduar për të gjithë!" Andaj u ngritën dhe thanë: "O Ebu Amër, i Dërguari i Allahut të ka caktuar që të gjykosh në çështjen e aleatëve tuaj!"

Sa'd b. Muadhi tha: "Përmbajuni marrëveshjes së Allahut dhe rekomandimit të Tij! Po të ishte caktuar ndonjë gjykatës tjetër, unë nuk do të gjykoja!"

Ata thanë: "Ashtu është!"

Sa'di, duke u kthyer në drejtimin nga ishte i Dërguari a.s. për respekt ndaj tij, pyeti: "A pajtohen me këtë edhe të tjerët që janë këtu?" Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Po."

Sa'di tha: "Atëherë, unë po e shpall vendimin: meshkujt të ekzekutohen, pasuria të ndahet, fëmijët dhe gratë të robërohen!" Pejgamberi a.s. tha: "*Ke gjykuar sipas Ligjit të Allahut, i Cili është përmbi shtatë qiej.*"

Pastaj u deportuan dhe Pejgamberi a.s. i burgosi në Medinë, në shtëpinë e vajzës së Harithit<sup>131</sup>. Pejgamberi a.s. shkoi te sheshi i Medinës - i njëjti që edhe sot gjendet atje - dhe aty gërmuan gropa. Pastaj dërgoi njerëz për t'i sjellë aty dhe në ato gropa i ekzekutuan.

<sup>130</sup> Nga fjalët e Sa'dit: "Edhe Sa'dit i erdhi koha të ruhet, në emër të Allahut, nga protestat e të nënshtruarve!", konkludoi se Sa'di synonte vrasjen e tyre, prandaj i ka vajtuar para vdekjes së tyre.

<sup>131</sup> Ajo quhej Kejsa bint Harith.

Aty u sollën në grupe, në mesin e tyre ishte edhe armiku i Allahut, Hujejj b. Ahtab dhe Ka'b b. Esedi, i pari i tyre. Ata gjithsej ishin 600 ose 700, edhe pse ata që janë të prirë për ekzagjerim thonë se “kanë qenë midis 800 dhe 900 njerëz”.

Kur një grup, në të cilin ishte edhe Ka'b b. Esedi, e çuan para Pejgamberit a.s., njerëzit e tij e pyetën: “Si mendon, ç’do të bëhet me ne?” Ai u përgjigj: “Vallë, as këtu nuk keni mend? A nuk e shihni se i thirruri nuk kundërshton dhe kur dikush prej jush del prej këtu, nuk kthehet më? Vallahi, na pret likuidimi!”

Kjo gjendje ka zgjatur për aq kohë derisa Pejgamberi a.s. u dha fund atyre.

Kur u mor për ekzekutim armiku i Allahut, Hujejj b. Ahtab, ai kishte të veshur një pelerinë me ngjyrë të kuqe<sup>132</sup>, të cilën e kishte grisur pak nga të gjitha anët që mos t’ia vidhnin, ndërsa duart i kishte të lidhura me litar pas qafës. Duke e parë Pejgamberin a.s., tha: “Nuk do ta qortoj veten për armiqësinë që kam ndaj teje, por ai që lufton kundër Allahut gjithnjë do të jetë i mposhtur.” Pastaj u kthye nga njerëzit dhe tha: “O njerëz, nuk ka dyshim në urdhrin e Allahut. Këtu është Libri dhe përcaktimi i Tij si dhe likuidimi i përgjakshëm që ka ligjësuar Allahu për Beni Israilët.” Pastaj u ul dhe ia prenë kokën.

Nga Aishja, nëna e besimtarëve, transmetohet se ka thënë:

“Nga gratë e tyre është ekzekutuar vetëm një. Ajo, vallahi, ishte tek unë dhe bisedonte me mua dhe qeshte me të madhe derisa Pejgamberi a.s. në shesh ekzekutonte njerëzit e saj! Papritmas dikush thirri emrin e saj: “Ku është filania!” Ajo tha: “Unë jam ajo, pasha Zotin!” Unë i thashë: “Vaj halli për ty, çfarë ke?” Ajo tha: “Edhe mua do të më ekzekutojnë!” Unë i thashë: “Përse, çfarë ke bërë?” Ajo u përgjigj: “Për shkak të diçkaje që kam bërë!”<sup>133</sup> Pastaj u çua aty në shesh dhe u ekzekutua.”

Aishja pastaj kishte thënë:

“Vallahi, kurrë nuk do ta harroj, ishte e çuditshme, ishte e gëzuar dhe shumë e qeshur, edhe pse e dinte se do të ekzekutohej!”

Pejgamberi a.s. pat urdhëruar që të vriten të gjithë burrat e rritur. Atijje Kuredhiu ka thënë: “Pejgamberi a.s. urdhëroi që Benu Kurejdhes t’i vriten të gjithë meshkujt e rritur. Unë atëherë isha ende djalosh, kur më panë se ende nuk isha pjekur, më lejuan të shkoj.”

Nga Ejjub b. Abdurrahman transmetohet si vijon:

“Selma bint Kajs ishte njëra prej tezeve të Pejgamberit a.s., e cila e kishte falur namazin së bashku me të kur ishte ndryshuar kibla. Ajo kishte dhënë betimin e besnikërisë kur kishte ndodhur betimi i grave. Tek ajo u strehua Rufa'a b. Samuel Kuredhiu, i cili atëherë ishte njeri i pjekur dhe kërkoi mbrojtje. Ajo tha: “Nënë e

<sup>132</sup> Dëshironte të paraqitej me ngjyra të zjarra.

<sup>133</sup> Ibni Hishami thotë: “Ajo e kishte gjuajtur Hal-lad b. Suvejdin me mulli dhe e kishte vrrarë.”

baba t'u bëfshin kurban, o i Dërguari i Allahut, ma dhuro mua Rufa'an. Ai thotë se do të falet dhe do të hajë mish deveje!" Pejgamberi a.s. ia dhuroi dhe kështu ajo ia shpëtoi jetën."

Pastaj Pejgamberi a.s., pronat e Beni Kurejdhës, gratë dhe fëmijët e tyre ua ndau muslimanëve.

Disa të burgosura Pejgamberi a.s., përmes Sa'd b. Zejd ensariut i dërgoi në Nexhd tek vëllezërit e tyre Beni Abdil-Eshhel, ku si kompensim për to Sa'di mori disa kuaj dhe armë.

Pejgamberi a.s. nga gratë e tyre për vete zgjodhi Rejhane bint Amër b. Hunafe dhe ajo qëndroi me të deri në vdekjen e tij. Ai i kishte ofruar asaj martesë, që nënkuptonte edhe mbulesën, por ajo nuk e kishte pranuar duke thënë: "O i Dërguari i Allahut, më lejo vetëm të qëndroj në pronësinë tënde, kjo është më e lehtë për mua dhe për ty!" Dhe ai e kishte lejuar.

Kur ajo u kap rob, nuk donte ta pranonte Islamin dhe këmbëngulte në fenë e saj hebreje. Pejgamberi a.s. e kishte izoluar dhe ishte zemëruar me të. Mirëpo, një herë derisa ai ishte me shokët e tij, dëgjoi pas tij trokitjen e këpucëve, ndaj tha: "Ky me siguri është Thalebe b. Sa'je, i cili do të më përgëzojë me Islamin e Rejhanes!" Dhe me të vërtetë ishte Thalebe, i cili erdhi dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, Rejhana e ka pranuar Islamin!" Pejgamberi a.s. u gëzua shumë.

Rrëfimin për Betejën e Hendekut dhe fisin Beni Kurejdha, Allahu i Madhërishtëm e ka shpallur në Kur'an në suren el-Ahzab, ku i përmend vuajtjet, por edhe begatitë që u ka dhënë atyre, si edhe mbështetjen kur e largoi vuajtjen prej tyre, sidomos pas kundërshtimeve të hipokritëve:

*"O ju që keni besuar, përkujtoni të mirën e Allahut ndaj jush, kur juve ju erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e Allahu e shihte atë që ju vepronit."* Me fjalën ushtri këtu nënkuptohen Kurejshët, Gatafanët dhe Beni Kurejdha, ndërsa ushtria të cilën e dërgoi Allahu mbi ta me erë, në realitet janë engjëjt. Allahu i Madhërishtëm më tutje thotë:

*"Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshtmi dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojlojta për Allahun."* Ata të cilët u kishin ardhur prej së larti ishin Benu Kurejdha, ndërsa ata prej së poshtmi ishin Kurejshët dhe Gatafani.

Allahu i Madhërishtëm më tutje vazhdon:

*"Atje, në atë vend qenë sprovuar jobsimtarët, dhe qenë tronditur me një dridhje të fortë."*

Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishin sëmundje, thoshin: "Allahu dhe i Dërguari Tij nuk na premtuan tjetër vetëm se mashtrim!" Kjo u referohet fjalëve të Muattib b. Kuseirit, të cilat i citon i Lartmadhërishtëmi<sup>134</sup>.

<sup>134</sup> Shih në kaptinën e mëparshme.

*“Dhe kur një grup prej tyre thanë: “O banorë të Jethribit, nuk ka qëndresë për ju, ndaj kthehuni!” E një grup prej tyre kërkonin lejen e Pejgamberit, duke thënë: “Shtëpitë tona janë të pambrojtura, në realitet ata nuk donin tjetër por vetëm të iknin.” Që ka të bëjë me fjalët e Evs b. Kajedhiut dhe të tjerët që mendojnë si ai.*

*“Dhe sikur t’u hynin atyre nga anët e saj (Medinës) dhe prej tyre të kërkohej tradhtia” d.m.th. kthimi në idhujtari. “Ata do të ishin të gatshëm për të dhe nuk do të vononin aspak. (të tradhtonin).*

*E, ata ishin që i patën dhënë besën Allahut më parë se nuk do të kthehen prapa (nuk do të ikin), pra premtimi i dhënë Allahut mban edhe përgjegjësi.”*

Këtu mendohet për fisin Beni Harithe, të cilët në Betejën e Uhudit për pak sa u lëkundën së bashku me Beni Selemin, pastaj ata iu zotuan Allahut se kurrë nuk do ta mendonin diçka të tillë. Këtu u përmendet ai zotim që vetë e kishin marrë përsipër. Allahu i Lartësuar thotë:

*“Thuaj: “Nëse ikët prej vdekjes ose prej mbytjes, ikja nuk do t’ju bëjë dobi, sepse edhe atëherë nuk do të (shpëtoni) përjetoni vetëm për pak kohë.”*

*Thuaj: “Kush do t’ju mbrojë prej Allahut, nëse Ai ua ka caktuar ndonjë të keqe, ose (do t’ju godit me ndonjë të keqe) nëse Ai ua ka caktuar ndonjë të mirë. Po përveç Allahut ata nuk do të gjejnë për vete ndonjë përkrahës e as ndonjë ndihmëtar.”*

*Allahu i ka njohur shumë mirë ata që ndër ju pengonin”, d.m.th. hipokritët. “Dhe ata vëllezërve të vet u thoshin: “Ejani me ne!” E ata nuk vijnë në luftë, vetëm pakicë”, d.m.th. vetëm për t’i mbuluar qëllimet e tyre.*

*“Janë koprracë ndaj jush (nuk ju duan të mirën).” Nga shpirtligësia që fshihnin në vetvete. “E kur u vjen frika i sheh ata të shikojnë ty, e sytë e tyre rrotullohen si të atij nga të fikët para vdekjes”, d.m.th. nga frika e madhe dhe paniku. “E kur largohet frika, ata ju shpojnë ju me gjuhë të mprehta...”, d.m.th. flasin atë që ju nuk e doni sepse ata nuk shpresojnë në botën tjetër, as nuk i stimulon shpërblimi i atjeshëm. Ata tmerrësisht i frikësohen vdekjes, si dikush që nuk ka asnjë shpresë pas saj.*

*“Ata mendonin se grupet aleate ende nuk kishin shkuar”, d.m.th. Kurejshët dhe Gatafani. “Dhe nëse aleatët kthehen edhe njëherë, ata (hipokritët) do të dëshironin të kishin qenë beduinë diku me arabët dhe prej tyre të pyesin për çështjen tuaj, por edhe sikur të ishin në mesin tuaj, ata krejt pak do të luftonin.”*

Pastaj u drejtohet besimtarëve:

*“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër”, d.m.th. ashtu që ata të mos largohen prej tij dhe nga vendi në të cilin gjenden.*

Pastaj, Allahu i Madhërishëm i përmend besimtarët dhe sinqeritetin e tyre si dhe besimin e tyre të fortë se vështirësitë janë vetëm sprovë dhe se premtimi i Allahut është i vërtetë. Ai thotë:

*“E kur muslimanët e panë ushtrinë aleate, thanë: “Kjo është ajo që Allahu dhe i Dërguari i Tij na premtuan neve, e Allahu dhe i Dërguari i Tij thanë të vërtetën. Ajo (ushtria e armikut që e panë) vetëm ua shtoi atyre besimin dhe mbështetjen.”*, d.m.th. të durojnë në vështirësi dhe t’i dorëzohen e t’i binden Allahut për premtimet që u dha atyre Allahu dhe i Dërguari i Tij. Pastaj thotë:

*“Prej besimtarëve kishte burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut, e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën”,* d.m.th. e kanë përfunduar veprën e tyre dhe i janë kthyer Zotit tyre, si ata që vdiqën në Bedër dhe të tjerët në Uhud, *“Dhe ka prej tyre që janë duke pritur”,* d.m.th. të arrijë ndihma që Allahu u ka premtuar dhe vdekja në rrugën e Tij siç kanë vepruar sahabët. *“Dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi”,* d.m.th. nuk kanë dyshuar dhe asnjëherë nuk janë hamendur në besimin e tyre.

*“Që Allahu t’i shpërblejë të vërtetët për sinqeritetin e tyre e hipokritët t’i ndëshkojë, nëse do, ose t’ua falë atyre; Allahu është që fal shumë, është mëshirues.*

*Dhe Allahu i zbrapsi ata që nuk besuan me atë mllëfin e tyre”,* d.m.th. Kurejshët dhe Gatafanin, *“Duke mos arritur kurrnjë të mirë. Dhe Allahu ua largoi luftën besimtarëve. Allahu është i fuqishëm, ngadhënjyes.*

*E ata nga ithtarët e librit (hebrenjtë)”,* d.m.th. Beni Kurejdha, *“të cilët u ndihmuan atyre (idhujtarëve), Ai (Allahu) i nxori prej kështjellave të veta dhe në zemrat e tyre u futi frikën, ashtu që një grup e mbytni, kurse grupin tjetër e robëroni.”* Pra, i keni mbytur meshkujt, ndërsa fëmijët dhe gratë i keni robëruar.

*“E juve ju la trashëgim tokën e tyre, shtëpitë e tyre, pasurinë e tyre dhe tokën që ende nuk e keni shkelur. Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo send.”* (El-Ahzab, 9-27)

Pasi u mbyll çështja e Beni Kurejdhës, i shpërtheu plaga Sa’d b. Muadhrit dhe prej saj ai së shpejti vdiq si shehid.

Nga Hasan Basriu transmetohet se ka thënë:

*“Sa’di ishte një njeri trupmadh, por kur njerëzit e bartën iu duk i lehtë. Atëherë disa hipokritë thanë: “Vallahi, nuk ka qenë edhe aq trupmadh! Asnjëherë xhenaze më të lehtë nuk kemi bartur.” Kur dëgjoi për këtë, Pejgamberi a.s. tha: “Atë e ka bartur edhe tjetërkush pos jush! Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, engjëjt janë gëzuar me shpirtin e Sa’dit dhe është tronditur Arshi!”*

Në anën e idhujtarëve u vranë tre persona: Munebbih b. Osman b. Ubejd, i cili u godit nga një shigjetë dhe vdiq në Mekë. Pastaj, nga fisi Benu Mahzum b. Jekadha u vra Nufel b. Abdullah b. Mugire, trupin e të cilit e kërkuan nga Pejgamberi a.s. që t’ua shesë. Në fakt, ai kishte dalë në hendek, pastaj aty ishte mbërthyer dhe ishte vrarë. Muslimanët ia kishin mbledhur trupin e tij, por Pejgamberi a.s. kishte thënë: *“Ne nuk kemi nevojë as për trupin e tij, as për kompensimin për të!”* Kështu që i la që ta marrin.

Nga fisi Beni Amir b. u vra Amër b. Abdu Vudd, atë e vrau Ali b. Ebi Talibi.

Në konfliktin me Beni Kurejdhën nga muslimanët u vra Hal-lad b. Suvejd, mbi të cilin ishte gjuajtur mulliri, i cili e kishte goditur rëndë në pjesën e prapme të kokës. Pohohet se Pejgamberi a.s. në lidhje me të ka thënë: *“Ai me të vërtetë do të ketë shpërblimin e dy shehidëve!”*

Gjithashtu ka vdekur edhe Ebu Sinan b. Mihsan b. Hurthan, gjatë kohës derisa Pejgamberi a.s. mbante Beni Kurejdhan nën bllokadë. Ai është varrosur në varrezat e Beni Kurejdhës.

Së fundi, kur sulmuesit u kthyen nga Hendeku, siç jam informuar, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Pas këtij viti, Kurejshët nuk do t’ju sulmojnë ju, por ju do t’i sulmoni ata!”*

Me të vërtetë, pas kësaj Kurejshët nuk sulmuan, por Pejgamberi a.s. ishte ai që sulmonte, derisa Allahu ia bëri të mundur ta çlironte Mekën.

### Ekspedita në Beni Lihjan

Pas këtyre ngjarjeve, Pejgamberi a.s. në Medinë kaloi muajt dhul-hixhxe, muharrem, safer, rebiul-evvel dhe rebiul-ahir. Në muajin xhumadel-ula, përkatësisht në muajin e gjashtë pas pushtimit të Beni Kurejdhës, nisi ekspeditën për në Lihjan për të kërkuar pjesëmarrësit në Rrexhî’: Hubejb b. Adijj dhe shokët e tij. Ai bëri sikur kishte për qëllim Sirinë, në mënyrë që t’i kapte në befasi.

Nga Medina<sup>135</sup> doli nëpër malin Gurab, i cili gjendet në rrugën për Siri, pastaj kaloi nëpër Mahid, përmes Betra's, e pastaj u kthye majtas dhe shkoi në Bin<sup>136</sup>, e më pas nëpër guroret e Jemames. Nga atje rruga drejt e çoi në Mihaxhxe, në drejtim të Mekës, ku e përshpejtoi ritmin dhe zbriti në Guran, ku ishin vendbanimet e Beni Lihjanit.

Gurani është një luginë që ndodhet në mes Emexhit dhe Usfanit, pranë një vendi të quajtur Saje.

Mirëpo ata i gjeti të përgatitur, ishin ngjitur dhe fortifikuar në maja malesh dhe kur Pejgamberi a.s. e pa se nuk kishte arritur t’i befasonte, tha: *“Sikur të zbritnin në Usfan, mekasit do të mendonin se kemi ardhur në Mekë!”*

Pastaj, me dyqind kalorës të tij, vërtet zbriti në Usfan. Nga atje i dërgoi dy kalorës të tij deri në Kura'el-Gumejm dhe kur ata u kthyen, të gjithë në kolona u drejtuan për në Medinë.

Xhabir b. Abdullahu thoshte:

*“E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. kur u drejtua për t’u kthyer në Medinë duke thënë: “Do të kthehen ata dhe do të pendohen, me vullnetin e Zotit, dhe do ta falënderoj-*

<sup>135</sup> Administrator të Medinës caktoi Ibni Umme Mektumin.

<sup>136</sup> Një luginë afër Medinës.

*në Zotin tonë! Unë kërkoj mbrojtje nga Allahu nga lodhja e udhëtimit dhe nga dëshpërimi në vendin e kthimit dhe i kërkoj mbrojtje nga pamja e shëmtuar në familje dhe në pasuri!"*

### **Ekspedita në Dhu Kared**

Në Medinë, Pejgamberi a.s. kaloi vetëm disa net, kur devetë e tij qumështore në Gabe<sup>137</sup> i sulmoi Ujejne b. Hisn b. Hudhejfe b. Bedr Fizariu. Me devetë ishte një njeri nga Benu Gifari<sup>138</sup> dhe gruaja e tij. Atë e vranë, ndërsa gruan e morën me vete në deve.

I pari që i kishte vërejtur ishte Seleme b. Amër b. Ekve'a Sulemiu, i cili ishte në rrugë për në Gabe, i ngjeshur me hark dhe shigjetë. Me të ishte edhe djaloshi i Talha b. Ubejdullahut, i cili tërhoqte me vete kalin e tij. Kur hipi mbi kodrën Veda', ai i pa disa nga kalorësit e tyre, pastaj duke u kthyer në drejtim të malit Sel briti: "Sulm armiçësor!" Pastaj u nis gjurmëve të armikut dhe filloi të gjuajë me shigjetë duke recituar vargje: "Ja merre, unë jam Ibnul-Ekve'a, ndërsa kjo ditë është dita e shkatërrimit të të poshtërve!"

Njëri prej tyre ishte përgjigjur: "Betohem në Zotin se ai është më i poshtër!"

Britmën e Ibnul-Ekve'as e dëgjoi edhe vetë Pejgamberi a.s., kështu që edhe ai filloi të thërrasë në Medinë: "Ndihmë Ndihmë!". Pas kësaj, nga të gjitha anët nxituan kalorësit.

I pari që u gjend pranë Pejgamberit a.s. ishte Mikdad b. Amër, pastaj Ubade b. Bishr b. Vaksh, Sa'd b. Zejd, Usejd b. Dhuhejr, Ukkashe b. Mihsan, Muhriz b. Nedle, Ebu Katade Harith b. Rib'iu dhe Ebu Ajjash Ubejd b. Zejd.

Kur u mblodhën rreth tij, Pejgamberi a.s. udhëheqës të tyre caktoi Sa'd b. Zejdin, pastaj tha: "Shko në ndjekje të tyre, ndërsa unë do t'ju bashkëngjitëm me të tjerët."

Kur u përballën kalorësit, Ebu Katade Harith b. Rib'iu vrau Hubejb b. Ujejne b. Husnin dhe e mbuloi me pelerinën e tij, pastaj u bashkua me të tjerët.

Kur Pejgamberi a.s. dhe muslimanët u afruan, papritmas e panë Hubejbin të mbuluar me pelerinën e Ebu Katades. Njerëzit thanë: "Qenka vranë Ebu Katade!" Por Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Jo, nuk është Ebu Katade, por është njeriu që ka vranë ai, që ta dini se e ka bërë ai!"

Ukkashe b. Mihsan zuri Evbarin dhe djalin e tij Amër b. Evbarin, të cilët kishin hipur mbi një deve, i gjuajti me shtizë dhe i vrau.

Në atë aksion arritën të shpëtonin disa deve. Ndërkohë, Pejgamberi a.s. u ndal në një kodër, në Dhu Kared, aty iu bashkëngjitën edhe njerëzit e tjerë. Aty Pejgamberi a.s. qëndroi një ditë e një natë.

<sup>137</sup> Gabe, vend afër Medinës nga ana e Shamit.

<sup>138</sup> Ky ishte djali i Ebu Dherit.

Seleme b. Ekve'a i tha: "O i Dërguari i Allahut, nëse do të më lejoje me një-qind njerëz, do të mund t'i shpëtoja devetë e mbetura dhe do t'i vrisja njerëzit e tyre!" Pejgamberi a.s. u përgjigj: "*Gatafanët tani janë duke mjelë qumësht prej tyre!*"

Aty për çdo njëqind njerëz therën nga një kafshë e pastaj u kthyen në Medinë.

Ndërkohë, në njërën nga devetë e Pejgamberit a.s. arriti ajo gruaja nga fisi Gifarij dhe menjëherë erdhi te Pejgamberi a.s. dhe e informoi për gjithçka që ndodhi. Më në fund ajo tha: "O i Dërguari i Allahut, unë i jam zotuar Allahut se do ta ther këtë deve, nëse Ai më shpëton mbi të!"

Pejgamberi a.s. buzëqeshi pastaj tha: "*Me të keq po ia kthen! Ajo të barti dhe Allahu të shpëtoi mbi të, ndërsa ti do ta therësh. Përveç kësaj, nuk ka zotim në padëgjueshmëri ndaj Allahut, as në diçka që nuk është pronë e jotja. Ajo është një nga devetë e mia, kështu që mund të kthehesh në shtëpinë tënde me begatinë e Allahut!*"

### **Ekspedita në Beni Mustalik**

Pejgamberi a.s., pasi e kaloi në Medinë një pjesë të muajit xhumadel-ahire dhe krejt muajin rexheb, në muajin shaban të vitit të gjashtë marshoi për në Beni Mustalik, degë e fisit Huza'a.

Pejgamberit a.s. i kishte arritur lajmi se fisi Beni Mustalik po bënin përgatitje për sulm kundër tij, nën udhëheqjen e Harith b. Ebi Dirar, babai i Xhujerije bint Harithit, njëra nga gratë e tij. Sapo dëgjoi për këtë, Pejgamberi a.s. menjëherë u nis për tek ata dhe i takoi tek uji me emrin Murejsi'<sup>139</sup>, i cili gjendej nga ana e Kididit, në drejtim të bregdetit. Aty u dyndën tërë trupat dhe ndodhi përlëshja. Allahu e mposhti Beni Mustalikun dhe u vranë shumë prej tyre. Pejgamberi s.a. v.s. zuri robër shumë fëmijë e gra si dhe shtiu në dorë një pre të madhe materiale, të cilat Allahu ua dhuroi si pre të luftës.

Në anën e muslimanëve u vra një njeri nga fisi Beni Ka'b b. Avf, i quajtur Hisham b. Subabe. Atë e kishte qëlluar një ensarij nga çeta e Ubade b. Samit, duke menduar se ishte nga ushtria e armikut, dhe e kishte vranë gabimisht.

Derisa Pejgamberi a.s. ishte atje pranë ujit të lartpërmendur, nga të gjitha anët i mbërrinin njerëz. Me Omer b. Hattabin shkante edhe shërbëtori i tij nga fisi Beni Gifar i quajtur Xhehxhah b. Mesudi, i cili i tërhiqte kalin. Kur u gjendën aty tek uji, ai u grind rreth ujit me Sinan b. Veber Xhihnium dhe u rrahën me njëri-tjetrin. Xhihnium kërkoi ndihmë: "O ensarë!" Kërkoi ndihmë edhe Xhehxhahi: "O muhaxhirë!" Me atë rast u zemërua shumë Abdullah b. Ubejj b. Seluli. Me të ishte një grup i njerëzve të tij, ndër ta edhe Zejd b. Erkami, atëbotë djalosh i ri. Ibni Seluli tha: "Edhe këtë e arritën! Na tejkaluan dhe u bënë shumicë në vendin tonë!"

<sup>139</sup> Për këtë shkak kjo betejë është quajtur edhe Beteja në Murejsi'.

Vallahi, unë xhelabijet Kurejshë<sup>140</sup> nuk i konsideroj ndryshe pos siç ka thënë i pari: 'Ushqeje qenin, e më në fund edhe ty do të të kafshojë!' Për Zotin, nëse kthehemi në Medinë, gjithsesi të fortët kanë për t'i përzënë prej aty më të dobëtit."

Pastaj u kthye nga njerëzit e tij të pranishëm dhe tha: "Që të gjithë ju keni faj për këtë. E keni sjellë veten në këtë situatë. U keni dhënë atdheun tuaj. U keni lejuar të shërbehen me pasurinë tuaj. Sikur t'ua ndërpresim të gjitha këto, ata do të detyrohen të kërkojnë për vete një vend tjetër!"

Këtë e dëgjoi edhe Zejd b. Erkami dhe menjëherë shkoi te Pejgamberi a.s., i cili e kishte përfunduar betejën me armikun. Kur ia tregoi ngjarjen, me Pejgamberin a.s. ishte edhe Omer b. Hattabi. Ai i tha Pejgamberit a.s.: "Urdhëroje Ubbad b. Bishrin që ta vrasë!"

Pejgamberi a.s. i tha: "Si bëhet kjo, o Omer, njerëzit do të thonë se Muhamedi ka vrarë shokun e vet! Jo, nuk ka nevojë që kjo të kryhet kështu, urdhëro që të nisemi."

Kjo ishte në kohën kur Pejgamberi a.s. nuk e kishte zakon të udhëtonte. Dhe njerëzit u nisën për rrugë.

Abdullah b. Seluli, kur kuptoi se Zejd b. Erkami e kishte informuar Pejgamberin a.s. për atë që kishte thënë, menjëherë shkoi dhe para Pejgamberit u përbetua me Allahun: "Unë nuk kam thënë atë që po pretendon Zejdi, e jo vetëm kaq, por as që kam folur në lidhje me këtë!"

Ai në popullin e tij ishte njeri shumë i respektuar. Kur i deklaroi kështu Pejgamberit a.s., ensarët të cilët ishin së bashku me të thanë: "O i Dërguari i Allahut, ndoshta djaloshi nuk e ka dëgjuar mirë dhe nuk e ka mbajtur mend se çfarë ka thënë ky", duke anuar nga Ibn Ubejj b. Seluli dhe duke u pozicionuar me të.

Pejgamberi a.s. pasi i hipi kafshës dhe u nis për udhëtim, takoi Usejd b. Hudajrin, i cili e përshëndeti me selam dhe pastaj e pyeti: "O Pejgamber i Allahut, për Zotin, je nisur në kohë të pavolitshme. Nuk të ka ndodhur kështu më herët!"

Pejgamberi a.s. i tha: "A nuk ke dëgjuar se çfarë ka thënë njeriu juaj?!" Tha: "Cili njeri yni, o i Dërguari i Allahut?"

Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Abdullah b. Ubejj." Usejdi tha: "Po çfarë tha ai?"

Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Ai mendon se, kur të kthehen në Medinë, të fortët gjithsesi kanë për t'i përzënë më të dobëtit prej aty."

Usejdi tha: "E ti, o Pejgamber, ti mund ta përzësh atë, nëse do, sepse vallahi ai është më i dobët se ti."

Pastaj shtoi: "O Pejgamber i Allahut, ki mëshirë ndaj tij. Allahu të dërgoi te ne në kohën kur populli i tij po përgatiste kurorën për ta kurorëzuar. Ai mendon se ti i ke rrëmbyer pushtetin."

<sup>140</sup> Xhelabije Kurejshë ishte emri që idhujtarët u kishin vënë muhaxhirëve që kishin pranuar Islamit.

Pejgamberi a.s. me njerëzit vazhdoi tutje, eci tërë natën dhe mëngjesin e ditës së ardhshme. Kur ende dielli nuk ishte bërë shumë i fortë, urdhëroi për të ndaluar. Së shpejti njerëzit u shtrinë nëpër tokë të rraskapitur dhe i kaploi gjumi.

Pejgamberi a.s. veproi në këtë mënyrë me qëllim që sa më shumë njerëz të preokupohen me deklaratën e Abdullah b. Ubejjit. Pastaj Pejgamberi a.s. vazhdoi rrugën në drejtim të Hixhazit, ku u ndal në vendin Neki' pranë një uji të quajtur Bek'a. Sapo mbërriti Pejgamberi a.s. atje, shpërtheu një erë e fortë e cila i shqetësoi dhe i frikësoi njerëzit. Por, Pejgamberi a.s. tha: *"Mos u frikësoni prej saj sepse ajo po fryn për shkak të vdekjes së një jobesimtari të madh!"*

Dhe me të vërtetë kur erdhën në Medinë mësuan se atë ditë kishte vdekur Rufa'a b. Zejd b. Tabut, një anëtar i fisit Benu Kajnuka, njëri nga gjigantët hebrenj, i cili ishte mbrojtës i madh i hipokritëve.

Së shpejti u shpall surja në të cilën Allahu përmes Ibni Ubejjit përmend edhe hipokritët e tjerë të ngjashëm me të. Kur u shpall ajo, Pejgamberi a.s. e kapi për veshi Zejd b. Erkamin dhe i tha: *"Ky me veshin e tij e ka përmbushur borxhin ndaj Allahut!"*

Kur dëgjoi Abdullah b. Abdullah b. Ubejj për çështjen në lidhje me babanë e tij tha: *"O i Dërguar i Allahut, kam dëgjuar se ti do ta vrasësh Abdullah b. Ubejjin për shkak të asaj që ke mësuar rreth tij. Nëse vërtet do ta bësh këtë, atëherë të lutem më urdhëro mua dhe unë do ta sjell kokën e tij!"*

Vallahi, hazrexhasit e dinë mirë se asnjëri prej tyre nuk kujdeset për babanë e tij më mirë se unë dhe unë kam frikë se nëse ti urdhëron dikë tjetër për ta vrasur, unë nuk do të mund të duroj ta shoh vrasësin e Abdullah b. Ubejjit duke ecur mes njerëzve. Frikësohem se e vras dhe kështu do ta vras besimtarin për jobesimtarin dhe do të shkoj në xhehenem!"

Pejgamberi a.s. tha: *"Përkundrazi, ne do të sillemi mirë me të dhe do ta trajtojmë bukur derisa të jetë me ne."*

Pas kësaj, kur Abdullah b. Ubejji bënte ndonjë gjë të re, vetë populli i tij e kritikonin dhe e qortonin. Duke vënë në dukje këtë, Pejgamberi a.s. iu drejtua Omer b. Hattabit:

*"Çfarë po mendon tani, o Omer? Nëse do ta vrisja kur më fole ti, atëherë e gjithë paria do të ngriheshin për ta mbrojtur atë, ndërsa sot, nëse i urdhëroj ata për ta vrasur, do ta vrisnin!"*

Omeri tha: *"Vallahi, e kuptova se zgjidhja e të Dërguarit është më e bereqetshme se zgjidhja ime!"*

Pastaj nga Meka mbërriti Mikjas b. Subabe, në dukje si musliman, i cili tha: *"O i Dërguari i Allahut, unë kam ardhur këtu si musliman dhe po kërkoj dëmshpërblim për vëllanë tim, i cili u vra gabimisht!"*

Menjëherë Pejgamberi a.s. urdhëroi që t'i paguhet dëmshpërblimi për vëllanë e tij Hisham b. Subabe. Ai qëndroi një kohë të shkurtër te Pejgamberi a.s., por së shpejti e sulmoi vrasësin e vëllait të tij dhe e vrau. Prej aty si femohues nga Islami u kthye në Mekë.

Edhe në anën e fisit Beni Mustalik u vranë disa njerëz. Kështu, Ali b. Ebi Talibi vrau dy prej tyre: një Malik dhe të birin e tij, ndërsa Abdurrahman b. Avfi vrau një nga kalorësit e tyre me emrin Ahmer ose Uhajmir.

Pejgamberi a.s. zuri robër shumë anëtarë të fisit Beni Mustalik dhe ndarja e tyre në mesin e muslimanëve bëri jehonë. Në mesin e të zënëve robër ishte edhe Xhujejrije bint Harith b. Ebi Dirar, më vonë gruaja e Pejgamberit a.s..

Aishja tregon:

"Kur Pejgamberi a.s. bëri shpërndarjen e anëtarëve të kapur rob nga fisi Beni Mustalik, Xhujejrije bint Harith i takoi Thabit b. Kajs b. Shemmasit apo djalit të xhaxhait të tij, me të cilin bëri kontratë mbi sasinë e shpërblimit të saj. Ajo ishte grua e ëmbël dhe shumë e bukur dhe si e tillë nuk e linte askënd indiferent. Kështu ajo erdhi tek Pejgamberi a.s. për të kërkuar ndihmën e tij në realizimin e kontratës që kishte bërë. Vallahi, posa e pashë në derën e dhomës sime, e urreva, e dita se ashtu siç e kam parë unë, do ta shohë edhe i Dërguari a.s.! Ajo hyri tek ai dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, unë jam Xhujejrije bint Harith b. Ebi Dirar, bija e prijësit të popullit të tij. Më ka goditur kjo fatkeqësi, siç e di. Kur u bë shpërndarja, unë i takova Thabit b. Kajs b. Shemmasit apo djalit të xhaxhait të tij dhe kemi bërë kontratë për shpërblimin tim, kështu që te ti kam ardhur që të më ndihmosh!"

Pejgamberi a.s. tha: *"Ka diçka më të mirë se kjo!"*

Ajo tha: *"Çfarë është ajo, o i Dërguari i Allahut?!"*

Pejgamberi a.s. tha: *"Nëse e paguaj unë shpërblimin dhe martohem me ty!"*

Ajo tha: *"Jam dakord, o i Dërguari i Allahut!"*

Pejgamberi a.s. tha: *"Le të jetë ashtu!"*

Lajmi se Pejgamberi a.s. u martua me Xhujejrije bint Harith b. Ebi Dirar u përhap shpejt dhe njerëzit thanë: "Këta tani janë krushqi e Pejgamberit a.s.!" Kështu që i liruan ata që ishin në duart e tyre.

Aishja më tutje thotë: "Falë kësaj martese u liruan 100 anëtarë të fisit Beni Mustalik dhe unë nuk e di që ndonjë grua i ka sjellë përfitim më të madh popullit të saj!"

Nga Jezid b. Rumani është transmetuar:

"Pasi e pranuan Islamin, Pejgamberi a.s. dërgoi tek ata Velid b. Ukbe b. Ebi Mu'ajt dhe ata kur dëgjuan për këtë të hipur në kafshë i dolën përpara. Mirëpo ai kur dëgjoi për ta, u frikësua prej tyre dhe u kthye te Pejgamberi a.s. dhe i tha se ata kishin ndër mend ta vrisnin dhe e penguan që të merrte zekatin. Muslimanët

pastaj gjithnjë e më shumë po e përmendnin fushatën ushtarake kundër tyre, derisa më në fund Pejgamberi a.s. vendosi për të ndërmarrë fushatë kundër tyre.

Derisa ishin në atë gjendje, te Pejgamberi a.s. erdhi një delegacion i tyre dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut, ne kur kemi dëgjuar se po vjen i dërguari yt, nga respekti kemi dalë për ta pritur dhe për t’i dorëzuar zekatin e tubuar, por ai u kthye pas, ndërsa tani, siç kemi dëgjuar, ka pohuar se ne i kemi dalë përpara për ta vrarë, ndërsa ne, vallahi, nuk e kemi pasur ndër mend një gjë të tillë!”

Allahu i Madhërishëm në lidhje me këtë ndodhi ka zbritur:

*“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë. E, dijeni se në mesin tuaj e keni të Dërguarin e Allahut. sikur ai t’ju dëgjonte juve në shumë çështje, ju do të pësonit vuajtje, por Allahu juve ua bëri të dashur besimin dhe ua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, ua bëri që t’i urreni. Të tillë janë ata që gjetën rrugën e drejtë.”* (El-Huxhurat, 6-7)

Pas kthimit nga ky udhëtim, në të cilin ishte edhe Aishja, në afërsi të Medinës, hipokritët filluan të flasin gënjeshtër rreth saj.

### **Rasti i shpifjes gjatë ekspeditës në Beni Mustalik (viti i 6 h.)**

Nga hz. Aishja transmetohet se ka thënë:

“Kur Pejgamberi a.s. kishte për qëllim të shkonte në një udhëtim, ai hidhte short dhe vendoste se cilën grua do të merrte me vete. Kështu veproi edhe me rastin e fushatës në fisin Beni Mustalik, hodhi shortin mes grave të tij dhe shorti më ra mua.

Gratë atëherë hanin vetëm ushqim të lehtë, për shkak të udhëtimit, që mos të rëndoheshin. Kur u shalua deveja ime, u ula në shkalcin tim, pastaj erdhën njerëzit që e shaluan devenë dhe më bartën, pastaj nga poshtë e kapën shkalcin, e ngritën, e vendosën në shpinë të devesë dhe e lidhën me litarë dhe pastaj devenë e kapën për kërpeshi dhe u nisën.

Kur Pejgamberi a.s. e mbaroi udhëtimin e tij, formoi karvanin dhe u nis për kthim. Jo shumë larg nga Medina u ndal dhe në atë vend kaloi një pjesë të natës, pastaj lajmëroi se udhëtimi po vazhdonte dhe njerëzit u nisën.

Unë shkova jashtë për disa nevoja të mia. Në qafë kisha një gjerdan me perla nga Dhafari<sup>141</sup>. Pasi mbarova punë, gjerdani më kishte rënë pa e hetuar. Vetëm kur jam kthyer përsëri te deveja, e pashë se nuk e kisha, por njerëzit tashmë ishin nisur. Unë përsëri u ktheva në atë vend dhe e gjeta gjerdanin tim, por ndërkohë

<sup>141</sup> Dhafar, qytet në Jemen, afër San’as.

njerëzit që kujdeseshin për devenë time e kishin shaluar dhe kishin vendosur mbi të shkalcin tim, duke menduar se unë isha në të, siç veproja zakonisht. Ata e kishin lidhur në shpinën e devesë duke mos dyshuar aspak se unë nuk jam aty, pastaj ishin nisur.

Kur u ktheva përsëri, atje nuk ishte asnjë njeri, nuk u përgjigj askush. Të gjithë kishin shkuar.

Unë u mbështolla me mantelin tim dhe u shtriva. E dija se kur ta vërejnë se kam humbur, do të kthehen pas. Isha ashtu shtrirë kur kaloi pranë meje Safvan b. Muattal Silmiu, i cili gjithashtu kishte mbetur prapa për shkak të disa nevojave të tij dhe nuk kishte bujtur me njerëzit e tjerë. Ai e pa siluetën time dhe m'u afrua. Ai më kishte parë edhe më herët, para se të na bëhej obligim hixhabi, kështu që kur më pa, tha: *"Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi! Gruaja e Pejgamberit a.s.!"* Unë edhe më tutje isha e mbështjellë në rrobat e mia.

Ai më pyeti: *"Çfarë të ka penguar ty, Allahu të mëshiroftë?!"*

Unë nuk u përgjigja fare. Pastaj e afroi devenë dhe më tha: *"Hip!"*, ndërsa ai u largua mënjatë. Pasi hipa unë, e mori devenë për kërpeshi dhe u nis me nxitim duke kërkuar njerëzit. Vallahi, as ne nuk e arritëm askënd, por as ata fare nuk kishin vërejtur se nuk isha, derisa u gdhi. Njerëzit atëherë ishin ndalur, pasi ishin qetësuar, ndërsa ky njeri u shfaq me mua dhe njerëzit që kishin marrë pjesë në shpifjen e rrejshme kishin thënë atë që kishin thënë. Masa u shqetësua për këtë, ndërsa unë, vallahi, nuk dija asgjë!

Kur arritëm në Medinë, unë u sëmura shumë, por ende nuk dija asgjë rreth kësaj. Ngjarja arriti edhe te Pejgamberi a.s. dhe te prindërit e mi, por mua ende askush nuk më tha asgjë. E vetmja gjë që kam vënë re ishte se Pejgamberi a.s. nuk e kishte të njëjtën vëmendje sepse kur unë i ankoheja për diçka, ai ishte shumë i vëmendshëm dhe i sjellshëm ndaj meje. Ndaj kësaj ankese timen nuk ishte i tillë, gjë që e përballova me vështirësi.

Këto ditë tek unë po qëndronte nëna ime<sup>142</sup> që më kishte rritur dhe Pejgamberi a.s. kur vinte tek unë vetëm thoshte: *"Si jeni?!"* dhe asnjë fjalë më shumë. Kjo më pikëlloi dhe unë duke parë tjetërsimin e tij, e pyeta: *"O i Dërguari i Allahut, nëse më lejon të shkoj te nëna ime, që ajo të kujdeset për mua?"* Ai vetëm m'u përgjigj: *"Mos ki gajle!"*

Hz. Aishja më tej tha:

"Unë u zhvendosa te nëna ime, ende duke mos ditur asgjë dhe pas njëzet e disa netësh unë u shërova.

Ne nuk jemi si të huajt, që tualetet i kanë në shtëpitë e tyre. Ne ato i përbuznim dhe një gjë e tillë për ne ishte e neveritshme. Ne shkonim në hapësirë të zbra-

<sup>142</sup> Sipas Ibni Hishamit, ajo quhej Zejneb bint Abdi Dihman.

zët dhe të pabanuar të Medinës dhe kështu gratë shkonin jashtë çdo natë për shkak të nevojave të tyre.

Një natë unë dola dhe me mua ishte dhe Ummu Mistah bint Ebi Ruhem b. Muttalib b. Abdi Menaf. Duke ecur me mua, ajo u ngatërrua me rrobat e saj, pastaj tha: "U shkatërroftë Mistahu!" Unë i thashë: "Pashë Allahun, a nuk është e shëmtuar të thuash ashtu për një muhaxhir që ka marrë pjesë në Betejën e Bedrit?!"

Ajo pyeti: "Ti nuk di gjë, bija e Ebu Bekrit?!" I thashë: "Dhe çfarë duhet të di?!"

Pastaj ajo më tregoi gjithçka që është thënë në atë shpifjen e rrejshme. Unë i thashë: "A është kjo e mundur?!" Ajo u përgjigj: "Po, vallahi, kështu ka ndodhur!"

Unë nuk munda të kryeja nevojat e mia, por menjëherë u ktheva. Aq shumë qava, sa që mendova se do të më copëtohet mëlcia! I thashë nënës sime: "Allahu të faltë! Njerëzit janë duke folur për mua atë që po flasin, ndërsa ti s'po më thua asgjë për këtë?!"

Ajo më tha: "O bija ime, mos e merr këtë shumë afër zemrës, se vallahi pak mund të gjesh raste kur një grua të bukur që ka shemër ta dojë burri i saj dhe që njerëzit të mos flasin dhe mos ta bezdisin!"

Dhe Aishja vazhdon tregimin: "Pejgamberi a.s. një herë u ngrit dhe u mbajti një fjalim njerëzve, për të cilin unë nuk kisha dijeni, dhe me atë rast pas falënderimit dhe lavdërimit ndaj Allahut tha: *"O njerëz, çfarë mendojnë ata që më fyejnë mua përmes familjes time, që rreth tyre flasin të pavërteta, derisa unë për ta, pasha Allahun, di vetëm mirë?! Ata flasin kështu edhe për një njeri për të cilin unë di vetëm mirë, ndërsa në shtëpinë time hyn vetëm kush është me mua!"*

Mëkatin më të madh për këtë në mesin e njerëzve të fisit Hazrexh e kishte Abdullah b. Ubejj b. Seluli, krahas gjithë asaj që kanë thënë Mistahu dhe Hamne bintu Xhahsh, motra e së cilës Zejnebe bintu Xhahsh, ishte e vetmja që në mesin e grave të Pejgamberit ishte e barabartë me mua. Allahu e mbrojti Zejneben me fenë e saj dhe ajo fliste vetëm mirë, për dallim nga Hamne bint Xhahsh, e cila mori pjesë në përhapjen e shpifjes duke më apostrofuar mua si kundërshtarë të motrës së saj, gjë që shumë më lëndonte.

Pas këtyre deklaratave të Pejgamberit a.s. në fjalimin e përmendur, Usejd b. Hudajri tha: "O i Dërguari i Allahut, nëse këta njerëz janë nga fisi Evs, ne do të të mbrojmë nga ata, por nëse janë vëllezërit tanë nga fisi Hazrexh, na urdhëro çfarë të duash, se vallahi, e kanë merituar të vriten!"

Pas tij u ngrit Sa'd b. Ubade, i cili më parë dukej njeri i mirë, dhe tha: "Vallahi, po gënjen! Ne nuk do t'i vrasim ata! Vallahi, ti po thua këtë vetëm për shkak se e di që këta njerëz janë nga Hazrexhi, se po të ishin nga populli yt, nuk do të thoshe kështu!"

Atëherë Usejdi u përgjigj: "Vallahi, ti po gënjen, me siguri edhe ti je hipokrit (munafik) pasi po i mbron hipokritët!"

Aishja tha: "Njerëzit u hodhën në këmbë dhe midis këtyre dy fiseve, fisit Evs dhe fisit Hazreth, për pak sa nuk plasi sherri. Pejgamberi a.s., zbriti poshtë (nga minberi) dhe erdhi tek unë, pastaj thirri Ali b. Ebi Talibin dhe Usame b. Zejdin, që të konsultohet me ta.

Sa i përket Usames, ai për mua shprehu mirënjohje e më në fund tha: "O i Dërguari i Allahut, ne për familjen tuaj dimë vetëm mirë. Kjo është pa dyshim një gënjeshtër dhe e pavërtetë!" Ndërsa Aliu tha: "O i Dërguari i Allahut, gra në të vërtetë ka shumë, mund ta zëvendësosh atë! Mund ta pyesësh shërbëtoren e saj, ajo do të flasë më drejtë!"

Pastaj Pejgamberi a.s., e ftoi Burejren<sup>143</sup> për ta pyetur, ndërsa Aliu menjëherë kërcëu ndaj saj, e goditi fort dhe i tha: "Tregoji drejt Pejgamberit a.s.!" Ajo pastaj tha: "Unë për të di vetëm mirë! E vetmja gjë që unë mund të ankojem rreth saj është se unë e zija brumin dhe kërkoi prej saj që të kujdesej për të, kurse ajo flinte dhe pastaj vinte delja dhe e hante atë."

Pastaj Pejgamberi a.s. erdhi në dhomën time, aty ishin prindërit e mi dhe një grua ensarije. Unë po qaja, edhe ajo qante me mua. Pejgamberi a.s. u ul, e falënderoi Allahun dhe i shprehu lavdi e pastaj tha: "*Oj Aishe, ti me siguri ke dëgjuar atë që njerëzit po flasin, andaj frikësohu nga Allahu! Nëse ti ke bërë ndonjë mëkat siç po flasin njerëzit, lute Allahun të të falë dhe pendohu, sepse Allahu e pranon pendimin nga robërit e Tij!*"

Vallahi, kur ai ma tha këtë, mua m'u ndalën lotët dhe nuk ndjeva asgjë. Unë prita që prindërit e mi t'i përgjigjeshin Pejgamberit a.s., por ata nuk folën. Atëherë unë u ndjeva aq e mjerë dhe e pavlefshme dhe s'kam menduar se Allahu për mua mund të shpallte diçka në Kur'an që do të lexohej në xhami dhe do të falej namaz me të. Unë vetëm kam shpresuar që Pejgamberi a.s. të shihte në ëndërr diçka ku Allahu do të përgënjeshtrohte se gjithçka për mua ishte gënjeshtër, pasi Ai e di se unë jam e pastër, apo do t'i dërgojë ndonjë lajm, por që të zbrësë Kur'ani në lidhje me mua, vallahi, e kam konsideruar veten shumë të padenjë për të shpresuar diçka të tillë!"

Pasi prindërit e mi nuk folën asgjë, unë i pyeta: "A nuk do t'i përgjigjeni të Dërguarit të Allahut?!" Ata thanë: "Vallahi, nuk po dimë se çfarë t'i përgjigjemi." Vallahi, unë nuk e di se ndonjë familjeje i ka ndodhur më parë diçka sikurse kjo që i ndodhi familjes së Ebu Bekrit këto ditë!

Kur prindërit e mi nuk deshën të flisnin asgjë, mua përsëri më rrodhën lotët, përsëri kam qarë, pastaj thashë: "Për këtë që po më thua, unë kurrë nuk do të pendohem tek Allahu! Vallahi, unë e di se nëse e konfirmoj atë që po flasin njerëzit, dhe Allahu e di më së mirë se unë jam e pastër, do të them diçka që nuk ka qenë, e në qoftë se e mohoj, ju nuk do të më besoni!"

<sup>143</sup> Burejre ishte emri i shërbëtorese së Aishes.

Aishja thotë: “Pastaj u përpoqa të kujtoja emrin e Jakubit, por nuk e bëra dot. Atëherë thashë: “Mirëpo do të them ashtu siç ka thënë babai i Jusufit:

*“...Halli im është: durim i mirë. Allahu është nga i cili kërkohet ndihmë për këtë që përshkruani ju.”* (Jusuf, 18)

Derisa Pejgamberi a.s. ishte i mbuluar me rroba dhe nën krye kishte një jastëk prej lëkure, nga Allahu i erdhi ajo që i erdhi. Kur e pashë atë, fare nuk u frikësova, as nuk u shqetësova, sepse e dija se isha e pastër dhe se Allahu i Madhërishëm nuk do të ishte i padrejtë me mua. Mirëpo, prindërve të mi – pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Aishes – ende pa u tharë djersa nga Pejgamberi mendova se po u dilte shpirti nga frika e madhe se mos nga Allahu po vinte konfirmimi i asaj që kishin thënë njerëzit.

Pastaj Pejgamberit a.s. iu fshinë djersët dhe ai u ul, kurse djersa rrodhi si kokrra me perla argjendi në një ditë me shi. Ai e fshiu djersën nga balli i tij dhe tha: *“Gëzohu, o Aishe! Allahu e konfirmoi pafajësinë tënde!”*

Unë thashë: “Atij i qoftë falënderimi!”

Ai pastaj doli përpara njerëzve dhe u mbajti fjalim. Atyre u lexoi atë që i zbriti Allahu nga Kur’ani në lidhje me këtë çështje. Pastaj urdhëroi kapjen e Mistah b. Uthathe, Hassan b. Thabit dhe Hamne bint Xhahsh, të cilët më së shumti kontribuan për përhapjen e gënjeshtërisë, dhe mbi ta u ekzekutua dënimi (me rrahje për shpifje).“

Ibni Is'haku thotë:

*“Disa njerëz nga fisi Benu Nexhxhar tregojnë se Ebu Ejjub Halid b. Zejdin gruaja e tij Ummu Ejjub e kishte pyetur: -A ke dëgjuar ç’thonë njerëzit kundër Aishes? -Po, i kam dëgjuar! Të gjitha janë gënjeshtër dhe shpifje!- iu përgjigj Ebu Ejubi. Pastaj iu drejtua të shoqes: -Po ti, a do ta bëje një gjë të tillë të keqe? -Jo! Vallahi, unë kurrë s’do ta bëja një gjë të tillë!- iu përgjigj ajo. Atëherë, Ebu Ejubi i tha: -Nëse ti thua kështu për veten tënde, dije se Aishja është më e mirë se ti!*

Aishja vazhdon: “Kur’ani i ka përmendur ata që morën pjesë në këtë shpifje. Allahu i Madhërishëm thotë:

*“S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që e barti pjesën e madhe (të shpifjes) i takon dënim i madh.”* (En-Nur, 11). Kjo vlen për Hassan b. Thabitin dhe shoqërinë e tij, të cilët thanë atë që thanë.

Pastaj Allahu i Lartësuar thotë: *“E përse kur e dëgjuan atë (shpifje) besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thoshin: “Kjo është shpifje e qartë?!”* (En-Nur, 12), d.m.th. duhet të kishin thënë ashtu siç tha Ebu Ejjubi dhe gruaja e tij.

Pastaj thotë:

*"Kur ju atë (shpifjen) e përcollët me gjuhën tuaj dhe për atë që nuk kishit kurrfarë dije flisnit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme, ndërsa tek Allahu ajo është e madhe." (En-Nur, 15)*

Pasi u shpall nga Kur'ani kjo pjesë që flet për Aishen dhe për ata që kishin folur rreth saj, Ebu Bekri, i cili një pjesë të të ardhurave të tij e ndante për Mistahun sepse ishte nevojtar, por edhe kishte afërsi familjare me të, atëherë tha: "Vallahi, kurrë më asgjë nuk do të ndaj për të, as nuk do t'i bëj ndonjë të mirë për shkak të shqetësimit që na shkaktoi me atë që tha për Aishen."

Allahu i Madhërishëm në lidhje me të ka shpallur:

*"Të ndershmit dhe të pasurit nga ju të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmeve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut lanë vendlindjen e tyre, por le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t'ju falë? Allahu fal dhe mëshiron shumë." (En-Nur, 22)*

Atëherë Ebu Bekri kishte thënë:

"Sigurisht, për Zotin, unë dua që Allahu të më falë!" Pastaj vazhdoi të ndante para për Mistahun, ashtu siç bënte edhe më parë, dhe tha: "Vallahi, asnjëherë nuk do t'ia ndërpres ndihmën!"

Ibni Is'haku thotë:

"Rreth ndëshkimit të Hassanit dhe shokëve të tij një prej muslimanëve kishte thurur vargjet e mëposhtme:

*E shijoi Hassani, edhe pse ishte farefis i saj,  
frytin e hidhur, por edhe Hamneja dhe Mistahu!  
I shpifën me të panjohura gruas së Pejgamberit të tyre,  
dhe shkaktuan indinjatën e Fisnikut, Zotit të Arshit!  
Ata u trishtuan, u turpëruan dhe e humbën fytyrën,  
sepse e përhapën shpifjen dhe Pejgamberin e fyen!  
Prandaj mbi ta u zbrazën goditje dhe rrahje kamxhiku  
ashtu siç derdhet prej së larti nga retë shtrëngata dhe shiu!*

## NGJARJA NË HUDEJBIJE (Në fund të vitit 6 h.)

Pejgamberi a.s. në Medinë kaloi muajin ramazan dhe shevval, ndërsa në muajin dhul-kade u nis për të kryer umren, duke mos dashur ndonjë konflikt<sup>144</sup>. Ai u përpoq t'i inkurajonte edhe fiset e tjera arabe dhe fiset beduine përreth që të nisen me të në atë rrugë sepse kishte frikë se Kurejshët mund të bënin ndonjë sulm apo mos e pengonin nga shkuarja në Qabe. Megjithatë, një numër i madh arabësh nuk iu përgjigj thirrjes së tij dhe ai u nis me muhaxhirët, me ensarët dhe arabët e tjerë që u bashkuan me të. Me vete kishte marrë edhe kafshët për kurban<sup>145</sup> si dhe ishte veshur me ihram për t'i siguruar njerëzit se ai nuk dëshironte luftë, por vetëm vizitën e Qabesë dhe madhërimin e saj.

Pejgamberi a.s. pastaj u nis dhe kur arriti në Usfan<sup>146</sup>, u takua me Bishr b. Sufjan Ka'biun, i cili i tha: "O i Dërguari i Allahut, Kurejshët kanë dëgjuar për udhëtimin tënd dhe kanë zbritur në Dhi Tuva<sup>147</sup>, me vete kanë marrë edhe devetë që kanë pjellë, përplot me qumësht. I janë betuar Allahut se kurrsesi nuk do të të lejojnë të hysh në Mekë. Në krye të kalorësve të tyre është Halid b. Velidi dhe janë vendosur në Kura'ul-Gamim."<sup>148</sup>

Me atë rast, Pejgamberi a.s. tha: *"Vaj halli për Kurejshët! Lufta i ka ngrënë krejtësisht, çfarë u mungon atyre sikur të mos ndërhyjnë midis meje dhe arabëve të tjerë? Nëse ata më shkatërrojnë mua, kanë bërë atë që kanë dëshirë, e nëse Allahu më bën mua më të fortë, atëherë ata mund ta pranojnë Islamin. E nëse as këtë nuk e bëjnë, atëherë ata mund të luftojnë me mua me fuqinë e tyre të ruajtur! Çfarë mendojnë Kurejshët? Pasha Allahun, unë do të luftoj për atë me të cilën më dërgoi Allahu, derisa Allahu të më bëjë superior ose derisa kjo qafë të mbetet e vetmuar!"*

Pastaj pyeti: *"A është ndokush që mund të na çojë në ndonjë rrugë tjetër, përbri asaj në të cilën gjenden ata?"*

Një njeri nga fisi Beni Eslem tha: "Unë mundem, o i Dërguari i Allahut!" Dhe i udhëhoqi nëpër një rrugë të pakalueshme, plot gurë, e tëra midis grykave. Kur e kapërcyen, ashtu të rraskapitur të gjithë u shtrinë në tokë në vendin ku përfundoi lugina. Pejgamberi a.s. tha: *"Thoni: "Nestagfirullahe ve netubu ilejhi!"<sup>149</sup>* Dhe ata

<sup>144</sup> Ibni Hishami thotë se Pejgamberi a.s. në atë kohë në Medinë si administrator la Numejje b. Abdullah Lejthin.

<sup>145</sup> Kishin gjithsej 70 deve të majme, ndërsa ata ishin 700 burra. Për çdo 10 njerëz ishte nga një deve.

<sup>146</sup> Usfan, vend pushimi, në largësi dy ditë ecje nga Meka.

<sup>147</sup> Dhi Tuva, vend afër Mekës.

<sup>148</sup> Kura'ul-Gamim, luginë para Asfanit, tetë milje larg tij.

<sup>149</sup> "Allahut i lutemi për falje dhe pendohemi tek Ai!"

këtë e përsëritën pas tij. Pastaj tha: *“Pasha Allahun, ky është lehtësimi (hitta)<sup>150</sup> që u është paraqitur hebrenjve, por ata nuk deshën ta thonë!”*

Pastaj Pejgamberi a.s. urdhëroi: *“Shkoni në të djathtë, në mes dy cungave, rrugës e cila do t’ju shpjerë në kthesën Merrar, në pjerrësirën e Hudejbisë, poshtë Mekës!”*

Dhe ushtria u nis asaj rruge. Kur kalorësia kurejshite pa pluhurin duke u ngritur pas tyre, e kuptoi se ata ishin nisur në rrugë tjetër dhe atëherë trokthi u kthyen te Kurejshët.

Pejgamberi a.s. ecte asaj rruge, por kur erdhi te kthesa Merrar, papritmas deveja e tij ra në gjunjë dhe njerëzit thanë: *“Ja, ra në gjunjë dhe nuk do të lëvizë dot!”* Pejgamberi a.s. tha: *“Jo, kjo nuk është natyra e saj, por nga Meka po e ndalon Ai që i pat penguar elefantët! Kështu që unë sot çdo propozim që më vjen nga Kurejshët e që ka të bëjë me lidhjet familjare, do ta pranoj!”*

Pastaj i urdhëroi ata për t’u ndalur. Ata i thanë: *“O i Dërguari i Allahut, në këtë luginë nuk ka ujë ku mund të ndalemi!”*

Me atë rast Pejgamberi a.s. nxori nga qesja e tij një shigjetë dhe ia dha njërit prej shokëve të tij, i cili e lëshoi në njërin nga pusët ekzistuese dhe e shtyu thellë poshtë, kur prej tij u turbullua dhe u paraqit ujë me bollëk, kështu që njerëzit filluan ta ndalonin për të mos u përhapur në vendin ku ishin zbarkuar devetë.

Kur Pejgamberi a.s. u qetësua, erdhi tek ai Budejl b. Verka Huza’iu, me disa njerëz nga fisi Huza’a, të cilët biseduan me të dhe e pyetën për arsyen e ardhjes së tij. Ai u tha atyre se nuk ka ardhur me synim për luftë, por vetëm dëshiron të vizitojë Qabenë dhe ta madhërojë shenjtërinë e saj. Pastaj u tha atyre ngjashëm me atë që i pat thënë edhe Bishr b. Sufjanit. Ata u kthyen prapa te Kurejshët dhe u thanë: *“O Kurejshë! Ju jeni duke nxituar në lidhje me Muhamedin sepse Muhamedi nuk ka ardhur për të luftuar, por vetëm dëshiron të vizitojë Qabenë!”*

Mirëpo ata dyshuan dhe u tallën me ta duke u thënë: *“Edhe në qoftë se nuk ka ardhur për të luftuar, vallahi, kurrë nuk do të hyjnë në të me forcë! Arabët asnjëherë të mos flasin për ne!”*

Fisi Huza’a kishin marrëdhënie të ngushta me Pejgamberin a.s. dhe dinin shumë nga sekretet e tij. Nga ana tjetër, as ata nuk fshihnin asgjë nga ai çfarë po ndodhte në Mekë.

Kurejshët pastaj dërguan Mikrez b. Hafs b. Ahjefin, të cilin kur e pa Pejgamberi a.s. tha: *“Ky është njeri i pabesueshëm!”* Edhe atij ia përsëriti atë që i kishte thënë Budjelit dhe shokëve të tij. Edhe ky u kthye te Kurejshët dhe u përcolli atë që kishte dëgjuar nga Pejgamberi a.s..

<sup>150</sup> Aludohet për fjalën e Allahut: *“...Dhe thoni: “Hittatun” - ndjesë, Ne ua falim mëkatet tuaja, e bamirësve ua shtojmë shpërblimin.”* (El-Bekare, 58)

Ata pastaj dërguan Hulejs b. Alkame ose Ibn Zibanin, i cili në atë kohë ishte prijës i Ehabishëve.

Kur e pa atë Pejgamberi a.s. tha: *“Ky është nga populli që e adhurojnë dhe madhërojnë Allahun! Dërgoni para tij kafshët për kurban, le t’i shohë!”*

Me të vërtetë, si e pa gjithë atë forcë se si nga njëra anë e luginës kalonin në anën tjetër, se si kafshët në qafë mbanin qafore<sup>151</sup> dhe lëkura e tyre ishte ngrënë dhe vjetruar nga mospërdorimi, ai menjëherë u kthye te Kurejshët ende pa arritur te Pejgamberi a.s. nga respekti për atë që pa. Kur ai u tregoi këtë gjë, ata i thanë atij: *“Ulu aty! Ti je një arab injorant!”* Ai u zemërua dhe tha: *“O Kurejshë, ne me ju nuk kemi bërë aleancë për këtë, as për këtë nuk kemi bërë marrëveshje. A duhet të kthehet nga Shtëpia e Allahut ai që ka ardhur për ta respektuar atë? Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti i Hulejsit, ose do ta lejoni Muhamedin që të kryejë atë për çfarë ka ardhur, ose unë me Ehabishët do të shpërndahe mi si një njeri i vetëm!”* Ata i thanë: *“Ik, o Hulejs! Na lejo që të vendosim çfarë duam ne!”*

Pastaj te Pejgamberi a.s. dërguan Urve b. Mesud Thekafiun, i cili, kur arriti, u ul para tij dhe tha: *“O Muhamed, a ke mbledhur njerëz të ndryshëm dhe me ta ke ardhur për ta shkatërruar fisin tënd?! Ja ku janë Kurejshët, me vete kanë gjithashtu edhe devetë qumështore, të gjithë të veshur me lëkura tigri dhe i janë betuar Allahut se pranë tyre kurrë nuk do të hysh në Mekë me forcë! Vallahi, këta që sot janë me ty, nesër do të largohen prej teje!”*

Ebu Bekër Siddiku, i cili ishte i ulur prapa Pejgamberit a.s., tha: *“O mjerani, lëpirës i Latit, a mos vallë ne do të ikim prej tij?”*

Ai pyeti: *“Kush është ky, o Muhamed?”*

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Është biri i Ebu Kuhafes.”*

Ai u përgjigj: *“Vallahi, sikur të mos kishte pasur më herët miqësi mes nesh, unë do t’i jepja përgjigjen e merituar.”*

Pastaj Urve iu kthye Pejgamberit a.s. për të biseduar me të, duke i bërë lajka dhe gjithnjë duke ia mikluar mjekrën, ndërsa mbi kokën e tij qëndronte Mugire b. Shu’be duke mbajtur në dorë një copë hekur. Sa herë që ky e prekte mjekrën e Pejgamberit a.s., ai e godiste në dorë duke i thënë: *“Hiqe dorën nga fytyra e Pejgamberit a.s. para se të mos jesh në gjendje ta kthesh në vend!”*

Kurse Urve u përgjigj: *“Për hir të Zotit! Pse je kaq i vrazhdë dhe i ashpër?!”*

Pejgamberit a.s. vetëm buzëqeshi.

Urve pyeti: *“Kush është ky, o Muhamed?”*

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Ky është djali i vëllait tënd, Mugire b. Shu’be.”*

<sup>151</sup> Qafore ishin ato që u vendosnin kafshëve për kurban, për t’i dalluar.

Ai tha: "Domethënë mashtrues! A nuk ta kam pastruar turpin tënd deri dje?"<sup>152</sup>

Pejgamberi a.s. pastaj edhe atij i foli ngjashëm siç bëri me të tjerët para tij, d.m.th. se nuk kishte ardhur për të luftuar.

Gjatë kësaj vizite te Pejgamberi a.s., Urve e pa me sy raportin e sahabëve ndaj tij; kur ai merrte abdest, ata nxitonin për të rrëmbyer nga uji i abdestit të tij. Po t'i binte ndonjë flokë nga koka, e merrnin dhe e fshihnin për ta ruajtur.

Kur u kthye te Kurejshët, tha: "O Kurejshë, unë kam qenë në oborrin mbretëror të Kistras (mbretit të Persisë), të Cezarit (mbretit të Bizantit) dhe të Nexhashiut (mbretit të Etiopisë), por për Zotin, nuk kam parë mbret të cilin e duan dhe e respektojnë njerëzit e tij ashtu siç e bëjnë këtë njerëzit e Muhamedit! I pashë se kurrë për asgjë nuk e lënë vetëm, prandaj thoni çfarë mendoni!"

Pejgamberi a.s. pastaj thirri Hirash b. Umejje Huzaiun, të cilin e dërgoi te Kurejshët në Mekë, duke e vendosur në një deve të quajtur "thaleb". Përmes tij ai i dërgoi një mesazh parisë së tyre, ku u tregoi qëllimin e ardhjes së tij, mirëpo ata ia therën devenë dhe atë për pak sa nuk e vranë! Atë e shpëtuan Ehabishët, të cilët e morën nën mbrojtjen e tyre, dhe vetëm në atë mënyrë ai u kthye i qetë te Pejgamberi a.s..

Pastaj Pejgamberi a.s. thirri Omer b. Hattabin për ta dërguar në Mekë që udhëheqësit Kurejshë t'i njoftonte për arsyet e ardhjes së tij. Por Omeri tha: "O i Dërguari i Allahut, unë kam frikë për veten time! Në Mekë nuk ka asnjë nga fisi Benu Adij b. Ka'b që do të më mbronte, ndërsa Kurejshët e dinë shumë mirë armiqësinë time ndaj tyre si dhe vrazhdësinë time në raport me ta. Por unë mund të të tregoj një njeri i cili është më i përshtatshëm se unë, Osman b. Affani."

Atëherë Pejgamberi a.s. e thirri Osman b. Affanin dhe e dërgoi tek Ebu Sufjani dhe prijësit e tjerë Kurejshë për t'i bindur ata se ai nuk kishte ardhur për të luftuar, por vetëm për të vizituar Shtëpinë e Allahut, për ta respektuar dhe madhëruar shenjtërinë e saj.

Osmani në rrugën e tij për në Mekë u takua me Ebban b. Seid b. Asin, kur tashmë kishte hyrë në Mekë apo para hyrjes, dhe e mori me vete. Pastaj ai i ofroi mbrojtje në shtëpinë e tij dhe ai kështu ishte në gjendje ta përcillte mesazhin e Pejgamberit a.s.. Ai shkoi tek Ebu Sufjani dhe te udhëheqësit tjerë Kurejshë dhe ua tha atyre atë për çfarë e kishte dërguar Pejgamberi a.s.. Kur ky e mbaroi, ata i thanë: "Nëse dëshiron të bësh tavaf rreth Qabesë, urdhëro!" Ai u përgjigj: "Unë nuk dua ta bëj atë përderisa nuk e bën Pejgamberi a.s.!"

Kurejshët atëherë e ndalën dhe e mbajtën aty, ndërsa te Pejgamberi a.s. dhe te muslimanët shkoi lajmi se Osman b. Affani ishte vvarë.

<sup>152</sup> Ibni Hishami thotë: "Urve me këtë donte të thoshte se Mugire b. Shu'be para kalimit të tij në Islam kishte vvarë 13 njerëz nga fisi Benu Malik, degë e Thekifit, gjë që çoi deri te konflikti midis këtyre dy degëve. Nga njëra anë ishte Benu Malik si mbrojtës i të vvarëve, ndërsa nga ana tjetër ithtarët e Mugires. Urve atëherë pagoi 13 paguesa gjaku për të vvarët dhe kështu e rregulloi atë çështje.

## Besëlidhja e Hudejbijes - Bej'atur-Ridvan (Betimi për besnikëri) -

Ibni Is'haku thotë:

Më ka treguar mua Abdullah b. Ebi Bekri se kur Pejgamberit a.s. i arriti lajmi se Osmani ishte vrrarë, ai tha: *"Nuk do të zmbrespem derisa ta ndëshkojmë këtë popull!"* Pastaj i thirri shokët e vet që të betoheshin. Kjo besë e lidhur nën një pemë u quajt "Bej'atur-Ridvan" ose "Besëlidhja e Hudejbijes".

Njerëzit më vonë thanë: "Pejgamberi a.s. atyre u kërkoi që të betohen për vdekje." Por Xhabir b. Abdullahu u përgjigj duke thënë: "Pejgamberi a.s. nuk kërkoi nga ne që të betohemi për vdekje, por kërkoi që të betohemi se nuk do të ikim!"

Të gjithë njerëzit i dhanë besën Pejgamberit a.s.. Nga të pranishmit askush nuk u përmbajt nga betimi, përveç Xheda b. Kajsit, vëlla i Benu Selemes. Xhabir b. Abdullahu ka thënë: "Betohem në Allahun, sikur po e shoh atë të puthitur nën sjetullën e devesë duke u strehuar nga njerëzit!"

Pastaj Pejgamberi a.s. mori vesh se lajmi për vrasjen e Osmanit nuk ishte i vërtetë.

## MARRËVESHJA E PAQES NË HUDEJBIJE

Kurejshët dërguan te Pejgamberi a.s. Suhejl b. Amrin nga fisi Benu Amir b. Luejj dhe i thanë: “Shko te Muhamedi dhe lidh marrëveshje me të, por gjithsesi këtë vit ai të tërhiqet nga qëllimi i tij sepse, për Zotin, nuk dëshirojmë që arabët të thonë për ne se ata kanë hyrë në Mekë befas dhe me dhunë.”

Kur e pa Pejgamberi a.s. Suhejl b. Amrin duke u afruar, tha: *“Kurejshët me siguri dëshirojnë armëpushim, prandaj e kanë dërguar këtë.”*

Suhejli pas mbërritjes së tij te Pejgamberi a.s. foli gjerë e gjatë dhe më në fund u pajtuan dhe filloi hartimi i marrëveshjes së paqes.

Megjithatë, kur tashmë çdo gjë ishte rregulluar dhe kishte mbetur vetëm që të hidhej në letër, Omer b. Hattabi kërceu dhe shpejt shkoi tek Ebu Bekri dhe i tha: “O Ebu Bekër, a nuk është ai i Dërguari i Allahut?”

Ebu Bekri u përgjigj: “Sigurisht se po!”

Omeri pyeti: “Po ne, a nuk jemi muslimanë?”

Ebu Bekri u përgjigj: “Sigurisht po, ne jemi muslimanë!”

Omeri vazhdoi: “A nuk janë ata idhujtarë?!”

Ebu Bekri përsëri u përgjigj: “Po, ata janë idhujtarë.”

Omeri e pyeti: “Përse atëherë po e poshtërojmë fenë tonë?”

Ebu Bekri i përgjigjet: “O Omer, përmbaju rripit të yzengjisë!<sup>153</sup> Unë dëshmoj se ai është i Dërguari i Allahut!”

Omeri tha: “Edhe unë dëshmoj se ai është i Dërguari i Allahut!”

Pastaj shkoi te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti atë: “O i Dërguari i Allahut, a nuk je ti i Dërguari i Allahut?!”

Pejgamberi a.s. tha: *“Sigurisht, unë jam!”*

Omeri përsëri: “A nuk jemi ne muslimanë?”

Pejgamberi a.s. tha: *“Sigurisht, ne jemi muslimanë!”*

Omeri pyeti: “A nuk janë ata idhujtarë?!”

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Po, ata janë idhujtarë.”*

Omeri tash e pyeti: “Përse atëherë po e poshtërojmë fenë tonë?”

Pejgamberi a.s. iu përgjigj: *“Unë jam rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij, unë nuk do ta kundërshtoj urdhrin e Tij, as Ai nuk do të më injorojë mua!”*

Omeri më vonë kishte deklaruar: “Për shkak të asaj që kam bërë atëherë, unë edhe tani jap lëmoshë, agjëroj, fal namaz dhe paguaj për lirim e njerëzve nga

<sup>153</sup> Zbatoje urdhrin e tij!

robëria nga frika e atyre fjalëve që pata shqiptuar, ndonëse kam dëshiruar vetëm të mirën!"

Atëherë Pejgamberi a.s. e ftoi Ali b. Ebi Talibin, kënaqësia e Allahut qoftë mbi të, dhe i tha atij: *"Shkruaj: Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim!"*

Menjëherë aty reagon Suhejli: *"Unë nuk e njoh këtë! Por ti shkruaje: "Në emrin tënd, o Zoti im!"* (Bismike Allahumme!) Dhe ai e shkroi kështu.

Pastaj i tha: *"Shkruaj: "Kjo është marrëveshja mes Muhamedit, të Dërguarit të Allahut dhe Suhejlit, të birit të Amrit", kurse Suhejli ndërhyri, duke thënë: "Ndal, sikur të të kishim pranuar për të Dërguar të Zotit, ne nuk do të luftonim kundër teje, por shkruaje emrin tënd dhe emrin e babait tënd. Pejgamberi a.s. tha:*

*"Shkruaje: Kjo është marrëveshja mes Muhamedit, të birit të Abdullahut dhe Suhejlit, të birit të Amrit..."*

Ata kanë rënë dakord për ndërprerjen e luftimeve për dhjetë vitet e ardhshme dhe gjatë kësaj periudhe njerëzit duhet të jenë të sigurt duke pezulluar sulmet ndaj njëri-tjetrit, me kusht që ata që ikin te Muhamedi si muslimanë nga fisi Kurejsh, pa lejen e kryeparëve të tyre, do t'i kthejnë në Mekë, kurse ata që vijnë nga muslimanët te Kurejshët, përkatësisht nëse dikush prej tyre ikën te këta, të mos u kthehen muslimanëve.

Mes nesh është çanta e mbyllur!<sup>154</sup> Nuk guxon të ketë vjedhje e as tradhti! Kush dëshiron të hyjë në ndonjë kontratë apo marrëveshje me Kurejshët, mund të hyjë!"

Në atë çast, fisi Huza'a deklaruan: *"Ne kemi kontratë dhe marrëveshje me Muhamedin!"*

Pastaj, u paraqitën fisi Benu Bekr dhe ata deklaruan: *"Ne kemi kontratë dhe marrëveshje me Kurejshët. Ti këtë vit do të kthehesh dhe nuk do të hysh në Mekë, ndërsa vitin e ardhshëm me njerëzit e tu mund të hysh në të në afat prej tri ditësh! Ne gjatë asaj kohe do të dalim prej saj. Me vete mund të keni vetëm armë kalorësi, pra vetëm shpatat në këllëf dhe asgjë tjetër!"*

Derisa Pejgamberi a.s. dhe Suhejl b. Amri po shkruanin tekstin e kontratës, papritmas vjen Ebu Xhendel b. Suhejl b. Amër, i cili ishte nën pranga dhe u nis drejt Pejgamberit a.s.. Njerëzit e tij kishin dalë jashtë, të përfshirë me dyshimin rreth fitores që kishte parë në ëndërr Pejgamberi a.s.. Kur e panë këtë marrëveshje paqeje dhe tërheqjen, pastaj dhembjen që ndjeu në vetvete Pejgamberi a.s. për shkak të saj, kjo tek ata ndikoi shumë negativisht dhe pothuajse u shkatërruan.

Sapo Suhejli pa Ebu Xhendelin, kërceu mbi të, e goditi fort me shuplakë, pastaj e rrëmbeu për jake dhe e tërhoqi duke thënë: *"O Muhamed, marrëveshja në mes nesh është bërë para se të vinte ky!"*

<sup>154</sup> "Mes nesh është çanta e mbyllur!" Është thënë si shembull për zemrat që kanë brenda atë për çfarë janë zotuar.

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Po, o Suhejl, kjo është e vërtetë!”*

Pastaj filloi ta shtrëngonte dhe ta tërhiqte, në mënyrë që përsëri t’ua kthente Kurejshëve. Mirëpo, Ebu Xhendeli bërtiti me zë të lartë: *“O muslimanë, a mos vallë do t’u kthehem idhujtarëve e të më mendojnë që të largohem nga feja?”* Kjo për njerëzit u bë një barrë shtesë.

Pejgamberi a.s. tha: *“Ki durim, o Ebu Xhendel, e mos u dorëzo, sepse Allahu ty dhe të tjerëve sikurse ti, të dobët dhe të pambrojtur, do t’ju gjejë rrugëdalje dhe lehtësim. Ne kemi lidhur marrëveshje ndërmjet nesh, ne u kemi dhënë besën e Allahut dhe ata na kanë dhënë besën, ndaj nuk mund t’i tradhetojmë.”*

Omer b. Hattabi u ngrit për ta përcjellë Ebu Xhendelin dhe i tha: *“Ki durim, o Ebu Xhendel, ata me të vërtetë janë idhujtarë, gjaku i asnjërit prej tyre nuk ka vlerë më tepër se gjaku i një qeni.”*

Ai u kthye në mënyrë të atillë që doreza e shpatës iu afrua Ebu Xhendelit. Përkritazi me këtë Omeri më vonë rrëfen: *“Dëshiroja që ta nxirrte shpatën e me të ta vriste babanë e vet.”* Mirëpo, ai e pati vështirë t’ia bënte këtë babait të vet dhe kjo punë u krye kështu.

Në fund, kur marrëveshja u përfundua në formë të shkruar, Pejgamberi a.s. si dëshmitarë mori disa muslimanë dhe disa idhujtarë. Ata ishin: Ebu Bekër Siddiku, Omer b. Hattabi, Abdurrahman b. Avfi, Abdullah b. Suhejl b. Amri, Sa'd b. Ebi Vekkasi, Mahmud b. Mesleme, Mikrez b. Hafs, i cili atëherë ende ishte idhujtar, dhe Ali b. Ebi Talibi, i cili njëherazi shkroi tekstin e marrëveshjes.

Pejgamberi a.s. e kishte vendosur kampin e tij në tokën që ishte jashtë Haremit (Hill), ndërsa namazin e kryente në pjesën që i takonte Haremit. Sapo përfundoi marrëveshjen e paqes, menjëherë iu afrua kurbanit të tij dhe e theri, pastaj u ul dhe vetë e rroi kokën. Kur e panë njerëzit se Pejgamberi a.s. e theri kurbanin dhe e rroi kokën, menjëherë nxituan edhe ata për ta bërë këtë.

Menjëherë pas kësaj, Pejgamberi a.s. u kthye pas duke formuar karvanin. Në atë udhëtim, diku në mes Mekës dhe Medinës, i zbriti surja el-Fet’h:

*“Ne ty të dhamë (vendosëm për) një fitore të sigurt. Ashtu që Allahu (pas fitores) të liroi ty prej mëkateve (që t’i mbathën) të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme (kur njerëzit do të pranojnë fenë islame dhe nuk do të jenë më mëkatarë) dhe ashtu të plotëson mirësinë e Vet ndaj teje në rrugën e drejtë.”* (El-Fet’h, 1-2)

Pastaj Allahu i Madhërishëm thotë:

*“Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet: se me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të siguruar, të rruani flokët e kokave tuaja, t’i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit.”* (El-Fet’h, 27)

Kjo i referohet ëndrrës që kishte parë Pejgamberi a.s.: që në Mekë do të hyjë i sigurt, pa frikë, dhe me koka të rruara dhe flokë të qethur, pa u frikësuar. Ai di atë që ju nuk e dini. *“Para kësaj ju dha një fitore të shpejtë.”* Paqen në Hudejbije.

Zuhriu thotë: "Në Islam deri atëherë nuk ka ekzistuar fitore më e madhe se kjo. Deri atëherë, vazhdimisht ka pasur konflikte, kudo që njerëzit takoheshin. Pas këtij armëpushimi u ndal lufta. Njerëzit nuk kishin më frikë nga njëri-tjetri. Sa herë që kishin keqkuptime dhe zënka verbale, bisedonin midis tyre, kushdo që i fliste për Islamin dikujt që kuptonte, ai e pranonte. Për këto dy vjet numri i muslimanëve u dyfishua, madje edhe u tejkalua ai numër."<sup>155</sup>

<sup>155</sup> Ibni Hishami thotë: "Këto fjalë të Zuhriut i konfirmon fakti se Pejgamberi a.s., sipas Xhabir b. Abdullahut, në Hudejbije kishte 1400 burra, ndërsa dy vjet më vonë, gjatë çlirimit të Mekës, doli me dhjetë mijë burra."

## DALJA NË HAJBER (Muharrem, viti i 7 h.)

Pas kthimit nga Hudejbija, Pejgamberi a.s. në Medinë kaloi muajin dhul-hixhxe dhe një pjesë të muharremit, pasi kryerja e haxhit atë vit u takoi idhujtarëve. Në pjesën e dytë të muajit muharrem u nis për në Hajber.

Nga Ebu Muattib b. Amër transmetohet si vijon:

"Kur Pejgamberi a.s. pa Hajberin, shokëve të tij, në mesin e të cilëve isha dhe unë, u tha: *"Ndaluni!"* Pastaj tha lutjen e mëposhtme:

*"Allahumme Rabbes-semavati ve ma adhlelne, ve Rabbel-erdine ve ma aklelne, ve Rabbesh-shejtani ve ma adlelne, ve Rabberr-rrijahi ve ma edhrejne! Fe inna nes'eluke hajre hadhihil-karjeti ve hajre ehliha ve hajre ma fiha, ve ne'udhu bike min sherriha ve sherri ma fiha! Akdimu, bismil- lah!"*

*"Allahu im, që je Zoti i qiejve e i atyre që ndodhen në to, i shtresave tokësore dhe i atyre që ndodhen në to, i djajve e i atyre të çorientuar prej djajve, i erërave e i gjërave të marra me vete prej tyre! Ne duam prej Teje të mirën e këtij vendbanimi e të banorëve të tij! Dhe nga e keqja e tyre, tek Ti strehohemi! Marshoni me emrin e Allahut!"*

Ai pastaj tha: "Këtë lutje Pejgamberi a.s. e thoshte para çdo vendi në të cilin hynte."

Transmetohet nga Enes b. Maliku se ka thënë:

"Kur Pejgamberi a.s. donte të sulmonte një popull, ai kurrë nuk e sulmonte deri në agim dhe nëse nga atje dëgjonte ezanin, tërhiqej nga sulmi, e nëse nuk e dëgjonte ezanin, e sulmonte. Në Hajber arritëm natën dhe Pejgamberi a.s. e kaloi aty natën. Pasi në mëngjes, kur u gdhi, nuk e dëgjoi ezanin, ai i hipi kafshës, e me të edhe ne u hipëm kafshëve. Unë isha pas Ebu Talhas dhe këmba ime e prekte këmbën e Pejgamberit a.s.. Gjatë rrugës takuam punëtorët e hershëm të Hajberit, të cilët kishin dalë me lopata dhe me shporta të gjera. Kur e panë Pejgamberin a.s. dhe ushtrinë thanë: *"Muhamedi dhe ushtria!"*<sup>156</sup> dhe u kthyen pas dhe filluan të iknin. Pejgamberi a.s. tha: *"Allahu ekber! U shemb e u rrënuu Hajberi, kur ne zbrezim në territorin e dikujt, i shëmtuar është mëngjesi i atyre që janë paralajmëruar!"*

Ibni Is'haku thotë:

"Kur Pejgamberi a.s. u nis nga Medina për në Hajber, ai shkoi nëpër Isra<sup>157</sup> dhe në atë vend iu ndërtua një xhami. Pastaj kaloi nëpër Sahba<sup>158</sup> dhe me ushtrinë

<sup>156</sup> Për ushtrinë ata këtu përdorën shprehjen 'hamis', që do të thotë pesë, pasi ushtria përbëhej nga pesë pjesë: krahu i djathtë, krahu i majtë, pararoja, prapavija dhe pjesa qendrore.

<sup>157</sup> Isra është emri i një kodre ndërmjet Medinës dhe luginës Fer'.

shkoi përpara deri në një luginë të quajtur Regji', në të cilën u ndal, aty në mes tyre dhe fisit Gatafan, në mënyrë që t'i pengojë ata nga dhënia ndihmë banorëve të Hajberit, të cilët i patën ndihmuar ata kundër Pejgamberit a.s..

Kam mësuar se kur Gatafanët dëgjuan për ardhjen e Pejgamberit a.s. në Hajber, i mblodhën njerëzit e tyre dhe u nisën për t'i ndihmuar hebrenjtë, mirëpo pasi kaluan një distancë, pas vetes aty ku kishin lënë familjet dhe pasuritë e tyre, dëgjuan tinguj të pazakontë, prandaj menduan se ata u janë vërsulur këtyre, ndaj menjëherë u kthyen. Kështu ata ngelën te familjet e tyre dhe te pasuria e tyre duke mos ndërhyrë ndërmjet Pejgamberit a.s. dhe Hajberit.

Pejgamberi a.s. ngadalë iu afrua pasurive të tyre, i mori një nga një dhe gjatë rrugës i pushtonte një nga një fortifikatat e tyre. Fortifikata e parë që pushtoi ishte fortifikata Na'im, në të cilën u vra Mahmud b. Mesleme, kur prej saj mbi të ishte hedhur një gur që e kishte vrarë në vend. Pastaj u pushtua Kamusi, fortifikata e Beni Ebil-Hukajk. Aty Pejgamberi a.s. kapi shumë robër, mes të cilëve ishte edhe Safijja bint Hujejj b. Ahtab – ajo gjendej te Kinane b. Rebi' b. Ebil-Hukajk - dhe dy vajza të xhaxhait të saj. Pejgamberi a.s. e zgjodhi Safijjen për vete.

Dehijje b. Halife Kelbiu e kishte kërkuar nga Pejgamberi a.s. Safijjen për vete, por pasi ai tashmë e kishte zgjedhur për veten e tij, i dha atij dy vajzat e xhaxhait të saj. Robërit e tjerë të Hajberit u shpërndanë në mesin e muslimanëve.

Kështu Pejgamberi a.s. pushtoi numrin më të madh të fortifikatave të tyre dhe ua konfiskoi pjesën më të madhe të pasurisë së tyre. Në fund mbetën vetëm dy fortifikata: Vatih dhe Sulalem, të cilat ishin të fundit që u pushtuan. Ato Pejgamberi a.s. i mbajti të rrethuara më shumë se dhjetë net.

Një hebre me emrin Merhab kishte dalë nga fortifikimet e tyre duke mbajtur me vete të gjitha armët e tyre. Ai duke shkuar kishte kënduar këtë poezi në rexhez<sup>159</sup>:

*Hajberi e di mirë që unë jam Merhabi,  
me armët e mprehta përkryer, hero i provuar!  
Ndonjëherë shpoj, e ndonjëherë edhe godas,  
kur më vërsulet luani i zemëruar!  
Dhe atij që mbroj unë, nuk e lë për t'iu afruar!*

Pastaj ai tha: "Kush më del në dyluftim?" Atij iu përgjigj Ka'b b. Maliku:

*Hajberi e di mirë, që unë jam Ka'bi vetë,  
i qëndrueshëm, i guximshëm, i cili i largon shqetësimet!  
Kur e filloj një luftë, atë e pason një tjetër luftë,*

<sup>158</sup> Sahba është vendi ku ndërmjet saj dhe Hajberit gjendet Revha.

<sup>159</sup> Rexhez, masë krijimtarie poetike.

*me vete kam një shpatë, që si rrufe pret shpejt!  
Do t'ju shkelim ju, që zemërimin ta shfryjmë,  
do ta japim shpërblimin ose plaçkën do ta kthejmë,  
sepse shmangia nga e kaluara ndonjë mëkat nuk është!*

Atëherë Pejgamberi a.s. pyeti: *"Kush është i gatshëm për këtë?"*

Muhammed b. Mesleme tha: *"Unë jam për atë, jam i zemëruar dhe i tensionuar sepse dje më është vrarë vëllai im!"*

Pejgamberi a.s. tha: *"Dil para tij! O Allah, ndihmoje atë kundër tij!"*

Kur iu afruan njëri-tjetrit, midis tyre gjendej një dru i vjetër<sup>160</sup> dhe ata të dy mbroheshin me të. Sa herë që njëri prej tyre strehohej pas tij, ky tjetri me shpatë i priste disa degë, ashtu që së shpejti trangu mes tyre mbeti si një njeri, pa asnjë degë në të. Merhabi pastaj me forcë iu vërsul Muhammed b. Meslemes dhe arriti ta godiste, por ky u mbrojt me mburojën e tij prej lëkure, në të cilën iu ngatërrua shpata e tij dhe aty mbeti. Atëherë e goditi Muhammed b. Mesleme dhe e vrau.

Pas Merhabit doli vëllai i tij Jasiri, i cili gjithashtu pyeti se kush mund t'i dilte në dyluftim. Hisham b. Urve pohon se para tij doli Zubejr b. Avvam dhe me atë rast nëna e tij Safijje bint Abdulmuttalib kishte thënë: *"Do të më vritet djali, o i Dërguari i Allahu!"*

Kurse Pejgamberi a.s. i përgjigjet: *"Përkundrazi, djali yt do ta vrasë, nëse do Allahu!"* Kur ata të dy u ndeshën, me të vërtetë Zubejri e vrau atë.

Nga Seleme b. Amër b. Ekvea transmetohet si vijon:

*"Pejgamberi a.s. në disa fortifikata hebreje së pari me flamurin e tij dërgoi Ebu Bekër Siddikun dhe ai pas betejës i shteruar u kthye përsëri pa sukses. Pastaj, ditën tjetër, dërgoi Omer b. Hattabin, por edhe ai, pas një lufte të gjatë, i dërmuar u kthye pa arritur gjë. Atëherë Pejgamberi a.s. tha: "Nesër me siguri flamurin do t'ia jap një njeriu i cili e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që nuk do të ikë! Allahu përmes tij do të na japë fitoren!" Pastaj Pejgamberi a.s. thirri Ali b. Ebi Talibin, i cili kishte syrin e sëmurë. Ia bëri pak me pështymë, pastaj i tha: "Merre këtë flamur dhe mbaje derisa Allahu të të japë ndihmën e Tij!"*

Seleme thotë:

*"Ai u nis, vallahi, duke fryrë nga forca dhe me shumë nxitim, ndërsa ne i ndiqnim gjurmët e tij. Pastaj flamurin e nguli në një grumbull gurësh nga të cilët ishte ndërtuar fortifikata. Atë nga maja e fortifikatës e pa një hebre, i cili e pyeti: "Kush je ti?" Tha: "Unë jam Ali b. Ebi Talibi." Hebreu tha: "Jeni ngritur, por kjo nuk i ka zbritur Musait!"*

Vërtet, Aliu nuk u kthye pa na e dhënë Allahu fitoren përmes tij."

<sup>160</sup> Druri ushar, një dru që ka trangun të lëmuar e degët të dobëta.

Pejgamberi a.s., siç u theksua më herët, i mbajti nën rrethim dy fortifikatat e tyre Vatih dhe Sulalem. Së fundi, kur tashmë ata e kishin të qartë se do të shkatërroheshin, kërkuan prej tij që t'ua kursente jetën dhe t'i dëbonte nga vendi i tyre, gjë që ai e pranoi. Ai ua kishte konfiskuar tërë pasuritë nga të gjitha fortesat e tyre: Shekka, Natate, Ketibe e të tjerat dhe kishin mbetur vetëm ato dyja. Kur dëgjuan banorët e Fedekut se ata kishin vepruar në këtë mënyrë, ata i dërguan një mesazh Pejgamberit a.s. dhe i kërkuan që t'ua kursente jetën dhe t'i dëbonte nga vendi, ndërsa ata si kundërshtpërblim do t'i linin të gjitha pronat e tyre. Ai ashtu veproi.

Në mesin e delegacionit që ndërmjetësoi në negociata ishte edhe Muhajsa b. Mesud, vëllai i Benu Harithes. Kur banorët e Hajberit patën këtë ide dhe ia propozuan Pejgamberit a.s., ata nga Pejgamberi a.s. kërkuan që t'ua përgjysmonte pasurinë. Ata thanë: "Ne e njohim atë më mirë se ju dhe jemi në kontakt me të prej më shumë kohe." Pejgamberi a.s. ra dakord për përgjysmim, por me kusht që *"nëse vendosim për t'ju përzënë, ne do t'ju përzëmë!"*

Një marrëveshje e ngjashme është bërë edhe me banorët e Fedekut. Hajberi i tëri u shndërrua në pronë të përgjithshme të muslimanëve, ndërsa Fedeku i përkiste ekskluzivisht vetëm Pejgamberit a.s. sepse muslimanët nuk i kishin angazhuar as kuajt dhe as devetë e tyre.

Kur situata u stabilizua plotësisht dhe Pejgamberi a.s. ishte i sigurt nga ndonjë befasi nga ana e banorëve të Hajberit, Zejnebja bija e Harithit, gruaja e Sel-lam b. Mushkemit, i solli si dhuratë një dele të pjekur. Para kësaj kishte pyetur: "Cila pjesë e mishit i pëlqen më së tepërmi Pejgamberit a.s.?" I thanë: "Shpatulla." Ajo e mbushi atë me helm, por e helmoi edhe tërë mishin tjetër. Kur ia dorëzoi, Pejgamberi a.s. e shkëputi shpatullën dhe kafshoi një kafshatë prej saj. Ende pa filluar ta përtypte, ndjeu një shije të hidhur dhe menjëherë e nxori nga goja. Me të ishte edhe Bishr b. Bera' b. Ma'rur, i cili gjithashtu nga ajo shpatull mori një kafshatë, por ai e kishte gëlltitur, ndërsa Pejgamberi a.s. kafshatën e tij e kishte vjellë.

Ai pastaj kishte thënë: *"Ky asht më flet mua se ky mish është i helmuar."* Pastaj Pejgamberi a.s. e thirri Zejneben dhe e pyeti për këtë dhe ajo e pranoi. Ai e pyeti: *"Çfarë të shtyu të veprosh kështu?"*

Ajo u përgjigj: "Ti e di mirë se çfarë të ka bërë populli im. Mendova se nëse është mbret, do të lirohem prej tij, e nëse është Pejgamber, do të jetë i informuar (që të mos hajë)!" Pejgamberi a.s. e fali, ndërsa Bishri, i cili e hëngri një kafshatë nga mishi i helmuar, vdiq.

Pas përfundimit të ekspeditës së Hajberit, Pejgamberi a.s. shkoi deri në vendin Vadil-Kura, ku banorët e tij i mbajti disa net të rrethuar, pastaj u kthye në Medinë.

Kur Pejgamberi a.s. u martua me Safijjen, ishte në Hajber ose diku rrugës për në Medinë, me ç'rast atë e kishte stolitur, e kishte krehur dhe zbukuruar Ummu Sulejm bint Milhan, nëna e Enes b. Malikut. Pejgamberi a.s. e kaloi natën me të në tendë, rreth së cilës tërë natën ishte sjellë Ebu Ejjub Halid b. Zejdi i ngjeshur me shpatë.

Në mëngjes, kur e pa aty, Pejgamberi a.s. e pyeti: *“Çfarë ke ti, o Ebu Ejjub?!”*

Ai u përgjigj: *“O i Dërguari i Allahut, kisha frikë për ty nga kjo grua sepse ia ke vrarë babanë e saj, burrin e saj dhe popullin e saj, gjithashtu ajo vetë deri kohët e fundit ishte në mosbesim. E pra, unë kisha frikë për ty!”*

Pohohet se Pejgamberi a.s. atëherë i tha: *“O Allah, ruaje Ebu Ejjubin siç më ruajti ai mua gjithë natën!”*

Duke shkuar nga Hajberi në Medinë, diku rrugës, nga fundi i natës, Pejgamberi a.s. pyeti: *“Kush do të kujdeset për agimin, që ne të flemë pak?”*

Bilali tha: *“Unë, o i Dërguari i Allahut, do të kujdesem për të!”*

Pastaj ata ndaluan dhe së shpejti të gjithë fjetën. Bilali u ngrit dhe fali namaz një kohë të gjatë, pastaj u mbështet te deveja e tij duke e pritur agimin, por syri e mashtrou dhe e kaploi gjumi. U zgjuan vetëm nga rrezet e diellit.

I pari që u zgjua ishte Pejgamberi a.s., i cili me atë rast tha: *“Çfarë bëre me ne o Bilal?!”*

Bilali u përgjigj: *“O i Dërguari i Allahut, më mori ai që të mori edhe ty!”*

Pejgamberi a.s. tha: *“Ashtu është!”* Pastaj Pejgamberi a.s. e mori devenë e tij, e largoi pak nga aty dhe e urdhëroi që të bjerë në gjunjë. Aty, së bashku me njerëzit e tjerë, mori abdest dhe e urdhëroi Bilalin që të këndonte ikametin dhe së bashku falën namazin. Së fundi, pasi dha selam, u kthye nga ata dhe u tha:

*“Nëse e harroni namazin, faleni kur t’ju kujtohet, sepse Allahu i Madhërishëm thotë: “... dhe fale namazin për të më kujtuar Mua.” (Taha, 14)*

Kur Pejgamberi a.s. e pushtoi Hajberin, me sa di unë, të gjitha pulat apo kafshët shtëpiake ia dha Ibn Lukajm Absiut.

Pushtimi i Hajberit ndodhi në muajin safer.

Ibn Lukajm Absiu për Hajberin kishte thurur vargjet e mëposhtme:

*Netati u godit nga Pejgamberi me ushtri të bardhë,  
të madhe, të gjerë dhe të fortë.*

*Dhe ata e kuptuan, kur u thyen, se i kaploi pushtimi,  
sepse në mes të tyre i gjetën njerëzit nga Gifari dhe Eslemi!*

*Benu Amër b. Zur'an në mëngjes u dëbuan me forcë të përfshirë,  
kështu që atyre në Shekk, në mes të ditës iu bë errësirë!*

*I tërhoqën zvarrë bishtat, nëpër tokën e rrafshët,  
i lanë vetëm pulat që në mëngjes të krrokasin.*

*Kalorësia u përkujdes për secilën fortifikatë,  
qoftë nga Abdi Esh'heli ose nga Beni Nexhxhar.  
Muhaxhirët u shquan me tipare e shenja,  
ndërsa për të ikur as që u shkonte mendja!  
Unë e kuptova, me siguri fitorja është e Muhamedit,  
dhe aty do të qëndrojnë deri në muajin e saferit.  
Hebrenjtë atë ditë ikën me sy të zgurdulluar,  
nën britmën e tmerrshme, e cila shkaktoi rrëmuje!*

## ARDHJA E XHAFER B. EBI TALIBIT NGA ABISINIA DHE ADRESIMI I TIJ MUHAXHIRËVE

Ibni Hishami thotë:

“Transmetohet nga Sha’biu se Xhafer b. Ebi Talibi erdhi te Pejgamberi a.s. në ditën e pushtimit të Hajberit dhe Pejgamberi a.s. e puthi në mes të syve, e përqafoi dhe tha: *“Nuk e di, a të gëzohem për fitoren e Hajberit apo për ardhjen e Xhaferit?!”*

Ibni Is'haku thotë:

“Sahabët e Pejgamberit a.s., të cilët qëndruan në Abisini deri në kohën kur Nexhashiu e dërgoi Amër b. Umejje Damriun, i cili i ngarkoi me dy anije dhe i ktheu përsëri në kohën kur Pejgamberi a.s. ishte në Hajber, pas Hudejbijes, janë:

- *Nga Benu Hashim b. Abdi Menaf*: Xhafer b. Ebi Talib b. Abdulmuttalib, me të ishte edhe gruaja e tij Esmā bintu Umejs Hath'amijje, pastaj biri i tij Abdullah b. Xhaferi, i cili kishte lindur në Abisini.

- *Nga Benu Abdi Shems b. Abdi Menaf*: Halid b. Seid b. As b. Umejje b. Abdi Shems, me të ishte edhe gruaja e tij Emine bint Halef b. Es'ad dhe dy fëmijët e tyre - Seid b. Halid dhe Emme bint Halid, të dy të lindur në Abisini, pastaj vëllai i tij Amër b. Seid b. As, Mu'ajkajb b. Ebi Fatime, i cili te Omer b. Hattabi ishte në krye të buxhetit të shtetit dhe Ebu Musa Esh'ariu.

- *Nga Benu Esed Abduluzza*: Esved b. Nufel b. Huvejlid.

- *Nga Benu Abdud-Dar b. Kusaj*: Xhehm b. Kajs.

- *Nga Benu Zuhre b. Kilab*: Amir b. Ebi Vekkas as dhe Utbe b. Mesud.

- *Nga Benu Temim b. Murr*: Harith b. Halid b. Sahr.

- *Nga Benu Xhumeh b. Amër*: Osman b. Rebia b. Ehban.

- *Nga Benu Sehm b. Amër*: Mahmije b. Xhez'.

- *Nga Benu Adij b. Ka'b*: Me'amer b. Abdullah b. Nadle.

- *Nga Benu Amir b. Luejj*: Ebu Hatib b. Amër dhe Malik b. Rebia.

- *Nga Benu Harith b. Fihir b. Malik*: Harith b. Abdi Kajs b. Lukajt.

Në ato dy anije ishin edhe gratë e atyre muslimanëve që kishin vdekur atje.

Këta pra janë ata të cilët Nexhashiu i hipi në anije me Amër b. Umejje Damriun. Numri i përgjithshëm i tyre ishte 16 burra, ndërsa numri i përgjithshëm i atyre që munguan në Bedër dhe nuk shkuan te Pejgamberi a.s. në Mekë, por erdhën më vonë atje, përveç këtyre dy anijeve të Nexhashiut, ka qenë 34 burra.

## UMRA SUPLEMENTARE (Dhul-kade, viti i 7 h.)

Pas kthimit nga Hajberi, Pejgamberi a.s. në Medinë kaloi këta muaj: rebiul-evvel, rebiul-ahir, xhumadel-ula, xhumadel-ahire, rexheb, shaban, ramazan dhe shevval. Gjatë kësaj kohe ai dërgoi aty-këtu ndonjë çetë dhe ndërmoi disa aktivitete luftarake.

Pastaj në muajin dhul-kade, në të njëjtin muaj në të cilin një vit më parë idhujtarët e penguan për ta kryer umren që pati për qëllim, ai u nis tani për ta kryer atë. Me të u nisën edhe të gjithë ata që vitin e kaluar bashkë me të u kthyen. Kjo ishte në vitin e shtatë të hixhretit.

Kur dëgjuan për ardhjen e tyre, mekasit u zhvendosën nga qyteti dhe në mesin e Kurejshëve qarkullonin thashethemet se Muhamedi dhe shokët i kishte kapluar mundimi, lodhja dhe fatkeqësia.

Ibni Abbasi thotë:

“Ata u patën rreshtuar para Asamblesë së tyre (Darun-Nedve), në mënyrë që ta shikojnë atë dhe njerëzit e tij. Kur Pejgamberi a.s. hyri në kompleksin e Qabesë, e lëshoi rrobën e tij nën sqetullën e tij të djathtë, ndërsa skajin tjetër e hodhi mbi krahun e majtë, në mënyrë që njëri krah i tij të ishte i zbuluar, pastaj tha: *“Allahu e mëshiroftë njeriun i cili sot u tregon atyre forcën e tij!”* Pastaj e preku këndin e Qabesë me Gurin e Zi, pastaj me hapa të shpejtë u nis të sillej duke u ndjekur nga shokët e tij. Kur Qabeja u mbulua prej tyre dhe ai e preku këndin e saj jugor, i ngadalësoi hapat dhe eci ngadalë derisa arriti në këndin e zi. Aty ai përsëri filloi të shpejtojë dhe kështu u soll tri herë (tavaf). Pjesën tjetër të tavafit e bëri me ritëm të ngadaltë.”

Gjithashtu transmetohet prej tij se Pejgamberi a.s. gjatë atij udhëtimiti u martua me Mejmune bint Harith, derisa ishte ende i veshur me ihram. Me të e martoi Abbas b. Abdulmuttalibi.

Pejgamberi a.s. në Mekë qëndroi tri ditë. Në ditën e tretë erdhi Huvejtib b. Abduluzza, me një grup të cilin Kurejshët e kishin autorizuar për ta nxjerrë nga Meka dhe i thanë: “Të ka mbaruar koha<sup>161</sup>, ndaj largohu tani nga ne!”

Pejgamberi a.s. tha: *“Pse nuk po më lejoni që këtu në mesin tuaj të bëj dasmën time, ta përgatis gostinë dhe t’ju ftoj edhe ju në të?!”*

Ata u përgjigjën: “Ne nuk kemi nevojë për ushqimin tënd, largohu nga ne!”

<sup>161</sup> Koha për të cilën ishin dakorduar në Marrëveshjen e Hudejbijes, e cila ishte tri ditë.

Pejgamberi a.s. shkoi, ndërsa kujdesin për Mejmunën ia besoi Ebu Rafi'ut, i cili e çoi deri në Seref<sup>162</sup>. Aty pastaj e mori Pejgamberi a.s. dhe shkoi në Medinë.

Ibni Hishami thotë:

"Siç më ka treguar Ebu Ubejde, Allahu i Madhërishëm atëherë ka zbritur këtë ajet:

*"Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet: se me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të siguruar, të rruani flokët e kokave tuaja, t'i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit, para kësaj ju dha një fitore të shpejtë (Hajberin)."* (El-Fet'h, 27)

<sup>162</sup> Seref, një vend afër Ten'imit.

**BETEJA E MU'TES<sup>163</sup>**  
**(Xhumadel-ula, viti i 8 h.)**

Pejgamberi a.s. në Medinë kaloi pjesën tjetër të muajit dhul-hixhxe, duke i lënë idhujtarët që ta kryenin haxhin këtë vit, pastaj edhe muajin muharrem, safer, rebiul-evvel, rebiul-ahir, ndërsa në muajin xhumadel-ula dërgoi një ushtri për në Siri, e cila në Mu'te pësoi humbje të konsiderueshme. Në krye të kësaj ushtrie caktoi Zejd b. Harithen dhe me këtë rast tha: *“Po qe se bie dëshmor Zejdi, komandën ta marrë Xhaferi. Po qe se bie dëshmor Xhaferi, komandën ta marrë Abdullah b. Revaha!”*

Njerëzit menjëherë filluan të përgatiten për nisje. Numri i tyre arriti në tre mijë. Pak para nisjes njerëzit dolën për t'i përcjellë dhe për t'i përshëndetur komandantët e Pejgamberit a.s.. Gjatë kësaj lamtumire, Abdullah b. Revaha qau. Ata e pyetën: *“Pse po qan, o Ibn Revaha!”* Ai tha: *“Unë nuk po qaj pse e dua shumë jetën e kësaj bote apo se më dhimbset t'ju lë ju, por unë e dëgjova Pejgamberin a.s. duke lexuar një ajet nga Kur'ani, në të cilin përmendet xhehenemi:*

*“Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t'i afrohet atij. Ky (kontaktim i xhehenemit) është vendim i kryer i Zotit tënd.”* (Merjem, 71)

E unë nuk e di se si do të largohem nga xhehenemi pasi t'i jem afruar?”

Muslimanët u uruan të gjithëve rrugë të mbarë duke thënë: *“Ju ndjekë fati i Allahut, Allahu ju mbrojtë dhe u kthefshi shëndosh e mirë!”*

Abdullah b. Revaha iu përgjigj me disa vargje, me të cilat e luti Allahun e Madhërisëm që me mirësinë e Tij t'ia falte mëkatet dhe që gjatë luftës të pastrohej llumi që do të dilte në sipërfaqe porsì shkuma (në ujë apo në gjak). Dhe u lut që nëse vritej, të vritej në mënyrë dinjitoze, si shehid, që kalimtarët pranë varrit të tij ta dinin se ka qenë shehid në rrugën e Allahut.

Pastaj ata dolën dhe me ta ishte edhe Pejgamberi a.s.. Pasi i përcolli, Abdullah b. Revaha tha:

*Paqja mbetet pas atyre, të cilët i përcolle  
nën një palmë Ti, ushqyesi dhe miku më i mirë!*

Pastaj ata marshuan derisa arritën në Mean, territor i Sirisë, ku dëgjuan se Herakleu kishte zbarkuar me një qind mijë ushtarë bizantinas në Meab, në krahinën Belka', dhe se atij i ishin bashkuar edhe njëqind mijë njerëz të tjerë nga Lahmi, Xhudhami, Kajni, Behraja dhe Belijja<sup>164</sup>, me në krye një njeri nga Belijja dhe një tjetër nga fisi Irash i quajtur Malik b. Rafile. Kur dëgjuan për këtë, muslimanët

<sup>163</sup> Mu'te, një fshat në territorin Belka', në Siri.

<sup>164</sup> Lahmi, Xhudhami, Kajni, Behraja dhe Belijja janë emra fisesh.

dy net i kaluan në Mean duke menduar dhe duke u konsultuar se çfarë duhet të bënin. Më në fund vendosën. “Do t’i shkruajmë Pejgamberit a.s. dhe do ta informojmë për numrin e armikut tonë dhe ose të na dërgojë ende njerëz ose të na urdhërojnë se çfarë të bëjmë. Ne do të veprojmë sipas urdhrat të tij.”

Mirëpo Abdullah b. Revaha i inkurajoi dhe i trimëroi njerëzit duke u thënë: “O popull! Vallahi, tani nuk mund ta urreni atë që vetë e keni dëshiruar. Keni dashur të bëheni shëhidë, kurse ne nuk do të luftojmë me ndihmën e masave, të fuqisë apo të numrit. Ne do të luftojmë me fuqinë e fesë sonë, me të cilën na ka shpërblyer Allahu. Të nisemi pra! Nuk do të jemi të privuar nga njëra prej dy të mirave: ose fitore, ose shëhidllëk (vdekje në rrugën e Allahut).”

Njerëzit thanë: “Vallahi, mirë po thotë Ibnu Revaha!”

Pastaj, njerëzit e vazhduan rrugën dhe kur u gjendën në zonat kufitare të Belka’s, në një fshat të quajtur Mesharif, ua zuri rrugën armata e Herakleut, e cila ishte e përbërë nga bizantinët dhe arabët. Muslimanët ishin vendosur në një fshat të quajtur Mu'te dhe aty u takuan dy ushtritë. Muslimanët u pozicionuan në atë mënyrë që anën e djathtë ia besuan një njeriu nga fisi Beni Udhre me emrin Kutbe b. Katade, ndërsa në anën e majtë një ensari të quajtur Abaje b. Malik.

Në atë moment filluan luftën. Zejd b. Harithe duke mbajtur flamurin e Pejgamberit a.s. luftoi derisa u përgjak nga goditjet e shigjetave të armikut dhe vdiq.

Pastaj flamurin e mori Xhaferi. Ai luftoi me të derisa u ngatërrua dhe u gjend në një situatë ku nuk mund të shpëtonte, ndaj kërcëu nga kali i tij dori, duke krasitur me shpatë, dhe pastaj vazhdoi të luftojë derisa u vra duke recituar vargje:

*Sa i bukur që je, o xhenet, dhe sa e këndshme  
që është pija jote e ftohtë dhe afërsia jote!  
Bizantinëve vuajtja po u afrohet, ata janë jobesimtarë,  
larg qoftë nga unë origjina e tyre!  
Sa herë që të takohem me ta, do t’i godas!*

Ibni Hishami thotë:

"Më kanë thënë njerëz të ditur, të cilëve u besoj plotësisht, se Xhafer b. Ebi Talibi e mori flamurin me dorën e djathtë. Kur ia prenë atë, atëherë e mori me të majtën, por kur ia prenë edhe atë, pastaj e kapi me parallëren gjersa ra i vvarë. Allahu qoftë i kënaqur me të. Ai ishte 33 vjeç. Allahu e ka shpërblyer atë me krahë në xhenet, në mënyrë që të mund të fluturojë nga të dojë. Tregohet se ka vvarë një bizantinas duke e ndarë më dysh."

Ibni Is'haku thotë:

"Pasi u vra Xhaferi, flamurin islam e mori Abdullah b. Revaha. Ai doli përpara duke kalëruar, u hamend pak e pastaj u vërsul përpara duke recituar vargje:

*Ia kam dhënë besën vetes se do ta flijoj vetveten,  
e ka dashur këtë shpirti im apo e ka urryer.  
Kur njerëzit vërsulen dhe gjëmojnë ashpër e bërtasin,  
ç'është puna e shpirtit, a mos vallë nuk ia ka ënda xhenetin?!  
U bë gjatë (o shpirti im), që ti qëndrove i qetë,  
po a ishe gjë tjetër vetëm se një pikë e pavlerë!?*

Dhe gjithashtu ka thënë:

*O shpirt, edhe nëse nuk vritesh, ti përsëri do të vdesësh,  
por në atë vdekje në zjarr do të digjesh!  
Çdo gjë që ke dashur, ja ty të është dhuruar,  
për të bërë të mirën dhe të keqen, të është treguar!*

Pastaj zbriti nga kali. Në atë moment erdhi djali i xhaxhait të tij me një asht me pak mish të pjekur dhe i tha: "Forcohu pak sepse këto ditë çdo gjë të ka rënë mbi kokë!" Ai ia mori mishin nga dora, e kafshoi një herë, pastaj dëgjoi potere dhe rrëmujë nga ana e njerëzve dhe tha: "Kurse ti këtu në këtë botë?!" E hodhi ashtin, e rrëmbeu shpatën dhe filloi të vriste përreth vetes derisa u vra edhe vetë.

Flamurin pastaj e mori Thabit b. Akrem, nga fisi Beni Axhlan, i cili tha: "O muslimanë, merrni vesh dhe zgjidhni njërin nga ju që t'ju udhëheqë." Ata thanë: "Ti". Ai u përgjigj: "Nuk mund ta bëj këtë." Atëherë zgjodhën Halid b. Velidin. Kur e mori flamurin, e mbrapsi armikun pastaj u nda prej tij dhe u tërhoq me njerëzit e tij.

Kur ndodhi kjo, siç kam dëgjuar, Pejgamberi a.s. tha: "*Flamurin e mori Zejd b. Harithe, me të në dorë ai luftoi derisa ra shehid. Pastaj atë e mori Xhaferi, edhe ai luftoi me të në dorë derisa u vra si shehid!*" Pastaj Pejgamberi a.s. heshti, ndërsa ensarëve i ndryshoi çehryja. Ata menduan se ndoshta Abdullah b. Revaha mund të kishte pasur me vete diçka që ata nuk do të ishin të kënaqur.

Pastaj vazhdoi: "*Pastaj e mori (flamurin) Abdullah b. Revaha, edhe ai luftoi me të derisa ra si shehid.*"

Pastaj përsëri tha: "*Të gjithë në ëndërr më janë treguar se si janë ngritur në xhenet, mbi shtretër prej ari. Në krevatin e Abdullah b. Revahës vura re një shtrembërim dhe lakim në krahasim me krevatet e dy shokëve të tij!*" Unë thashë: "*Pse është kjo kështu?*" Më thanë mua: "*Ata hynë menjëherë në luftë, ndërsa Abdullahu së pari hezitoi pak e pastaj hyri në luftë!*"

Kur Halidi u tërhoq me njerëzit, mori rrugën për kthim. Afër Medinës u takuan me Pejgamberin a.s. dhe me muslimanët, ndërsa fëmijët duke vrapuar u dilnin përpara.

Pejgamberi a.s., i cili me njerëzit erdhi duke kalëruar, tha: "*Merrni fëmijët, kurse mua më sillni djalin e Xhaferit.*" Ata pastaj ia sollën Abdullah b. Xhaferin dhe ai e barti me duart e veta.

Duke kaluar ushtria njerëzit u hidhnin pluhur dhe i thërrisnin: “O dezertorë! Keni ikur nga rruga e Allahut!”

Ndërsa Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Ata nuk janë dezertorë, por janë të kthyer, nëse do Allahu!”*

Ndër ata që vajtoi për sahabët e Pejgamberit a.s., të cilët kishin rënë shëhidë në betejën e Mu'tes, ishte edhe poeti Hassan b. Thabit, i cili u kushtoi një poezi.

## ÇLIRIMI I MEKËS (Ramazan, viti 8 h.)

Pasi e dërgoi ushtrinë e tij në Mu'te, Pejgamberi a.s. në Medinë kaloi muajt xhumadel-ahire dhe rexheb. Në atë kohë fisi Beni Bekër b. Abdu Menat b. Kenan sulmoi fisin Huza'a. Shkas për këtë ishte se një njeri nga fisi Beni Hadremi, i quajtur Malik b. Ubad - atëherë fisi Hadremi ishte aleat me Esved b. Rezn – kish-te dalë për tregti dhe kur ishte diku në mes të territorit të fisit Huza'a, këta e kishin sulmuar, e kishin vrarë dhe ia kishin marrë çdo gjë që kishte pasur me vete. Atëherë Beni Bekri sulmojnë një njeri nga Huza'a dhe e vrasin. Pastaj fisi Huza'a para hyrjes së tyre në Islam sulmojnë tre anëtarë të fisit Beni Esved b. Rezn Diliu, ata ishin: Selma, Kulthumi dhe Dhuejbi, dhe i vrasin te vendi që simbolizonte hyrjen në zonën e mbrojtur – Harem (Ensabul-Harem).

Derisa Benu Bekri dhe Huza'a ishin në këtë situatë, në mes tyre ndërhyri Islami dhe ata u angazhuan rreth tij. Kur u arrit marrëveshja e paqes në Hudejbije ndërmjet Pejgamberit a.s. dhe Kurejshëve, një nga kushtet e ndërsjella ishte që kush dëshironte të hynte në aleancë me Pejgamberin a.s. dhe të nënshkruante kontratë me të, mund ta bënte këtë dhe po ashtu kush dëshironte të hynte në aleancë me Kurejshët dhe të nënshkruante kontratë me të, mund ta bënte këtë. Sipas këtij paragrafi, fisi Beni Bekër hyri në aleancë me Kurejshët, ndërsa fisi Huza'a me Pejgamberin a.s..

Kur ishte armëpushimi, Beni Dili nga fisi Beni Bekër e shfrytëzoi rastin për t'u hakmarrë ndaj Huza'as për ata tre personat që iu patën vrarë fisit Benu Esved b. Rezn.

Me këtë qëllim, kryepari i fisit Beni Bekër, Nufel b. Muavije Diliu, u nis në krye të fisit Beni Dil, ndonëse nuk e pasonte i tërë fisi Benu Bekër. Ata shkuan te fisi Huza'a, të cilët në ato momente ndodheshin te burimi i tyre Vetir dhe aty bujtën. Më pas rrëmbyen një njeri të tyre dhe u tërhoqën në fiset e tyre. Pak më vonë i sulmuan, ku Kurejshët i ndihmuan Beni Bekrit me armë, por edhe disa njerëz të tyre luftuan me ta, duke u strehuar në errësirën e natës.

Kur Huza'an e dëbuan në zonën e mbrojtur të Haremit, atëherë fisi Beni Bekër iu drejtua komandantit të tyre: "O Nufel, kemi dalë në zonën e Haremit, prandaj ruaju Zotit!"

Ai atëherë kishte thënë një fjalë të madhe: "Prej sot nuk ka Zot!<sup>165</sup> O Beni Bekër, merrni hakun tuaj! Pasha jetën time, ju madje kryeni edhe vjedhje në zonën e Haremit, kështu që pse të mos e merrni aty edhe hakun tuaj?!"

<sup>165</sup> Do të thotë "Nuk ka Zot për Nufelin!" Këtë e thotë nga mosbesimi i tij.

Atë natë kur i lejuan që të kalojnë natën pranë burimit Vetir, ua kishin rrëmbyer një njeri të quajtur Munebbih, i cili e kishte zemrën e dobët. Ai kishte dalë jashtë me një nga anëtarët e fisit të vet, njëfarë Temim b. Esedi, i cili kur i sheh këta, i thotë: “O Temim, ti shpëtoje vetveten, sepse unë, vallahi, edhe ashtu jam i vdekur, edhe nëse më vrasin, edhe nëse më lëshojnë, zemra ime tashmë ka pëlcitur!”

Dhe Temimi iku dhe shpëtoi, ndërsa Munebbihun e zunë dhe e vranë.

Fisi Huza'a kur hynë në Mekë, u strehuan në shtëpinë e Budejl b. Verka' dhe te mbrojtësi i tyre i quajtur Rafi'.

Pasi fisi Beni Bekër dhe Kurejshët triumfuan dhe vepruan ndaj tyre atë që vepruan, me çka ata e shkelën marrëveshjen e arritur me Pejgamberin a.s., sepse fisi Huza'a ishte me të dhe aleat i tij, atëherë Amër b. Salim Huza'iu dhe një njeri prej fisit Benu Ka'b shkuan te Pejgamberi a.s. në Medinë duke e përshpejtuar çlirimin e Mekës. Në Medinë e gjeti në xhami duke ndenjtur me njerëzit e vet. Kur hyri në mesxhid, Amri filloi të recitonte këto vargje:

*O Zoti im, unë Muhamedin po e përkujtoj,  
aleatin e gjyshërve dhe të stërgjyshërve tanë.  
Ju ende ishit fëmijë, ndërsa ne ishim njerëz të pjekur  
kur e pranuan Islamin dhe dorën s'e kemi tërhequr.  
Andaj na ndihmo, menjëherë, të udhëzofte Allahu,  
thirri besimtarët, që të na japin krahun!  
Në mes tyre Resuli, me fytyrë si hëna e shtatlartë,  
për vepër turpi ka fytyrë serioze dhe qëndrim të qartë.  
Me një ushtri të madhe si deti ai do të shkojë,  
Kurejshët që thyen premtimin do t'i edukojë!  
Ata e shkelën marrëveshjen e konfirmuar,  
në vendin Keda të Mekës shpëtimin e kërkuan.  
Menduan se për ndihmë askënd nuk do ta thërras,  
e ata janë të dobët dhe nuk kanë ndonjë numër të madh.  
Në Vetir për ta kaluar natën ata ne na lanë,  
por duke bërë ruku e sexhde pastaj na vranë!*

Kur ai mbaroi, Pejgamberi a.s. i tha: “Do të ndihmohesh, o Amër b. Salim!”

Në ato momente Pejgamberit a.s. iu shfaqen retë në qiell, i cili tha: “Me të vërtetë kjo re po paralajmëron ndihmën e Benu Ka'bit!”

Pak më vonë erdhi Budejl b. Verka' me disa njerëz nga fisi Huza'a te Pejgamberi a.s. dhe e informuan për atë çfarë u kishte ndodhur, sidomos theksuan mbështetjen e Kurejshëve ndaj Beni Bekrit kundër tyre.

Pastaj ata u nisën për në Mekë, kurse Pejgamberi a.s. u tha njerëzve: *“Sikur ju do të jeni me Ebu Sufjanin, i cili do të vijë për ta përtërirë marrëveshjen dhe për ta vazhduar afatin e saj.”*

Budejl b. Verka' dhe njerëzit e tij lëvizën në drejtim të Mekës dhe në Usfan<sup>166</sup> takuan Ebu Sufjan b. Harbin, të cilin Kurejshët e kishin dërguar te Pejgamberi a.s. për ta përtërirë marrëveshjen dhe për ta zgjatur afatin sepse u frikësoheshin pasojave për atë që kishin bërë.

Kur e takoi Budejl b. Verka'en, Ebu Sufjani e pyeti: *“Prej nga vjen, o Budejl?”* Sepse dyshoi se ai po vinte nga Pejgamberi a.s.. Budejli u përgjigj: *“Vajta me disa njerëz nga fisi Huza'a në breg të detit dhe në këtë luginë.”*

Ebu Sufjani e pyeti: *“A mos ke qenë ndoshta te Muhamedi?”* Budejli u përgjigj: *“Jo.”* Kur Budejli vazhdoi rrugën për në Mekë, Ebu Sufjani tha: *“Nëse ka qenë në Medinë, me siguri e ka ushqyer devenë e vet me bërthama.”*

Pastaj iu afrua vendit ku kishte pushuar deveja e Budejlit, mori një bajgë, e thërrmoi dhe në të gjeti bërthama e tha: *“Betohem për Allahun se Budejli ka qenë te Muhamedi!”*

Pastaj ai shkoi dhe nuk u ndal derisa arriti te Pejgamberi a.s. në Medinë. Së pari ai u kthye te vajza e tij Ummu Habibe bint Ebu Sufjan dhe kur u ul mbi shtratin e Pejgamberit a.s., ajo e palosi shtratin dhe e ngriti.

Ai e pyeti: *“Oj bija ime, a po i jep përparësi shtratit ndaj meje apo mua ndaj shtratit?”* Ajo u përgjigj: *“Ky është shtrati i Pejgamberit a.s., ndërsa ti je jobesimtar dhe i papastër, ndaj nuk dua që ti të ulesh mbi shtratin e Pejgamberit a.s.”* Ai tha: *“Vallahi, që kur je larguar nga unë të ka goditur e keqja.”*

Ai doli nga e bija dhe vajti te Pejgamberi a.s. për të biseduar me të, por ai kurrësi nuk iu përgjigj. Pastaj vajti tek Ebu Bekri për ta lutur që të fliste me Pejgamberin a.s.. Ebu Bekri iu përgjigj: *“Unë nuk mund ta bëj kurrësi.”*

Pas këtij vajti tek Omer b. Hattabi, edhe me të deshi të fliste, kurse Omeri i tha: *“A mos dëshiron të ndërmjetësoj për ju te Pejgamberi a.s.? Vallahi, edhe sikur të mos kisha asgjë tjetër, përveç një fare të vetme, me të do të luftoja kundër jush.”*

Ebu Sufjani vajti tek Ali b. Ebu Talibi, Allahu qoftë i kënaqur me të, aty ishte edhe Fatimja r.a., bija e Pejgamberit a.s., ndërsa Hasani, djali i tyre, ecte zvarrë mes tyre. Ai tha: *“O Ali, ti je kushëriri im më i afërt, e unë kam ardhur për një punë dhe sigurisht nuk do të kthehem i dëshpëruar ashtu siç kam ardhur. Bëhu ndërmjetësuesi im te Muhamedi.”* Aliu iu përgjigj: *“Mjerë ti, o Ebu Sufjan! Pejgamberi a.s. na ka ndaluar rreptësisht të flasim me të për këtë çështje.”* Ai pastaj iu drejtua Fatimes e tha: *“Oj bija e Muhamedit, a mund ta urdhërosh këtë birin tënd të ndërmjetësorë mes njerëzve, do të bëhet prijës i arabëve gjer në vdekje!”*

<sup>166</sup> Usfan, emri i vendit, dy bujtje larg nga Meka.

Ajo u përgjigj: "Vallahi, biri im është i vogël për të ndërmjetësuar mes njerëzve. Pejgamberit a.s. nuk i duhet kurrfarë ndërmjetësuasi."

Ebu Sufjani përsëri iu drejtua Aliut: "O Ebul-Hasan (baba i Hasanit), gjendem në një situatë shumë të vështirë, më këshillo, çfarë të bëj?"

Aliu iu përgjigj: "Vallahi, unë nuk shoh se çfarë mund të të nxjerrë nga kjo situatë. Ti je kryepar i Beni Kenanit, ngrihu dhe vetë ndërmjetëso te njerëzit e pastaj kthehu në vendin tënd." Ebu Sufjani tha: "A mendon se kjo do të më ndihmojë?" Aliu tha: "Nuk mendoj, vallahi, por nuk besoj se ke rrugëdalje tjetër."

Ebu Sufjani u ngrit dhe vajti në xhami e tha: "O popull, unë kam ndërmjetësuar te njerëzit (për përtëritjen e armëpushimit)." Pastaj i hipi devesë dhe shkoi.

Kur arriti në Mekë, Kurejshët e pyetën: "Çfarë lajmesh na solle?" Ai u përgjigj: "Vajta te Muhamedi dhe i tregova se për çka kisha ardhur, e ai, për Zotin, nuk u përgjigj. Pastaj vajta tek Ibni Ebi Kuhafe (Ebu Bekri), e as tek ai nuk arrita gjë. Pastaj vajta tek Omer b. Hattabi dhe e vëreja se ai ishte armiku ynë më i madh. Më në fund vajta tek Aliu dhe vëreja se ai ishte më i buti (më sjellje të këndshme) prej të gjithëve. Ai më sinjalizoi se ç'duhet bërë dhe unë veprova ashtu. Për Zotin, nuk di nëse do të bëhet diçka nga kjo apo jo."

Ata e pyetën: "E çfarë të këshilloi?"

Ebu Sufjani tha: "Më urdhëroi që të kërkoj mbrojtje nga njerëzit dhe unë e bëra këtë."

Ata e pyetën: "A e lejoi këtë Muhamedi?"

U përgjigj: "Jo!"

Ata thanë: "Mjerë ti, Aliu vetëm është tallur me ty!"

Ai u përgjigj: "Jo, për Zotin, tjetër rrugëdalje nuk pata."

Pejgamberi a.s. tashmë kishte urdhëruar që të bëheshin përgatitjet, edhe familjes së tij i kishte kërkuar që t'ia përgatisnin rrobat e tij.

Kur Ebu Bekri hyri te vajza e tij Aishja r.a., e gjeti duke përgatitur disa gjëra të Pejgamberit a.s. dhe e pyeti: "Oj bija ime, a Pejgamberi a.s. ju ka urdhëruar për t'u përgatitur?"

Ajo u përgjigj: "Po, përgatitu edhe ti!"

Ai tha: "Çfarë mendon, ku do të shkojë?"

Ajo u përgjigj: "Asgjë nuk di, vallahi!"

Pejgamberi a.s. i njoftoi njerëzit se do të shkojë për në Mekë dhe nënvizoi që këtë ta kuptojnë shumë seriozisht dhe të përgatiten mirë. Në fund iu drejtua Allahut me dua: "O Allahu im, mos lejo që Kurejshët të dëgjojnë dhe të shohin diçka gjersa t'i befasojmë në vendin e tyre!"

Dhe njerëzit u përgatitën.

Megjithatë, derisa Pejgamberi a.s. bënte përgatitjet e fundit për nisjen drejt Mekës, Hatib b. Ebu Belte' u dërgoi një letër Kurejshëve, në të cilën i lajmëronte për marshimin e Pejgamberit a.s. drejt tyre. Letrën ia dha një gruaje dhe i premtoi shpërbllim nëse ua dërgonte Kurejshëve. Ajo letrën e vendosi në flokë dhe mbi të thuri gërsheta, pastaj u nis.

Për këtë veprim të Hatibit, Pejgamberi a.s. u informua përmes shpalljes. Ai menjëherë e ftoi Ali b. Ebi Talibin dhe Zubejr b. Avvamin r.a. dhe u tha: *“Shkoni dhe arrijeni një grua rrugës për në Mekë! Asaj Hatib b. Ebi Belte' i ka dhënë një letër për Kurejshët, në të cilën i paralajmëron ata për planin tonë!”*

Këta kalëruan dhe u nisën. Atë e arritën te një tokë e punuar, e cila ishte e Beni Ebi Ahmedit, dhe e urdhëruan që të zbriste nga deveja. Kontrolluan mirë gjithçka që ishte në kafshë dhe kur nuk gjetën asgjë, Ali b. Ebi Talibi i tha asaj: *“Betohem me Allahun, se Pejgamberi a.s. ka thënë të vërtetën, ndaj ne nuk të akuzoam pa arsye. Vallahi, ose do ta nxjerrësh letrën ose ne do të të kontrollojmë!”*

Kur e pa se me këta nuk bëhej shaka, tha: *“Largohuni!”* Këta u larguan, kurse ajo e shturi bishtalecin dhe e nxori letrën, të cilën ia dorëzoi Aliut, kurse ky ia solli Pejgamberit a.s..

Pejgamberi a.s. pastaj dërgoi dhe e thirri Hatibin, të cilin e pyeti: *“Pse e ke bërë këtë, o Hatib?”*

Ai u përgjigj: *“Vallahi, unë e besoj Allahun dhe Pejgamberin e Tij. Nuk kam dezertuar nga Islami, as që kam ndërruar fenë. Unë jam këtu në mesin tuaj i vetëm, nuk i kam këtu as rrënjët e mia e as familjen, kurse atje tek ata është familja ime, fëmijët e mi. Për këtë arsye desha t'u bëj lajka!”*

Omer b. Hattabi atëherë tha: *“Më lejo, o Pejgamber i Allahut, t'ia heq kokën, se ky qenka bërë munafik.”*

Pejgamberi a.s. tha: *“Ku e di ti, o Omer, ai është pjesëmarrës i Bedrit dhe Allahu i ka ditur mirë pjesëmarrësit e Bedrit, kur ka thënë: “Veproni si të doni, Unë jua kam falur!”*

Për rastin e Hatibit, Allahu i Madhërisëm ka shpallur:

*“O ju që besuat, nëse keni dalë (prej vendlindjes) për hir të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që u erdhi juve. Ata e dëbojnë të Dërguarin dhe ju sepse i besoni Allahut, Zotit tuaj, e ju fshehurazi u ofroni miqësi, por Unë më së miri e di atë që e keni fshehur dhe atë që e keni publikuar. Ai që punon ashtu nga pala juaj, ai e ka humbur rrugën e drejtë.”*

*Nëse ata ia dalin t'ju mundin, ata do të jenë armiq tuaj, do të zgjasin duart e veta dhe gjuhët e veta kundër jush, duke ju përbuzur, sepse ata dëshironin të mos besonit.*

*Në Ditën e Kiametit, Allahu gjykon mes jush, e nuk do t'ju bëjnë dobi as të afërmit tuaj e as fëmijët tuaj. Allahu sheh atë që punoni.*

*Ju e keni shembullin më të mirë tek Ibrahimimi dhe ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuroni, pos Allahut, nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm Allahun një!"* (El-Mumtehine, 1 - 4), dhe më tutje deri në fund të tregimit.

Pejgamberi a.s. pastaj e vazhdoi rrugën e tij, kurse guvernator të Medinës caktoi Ebu Ruhm Giffariun. Ai u nis më 10 ramazan, kështu që agjëronte edhe ai edhe ata që ishin me të. Iftarin e bënë kur mbërritën në Kudejdu, mes Usfanit dhe Emexhit.

Pastaj vazhdoi tutje. Kur zbriti në kanionin Dhahran me dhjetë mijë muslimanë, aty nga fisi Sulejm iu bashkuan edhe 700 njerëz. Disa thonë se kanë qenë 1000, e po aq edhe nga fisi Muzejne. Çdo fis kishte tashmë numër të madh muslimanësh. Me Pejgamberin a.s. u nisën të gjithë muhaxhirët dhe të gjithë ensarët, asnjëri prej tyre nuk mungoi.

Pejgamberi a.s. tashmë ishte në kanionin Dhahran, ndërsa Kurejshët ende nuk dinin asgjë për të e as për synimet e tij.

Në njërën nga ato net, Ebu Sufjan b. Harbi, Hakim b. Hizami dhe Budejl b. Verka' dolën për të dëgjuar përreth në mënyrë që të mësojnë apo dëgjojnë ndonjë lajm.

Ndërkohë, Pejgamberi a.s. gjatë rrugës kishte takuar Abbas b. Abdulmuttalin, kurse në majë të një shkëmbi, në shpatin e një kodre diku në mes Mekës dhe Medinës, tek ai vijnë edhe Ebu Sufjan b. Harb b. Abdulmuttalin dhe Abdullah b. Ebi Umejje b. Mugire dhe i kërkojnë pranim. Pejgamberin a.s. e lajmëroi Ummu Seleme, e cila i tha: "O i Dërguari i Allahut, aty është djali i xhaxhait tënd, djali i tezes sate dhe dhëndri."

Pejgamberi a.s. tha: "Unë nuk kam nevojë për ta! Djali i xhaxhait më ka goditur në nder, kurse djali i tezes dhe dhëndri në Mekë kanë folur gjithçka!"

Kur u përhap lajmi se si reagoi Pejgamberi a.s. për ata të dy, Ebu Sufjani e mori me vete edhe nipin e vogël dhe tha: "Vallahi, ose do të më lejojë të hyjë tek ai, ose unë me këtë nip do të humbim diku larg dhe do vdesim nga uria dhe etja!"

Kur dëgjoji për këtë, Pejgamberit a.s. i erdhi keq për ta dhe i lejoi që të hyjnë. Me atë rast të dy ata e pranuan Islamit.

Përqaftimin e Islamit Ebu Sufjan b. Harithi e ka shprehur me vargje, në të cilat, ndër të tjera, i kërkon falje Pejgamberit a.s. për atë që ka ndodhur më herët. Ai tha:

*Pasha jetën tënde, unë e kam mbajtur flamurin në luftë,  
që kalorësia e Latit, kalorësinë e Muhamedit ta mundë!  
Dhe i hutuar shkoja në natën time të errët,  
unë e gjeta rrugën dhe çasti i udhëzimit më erdh!  
Jashtë vetes sime një udhëzues më ka udhëzuar,  
dhe më bashkoi me Allahun, ai të cilin e kam dëbuar!  
Kam dekurajuar dhe larguar shumë nga Muhamedi,*

*e tash e konsideroj timin, edhe pse nuk e kam origjinën e tij!  
 Ata janë ata të cilët nuk flasin sipas tekave të tyre,  
 edhe pse mirë mënojnë, akuzohen se kanë gënjyer!  
 Unë dua t'i bëj të kënaqur, por nuk u përkulem,  
 atyre me të cilën në çdo gjë nuk pajtohem!  
 Pra, thuaj Thekifit se me të unë nuk dua të luftoj,  
 dhe thuaju atyre, se tjetërkush ata i kërcënoi.  
 Sepse unë nuk isha në ushtrinë që Amirin e mori,  
 as nuk isha që me gjuhë apo me vepër e ndihmoi!  
 E bënë atë fiset e tjera, nga viset e largëta,  
 që erdhën andej nga Surdedi dhe Seham!<sup>167</sup>*

Pohohet se kur e shqiptoi vargun: “Dhe më bashkoi me Allahun, ai të cilin e kam dëbuar!” Pejgamberi a.s. e rrëmbeu Ebu Sufjanin për gjoksi e tha: “Po, ti je ai që më ke përndjekur nga Meka!”

Pra, kur Pejgamberi a.s. zbriti në kanionin Dhahran, atëherë Abbas b. Abdulmutalibi tha: “Të mjerët Kurejshë! Vallahi, nëse Pejgamberi a.s. hyn në Mekë me forcë, para se të vijne dhe të kërkojnë siguri, përfundimisht do të jetë ky fundi i tyre!”

Abbasi ka thënë:

“Hipa në mushkën e bardhë të Pejgamberit a.s. dhe shkova deri në Irak. Kam menduar se mos ndoshta takoj ndonjë druvar, dikë që bart qumësht apo dikë që ka dalë për nevoja të veta, për ta dërguar në Mekë që t’u tregonte atyre se ku gjendej Pejgamberi a.s. dhe t’u thoshte të dilnin dhe t’i ofronin garanci sigurie para se të hynte në Mekë me forcë!”

Ai më tej thotë: “Vallahi, unë shkova hipur duke vëzhguar përreth mos po gjej dikë për çfarë kam dalë, kur papritmas dëgjova bisedën e Ebu Sufjanit dhe Budejl b. Verka’es të cilët po ktheheshin nga vëzhgimi. E dëgjova Ebu Sufjanin duke thënë:

“Kurrë gjer më tani nuk kam parë kaq shumë zjarre të ndezura natën, e as ushtri kaq të madhe”. Budejli tha: “Këta janë Benu Huza’a, të cilët i ka kapluar euforia e luftës!” Ndërsa Ebu Sufjani shtoi: “Nuk janë këta vetëm Huza’a, ata janë në numër më të vogël për të ndezur kaq shumë zjarre.”

Abbasi vazhdon rrëfimin:

“Ia njoha zërin e thashë: “O Ebu Handhaleh (Ebu Sufjan)!” Edhe ai ma njohu zërin e tha: “O Ebul-Fadël, a je ti?” “Po, unë jam”, iu përgjigja. Ai tha: “Çfarë ke, nënë e babë t’u bëfshin kurban?” Unë i thashë: “Vaj halli për ty, o Ebu Sufjan! Ja, ai është Pejgamberi a.s. me ushtrinë e vet. Mëngjesi i zi do të jetë për Kurejshët, va-

<sup>167</sup> Seham dhe Surded, dy vende në territorin e Ukkes.

llahi!" Ai tha: "E çfarë të bëj, pash babën dhe nënën tënde?" I thashë: "Vallahi, nëse të zë, do të ta presë kokën. Por hip në këtë mushkë gjersa të të dërgoj te Pejgamberi a.s. dhe prej tij kërko amnisti." Ai hipi pas meje, kurse dy shokët e tij u kthyen.

Abbasi vazhdon:

"Kalëroja me të dhe kur kalonim afër ndonjë zjarri, muslimanët pyetnin: "Kush është ky?" Kur e shihnin mushkën e Pejgamberit a.s. dhe mua mbi të, përgjigjeshin: "Kushëriri i Pejgamberit a.s. mbi mushkën e tij."

Mirëpo, kur kaluam afër zjarrit të Omer b. Hattabit. Ai pyeti: "Kush është ky?" U ngrit e u afrua dhe kur e pa Ebu Sufjanin prapa meje, bërtiti: "Ebu Sufjani? Armiku i Allahut? Falënderimi i qoftë Allahut që të solli te ne pa kontratë dhe pa fjalën e dhënë."

Ai shpejtoi te Pejgamberi a.s., por unë e nguta mushkën dhe e tejkalova, aq saqë kafsha e ngadaltë e tejkalon njeriun e ngadaltë dhe arrita para tij. Zbrita nga mushka dhe hyra te Pejgamberi a.s. në çadër e pas meje hyri edhe Omeri e tha: "O Pejgamber i Allahut, ja ku është Ebu Sufjani, e solli Allahu te ne pa kontratë dhe pa fjalën e dhënë, më lejo që ta vras."

Abbasi rrëfen:

"Unë thashë: "O Pejgamber i Allahut, unë e kam marrë nën mbrojtjen time." Pastaj u ula pranë Pejgamberi a.s., e përqafova rreth kokës, e thashë: "Vallahi, sonte askush përveç meje nuk do ta marrë në mbrojtje atë", dhe pasi Omeri ishte këmbëngulës për ta vvarë, i thashë: "Ngadalë, o Omer, po që se rastësisht ky do të ishte njëri nga Beni Adijj b. Ka'b, ti nuk do të flisje kështu, por ti mirë e di që ai është nga Beni Abdu Menafi."

Omeri tha: "Ngadalë, o Abbas, se, vallahi, kalimi yt në Islam për mua është më i çmueshëm se Islami i Hattabit, sikur ta pranonte."

Pejgamberi a.s. tha: "*Shko Abbas me të te sendet e tua, e kur të agojë drita sillma përsëri këtu!*"

Unë shkova me të dhe ai bujti tek unë. Kur agoi, ia solla atë Pejgamberit a.s.. Kur e pa Ebu Sufjanin, tha: "*Vaj halli për ty, o Ebu Sufjan, a nuk erdhi koha që edhe ti të kuptosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut?*" Ai tha: "Nënë e babë t'u bëfshin kurban! Nuk ka njeri më bujar, më bamirës dhe më të kujdesshëm se ti. Vallahi kam menduar: Sikur të kishte tjetër zot përveç Allahut, ai gjer tani do të më mbronte."

Pejgamberi a.s. tha: "*Vaj halli për ty, o Ebu Sufjan, a nuk erdhi koha që të kuptosh se unë jam Pejgamber i Allahut?*" Ai tha: "Nënë e babë t'u bëfshin kurban! A ka njeri më bujar, më mirëbërës dhe më të kujdesshëm se ti?" Pastaj tha: "Për sa i përket pejgamberisë tënde, mua ende nuk më është e qartë tërësisht!"

Abbasi i bërtiti: "Mjerë ti, pranoje Islamit dhe dëshmo se nuk ka Zot përveç Allahut dhe se Muhamedi është Pejgamber i Allahut para se të të pritët koka!"

Ebu Sufjani e pranoi Islamit dhe e shqiptoi shehadetin.

Abbasi tha:

"I thashë: O Pejgamber i Allahut, Ebu Sufjani është njeri të cilit ia ka ënda krenarinë dhe sedrën, bëj diçka për të në këtë kuptim!" Pejgamberi a.s. tha: *"Po, ai që në Mekë strehohet në shtëpinë e Ebu Sufjanit, do të jetë i sigurt. Gjithashtu do të jenë të sigurt edhe ata që mbyllën në shtëpitë e veta dhe ata që strehohen në Harem (Qabe)!"*

Kur Ebu Sufjani u nis drejt Mekës, Pejgamberi a.s. tha: *"O Abbas, mbaje atje te ngushtica e luginës, tek ai guri i theksuar, derisa pranë tij të kalojë ushtria e Allahut, le ta shohë mirë!"*

Abbasi tha: "Dhe unë shkova me të dhe aty te ngushtica e luginës u ndala, ashtu siç më urdhëroi Pejgamberi a.s..

Atëherë filluan të kalojnë fiset me flamujt e tyre.

Sa herë që kalonte ndonjë fis, ai gjithmonë më pyeste: "Kush janë këta, o Abbas?" Unë i përgjigjesha: "Sulejmi." Ai thoshte: "Çfarë më duhet mua Sulejmi?!" Pastaj kalonte fisi tjetër, ai më pyeste përsëri: "O Abbas, kush janë këta?" Unë i thosha atij: "Muzejne." Ai thoshte: "Çfarë më duhet mua Muzejne?!" Derisa parakaluan fiset, ai më pyeste mua për secilin fis. Dhe kur unë i përgjigjesha, ai ma kthente "Çfarë më duhet mua filan fis?!"

Kur erdhi Pejgamberi a.s. me brigadën e tij të gjelbër<sup>168</sup>, e cila përbëhej nga muhaxhirët dhe ensarët – Allahu qoftë i kënaqur me ta – të cilëve nga parzmoret përveç syve nuk u shihej asgjë tjetër, ai tha: "Subhanallah, o Abbas! Kush janë këta?"

Unë u përgjigja: "Ky është i Dërguari i Allahut me muhaxhirët dhe ensarët!" Kurse ai tha: "Këtij askush nuk është në gjendje t'i rezistojë! Pasha Zotin, o Ebul-Fadël, sa e paska zmadhuar mbretërinë biri i vëllait tënd!"

Unë i thashë: "Kjo nuk është mbretëri, por është pejgamberi!" "Po, po, ashtu është!" - miratoi Ebu Sufjani.

Unë i thashë: "Shpejt tani, shko te populli yt!"

Sapo mbërriti tek ata, menjëherë bërtiti me zë të lartë: "O Kurejshë! Ja po ju vjen Muhamedi me një forcë të cilën ju nuk jeni në gjendje ta përballoni. Ai që hyn dhe strehohet në shtëpinë e Ebu Sufjanit do të jetë i sigurt!"

Pas këtyre fjalëve iu vërsul gruaja e tij Hinda, e bija e Utbes, e kapi për mustaqesh dhe bërtiti:

"Vriteni këtë njeri të ëmbël, të majmë, me këmbë të shëmtuara! O sa i urryer është ky që paraprin popullin e vet!"

Ebu Sufjani tha: "Vaj halli për ju, kurrsesi mos lejoni t'ju verbojë kjo këtu! Muhamedi është duke ardhur me atë mbi çka ju nuk keni pushtet, por dijeni se ai që strehohet në shtëpinë e Ebu Sufjanit do të jetë i sigurt."

<sup>168</sup> Ibni Hishami thotë: "Është quajtur e gjelbër për shkak të metaleve që dukeshin në të."

Ata u përgjigjën: "Zoti të vraftë, nuk na duhet as shtëpia e as mbrojtja jote!"

Ai tha: "Kush mbyllet në shtëpinë e vet ka garanci, edhe ai që hyn në Harem të Qabesë."

Njerëzit u shpërndanë dhe vajtën në shtëpitë e veta dhe në Harem të Qabesë.

Abdullah b. Ebu Bekri transmetohet se ka thënë:

"Kur Pejgamberi a.s. erdhi në Dhu Tuva, e ndali kafshën që kalëronte dhe nga gjysma e pelerinës së tij të kuqe jemenase bëri për vete një çallmë dhe nga përujla ndaj Allahut, duke parë se është nderuar me çlirimin e Mekës, u përkul ashtu që mjekra pothuajse i prekte pjesën e përparme të shalës."

Esma bint Ebi Bekri ka thënë:

"Kur Pejgamberi a.s. u ndal në Dhu Tuva, Ebu Kuhafe, i cili tashmë ishte i verbër, i tha në atë kohë vajzës së djalit më të vogël: "Oj bija ime, më çto mua deri në Ebu Kubejs!"<sup>169</sup> Dhe ajo me të shikonte nga lart. Ai e pyeti: "Çfarë po sheh, oj bijë?" Ajo u përgjigj: "Unë po shoh një grumbull të madh." Ai tha: "Ata janë kalorës." Dhe ajo shtoi: "Po e shoh edhe një njeri para turmës i cili po shkon me ngut, herë andej e herë kënde!" Ai tha: "Ai është komandanti i ushtrisë së tyre!" Ajo bërtiti: "Vallahi, turma po zgjerohet!" Kurse ai tha: "Vallahi, kalorësia është nisur. Shpejt më kthe në shtëpi!"

Megjithatë, kalorësia e takuan para se të arrinte në shtëpi. Vajza kishte rreth qafës së saj një gjerdan argjendi, kur njëri prej tyre kaloi pranë saj dhe ia grabiti nga qafa.

Esma vazhdon tregimin:

"Kur Pejgamberi a.s. hyri në Mekë e pastaj edhe në Harem, tek ai erdhi Ebu Bekri duke prurë babanë e tij. Kur e pa atë, Pejgamberi a.s. tha: "Përse nuk e ke lënë gjyshin në shtëpi, kështu që unë të shkoj tek ai?!" Ebu Bekri u përgjigj: "O i Dërguari i Allahut, ai duhet të vijë tek ti dhe jo ti të shkosh tek ai!"

Pastaj e uli para Pejgamberit a.s.. Ai e ledhatoi me dorë në gjoks dhe i tha: "Eja, pranoje Islamin!" Dhe ai e pranoi.

Kur Ebu Bekri erdhi tek ai, koka e tij ishte si druri i segamit<sup>170</sup>, ndaj Pejgamberi a.s. i tha: "Ndryshojani flokët e tij!"

Pastaj Ebu Bekri e mori për dore motrën e tij dhe i pyeti njerëzit: "Ju përbetohem në Allahun dhe Islamin, për gjerdanin e motrës sime!" Por askush nuk iu përgjigj. Atëherë tha: "Oj motërz, duhet ta kishe ruajtur gjerdanin tënd sepse sot ka pak besim te njerëzit!"

<sup>169</sup> Ebu Kubejs, emri i kodrës në Mekë.

<sup>170</sup> Segam është një lloj druri, i cili çel jashtëzakonisht bardhë, kështu që me të krahasojnë flokët e bardha.

\* \* \*

Në ditën e çlirimit të Mekës, Hunejnit dhe Taifit fjalëkalimi i shokëve të Pejgamberit a.s. ka qenë si vijon: i muhaxhirëve: “O Beni Abdurrahman!” Te Hazre-xhi ka qenë: “O Beni Abdullah!” Ndërsa te Evsu ka qenë: “O Beni Ubejdullah!”

Pejgamberi a.s. kur i urdhëroi komandantët e tij ushtarakë për të hyrë në Mekë, u kërkoi atyre që të mos vrasin askënd, me përjashtim të disa individëve të cilët i përmendi me emra. Ai urdhëroi vrasjen e tyre edhe në qoftë se i gjejnë në mbulesën e Qabesë. Në mesin e tyre ishte Abdullah b. Sa’d, vëllai i Amir b. Luej-jit. Pejgamberi a.s. e urdhëroi vrasjen e tij sepse ai e kishte pranuar Islamin dhe një kohë madje kishte shkruar shpalljen Pejgamberit a.s., por pastaj përsëri ishte kthyer në idhujtari dhe kishte shkuar te Kurejshët. Ai ishte strehuar tek Osman b. Affani, i cili ishte vëllai i tij nga qumështi dhe ai e kishte fshehur, derisa e kishte sjellë te Pejgamberi a.s. kur populli dhe banorët e Mekës ishin qetësuar dhe prej tij kishte kërkuar siguri. Pohojnë se Pejgamberi a.s. kishte bërë një heshtje të gjatë dhe vetëm atëherë kishte thënë: “Po.” Kur ishte larguar Osmani, ai atyre që ishin përreth tij u kishte thënë: “Unë heshta, në mënyrë që ndonjëri nga ju të ngrihej dhe ta vriste.” Një ensar tha: “Po pse nuk ma bëre me shenjë, o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi a.s. i tha: “Pejgamberi nuk vret me shenjë!”<sup>171</sup>

Midis tyre ishte edhe Abdullah b. Hatal, një burrë nga fisi Bani Tejm b. Galib. Pejgamberi a.s. e kishte urdhëruar vrasjen e tij sepse ishte musliman dhe ai e kishte dërguar për të mbledhur zekatin. Me të kishte dërguar edhe një njeri tjetër, kurse me ta ishte edhe shërbëtori i tij, që gjithashtu ishte musliman. Diku gjatë rrugës ai e kishte urdhëruar shërbëtorin që t’i therte një cjaq dhe prej tij t’i përgatiste ushqim. Ai vetë ishte shtrirë për të fjetur pak dhe kur ishte zgjuar, ky nuk i kishte përgatitur asgjë. Për këtë shkak ai e sulmoi dhe e vrau shërbëtorin, pastaj u arratis dhe përsëri u bë idhujtar.

Ai kishte edhe dy vajza këngëtare, të cilat me këngë e përqeshnin Pejgam-berin a.s., kështu që Pejgamberi a.s. urdhëroi që me të bashkë të vriten edhe ato të dyja.

Pastaj, Huvejrith b. Nukajdh, i cili ishte njëri nga ata që e torturonin Pejgam-berin në Mekë.

Pejgamberi a.s. e urdhëroi vrasjen e Mikjes b. Subabes për shkak se ai kishte vrarë një ensarij, i cili ia kishte vrarë gabimisht vëllanë e tij, dhe pastaj ishte kthy-er te Kurejshët si idhujtar.

Ndër ta ishte edhe Sara, shërbyesja e Beni Abdulmuttalibit dhe Ikrimë b. Ebi Xhehlit.

<sup>171</sup> Ibni Hishami thotë: “Ai më vonë e pranoi Islamin dhe Omeri e caktoi në disa detyra, po ashtu edhe Osman b. Affani pas tij.”

Sara ishte nga ata që e torturonin Pejgamberin a.s. në Mekë. Ikrime iku në Jemen, ndërkaq gruaja e tij, Ummu Hakim bint Harith b. Hisham, e përqafoi Islamin dhe kërkoi nga Pejgamberi a.s. që t'i ofronte siguri dhe ai e miratoi kërkesën e saj. Ajo shkoi pas tij në Jemen, e mori dhe e solli te Pejgamberi a.s. dhe ai e përqafoi Islamin.

Abdullah b. Hatalin e vranë bashkërisht Seid b. Hurejth Mahzumiu dhe Ebu Berezat Eslemiu.

Ndërsa Mikjes b. Subaben e vrau Numejle b. Abdullah, një burrë nga fisi i tij, për të cilin motra e Mikjesit kishte deklaruar:

*Pasha jetën time, Numejle origjinën e tij e ka turpëruar,*

*që për Mikjesin vizitorët e dimrit i ka pikëlluar!*

*Tek Zoti na ankohet, kushdo që si Mikjesi sheh një të tillë,*

*që lehonës pas lindjes nuk i jepet ushqim!*

Sa u përket dy vajzave të Ibni Hatalit, njëra prej tyre u ekzekutua, ndërsa tjetra iku dhe kur më vonë për të ishte kërkuar siguri nga Pejgamberi a.s., ai i kishte dhënë.

Siguri ishte kërkuar edhe për Sarën, të cilën e kishte falur. Ajo kishte mbetur aty derisa një njeri e kishte shkelur me kalë në Ebtah, në kohën e Omer b. Hattabit, dhe e kishte vranë.

Kurse Huvejrit b. Nukajdhin e kishte vranë Ali b. Ebi Talibi.

\* \* \*

Nga Ummi Hani'e, e bija e Ebu Talibit, transmetohet të ketë thënë:

"Kur Pejgamberi a.s. ndodhej në pjesën e sipërme të Mekës, tek unë erdhën dy burra të afërm me mua nga Beni Mahzumi, kurse unë ndodhesha te Hubejre b. Ebi Veheb Mahzumiu. Me atë rast, tek unë hyri vëllai im, Ali b. Ebi Talibi, dhe tha: "Vallahi, do t'i vras që të dy ata!" Unë ua mbylla derën nga pas atyre dhe shkova te Pejgamberi a.s., i cili ishte në krye të Mekës. E gjeta duke u larë me ujin të cilin e merrte nga një çanak i madh, të cilit i vëreheshin ende gjurmët e brumit, ndërsa bija e tij Fatimeja e mbronte të mos shihej me rrobat e tij. Kur e përfundoi larjen, u ngjesh me rrobat e veta dhe pastaj fali tetë rekate duha namaz. Pastaj ai m'u afrua dhe më tha: "Mirë se erdhe, Ummi Hani'e! Çfarë e mire të solli këtu?" Unë i tregova për rastin e atyre dy njerëzve dhe për Aliun dhe ai më tha: "Atë që ti e merr në mbrojtje, do ta marrim edhe ne dhe kujt i jep ti siguri, do t'i japim edhe ne! Të mos i vrasë ata të dy!"

Nga Safijje bint Shejbe është transmetuar të ketë thënë:

"Pejgamberi a.s. kur zbriti në Mekë dhe njerëzit u qetësuan, shkoi në Qabe dhe kaluar në kafshën e tij shtatë herë bëri tavaf rreth saj duke e prekur gurin e zi

me shkopin e tij me grremç në majë, të cilin e mbante në dorë. Pas përfundimit të tavafit, e ftoi Osman b. Talhan dhe prej tij mori çelësin e Qabesë dhe pasi ia hapën derën, ai hyri në të. Aty gjeti një pëllumb të ndërtuar nga druri tropikal, të cilin e theu me dorën e vet dhe e hodhi. Pastaj qëndroi në hyrjen e Qabesë, ndërsa në xhami tashmë ishin tubuar shumë njerëz."

Ibni Is'haku thotë:

"Pejgamberi a.s. qëndroi tek dera e Qabesë dhe tha: *"Nuk ka zot tjetër veç Allahut që është një dhe i vetëm! Ai s'ka të ngjashëm e të barabartë! Allahu e zbotoi premtimin, e ndihmoi robin e Vet, i shkatërroi i vetëm të gjitha ushtritë e mbledhura për armiqësi! Çdo vepër e mirë, pasuria dhe njerëzit janë nën pushtetin tim, përveç shërbimit në këtë shtëpi të Allahut dhe furnizimit të haxhilerëve me ujë. Kush vret dikë gabimisht, do të rrihet me kamxhik dhe me shkop dhe për të do të pasojë dëmshpërblimi i rëndë prej njëqind devesh, prej të cilave dyzet duhet të jenë me fryt në bark."*

*"O popull Kurejsh! Allahu ju ka çliruar nga kryelartësia e xhahilijetit dhe nga madhërimi paraislamik i etërve tuaj. Të gjithë njerëzit e kanë prejardhjen nga Ademi, ndërsa Ademi është prej dheut."* Pastaj citoi ajetin:

*"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat)..."* (El-Huxhurat, 13)

Pastaj ai pyeti: *"O popull Kurejsh, çfarë mendoni se do të veprojtani me ju?"* U përgjigjën: *"Vetëm të mira, sepse ti je vëllai dhe i biri fisnik i vëllait fisnik."*

Pejgamberi a.s. tha: *"Shkoni, të gjithë jeni të lirë!"*

Pastaj Pejgamberi a.s. u ul në xhami. Atij iu afrua Ali b. Ebi Talibi me çelësin e Qabesë në dorë e tha: *"O Pejgamber i Allahut, na cakto ne për ruajtjen e Qabesë dhe për t'u dhënë ujë haxhilerëve, të bekoftë Allahu!"* Pejgamberi a.s. pyeti: *"Ku është Osman b. Talha?"* Ata e thirrën, e Pejgamberi a.s. i tha: *"Ja ku e ke çelësin që ke pasur, sot është dita për bamirësi dhe falje!"*

Hishami thotë:

*"Disa dijetarë më kanë thënë se Pejgamberi a.s., në ditën e çlirimit të Mekës ka hyrë në Qabe dhe ka parë imazhe të engjëjve dhe portrete të tjera, në mesin e tyre edhe Ibrahimin a.s. të paraqitur duke mbajtur në dorë shigjetat që konsultonte për ndonjë vendim të tijin. Pastaj ka thënë: "Allahu i vraftë! Të madhin tonë e kanë paraqitur duke konsultuar shigjetat! Çfarë ka Ibrahimimi me shigjetat!?"*

*"Ibrahimimi nuk ka qenë as hebre e as i krishterë, por ai ishte larg besimeve të kota, ishte musliman dhe nuk ishte prej idhujtarëve."* (Alu Imran, 67)

Ai pastaj urdhëroi që të gjitha imazhet të fshihen dhe ashtu ndodhi. Gjithash-tu më kanë treguar se në vitin e çlirimit të Mekës, Pejgamberi a.s. hyri në Qabe me Bilalin dhe e urdhëroi atë që të këndonte ezanin, ndërsa në oborrin e Qabesë

ishin ulur Ebu Sufjan b. Harb, Uttab b. Usejd dhe Harith b. Hisham. Me atë rast, Uttab b. Usejdi kishte thënë: "Allahu e mëshiroi Usejdin (babanë e vet), që të mos e dëgjojë dhe të mos e shohë këtë, sepse kjo gjë do ta hidhëronte shumë." Harithi tha: "Vallahi, sikur ta dija se kjo është e vërteta, unë do ta pasoja atë!" Ndërsa Ebu Sufjani më në fund tha: "Unë nuk do të them asgjë. Sikur të thosha diçka, edhe kjo rërë do të më tradhtonte dhe do ta informonte!"

Në atë çast para tyre erdhi Pejgamberi a.s. e tha: *"I di të gjitha se ç'keni folur."* Ai ua përsëriti çdonjërit fjalët që kishin thënë. Harithi dhe Itabi atëherë thanë: "Ne dëshmojmë se ti je i Dërguar i Allahut, e dimë se këtë askush nuk ka mundur ta dëgjojë e të të informojë!"

Ibni Hishami thotë:

"Nga Ibni Abbasi është transmetuar si vijon: "Në ditën e çlirimit të Mekës, Pejgamberi a.s. hyri në Mekë duke kalëruar mbi kafshën e tij dhe ashtu bëri tavafin, ndërsa gjithandej rreth Qabesë kishte idhuj të përforcuar me plumb. Ai duke bërë shenjë nga idhujt me purtekën që mbante në dorë tha: *"Dhe thuaj: "Erdhi e vërteta e u zhduk e kota". Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur."* (El-Isra, 81)

Cilindo idhull që prekte në fytyrë, ai rrëzohej në pjesën e prapme të kokës dhe cilindo prej tyre që e prekte në pjesën e prapme të kokës së tij, ai rrëzohej në fytyrën e tij. Në fund, asnjë nuk mbeti në këmbë.

Disa transmetues të besueshëm ngjarjesh më kanë rrëfyer se Fedale b. Umejr Lejthiu kishte për qëllim vrasjen e Pejgamberit a.s. në vitin e çlirimit të Mekës, derisa ky ishte duke bërë tavaf rreth Qabesë. Kur ky ishte afruar, Pejgamberi a.s. e pyeti: *"A ti je Fedale?"* Tha: "Po, unë jam Fedale, o i Dërguari i Allahut!"

Pejgamberi a.s. e pyeti: *"Çfarë ishe duke folur me vete, o Fedale?"*

Tha: *"Asgjë, isha duke përmendur Allahun!"*

Pejgamberi a.s. buzëqeshi, pastaj tha: *"Kërko falje nga Allahu!"* Pastaj ia vuri dorën e tij mbi gjoks dhe kështu zemra e tij u qetësua.

Fedale më vonë tha: "Vallahi, ai ende nuk e kishte larguar dorën e tij nga gjoksi im kur tashmë askush në botë nuk ishte më i dashur për mua sesa ai!"

Fedale më tutje thotë: "Kur prej atje erdha në shtëpi, kalova pranë gruas me të cilën kisha biseduar pak më herët dhe ajo përsëri më bëri thirrje për bisedë, por unë e refuzova.

Pastaj Fedale nxitoi duke recituar vargje:

*"Eja që të flasim!" më tha ajo, por unë refuzova,  
i thashë: "Këtë ta ndalon Allahu dhe Islami, fe e jona!  
Vetëm sikur ta shihje Muhamedin dhe njerëzit e tij,  
dhe ta dëgjoje thyerjen e idhujve në ditën e çlirimit!  
Ti do ta shihje fenë e Allahut duke u shfaqur si drita,  
ndërsa fytyrën e idhujtarisë se si e mbulon errësira!"*

Ibni Is'haku thotë:

“Në çlirimin e Mekës janë përfshirë gjithsej dhjetë mijë muslimanë. Vetëm nga fisi Beni Sulejm kishte 700 veta, disa madje thonë se ka pasur një mijë. Nga fisi Beni Gifar ishin 400, nga Beni Muzejne ishin një mijë e tre burra. Të tjerët ishin nga fisi Kurejsh, pastaj ensarët dhe aleatët e tyre si dhe grupe arabësh nga fiset Temim, Kajs dhe Esed.”

## BETEJA NË HUNEJN (viti i 8 h. pas çlirimit të Mekës)

Sapo morën vesh fisi Hevazin se Pejgamberi a.s. kishte çliruar Mekën, Malik b. Avf Nasriu menjëherë nxitoi për t'i mbledhur të gjitha degët dhe nëndegët e atij fisi. Atij iu përgjigjën fiset Thekif, Nasr, Xhushem dhe Sa'd b. Bekër, pastaj një numër i vogël i fisit Beni Hilal, të cilët ishin të vetmit nga fisi Kajs 'Ajlan. Nga degët e Ka'bit dhe Kilabit, të cilët gjithashtu i përkisnin Hevazinit, nuk kishte asnjë njeri që ishte për ta i rëndësishëm. Në fisin Beni Xhushem ishte Durejd b. Samme, një plak që nuk kishte dituri tjetër përveç diturisë mbi luftimin, si teorike ashtu edhe praktike. Kishte qenë luftëtar jashtëzakonisht i guximshëm dhe i sprovuar.

Thekifi kishte dy prijës, ndërsa te fisi Ahlaf ishte Karib b. Esved b. Mesud b. Muattab. Beni Maliku e kishin Dhul-Himar Subej' b. Harith b. Malik dhe vëllain e tij Ahmer b. Harith. Në nivel të përgjithshëm udhëheqja i përkiste Malik b. Avf Nasriut.

Duke u përgatitur për t'u nisur kundër Pejgamberit a.s. bashkë me ushtrinë kishte marrë pasuritë e tyre, gratë dhe fëmijët. Kur kishin arritur në Evtas<sup>172</sup>, atyre u ishin bashkuar edhe njerëz të tjerë, në mesin e të cilëve ishte edhe Durejd b. Samme, i cili ndodhej në krye të kolonës, në një bartëse prej druri.

Kur zbriti ai pyeti: "Në cilën luginë gjendeni?"

Njerëzit u përgjigjën: "Gjendemi në Evtas."

Ai tha: "Po, ky është terren i mirë për kuaj. Ky natyrisht është truall kreshtash malore (kodrina të shpërndara), pa aspak tokë ranore dhe të butë. Pse po dëgjohen palljet e deveve, palljet e gomarëve, të qarët e fëmijëve dhe blegërimat e deveve?"

Njerëzit iu përgjigjën: "Malik b. Avfi i ka marrë me vete, edhe gratë, fëmijët dhe tërë pasurinë e tyre të tundshme."

Ai pyeti: "Po ku është Maliku?" Dhe ata shpejt e çuan tek ai dhe i thanë: "Ja Maliku!"

Ai tha: "O Malik, ti je bërë prijës i popullit tënd, kurse kjo është një ditë vendimtare. Vendimi i sotëm do të jetë vendimtar për të ardhmen. Pse po dëgjohen palljet e deveve, gomarëve, të qarët e fëmijëve dhe blegërimat e deveve?!" Maliku u përgjigj: "Bashkë me burrat kam marrë edhe pasuritë dhe gratë e tyre." Durejdi e pyeti: "Po pse kështu?" Ai u përgjigj: "Desha që pas çdo mashkulli të qëndrojë familja dhe pasuria e tij, që të luftojë duke i mbrojtur ata!"

<sup>172</sup> Evtas, luginë mes vendbanimeve të fisit Hevazin.

Durejdi duke lëvizur gjuhën në shenjë mospajtimi, tha: “Bari delesh, vallahi! Ai që e humb betejën, a mund ta mbrojë familjen dhe të kujdeset për të e për pasurinë e vet? Nëse dëshiron të ngadhënjesh, nuk ke dobi prej askujt tjetër përveç prej luftëtarëve me shpata dhe me shtiza të gatshme, e nëse dështon, atëherë do të shkatërrohen edhe familjet, edhe pasuria e tyre.”

Pastaj pyeti: “Si kanë vepruar Ka’bi dhe Kilabi?” Thanë: “Prej tyre nuk është asnjëri!”

Ai atëherë tha: “Pikërisht po munguakan njerëzit më të vendosur dhe trima. Po të ishte puna për lartësi dhe lavdi, Ka’bi dhe Kilabi me siguri nuk do të mungonin. Sikur të kishit vepruar edhe ju si ata. Kush është nga ju?” Ata u përgjigjën: “Nga ne është Amër b. Amiri dhe Avf b. Amiri.”

Ai tha: “Që të dy pa përvojë për luftë! Nuk ka prej tyre as dobi, as dëm! O Malik, asgjë nuk do të arrish me dërgimin e ushtarëve havazinë me helmata për të shkatërruar kuajt. Vendosi ata në lartësira të vendit të tyre, që të mbrojnë shtëpitë dhe parinë e tyre, e pastaj para sabejve<sup>173</sup> le të hidhen në shpinat e kuajve. Nëse fiton, pas teje do të vijë edhe ata që janë prapa teje, e nëse dështon, kjo le të gjejë vetëm ty, kurse familjet dhe pasuria do të jenë të sigurta.”

Mirëpo Maliku refuzoi duke thënë: “Vallahi, nuk do të bëj asgjë prej asaj që më propozove. Ti tanimë je plakur dhe rraskapitur, edhe truri të është vjetruar. Vallahi, ose do të më dëgjoni mua o havazinë, ose do të mbështetem me gjoks në shpatë dhe le të dalë shpata në shpinë!” Maliku nuk lejoi të miratohej mendimi e as propozimi i Durejdit. Havazinët deklaruan: “Do të dëgjojmë ty!” Kurse Durejd b. Samme tha: “Unë kurrë nuk kam përjetuar një ditë të tillë, as nuk më ka kaluar!”

*Ah sikur të isha tash unë më i ri dhe  
të vërsulesha me galop dhe trokthi,  
duke vrapuar mbi kalin jelegjatë,  
si çjapi i egër për shpejtësi i shkathtë!*

Maliku pastaj u tha njerëzve: “Kur t’i shihni ata, thyeni millat e shpatave tuaja dhe vërsuluni mbi ta të gjithë përnjëherë!”

Kur Pejgamberi a.s. mësoi se Hevazini po përgatisin diçka, e dërgoi Abdullah b. Ebi Hadred Eslemiun dhe e urdhëroi që të futet në mesin e tyre, të qëndrojë një kohë derisa të kuptojë se çfarë po përgatisin dhe pastaj ta informojë për të. Ibn Hadredi ashtu veproi, u infiltrua në mesin e tyre, ku qëndroi derisa i mësoi të gjitha detajet në lidhje me përgatitjet e tyre për luftë kundër Pejgamberit a.s.. Gjithashtu, ai i mësoi të gjitha për Malikun dhe gjendjen e fisit Hevazin, pastaj u kthye te Pejgamberi a.s. të cilin e informoi në detaje.

<sup>173</sup> Sabej, adhures yjesh, këtë nofkë ata e përdornin për muslimanët sepse ata prej idhujtarisë kishin kaluar në Islam.

Pejgamberi a.s. menjëherë përgatiti marshimin kundër tyre dhe derisa përgatitjet po vazhdonin, dikush i tha atij se Safvani b. Umejje kishte shumë parzmore dhe armë. Safvani ende ishte idhujtar, prandaj tek ai dërgoi dikë nga njerëzit e tij, i cili kur mbërriti i tha: “O Ebu Umejje, na i jep hua armët e tua që nesër t’i qërojmë hesapet me armikun tonë!” Safvani pyeti: “O Muhamed, a është ky detyrim apo plaçkë!?” Pejgamberi a.s. u përgjigj: “Jo, vetëm hua e garantuar, të cilën do ta kthejmë!”

Ai tha: “Atëherë nuk ka problem!” Dhe i dha njëqind parzmore dhe numër të mjaftueshëm armësh. Thuhet se Pejgamberi a.s. kishte kërkuar prej tij që të bënte edhe transportimin e tyre dhe ai e kishte bërë.

Pastaj Pejgamberi a.s. ishte nisur me dhjetë mijë njerëz me të cilët e çliroi Mekën, të cilëve iu shtuan edhe dy mijë mekas, kështu që numri i përgjithshëm i tyre ishte dymbëdhjetë mijë. Për guvernator të Mekës dhe komandant të atyre që mbetën aty Pejgamberi a.s. caktoi Uttab b. Esijd b. Ebul-Ijs b. Umejje b. Abdi Shems. Pastaj u nis me qëllim që të përballet me hevazinët.

Transmetohet nga Harith b. Malik si vijon:

“Me Pejgamberin a.s. u drejtua për në Hunejn. Ne sapo kishim dalë nga xhahilijeti. Pra, ne shkuam me të deri në Hunejn. Jobesimtarët Kurejshë dhe arabët e tjerë kanë pasur një dru të madh të gjelbër, i cili quhej Dhatu Envat, dhe ata çdo vit shkonin e varnin armët në të, afër tij thernin kurbane dhe aty qëndronin tërë ditën. Ne duke shkuar me Pejgamberin a.s., pamë një zambak uji të madh të gjelbër dhe menjëherë buzë rrugës filluam të thërrasim: “O i Dërguari i Allahut, a mund të kemi edhe ne sikurse fiset arabe një Dhatu Envat?”

Pejgamberi a.s. tha: “Allahu është i madh! Ju, pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, jeni duke folur siç i ka folur Musait populli i tij: “O Musa, na e bëj edhe ne një zot (statujë) si zotat që kanë ata (ai popull)”. Ai (Musai) tha: “Ju jeni popull që nuk dini.” (El-A’raf, 138). Vërtet këto janë tradita dhe ju me siguri do t’i ndiqni traditat e atyre para jush!”

Transmetohet nga Xhabir b. Abdullahu si vijon:

“Kur arritëm përballë luginës së Hunejnit, u lëshuam në njërën nga luginat e Ti-hames, mjaft e gjerë dhe shumë e pjerrët, kështu që zdirgjeshim teposhtë saj. Kjo ishte afër fundit të natës, në errësirë të dendur, pak para agimit, kurse ata kishin mbërritur në atë luginë para nesh dhe gjithkund anës rrugës nëpër shtigje e tërthore, lugje e gryka kishin vendosur prita si dhe ishin përgatitur dhe rregulluar mirë. Vallahi, derisa ne po zdirgjeshim kështu, na befaso i ushtria e armikut, e cila u vërsul njëherësh, kurse muslimanët nisën të tërhiqeshin me të shpejtë duke rënë njëri mbi tjetrin.

Pejgamberi a.s. mbeti vetëm në anën e djathtë dhe filloi të thërriste: “O burra, ejani tek unë, unë jam Resulullahu, Muhmmmed b. Abdullahu! Përse kështu devetë po i vërsulen njëra-tjetrës!?”

Njerëzit megjithatë ikën. Me të mbeti vetëm një numër i vogël muhaxhirësh, ensarësh dhe prej familjes së tij.”

Ibni Is'haku thotë:

“Kur njerëzit ashtu të mundur u tërhoqën, disa të pagdhendur nga Meka që ishin me Pejgamberin a.s., kur e panë këtë disfatë, filluan ta shfaqin me keqdashje atë që kishin në zemrat e tyre. Ebu Sufjan b. Harbi për shembull tha: “Dështimi i tyre nuk do të përfundojë derisa t’i dëbojmë gjer në Detin e Kuq, ndërsa shigjetat i kanë me vete në qese!”

Atëherë Xhebele b. Hanbeli bërtiti me zë të lartë: “Sot dështoi mrekullia!”

Shejbe b. Osman më vonë ka treguar:

“I thashë vetes: “Sot do ta marr hakun ndaj Muhamedit! Sot unë do ta vras Muhamedin!” Pastaj shkova në kërkim të Pejgamberit a.s. për ta vrarë! Atëherë më kaploi një ndjenjë e çuditshme dhe ma pushtoi zemrën dhe unë nuk mund ta duroja. Kështu kuptova se ai ishte i mbrojtur nga unë dhe se nuk mund t’i bëja asgjë.”

Disa njerëz nga Meka më kanë thënë se Pejgamberi a.s., gjatë rrugës nga Meka për Hunejn, kur kishte parë një numër të madh të ushtrisë së Allahut që shkonte me të, kishte thënë: “Sot nuk do të mposhemi për shkak të numrit tonë të vogël!”

Abbas b. Abdulmuttalibi ka thënë:

“Unë kam qenë me Pejgamberin a.s. dhe e mbaja për freri mushkën e tij të bardhë, të cilën e shtrëngoja fort. Unë isha trupmadh dhe kisha zë të fortë dhe kur Pejgamberi a.s. e pa rrëmujën tek njerëzit, u bërtiti atyre: “*Ku po shkoni o njerëz!?*” por nuk vërejta se njerëzit po çanin kokën për diçka. Atëherë më tha mua: “*O Abbas, bërtit: -O ensarë, o populli i Semures!*”, dhe vetëm atëherë ata filluan të përgjigjen: “*Të përgjigjemi, ja po vijmë!*”

Kështu ka pasur situata kur njeriu përpiqej ta kontrollonte devenë e tij, por për shkak të nervozizmit të saj nuk kishte sukses. Pastaj e merrte parzmoren e vet, e varte rreth qafës së tij, pastaj e merrte shpatën dhe mburojën, kërcente nga deveja duke e lënë të shkojë nga të dojë, ndërsa ai vetë drejtohej sipas zërit tim dhe vinte te Pejgamberi a.s.. Kur u tubuan rreth 100 veta, u drejtuan nga armiku dhe nisën luftimin. Në fillim ishte thirrja: “O ensarë!”, por në fund u thirrën: “O hazrexhë!”, sepse u treguan më të qëndrueshëm në luftë. Pastaj Pejgamberi a.s. u ngrit në yzengjitë e tij dhe vështroi vendin ku njerëzit përlesheshin me shpata e tha: “*Tani lufta u ndez flakë!*”

Nga Xhabir b. Abdullahu transmetohet se ka thënë:

“Një njeri që mbante flamurin e Hevazinit u shfaq në deve. Për një moment e pamë se si mbi të u vërsulën Ali b. Ebi Talibi, Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe një ensar. Pasi Aliu iu afrua nga pas dhe e goditi devenë në pjesën e poshtme të këmbës, ajo u gjunjëzua në pjesën e prapme. Ne e pamë kur ensari nxori shpatën,

e cila vringëlloi në ajër nga shpejtësia, dhe njeriut ia preu këmbën nën gju, e cila fluturoi nga deveja e tij.

Njerëzit vrullshëm luftonin me shpata dhe vallahi ende pa u zhdukur të gjitha gjurmët e humbjes fillestare, tek Pejgamberi a.s. filluan të silleshin robër të lidhur.

Pejgamberi a.s. në një moment u kthye nga Ebu Sufjan b. Harith b. Abdulmuttalibi, Islami i të cilit ishte shembullor dhe që gjatë tërë kohës ishte pranë Pejgamberit a.s., duke e mbajtur për bishti mushkën e tij dhe e pyeti: "*Kush je ti?!*" Ai tha: "Unë jam djali i xhaxhait tënd, o i Dërguari i Allahut!"

Abdullah b. Ebi Bekër ka thënë:

"Pejgamberi a.s. u kthye dhe pa Ummu Sulejm bint Milhan me burrin e saj Ebu Talhan. Ajo rreth belit ishte mbështjellë me pelerinë sepse ishte shtatzënë me djalin e saj Abdullahun. Kishte hipur në deve, por nga frika se mos i dilte nga kontrolli, kokën e devesë e kishte afruar kah vetja, ndërsa dorën e kishte futur nëpër hallkën e hundës së bashku me kapistër.

Pejgamberi a.s. e pyeti: "*Oj Ummu Sulejm?*" Ajo u përgjigj: "Po, nënë e babë t'u bërshin kurban, o i Dërguari i Allahut, vriti ata që tërhiqen nga ti siç i vret edhe ata kundër të cilëve po lufton! Vërtet, ata e meritojnë!"

Pejgamberi a.s. tha: "*A nuk mjafton Allahu, oj Ummu Sulejm?!*"

Pasi kishte në dorë një kamë, Ebu Talha e pyeti: "Çfarë është kjo kamë, oj Ummu Sulejm?!" Ajo u përgjigj: "E kam marrë që në qoftë se më afrohet ndonjë idhujtar, me të t'ia shqyej barkun!"

Ebu Talha tha: "A po dëgjon, o i Dërguari i Allahut, se çfarë tha sysklepa?!"

Nga Ebu Katade transmetohet se ka thënë:

"Në Betejën e Hunejnit pashë duke luftuar dy veta: njëri musliman e tjetri idhujtar. Për një çast pashë një idhujtar që erdhi për të ndihmuar shokun e tij kundër muslimanit dhe unë iu afrova, e godita me shpatë dhe ia këputa dorën, mirëpo ai më kapi me dorën tjetër dhe më shtrëngoi aq fortë, sa që e ndjeva erën e gjakut. Për pak më mbyti, e sikur ndërkohë të mos kishte gjakderdhje, do të më mbyste. Kur për shkak të lodhjes ra në tokë, unë e godita atë dhe kështu i dhashë fund. Ky dyluftim me të më rraskapiti. Unë vetëm mund të shikoja se si kaloi pranë tij një burrë nga Meka dhe ia mori atij gjithçka që kishte.

Pas përfundimit të betejës Pejgamberi a.s., tha: "*Kushdo që ka vrarë dikë, atij i takon gjithçka që ka gjetur në trupin e të vdekurit!*"

Unë i thashë: "O i Dërguari i Allahut, unë vrava një njeri që kishte me vete gjëra të vlefshme, por lufta me të më rraskapiti, kështu që nuk e di se kush i ka marrë prej tij!"

Atëherë erdhi një njeri nga Meka dhe tha: “Të vërtetën po thotë, o i Dërguari i Allahut! Të gjitha gjërat që kanë qenë tek ai njeri janë tek unë, ndaj jepi atij aq sa të jetë i kënaqur!”

Atëherë Ebu Bekër Siddiku tha: “Jo, vallahi, nuk do t’i japë vetëm sa të jetë i kënaqur! Vallë, me njërin nga luanët e Allahut, i cili ka luftuar duke mbrojtur fenë e Allahut, dëshiron ta ndajmë atë që i takon?! Ktheja të gjitha gjërat që ishin tek ai që ka vrarë!”

Pejgamberi a.s. vetëm shtoi: “Të vërtetën thotë, ktheja të gjitha!”

Ebu Katade ka thënë: “Unë i mora dhe i shita, pastaj me to bleva një truall të vogël me palma. Kjo ka qenë prona ime e parë.”

Ibni Is'haku thotë:

“Pas disfatës së fisit Hevazin, konflikti i përgjakshëm vazhdoi me degën e tij Beni Malik, ku nën flamurin e tyre u vranë 70 njerëz, në mesin e tyre edhe Osman b. Abdullah b. Rebia b. Harith b. Hubejb. Flamurin e tyre e kishte Dhul-Himar<sup>174</sup>, pas të cilit e mori Osman b. Abdullahu dhe luftoi me të derisa u vra.

Idhujtarët pas disfatës së pësuar shkuan në Taif. Me ta ishte Malik b. Avf, i cili për një pjesë të tyre e ngriti kampin në Evtas, ndërsa të tjerët, në fakt vetëm dega Beni Gijere e fisit Thekif, u drejtuan për Nahle. Kalarësia e Pejgamberit a.s. i ndoqi vetëm këta që shkuan për Nahle, kurse të tjerët jo.

Pas atyre që shkuan për në Evtas, Pejgamberi a.s. dërgoi Ebu Amir Esh'ariun. Ai gjatë rrugës i mbërriti disa nga grupet e tyre të shpartalluara dhe ata nisën luftën me të, ku Ebu Amir mori plagë vdekjeprurëse nga një shigjetë. Pas tij flamurin e mori Ebu Musa Esh'ariu, djali i xhaxhait të tij. Ai vazhdoi të luftojë me ta dhe me ndihmën e Allahut arriti t’i mposhtë.

Pas kësaj humbeje, Malik b. Avfi u ndal gjatë rrugës në një kodrinë në mes të shokëve të tij dhe u tha: “Ndaluni këtu derisa të kalojnë këta më të dobëtit dhe derisa t’ju bashkëngjiten ata që janë prapa!” Me ta u ndal edhe ai dhe qëndroi aty derisa iu bashkëngjiten edhe grupet e fundit të shpartalluara.

Pejgamberi a.s. duke kaluar hasi në një grua të cilën e kishte vrarë Halid b. Velidi dhe përnjëherë njerëzit u grumbulluan përreth saj. Ai tha: “Çfarë është kjo?” I thanë: “Një grua që e ka vrarë Halid b. Velidi.” Pejgamberi a.s. i tha dikujt që ishte rreth tij: “Shko zëre Halidin dhe thuaj: “I Dërguari i Allahut të ndalon të vrasësh fëmijë, gra ose shërbëtorë!”

Ndër të tjera, Pejgamberi a.s. prej tyre kërkoi: “Nëse mund të ma sillni Xhadin - një njeri nga Beni Sa’d b. Bekër- i cili kishte bërë diçka të madhe, “kurrsesi mos lejoni t’ju ikë!” Dhe kur e kapën muslimanët, bashkë me të sollën edhe familjen e tij, e kështu edhe Shejme bint Harith b. Abduluzzanë, motër e Pejgamberit a.s.

<sup>174</sup> Dhul-Himar ishte Avf b. Rebi’.

nga qumështi. Ata gjatë shoqërimit të saj ishin sjellë ashpër, ndaj ajo u kishte thonë: “Le ta dini se unë jam motra e Pejgamberit tuaj nga qumështi!” Por ata nuk i besuan derisa e sollën te Pejgamberi a.s..

Kur ajo u soll te Pejgamberi a.s. tha: “O i Dërguari i Allahut, unë jam motra jote nga qumështi!”

Ai pyeti: “A ke ndonjë shenjë për këtë?” Ajo u përgjigj: “Po, është kafshimi që më ke bërë në shpinë me një rast kur unë të kam bartur në vithet e mia!”

Dhe pasi Pejgamberi a.s. e njohu shenjën, i shtroi asaj pelerinën e tij dhe e uli mbi të. Pastaj i tha asaj që të zgjedhë: “Nëse do, qëndro me mua, do të jesh e mirëpritur dhe e respektuar, por nëse preferon që të shkosh te populli yt, do të ta mundësojmë.”

Ajo tha: “Më përgatit dhe më kthe te populli im!” Pejgamberi a.s. e përgatiti dhe e ktheu te populli i saj.

Benue Sa’dët pretendojnë se ai me atë rast i dhuroi asaj një djaloshe të ri që quhej Mekhul dhe një vajzë, të cilët pastaj u martuan mes tyre, pasardhësit e të cilëve ende ekzistojnë.

Ibni Hishami thotë:

“Rreth Betejës së Hunejnit, Allahu i Madhërisëm ka shpallur ajetet vijuese:

*“Nuk ka dyshim se Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, edhe në ditën e Hunejnit, kur ju mahnitë numri i madh, i cili nuk ju vlejti asgjë, dhe me gjerësinë e saj që e kishte toka u ngushtua për ju, pastaj ju u zbrapsët (ikët). Pastaj Allahun zbriti qetësinë e Vet tek i Dërguari i Tij dhe besimtarët, zbriti një ushtri që ju nuk e patë, i dënoi ata që mohuan, e ai ishte ndëshkim ndaj mosbesimtarëve.”* (Et-Tevbe, 25-26)

Ibni Is’haku thotë:

“Të gjitha pasuritë dhe të zënët robër në Hunejn i grumbulluan te Pejgamberi a.s. në një vend, ndërsa mbikëqyrës i tyre u caktua Mesud b. Amër Giffariu. Pastaj Pejgamberi a.s. urdhëroi që të gjitha këto të grumbulloheshin dhe të depozitoheshin në Xhi’rane.”

### BETEJA E TAIFIT (viti i 8 h.)

Sapo kishte mbërritur në Taif grupi i mundur i fisit Thekif, menjëherë i kishin mbyllur dyert e qytetit dhe kishin marrë të gjitha masat e nevojshme për luftë.

Këtu duhet të përmenden dy njerëz: Urve b. Mesud dhe Gajlan b. Seleme, të cilët nuk kishin marrë pjesë as në betejën e Hunejnit as në rrethimin e Taifit, por gjatë asaj kohe kishin qëndruar në Xhuresh dhe kishin mësuar prodhimin e 'breshkave'<sup>175</sup>, katapultave dhe mburojave të drunjtja.

Pas Hunejnit, Pejgamberi a.s. u nis për Taif.

Para nisjes së Pejgamberit a.s. për Taif, Ka'b b. Maliku kishte recituar vargjet vijuese:

*Ne nga Tihame larguam edhe më të voglin dyshim  
edhe nga Hajberi, pastaj i lamë shpatat për pushim!  
Dhe i vendosëm para alternativës: nëse do të flisnin  
prerësit e tyre do të thoshin duam Devsin ose Thekifin!  
Kështu që unë nuk jam i patëmetë, nëse nuk i sheh  
në oborrin e shtëpisë tënde, me mijëra nga ne.  
Duke shembur kulmet, në Vexhxxh<sup>176</sup>, mu në brendi,  
dhe pastaj mbesin të zbrazura pa asnjë njeri!*

Pejgamberi a.s. shkoi rrugës nëpër Nahlen jemenase, pastaj nëpër Karn, pastaj Mulejh, pastaj nëpër Buhretur-Regae në rajonin e Lijjes<sup>177</sup>, ku iu ndërtua një xhami dhe aty fali namaz. Prej aty vazhdoi nëpër rrugën e quajtur Dajka dhe doli në Nahb, e më në fund u ndal nën një zambak uji të quajtur Sadire, në afërsi të pasurive të një burri nga fisi Thekif.

Pejgamberi a.s. atij njeriu i dha ultimatum: "Ose dil, ose ne do ta rrënojmë murin!" Pasi ai nuk pranoi të dilte, Pejgamberi a.s. urdhëroi që ai mur të rrënohet.

Pastaj Pejgamberi a.s. vazhdoi rrugën e tij deri në afërsi të Taifit dhe aty u ndal. Menjëherë urdhëroi që ushtria të vendoste kampet, mirëpo pasi ishin shumë afër armikut dhe shigjetat e tyre mund të arrinin aty, iu vranë disa njerëz, ndërsa muslimanët nuk ishin në gjendje ta kapërcejnë murin që ata kishin mbyllur para tyre. Prandaj, pasi i humbi disa njerëz, Pejgamberi a.s. kampin e zhvendosi te xhamia e tij, e cila edhe sot gjendet në Taif. Pastaj i mbajti ata nën rrethim mbi

<sup>175</sup> Debbabat, lloj makine e vjetër luftarake.

<sup>176</sup> Vexhxxh, emër vendi në Taif.

<sup>177</sup> Karn, Mulejh, Buhretur-Regae dhe Lijje janë emra vendesh në territorin e Taifit.

njëzet net. Pejgamberi a.s. me vete kishte dy nga gratë e tij, prej të cilave njëra ishte Ummu Seleme, bija e Ebu Umejjes. Secilës prej tyre u bëri nga një tendë të veçantë, kurse mes atyre dy tendave falte namazin. Më vonë, kur Thekifi e përqafoi Islamin, në atë vend Amër b. Umejje b. Vehb ndërtoi një xhami. Thuhet se në atë xhami gjendej një zog nate dhe sa herë që shkëlqente dielli, nga aty dëgjohej zëri i tij.

Pejgamberi a.s. i mbajti nën rrethim dhe i sulmoi ashpër. Shigjetat fluturonin në të dyja anët<sup>178</sup>.

Një grup luftëtarësh të Pejgamberit a.s. u afruan të fshehur nën 'breshkat luftarake' dhe me to sulmuan muret me qëllim depërtimi, mirëpo Thekifi kundër tyre hodhën shufra hekuri të skuqura në zjarr dhe ata u detyruan të dalin nga 'breshka', pastaj mbi ta hodhën breshëri shigjetash dhe me atë rast u vranë disa luftëtarë. Atëherë Pejgamberi a.s. urdhëroi që të pritej hardhia e Thekifit dhe muslimanët filluan ta bënin këtë me shpejtësi të madhe.

Kam mësuar se Pejgamberi a.s. gjatë rrethimit të Thekifit i kishte thënë Ebu Bekër Siddikut: *"O Ebu Bekër, pashë në ëndërr se më është dhënë një enë plot me kajmak, pastaj atë e çukiti gjeli dhe u derdh e tëra!"* Ebu Bekri iu përgjigj: "Nuk mendoj se këtë herë do të mund ta bësh atë që dëshiron!" Pejgamberi a.s. i tha: *"Edhe unë mendoj ashtu!"*

Huvejle bint Hakim Sulmijje, gruaja e Osmanit, e kishte lutur Pejgamberin a.s.: *"O i Dërguari i Allahut, nëse ta mundëson Allahu që ta çlirosh Taifin, a do të ma japësh stolinë e Badije bint Gajlanit ose stolinë e Farige bint Ukajlit?"* Ato të dyja kishin më së shumti stoli në mesin e grave të Thekifit. Siç më është thënë, Pejgamberi a.s. i kishte thënë: *"Edhe nëse ende nuk më është dhënë leja për Thekif, oj Huvejle?!"*

Ajo pastaj kishte shkuar nga atje dhe i kishte treguar Omer b. Hattabit, ndërsa ky menjëherë kishte ardhur te Pejgamberi a.s. dhe i kishte thënë: *"O i Dërguari i Allahut, çfarë do të thotë ajo që më tregoi Huvejla? Ajo pohon se ato janë fjalët e tua."*

Pejgamberi a.s. u përgjigj: *"Po, unë i kam thënë!"* Omeri r.a. tha: *"A me të vërtetë nuk të është lejuar, o i Dërguari i Allahut?"*

Pejgamberi a.s. tha: *"Jo!"* Omeri r.a. tha: *"E pra, a t'ua shpall njerëzve njoftimin për largim?"*

Pejgamberi a.s. tha: *"Po, sigurisht!"* Dhe atëherë Omeri i njoftoi njerëzit për kthim.

Kur njerëzit u përgatitën për nisje, Se'id b. Ubejd bërtiti: *"Kjo lagje, ja, mbeti e pathyeshme!"*

<sup>178</sup> Ibni Hishami thotë: "Pejgamberi a.s. i ka gjuajtur edhe me katapulta. Më kanë treguar njerëz të besueshëm se të parët në Islam që kishte gjuajtur Pejgamberi a.s. me katapulta kanë qenë banorët e Taifit."

Kurse Ujejne b. Hisni tha: "Po, vallahi, e lavdishme dhe e nderuar!" Me atë rast një prej muslimanëve u tha: "Të vraftë Allahu, o Ujejne! A po i lavdëron idhujtarët sepse e penguan të Dërguarin e Allahut, kurse ti ke ardhur për ta ndihmuar Pejgamberin a.s.?!"

Atëherë ai tha: "Unë, vallahi, nuk kam ardhur për të luftuar me ju kundër Thekifit, por kam shpresuar se Muhamedi do ta çlirojë Taifin, kështu që unë pastaj të kap ndonjë vajzë të tyre e të më lindë një djalë, sepse Thekifi janë popull dinak."

Derisa Pejgamberi a.s. ishte ende në vendin e tij, erdhën tek ai vetëm robërit nga Taifi dhe e pranuan Islamin, pastaj Pejgamberi a.s. u dha atyre lirinë.

Më vonë, kur edhe banorët e Taifit u konvertuan në Islam, disa prej tyre i përmendën ata robër, por Pejgamberi a.s. u tha: "Jo, ata tani janë të liruarit e Allahut!"

Në mesin e atyre që janë përmendur ishte edhe Harith b. Kelede. Numri total i sahabëve të Pejgamberit a.s. që ranë shëhidë në Taif ishte 12 burra: shtatë nga Kurejshët, katër nga ensarët dhe një nga fisi Lejth.

Kur Pejgamberi a.s. u largua nga Taifi, Buxhejr b. Zuhejr b. Ebu Sulme i kishte kushtuar poezi Hunejnit dhe Taifit.

## PLAÇKA E LUFTËS DHE ROBËRIT E HEVAZINIT

Pas tërheqjes nga Taifi, Pejgamberi a.s. me njerëzit e tij nëpër Dahne shkoi në Xhi'rane, ku ishte vendosur një numër i madh robërish nga fisi Hevazin. Kur ai vendosi të tërhiqet nga Thekifi, një nga shokët e tij i tha: "O i Dërguari i Allahut, lutu kundër tyre!" Por Pejgamberi a.s. u përgjigj: *"O Zoti im, udhëzoji Thekifët në rrugën e drejtë dhe futi ata në Islam!"*

Në Xhi'rane erdhi një delegacion i fisit Hevazin. Në fakt, Pejgamberi a.s. nga robërit e Hevazinit kishte 6000 gra e fëmijë dhe një numër të madh devesh dhe delesh. Ata i thanë: "O i Dërguari i Allahut! Ne jemi fis i vjetër dhe i respektuar dhe ti e di mirë për fatkeqësinë që na ndodhi, ndaj ki mëshirë për ne, Allahu të mëshiroftë!"

Atëherë u ngrit një njeri nga Hevazini, pas tij edhe një tjetër nga fisi Beni Sa'd b. Bekër, i quajtur Zuhejr, me nofkën Ebu Sured dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, atje në vathë janë edhe hallat, tezët dhe nënat e tua nga qumështi, që janë kujdesur për ty. Dhe sikur t'i kishim dhënë gjë edhe Harith b. Ebu Shimres ose Nu'man b. Mundhirit dhe ata tash të ishin në pozicionin tënd, edhe prej tyre ne do të prisnim dhembshuri dhe bamirësi reciproke, e lëre më prej teje si personi më përgjegjës!"

Pejgamberi a.s. tha: *"A i doni ju më shumë fëmijët dhe gratë tuaja apo pasuritë tuaja?"*

Ata u përgjigjën: "O i Dërguari i Allahut, a do të vendosim në mes pasurisë dhe pasardhësve tanë?! Na kthe gratë dhe fëmijët tanë, ata janë më të dashur për ne!"

Pejgamberi a.s. tha: *"Ja, unë po ju jap atë që më takon mua dhe Benu Abdulmuttalibit. Por pasi ta fal unë namazin e drekës, ju ngrihuni dhe thoni: "Ne kërkojmë që i Dërguari i Allahut të angazhohet për ne te muslimanët, ndërsa kërkojmë prej muslimanëve të angazhohen për ne tek i Dërguari i Allahut që të na i kthejë fëmijët dhe gratë tona", dhe unë atëherë do t'ju jap çfarë ju thashë si dhe do të kërkoj për ju!"*

Dhe vërtet, kur Pejgamberi a.s. e fali namazin e drekës me njerëzit, ata u ngrihën dhe i thanë ato fjalë siç i kishte këshilluar ai. Atëherë Pejgamberi a.s. tha: *"Sa për pjesën që më takon mua dhe Benu Abdulmuttalibit, unë po jua jap juve!"*

Atëherë muhaxhirët thanë: "Ajo çfarë na takon neve, ajo është e Pejgamberit a.s.!" Edhe ensarët thanë: "Edhe pjesa jonë gjithashtu i përket të Dërguarit të Allahut!"

Pastaj Akre' b. Habis deklaroi: "Mirëpo, ajo që më përket mua dhe Beni Temimit, ajo nuk i përket atij!"

Uejne b. Hisn nga ana e tij tha: "As pjesa ime dhe as pjesa e Beni Fezares!" Pas tij, Abbas b. Mirdas tha: "As ajo që më përket mua dhe Beni Sulejmit!"

Me atë rast reaguesan përfaqësuesit e fisit Beni Sulejm duke thënë: "Përkundrazi! Ajo që na përket neve, i takon Pejgamberit a.s.!"

Abbas b. Mirdasi i tha Beni Sulejmit: "E pra, ju më dobësua mua!"

Pastaj Pejgamberi a.s. tha: *"Pra, secili nga ju që e merr të drejtën e tij në lidhje me këta robër, duhet ta dijë se ndaj secilit prej tyre kanë nga gjashtë detyra të rrepta, duke filluar nga i pari të cilin e marr, kështu që (është më mirë për ju) njerëzve t'ua ktheni fëmijët dhe gratë e tyre!"*

Pejgamberi a.s. delegacionin e Hevazinit e pyeti për Malik b. Avfin, se çfarë kishte bërë. Ata u përgjigjën: *"Ai gjendet në Taif, me fisin Thekif."*

Pejgamberi a.s. ju tha: *"Tregojini Malikut se nëse ai më vjen si musliman, do t'ia kthej edhe familjen edhe pasurinë dhe përveç kësaj do t'ia jap edhe njëqind deve!"*

Sapo u informua për këtë, Maliku menjëherë u nis nga Taifi për te Pejgamberi a.s.. Por pasi kishte frikë nga Thekifi, se nëse mësojnë për atë çfarë i tha Pejgamberi a.s. mund ta arrestojnë dhe ta mbajnë, ai urdhëroi që t'i përgatisin një deve si dhe kërkoi që në Taif t'i sjellin kalin e tij dhe ashtu u bë. Atëherë natën i hipi kalit dhe shkoi për tek vendi ku ishte duke e pritur deveja e përgatitur. Pastaj hipi mbi devenë e tij dhe shkoi te Pejgamberi a.s.. Atë e mbërriti në Xhi'rane ose në Mekë dhe ai ia ktheu familjen dhe pasurinë e tij dhe i dha njëqind deve. Pasi e përqafoi Islamin dhe ishte mirë i përkushtuar në të, ai recitoi këto vargje:

*Nuk kam parë as nuk kam dëgjuar për një të tillë,  
që në mesin e njerëzve të jetë si Muhamedi:  
Ai e përmbush premtimin dhe dhuron me bujari tepër,  
sa herë që kërkon, të tregon ty se çfarë do të jetë nesër!  
Kur njerëzit kryesorë të ushtrisë tërhiqen dhe ndalen,  
dhe fillojnë t'i hedhin shtizat dhe shpatat indiane:  
bëhen si luanët për të vegjlit e tyre të tërbuar,  
që në pluhur të betejës, i shikojnë pas prite të strehuar!*

Pejgamberi a.s. pastaj atë e emëroi zyrtar mbi pjesën e popullit të tij që e përqaftuan Islamin si dhe mbi fiset Thumale, Selime dhe Fehm dhe ai me ta luftoi kundër Thekifit, ashtu që asnjë tufë e tyre nuk mund të dilte në kullota veçse ai do ta sulmonte. Në këtë mënyrë ushtroi presion të fortë mbi ta, për të cilën Ebu Mihxhan Thekafiu thuri këto vargje:

*Armiqtë kishin frikë nga ana jonë,  
dhe pastaj Benu Selimet ne na sulmojnë!  
Maliku i solli ata mbi ne me marshim,  
duke shkelur kështu marrëveshje e ndalim!  
Ata na sulmuan ne duke qenë ne në shtëpi,  
kështu që ne u bëmë objekt i urrejtjes së tij!*

\* \* \*

Njerëzit shkonin pas tij dhe i thoshin: “O i Dërguari i Allahut, na e ndaj plaçkën tonë të deveve dhe deleve!” Si përfundim, e ndaluan Pejgamberin a.s. nën një pemë dhe xhybja i negci në dru dhe u gris. Ai tha: “Ma jepni xhyben time o njerëz! Vallahi, po të kisha në dorë pasuri sa numri i drunjoe të Tihames, do t’ua ndaja të gjithëve dhe atëherë do të shihnit se nuk jam koprrac, frikacak dhe gënjeshtar!”

Pastaj qëndroi pranë devesë së tij dhe nga kurrizi i saj mori disa fije leshi dhe duke ngritur dorën lart tha: “O njerëz, Vallahi, unë s’kam të bëj me mallrat tuaja as edhe sa këto qime deveje! Edhe nëse një të pestën e tyre e heq mënjandë, ajo sërish të varfërve tuaj do t’u shpërndahet. Kthejeni nga peri e gjilpëra, të gjithë! Dijeni mirë se pabesia në plaçkën e luftës i kthehet personit në Ditën e Kiametit si zjarr.”

Pastaj një ensar solli një lëmsh të bërë nga fijet e flokëve, i cili tha: “O i Dërguari i Allahut! Këtë lëmsh e mora për ta vënë nën shalën e devesë time, e cila ka disa plagë në shpinë!”

Pejgamberi a.s. tha: “Sa për pjesën time që më takon, ja merre, po ta fal!”

Ensariu u përgjigj: “Pasi qenka puna kështu, jo, nuk më nevojitet!” Dhe e hodhi lëmshin nga dora.

Pejgamberi a.s. pastaj një pjesë të plaçkës ua ndau atyre zemrat e të cilëve kërkonte t’i afronte edhe më shumë me Islamin, sidomos atyre që ishin më të shquar, që përmes tyre pastaj t’i përfitonte edhe njerëzit e tyre. Kështu, për shembull, Ebu Sufjan b. Harbit edhe djalit të tij Muavijut u caktoi nga 100 deve, pastaj Hakim b. Hizamit, Harith b. Harith b. Keledes, Suhejl b. Amrit, Huvejtib b. Abduluzzas, Ala' b. Xharije Thekafjut, Ujejne b. Hisnit, Akre'a b. Habis Temimit, Malik b. Avf Nasrit dhe Safvan b. Umejjes të gjithëve këtyre u dha nga 100 deve.

Më pak se njëqind deve ua dha disa Kurejshëve, ndër të cilët janë Mahreme b. Nufel Zueriu, Umejz b. Veheb Xhumehiu dhe Hisham b. Amër, nga fisi Benu Amir b. Luejj. Nuk e mbaj mend se sa u dha saktësisht, por e di se ishte nën njëqind.

Pastaj, Seid b. Jerbu' b. Ankethe dhe Semhiut u dha nga 50 deve.

Ndërkaq, deve të vogla rreth pesëvjeçare i dha Abbas b. Mirdasit, i cili duke e parë si të paktë mallin që i ishte dhënë u zemërua shumë dhe e qortoi Pejgamberin a.s.. Ky recitoi disa vargje qortuese për Pejgamberin a.s.:

*Një pre të tillë unë e kam realizuar,  
në një vend të lehtë mëzat duke i sulmuar!  
Duke qenë zgjuar ndërsa të tjerët po pushonin,  
dhe duke mos fjetur kur ata gjumë po bënin!  
Dhe tani preja ime dhe preja e Abidit<sup>179</sup> tim,*

<sup>179</sup> El-Abid, emri i kalit të tij.

*mbeti në mes të Ujejnës dhe Akre'it!  
Në luftë, unë e mbrojta popullin tim,  
dhe për këtë nuk m'u dha ndonjë kompensim!  
Përveçse katër mëza deveje që m'i dhanë,  
që secila syresh po nga aq këmbë kanë!  
As Hisni as Habisi nuk kanë qenë më lart,  
në konfliktin e tyre që kanë pasur me tim atë!  
Dhe as unë nuk kam qenë njeri më i keq se ata!  
kënd e përul sot, ai dot nuk ngrihet lart!*

Pejgamberi a.s. tha: "Merreni atë dhe në vendin tim prejani gjuhën!" Ata e morën dhe i dhanë pasuri derisa u pajtua me atë që i dhanë. Kjo ishte prerja e gjuhës së tij që urdhëroi Pejgamberi a.s.<sup>180</sup>.

Nga Ebu Seid Hudriu transmetohet se ka thënë:

"Kur Pejgamberi a.s. i shpërbleu Kurejshët dhe disa fise të tjera arabe, ndërsa për ensarët nuk mbeti asgjë, ata në vetvete ndjenë siklet dhe në mesin e tyre gjithnjë e më shpesh filluan të dëgjohen fjalë të këqija. Një prej tyre madje kishte thënë: "Vallahi, i Dërguari i Allahut i mirëpriti njerëzit e tij!" Pastaj u afrua Sa'd b. Ubade dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, disa ensarë janë hidhëruar për shkak të mënyrës së ndarjes së plaçkave të luftës. I dhe popullit tënd, i dhe pjesë të mëdha të plaçkave dhe fiseve arabe, ndërsa në tërë këtë ndarje ensarët nuk morën pjesë."

Pejgamberi a.s. i tha: "E çka fitove ti, o Sa'd?" Ai u përgjigj: "Unë jam sikurse edhe populli im."

Pejgamberi a.s. i tha: "Thirre popullin tënd në këtë vend të rrethuar!"

Sa'di vajti dhe i sollti ensarët në vendin e caktuar. Atë çast erdhën edhe disa muhaxhirë, të cilët i lejoi të hynin. Erdhën edhe disa njerëz të tjerë, por Sa'di nuk i la të hynin. Kur u tubuan të gjithë, Sa'di erdhi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: "Ja, unë t'i tubova këta njerëz nga ensarët." Pejgamberi a.s., erdhi para tyre, e falënderoi Allahun dhe e lavdëroi Atë, pastaj tha: "O ensarë! Çfarë janë ato fjalë që kam dëgjuar dhe ai hidhërim i juaji për mua? Por, më thoni, a nuk jua tregoi Allahu udhën e drejtë me anën time atëherë kur ju ishit idhujtarë që e kishit ngatërruar udhën? Ndërsa ishit të varfër, a nuk ju bëri Allahu të pasur pas ardhjes sime mes jush? Ndërsa ju brente pa pushim urrejtja dhe armiqësia mes jush, a nuk jua rregulloi Allahu me ardhjen time zemrat e ju bashkoi?"

Ata u përgjigjën: "Po. Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë më të besueshmit dhe më të vlefshmit."

<sup>180</sup> Ibni Hishami thotë: "Disa dijetarë më kanë thënë se Abbas b. Mirdasi është sjellë para Pejgamberit a.s. dhe e pyetën: "A ke thënë ti: "Dhe tani preja ime dhe preja e Abidit tim mbeti në mes të Ujejnës dhe Akre'it!"" Ebu Bekër Siddiku tha: "Ndërmjet Ujejnës dhe Akre'it!" Pejgamberi a.s. tha: "Është e njëjtë", kurse Ebu Bekri shtoi: "Dëshmoj se ti je ashtu siç ka thënë Allahu: "Ne as nuk ia mësuam atij (Muhamedit) poezinë, e as që i takon ajo atij..." (Jasin, 69)

Pastaj Pejgamberi a.s. vazhdoi: “O ensarë, a do të më përgjigjeni për një pyetje?” Ata thanë: “E çka të përgjigjemi, o Pejgamber i Allahut? Bamirësia dhe çdo vlerë i takon Allahut dhe të Dërguarit Tij.”

Pejgamberi a.s. tha: “Vallahi, nëse dëshironi mund ta thoni! Dhe do ta thoni të vërtetën dhe ajo do t’ju konfirmojë: Mund të thoni: Erdhe te ne kur të tjerët të thoshin gënjeshtar, ndërsa ne i besuam të vërtetës sate. Erdhe i thyer, ndërsa te ne u bërë fitues. Erdhe i përndjekur, ndërsa ne të pranuan dhe të ndihmuam. Erdhe i varfër, ndërsa ne të përkrahëm.

*O ensarë, a ju vjen vështirë që ndava diçka nga kjo botë për të përfituar disa njerëz në Islam?! O ensarë, a do kishit qenë më të kënaqur që njerëzit të shkonin me delet dhe me devetë e veta e ju të ktheheni me Pejgamberin nëpër shtëpitë tuaja? Pasha Atë, në dorën e të Cilit është jeta e Muhamedit, sikur të mos ndodhte hixhreti, edhe unë do të isha njëri prej ensarëve. Sikur këta njerëz të niseshin në një anë e ju ensarët në anën tjetër, unë do të nissha me ju. O Allahu im, mëshiroji ensarët, bijtë e ensarëve dhe nipat e ensarëve!”*

Ensarët filluan të qanin. Lotët u shkonin rrëke dhe ua lagnin mjekrat. Ata thanë: “Jemi të kënaqur me Pejgamberin e Allahut. Jemi të kënaqur me ndarjen e tij dhe me fatin tonë me të!”

Pastaj Pejgamberi a.s. doli dhe ata u shpërndanë.

## UMRA E PEJGAMBERIT A.S. NGA VENDI XHI'RANE

Për mbikëqyrës të Mekës, Pejgamberi a.s. emëroi Attab b. Esijdin, i cili haxhin me muslimanët e kreu në vitin e tetë hixhrij.

Ibni Is'haku thotë:

“Pejgamberi a.s. nga vendi Xhi'rane shkoi për të bërë umren dhe urdhëroi që pjesa e mbetur e plaçkave të depozitohet në Mexhenne, në anën e kanionit Dhahran. Pas përfundimit të saj, ai u kthye në Medinë, ndërsa për mbikëqyrës të Mekës emëroi Attab b. Esijdin dhe me të la edhe Muadh b. Xhebelin me detyrë që t'u mësojë njerëzve rregullat e fesë dhe t'ua mësojë Kur'anin. Me vete kishte edhe pjesën e mbetur të plaçkës. Umren e bëri në muajin dhul-kade, ndërsa në pjesën e mbetur të tij ose në fillim të dhul-hixhjes arriti në Medinë.”

Ibni Is'haku thotë:

“Atë vit njerëzit haxhin e kryen ashtu siç e kryenin arabët edhe më parë. Këtë vit muslimanët në haxh i udhëhoqi Attab b. Esijdi. Kjo ishte në vitin e tetë hixhrij.

Taifi ende këmbëngulte në idhujtarinë e vet. Pejgamberi a.s. së shpejti hyri në muajin ramazan dhe kështu doli në vitin e nëntë.”

### Rasti i Ka'b b. Zuhejrit pas tërheqjes nga Taifi

Pas mbërritjes së Pejgamberit a.s. nga tërheqja e tij nga Taifi, Buxhejr b. Zuhejr b. Ebu Sulme i dërgoi një letër vëllait të tij Ka'b b. Zuhejr, në të cilën e njofton se Pejgamberi a.s. në Mekë ka likuiduar shumë njerëz të cilët e kanë fyer dhe ofenduar dhe se pjesa tjetër e poetëve Kurejshë, si Ibn Zeba'ra dhe Hubejre b. Ebu Veheb, kanë ikur nga kanë mundur. Nëse ti ke ndonjë nevojë, shpejto për tek Pejgamberi a.s. sepse ai askënd nuk do ta vrasë nëse i vjen si i penduar, por nëse nuk e bën, atëherë shpëto si të mundësh!”

Në përgjigje të letrës së tij, Ka'bi i shkroi një numër vargjesh të cilat ia dërgoi Xhubejrit dhe ky nuk deshi t'i mbajë të fshehta nga Pejgamberi a.s., ndaj ia lexoi atij. Kur i dëgjoi, Pejgamberi a.s. tha: *“Le të japë për të pirë i Besueshmi! Të vërtetën e ka thënë, ndonëse është gënjeshtar i madh, ndërsa unë jam i besueshmi!”* Dhe kur i dëgjoi fjalët: “Moral i tij është e tillë që nuk mund të kompensohet as me nënë e as me baba!”, ai tha: *“Sigurisht, se nuk mund të kompensohet as me nënë e as me baba!”*

Ibni Is'haku thotë:

“Kur Ka'bi e mori letrën, u ngushtua shumë dhe nuk dinte çfarë të bënte. U ndje i mjerë dhe i erdh i keq për veten. Armiqtë e tij përreth ngritën potere dhe

thanë: “Ai është i vdekur!” Në fund, kur nuk gjeti asnjë mënyrë tjetër, e thuri kasiden e tij, në të cilën i shprehu falënderim Pejgamberit a.s. duke nxjerrë në pah frikën e tij si dhe zhurmën e armiqve të tij, e pastaj u nis për në Medinë. Atje ai së pari u ndal te një njeri me të cilin njihej që nga Xhuhejne, siç më është thënë, dhe ai njeri e çoi te Pejgamberi a.s. në kohën e namazit të sabahut.

Pas përfundimit të namazit, në të cilin edhe ai mori pjesë, i tha: “Ja, ai është i Dërguari i Allahut, afroju dhe kërko prej tij siguri!”

Më është thënë se pastaj Ka’bi iu afrua Pejgamberit a.s., u ul para tij, u përshëndet me të dorë për dore - ndërsa Pejgamberi a.s. ende nuk e njihte – e i tha: “O Pejgamber i Allahut, Ka’bi ka ardhur si i penduar dhe mendoj se kërkon mbrojtje nga ti. A do ta pranosh pendesën e tij nëse unë e sjell para teje?” Pejgamberi a.s. u përgjigj: “Po!” Atëherë Ka’bi tha: “Unë jam Ka’b b. Zuhejri.”

Ibni Is’haku më tutje thotë:

“Më ka treguar Asim b. Omer b. Katade se kur e dëgjoi këtë njëri prej ensarëve kërceu në këmbë dhe kërkoi leje nga Pejgamberi a.s. që ta vriste, kurse Pejgamberi a.s. i tha: “Lëre të qetë! Ai ka ardhur i gatshëm për ta braktisur mënyrën e jetesës së gjertanishme dhe të pendohet.”

Ka’bi për këtë shkak shumë u zemërua me këta ensar, sidomos për faktin se të gjithë muhaxhirët për të ishin shprehur vetëm me lavdërim. Kur erdhi para Pejgamberit a.s., si poet i talentuar që ishte, recitoi kasiden e njohur e cila fillon me vargje dashurie kushtuar “Suadës” së dashur nga periudha paraislamike<sup>181</sup>:

*“Banet Suadu fe kalbil-jevme metbulu  
mutej-jemun isruha lem jufde mekbulu.”*

Përkthimi:

*“Shkoi Suada.  
Zemra ime mezi pret të hakmerret.  
E kam dashuruar si hyjneshë.  
Për shkak të saj nuk do të kem më flijim  
e as që do të lidhem në zinxhirë.”*

Në këtë kaside gjenden vargjet me të cilat Ka’bi kërkonte falje nga Resulullahu a.s. për vjershat e veta të mëparshme dhe i kushton atij një lavdithurje, në të cilën vë në pah virtytet e Resulullahut a.s. si falës, mëshirues dhe i shoqërueshëm. E lavdëron Kur’ani Kerimin për urtësinë e udhëzimet e tij, ndërsa i qorton fjalët e magjistarëve e të falltarëve dhe thotë se Resulullahu a.s. është njeri i mirë përkundër asaj se ç’thoshin ata. Betohet se do t’i qëndrojë besnik fesë dhe Resulullahut a.s.,

181 Cituar sipas librit “Nektari i vulosur i Xhenetit”, fq. 538.

të cilit edhe iu betua. Resulullahu a.s. në sytë e tij pa një dritë, e cila shndriste, e priste të keqen në rrënjë dhe e ndante të drejtën porsi shpatat indiane.

Pastaj vazhdon me lavdërimin e muhaxhirëve - Kurejshëve, sepse asnjëri prej tyre nuk i tha Ka'bit ndonjë fjalë të keqe kur erdhi te Resulullahu a.s.. Në kaside përmendet edhe ensari që kërkoi leje për ta vvarë.

Kur Ka'bi e pranoi Islamin dhe u bë besimtar i mirë, thuri një kaside, të cilën ua kushtoi ensarëve dhe në të cilën lavdëronte mirësinë dhe mikpritjen e tyre.

### BETEJA E TEBUKUT (Rexheb, viti i 9 h.)

Pejgamberi a.s. kaloi në Medinë kohën midis muajve dhul-hixhxe dhe rexheb, pastaj urdhëroi që të bëheshin përgatitje për sulmin mbi bizantinët.

Një pjesë e madhe e dijetarëve tanë, në mesin e tyre Zuhriu, Jezid b. Ruman, Abdullah b. Ebi Bekër, Asim b. Omer b. Katade dhe të tjerë, janë marrë me Betejën e Tebukut, secili sipas njohurive të tij personale, kështu që te secili prej tyre gjejmë diçka që mungon te të tjerët.

Ata deklarojnë se Pejgamberi a.s. i urdhëroi sahabët që të bëjnë përgatitje të plota për ekspeditë kundër Bizantit, në një kohë që ishte shumë e papërshtatshme për njerëzit sepse ishte nxehtësi e madhe dhe krejt zonën e kishte përfshirë një thatësi, kur frutat ishin pjekur dhe kur njerëzit kishin dëshirë të qëndronin në hije, në mesin e këtyre frutave, dhe urrenin që dikush t'i shqetësonte nga ajo gjendje. Pejgamberi a.s. kur shkante në ndonjë ekspeditë rrallëherë tregonte hap-tazi se ku po shkante. Kryesisht ai shprehej me aludim dhe përmendte një anë tjetër - jo atë që kishte për qëllim. Megjithatë, në rastin e Betejës së Tebukut veproi ndryshe: ua shpalli publikisht njerëzve për shkak të rrugës së gjatë deri atje, për shkak të kohës së vështirë që ishte dhe për shkak se kishte shumë armiq të cilët e synonin atë.

Për shkak të gjithë këtyre njerëzit duhet të bënin përgatitje të veçanta, për çka ai enkas urdhëroi, duke u thënë atyre se kishte për qëllim që të sulmonte bizantinët.

Një ditë, derisa po bëheshin përgatitjet, Pejgamberi a.s. e pyeti Xhedd b. Kajsin, një njeri nga Benu Seleme: *"O Xhedd, a do të shkosh këtë verë në luftë kundër të verdhëve?!"*<sup>182</sup>

Ai u përgjigj: *"O i Dërguari i Allahut, a nuk do të më lirosh dhe të mos futem në sprovë?! Populli im e di mirë se askush nuk i do femrat më shumë se unë dhe po frikësohem se kur t'i shoh gratë e atyre të verdhëve, nuk do të mund të duroj!"* Pejgamberi a.s. i tha: *"Po të liroj!"* dhe u largua prej tij.

Në lidhje me Xhedd b. Kajsin është shpallur ky ajat:

*"Dhe prej tyre ka të tillë që thonë: "Më lejo mua (të mos shkoj në luftë) e mos më vë në sprovë!" Ja, ata mu në sprovë kanë rënë (më parë). Xhehenemi gjithsesi i përfshin nga të gjitha anët jobsimtarët."* (Et-Tevbe, 49), d.m.th. nëse i frikësohet sprovës nga gratë bizantine, që edhe nuk është arsyeja e vërtetë, sprovë shumë më e madhe

<sup>182</sup> Të verdhët ose Benul-Esfer ishin bizantinët.

në të cilën ka rënë ai është mosshkuarja e tij pas Pejgamberit a.s. dhe kundërshtimi i tij. Ai thotë: *“Pas tij, me të vërtetë, është xhehenemi!”*

Hipokritët i thoshin njëri-tjetrit: *“Ku po shkoni në këtë nxehtësi!?”*, duke iu shmangur xhihadit, duke dyshuar në të vërtetën dhe duke përhapur gënjeshtër për Pejgamberin a.s.. Rreth tyre Allahu i Plotfuqishëm ka shpallur:

*“Ata (hipokritët) që mbetën (pa shkuar në luftë), u gëzuan për ndenjen e tyre pas të Dërguarit të Allahut dhe nuk dëshiruan që të luftonin me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e Allahut dhe thanë: “Mos dilni (në luftë) në vapë!” Thuaju: “Zjarri i xhehenemit ka vapën edhe më të fortë”, nëse janë që kuptojnë! Le të qeshin pak (në dynja) e le të qajnë shumë (në botën tjetër). Ai është shpërblim i asaj që fituan.”* (Et-Tevbe, 81-82)

Ibni Is'haku thotë:

*“Pejgamberi a.s. pastaj i intensifikoi përgatitjet për udhëtim dhe nga njerëzit kërkoi që të nxitonin, ndërsa të pasurit i inkurajoi që të japin nga pasuria e tyre dhe të sjellin çfarë është e nevojshme në rrugën e Allahut. Kështu disa njerëz të pasur sollën mjete me bollëk. Osman b. Affani me atë rast kishte dhënë pasuri më shumë se çdokush tjetër<sup>183</sup>.*

Disa njerëz, ndërkaq, erdhën te Pejgamberi a.s. duke qarë. Ata ishin shtatë persona, disa prej të cilëve ishin ensarë e disa nga fiset e tjera. Nga fisi Benu Amër b. Avf ishin: Salim b. Umejr dhe Ulbe b. Zejd, nga fisi Benu Harithe: Ebu Leila Abdurrahman b. Ka'bi, nga Benu Mazin b. Nexhxhar: Amër b. Humam b. Xhemuh, nga Benu Seleme: Abdullah b. Mugaffel Muzniu. Disa thonë edhe: *“Abdullah b. Amër Muzniu dhe Hermi b. Abdullah, nga Benu Vakifi: Irbad b. Sari Fezzaziu.*

Këta, pasi ishin shumë të varfër, kërkuan nga Pejgamberi a.s. që t'i vendoste mbi ndonjë kafshë. Mirëpo, kur Pejgamberi a.s. u tha: *“Nuk mund të gjej kafshë ku t'ju vendos!”*, ata u kthyen me sy plot lot, të pikëlluar që nuk kanë asnjë gjë për të dhënë.

Kam kuptuar se Ibn Jamin b. Umejr b. Ka'b Nadriu i kishte takuar Ebu Lejla Abdurrahman b. Ka'bin dhe Abdullah b. Mugaffelin që të dy duke qarë dhe i kishte pyetur: *“Përse po qani?”* Ata të dy ishin përgjigjur: *“Ne shkuam tek i Dërguari i Allahut që të na gjente kafshë për udhë, por nuk na gjeti dot. Kurse ne s'kemi kafshë transporti që të mund të shkojmë në luftë së bashku me të Dërguarin e Allahut!”*

<sup>183</sup> Ibni Hishami thotë: *“Më kanë treguar, ata të cilëve u besoj plotësisht, se Osman b. Affani për ushtrinë që u përgatit për Betejën e Tebukut kishte dhënë një mijë, për të cilën Pejgamberi a.s. kishte thënë: “O Zot, ji i kënaqur me Osmanin sepse unë jam i kënaqur me të!”*

Atëherë ai ua dha atyre devenë e tij me të cilën sillte ujë. Ata menjëherë ia vendosën shalën, kurse ai u dha edhe pak hurma dhe kështu ata shkuan me Pejgamberin a.s..

Thuhet se në fakt ata ishin një grup njerëzish nga Beni Gifari.

Pastaj te Pejgamberi a.s. erdhën arabë me pretekte dhe justifikime të ndryshme, por atyre nuk ua pranoi justifikimin Allahu i Plotfuqishëm.

Ndërkohë, Pejgamberi a.s. po bëhej gati për udhëtim dhe po kryente përgatitjet e fundit. Një grup muslimanësh, të cilët kishin ndër mend të shkonin me të, në një mënyrë ose në një tjetër, ishin penguar dhe kishin mbetur prapa, por sigurisht jo nga dyshimi apo hezitimi. Midis tyre ishin Ka'b b. Malik b. Ebu Ka'b, Murare b. Rabi', Hilal b. Umejje, Ebu Hejthème - të gjithë ishin njerëz shumë të sinqertë, në përkushtimin e të cilëve ndaj Islamit nuk kishte asnjë dyshim.

Pejgamberi a.s. pas nisjes së pari e ngriti kampin e tij në Thenijjetul-Veda<sup>184</sup>, ndërsa pak më poshtë Abdullah b. Ubejj kishte ngritur një kamp të ndarë, në drejtim të Dhubabit<sup>185</sup>. Disa pohojnë se ky kamp nuk ishte aspak më i vogël se ai i Pejgamberit a.s..

Kur Pejgamberi a.s. vazhdoi rrugën, Abdullah b. Ubejj kishte mbetur pas tij së bashku me hipokritët dhe dyshuesit.

Pasi Pejgamberi a.s. e kishte lënë prapa Ali b. Ebi Talibin që të kujdesej për familjen e tij dhe e kishte urdhëruar që të ishte vazhdimisht me të, hipokritët kishin filluar të përhapnin gënjeshtër rreth tij.

Ata thanë: "Vallahi, e ka lënë prapa për ta kursyer dhe për ta shmangur nga këto vuajtje!"

Me të dëgjuar këto dezinformata të hipokritëve, Aliu menjëherë i kapi armët e tij dhe u nis drejt Pejgamberit a.s., i cili ishte ndalur në Xhuref<sup>186</sup>. Tha: "O Pejgamberi i Allahut, hipokritët po pohojnë se ti më ke lënë prapa për të më kursyer dhe shmangur nga vuajtjet!"

Pejgamberi a.s. tha: *"Ata janë duke gënjyer! Të kam lënë prapa për shkak të atyre që kam lënë prapa, ndaj kthehu prapa dhe më zëvendëso në familjen time dhe familjen tënde! A nuk je i kënaqur të jesh ndaj meje sikurse ka qenë Haruni ndaj Musait, vetëm që pas meje nuk do të ketë më Pejgamber?!"*

Kështu Aliu përsëri u kthye në Medinë, ndërsa Pejgamberi a.s. vazhdoi rrugën tutje.

Pasi Pejgamberi a.s. u largua nga Medina, Ebu Hejthème, në një ditë të nxehetë, u kthye për të kaluar disa ditë me familjen e tij. Dy gratë e tij i gjeti në kasollet

<sup>184</sup> Thenijjetul-Veda', emër i një qafëmalit mbi Medinë, rrugës për Mekë.

<sup>185</sup> Dhubab, kodër në Medinë.

<sup>186</sup> Xhuref, vend tri milje larg Medinës, në drejtim të Sirisë. Aty ndodheshin pasuritë e Omer b. Hattabit dhe banorëve të Medinës.

e bëra nga degët<sup>187</sup> në kopshtin e tij. Secila prej tyre e kishte spërkatur me ujë kasollen e saj, i kishte ftohur ujë dhe i kishte përgatitur ushqim. Kur ai arriti, qëndroi në derë të kasolles, shikoi gratë e tij dhe atë që ato i kishin përgatitur atij, pastaj tha: "Pejgamberi a.s. në diellin përcëllues, në erë dhe nxehtësi, ndërsa Ebu Hejtheme këtu nën hije të freskët, me ushqim të përgatitur dhe me grua të bukur duke qëndruar në pasurinë e tij. Kjo nuk është e drejtë!" Pastaj shtoi: "Vallahi, nuk do të hyj në kasollen e asnjërës prej jush derisa t'i bashkëngjitem Pejgamberit a.s.! Më përgatitni çfarë më nevojitet për rrugë!" Dhe ato i përgatiten çfarë kishte nevojë.

Ai pastaj e nxori devenë e tij që e përdorte për të bartur ujë, ia vuri shalën dhe menjëherë u nis në kërkim të Pejgamberit a.s. derisa arriti në Tebuk. Duke shkuar rrugës e mbërriti Umejri b. Veheb Xhumehiun, i cili gjithashtu kërkonte Pejgamberin a.s., kështu që të dy u bashkuan. Kur ata tashmë i ishin afruar Tebukut, Ebu Hejtheme i tha Umejrit: "Unë me vete kam një mëkat, ndaj bën mirë sikur të qëndrosh pak prapa meje derisa unë të shkoj te Pejgamberi a.s.." Dhe ky ashtu veproi.

Derisa ky po afrohej, ndërsa Pejgamberi a.s. në ato momente ishte duke zbritur në Tebuk, njerëzit thanë: "Ja atje, një kalorës është duke ardhur!"

Pejgamberi a.s. tha: "Je ti, o Ebu Hejtheme!"

Ata i thanë: "O i Dërguari i Allahut, për Zotin, ai është Ebu Hejtheme!"

Kur erdhi tek ata, e urdhëroi devenë që të bjerë në gjunjë, pastaj u afraua dhe u përshëndet me Pejgamberin a.s., i cili i tha: "Ishe duke u shkatërruar, o Ebu Hejtheme!" Dhe ky i tregoi se çfarë kishte ndodhur. Ndërkaq, Pejgamberi a.s. i tha: "Qoftë me të mirë!" dhe e luti Allahun për të mirën e tij.

Duke kaluar nëpër Hixhr<sup>188</sup>, Pejgamberi a.s. u ndal aty dhe njerëzit nga pusët u furnizuan me ujë, ndërsa kur u kthyen, Pejgamberi a.s. tha: "Mos pini nga ai ujë, as mos merrni abdest për namaz! Brumin që e keni zënë me të mos e hani, por me të ushqeni devetë! Askush mos të dalë jashtë natën i vetëm pa ndonjë shok!"

Dhe njerëzit vepruan sipas fjalëve të Pejgamberit a.s., me përjashtim të dy vetave nga fisi Benu Sa'ade: njëri kishte dalë jashtë për nevoja fiziologjike, ndërsa tjetri për të kërkuar devenë e tij. Atij që doli për nevoja fiziologjike i ishte zënë fryma në tualet, ndërsa tjetrin e kishte bartur era në kodrinën e fisit Tajji'. Kur u informua për këtë, Pejgamberi a.s. tha: "A nuk ju ndalova që të mos dilni jashtë të vetëm pa ndonjë shok?!" Pastaj, për atë që iu ndal fryma në tualet, Pejgamberi a.s. bëri lutje dhe ai u shërua, ndërsa atë që e barti era në kodrinën e fisit Tajji', ia dhuruan Pejgamberit a.s. kur erdhi në Medinë.

<sup>187</sup> Kasolle nga degët (arish), e ngjashme me tendën, të cilën e ndërtonin në kohë të nxehta dhe ishte më e freskët se shtëpia.

<sup>188</sup> Hixhr, një fshat nga njëra anë e Medinës, në të cilin gjendeshin pusët e fisit Benu Sulejm.

Të nesërmen në mëngjes njerëzit nuk kishin me vete ujë, ndaj u ankuan te Pejgamberi a.s. dhe ai menjëherë e luti Allahun të dërgonte një re, nga e cila ra shi. Kështu njerëzit e shuan etjen e tyre dhe u pajisen me sasi të nevojshme uji.

Pastaj Pejgamberi a.s. vazhdoi tutje, kur në një pjesë të rrugës humbi deveja e tij dhe sahabët dolën në kërkim të saj. Në ato momente, te Pejgamberi a.s. po qëndronte një sahab i quajtur Umare b. Hazm. Ai kishte marrë pjesë në Akabe dhe në Bedër, ishte xhaxhai i Beni Amër b. Hazmit. Me të ishte edhe një hipokrit, Zejd b. Lusajt Kajnuka'iu.

Derisa Umare ishte me Pejgamberin a.s., Zejd b. Lusajti tha: "A nuk po pretendon Muhamedi se është Pejgamber dhe po ju flet lajme nga qielli, ndërsa këtu ai nuk po e di se ku është deveja e tij?!"

Pejgamberi a.s. derisa Umare ishte ende me të tha: *"Dikush po thotë: "A nuk po pretendon Muhamedi se është Pejgamber dhe po ju flet lajme nga qielli, ndërsa këtu ai nuk po e di se ku është deveja e tij?! Vallahi, unë di vetëm atë që më mëson Allahu dhe Ai tani po më tregon se deveja ime gjendet në filan luginë, në filan grykë, i është ngatërruar kapistra te një pemë! Shkoni dhe silleni këtu!"*

Ata shkuan dhe së shpejti e sollën devenë, ndërsa Umare u kthye në vendin e tij.

Ai tha: "Vallahi, Pejgamberi a.s. pak më parë na ka folur diçka të çuditshme. Për diçka që dikush ka folur dhe Allahu e informoi për të – për ato që kishte thënë Zejd b. Lusajti – Atëherë njëri nga ata që kishin qenë në vendpushimin e Umares dhe nuk kishte qenë i pranishëm me Pejgamberin a.s. tha: "Vallahi, Zejdi pikërisht këto ka thënë para se të arrije ti këtu!" Atëherë Umare i afrohet Zejdit, e godet në qafë dhe i thotë: "Këtej, o robërit e Allahut! Unë nuk e kam ditur se me vete kam këtë fatkeqësi! Shporru nga këtu armik i Allahut dhe mos u shoqëro me mua!"

Disa pohojnë se Zejdi pas kësaj u pendua, ndërsa të tjerë thonë se ai vazhdimisht nuk u nda nga e keqja, deri në vdekjen e tij.

Pastaj Pejgamberi a.s. vazhdoi tutje. Sa herë që dikush nga njerëzit mbetej prapa, ata i thoshin: "O i Dërguari i Allahut, filani dhe filani kanë mbetur pas nesh!" Ndërsa ai thoshte: *"Lëreni, nëse në të ka dobi, Allahu disi e bashkon me ju, e nëse jo, atëherë Allahu do t'ju shpëtojë prej tij!"* Madje edhe kur i thanë: "O i Dërguari i Allahut, ka ngelur prapa Ebu Dherri, deveja i është ngadalësuar!", ai përsëri tha: *"Lëreni, nëse në të ka dobi, Allahu disi e bashkon me ju, e nëse jo, atëherë Allahu do t'ju shpëtojë prej tij!"*

Ebu Dherri një kohë hezitoi mbi devenë e tij dhe kur ajo plotësisht u ngadalësua, i mori pajisjet, i vuri në shpinën e tij dhe duke ecur në këmbë u vu në ndjekje të gjurmëve të Pejgamberit a.s.. Kur Pejgamberi a.s. u ndal në një nga vendpushimet e tij, dikush nga muslimanët e vërejti dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, ja atje një njeri është duke shkuar rrugës i vetëm!" Pejgamberi a.s. tha:

*"Je ti, o Ebu Dherr!"* Kur e shikuan me kujdes, ata thanë: "O i Dërguari i Allahut, vallahi, ai është Ebu Dherr!" Pejgamberi a.s. tha: *"Allahu e mëshiroftë Ebu Dherrin! Po shkon i vetëm, do të vdesë i vetëm dhe do të ringjallet i vetëm!"*

Abdullah b. Mesudi thotë:

"Kur Ebu Dherr u dëbua në Rebedhe<sup>189</sup> dhe e goditi fati i tij, bashkë me të ishin vetëm gruaja e tij dhe djali. Ai i porositi: "Ma lani xhenazen dhe më mbësh-tillni me qefin. Pastaj më vendosni në rrugë të hapur dhe kalorësit të parë që kalon atypari thojini: "Ky është Ebu Dherr, shoku i Pejgamberit a.s., na ndihmoni që ta varrosim!"

Dhe kur ai vdiq, ata ashtu vepruan me të. Dhe e vendosën në rrugë të hapur. Atypari kaloi Abdullah b. Mesudi me një grup irakianësh, të cilët ishin nisur për të kryer umren. Ata i frikësoi xhenazja në mes të rrugës, të cilën për pak sa nuk e shkelën devetë!

Pastaj atyre iu afrua djaloshi dhe u tha: "Ky është Ebu Dherr, shoku i Pejgamberit a.s., na ndihmoni që ta varrosim!"

Me atë rast, Abdullah b. Mesudi filloi të qajë e tha: "Të vërtetën e ka thënë Pejgamberi a.s.: *"Po shkon i vetëm, do të vdesë i vetëm dhe do të ringjallet i vetëm!"*

Pastaj zbritën nga kafshët dhe e varrosën. Ndërsa Abdullah b. Mesudi u tregoi çfarë kishte ndodhur dhe çfarë kishte thënë Pejgamberi a.s. gjatë rrugës së tij për në Tebuk."

Kur Pejgamberi a.s. arriti në Tebuk, erdhi tek ai Johanne b. Ru'be, pronar i portit Ilije<sup>190</sup>, dhe me Pejgamberin a.s. bëri marrëveshje duke pranuar dhënien e xhizjes<sup>191</sup>. Gjithashtu, erdhën edhe banorët e Xherbaes dhe Edhruhut, të cilët në mënyrë të njëjtë pranuan dhënien e xhizjes. Pejgamberi a.s. për këtë u shkroi edhe konfirmimin me shkrim, i cili edhe tani ndodhet tek ata.

Pejgamberi a.s. i shkroi Johanne b. Ru'bes si vijon:

*"Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Kjo është garanci nga Allahu dhe Muhamedi, Pejgamberi dhe i Dërguari i Allahut, dhënë Juhanne b. Ru'bes dhe banorëve të Ilijes. Anijet dhe karvanët e tyre janë të lirë të qarkullojnë nëpër tokë dhe nëpër det. Ata kanë kontratë nga Allahu dhe Muhamedi, Pejgamberi, sikurse edhe ata që janë me ta nga banorët e Shamit, të Jemenit dhe banorët e bregut të Detit të Kuq. Kushdo që prej tyre shkakton prishjen e kontratës, edhe ai edhe pasuria e tij i nënshtrohen hakmarrjes. Ata që i përmbahen kontratës, do ta kenë mirë. Kurrkush nuk guxon t'ia ndalojë ujin tjetrit, as rrugën, qoftë tokësore qoftë detare."*

<sup>189</sup> Rebedhe, emër vendi në Arabi.

<sup>190</sup> Ilije, port i dikurshëm në Detin e Kuq.

<sup>191</sup> Xhizje, lloj tatimi për jomuslimanët që jetojnë në shtetin islam.

## PEJGAMBERI a.s. DËRGON HALID B. VELIDIN TE UKEJDIR DUME

Pejgamberi a.s. e thirri Halid b. Velidin dhe e dërgoi te Ukejdir Dume, ose te Ukejdir b. Abdulmeliku, mbret i Kindes, i krishterë. Para nisjes së tij, Pejgamberi a.s. i tha Halidit: *“Ti ke për ta gjetur atë duke gjuajtur lopë!”*

Dhe Halidi mori rrugën. Kur iu afrua kështjellës së tij, aq sa mund të shihej me sy, nata ishte e kthjellët dhe me hënë të plotë, ndërsa ai dhe gruaja e tij ishin në terracë, kur papritmas lopët filluan të kruhen me brirë te dera e kështjellës. Gruaja e tij e pyeti: *“A ke parë ndonjëherë diçka si kjo?”* Ai u përgjigj: *“Jo, vallahi!”* Ajo i tha: *“Dhe kush do ta lëshonte këtë rast?”* Ai tha: *“Jo, askush.”* Atëherë zbriti poshtë dhe urdhëroi që të shalonin kalin e tij. Bashkë me të duke kalëruar u nis edhe një grup i familjarëve të tij, ndër të cilët ishte edhe vëllai i tij me emrin Hassan. Me vete morën shtiza të shkurtra gjuetie, mirëpo, sapo dolën, të gjithë u kapën nga kalorësia e Pejgamberit a.s., me përjashtim të vëllait të tij, i cili u vra. Ai kishte të veshur një kaftan (pelerinë) nga coha e mëndafshit e qëndisur me ar. Atë kaftan Halidi ia hoqi dhe ia dërgoi Pejgamberit a.s. përpara mbërritjes së tij.

Enes ibni Maliku thotë:

*“Unë e pashë kaftanin e Ukejdirit kur e prunë para Pejgamberit a.s.. Muslimanët e preknin me duart e tyre dhe admironin bukurinë e tij. Atëherë Pejgamberi a.s. u tha: “A po admironi këtë?! Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, shamitë e Sa’d b. Muadhrit në xhenet janë shumë më të mira se kjo!”*

Ibni Is’haku thotë:

*“Pastaj Halidi e pruri Ukejdirin para Pejgamberit a.s., të cilit ia fali jetën. Ai pastaj me Pejgamberin a.s. bëri marrëveshje paqeje dhe ra dakord për dhënien e xhizjes. Pejgamberi a.s. e la të lirë dhe ai u kthye në vendin e vet.”*

Në Tebuk, Pejgamberi a.s. kaloi më shumë se dhjetë net, duke mos shkuar më përtej dhe pastaj u nis për në Medinë. Gjatë kësaj rruge, në një luginë të quajtur Mushekkak, ishte një ujë i vogël që rridhte nga shkëmbi, që mund të ishte i mjaftueshëm për një kalorës, dy apo më së shumti për tre kalorës.

Pejgamberi a.s. u tha: *“Kush mbërrin para nesh në atë luginë, kurrsesi mos të marrë ujë nga aty para se të vijmë ne!”* Para tij atje kishte arritur një grup hipokritësh dhe e kishin shteruar krejt ujin që gjendej aty. Kur erdhi Pejgamberi a.s. dhe u ndal atje, ai nuk gjeti asgjë.

Atëherë tha: *“Kush ka ardhur këtu te ky uji para nesh?”*

I thanë: *“O i Dërguari i Allahut, filani dhe filani!”*

Ai tha: *“A nuk ju ndalova që mos të merrni asgjë para se të vijmë ne?!”* Pastaj i mallkoi ata dhe bëri lutje për ndëshkimin e tyre. Pastaj zbriti, e vuri dorën nën shkëmb, derdhi mbi të pak ujë dhe me ujë e lagu atë vend, pastaj e fshiu me dorën e tij. Aty bëri edhe një lutje, pastaj shpërtheu uji *“i shoqëruar nga një tingull si bubullimë”*, siç thonë ata që e dëgjuan.

Atëherë pinë ujë të gjithë njerëzit dhe morën edhe me vete për rrugë. Në fund Pejgamberi a.s. tha: *“Nëse mbijetoni, ose nëse dikush nga ju mbijeton, me siguri do të dëgjoni kur të flitet për këtë luginë – ajo është shumë më pjellore se pjesa tjetër që është para saj dhe ajo që është pas saj!”*

Ibni Is'haku thotë:

*“Ibn Shihab Zuhriu ka raportuar, duke iu referuar Ibn Ukejmete Lejthiut, e ky nga vëllai i vogël i Ebu Ruhm Gifariut, i cili thotë se e ka dëgjuar Ebu Ruhm Kulthum b. Hasinin, i cili ishte një prej shokëve të Pejgamberit a.s. që i kishin dhënë betimin e besnikërisë nën atë pemë, duke thënë: “Kam marrë pjesë me Pejgamberin a.s. në Betejën e Tebukut dhe një natë ne ishim në Ahdar, kurse unë isha afër Pejgamberit a.s.. Aty Allahu na lëshoi një sy gjumë. Kur fillova të zgjohem, e pashë se deveja ime i ishte afruar devesë së Pejgamberit a.s., kështu u frikësova se mos po ia dëmton këmbën e tij në yzengji, ndaj pak e dëbova prej tij, por pas pak përsëri më mashtroi dhe më mori gjumi sepse ishim thellë në natë. Deveja ime u ngushtua tek ajo e Pejgamberit dhe ai këmbën e tij e kishte në yzengji. Unë u zgjova vetëm pas britmës së tij: “Ah!” Unë i thashë: “Më fal, o i Dërguari i Allahut!” Ai vetëm më tha: “Shko!”*

Pastaj filloi të më pyeste për njerëzit e Benu Gifarit që kishin mbetur prapa dhe unë e informoja. Pastaj më pyeti: *“Çfarë u bë me ata lëkurëbardhët, të gjatët, me mjekra të rralla e me vetulla të holla?”* Atëherë unë i tregova për mungesën e tyre. Ai tha: *“Po me ata zeshkanët e shkurtër?”*

Unë i thashë: *“Vallahi, unë nuk di që ka të tillë në mesin tonë!”* Ai tha: *“Ata që kanë bagëti në Shebeketu Shede!”*<sup>192</sup> Atëherë m'u kujtua se një grup i tyre ishte në Beni Gifar. M'u kujtua se ata ishin nga fisi Eslem dhe ishin aleatët tanë. I thashë: *“O i Dërguari i Allahut, ata janë njerëz nga Eslemi, kanë qenë aleatë me ne.”*

Pejgamberi a.s. tha: *“Mungesa e tyre nuk e ka penguar asnjërin prej tyre që në deventë e tij të marrë ndonjë njeri të aftë për të luftuar në rrugën e Allahut! Unë më shumë do të kisha preferuar që të mungonin muhaxhirët, ensarët dhe njerëz nga Gifari dhe Eslemi!”*

<sup>192</sup> Shebeketu Shede, pjesë e banesave të fisit Gifar dhe Eslem në Hixhaz.

## DELEGACIONI I FISIT THEKIF DHE KALIMI I TYRE NË ISLAM (Ramazan, viti 9 h.)

Ibni Is'haku thotë:

“Pejgamberi a.s. nga Tebuku u kthye në Medinë në muajin ramazan dhe në këtë muaj tek ai erdhi delegacioni i fisit Thekif.

Kur Pejgamberi a.s. hoqi dorë prej tyre, duke u kthyer për në Medinë, gjurmëve të tij shkoi Urve b. Mesud Thekafiu dhe e arriti para se ai të hynte në qytetin e Medinës. Me këtë rast Urve e pranoi Islamin dhe kërkoi nga Pejgamberi a.s. që të kthehet te populli i tij me Islam. Siç thonë njerëzit e tij, Pejgamberi a.s. i ka thënë: *“Ata do të të vrasin ty!”* Sepse edhe vetë ishte bindur për arrogancën dhe rezistencën që kishin treguar. Urve i tha: *“O i Dërguari i Allahut, unë jam më i dashur për ta sesa fëmija i parë!”*<sup>193</sup>

Ai në mesin e tyre ishte vërtet i dashur dhe fjala e tij dëgjohej. Kështu që shkoi për t'i thirrur në Islam duke shpresuar se për shkak të respektit që gëzonte, ata do ta dëgjonin. Mirëpo, sapo u nis nga dhoma e tij dhe u kthye në drejtim të tyre duke i njoftuar për besimin e tij dhe duke i ftuar në Islam, ata nga të gjitha anët e gjuajtën me shigjeta dhe njëra e qëlloi dhe e vrau. Fisi Benu Malik pretendonte se atë e kishte qëlluar një njeri i tyre, njëfarë Evs b. Avf, nga fisi Benu Salim b. Malik, kurse Ahlafi pohonte se atë e kishte bërë njeriu i tyre, nga fisi Benu Attaba b. Malik, njëfarë Vehb b. Xhabiri.

E pyetën Urven në prag të vdekjes: *“Si e shikon ti këtë gjakun tënd?”* Ai u përgjigj: *“Unë këtë e shoh si një nder që Allahu më bëri mua, mendoj se jam i barabartë me shehidët që vdiqën duke luftuar me Pejgamberin a.s. para se të largohej nga ju, kështu që më varrosni në mesin e tyre!”*

Thuhet se Pejgamberi a.s. për të ka thënë: *“Ai te populli i tij është si shembulli i atij personi në suren Jasin në raport me popullin e tij!”*

Disa muaj pas vrasjes së Urves, fisi Thekif filluan të bënin kuvende mes vete dhe erdhën në përfundimin se nuk janë në gjendje të luftojnë kundër të gjitha fiseve arabe përreth, të cilat e kishin përqaftuar Islamin dhe i kishin shprehur besnikërinë e tyre Pejgamberit a.s..

Ata ranë dakord që të dërgojnë një njeri te Pejgamberi a.s., siç e kishin dërguar edhe Urven dhe rrjedhimisht biseduan me Abdu Jalil b. Amër b. Umejr, i cili ishte i moshës së njëjtë me Urve b. Mesudin, por kur ia paraqitën vendimin e

<sup>193</sup> Ibni Hishami thotë: *“Disa pohojnë se ka thënë: “Më i dashur se drita e syve të tyre!”*

tyre, ai refuzoi nga frika se kur të kthehej mbrapa, edhe ndaj tij do të vepronin ashtu siç vepruan me Urven.

Ai tha: “Unë nuk e bëj dot, përveç nëse dërgoni me mua edhe njerëz të tjerë!”

Pas konsultimeve shtesë, u pajtuan që të dërgojnë krahas tij edhe dy burra nga fisi Ahlaf dhe tre burra nga fisi Beni Malik dhe kështu grupi të numërojë gjashtë burra. Kështu me Abdu Jalilin dërguan: Hakem b. Amër b. Veheb b. Mu'attibin dhe Shurahbil b. Gajlan b. Seleme b. Mu'attibin nga fisi Beni Malik, pastaj Osman b. Ebil-As b. Bishr b. Abdi Duhmanin, nga fisi Beni Jesar, pastaj Evs b. Avfin nga fisi Beni Salim dhe Numejr b. Hareshe b. Rebia nga fisi Beni Harith.

Abdu Jalili shkoi me ta në cilësinë e udhëheqësit dhe përgjegjësit të tyre. Ai i mori me vete thjesht nga frika se mos po i ndodhte e njëjta gjë sikurse Urve b. Mesudit, sepse kur të ktheheshin në Taif me secilin prej tyre do të merrej fisi i tij.

Kur iu afruan Medinës, ata zbritën në një kanal dhe aty takuan Mugire b. Shu'ben, i cili po kulloste devetë për kalërim të Pejgamberit a.s., sepse ato kullota sahabët i mbikëqyrnin me ndërrime. Kur i pa ata, ai ua la thekifasve devetë, ndërsa vetë me vrap nxitoi për tek Pejgamberi a.s. që ta gëzojë për mbërritjen e tyre. Para se të hynte tek Pejgamberi a.s., takoi Ebu Bekër Siddikun, të cilit i tregoi në lidhje me kalorësit e Thekifit, që kishin ardhur për të përqaftuar Islamin dhe për të shprehur besën për besnikëri, por që Pejgamberi a.s. t'ua parashtronte atyre kushtet e tij dhe t'u përgatiste një dokument me shkrim për njerëzit e tyre, për territoret dhe për pronat e tyre. Ebu Bekri i tha Mugires: “Të përbetohem në Allahun, mos shko te Pejgamberi a.s. para meje! Kam dëshirë që t'ia them unë këtë!”

Mugire pranoi, ndërsa te Pejgamberi a.s. hyri Ebu Bekri, i cili i tregoi për ardhjen e tyre.

Mugire u kthye atje dhe i relaksoi pak, i mësoi se si duhet ta përshëndesnin Pejgamberin a.s., megjithatë ata përsëri e përshëndetën me përshëndetje para-islamike.

Kur ata shkuan tek Pejgamberi a.s., siç pohojnë, ai e kishte ngritur çadrën e tij në një anë të xhamisë. Derisa po shkruanin dokumentin, mes tyre dhe Pejgamberit a.s. ndërmjetësonte Halid b. Seid b. As, i cili shkonte herë andej e herë këndeje. Halidi dokumentin e shkroi me dorën e vet. Ata shkuan aq larg, sa që as ushqimin që u erdhi nga Pejgamberi a.s. nuk deshën ta hanin para se ta shijonte Halidi, derisa përfunduan shkrimin dhe deklaruan pranimin e Islamit.

Ata, ndër të tjera, nga Pejgamberi a.s. kërkuan që t'ua lejonte idhullin Lat dhe mos t'ua rrënonte në tre vitet e ardhshme. Kur Pejgamberi a.s. nuk ra dakord me këtë, ata e pakësonin nga viti në vit derisa në fund e lutën vetëm edhe për një muaj pas kthimit të tyre. Pejgamberi a.s. nuk pranoi asnjë afat të caktuar, ndërsa

ata, siç theksuan, këtë e justifikonin se duhet të mbroheshin nga budallenjtë e tyre, nga gratë dhe fëmijët si dhe popullin e tyre mos ta trembnin me rrënimin e idhullit para se të hynte atje Islami. Megjithatë, Pejgamberi a.s. të gjitha i refuzoi dhe insistoi që të dërgonte Ebu Sufjan b. Harbin dhe Mugire b. Shu'ben që ta rrënonin atë idhull.

Përveç kësaj, krahas kërkesës për lejimin e idhullit Lat, ata kërkuan nga Pejgamberi a.s. që t'i lironte edhe nga falja e namazit si dhe që idhujt e tyre të mos i shkatërrojnë me duart e veta.

Pejgamberi a.s. tha: *“Sa për shkatërrimin e idhujve me duart tuaja, do t’ju kursejmë, ndërsa sa i përket namazit, nuk ka mbarësi në fenë që nuk ka namaz.”*

Kur e deklaruan pranimin e Islamit dhe kur Pejgamberi a.s. u bëri një dokument të shkruar për këtë, për udhëheqës të tyre caktoi Osman b. Ebil-Asin, që ishte më i riu në mesin e tyre, për arsye se ai kishte treguar më shumë dëshirë për njohjen e rregullave të Islamit dhe për mësimin e Kur’anit. Me atë rast, Ebu Bekri, i cili e kishte vërejtur çështjen, tha: *“O i Dërguari i Allahut, më duket se nga të gjithë ata, ky i riu ka shfaqur më shumë kujdes për përvetësimin e rregullave të Islamit dhe për mësimin e Kur’anit!”*

Së fundi, pasi mbaruan punë dhe u nisën për në vendin e tyre, Pejgamberi a.s. me ta dërgoi Ebu Sufjan b. Harbin dhe Mugire b. Shu'ben me detyrë që të shembnin idhullin Lat dhe ata shkuan me ta. Kur iu afruan Taifit, Mugire deshi ta vendoste Ebu Sufjanin përpara, por Ebu Sufjani këtë nuk e pranoi.

Ai tha: *“Hyri ti në mesin e popullit tënd!”* dhe ai vetë u ndal në pronën e tij në Dhul-Hudum<sup>194</sup>.

Sapo arriti Mugire b. Shu'be, menjëherë u ngjit në majë të idhullit dhe filloi ta godasë me kazmë. Njerëzit e tij, nga fisi Benu Mu'atib, i qëndronin prapa nga frika se mos po i ndodhte ajo që i ndodhi Urves. Gratë e fisit Thekif dolën me fytyra të zbuluara dhe vajtonin duke shikuar se ç’po ndodhte me Latin e tyre duke thënë:

*“Me siguri, mbrojtësit, do të qajnë e vajtojnë,  
që keqbërësit, për të rrënuar po i lejojnë,  
duke luftuar me shpatë, nuk po e mbrojnë!”*

Derisa Mugire po e godiste idhullin me sëpatë, Ebu Sufjani thoshte: *“Mjerë ti!”*

Kur idhulli u shkatërrua plotësisht, i mblodhi stolitë e tij dhe gjërat e tjera me vlerë, perla e margaritarë, dhe ia dërgoi Ebu Sufjanit.

Edhe më herët, para delegacionit të Thekifit, kur u vra Urve, te Pejgamberi a.s. kishin ardhur Ebu Mulejh b. Urve dhe Karib b. Esved dhe kishin shprehur

<sup>194</sup> Hudum, burim uji që gjendet pas luginës Kura.

dëshirën për t'u ndarë nga Thekifi dhe ai në asnjë mënyrë asnjëherë mos t'i identifikonte me ta. Atëherë ata të dy pranuan Islamin dhe Pejgamberi a.s. u tha:

*"Tani merrni për mik dikë tjetër, kë të doni!"* Ata u përgjigjën: "Po marrim për mik Allahun dhe të Dërguarin e Tij!"

Pejgamberi a.s. shtoi: *"Edhe dajën tuaj Ebu Sufjan b. Harbin!"* Ata konfirmuan: "Edhe dajën tonë Ebu Sufjanin."

Pasi banorët e Taifit e pranuan Islamin dhe Pejgamberi a.s. dërgoi atje Ebu Sufjanin dhe Mugiren për të shembur idhullin Lat, Ebu Mulejh b. Urve e luti Pejgamberin a.s. që nga pasuria e idhullit të shlyejë borxhin e mbetur nga babai i tij Urve dhe Pejgamberi a.s. pranoi. Karib b. Esvedi i tha: "Edhe për Esvedin, o i Dërguari i Allahut!" Urve dhe Esved ishin vëllezër nga një baba dhe një nënë, por Pejgamberi a.s. tha: *"Esvedi ka vdekur si idhujtar!"* Por Karibi insistoi duke i thënë Pejgamberit a.s.: "O i Dërguari i Allahut, por muslimanin e lidh lidhja e gjakut – aludoi për vetveten – ai borxh tani është mbi mua dhe nga unë kërkohet larja e tij."

Atëherë Pejgamberi a.s. e urdhëroi Ebu Sufjanin që nga pasuria e idhullit të shlyhet edhe borxhi i Urves edhe i Esvedit.

Mugire pasi i mblodhi sendet me vlerë të atij idhulli, i tha Ebu Sufjanit: "Pejgamberi a.s. të ka urdhëruar që t'ua lash borxhet Urves dhe Esvedit!" dhe ai ashtu veprroi.

Teksti i dokumentit që Pejgamberi a.s. i shkroi delegacionit të Thekifit është si më poshtë:

*"Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Nga Muhamedi, Pejgamberi dhe i Dërguari i Allahut, për besimtarët: Drunjtë e kulumbriove, që rriten në Vexh<sup>195</sup>, mos të priten! Kush kapet duke bërë diçka të tillë, do të rrihet me kamxhik dhe do t'i merren rrobat! Kush e shkel këtë, do të kapet dhe do të dorëzohet te Pejgamberi Muhamed. Kjo është urdhëresë e Muhamedit, Pejgamberit dhe të Dërguarit të Allahut a.s.. Dokumentin e shkroi Halid b. Seidi, me urdhër të Pejgamberit Muhamed b. Abdullah. Kushdo që e thyen këtë urdhëresë, vetvetes do t'i bëjë dhunë për ato çfarë urdhëroi Muhamedi, i Dërguari i Allahut!"*

<sup>195</sup> Vexh, emër vendi në Taif.

## VITI I DELEGACIONEVE (Viti i 9 h.) - Shpallja e sures el-Fet'h -

Ibni Is'haku thotë:

“Pasi e çliroi Mekën, bëri ekspeditën e Tebukut dhe fisi Thekif pranuan Islamit dhe dhanë betimin për besnikëri, Pejgamberit a.s. filluan t’i vijnë delegacione arabe nga të gjitha anët<sup>196</sup>.

Në fakt, arabët kishin pritur se çfarë qëndrimi do të mbanin Kurejshët ndaj Islamit sepse ata ishin prijës dhe udhërrëfyes të tyre, ishin njerëz të Qabesë dhe Haremit, pasardhësit e drejtpërdrejtë të Ismailit, birit të Ibrahimit - paqja qoftë mbi ta – me një fjalë ishin udhëheqës të arabëve, gjë që asnjë prej tyre këtë kurrë nuk ua ka mohuar.

Përveç kësaj, pikërisht Kurejshët ishin ata që e filluan luftën me Pejgamberin a.s. dhe iu kundërvunë mësimi të tij, ndërsa kur u çlirua Meka, Kurejshët u afruan me Pejgamberin a.s. dhe iu nënshtruan Islamit. Atëherë arabët e kuptuan se nuk kanë fuqi për të zhvilluar luftë kundër Pejgamberit a.s., as për të mbajtur armiqësi me të, ndaj filluan të hyjnë në fenë e Allahut, siç thotë Allahu, *në turma*, duke ardhur tek ai nga të gjitha anët.

Allahu i Madhërishëm i thotë të Dërguarit të Tij:

*“Kur erdhi ndihma e Allahut dhe çlirimi (ngadhënjimi), dhe i pe njerëzit që po hyjnë turma-turma në fenë e Allahut. Ti, pra, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin.”* (En-Nasr), d.m.th. falënderoje Allahun sepse ka bërë që të fitojë feja jote dhe lutju Atij për falje sepse Ai gjithmonë e pranon pendimin.

### Ardhja e delegacionit të Beni Temimit - dhe shpallja e sures el-Huxhurat -

Delegacionet arabe te Pejgamberi a.s. vinin njëri pas tjetrit. Erdhi edhe delegacioni i fisit Beni Temim, i përbërë nga personalitete të përzgjedhura, i kryesuar nga Utarid b. Haxhib b. Zurare b. Udus Temimiu. Me të ishin edhe Akre' b. Habis Temimiu, Zibrikan b. Bedër Temimiu, ky ishte nga Benu Sa'di, pastaj Amër b. Ehtem dhe Habhab b. Jezid.

<sup>196</sup> Ibni Hishami thotë: “Më ka treguar Ebu Ubejde se kjo ka ndodhur në vitin e nëntë hixhrij dhe ai vit është quajtur viti i delegacioneve.”

Në delegacionin e Beni Temimit ishin gjithashtu edhe Nu'ajm b. Jezid, Kajs b. Harith dhe Kajs b. Asim, me prejardhje nga Beni Sa'di. Ky ishte delegacioni i mrekullueshëm i Benu Temimit. Me ta ishte edhe Ujejne b. Hisn b. Hudhejfe b. Bedër Fezariu. Akre' b. Habisi dhe Ujejne b. Hisni kishin marrë pjesë me Pejgamberin a.s. në çlirimin e Mekës, në Betejën e Hunejnit dhe në Taif, kurse tani ishin në përbërje të delegacionit të fisit Beni Temim.

Me të hyrë në xhami, ky delegacion filloi ta thërriste Pejgamberin a.s.: "O Muhamed, dil para nesh!" Pejgamberi a.s. u shqetësua nga thirrjet dhe bërtitjet e tyre. Më në fund, kur doli, ata iu drejtuan: "O Muhamed, ne erdhëm që të garojmë me ty në lavdërim dhe në krenari, ndaj na lejo që poeti ynë dhe ligjëruesi ynë të flasim!"

Pejgamberi a.s. tha: "Po e lejoj ligjëruesin tuaj, le të flasë!"

Atëherë u ngrit Utarid b. Haxhib dhe tha:

*"Falënderimi i qoftë Allahut, të Cilit i kemi borxh për çdo përparësi dhe mirësi; Ai është i denjë për këtë –na ka bërë mbretër dhe na ka dhuruar shumë begati me të cilat ne bëjmë vepra të mira; na ka bërë njerëzit më të fuqishëm në Lindje, në numër dhe në pasuri. A është ndokush si ne?! A nuk jemi të parët midis njerëzve dhe më të mirët mes tyre? Kush do të matet me ne në laudi, le të numërojë diçka si kjo! Po të duam, ne mund të flasim akoma, por ne kemi turp të flasim më shumë për atë që kemi dhënë, ne jemi të njohur për këtë! Unë thashë vetëm kaq, në mënyrë që edhe ju të mund të thoni diçka të ngjashme apo edhe më të mirë!"*

Pastaj ai u ul, ndërsa Pejgamberi a.s. iu drejtua Thabit b. Kajs b. Shimasit, nga fisi Beni Harith b. Hazrexh me fjalët: "Çohu dhe përgjigju fjalimit të tij!"

Thabiti u ngrit dhe tha:

*"Falënderimi i qoftë Allahut, i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën! Në to ka përmbushur urdhrin e Tij dhe çdo gjë e ka përfshirë me diturinë e Tij. Të gjitha krijesat ekzistojnë vetëm në saje të Tij. Prej argumenteve të fuqisë Tij është edhe ajo që ne na bëri sundues! Ndër krijesat më të mira të Tij e zgjodhi të Dërguarin, me prejardhje më fisnike, me fjalët më të sinqerta, me virtytet më të larta, atij ia zbriti librin e Tij dhe ia besoi krijesat e Tij. Kjo ishte zgjedhja e Allahut në mesin e të gjitha botëve. Ai pastaj u bëri thirrje njerëzve që të besojnë në të dhe asaj thirrjeje të Pejgamberit a.s. menjëherë iu përgjigjën muhaxhirët nga populli i tij dhe të afërmit e tij, njerëzit më fisnikë, më të shquar dhe më vepërmirë. Ata ishin njerëzit e parë që u përgjigjën, pastaj Allahu e pranoi lutjen e Pejgamberit të Tij për ne dhe ne u bëmë luftëtarë të Allahut dhe ndihmues të të Dërguarit të Tij. Ne luftojmë kundër njerëzve derisa ata të besojnë në Allahun. Kush beson në Allahun dhe Pejgamberin e Tij, na ndalohet jeta dhe pasuria e tij! Ndërsa kush vazhdon në mosbesim, gjithmonë për Allahun do të luftojmë kundër tij. Luftimin e tyre e kemi të lehtë! Ja, kjo ishte fjala ime, unë kërkoh nga Allahu të më falë mua, t'i falë besimtarët dhe besimtare. Paqja qoftë mbi ju!"*

Ligjërata e tij ishte më e bukur dhe ngjadhënyese ndaj të parit.

Paria e Temimëve ofruan poetin Zibrikan b. Bedrin<sup>197</sup>, i cili recitoi vargje lavdithurjeje. Atij iu përgjigj poeti islam, Hassan b. Thabit, me entuziazmin e poetit të papërgatitur më parë.

Kur folën dy oratorët dhe dy poetët, Akre' b. Habis tha:

*“Oratori i Resulullahut a.s. është gojëtar më i mirë se yni, edhe poeti i tij është më i mirë se poeti ynë. Zërat e tyre janë më të fuqishëm se të tanëve, niveli i shprehjes së tyre është më i lartë se i yni.”*<sup>198</sup>

Ata pastaj pranuan Islamin, ndërsa Resulullahu a.s. ua vërtetoi këtë dhe i lavdëroi duke u shprehur mirënjohje<sup>199</sup>.

### **Rasti i Amir b. Tufejlit dhe Erbed b. Kajsit në delegacionin e fisit Beni Amir**

Te Pejgamberi a.s. erdhi një delegacion i fisit Bani Amir, të cilin e përbënin tre persona: Amir b. Tufejli, Erbed b. Kajs b. Xhez' b. Halid b. Xhaferi dhe Xhebbar b. Selma b. Malik b. Xhaferi. Këta të tre ishin kryeparët e popullit të tyre dhe njerëzit më djallëzorë të tyre. Amir b. Tufejli, armiku i Allahut, në të vërtetë erdhi tek Pejgamberi a.s. me qëllim që ta mashtrojë dhe ta vrasë atë, megjithëse populli i tij para se të shkonte i kishte thënë: “O Amir, të gjithë njerëzit e kanë pranuar Islamin, pranoje edhe ti!” Por ai u tha atyre: “Vallahi, unë jam zotuar se nuk pushoj derisa arabët të më ndjekin mua. Tani ta ndjek unë këtë djalosh kurejshit!?” Pastaj ai iu drejtua Erbedit: “Kur të shkojmë tek ai, unë do t’ia tërheq vëmendjen dhe kur ta bëj unë këtë, ti pa u hetuar godite me shpatë!”

Duke ardhur te Pejgamberi a.s. Amir b. Tufejl i tha atij: “O Muhamed, më merr mua për mik tëndin!”

Pejgamberi a.s. i tha: “Jo, pasha Allahun, derisa të besosh në Allahun një!”

“Më merr për mik, tëndin, o Muhamed!” i tha përsëri me bezdi duke pritur që Erbedi të bënte atë që e kishte urdhëruar, por ai nuk reagoi. Kur e pa Amiri se Erbedi nuk do të bënte gjë, edhe një herë tha: “O Muhamed, më merr për mik tëndin!” Pejgamberi a.s. tha: “Jo, pasha Allahun, derisa të besosh se Allahu është një dhe nuk ka shok!”

Në fund, pas refuzimit të vazhdueshëm të Pejgamberit a.s., tha: “Pasha Zotin, unë do ta mbush këtë qytet me njerëz dhe me kalorësi kundër teje!”

Pasi shkoi ai, Pejgamberi a.s. tha: “O Allahu im, më kurse nga Amir b. Tufejli!”

<sup>197</sup> “Nektari i vulosur i xhenetit”, Safijurr Rrahman El Mubarekfuri, fq. 513. (Versioni elektronik).

<sup>198</sup> Kur’ani i është shpallur popullit më orator në botë asokohe, arabëve dhe poetëve të talentuar. Është shpallur në gjuhën arabe si apogje e fjalës dhe e ligjërimit të Allahut të Madhërishëm (shih fusnotën paraprake).

<sup>199</sup> “Nektari i vulosur i xhenetit”, Safijurr Rrahman El Mubarekfuri, fq. 513 (versioni elektronik).

Kur dolën nga Pejgamberi a.s., Amiri e pyeti Erbedin: “Për hir të Zotit, o Erbed! Ku mbeti urdhri im për ty?! Vallahi, nuk ka pasur njeri mbi sipërfaqen e tokës të cilit i jam frikësuar më shumë se ty, kurse prej sot më nuk ta kam frikën!”

Erbedi u përgjigj: “Nuk e kam dert aspak, por mos nxito! Vallahi, sa herë që synoja ta bëja atë që më urdhërove, ti gjithmonë ndërhyje midis meje dhe atij, kështu që unë të shihja vetëm ty. A të të goditja ty me shpatë!”

Pastaj vazhduan rrugën për të shkuar në vendin e tyre. Gjatë rrugës Allahu i Madhërishëm, Amir b. Tufejlit i dërgoi murtajën dhe ai prej saj vdiq në shtëpinë e një gruaje nga fisi Beni Selul. Në shtratin e vdekjes, ai tha: “O Beni Amir, a mos është kjo vallë gusha që u bie deveve të reja në shtëpi të një gruaje nga Beni Seluli!?”

Pasi e varrosën, shokët e tij vazhduan tutje. Kur mbërritën në tokën e Benu Amir Shatinit, iu afruan njerëzit e tyre dhe i pyetën: “Çfarë ka të re, o Erbed?” Ai u përgjigj: “Asgjë! Ai na ftoi që të adhurojmë diçka, por unë do të doja tani ta kisha këtu me mua, ta gjuaja me shigjetë dhe ta vrisja!”

Një ose dy ditë pas këtyre fjalëve, doli Erbedi dhe deveja e tij e ndiqte pas. Allahu mbi ta dërgoi një rrufe, e cila i dogji të dy.

Erbed b. Kajsi ishte vëlla prej nëne i Lubejd b. Rebias dhe Lubejdi e kishte vajtuar Erbedin duke i kushtuar një numër vargjesh.

### **Ardhja e Xharudit në delegacionin e Abdul-Kajsit**

Te Pejgamberi a.s. gjithashtu erdhi edhe Xharud b. Amër b. Hanesh, vëllai i Abdul-Kajsit<sup>200</sup>.

Hasani ka thënë:

“Kur ai mbërriti te Pejgamberi a.s., bisedoi me të dhe i ofroi Islamit. Ai tha: “O Muhamed! Unë kam qenë në një fe, ndërsa tash më duhet ta braktis për shkak të fesë tënde, ndaj a ma garanton ti fenë time?”

Pejgamberi a.s. u përgjigj: “Po, unë të siguroj ty se Allahu të ka udhëzuar në diçka që është më e mirë se ajo!”

Atëherë ai e pranoi Islamit, e pranuan edhe shokët e tij që ishin me të. Pastaj ia kërkoi Pejgamberit a.s. dy kafshë për kalërim.

Pejgamberi a.s. i tha: “Pasha Allahun, nuk kam me vete ndonjë kafshë të tillë për t’ju dhënë!”

Ai tha: “O i Dërguari i Allahut, nuk prish punë sepse prej këtu deri te vendi ynë do të gjejmë ndonjë deve të humbur dhe do të kalërojmë derisa të arrijmë në vendin tonë!”

<sup>200</sup> Xharudi ishte i krishterë.

Pejgamberi a.s. tha: *“Jo, në asnjë mënyrë! Ajo me të vërtetë është flakë e zjarrit!”*<sup>201</sup>

Prej Pejgamberit a.s. Xharudi u kthye te njerëzit e tij. Ishte shembullor në praktikimin e Islamit dhe mbeti i vendosur dhe i patundur në fenë e tij deri në fund të jetës. Ai kishte mbërritur edhe kohën e renegatëve nga Islami.

Kur disa anëtarë të popullit të tij, të cilët e kishin pranuar Islam, përsëri u kthyen në fenë e tyre të mëparshme me Garur b. Mundhir b. Nu'man b. Mundhir, u ngrit Xharudi e shqiptoi dëshminë e së vërtetës (shehadetin), u bëri thirrje në Islam e tha: *“O njerëz, unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij! Kush nuk e dëshmon këtë, konsideroj se është jobesimtar!”*

### **Ardhja e Benu Hanifes, me ta ishte edhe Musejleme Kedhdhabi**

Te Pejgamberi a.s. erdhi edhe delegacioni i Beni Hanifes, në të cilin ndodhej edhe Musejleme b. Habib Hanefi Kedhdhabi<sup>202</sup>.

Ky delegacion së pari u ndal në shtëpinë e Bintul-Harithit<sup>203</sup>, një grua ensare nga fisi Beni Nexhxhar. Disa nga njerëzit tanë nga Medina më kanë thënë se Benu Hanife e kishin sjellë atë tek Pejgamberi a.s. duke e mbuluar me rroba, ndërsa Pejgamberi a.s. ishte ulur me shokët e tij dhe mbante një degë palme të qëruar, e cila vetëm në majë kishte disa fletë. Me të arritur te Pejgamberi a.s., derisa ata ende e mbulonin me rroba, foli me të dhe i kërkoi diçka. Pejgamberi a.s. i tha: *“Sikur të më kërkoje madje edhe këtë copë dege të palmës, as këtë nuk do të ta jepja!”*

Ibni Is'haku thotë:

*“Një burrë i vjetër nga Benu Hanife, me prejardhje nga Jemame, më tha se ishte ndryshe.*

Ai pretendon se kur erdhi delegacioni i Beni Hanifes te Pejgamberi a.s., Musejlemin e kishin lënë te bagazhet i tyre, ndërsa kur ishin konvertuar në Islam, kishin treguar se edhe ai ishte me ta. Ata kishin thënë: *“O i Dërguari i Allahut, ne kemi lënë një shok që të kujdeset për bagazhet dhe për kafshët tona!”* Atëherë Pejgamberi a.s. kishte urdhëruar që t'i jepej edhe atij njëjtë si të tjerëve. Kishte thënë: *“Ai nuk është në pozitë më të keqe se ju!”* duke aluduar për ruajtjen e pasurisë së atyre me të cilët kishte ardhur.

Pastaj këta u larguan nga Pejgamberi a.s. dhe morën me vete edhe atë që i ishte dhënë atij. Kur arritën në Jemame, armiku i Allahut e lëshoi fenë dhe e shpalli veten pejgamber duke sajuar gënjeshtër dhe trillime. Ai tha: *“Unë jam*

<sup>201</sup> Do të thotë se ajo të shpie atje.

<sup>202</sup> Ibni Hishami thotë: *“Musejleme b. Thumame. Nofkën e kishte Ebu Thumame.”*

<sup>203</sup> Ebu Dherri ka thënë: *“Thuhet se ajo grua është quajtur Kejsa bintul-Harith.”*

bashkëpjesëmarrës me të në shpallje!" Ata që ishin me të në delegacion i pyeti: "E pra, a nuk iu tha juve: "Ai nuk është në pozitë më të keqe se ju!" Ai e tha këtë sepse e dinte se unë po merrja pjesë me të në pranimin e shpalljes!"

Pastaj filloi t' u fliste atyre në prozë të rimuar duke imituar shprehjet e Kur'anit:

*"Allahu shtatzënës i ka dhënë begati! Prej saj nxori qenie që lëviz, ndërmjet barkut dhe shtresës së brendshme të lëkurës!"<sup>204</sup>*

Mbështetësve të tij ai ua lejoi alkoolin dhe kurvërinë, ndërsa i liroi nga detyrimi i namazit. Por megjithatë, edhe më tutje dëshmonte se Muhamedi a.s. ishte Pejgamber.

Fisi i Benu Hanifes iu bashkuan dhe e mbështetën, vetëm Allahu e di pse.

### Rasti i Adijj b. Hatimit

Siç kam mësuar, Adijj b. Hatim thoshte: "Asnjë arab nuk e urrente Pejgamberin a.s. më shumë se unë kur dëgjonte për të. Kam qenë njeri fisnik, i krishterë, dhe në mes të popullit tim shkoja për të mbledhur një të katërtën!<sup>205</sup>

Privatisht i përkisja fesë sime, ndërsa publikisht isha mbret i popullit tim për shkak të privilegjeve që kisha. Prandaj, sapo dëgjova për Pejgamberin a.s., menjëherë ndjeva urrejtje për të. Shërbëtorit tim, i cili ishte arab dhe m'i ruante devetë, i thashë: "M'i ndaj disa deve të trasha të zbutura dhe ruaji diku afër meje, e kur të dëgjosh se ushtria e Muhamedit po përparon drejt nesh, më lajmëro!" Dhe ai ashtu veproi.

Një ditë, herët në mëngjes, ai erdhi tek unë dhe më tha: "O Adijj! Çfarë ke pasur ndër mend të veprosh në qoftë se të bie mbi krye kalorësia e Muhamedit, bëje tani! Unë pashë shumë flamuj dhe kur i pyeta se ç'janë, ata m'u përgjigjën: "Këto janë ushtritë e Muhamedit!"

Unë i thashë atij: "M'i sill tani ato devetë!" Kur ai m'i solli, ngarkova në to familjen time dhe djalin tim. Pastaj thashë: "Po shkoj në Siri, te bashkëfetarët e mi të krishterë!"

U nisa nëpër Xhushije<sup>206</sup> ose Hushije, sipas Ibni Hishamit - dhe aty, në lagjen e vjetër të atij vendi, lashë vajzën e Hatimit. Kur arrita në Siri, u ndala, ndërsa prapa meje shkonte kalorësia e Pejgamberit a.s. dhe ndër të tjera zuri rob edhe vajzën e Hatimit, të cilën, së bashku me të zënë robër të tjerë të fisit Tajji', e çuan te Pejgamberi a.s..

Ndërkohë, Pejgamberi a.s. mori vesh për ikjen time në Siri, ndërsa vajza e Hatimit ishte vendosur në një vend të rrethuar pranë derës së xhamisë, ku ata

<sup>204</sup>"Lekad en'amellahu 'alel-hubla. Ahrexhe minha nesemeten tes'a. Min bejni sifakin ve hashu."

<sup>205</sup> U merrte ¼ e plaçkës së luftës. Arabët këtë ia jepnin kryeparit të tyre.

<sup>206</sup> Xhushije, kodër afër Darijjes, në zonën e Nexhdit.

zakonisht mbanin pengjet. Kur kaloi pranë saj Pejgamberi a.s., ajo iu afrua dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, babai më vdiq, ndërsa udhëtari më braktisi, ndaj trego dashamirësi ndaj meje, Allahu tregoftë ndaj teje!”

Pejgamberi a.s. e pyeti: “*Po kush është udhëtari?*”

Ajo u përgjigj: “Ai është Adijj b. Hatim.”

Pejgamberi a.s. tha: “*Ai që ka ikur nga Allahu dhe nga Pejgamberi i Tij?*”

Ajo më vonë ka treguar: “Pejgamberi a.s. pastaj shkoi dhe më la mua aty. Të nesërmen kur përsëri kaloi pranë meje, unë ia përsërita të njëjtat fjalë, ndërsa Pejgamberi a.s. më dha të njëjtën përgjigje si ditën e kaluar. Të pasnesërmen, kur ai përsëri kaloi pranë meje, kur unë kisha humbur shpresën tek ai, një njeri i cili shkonte prapa tij më tregoi që t’i afrohem dhe t’i flas përsëri dhe unë përsëri iu afrova dhe ia përsërita: “O i Dërguari i Allahut, babai më vdiq, ndërsa udhëtari më braktisi, ndaj trego dashamirësi ndaj meje, Allahu tregoftë ndaj teje!”

Atëherë Pejgamberi a.s. më tha: “*Mirë, do ta bëj, por mos nxito për të dalë derisa të gjesh ndonjë nga populli yt tek i cili ke besim se mund të të çojë në vendin tënd. Kur ta gjesh dikë të tillë, më lajmëro!*”

Unë pastaj u interesova që të gjeja një njeri sipas sugjerimit të tij dhe të bisedoja me të. Më thanë: “Ai është Ali b. Ebi Talibi, Allahu qoftë i kënaqur me të. Aty unë qëndrova derisa erdhën disa kalorës nga Belijja ose nga Kuda'a dhe pikërisht dëshiroja të shkoja te vëllai im në Siri. Unë shkova te Pejgamberi a.s. dhe i thashë: “O i Dërguari i Allahut, erdhi një grup nga populli im dhe unë besoj se ata do të më çojnë atje!” Ai më dha rroba, më përgatiti për rrugë, më dha edhe para dhe unë u nisa me ta derisa arrita në Siri.”

Adiu tregon e thotë:

“Vallahi, unë isha ulur në mes të njerëzve të mi, kur e pashë një grua, në shkalc mbi deve u drejtua dhe po vjen drejt meje. Unë menjëherë thashë: “Pasha Zotin, vajza e Hatimit!” Dhe pashë se ishte ajo. Sapo u ndal, ajo menjëherë më bërtiti: “O bandit! O zullumqar! E more familjen tënde dhe djalin tënd, ndërsa i braktise fëmijët e tjerë të babait tënd, turp të qoftë!”

Unë i thashë: “Mirë po thua, oj motër! Unë nuk kam asnjë justifikim, ashtu kam vepruar siç po thua!” Pastaj ajo zbriti dhe qëndroi tek unë. Ishte grua e rreptë. Unë e pyeta: “Çfarë mendon ti për atë njeri?” Ajo më tha: “Pasha Zotin, unë mendoj se ti urgjentisht duhet të shkosh tek ai! Në qoftë se është Pejgamber, kush shkon tek ai sa më parë, e ka më mirë. Nëse është mbret, nuk do ta zvogëlosh nderin e Jemenit, ti do të vazhdosh të mbetesh i njëjtë.” I thashë: “Pasha Zotin, mendim i mirë!”

Pastaj u nisa, derisa erdha në Medinë te Pejgamberi a.s.. Ai ishte në xhami. Unë hyra brenda dhe i dhashë selam. Ai pyeti: “*Kush është?*” U përgjigja: “Jam

Adijj b. Hatimi." Ai u ngrit dhe më mori mua në shtëpinë e vet. Krugës, derisa më çonte atje, atij iu afrua një grua e moshuar dhe e sëmurë, e cila e ndaloi dhe ai mbeti gjatë duke biseduar për hallet e saj. Në ato momente unë mendova me vete: "Pasha Zotin, ky nuk është mbret!"

Pastaj Pejgamberi a.s. u nis me mua. Kur hymë në shtëpinë e tij, mori një jastëk prej lëkure të mbushur me fije druri hurme dhe ma dha duke më thënë: "*Ulu mbi këtë!*" Unë i thashë: "Jo, ulu ti mbi të!" Ai këmbënguli: "*Jo, ti do të ulesh!*" Dhe unë u ula mbi të, kurse Pejgamberi a.s. u ul në tokë. Me vete mendova: "Pasha Zotin, mbreti nuk sillet në këtë mënyrë!"

Pastaj ai më pyeti: "*O Adijj b. Hatim, a nuk ke qenë ti rekusi?*"<sup>207</sup>

Unë u përgjigja: "Po." Ai vazhdoi: "*A nuk e merr për vete një të katërtën e plaçkës së luftës të fisit tënd?*" Thashë: "Po." Ai tha: "*Në të vërtetë, sipas fesë tënde, kjo s'është hallall për ty!*" Thashë: "Po, ashtu është, vallahi!" Dhe kuptova se ai ishte me të vërtetë Pejgamber i dërguar sepse e dinte atë që të tjerët nuk e dinin.

Ai pastaj tha: "*O Adijj, ndoshta ty po të pengon për të hyrë në këtë fe sepse po i sheh se ata janë të varfër, por, vallahi, së shpejti do të shpërthejë pasuri sa nuk do të jenë në gjendje për ta marrë! Ndoshta po të pengon për të hyrë në këtë fe ajo që po sheh se armiqtë e tyre janë të shumtë, kurse ata janë në numër të paktë, por, pasha Allahun, ti do të dëgjosh së shpejti se një grua pa ndonjë frikë mbi devenë e saj do të niset nga Kadisijja dhe do të vijë këtu për ta vizituar këtë shtëpi! Ndoshta, përsëri, po të pengon për të hyrë në këtë fe ajo që po sheh se pushteti dhe fuqia janë në duart e të tjerëve, por, vallahi, ti do të dëgjosh së shpejti se pallatet e bardha të Babilonisë do të jenë në duart e tyre!*" Dhe kështu, unë e pranova Islamin.

Adiu duke treguar ka thënë:

"Dy gjëra prej atyre (paralajmërimeve) tashmë kanë ndodhur, ka mbetur vetëm ajo e treta, por, vallahi, edhe ajo do ndodhë. Unë pashë se u fituan pallatet e bardha të Babilonisë dhe pashë kur një grua pa frikë shkante nga Kadisijja mbi devenë e saj deri në Qabe për ta kryer haxhin. Vallahi, do të realizohet edhe e treta: do të shpërthejë pasuria në atë masë sa nuk do të ketë kush ta marrë!"

### Ardhja e Ferve b. Musejk Muradiut

Ibni Is'haku thotë:

"Te Pejgamberi a.s. erdhi Ferve b. Musejk Muradiu, pasi u nda nga mbretërit e Kindes dhe për këtë arsye u largua prej tyre dhe u afrua me Pejgamberin a.s.. Para hyrjes së tij në Islam kishte ndodhur konflikti në mes fiseve Murad dhe Hemdan. Hemdani me atë rast u kishin shkaktuar dëme të mëdha në prona dhe

<sup>207</sup> Rekusi, pjesëtar i sektit fetar krishtero-sabej.

në njerëz. Kjo kishte ndodhur në ditën e quajtur dita e grumbullimit (jev-mur-redm), kur ushtrinë e Hemdanit e kishte udhëhequr Exhde' b. Malik<sup>208</sup>.

Kur u drejtua kah Pejgamberi a.s., duke u larguar nga mbretërit e Kindes, Ferve b. Musejk u shpreh:

*Kur i pashë mbretërit e Kindes, si po zhgënjejnë,  
sikur nervi i femurit, kur këmba këmbën e tradhton,  
E afrova devenë time dhe kah Muhamedi u nisa,  
me shpresë në virtytet e tij dhe në pasuritë e mira!*

Kur erdhi te Pejgamberi a.s., siç kam dëgjuar, Pejgamberi a.s. i tha: "O Ferve, a të goditi shumë ajo që i ndodhi popullit tënd në ditën e grumbullimit?"

Ai u përgjigj: "O i Dërguari i Allahut, a është dikush që nuk goditet kur popullit të tij i ndodh ajo që i ndodhi popullit tim?"

Pejgamberi a.s. i tha: "Kjo popullit tënd në Islam do t'ia shtojë përfitimin!"

Pastaj Pejgamberi a.s. e emëroi udhëheqës të fiseve Murad, Zubejd dhe për të gjitha degët e fisit Medh'hixh. Bashkë me të dërgoi edhe Halid b. Se'id b. As për në Sadefe. Ai ishte me të deri në vdekjen e Pejgamberit a.s..

### **Ardhja e Amër b. Ma'di Jekrebit me njerëz nga fisi Zubejd**

Te Pejgamberi a.s. erdhi edhe Amër b. Ma'di Jekreb me disa njerëz nga fisi Zubejd dhe e pranoi Islamit. Amri, edhe më herët, kur kishte dëgjuar për Pejgamberin a.s., i kishte thënë Kajs b. Mekshuh Muradiut: "O Kajs, ti je i pari i popullit tënd, ne kemi dëgjuar se në fisin Kurejsh në Hixhaz është shfaqur një njeri i quajtur Muhamed, që po pretendon se është Pejgamber, ndaj eja me ne të shkojmë ta vizitojmë dhe të njihemi me mësimin e tij, kështu që nëse është me të vërtetë Pejgamber, siç po pretendon, ti këtë do ta kuptosh, atëherë le ta ndjekim. Por, në qoftë se nuk është Pejgamber, së paku do ta njohim mësimin e tij." Kajs, megjithatë, e refuzoi këtë dhe për më tepër propozimin e tij e quajti pa vend. Por Amër b. Ma'di Jekrebi edhe pa të shkoi te Pejgamberi a.s., i besoi atij dhe e pranoi Islamit. Kur mori vesh për këtë Kajs b. Mekshuhi, e kërcënoi dhe shumë u zemërua me të. Pastaj tha: "Do të thotë më paska kundërshtuar dhe paska shkuar pa mua!"

Në lidhje me këtë Amër b. Ma'di Jekrebi ka thurur disa vargje.

### **Ardhja e Esh'ath b. Kajsit në delegacionin e Kindes**

Ibni Is'haku thotë:

"Në delegacionin e Kindes te Pejgamberi a.s. erdhi edhe Esh'ath b. Kajs.

<sup>208</sup> Ibni Hishami thotë: "Udhëheqës i Hemdanit atë ditë ka qenë Malik b. Hurejm Hemdani."

Zuhrij b. Shihabi më tha se ai erdhi me tetëdhjetë kalorës nga Kinde. Ata hynë në xhaminë ku gjendej Pejgamberi a.s., me flokë të lëshuar e të krehur, në sy kishin surmë, kurse mbi vete kishin pelerina jemenase të qëndisura me mëndafsh.

Sapo hynë te Pejgamberi a.s. ai menjëherë i pyeti: *“Ju, a nuk e keni pranuar Islamin?!”*

Thanë: *“Po, si jo!”*

Ai përsëri i pyeti: *“Atëherë çfarë do të thotë ai mëndafshi rreth qafave tuaja?!”* Ata pastaj e hoqën nga vetja dhe e hodhën.

Pastaj Esh'ath b. Kajsi i tha: *“O i Dërguari i Allahut, ne jemi Benu Akil Murari, por edhe ti je pasardhës i tyre!”*

Pejgamberi a.s. duke buzëqeshur i tha: *“Ju në këtë faqefis po fusni edhe Abbas b. Abdulmuttalibin edhe Rebia b. Harithin! Abbasi dhe Rebia kanë qenë tregtarë dhe kur ata të dy shkonin në ndonjë fis të largët arab, pyetjes prej nga jeni, u përgjigjeshin: “Jemi nga Benu Akil Murari!” duke zgjedhur për vete këtë fis sepse pjesëtarët e Kindes ishin mbretër!”*

Pastaj u tha atyre: *“Ne jemi Benu Nadr b. Kinane, në linjën tonë ne nuk e ndjekim linjën e nënës dhe nuk tjetërsohemi nga linja e babait tonë!”*

Atëherë Esh'ath b. Kajsi pyeti: *“A përfunduat, o njerëz të Kindes? Vallahi, nëse edhe njëherë e dëgjoj dikë duke folur ashtu, do t'i jap 80 të rëna!”*

### **Ardhja e Sured b. Abdullah Ezdiut**

Pejgamberit a.s. i erdhi edhe Sured b. Abdullah Ezdiu me një delegacion nga fisi Ezd. Me atë rast ai e pranoi Islamin dhe u përmbahej dispozitave të tij me përpikëri. Pejgamberi a.s. e caktoi atë si emir për pjesën e popullit të tij që kishin pranuar Islamin dhe e urdhëroi që me ata muslimanë të luftonte kundër fiseve idhujtare jemenase që ishin prapa tij.

Sured b. Abdullahu u nis sipas urdhrit të Pejgamberit a.s. dhe arriti në Xhuresh, i cili në atë kohë ishte qytet i mbyllur. Aty gjendeshin shumë fise jemenase, por kur dëgjuan për lëvizjen e muslimanëve në drejtim të tyre, atyre iu bashkua edhe fisi Hath'am.

Ai i mbajti nën rrethim gati një muaj, por pasi nuk arriti gjë, u tërhoq. Mirëpo kur shkoi në një nga kodrat e tyre të quajtur Shekr, banorët e Xhureshit menduan se po tërhiqet si i mundur prej tyre, kështu që dolën në ndjekje. Kur e arritën, ai u vërsul mbi ta dhe u shkaktoi humbje të mëdha.

Banorët e Xhureshit më herët patën dërguar dy nga njerëzit e tyre te Pejgamberi a.s. në Medinë për të vëzhguar se çfarë po ndodhte atje. Derisa këta të dy ishin me Pejgamberin a.s., një ditë pas namazit të ikindisë, ai papritmas i pyeti: *“Ku gjendet kodra Sheker?”*

Ata u përgjigjën: “O i Dërguari i Allahut, gjendet në rajonin tonë. Ajo është një kodër me emrin ‘Keshsher’, në fakt kështu e quajnë banorët e Xhureshit.”

Pejgamberi a.s. tha: “Jo, ajo nuk quhet ‘Keshsher’, por ‘Shekr.’”

Ata e pyetën: “Pse është e rëndësishme kjo, o i Dërguari i Allahut!”

Pejgamberi a.s. u përgjigj: “Pikërisht tani atje janë duke u flijuar krijesat e Allahut!”

Ata të dy pastaj u ulën me Ebu Bekrin, ose me Othmanin, dhe ai u tha: “Vaj halli për ju! Pejgamberi a.s. sapo ju informoi se atje po vdesin njerëzit tuaj, ndaj shkoni dhe kërkoni nga ai që t’i lutet Allahut që t’i shpëtojë ata!” Ata të dy menjëherë iu afruan Pejgamberit a.s. dhe ia shtruan këtë kërkesë.

Pejgamberi a.s. tha: “O Allahu im, largoje Ti atë prej tyre!”

Ata pastaj u larguan nga Pejgamberi a.s. dhe u kthyen te familjet e tyre. Atje me të vërtetë gjetën se njerëzve të tyre u kishte ndodhur belaja nga Sured b. Abdullahu në të njëjtën ditë që kishte thënë Pejgamberi a.s. dhe në të njëjtën kohë që ai e kishte përmendur.

Pastaj delegacioni i Xhureshit shkoi te Pejgamberi a.s. dhe e pranoi Islamin. Ai me atë rast ua përcakttoi vendet e ndaluara rreth fshatit të tyre; duke i shënuar saktësisht vendet: për kuajt, për devetë për kalërim, për lopët që shërbenin për lëvrim, se kush prej tyre kishte të drejtë aty për kullotje dhe kush e kishte të ndaluar.

### **Ardhja e të deleguarve të mbretërve të Himjerit me mesazhin e tyre**

Pejgamberit a.s. i erdhi edhe mesazhi i mbretërve të Himjerit, ku thuhej se e pranonin Islamin. Këtë mesazh nga Tebuku ia sollën të deleguarit e tyre: Harith b. Abdi Kulal, Nu'ajm b. Abdi Kulal, Nu'man Kajlu Ru'ajn, Me'afiri dhe Hemdani.

Në të njëjtën kohë edhe Zur'atu Dhu Jezen dërgoi Malik b. Murre Rehaviun për ta informuar atë se fisi i tij po pranonte Islamin dhe braktiste idhujtarinë dhe ndjekësit e saj.

Në përgjigje të letrës së tyre Pejgamberi a.s. shkroi:

*“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Nga Muhamedi, Pejgamberi dhe i Dërguari i Allahut, për Harith b. Abdi Kulal, Nu'ajm b. Kulal, Nu'man Kajlu Ru'ajn, Me'afirin dhe Hemdanin:*

*Unë e falënderoj Allahun, pos të Cilit nuk ka zot tjetër. Të deleguarit tuaj na erdhën nga toka e Bizantit dhe ne i takuam në Medinë. Na dorëzuan atë që na keni dërguar përmes tyre dhe na njoftuan për gjendjen tuaj dhe na informuan për Islamin tuaj dhe luftën tuaj kundër idhujtarëve. Ata na thanë se Allahu ju ka udhëzuar në rrugën e Tij.*

*Nëse ju përmirësoheni dhe e respektoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, nëse e falni namazin dhe e jepni zekatin dhe nga plaçka (e luftës) ndani 1/5 e Allahut dhe pjesën e Pejgamberit, si dhe pjesën që i takon atij si udhëheqës, pastaj nëse besimtarëve u jepni*

sadakanë e përcaktuar: nga toka bujqësore që ujitet nga burimi ose nga qielli 1/10, kurse nga toka që ujitet me ujë të bartur – gjysmën e të dhjetës; pastaj nga dyzet deve një deve që është në vitin e tretë, nga tridhjetë deve një mashkull të devesë në vitin e tretë; në çdo pesë deve një dele, e në çdo dhjetë deve dy dele; në çdo dyzet lopë një lopë, e në çdo tridhjetë lopë – një viç njëvojeçar, dem ose mëshqerrë dyvojeçar; për çdo dyzet copë të bagëtisë së imtë të cilat kullosin vetë një dele, atëherë e keni përmbushur dispozitën e Allahut që ka përcaktuar për besimtarët në aspektin e sadakasë! Kush i shton kësaj diçka me vullnet, ajo është më mirë për të. Kush e përmbush këtë, ai e ka dëshmuar Islamin e tij dhe i ka ndihmuar besimtarët kundër idhujtarëve. Ai hyn në radhën e besimtarëve, atij i takojnë të gjitha të drejtat që u takojnë të tjerëve, por ka edhe detyrat siç i kanë ata, si dhe e ka mbrojtjen e Allahut dhe mbrojtjen e të Dërguarit të Tij.

Kush nga hebrenjtë ose nga të krishterët e pranon Islamin, ai numërohet në mesin e besimtarëve dhe i gëzon të gjitha të drejtat që u përkasin atyre, ka edhe të gjitha detyrimet që kanë ata. Kush vazhdon të mbetet në fenë hebreje apo në fenë e krishterë, nuk guxon të pengohet në të, por atij i takon pagesa e xhizjes - për çdo person të rritur, burrë dhe grua, i lirë apo skllav nga një dinar të plotë ose kundërolerën e tij me pëlhurë (me'afir), ose rroba jemenase apo të ngjashme. Kush e zbaton këtë urdhër të Pejgamberit a.s., ai e gëzon mbrojtjen e Allahut dhe mbrojtjen e të Dërguarit të Tij, ndërsa kush i shmanget, ai është armik i Allahut dhe armik i të Dërguarit të Tij."

Pastaj Muhamedi, Pejgamberi dhe i Dërguari i Allahut, i rekomandon Zurate Dhu Jzenit: "Kur t'ju vijnë të deleguarit e mi, ju obligoj që ndaj tyre të silleni mirë. Ata janë: Muadh b. Xhebel, Abdullah b. Zejd, Malik b. Ubade, Ukbe b. Nemir, Malik b. Murre dhe njerëzit e tyre. Mblidhni të gjitha sadakatë dhe të gjitha xhizjet nga rajonet tuaja dhe dorëzojani të deleguarve të mi. Udhëheqësi i tyre është Muadh b. Xhebeli. Ai assesi mos të kthehet i pakënaqur!

Muhamedi dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se ai është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij.

Malik b. Murre Rehaviu më ka thënë se ti je i pari nga Himjeri që ke pranuar Islamin dhe i ke sulmuar idhujtarët, prandaj gëzohu për të mirën që të pret! Unë të urdhëroj që me Himjerët të sillësh mirë! Mos tradhtoni dhe njëri-tjetrin mos e lini në lëndinë sepse Pejgamberi a.s. është mbrojtës i të pasurve tuaj dhe i të varfërve tuaj! Vërtet sadakaja nuk është e lejuar për Muhamedin dhe familjen e tij, ajo është bamirësi që u jepet muslimanëve të varfër dhe udhëtarëve.

Maliku e ka përcjellë lajmin dhe e ka ruajtur sekretin, prandaj ju urdhëroj ta trajtoni bukur. Unë po ju dërgoj njerëzit e mi të mirë, të devotshëm dhe të dijshtëm dhe ju urdhëroj që të silleni mirë me ta sepse njerëzit do t'i shikojnë ata. Ves-selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu!"

**POROSIA E PEJGAMBERIT a.s.  
PËR MUADHIN, KUR E DËRGOI NË JEMEN**

Ibni Is'haku thotë:

“Abdullah b. Ebi Bekri më ka thënë se atij i kanë treguar se Pejgamberi a.s., kur e ka dërguar Muadhin, e ka porositur dhe e ka obliguar për më shumë gjëra e pastaj i ka thënë: *“Lehtëso e mos vështirëso! Përhap lajme të gëzueshme e mos frikëso! Ti po shkon te një popull që janë pasues të Librit dhe ata do të pyesin se cili është çelësi i xhenetit? Ti thuaju atyre: “Dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut të vetmit, i Cili nuk ka shok!”*”

**Pranimi i Islamit nga Beni Harith b. Ka'bi**

Ibni Is'haku thotë:

“Pastaj Pejgamberi a.s. në muajin rebiul-ahir ose në xhumadel- ula dërgoi Halid b. Velidin në Nexhran te fisi Benu Harith b. Ka'b dhe e urdhëroi që së pari tri ditë t'i ftojë në Islam, e nëse i përgjigjen, të ndalet. E nëse ata nuk pranojnë, atëherë t'i sulmojë!

Halidi shkoi tek ata dhe në të gjitha anët dërgoi kalorës që t'i thërrasin njerëzit në Islam. Ata shkuan dhe u thoshin njerëzve: “O njerëz, pranoni Islamin dhe do të jeni të sigurt!” Pas tyre, njerëzit e pranuan Islamin dhe hynë në fenë në të cilën i thirri. Halidi pastaj qëndroi në mesin e tyre për t'ua mësuar atyre Islamin, Kur'anin dhe Sunetin e Pejgamberit a.s., ashtu siç e pat urdhëruar Pejgamberi a.s., në rast se ata e pranojnë Islamin dhe nuk bëjnë rezistencë.

Pastaj Halid b. Velidi i shkroi Pejgamberit a.s.:

“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Për Muhamedin, Pejgamber dhe i Dërguar i Allahut, nga Halid b. Velidi:

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty, o i Dërguari i Allahut! Unë e falënderoj Allahun, që pos Tij nuk ka zot tjetër!

O i Dërguari i Allahut, Allahu të bekoftë, ti më dërgove mua te Benu Harith b. Ka'bi dhe më urdhërove që kur të shkoj tek ata, tri ditët e para të mos sulmoj, por t'i thërras ata në Islam dhe nëse e pranojnë Islamin, të qëndroj në mesin e tyre për t'ua mësuar atyre Islamin, Kur'anin dhe Sunetin e të Dërguarit Tij. Në rast se ata nuk e pranojnë Islamin, t'i luftoj. Unë kam ardhur këtu dhe siç më urdhërove, tri ditë i kam ftuar në Islam. Në mesin e tyre kam dërguar kalorës, të cilët i kanë ftuar duke u thënë: “O Beni Harith, pranoni Islamin dhe do të jeni të sigurt!” Kështu që

ata e pranuan Islamin dhe nuk na kundërshtuan. Prandaj, unë kam qëndruar në mesin e tyre dhe po kërkoj nga ata që t'i kryejnë ato që ka urdhëruar Allahu, kurse po u ndaloj atyre ato që i ka ndaluar Allahu si dhe po ua mësoj Islamin dhe Sunnetin e Pejgamberit a.s.. Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty!"

Pejgamberi a.s. kësaj letre iu përgjigj:

*"Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Nga Muhamedi, Pejgamber dhe i Dërguar i Allahut, për Halid b. Velidin:*

*Paqja qoftë mbi ty dhe unë e falënderoj Allahun, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër.*

*Letra jote më erdhi përmes të dërguarit tënd. Më njofton se Benu Harith b. Ka'bi e kanë pranuar Islamin para se t'i sulmohet dhe kur i ke ftuar në Islam, ata të janë përgjigjur dhe kanë dëshmuar se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij dhe kështu Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë.*

*Prandaj, ti ata përgëzoji dhe paralajmëroji! Eja tek unë dhe bashkë me ty le të vijë edhe një delegacion i tyre! Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty!"*

\*\*\*\*\*

Menjëherë pas kësaj, Halidi erdhi te Pejgamberi a.s. së bashku me delegacionin e Beni Harith b. Ka'bit, në të cilin ndër të tjerët ishin edhe: Kajs b. Husajn Dhil-Gussa, Jezid b. Abdil-Medan, Jezid b. Muhaxhxhel, Abdullah b. Kurad Zujadiu, Sheddad b. Abdullah Kananiu dhe Amër b. Abdullah Dibabiu.

Kur i pa Pejgamberi a.s., pyeti: *"Kush janë këta njerëz që duken si indianë?"* I thanë: *"O i Dërguari i Allahut, këta janë njerëz nga Beni Harith b. Ka'bi."*

Sapo arritën tek ai, i dhanë selam dhe i thanë: *"Ne dëshmojmë se ti je i Dërguar i Allahut dhe dëshmojmë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut!"*

Pejgamberi a.s. tha: *"Edhe unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut!"* Pastaj i pyeti ata: *"A ju jeni ata të cilët, nëse dikush ju ka bërë ndonjë dëm, me guxim jeni ngritur kundër tij?!"*

Ata heshtën dhe asnjë prej tyre nuk u përgjigj. Pejgamberi a.s. këtë pyetje ua përsëriti edhe për herën e dytë, të tretë dhe të katërt. Vetëm atëherë Jezid b. Abdil-Medani tha: *"Po, o Dërguari i Allahut, ne me guxim jemi ngritur kundër atij që na bënte ndonjë dëm!"*

Atëherë Pejgamberi a.s. tha: *"Sikur Halidi të mos më kishte shkruar se ju e keni pranuar Islamin dhe nuk e keni sulmuar atë, kokat tuaja do t'ua kisha hedhur nën këmbët tuaja!"*

Jezid b. Abdil-Medani tha: *"Mirëpo, vallahi, ne nuk të kemi falënderuar as ty e as Halidin!"*

Pejgamberi a.s. i pyeti: *"Kë falënderoni ju?!"*

Ata u përgjigjën: *"O i Dërguari i Allahut, ne falënderojmë Allahun e Madhërishëm, i Cili na ka udhëzuar përmes teje!"*

Pejgamberi a.s. tha: *“Të vërtetën e ke thënë!”* Pejgamberi a.s. pastaj vazhdoi: *“Me çka i keni mposhtur ata që ju kanë sulmuar në kohën e injorancës?”*

Ata u përgjigjën: *“Ne nuk kemi mposhtur askënd!”* Pejgamberi a.s. tha: *“Po, po, ju i keni mposhtur ata që ju kanë sulmuar!”*

Thanë: *“Po, ne i kemi mposhtur ata që na kanë sulmuar, O i Dërguari i Allahut! Ne ishëm unikë dhe nuk përçaheshim, askënd nuk e dëmtonim të parët!”*

Pejgamberi a.s. tha: *“Ju thatë të vërtetën!”*

Pastaj Pejgamberi a.s. si udhëheqës të Beni Harith b. Ka’bit caktoi Kajs b. Husajnin.

Delegacioni i tyre u kthye prapa në pjesën e mbetur të muajit shevval ose në fillim të muajit dhul-kade. Kjo ishte vetëm katër muaj para se Pejgamberi a.s. të kalonte në botën tjetër, në mëshirën dhe bekimin e Allahut, në kënaqësinë dhe në begatinë e Tij.

Kur delegacioni i tyre u largua nga Pejgamberi a.s., ai dërgoi atje Amër b. Hazmin me detyrë që t’ua mësojë dispozitat e fesë, t’i njoftojë me Sunnetin e Pejgamberit a.s. dhe t’ua sqarojë atyre karakteristikat e Islamit si dhe të mbledhë sadakatë e tyre. Atë e pajisi edhe me një dokument me të cilin e autorizoi dhe e urdhëroi për të kryer detyrën që ia ngarkoi.

Dokumenti kishte këtë përmbajtje:

*“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Ky është proklamim i të Dërguarit të Allahut: O ju që besuat, përmbahuni kontratave! Ky është urdhër nga ana e Muhamedit, Pejgamber i Allahut, deri tek Amër b. Hazmi, kur e dërgoi në Jemen.*

*E ka urdhëruar për devotshmëri ndaj Allahut në të gjitha çështjet që Ai e obligon, sepse me të vërtetë Allahu është me të devotshmit dhe bamirësit. E ka urdhëruar që t’i përmbahet së vërtetës ashtu siç ka kërkuar Allahu dhe njerëzit t’i përgëzojë me të mirë, e këtë ta kërkojë edhe prej tyre! E ka urdhëruar t’ua mësojë Kur’anin dhe t’ua shpjegojë rregullat që përmbahen në të dhe t’i mësojë ata se Kur’anin mund ta prekë vetëm njeriu i pastër.*

*Njerëzve duhet t’u shpjegohet se cilat janë të drejtat e tyre dhe cilat janë detyrat e tyre. Ndaj tyre në drejtësi të jetë i butë, ndërsa në padrejtësi i ashpër, sepse Allahu e urren dhunën dhe e ndalon atë. Ai thotë: “... , pra mallkimi i Allahut qoftë kundër mizorëve!” (Hud, 19)*

*Më pas, ai duhet t’i përgëzojë njerëzit me xhenet dhe t’ua tregojë veprat që i çojnë në të si dhe t’i paralajmërojë për xhehenemin dhe veprat që i çojnë në të. Duhet të përpiqet që t’i bashkojë njerëzit, në mënyrë që sa më mirë t’i kuptojnë rregullat e fesë. Duhet t’u jepen udhëzime për kryerjen e haxhit dhe t’u shpjegohet se çfarë është në të sunet dhe çfarë është farz si dhe të gjitha çështjet që i ka përcaktuar Allahu në lidhje me të. Haxhi i madh është haxhi i madh, ndërsa haxhi i vogël është Umra.*

U ndalohet njerëzve që ndonjë prej tyre ta kryejë namazin me rroba të përbëra vetëm nga një pjesë, e shkurtër, përveç nëse është veshje, skajet e së cilës mund të dyfishohen dhe të hidhen mbi supe.

Gjithashtu, u ndalohet njerëzve, nëse ndonjëri prej tyre është mbështjellë me veshje të përbërë vetëm nga një pjesë, që të ulet me këmbë të përvojela, në mënyrë që pjesët intime të zbulohen nga lart! Ndalohet po ashtu që dikush t'i mbledhë dhe lidhë flokët e tij në qafë! Ndalohet nëse ndodh grindja mes njerëzve që ndonjëri prej tyre të mburret me fisin apo familje! Thirrja e tyre le të jetë vetëm për Allahun e lartë, të vetmin, që nuk ka shok. Ndërkaq, ata që nuk veprojnë kështu, por bëjnë thirrje për te fiset dhe familjet, le të goditen me shpata derisa të thërrasin vetëm për tek Allahu, që është një dhe nuk ka shok!

Njerëzit duhet të urdhërohen që të marrin abdest në mënyrën e duhur: ta lajnë fytyrën, duart deri në bërriyla, këmbët deri te zokthi, ndërsa kokën ta fërkojnë ashtu siç i ka urdhëruar Allahu, pastaj të urdhërohen që ta falin namazin në kohët e parapara, duke e bërë me atë rast në mënyrën e duhur kërrusjen (ruku'), vendosjen e fytyrës në tokë (sexhde) dhe përluljen.

Ata namazin duhet ta kryejnë në fillim të agimit (sabahu), në mesditë (dreka), pak pasi dielli ta kalojë gjysmën e qiellit, pasdite (ikindia), kur dielli largohet nga zeniti, pastaj në fillim të natës (akshami), por jo aq vonë sa të paraqiten yjet në qiell dhe kur në tërësi hyn nata (jacia).

Janë të urdhëruar që të nguten për namazin e xhumasë, të premtën, kur të thirret ezani, dhe të lajnë trupin para shkuarjes në xhuma.

E ka urdhëruar që t'ua marrë një të pestën nga plaçka e luftës, e cila i takon Allahut.

Besimtarët nga aspekti i bamirësisë janë të detyruar: Nga toka bujqësore e cila ujitet nga burimi ose nga qielli - 1/10, kurse nga toka që ujitet me ujë të bartur - gjysma e të dhjetës.

Pastaj; në çdo dhjetë deve – dy dele; në çdo njëzet deve – katër dele; në çdo dyzet lopë - një lopë; në çdo tridhjetë lopë – një viç njëvjeçar, dem ose mëshqerrë; për çdo dyzet copë të bagëtisë së imtë të cilat kullosin vetë - një dele! Kjo është dispozitë e Allahut që e ka përcaktuar për besimtarët në aspektin e sadakasë! Kush i shton kësaj diçka me vullnet, ajo është më mirë për të.

Kush nga hebrenjtë ose nga të krishterët me vullnetin e vet e pranon Islamin dhe fillon ta praktikojë atë, ai numërohet në mesin e besimtarëve dhe i gëzon të gjitha të drejtat që u përkasin atyre dhe ka edhe të gjitha detyrimet që kanë ata.

Kush vazhdon të mbetet në fenë hebreje apo në fenë e krishterë, nuk guxon të pengohet në të, por atij i takon pagesa e xhizjes - për çdo person të rritur, burrë dhe grua, i lirë apo skllav nga një dinar të plotë ose vlerën e tij me rroba. Kush e zbaton këtë, e gëzon mbrojtjen e Allahut dhe mbrojtjen e të Dërguarit të Tij, ndërsa kush i shmanget, ai është armik i Allahut, armik i të Dërguarit të Tij dhe armik i të gjithë besimtarëve.

Bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin dhe paqja e mëshira e Allahut qofshin mbi të!"

## DY PROFETËT E RREJSHËM: MUSEJLEME HANEFIU DHE ESVED ANSIU

Ibni Ishaku thotë:

“Gjatë jetës së Pejgamberit a.s. u paraqitën dy profetë të rrejshëm: Musejleme b. Habib Kedhdhabi në Jemame, në mesin e Beni Hanifes, dhe Esved b. Ka'b Ansiu në San'a.

Transmetohet nga Ebu Seid Hudriu se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s., i cili nga minberi i tij u ligjëronte njerëzve: *“O njerëz, unë e pashë (në ëndërr) Natën e Kadrit, pastaj m'u bë ta harroja! Pashë në duart e mia dy byzylykë prej ari, unë i urreva, i hoqa duke u fryrë dhe ato fluturuan. Unë i komentova me këta dy pejgamberë të rrejshëm: njëri në Jemen dhe tjetri në Jemame!”*

Disa njerëz te të cilët kam plot besim më kanë thënë se ata e kanë dëgjuar Ebu Hurejrën duke thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s. duke thënë: *“Nuk do të ndodhë kiameti derisa të shfaqen tridhjetë dexhalë dhe secili prej tyre do të pretendojë se është pejgamber!”*

## DALJA E MËKËMBËSVE DHE AKTIVISTËVE PËR TË MBLEDHUR ZEKATIN

Pejgamberi a.s. i dërgoi mëkëmbësit dhe aktivistët e tij për ta mbledhur zekatin gjithandej zonave ku jetonin muslimanët. Kështu, në San'a dërgoi Muhaxhir b. Ebi Umejje b. Mugire, por e sulmoi Ansiu, i cili ndodhej atje.

Ai dërgoi Zijad b. Lubejdin nga fisi Benu Bejada Ensariu që të mblidhte zekatin në Hadremvt.

Ai dërgoi Adij b. Hatimin për të mbledhur zekatin në Tajji' dhe Beni Esed.

Ai dërgoi Malik b. Nuvejren për zekatin e Beni Handhales.

Për zekatin e Beni Sa'dit caktoi dy persona: Zibrikan b. Bedrin, në një rënë anë të fisit, dhe Kajs b. Asimin në anën tjetër të atij fisi.

Gjithashtu, ai dërgoi Ala b. Hadremiun në Bahrej, kurse Ali b. Ebi Talibin (r.a.) e dërgoi te banorët e Nexhranit që të mblidhte zekatin e tyre dhe të sillte xhizjen e tyre.

**LETRA E MUSEJLEMIT PËR PEJGAMBERIN a.s.  
DHE PËRGJIGJJA E PEJGAMBERIT a.s.**

Musejleme b. Habib i shkroi Pejgamberit a.s. një letër me këtë përmbajtje:

“Nga Musejlem b. Habibi, i Dërguari i Allahut, për te Muhamedi, i Dërguari i Allahut! Paqja qoftë mbi ty! Unë jam bërë pjesëtar (ortak) me ty në pejgamberi. Neve na takon gjysma (e pejgamberisë, e pushtetit, e prestigjit dhe e çdo gjëje tjetër), ndërsa gjysma tjetër i takon Kurejshëve. Mirëpo, Kurejshët janë një popull që e tejkalon masën!”

Këtë letër e kishin sjellë dy të deleguar të Musejlemit.

Ibni Is'haku thotë:

“Më ka treguar një plak nga Eshxhe'a, duke transmetuar nga Seleme b. Nu'ajm b. Mesud Eshxhe'iu, ndërsa ky nga babai i tij Nu'ajmi, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke u thënë atyre të dyve, kur e lexoi letrën e Musejlemit:

*“Po ju të dy, çfarë thoni?”* Ata u përgjigjën: *“Edhe ne themi ashtu siç ka thënë ai!”*

Atëherë Pejgamberi a.s. tha: *“Pasha Allahun, sikur të orisja ndonjë delegat, atëherë edhe juve do t'ju kisha vrarë!”*

Pastaj Musejlemit i shkroi këtë përgjigje:

*“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Nga ana e Muhamedit, Pejgamber i Allahut, për Musejlem Kedhhdabin (gënjeshтарin)! Paqja qoftë mbi atë që e pason udhëzimin! Me të vërtetë, toka është e Allahut. Ai ia jep në trashëgim kujt të dojë prej robërve të Tij. Kurse përfundimi i mirë do të jetë për ata që i frikësohen Allahut!”*

Kjo ka ndodhur në fund të vitit të dhjetë të hixhretit.

## HAXHI LAMTUMIRËS

Pasi hyri muaji dhul-kade, Pejgamberi a.s. u përgatit për të kryer haxhin dhe i urdhëroi njerëzit, që edhe ata të bëjnë përgatitje. Pejgamberi a.s. për haxh u nis kur nga muaji dhul-kade kishin mbetur edhe pesë net<sup>209</sup>.

Kur arriti atje, njerëzve ua tregoi ritet e haxhit dhe i njoftoi me dispozitat rreth tij. Ai mbajti një fjalim në të cilin u shpjegoi atyre çfarë kishte për t'u shpjeguar. Ai e falënderoi Allahun dhe i shprehu lavdërime, pastaj tha:

*“O njerëz! M'i dëgjoni me kujdes fjalët, sepse unë nuk e di nëse, pas këtij viti, do takohem më me ju në këtë vend!*

*O njerëz! Gjaku juaj dhe pasuria juaj janë të shenjta për ju, derisa ta takoni Zotin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë, ashtu siç është i shenjtë ky muaj.*

*Ju do ta takoni Zotin tuaj dhe, pa dyshim, Ai do t'ju pyesë për të gjitha veprimet tuaja! Ja, unë ua kumtova!*

*Kush ka ndonjë amanet, le t'ia japë atij nga i cili e ka marrë. Është hequr çdo lloj kamate, e kam vënë në këmbë, por duhet të jepni borxhin themelor. As mos bëni padrejtësi, as mos u goditni nga padrejtësia. Me urdhër të Allahut, është ndaluar marrja e kamatës. Kamata e parë që hoqa është kamata e xhaxhait tim, Abbasit, të birit të Abdulmuttalibit.*

*Janë hequr plotësisht edhe të gjitha gjakmarrjet e mbetura nga koha e injorancës. Gjakmarrja e parë që hoqa, nga koha e injorancës, është gjakmarrja për kushëririn tim, Rebia b. Harith b. Abdulmuttalib, i cili shkoi të kërkonte një gjdhënëse te fisi Beni Lejth, ndërsa e oranë njerëzit e fisit Hudhejl.*

*O njerëz! Sot djalli përjetësisht ka humbur çdo shpresë se do të jetë i adhuruar këtu në tokat tuaja. Por ju, veç këtyre gjërave që ndalova, nëse në gjëra që ju duken të vogla do ta dëgjoni atë, ai do të kënaqet. Për ta ruajtur fenë tuaj, bëni shumë kujdes!*

*O njerëz! Prolongimi (nesi'u) i ndonjë muaji të shenjtë (ndaluar) vetëm se e rrit më shumë mosbesimin. Me këtë po mashtrohen jobsimtarët: një vit e lejojnë, kurse vitin tjetër e ndalojnë, në mënyrë që të përshtatin periudhën në të cilën Allahu e ka ndaluar luftën. Kështu, e lejojnë atë që e ka ndaluar Allahu, ndërsa e ndalojnë atë që Ai e ka lejuar! Koha, e cila është në një ndërrim të pandërprerë, ka ardhur në gjendjen e ditës kur Allahu krijoi qiejt e tokën. Numri i muajve tek Allahu është dymbëdhjetë. Katër nga këta janë muaj të ndaluar. Tre janë njëri pas tjetrit (dhul-kade, dhul-hixhxe dhe muharrem), kurse i katërti, rexhebi i fisit Mudar<sup>210</sup>, mes muajve xhumadal-ahir dhe shaban.*

<sup>209</sup> Ibni Hishami thotë: “Për administrator të Medinës ka lënë Ebu Duxhane Saidiun, kurse disa thonë për Suba' b. Urfete Afariun.”

<sup>210</sup> Mudar, muaji rexheb, iu atribuuua fisit Mudar sepse i vetmi ky fis ndër fiset arabe muajin rexheb e konsideronte të shenjtë (ndaluar).

*O njerëz! Ju keni të drejta mbi gratë, por edhe gratë kanë të drejta mbi ju! E drejta juaj është që ato të mos e lejojnë askënd në shtratin tuaj që ju e urreni si dhe të mos bëjnë vepër të qartë të pamoralshme. Nëse ato e bëjnë, me atë rast Allahu ju lejon që t'i ndani ato nga shtrati dhe t'i goditni me goditje jo të fuqishme. Nëse ato e ndërpresin këtë, atëherë e drejta e tyre mbi ju është që t'u siguroni, në mënyrë legale, ushqim dhe veshje. Gratë trajtojini në mënyrë të bukur sepse ato tek ju janë si robër dhe nuk posedojnë asgjë për veten e tyre! Ju i morët ato si amanet nga Allahu dhe me to keni marrëdhënie falë fjalëve të Allahut!*

*O njerëz! Dëgjomani dhe mbajeni mend mirë fjalën time! Ja, unë ua kumtova!*

*Po ju lë një çështje shumë të qartë, që nëse i përmbaheni fort, nuk do ta devijoni rrugën asnjëherë. Po ju lë Librin e Allahut dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij.*

*O njerëz! Dëgjomani dhe mbajeni mend mirë fjalën time! Dijeni mirë se muslimani është vëlla me muslimanin e kështu që të gjithë muslimanët janë vëllezër. Nuk lejohet cenimi i çfarëdo të drejte që i përket vëllait tuaj të fesë përderisa ta ketë dhënë vetë me kënaqësi! Mos i bëni padrejtësi as vetes suaj! O Zoti im, a e kumtova?!"*

Më kanë thënë se me atë rast njerëzit thanë: "Po, e kumtova!" Atëherë Pejgamberi a.s. shtoi: "O Zoti im, Ti je dëshmitar."

### **Dërgimi i Usame b. Zejdit në Palestinë**

Ibni Is'haku thotë:

"Pastaj Pejgamberi a.s. u kthye në Medinë, ku kaloi pjesën e mbetur të muajit dhul-hixhxe, muharrem dhe safer. Pastaj i urdhëroi njerëzit që të nisën në rrugë për Siri, ndërsa si udhëheqës të tyre caktoi Usame b. Zejd b. Harithe, të birësuarin e tij. Ai e urdhëroi atë që kuajt t'i lejojnë të dalin në zonën e fundit të Balka'es dhe Darumit, në territorin palestinez.

Njerëzit u përgatitën dhe me Usame b. Zejdin u nisën të gjithë muhaxhirët e parë, pa asnjë përjashtim.

### **Shkuarja e të deleguarve të Pejgamberit a.s.tek sundimtarët përreth**

Ibni Hishami thotë:

"Pejgamberi a.s. u dërgoi sundimtarëve përreth të deleguar nga radhët e shoqëve të tij dhe përmes tyre u dërgoi mesazhe me shkrim me të cilët i ftoi ata që ta pranojnë Islamin."

Ibni Hishami thotë: "Më kanë treguar njerëz të besueshëm, të cilët i janë referuar Ebu Bekër Hudheliut, se ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin a.s., i cili

pasi u kthye nga Hudejbija pa e bërë umren, një ditë prej ditëve doli para shokëve të tij dhe tha:

*“O njerëz, Allahu më ka dërguar mua si mëshirë për të gjithë njerëzit, ndaj mos më kundërshtoni ashtu siç e patën kundërshtuar havarijunët Isain, birin e Merjemes!”*

Shokët e tij e pyetën: “Si e kanë kundërshtuar havarijunët, o i Dërguari i Allahut?”

Ai u përgjigj: *“Ai i ka thirrur ata ashtu siç ju thirra unë ju. Atë që e kishte dërguar në një vend afër ishte i kënaqur dhe me sukses e kishte kryer detyrën e besuar, ndërsa ai të cilin e kishte dërguar në ndonjë vend të largët, e urrente dhe ishte i mërzhitur në punën e tij. Kjo ishte arsyeja pse Isai u ankua tek Allahu, kështu që të gjithë këta të mërzhiturit filluan të flasin gjuhën e popujve të cilëve u ishin dërguar!”*

Pra, edhe Pejgamberi a.s. u dërgoi sundimtarëve përreth të deleguar nga radhët e shokëve të tij dhe përmes tyre u dërgoi mesazhe me shkrim me të cilët i ftoi ata që të pranojnë Islamin.

Kështu, ai dërgoi Dihje b. Halife Kelbiun te perandori i Bizantit;

Abdullah b. Hudhafe Sehmiun e dërgoi te Kisra, sundimtari i Persisë;

Amër b. Umejje Damriun e dërgoi te Nexhashiu, mbreti i Etiopisë;

Hatib b. Ebi Belte'a e dërgoi te Mukavkisi, mbreti i Aleksandrisë;

Amër b. As Sehmiun e dërgoi te Xhejfer dhe Ijadh, të bijtë e Xhulendiut, me prejardhje nga Ezdi, të dy mbretër të Umanit;

Selit b. Amrin, nga Beni Amir b. Luejj, e dërgoi te Thumame b. Uthal dhe Hevdhe b. Ali, të dy mbretër të Jemames, nga fisi i Benu Hanifes;

Ala b. Hadremiun e dërgoi te Mundhir b. Savej Abdiu, mbret i Bahrejnit;

Shuxha' b. Veheb Esediun e dërgoi te Harith b. Ebi Shimr Gassaniu, mbret i zonave kufitare të Sirisë.

Ibni Hishami thotë:

*“Unë kam theksuar gjenealogjinë e Selitit, Thumames, Hevdhes dhe Mundhirit.”*

Ibni Is'haku thotë:

*“Më ka thënë Jezid b. Ebi Habib Misriu se ai ka gjetur një libër në të cilin theksohen të deleguarit e Pejgamberit a.s. nëpër rajone të ndryshme, sundimtarëve arabë dhe joarabë, si dhe çfarë u ka thënë atyre me rastin e dërgimit të tyre.*

Ai thotë: *“Unë librin ia dërgova Muhamed b. Shihab Zuhriut dhe ai e njohu. Në të theksohet se si një ditë Pejgamberi a.s. doli para shokëve të tij dhe u tha: “Me të vërtetë, Allahu mua më ka dërguar si mëshirë për të gjithë njerëzit, ndaj shpërndajeni nga unë, Allahu ju mëshiroftë! Dhe mos më kundërshtoni siç e kundërshtuan havarijunët Isain, të birin e Merjemes!”*

Ata e pyetën: *“O i Dërguari i Allahut, si ka qenë kundërshtimi i tyre?”*

Ai u përgjigj: *“Ai i ka thirrur ata ashtu siç ju thirra unë ju. Atë që e kishte dërguar në një vend afër ishte i kënaqur dhe me sukses e kishte kryer detyrën e besuar, ndërsa ai të cilin e kishte dërguar në ndonjë vend të largët e urrente dhe ishte i mërzhitur me punën e tij dhe kjo ishte arsyeja pse Isai u ankua tek Allahu, kështu që të gjithë këta të mërzhiturit filluan të flasin gjuhën e popujve të cilëve u ishin dërguar!”*

Ibni Is'haku thotë:

“Disa nga havarijunët (apostujt) dhe pasuesit pas tyre, të cilët Isai biri i Merjemes i dërgoi nëpër botë, ishin:

Apostulli Pjetër dhe me të Pali, i cili ishte nxënës e jo apostull, të cilët i dërgoi në Perandorinë e Bizantit;

Anderaisin dhe Menten i dërgoi në një vend banorët e të cilit hanin njerëz;

Tomasin e dërgoi në tokën e Babilit, në rajonin e Lindjes;

Filipin e dërgoi në Kartagjenë, në rajonin e Afrikës;

Johansonin e dërgoi në Efsus, në fshatin e atij grupi të të rinjve, banorëve të Shpellës;

Jakobin e dërgoi në Jerusalem, vendi ku gjendet Tempulli i Shenjtë;

Ibn Thelma'in e dërgoi në Arabi, përkatësisht në Hixhaz;

Simonin e dërgoi në tokën e berberëve.

Ndërkaq Jehudha, i cili nuk ishte apostull, mori vendin e Judes.”

### **Ekspeditat e fundit (të ushtrisë)**

Ibni Is'haku thotë:

“Pejgamberi a.s. e caktoi Usame b. Zejd b. Harithen në krye të ushtrisë që dërgoi në Siri. Ai e urdhëroi atë që kuajt t'i lejojnë të dalin në zonën e fundit të Balka'es dhe Darumit, në territorin palestinez.

Njerëzit u përgatitën dhe me Usame b. Zejdin u nisën të gjithë muhaxhirët e parë, pa asnjë përjashtim.

## FILLIMI I SËMUNDJES SË PEJGAMBERIT a.s.

Ibni Is'haku thotë:

“Derisa njerëzit ishin të zënë me këtë, te Pejgamberi a.s. filloi të shfaqet sëmundja nga e cila u shpërngul tek Allahu, i Cili i dhuroi nderimet dhe mëshirën e Tij. Kjo ndodhi në netët e fundit të muajit safer ose në fillim të muajit rebiul-evvel. Gjëja e parë që kishte ndier – sipas asaj që më është thënë - është se në njërin nga këto net, në orët e vona, shkoi në Bekij’el-Garkad<sup>211</sup> dhe atje u lut për faljen e të vdekurve, pastaj u kthye në shtëpi, ndërsa prej mëngjesit të asaj dite filloi të ndiente dhimbje.

Transmetohet nga Ebu Muvejhibe, ndihmës i Pejgamberit a.s., se ka thënë: “Pejgamberi a.s. më thirri natën vonë, pas mesnate dhe më tha: *“O Ebu Muvejhibe, më është urdhëruar që për banorët e Bekij’es të kërkoj falje, ndaj eja edhe ti me mua!”* Dhe unë shkova me të. Kur u ndal pranë Bekij’es tha: *“Es-selamu alejkum! Paqja qoftë mbi ju, o banorë të varrezave. Mos u pikëlloni se ku gjendeni në krahasim me atë se ku gjenden njerëzit. Është paraqitur turbullira porsinata e errët. Është duke ardhur turbullirë pas turbullirë, e kjo e fundit është më e madhe se ajo e para!”*

Pastaj u kthye nga unë dhe më tha: *“O Ebu Muvejhibe, më janë ofruar çelësat e të gjitha thesareve të kësaj bote dhe qëndrimi i përjetshëm në këtë botë, e pastaj më është ofruar xheneti, që unë të zgjedh: a do ta zgjedh atë apo takimin me Zotin tim dhe xhenetin!”*

Unë i thashë: *“E flijofsha për ty babanë tim dhe nënën, o i Dërguari i Allahut, merri çelësat e thesareve të kësaj bote dhe përjetësinë në të e pastaj xhenetin!”*

Ai më tha: *“Jo, pasha Allahun, o Ebu Muvejhibe! Unë tashmë e kam zgjedhur takimin me Zotin tim dhe xhenetin!”*

Pastaj, në Bekij’e bëri lutje për faljen e të vdekurve dhe kur u kthye në shtëpi, filloi të ndiente dhembje, prej të cilave edhe u shpërngul tek Allahu.

Aishja, gruaja e Pejgamberit a.s., thotë:

“Kur u kthye Pejgamberi a.s. nga varrezat Bekij’e, më gjeti mua që kisha dhembje koke të rënda dhe i thashë atij: *“Sa shumë po më dhemb koka!”* Ai m’u përgjigj: *“Përkundrazi o Aishe, mua sa shumë po më dhemb koka!”* Pastaj më tha: *“Çfarë ka sikur të vdesësh para meje dhe unë të kujdesem për ty: të mbështjell me qefin, të ta fal xhenazen dhe të të varros?!”*

Unë i thashë: *“Vallahi, sikur po të shoh duke e bërë këtë e pastaj kthehesh në shtëpinë time dhe fle me njërin nga gratë e tua!”* Pejgamberi a.s. buzëqe-

<sup>211</sup> Bekij’el-Garkad, varrezat e Medinës, që gjenden brenda në qytet.

shi, pastaj derisa vizitonte gratë e tij, dhembja i vinte duke u shtuar dhe kur ishte në shtëpinë e Mejmunës, e shtroi plotësisht. Pastaj aty i thirri të gjitha gratë e tij dhe kërkoi prej tyre që t'ia lejojnë që përkujdesja t'i bëhet në shtëpinë time dhe ato ia lejuan.”

## GRATË E PEJGAMBERIT a.s.

### - nënat e besimtarëve -

Ibni Hishami thotë:

“Ai kishte nëntë gra: Aishe bint Ebi Bekër, Hafsa bint Omer b. Hattab, Ummu Habibe bint Ebi Sufjan b. Harb, Ummu Seleme bint Ebi Umejje b. Mugire, Sevde bint Zem'a b. Kajs, Zejneb bint Xhahsh b. Riab, Mejmune bint Harith b. Hazn, Xhevrijë bint Harith b. Ebi Dirar dhe Safijje bint Hujejj b. Ahtab. Kështu më kanë thënë shumica e dijetarëve.”

Numri i grave që u martuan me Pejgamberin a.s. është trembëdhjetë. Ajo janë:

1. *Hatixhe bint Huvejlid*: Ajo është gruaja e parë me të cilën u martua, atë e martoi babai i saj Huvejlid b. Esed, ndërsa disa thonë vëllai i saj Amër b. Huvejlid. Pejgamberi a.s. për mehr i dha njëzet deve të reja. Ajo i lindi Pejgamberit a.s. të gjithë fëmijët, me përjashtim të Ibrahimit. Para tij ajo ishte martuar me Ebu Hale b. Malik, nga fisi Benu Usejjid b. Amër b. Temim, aleat i fisit Benu Abdid-Dar, të cilit i kishte lindur Hind b. Ebi Hale dhe Zejneb bint Ebi Hale. Para tij kishte qenë e martuar me Atik b. Abid b. Abdullah b. Omer b. Mahzum dhe i kishte lindur Abdullahun dhe Xharijen.

2. *Aishe bint Ebi Bekër Siddik*: Ajo është bashkëshortja e vetme e Pejgamberit a.s. që ishte vajzë e pamartuar më parë. Atë e martoi babai i saj Ebu Bekri. Pejgamberi a.s. për mehr i dha katërqind dërhëmë.

3. *Sevde bint Zem'a b. Kajs b. Abdi Shems b. Abdi Vudd b. Nasr b. Malik b. Hisl b. Amir b. Luejj*: Atë e martoi Selit b. Amër, ndërsa sipas disave Ebu Hatib b. Amër b. Abdi Shems b. Abdi Vudd b. Nasr b. Malik b. Hisl<sup>212</sup>. Edhe asaj Pejgamberi a.s. i dha katërqind dërhëmë për mehr. Para tij ajo kishte qenë e martuar me Sekran b. Amër b. Abdi Shems b. Abdi Vudd b. Nasr b. Malik b. Hisl.

4. *Zejneb bint Xhahsh b. Riab Esedijje*: Atë e martoi vëllai i saj Ebu Ahmed b. Xhahsh. Pejgamberi a.s. i dha katërqind dërhëmë si mehr. Para tij ajo ishte martuar me Zejd b. Harithen, djalën e adoptuar të Pejgamberit a.s.. Në lidhje me të Allahu i Madhërisëm ka shpallur:

“(Përkujto) Kur i the atij që Allahu e kishte shpërblyer (me besim) e edhe ti i pate bërë mirë: “Mbaje bashkëshorten tënde dhe ki frikë nga Allahu!”, e ti e mbaje fshehtë në veten tënde atë që Allahu do ta zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t'i frikësohesh Allahut. E pasi Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, Ne

<sup>212</sup> Ibn Hishami thotë: “Me këtë nuk pajtohet Ibn Is'haku, i cili pohon se edhe Seliti edhe Ebu Hatibi asokohe ndodheshin në Abisini.”

ta kurorëzojmë ty atë, e për të mos pasur besimtarët vështirësi (mëkat) në martesë me gratë e të adoptuarve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i Allahut është kryer.” (El-Ahzab, 37)

5. *Ummu Seleme bint Ebi Umejje b. Mugire Mahzumijje*: Emri i saj është Hind. Atë e kishte martuar biri i saj Seleme b. Ebi Seleme. Për mehr Pejgamberi a.s. i dha një shtrat të mbushur me fije palme, një gotë, një sahan të madh dhe një mulli dore. Para tij kishte qenë e martuar me Ebu Seleme b. Abdil-Esed, emri i vërtetë i të cilit ishte Abdullah. Ajo atij i lindi Selemen, Omerin, Zejneben dhe Rukijjen.

6. *Hafsa bint Omer b. Hattab*: Atë e martoi babai i saj Omer b. Hattabi (r.a.). Pejgamberi a.s. i dha katërqind dërhëmë si mehr. Para tij kishte qenë e martuar me Hunejs b. Hudhafa Sehmiun.

7. *Ummu Habibe bint Ebi Suffjan b. Harb*: Emri i saj i vërtetë ishte Remle. Atë e martoi Halid b. Seid b. As derisa ende ishin në Abisini. Nexhashiu i dha asaj në vend të Pejgamberit a.s. katërqind dinarë për mehr. Ai e fejoj me Pejgamberin a.s.. Para tij ajo kishte qenë e martuar me Ubejdullah b. Xhahsh Esediun.

8. *Xhuvejrije bint Harith b. Ebi Dirar Huza'ijje*: Ajo ishte në mesin e robërve të Beni Mustalikut nga fisi Huza'a. Me rastin e ndarjes ajo i takoi Thabit b. Kajs b. Shemas Ensariut. Kur ai kërkoi prej saj një shumë të caktuar që ajo ta blinte lirinë e saj, ajo shkoi te Pejgamberi a.s. dhe kërkoi ndihmën e tij. Ai me atë rast e kishte pyetur: “A do diçka më të mirë se kjo?!” Ajo kishte thënë: “E çfarë është ajo?” Pejgamberi a.s. i thotë asaj: “Sikur unë ta paguaj për ty atë shumë dhe të martohem me ty?!” Ajo u pajtua dhe ai u martua me të.

Ibni Hishami thotë:

“Thuhet se Pejgamberi a.s., duke u kthyer nga ekspedita në Beni Mustalik, me vete solli edhe Xhuvejrije bint Harithin dhe pasi ishte i angazhuar me ushtrinë, Xhuvejrijen ia dorëzoi një ensariu për ta ruajtur dhe për t'u kujdesur për të. Kur arriti në Medinë, i ati i saj Harith b. Ebi Dirar u nis për ta çliruar vajzën e tij, por gjatë rrugës, në vendin Akik, sërish shikoi devetë që kishte me vete për ta paguar lirimën e saj. Dy prej tyre iu dukën shumë të bukura, kështu që i fshehu në një nga grykat e afërta në Akik. Kur erdhi te Pejgamberi a.s., i tha: “O Muhamed, ju ma keni zënë rob vajzën time, ja shpërblimi për lirimën e saj!” Pejgamberi a.s. e pyeti: “Ku janë ato dy devetë që fshehe atje në një grykë në Akik?!” Harithi tha: “Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Allahut! Vallahi, këtë nuk e ka parë askush përveç Allahut të Madhërishëm!”

Kështu Harithi e përqafoi Islamin e me të edhe dy djemtë e tij dhe shumë të tjerë nga populli i tij. Pastaj dërgoi njerëz për t'i marrë ato dy devetë, të cilat i prunë aty dhe ai të gjitha ia dorëzoi Pejgamberit a.s., kurse atij iu dorëzua vajza e tij Xhuvejrija, e cila gjithashtu e përqafoi Islamin dhe i zbatonte në mënyrë perfe-

kte rregullat e tij. Pejgamberi a.s. e kërkoi dorën e saj nga babai i saj dhe ai e martoi me të. Për mehr ai i dha asaj katërqind dërhëmë. Para Pejgamberit a.s. ajo kishte qenë e martuar. Ka mendime se Pejgamberi a.s. e bleu atë nga Thabit b. Kajsi, ia fali lirinë dhe pastaj u martua me të duke i dhënë për mehër katërqind dërhëmë.

9. *Safijje bint Hujejj b. Ahtab*: Pejgamberi a.s. Safijjen e kishte zënë rob në Hajber dhe e kishte zgjedhur për vete. Me atë rast kishte përgatitur edhe një gosti të vogël, në të cilën nuk kishte as yndyrë as mish, por vetëm sevik dhe hurma. Para tij ajo ishte martuar me Kinane b. Rebij' b. Ebil-Hukajk.

10. *Mejmunë bint Harith b. Hazn b. Behijr b. Huzem b. Ruvejbe b. Abdullah b. Hilal b. Amir b. Sa'sa'a*: Atë me Pejgamberin a.s. e martoi Abbas b. Abdulmuttalibi, i cili për Pejgamberin a.s. pagoi katërqind dërhëmë si mehr. Para tij ajo ishte martuar me Ebu Ruhm b. Abduluzza b. Ebi Kajs b. Abdi Vudd b. Nasr b. Malik b. Hisl b. Amir b. Luejj.

Disa thonë se "ajo vetë ia fali veten e saj Pejgamberit a.s. sepse kur i erdhi fejesa, ajo ishte në një deve dhe tha: "Deveja dhe çfarë ka në të i takojnë Allahut dhe të Dërguarit të Tij!" Atëherë Allahu i Plotfuqishëm shpalli: "... edhe një grua besimtare nëse ajo ia fal veten Pejgamberit dhe nëse Pejgamberi dëshiron të martohet me të..." (El-Ahzab, 50)

Të tjerë thonë se ajo që ia fali veten Pejgamberit a.s. në fakt ishte Zejneb bint Xhahsh, por ekziston mendimi se është Ummu Sherijk Gazijje bint Xhabir b. Veheb nga fisi Benu Munkidh b. Amër b. Muajs b. Amir b. Luejj, ndërsa disa të tjerë thonë se "ajo është një grua nga Benu Same b. Luejj, të cilën Pejgamberi a.s. e kishte shtyrë për më vonë".

11. *Zejneb bint Huzejme b. Harith b. Abdullah b. Amër b. Abdi Menaf b. Hilal b. Amir b. Sa'sa'a*: Pejgamberi a.s. u martua edhe me këtë Zejnebe, të cilën e quanin nëna e të varfërve për shkak të mëshirës së saj të madhe dhe ndjeshmërisë ndaj tyre. Atë e martoi Kabisa b. Amër Hilalij, ndërsa Pejgamberi a.s. i dha katërqind dërhëmë për mehr. Para tij ajo ishte martuar me Ubejde b. Harith b. Abdulmuttalib b. Abdi Menaf. Para Ubejdes ishte martuar me Xhehm b. Amër b. Harith.

Këto janë gratë me të cilat Pejgamberi a.s. ka pasur marrëdhënie martesore, gjithsej njëmbëdhjetë. Para tij kanë vdekur dy gra: Hatixhe bint Huvejlid dhe Zejneb bint Huzejme, ndërsa pas vdekjes së tij kanë mbetur nëntë të tjerat, të cilat i përmendëm në fillim të kapitullit.

Me dy gra nuk ka pasur marrëdhënie. Ato janë Esmā' bint Numan Kindijje, me të cilën, kur u martua, vuri re se vuante nga lebra, kështu që e përgatiti dhe e dërgoi tek familja e saj; dhe Umra bint Jezid Kilabijje. Ajo e kishte lënë vonë mosbesimin dhe kur e sollën para Pejgamberit a.s., kishte kërkuar mbrojtjen e

Allahut nga Pejgamberi a.s.. Atëherë Pejgamberi a.s. kishte deklaruar: “*Është e paprekshme ajo që mbrohet nga Allahu!*”, dhe ia kishte kthyer familjes së saj.

Disa pohojnë se gruaja që kishte kërkuar nga Allahu për ta mbrojtur nga Pejgamberi a.s. ishte nga Kindi dhe ishte vajza e xhaxhait të Esmā’ bint Numanit. Disa të tjerë thonë se arsyeja pse Pejgamberi a.s. ia ktheu familjes së saj ishte se kur ai e kishte thirrur, ajo ishte shprehur: “Unë i përkas një populli të cilit i vijnë të tjerët, kurse ai nuk u shkon atyre te këmbët!” Dhe Pejgamberi a.s. e ktheu te familja e saj.

\* \* \*

Gjashtë gra të Pejgamberit a.s. kanë qenë me prejardhje nga fisi Kurejsh. Ato janë:

*Hatixhe* bint Huvejlid b. Esed b. Abduluzza b. Kusajj b. Kilab b. Murre b. Ka'b b. Luejj;

*Aishe* bint Ebi Bekër b. Ebi Kuhafe b. Amir b. Amër b. Ka'b b. Sa'd b. Tejjim b. Murre b. Ka'b b. Luejj;

*Hafsa* bint Omer b. Hattab b. Nufejl b. Abduluzza b. Abdullah b. Kurt b. Rijah b. Rizah b. Adijj b. Ka'b b. Luejj;

*Ummu Habibe* bint Ebi Sufjan b. Harb b. Umejje b. Abdi Shems b. Abdi Menaf b. Kusajj b. Kilab b. Murre b. Ka'b b. Luejj;

*Ummu Seleme* bint Ebi Umejje b. Mugire b. Abdullah b. Omer b. Mahzum b. Jekadha b. Murre b. Ka'b b. Luejj;

*Sevde* bint Zem'a b. Kajs b. Abdi Shems b. Abdi Vudd b. Nasr b. Malik b. Hisl b. Amir b. Luejj.

*Shtatë* prej tyre ishin *arabe*, por nuk ishin nga fisi Kurejsh. Ato janë:

*Zejneb* bint Xhahsh b. Riab b. Ja'mer b. Sabire b. Murre b. Kebir b. Ganem b. Dudan b. Esed b. Huzejme;

*Mejmunë* bint Harith b. Hazn b. Behijr b. Huzem b. Ruvebijje b. Abdullah b. Hilal b. Amir b. Sa'sa'a b. Muavije b. Bekër b. Hevazin b. Mensur b. Ikrime b. Hasfe b. Kajs b. Ajlan;

*Zejneb* bint Huzejme b. Harith b. Abdullah b. Amër b. Abdi Menaf b. Hilal b. Amir b. Sa'sa'a b. Muavije;

*Xhuvejrije* bint Harith b. Ebi Dirar Huza'ijje, pastaj Mustalekijje;

*Esmā'* bint Nu'man Kindijje dhe

*Umra* bint Jezid Kilabijje.

E vetmja që ishte *joarabe* ka qenë *Safijje* bint Huzejj b. Ahtab, nga fisi Beni Nadir.

## PËRSËRI RRETH SËMUNDJES SË PEJGAMBERIT a.s.

Ibni Is'haku thotë:

“Më ka treguar Jakub b. Utbe, ai nga Muhammed b. Muslim Zuhriu, e ky nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe nga Aishja, gruaja e Pejgamberit a.s., e cila ka thënë: “Pejgamberi a.s. doli duke shkuar mes dy prej njerëzve të tij të afërm, njëri prej tyre ishte Fadl b. Abbasi dhe një tjetër. Kokën e kishte të mbuluar, ndërsa këmbët i hiqte zvarrë derisa hyri në shtëpinë time.”

Ubejdullahu thotë: “Unë këtë bisedë ia tregova Abdullah b. Abbasit, kurse ai më pyeti: “A e di se kush ishte ai burri tjetër?” Unë u përgjigja: “Jo.” Ai më tha: “Ai ishte Ali b Ebi Talibi!”

“Pastaj sëmundja iu përhap në tërë trupin dhe kishte dhembje të mëdha. Atëbotë tha: “M’i sillni shtatë matare me ujë nga puse të ndryshme, në mënyrë që të dal para njerëzve dhe t’u lë porosinë time.”

Ne ashtu e ulëm në govatën e Hafsa bint Omerit dhe derdhnim ujë mbi të saqë tha: “Mjaft më, mjaft!”

Zuhriu thotë:

“Më ka treguar Ejub b. Beshir, se Pejgamberi a.s. doli me kokë të mbështjellë dhe ashtu u ngjit në minber dhe u ul. Gjëja e parë që foli ishte salavati mbi të vrrarët në Uhud, kërkoi falje për ta dhe u dërgoi shumë bekime, pastaj vazhdoi:

*“Allahu njërin nga robërit e Tij e la të lirë të zgjedhë mes kësaj bote dhe të mirave pranë Tij. Dhe robi zgjodhi të mirat pranë Tij!”*

Ebu Bekri menjëherë e kuptoi, ai e ndjeu se me të po aludonte për veten e tij dhe filloi të qante. Ai përmes lotëve tha: “Ne jemi të gatshëm të flijojmë për ty vetveten dhe fëmijët tonë, o i Dërguari i Allahut!”

Pejgamberi a.s. i tha: “Ngadalë, o Ebu Bekër. Shikoni këto dyer që çojnë në xhami, të gjitha mbyllini, vetëm dera e Ebu Bekrit të mbetet e hapur sepse unë nuk di që dikush në shoqërimin tim ka më merita se ai!”

Abdurrahman b. Abdullahu më ka treguar, duke përmendur disa anëtarë të familjes së Seid b. Mu'al-liut, se atëherë Pejgamberi a.s. ndër të tjera ka thënë: “Po qe se do të bëja mik tjetër veç Zotit tim, ai do të ishte, pa dyshim, Ebu Bekri. Mirëpo, kemi pasur shoqërim dhe vëllazërim për fe, derisa Allahu të na bashkojë tek Ai!”

Muhammed b. Xhafer b. Zubejr më ka treguar, duke përmendur Urve b. Zubejrin dhe disa dijetarë të tjerë, se Pejgamberi a.s. për shkak të sëmundjes së tij e ka ngadalësuar pak nisjen e Usames, kështu që me kokë të mbështjellë doli, u ngjit në minber, ndërsa njerëzit tashmë kishin filluar të polemizonin rreth cakti-

mit të Usamës për komandant dhe thanë: “Ka caktuar që muhaxhirët eminentë dhe ensarët t’i komandojë një djalosh adoleshent!”

Pejgamberi a.s. së pari e falënderoi Allahun dhe i shprehu lavdi ashtu siç e meriton madhëria e Tij, pastaj tha:

*“O njerëz, zbatoni dërgimin e Usames sepse pasha jetën time nuk jam i habitur që jeni duke e sulmuar pozitën e Usames sepse e keni sulmuar edhe pozitën e babait të tij më parë! Babai i tij ka qenë i lindur për pozitën udhëheqëse, edhe ky gjithashtu është i lindur për të!”*

Pastaj ai zbriti nga minberi dhe njerëzit ngarendën të hynin në radhët e ushtrisë së Usames. Ndërkaq, gjendja e Pejgamberit a.s. sa vinte e keqësohej dhe dhembjet vinin duke u rritur.

Usame së shpejti u nis me ushtrinë dhe kur e lanë Medinën për pak u ndalën në një pjerrtësi tri milje larg Medinës për të pritur njerëzit e tjerë. Ndërkohë, Pejgamberi a.s. tashmë shumë ishte pamundësuar dhe Usame me njerëzit ishte në pritje se çfarë do të bënte Allahu me të Dërguarin e Tij.

Zuhriu thotë:

“Abdullah b. Ka'b b. Malik më ka treguar se kur Pejgamberi a.s. u dërgoi salavat, bekime dhe kërkoi falje për të vrrarët në Uhud, duke u përmendur vlerën dhe meritat e tyre, ai me atë rast ndër të tjera kishte thënë edhe këtë:

*“O muhaxhirë, silluni mirë me ensarët sepse numri i njerëzve po rritet, ndërsa ensarët, kështu si janë, nuk po rriten! Ata kanë qenë streha ime e sigurt, ndaj bëjini mirë atij që bën mirë prej tyre, ndërsa atë që bën keq, faleni!”*

Pastaj zbriti nga minberi dhe hyri në shtëpinë e tij, mirëpo dhembja tashmë ia kishte kapluar tërë trupin. Aty, tek ai, erdhën edhe dy nga gratë e tij, Ummu Seleme dhe Mejmuneja. Aty kishte edhe gra të tjera muslimane, ndër të cilat edhe Esma' bint Umejs, si dhe xhaxhai i tij Abbasi.

Ata ranë dakord që nga njëra anë e gojës t’i hedhin ilaç dhe Abbasi tha: “Unë do ta bëj këtë!”

Kështu që i vendosën pak ilaç, mirëpo kur u vetëdijesua Pejgamberi a.s. pyeti: “Kush ma bëri këtë?!”

Ata thanë: “Xhaxhai yt, o i Dërguari i Allahut!” Ai tha: “Këtë ilaç e kanë sjellë gratë që kanë ardhur nga ai vend – duke treguar drejt Abisinisë - pse e keni bërë këtë?!”

Abbasi i tha: “Ne u frikësua, o i Dërguari i Allahut, se mos është inflamacioni i pleurës!”

Pejgamberi a.s. tha: “Atë ilaç Allahu nuk ma ka lejuar! Atëherë, le ta marrin atë ilaç të gjithë ata që gjenden në këtë shtëpi, përveç xhaxhait!” Kështu, ilaçin e mori edhe Mejmune, vetëm për shkak të betimit të Pejgamberit a.s., ndonëse ishte duke agjëruar. Ky ishte për ta një lloj ndëshkimi për shkak të asaj që kishin vepruar.

Nga Usame b. Zejd transmetohet si vijon:

“Kur Pejgamberi a.s. tashmë ishte molisur shumë, unë dhe njerëzit e tjerë zbritëm në Medinë. Unë hyra tek ai, por ai heshti, nuk tha asnjë fjalë. Vetëm e ngriti dorën lart, pastaj e vendosi mbi mua, atëherë unë e kuptova se ai po lutej për mua.”

Aishja r.a. thotë:

“Shpesh herë e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *“Allahu asnjë Pejgamberi nuk ia ka marrë shpirtin para se t’i ofrojë mundësinë për të zgjedhur!”* Kështu në çastet e vdekjes, fjalët e fundit që kam dëgjuar nga Pejgamberi a.s. kanë qenë: *“Jo, por shoqërinë më sublime në xhenet!”* Atëherë unë thashë: “E pra, vallahi, nuk po na zgjedh ne!”, sepse m’u kujtua ajo çfarë na kishte thënë më herët se *“asnjë Pejgamberi Allahu nuk ia ka marrë shpirtin para se t’i ofrojë mundësinë për të zgjedhur!”*

## NJERËZIT NË NAMAZ I UDHËHEQ EBU BEKRI r.a.

Zuhriu thotë:

“Më ka treguar Hamza b. Abdullah b. Omeri, se Aishja r.a. ka thënë: “Kur sëmundja e molisi plotësisht Pejgamberin a.s., ai tha: “Urdhëroni Ebu Bekrin që t’i udhëheqë njerëzit në namaz!” Unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, Ebu Bekri është njeri i butë, ka zë të mekur dhe qan shumë kur lexon Kur’an!” Ai e përsëriti: “Urdhërojeni të falet para njerëzve!” Dhe kur unë ia përsërita atë që i thashë më parë, ai më tha: “Ju gratë edhe Jusufin e keni mashtruar! Urdhërojeni t’i udhëheqë njerëzit në namaz!”

Unë, megjithatë, vallahi, e thashë këtë vetëm për ta kursyer Ebu Bekrin nga kjo sepse e dija se njerëzit nuk do ta duan atë që vendoset në vendin e tij dhe për çdo gjë që do të ndodhë, do të fajësojnë atë. Për këtë arsye desha ta kurseja Ebu Bekrin.”

Transmetohet nga Abdullah b. Zem'a b. Esved b. Muttalib b. Esed se ka thënë:

“Kur Pejgamberi a.s. tashmë ishte rraskapitur nga sëmundja, unë me disa muslimanë të tjerë ndodhesha tek ai dhe Bilali thirri për namaz. Ai tha: “Thojini që dikush t’u prijë njerëzve në namaz!” Dhe kur dola, e pashë Omerin mes njerëzve, ndërsa Ebu Bekri nuk ishte. Unë i thashë: “O Omer, çohu dhe prijë njerëzve në namaz!”

Kur ai u ngrit dhe mori tekbir, pasi e dëgjoi Pejgamberi a.s. e njohu zërin e tij, sepse ai kishte zë të fortë dhe depërtues. Atëherë Pejgamberi a.s. tha: “Po ku është Ebu Bekri? Allahu dhe muslimanët nuk e pranojnë këtë! Allahu dhe muslimanët nuk e pranojnë këtë!”

Atëherë e thirrën Ebu Bekrin, por kur ai mbërriti, Omeri tashmë e kishte përfunduar namazin dhe atëherë ai i udhëhoqi njerëzit në namaz.”

Abdullah b. Zem'a thotë: “Omeri atëherë më tha: “Pashë Zotin, o Ibn Zem'a, çfarë më bëre kështu? Unë betohem për Zotin, se kur më urdhërove ti, unë mendova se ty këtë ta kishte urdhëruar Pejgamberi a.s., përndryshe unë nuk do të kisha dalë para njerëzve!”

Unë i thashë: “Vallahi, këtë nuk ma urdhëroi Pejgamberi a.s., por kur nuk e pashë Ebu Bekrin, konsiderova se ti ke më merita nga të pranishmit për t’u prirë njerëzve në namaz!”

Ibni Is'haku thotë: “Zuhriu ka thënë: “Enes b. Maliku më ka treguar si vijon:

“Kur ishte ajo e hëna në të cilën Allahu ia mori shpirtin Pejgamberit a.s., në mëngjes herët, derisa njerëzit po falnin namazin e sabahut, para Pejgamberit a.s. u ngrit perdja dhe u hap dera, ai doli për t’i parë njerëzit dhe u ndal te dera e Aishes. Kur e vërejtën muslimanët, aq shumë u gëzuan, saqë gati u tunduan në

namazin e tyre ashtu që u ndje se si përmes tyre depërtoi një lehtësim. Ai, megjithatë, ua bëri me shenjë që të qëndrojnë të palëkundur në namaz. Ai buzëqeshi nga gëzimi kur i pa ashtu në namaz. Pejgamberin a.s. kurrë nuk e kam parë me pamje më të bukur sesa në atë moment!

Pastaj ai u kthye, ndërsa turma filloi të shpërndahet duke menduar se tashmë i kaloi sëmundja. Ebu Bekri me familjen e vet madje u kthye në Sunh<sup>213</sup>.

Muhammed b. Ibrahim b. Harith, nga Kasim b. Muhamedi, më ka treguar se kur Pejgamberi a.s. e ka dëgjuar tekbinin e Omerit në namaz, ka pyetur: *“Ku është Ebu Bekri? Allahu këtë nuk e pranon, as muslimanët!”* Dhe po të mos ishte një fjali që e tha Omeri në shtratin e vdekjes, muslimanët kurrë nuk do të dyshonin se Pejgamberi a.s. në atë mënyrë e ka caktuar Ebu Bekrin për pasues të vetin. Mirëpo, në fakt, Omeri në shtratin e vdekjes ka thënë: *“Nëse unë emëroj pasues, këtë e ka bërë edhe ai që është më i mirë se unë”<sup>214</sup>, e nëse i lë kështu, po kështu i ka lënë edhe ai që është më i mirë se unë!”<sup>215</sup>*

Kështu njerëzit mësuan se Pejgamberi a.s. nuk kishte caktuar askënd për pasues të vetin, ndërsa Omeri nuk akuzohej si ishte kundër Ebu Bekrit.

Ebu Bekër b. Abdullah b. Ebi Mulejk, më ka thënë: *“Kur ishte dita e hënë, Pejgamberi a.s. doli në namazin e sabahut, me kokë të mbështjellë, ndërsa Ebu Bekri me njerëzit tashmë ishte në namaz. Sapo doli, njerëzit i kaploi një gëzim dhe Ebu Bekri e dinte se kjo mund të ndodhte vetëm për shkak të Pejgamberit a.s., ndaj u tërhoq nga vendi ku po qëndronte për namaz, por Pejgamberi a.s. e shtyu në shpinë dhe i tha: “Priju njerëzve në namaz!” dhe u ul pranë tij. Ai u fal ulur në anën e djathtë të Ebu Bekrit. Kur përfundoi namazi, u kthye kah njerëzit dhe duke ngritur zërin e tij, ashtu që dëgjohej edhe jashtë xhamisë, tha:*

*“O njerëz, zjarri mori flakë, kurse intrigat si net të errëta po vijnë! Mua, pasha Allahun, asgjë nuk mund të më bëni vërejtje. Unë e quajta hallall vetëm atë që e quante hallall Kur’ani dhe e quajta haram atë që e quante haram Kur’ani!”*

Kur ai mbaroi, Ebu Bekri i tha: *“O i Dërguari i Allahut, sot, siç po shoh, me mëshirën dhe bekimet e Allahut, je gdhirë ashtu siç duam ne dhe sot është ditë e volitshme për të dalë, ndaj sikur të kisha dalë jashtë?!”* Pejgamberi a.s. i tha: *“Po, dil!”* dhe hyri brenda, kurse Ebu Bekri shkoi në Sunh.

Abdullah b. Abbasi ka thënë:

*“Atë ditë Ali b. Ebi Talibi, Allahu qoftë i kënaqur me të, doli nga Pejgamberi a.s. dhe u ndal para njerëzve, ndërsa ata menjëherë e pyetën: “O babai i Hasanit, si është gdhirë Pejgamberi a.s.?”*

<sup>213</sup> Sunh, vend në të cilin Ebu Bekri kishte pronat dhe atje shkante me familjen e tij.

<sup>214</sup> Domethënë Ebu Bekri.

<sup>215</sup> Këtu aludon për Pejgamberin a.s.

Ai u përgjigj: “Është gdhirë i shëndetshëm, falë Allahut!” Ndërsa Abbasi e kapi për dore dhe i tha:

“O Ali, pas të treve, vallahi, ti do të jesh i katërti! Beto hem në Allahun, se unë në fytyrën e Pejgamberit a.s. e njoha vdekjen ashtu siç e kam njohur edhe më herët në fytyrat e njerëzve të Benu Abdulmuttalibit! Eja të shkojmë tek ai! Nëse çështja na lihet neve, do ta kuptojmë, e nëse jo, do të kërkojmë prej tij që të na lërë porosi për njerëzit!”

Aliu i tha: “Jo, vallahi, unë nuk e bëj dot! Vallahi, nëse kjo na ndalohet tani, pas tij atë nuk do të na e jepte askush!”

Pejgamberi a.s. vdiq atë ditë, në kohën e nxehtësisë së paradites.”

Aishja ka thënë:

“Në atë ditë, kur hyri në xhami, Pejgamberi a.s., u kthye tek unë dhe u shtri mbi krahun tim. Aty hyri dikush nga shtëpia e Ebu Bekrit, i cili në dorë mbante një misvak të gjelbër. Pejgamberi a.s. shikoi në dorën e tij, kështu që unë kuptova se e dëshironte atë misvak, ndaj i thashë: “O i Dërguari i Allahut, a e dëshiron këtë misvak?” Ai tha: “Po!” Pastaj unë e mora misvakun, e përtypa mirë derisa u zbut, pastaj ia dhashë atij. Ai aq mirë i fërkoj dhëmbët, sa që asnjëherë më parë nuk e kam parë ashtu. Pastaj e lëshoi, ndërsa unë e ndjeva se si m’u rëndua në krah. E shikova në fytyrë dhe e pashë se sytë i ishin ngurtësuar dhe thoshte: “Jo, por shoqërinë më sublime, në xhenet!”

Unë i thashë: “T’u ofrua mundësia e zgjedhjes dhe ti e bërë zgjedhjen, pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën!” Dhe vdiq i Dërguari i Allahut!”

Ibni Is’haku thotë:

“Më ka treguar Jahja b. Abbad b. Abdullah b. Zubejr, se babai i tij Abbadi i kishte thënë: “E kam dëgjuar Aishen duke thënë: “Pejgamberi a.s. ka vdekur në duart e mia, kur e kisha radhën që të kujdesesha për të dhe në këtë aspekt askujt nuk i kam bërë padrejtësi. Gjë tjetër është që unë isha e re dhe papërvojë e ai vdiq në krahun tim. Pastaj ia vura kokën në jastëk dhe u ngrita, së bashku me gratë e tjera, duke goditur gjoksin dhe fytyrën!”

Nga Ebu Hurejra transmetohet:

“Kur vdiq Pejgamberi a.s., Omer b. Hattabi u ngrit dhe tha: “Disa hipokritë po pretendojnë se Pejgamberi a.s. ka vdekur, kurse ai, vallahi, nuk ka vdekur! Vetëm ka shkuar te Zoti i tij, sikurse pat shkuar Musa b. Imrani. Edhe ai pat munguar nga populli i tij dyzet net dhe kur filluan të thonë se ka vdekur, ai u kthye! Vallahi, Pejgamberi a.s. do të kthehet në të njëjtën mënyrë siç u kthye Musai dhe pastaj me siguri do t’ua presë duart dhe këmbët atyre që pohuan se ai ka vdekur!”

Në ato çaste erdhi Ebu Bekri, i cili tashmë kishte dëgjuar për vdekjen e Pejgamberit a.s. dhe u ndal në derë të xhamisë. Omeri ishte duke u folur njerëzve, ndërsa Ebu Bekri pa përfillur asgjë shkoi drejt te Pejgamberi a.s. në shtëpinë e Aishes. Pejgamberi a.s. ishte në njërën anë të dhomës, i mbuluar me një pelerinë jemenase. Ai ia zbuloi fytyrën dhe e puthi, pastaj tha:

“Nënë e babë t’u bëfshin kurban, o i Dërguari i Allahut! Vdekjen që Allahu ta ka përcaktuar, ti e përjetove. Paskëtaj ti nuk do të vdesësh kurrë!”

Pastaj pelerinën e ktheu në fytyrën e Pejgamberit a.s. dhe shkoi, ndërsa Omeri vazhdonte t’u fliste njerëzve. Ebu Bekri tha: “Ngadalë, o Omer! Mjaft!” Omeri refuzoi të ulej. Atëherë Ebu Bekri iu drejtua njerëzve dhe kur njerëzit e dëgjuan zërin e tij, u shmangën nga Omeri dhe u kthyen nga Ebu Bekri. Ai e falënderoi Allahun dhe e lavdëroi, e pastaj tha:

“O njerëz, ju them se kush e ka adhuruar Muhamedin, le ta dijë se Muhamedi tashmë ka vdekur. E kush e adhuron Allahun, le ta dijë se Allahu është i gjallë. Ai kurrë nuk vdes!”

Pastaj lexoi këtë ajet:

*“Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i Dërguar. Edhe përpara tij pati të Dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t’i shpërblejë mirënjohësit.”* (Alu Imran, 144).

Vallahi, dukej sikur njerëzit nuk e kishin ditur se ishte shpallur ky ajet, gjersa e lexoi Ebu Bekri. Atëherë njerëzit filluan ta këndonin këtë ajet, e mësuan dhe e mbajtën në buzët e tyre.”

Ebu Hurejra thotë:

“Omeri ka thënë: “Vallahi, pasi e dëgjova këtë ajet që tha Ebu Bekri, u ula në tokë sepse nuk më mbajtën dot këmbët, u rrëzoza përdhe dhe vetëm atëherë e kuptova se Pejgamberi a.s. me të vërtetë kishte vdekur!”

## NGJARJA NË ÇADRËN E FISIT BENI SA'ADE

Ibni Is'haku thotë:

“Kur vdiq Pejgamberi a.s., komuniteti i ensarëve iu bashkuan Sa'd b. Ubades në çadrën e fisit Beni Sa'ade. Ndërkaq, Ali b. Ebi Talibi, Zubejr b. Avami dhe Talha b. Ubejdullahu u veçuan në shtëpinë e Fatimes dhe pjesa tjetër e muhaxhirëve u tubuan rreth Ebu Bekrit, të cilëve iu bashkua edhe Usejd b. Hudajr nga fisi Beni Eshhel.

Me atë rast erdhi dikush tek Ebu Bekri dhe Omeri dhe tha: “Komuniteti i ensarëve i janë bashkuar Sa'd b. Ubades në çadrën e fisit Beni Sa'ade. Nëse mendoni të bëni diçka, nxitoni atje para se njerëzit të marrin ndonjë vendim dhe të komplikohet çështja!”

Pejgamberi a.s. ishte ende në shtëpinë e tij, pasi kishte vdekur, kurse familjarët e tij dyert i mbanin të mbyllura.

Omeri thotë: “I thashë Ebu Bekrit: “Eja të shkojmë te këta vëllezërit tanë ensarë e të shohim se cili është qëndrimi i tyre!”

Transmetohet se Abdullah b. Abbasi ka thënë:

“Më ka treguar Abdurrahman b. Avfi, kur unë isha në shtëpinë e tij e po qëndroja përballë saj duke e pritur që ai të kthehet nga Omeri, që kishte shkuar në haxhin e tij të fundit. Kur u kthye, më gjeti mua duke e pritur para shtëpisë së tij dhe po lexoja Kur'an. Ai më tha:

“Sikur ta shihje, një burrë erdhi te udhëheqësi i besimtarëve dhe i tha: “O udhëheqës i besimtarëve! Çfarë mendon për filan njeri?” Vallahi, sikur të vdiste Omer b. Hattabi, unë do t'ia shprehja betimin për besnikëri atij! Vallahi, edhe besnikëria ndaj Ebu Bekrit ishte paraqitur rastësisht dhe mbijetoi!”, e cila e zemëroi shumë Omerin dhe tha: “Sonte unë, me vullnetin e Allahut, do të dal para njerëzve dhe do t'i paralajmëroj për disa që po duan t'ua uzurpojnë atë që u takon atyre!” Abdurrahmani tha: “Unë i thashë atij: “O udhëheqës i besimtarëve! Mos thuaj ashtu! Në haxh mbledhen njerëz nga të gjitha llojet dhe në mesin e tyre ka grumbull njerëzish që kur ngrihesh për të folur, shumica syresh afrohen rreth teje. Kam frikë se nëse kur të thuash atë që ke ndër mend, do të fluturojë në të gjitha anët pa u kuptuar se çfarë ke thënë ose do të kuptohet gabimisht. Prandaj, prit derisa të kthehesh në Medinë sepse është vendi i Sunnetit dhe shquhet me juristë të dalluar dhe njerëz të respektuar, andaj atë që dëshiron thuaje në Medinë, se aty juristët do t'i kuptojnë fjalët e tua dhe do t'i vendosin në vendin e tyre!”

Omeri tha: “Me lejen e Allahut, gjithsesi do ta them në paraqitjen time të parë që do të kem në Medinë!”

Ibni Abbasi ka thënë:

“Pastaj ne u kthyem në Medinë, në fund të muajit dhul-hixhxe, dhe të premtën e parë, sapo perëndoi dielli, unë nxitova për në xhami, ku pranë minberit ishte ulur Seid b. Zejd b. Amër b. Nufil dhe unë u ula pranë tij në mënyrë që gjunjët tanë u prekën. Pas pak erdhi Omer b. Hattabi dhe kur e pushë duke ardhur, unë i thashë Seid b. Zejdit: “Sonte, nga minberi do të thotë diçka që nuk e ka thënë që kur është bërë halif!”

Seid b. Zejdi më tha: “Pse pikërisht tani do të thotë diçka që nuk ka thënë më parë?” Omeri u ul në minber. Kur muezini mbaroi, ai u ngrit dhe i shprehu falënderimin dhe lavdërimin e duhur Allahut, pastaj tha:

“Unë sot do t’ju them diçka që më është përcaktuar për t’jua thënë. Dhe nuk e di, ndoshta kjo është para fundit të jetës sime. Kush e merr vesh dhe e kupton atë, le t’i përmbahet asaj dhe le ta shpërndajë kudo që mbërrin, e kush nuk është i sigurt se e ka kuptuar mirë, askujt nuk i lejohet që të gënjejë për mua!”

Allahu e dërgoi Muhamedin dhe ia shpalli Librin dhe në mesin e asaj që i ka shpallur është edhe ajeti në lidhje me gurëzimin; ne e kemi lexuar, e kemi mësuar dhe e kemi kuptuar. Pejgamberi a.s. e ka zbatuar gurëzimin, edhe ne pas tij, e kemi zbatuar gurëzimin. Dhe unë kam frikë se njerëzit, me kalimin e kohës, do të thonë: “*Ne në Librin e Allahut nuk po e gjejmë gurëzimin!*” dhe kështu duke e injoruar një dispozitë që ka shpallur Allahu, do të devijojnë nga rruga e Tij. Gurëzimi, që gjendet në Librin e Allahut, është i arsyeshëm dhe duhet të zbatohet për atë që kryen shkelje kurore, qoftë mashkull ose femër, nëse ka prova të qarta, shtatzëni apo pranim. Pastaj, ne kemi lexuar në Librin e Allahut: “*Mos i përçmoni etërit tuaj, sepse nëse ju i përçmoni etërit tuaj, kjo për ju është mosbesim!*”

Nga ana tjetër, Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Mos më glorifikoni shumë mua, ashtu siç u glorifikua Isai, biri i Merjemes! Vetëm thoni: rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij!*” Pastaj, kam dëgjuar se dikush ka thënë: “Vallahi, sikur të vdiste Omer b. Hattabi, unë do t’ia shprehja betimin për besnikëri. Askush mos të mashtrohet e të thotë: Edhe besnikëria ndaj Ebu Bekrit ishte paraqitur rastësisht dhe mbijetoi!” Kjo në fakt ka qenë ashtu, por Allahu e ka ruajtur nga pasojat e këqija sepse mes jush nuk ka asnjë njeri që është aq i devotshëm ndaj Tij siç ishte Ebu Bekri. Prandaj, askush askujt mos t’i shprehë besnikërinë e tij pa konsultim paraprak me muslimanët sepse me atë rast ai betim i tij për besnikëri nuk është i vlefshëm ligjërisht për të e as për atë të cilit i është dhënë dhe as nuk është e sigurt se nuk do të vriten.

Kjo na ka ndodhur neve kur vdiq Pejgamberi a.s., kur ensarët nuk ishin me ne, por me njerëzit e shquar të tyre u takuan në çadrën e fisit Beni Sa'ade. Gjithashtu na mungonte edhe Ali b. Ebi Talibi, Zubejr b. Avami dhe të tjerët që ishin me ta, ndërsa muhaxhirët u mblodhën rreth Ebu Bekrit. Atëbotë unë i thashë Ebu Bekrit: “Eja të shkojmë te këta vëllezërit tanë ensarë!”

Dhe ne u nisëm për tek ata. Gjatë rrugës takuam dy njerëz të mirë të tyre, të cilët na treguan se cila ishte gjendja në mesin e tyre dhe për çfarë po dakordoheshin. Së pari ata na pyetën: “Ku po shkoni, o muhaxhirë?!” Ne u përgjigjëm: “Po shkojmë te këta vëllezërit tanë ensarë!” Ata na thanë: “Ndoshta nuk është mirë që të afroheni tek ata, kthehuni!” Unë u thashë: “Jo, vallahi, por do të shkojmë!” Dhe ne vazhduam derisa arritëm në çadrën e fisit Beni Sa'ade.

Ne u befasuam kur në mesin e tyre pamë një njeri të mbështjellë. U thashë: “Kush është ky?”

Ata m'u përgjigjën: “Është Sa'd b. Ubade.” I pyeta: “Çfarë ka?” Ata thanë: “Është i sëmurë.”

Pasi u ulëm, një nga folësit e tyre e shqiptoi shehadetin islam dhe shprehu falënderimin e duhur për Allahun dhe pastaj tha: “Ne jemi ndihmëtarë të rrugës së Allahut (ensarullah) dhe bastion i Islamit, ndërsa ju, o muhaxhirë, jeni një grup i yni, jeni një pjesë e jona. Ju keni ardhur ngadalë nga andej, nga populli juaj!”

Omeri tha: “Kështu ata, në fakt, dëshironin ta nxirrnin nga rrënjët tona dhe të na e rrëmbenin çështjen nga duart. Kur e mbaroi fjalën, dëshirova të flisja dhe tashmë e kisha bërë konceptin se çfarë doja të thosha, kisha ndër mend t'ia paraqes së pari Ebu Bekrit dhe kështu ta qetësoja pak, por ai më tha: “Ngadalë, o Omer!” Dhe unë nuk desha ta zemëroja, kështu që foli ai dhe ishte më i dijsëm dhe më dinjitoz se unë. Vallahi, nuk la asnjë fjalë që unë isha gati për ta thënë dhe ai e tha me atë thjeshtësinë e tij ose të ngjashme apo edhe më të mirë, për aq kohë sa fliste.

Ai tha: “Sa u përket të mirave për veten tuaj, që i the, ju me të vërtetë për to jeni të denjë, mirëpo të gjitha ato arabët do t'i njohin vetëm në këtë bashkësi të Kurejshëve. Ata janë shtyllë e origjinës së tyre dhe janë shtëpitë e para nikoqire në mesin e tyre. Prandaj, do të isha i kënaqur nëse ju betimin tuaj për besnikëri do t'ia shprehni njërit prej këtyre dy njerëzve” dhe e mori dorën time dhe dorën e Ebu Ubejde b. Xherrahut, i cili ishte ulur aty mes nesh.

Nga çdo gjë që tha, mua vetëm kjo nuk më pëlqeu dhe vallahi më shumë do të doja të arrestohesha dhe ekzekutohesha, por kjo të mos më afronte te mëkati, sesa të qëndroja në krye të njerëzve në mesin e të cilëve ishte edhe Ebu Bekri.

Një nga ensarët tha: “Unë jam një shtyllë për kruajtje nga një palmë e përforcuar<sup>216</sup>, o Kurejshë, të dyja palët, le ta kemi nga një emir!”

Pastaj u shkaktua një shamatë dhe u ngritën tonet, sa që unë u frikësova nga përçarja. I thashë: “O Ebu Bekër, ma shtrij dorën!” Dhe kur ai ma zgjati dorën, unë ia dhashë betimin për besnikëri! Pastaj këtë e bënë edhe muhaxhirët, e pas

<sup>216</sup> Shtyllë është një dru i cili u vendoset deveve që të kruhen tek ai dhe të pushojnë pranë tij. Arabët këtë e merrnin si shembull për njeriun i cili me përpjekjen e tij tenton të gjejë zgjidhje. Palma e përforcuar simbolizon njeriun që i çmon të vetët dhe kujdeset për ta. Merret si shembull për njeriun prestigjioz.

tyre edhe ensarët. Pastaj ne iu hodhëm Sa'd b. Ubades, kur dikush prej tyre tha: "E vratë Sa'd b. Ubaden! Kurse unë thashë: "Allahu e vraftë Sa'd b. Ubaden!"

Zuhriu ka thënë:

"Urve b. Zubejri më ka thënë se njëri nga ata dy ensarët që kanë hasur rrugës për në çadrën e fisit Beni Sa'ade ishte Uvejm b. Sa'ide, kurse tjetri Ma'n b. Adiu nga fisi Beni Axhlan.

Sa i përket Uvejm b. Sa'ides, kemi dëgjuar se Pejgamberi a.s. është pyetur: "Kush janë ata për të cilët Allahu i Madhërishëm ka thënë: "... aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen mirë, e Allahu i do të pastrit." (Et-Tevbe, 108), dhe Pejgamberi a.s. ishte përgjigjur: "Më i miri prej tyre është Uvejm b. Sa'ide!"

Për Ma'n b. Adiun kemi dëgjuar se kur njerëzit qanë për vdekjen e Pejgamberit a.s. dhe thanë: "Vallahi, do të donim të kishim vdekur ne para tij sepse kemi frikë se pas tij mos devijojmë rrugën!", me atë rast Ma'n b. Adiu kishte thënë: "Unë, vallahi, nuk dëshiroj të kisha vdekur para tij, unë dua t'i besoj edhe pas vdekjes së tij, ashtu siç i kam besuar edhe gjatë jetës!"

Ma'ni vdiq si shehid në Betejën e Jemames kundër Musejleme Kedhdhabit gjatë halifatit të Ebu Bekrit."

Zuhriu gjithashtu ka thënë: "Enes b. Maliku më ka thënë:

"Pasi iu dha betimi për besnikëri në atë çadër, të nesërmen, Ebu Bekri u ul në minber, ndërsa Omeri u ngrit dhe filloi të flasë para tij. Ai së pari i shprehu falënderimin dhe lavdërimin e duhur Allahut e pastaj tha:

"O njerëz! Unë dje ju thashë diçka që nuk ka qenë e as nuk e kam gjetur në Librin e Allahut, por as nuk ma ka besuar mua Pejgamberi a.s.. Në fakt, unë kam menduar se Pejgamberi a.s. do ta menaxhojë këtë çështjen tonë, se ai do të jetë i fundit prej nesh, por Allahu në mesin tuaj la Librin e Tij, në të cilin gjendet udhëzimi i Tij dhe i Dërguarit të Tij: në qoftë se ju i përmbaheni atij, Allahu do t'ju udhëzojë siç e udhëzoi atë.

Allahu ju bashkoi në lidhje me zgjedhjen e më të mirit prej jush, shokun e Pejgamberit a.s., të dytin prej të dyve, kur ata ishin në shpellë, ndaj ngrihuni dhe jepjani betimin për besnikëri!"

Kështu, Ebu Bekrit, pas shprehjes së besnikërisë në çadër, iu dha edhe betimi i përgjithshëm për besnikëri.

Pastaj foli Ebu Bekri. Ai së pari i shprehu falënderimin dhe lavdërimin e duhur Allahut, e pastaj tha:

"O ju njerëz, unë u caktova për t'ju qeverisur, edhe pse unë nuk jam më i miri nga ju! Prandaj, nëse unë qeveris mirë, ju lutem më mbështetni, e nëse qeveris keq, ju lutem më drejtoni me këshillat dhe udhëzimet tuaja. Besnikëria është amanet, ndërsa gënjeshtria është tradhti. Prandaj në qeverisjen time i dobëti në

mesin tuaj është i fuqishëm tek unë derisa me lejen e Allahut t'ia kthej atij hakun që i takon, e i forti në mesin tuaj do të jetë i dobët tek unë derisa me lejen e Allahut prej tij të marr të padrejtën e t'ia kthej atyre që u takon. Çdo popull që ka braktisur luftën për hir të Allahut, Allahu ata i ka goditur me poshtërim. Nëse e keqja përhapet në popull, atëherë të gjithë do të përfshihen nga dënimi i Allahut. Më respektoni derisa unë e respektoj Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e nëse unë nuk e respektoj Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë ju nuk keni asnjë obligim ndaj meje që të më respektoni. Tash ngrihuni për namaz, Allahu ju mëshiroftë!”

Ibni Abbasi ka thënë:

“Vallahi, një herë unë po shkoja me Omerin gjatë kohës së halifatit të tij e ai e mbante në dorë një kamxhik dhe po shkonte për ndonjë nevojë të tij. Me ne nuk ishte askush tjetër, ai fliste me veten dhe me kamxhik po godiste këmbën e tij. Për një çast u kthye nga unë dhe më pyeti:

“O biri i Abbasit, a e di se çfarë më shtyu që të flas ashtu kur vdiq Pejgamberi a.s. ?!” Unë i thashë: “Nuk e di, o udhëheqësi i besimtarëve! Ti e di pse!”

Ai vazhdoi: “Vallahi, nuk më ka shtyrë asgjë tjetër por ky ajet që kam lexuar:

*“Ne ju bëmë ju një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve dhe për të qenë i Dërguari dëshmitar ndaj jush!”* (El-Bekare, 143), dhe vallahi unë kam menduar se Pejgamberi a.s. do të mbetet në mesin e umetit të tij dhe do të jetë dëshmitar për veprat e tyre të fundit. Vetëm kjo më shtyu që të them atë që kam thënë.”

## PËRGATITJA E PEJGAMBERIT A.S. DHE VARRIMI I TIJ

Ibni Is'haku ka thënë:

“Sapo iu dha Ebu Bekrit r.a. betimi për besnikëri, njerëzit menjëherë filluan përgatitjen e Pejgamberit a.s.. Kjo ishte ditën e martë.

Më ka treguar Abdullah b. Ebi Bekri, Husein b. Abdullahu dhe shumë të tjerë nga njerëzit tanë se kujdesin rreth larjes së Pejgamberit a.s. e kanë marrë përsipër: Ali b. Ebi Talibi, Abbas b. Abdulmuttalibi, Fadl b. Abbasi, Kuthem b. Abbasi, Usame b. Zejdi dhe Shukrani, bir i adoptuar i Pejgamberit a.s..

Evs b. Havliu, nga fisi Beni Avf, i tha Ali b. Ebi Talibit: “Pashë Allahun, o Ali, a nuk kemi ne asnjë pjesë të Pejgamberi a.s.?! Fisi Evs ka qenë shumë i afërt me Pejgamberin a.s. dhe ka marrë pjesë në Betejën e Bedrit!” Aliu i tha: “Hyr!” Ai hyri, u ul dhe qe prezent në larjen e Pejgamberit a.s.. Aliu e vendosi Evsin te gjoksi i Pejgamberit a.s., i cili së bashku me Abbasin, Fadlin dhe Kuthemin mori pjesë në kthimin e trupit, kurse Usame b. Zejdi dhe Shukrani i hidhnin ujë gjatë larjes, ndërkaq larjen e ka bërë Aliu. Pejgamberi a.s. në trup kishte këmishë dhe mbi të Aliu e fërkonte trupin e Pejgamberit a.s., duke mos e prekur me dorë. Ai thoshte: “Nënë e babë t’u bëfshin kurban, o i Dërguari i Allahut, sa i bukur je, si i gjallë ashtu edhe i vdekur!”

Te Pejgamberi a.s. nuk u pa asgjë, siç shihet zakonisht tek i vdekuri.

Aishja ka thënë:

“Kur deshën ta lanin Pejgamberin a.s., ishin në dyshim, nuk dinin si të vep-ronin. Ata thanë: “Vallahi, nuk e dimë a t’ia heqim rrobat Pejgamberit a.s. siç ua heqim të vdekurve tanë apo ta lajmë ashtu me rroba?!” Dhe kur ata nuk mund të dakordoheshin, Allahu i vuri në gjumë dhe të gjithëve u ra mjekra në gjoks. Në atë moment, një i panjohur, nga drejtimi i Qabesë, u tha: “Pejgamberin a.s. lajeni ashtu të veshur!” Atëherë filluan ta lajnë Pejgamberin a.s. duke e pasur të veshur këmishën, në të hidhnin ujë dhe e fërkonin mbi të, ashtu që duart e tyre nuk e preknin trupin e tij.”

Ibni Is'haku ka thënë:

“Pasi e lanë Pejgamberin a.s. e mbështollën me tri pëlhura: dy suharase<sup>217</sup> dhe një jemenase, në të cilën e vendosën mirë.”

Nga Ibni Abbasi transmetohet se ka thënë:

“Ebu Ubejde b. Xherrah i hapte varret në mënyrën siç bënë në Mekë, ndërsa Ebu Talha Zejd b. Sehl medinasve ua hapte varret me lahd<sup>218</sup>. Dhe kur deshën ta

<sup>217</sup> Suharase, me prejardhje nga qyteti Suhar, prej qyteteve të Jemenit. Ka mendim se ai është Amani.

hapin varrin e Pejgamberit a.s., Abbasi thirri dy njerëz dhe njërit i tha: “Shko te Ebu Ubejde Xherrahu”, kurse tjetrit i tha: “Shko te Ebu Talha!” Ai tha: “O Allah, Ti zgjidh për Pejgamberin a.s.!”

Personi që u dërgua tek Ebu Talha kishte arritur ta gjente dhe e solli aty. Kështu që varrin e Pejgamberit a.s. e hapi me lahd Ebu Talha.

Të martën, pasi u krye përgatitja, Pejgamberi a.s. u vendos në shtratin e tij në shtëpinë e tij. Muslimanët patën mospajtime edhe rreth vendit se ku ta varrosin: disa mendonin se kjo duhet të bëhet në xhami, ndërsa disa të tjerë mendonin se duhet të varroset me sahabët e tij, ndërsa Ebu Bekri tha: “Unë e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *“Secili Pejgamber, kur ka vdekur, është varrosur në vendin ku ka dhënë shpirt!”*

Atëherë u ngrit shtrati në të cilin vdiq Pejgamberi a.s. dhe në atë vend u hap varri i tij. Pastaj njerëzit në grupe kanë hyrë tek ai dhe ia kanë falur xhenazen. Kur kanë përfunduar burrat, janë lejuar gratë, e kur kanë përfunduar gratë, janë lejuar fëmijët. Askush nuk u ka prirë njerëzve në këtë.

Pejgamberi a.s. është varrosur në mes të natës, në prag të së mërkurës.

Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Ne nuk e dinim se Pejgamberi a.s. po varrosej, derisa kemi dëgjuar zërin e lopatave, natën vonë, në prag të së mërkurës!”

Ibni Is'haku ka thënë:

“Në varrin e Pejgamberit a.s. zbritën Ali b. Ebi Talibi, Fadl b. Abbasi, Kuthem b. Abbasi dhe Shukrani, biri i adoptuar i Pejgamberit a.s.. Pastaj Evs b. Havliu i tha Ali b. Ebi Talibit: “Pashë Allahun, o Ali, a nuk kemi ne asnjë pjesë të Pejgamberi a.s.?! Aliu i tha: “Zbrit!” dhe ai zbriti me ta.

Kur Pejgamberi a.s. u lëshua në varr dhe filluan ta mbyllin, Shukrani mori një pëlhurë me thekë, me të cilën Pejgamberi a.s. ndonjëherë mbulohej e ndonjëherë e shtronte, dhe e vendosi në varr duke thënë: “Pas teje këtë askush nuk do ta veshë!” Kështu edhe ajo pëlhurë është varrosur me Pejgamberin a.s..

Mugire b. Shu'be ka pretenduar se ai ishte njeriu i fundit që ka kontaktuar me Pejgamberin a.s.. Ai ka thënë: “E mora unazën time dhe e hodha në varr me qëllim. Atyre u thashë më ra unaza. Ajo nuk më ra, por unë e hodha me qëllim në mënyrë që ta prekja Pejgamberin a.s. dhe kështu unë kam qenë i fundit që e ka prekur!”

Transmeton Miksem Ebul-Kasim, shërbëtor i Abdullah b. Harith b. Nufelit, nga zotëria i tij Abdullah b. Harithi, se ka thënë:

“Unë isha në umre bashkë me Ali b. Ebi Talibin gjatë kohës së Omerit apo Othmanit dhe ai u ndal te motra e tij Ummu Hanie bint Ebi Talibi. Pas përfundi-

<sup>218</sup> Lahd quhet hapja e varrit kur i vdekuri vendoset në njëren anë të varrit dhe jo në mesin e tij.

mit të umres, përsëri u kthye tek ajo. Aty i përgatitën ujë për larje. Pasi u la, tek ai hyri një grup irakianësh, të cilët e pyetën: “O Ebu Hasan, ne kemi ardhur të pyesim për një çështje për të cilën duam të na tregosh!”

Ai tha: “Mendoj se Mugire b. Shu’be u ka folur se si ai ka qenë i fundit që e ka prekur Pejgamberin a.s.!” Ata thanë: “Po, pikërisht kemi ardhur të pyesim për këtë!” Aliu tha: “Njeriu i fundit që e ka prekur Pejgamberin a.s. ka qenë Kuthem b. Abbasi!”

Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe thotë se atij Aishja i ka thënë:

“Kur Pejgamberin a.s. sëmundja e molisi plotësisht, ai ishte i mbuluar me një mbulesë të zezë katrore me dy vija dhe ai me të herë e mbulonte fytyrën e herë e hiqte. Me atë rast tha: *“Allahu e vraftë një popull që varret e Pejgamberëve të tyre i marrin për xhami!”* Kështu e paralajmëroi umetin e tij për këtë.

Aishja ka thënë:

“Udhëzimi i fundit që ka dhënë Pejgamberi a.s. ishte: *“Në Gadishullin Arabik të mos mbeten dy fe!”*

Ibni Is’haku thotë:

“Vdekja e Pejgamberit a.s. muslimanëve u shkaktoi shumë telashe. Kështu, siç kam mësuar, Aishja ka thënë: “Kur vdiq Pejgamberi a.s., shumë arabë hoqën dorë nga feja, kurse Judaizmi edhe Krishterimi ngritën kokë dhe u shfaq hipokrizia. Muslimanët me humbjen e Pejgamberit të tyre u bënë si dele të lagura nga shiu në një natë dimri, derisa i bashkoi Allahu rreth Ebu Bekrit!”

Ibni Hishami thotë:

“Ebu Ubejde dhe dijetarë të tjerë më kanë thënë: Numri më i madh banorëve të Mekës kishin për qëllim të hiqnin dorë nga Islami dhe me të vërtetë donin ta bënin këtë, por i frikësoi Attab b. Usejd<sup>219</sup>, ndaj u tërhoqën nga ky synim. U ngrit Suhejl b. Amri, i shprehu falënderim dhe lavdërim Allahut, e përmendi vdekjen e Pejgamberit a.s., pastaj tha: “Kjo vetëm do ta forcojë Islamin edhe më tepër, ndërsa ai që na bën për të dyshuar në të, ne do ta vrasim!”

Kështu njerëzit u tërhoqën dhe hoqën dorë nga ajo që synuan, e më pas u shfaq edhe Attab b Usejdi.

Kjo është ajo për të cilën ka aluduar Pejgamberi a.s. kur Omer b. Hattabit i ka thënë: *“Ndoshta ai do të bëjë një veprim të cilin nuk do ta gjykos!”*

Siç na ka thënë Ibni Hishami, duke cituar Ebu Zejd Ensariun, Hassan b. Thabiti duke e vajtuar Pejgamberin a.s. ka recituar vargjet vijuese:

*Në Tajbe është vendi i Pejgamberit, i vjetër dhe i njohur,  
edhe kur vendet e tjera shkretohen, ai është i ndritur.  
Shumë shenja të harresës velloja nuk do të mund t’i mbulojë,*

<sup>219</sup> Kur vdiq Pejgamberi a.s., Attab b. Usejdi ishte guvernator i Mekës.

aty është minberi mbi të cilin udhërrëfyesi i botës qëndroi.  
 Gjurmët gjithandej janë të qarta, kanë mbetur shenjat,  
 në vendin e tyre joshin xhamitë dhe musal-lat.  
 Aty janë dhomat ku i Zgjedhuri ka jetuar,  
 në to dritën dhe shpalljen e Allahut ka pranuar.  
 Kudo janë vende të njohura, të harrohen është vështirë,  
 por sado që kalon koha, ato vijjnë duke u përtërirë.  
 Aty ia njoha pamjen dhe paraqitjen e tij pejgamberike,  
 aty i qëndron varri me lahdin, e mbi të ka dhe aromatike.  
 Shumë gjatë, duke vajtuar Pejgamberin, kam qëndruar,  
 ku dy sytë e mi me shumë bujari më kanë ndihmuar.  
 Sytë e mi, mirësitë e Pejgamberit, i përkujtojnë,  
 të cilat gjithë jetën as që mund t'i numërojnë.  
 Unë as për së afërmi meritat e tij nuk mund t'i numëroj,  
 por nga thellësia e zemrës pikëllimin tim atij ia kushtoj.  
 Gjatë qëndrova dhe pandërprerë dy sytë e mi lotuan,  
 mbi varrin e Ahmedit, ku atë me dhë e mbuluan.  
 Qofsh i bekuar, o ti varr që aromë të këndshme lëshon,  
 qoftë i bekuar edhe qyteti, ku i Virtytshmi pushon.

\* \* \*

Arsyeja, dituria dhe mëshira në varrin tënd u varros,  
 qysh kur ti, o më Fisniku, aty i shtrirë po qëndron.  
 Të pikëlluar u shpërndanë, sepse me ta nuk është Nebiu,  
 shpinat u janë ligështuar dhe supet u janë rraskapitur.  
 Vajtojnë atë për të cilin kanë vajtuar edhe qiejt,  
 edhe toka qan për të, e si mund të heshtin njerëzit?  
 A ka ndodhur ndonjëherë një telash kaq i madh,  
 sesa kur vdiq Muhamedi dhe ata mbetën pa të?  
 Iu ndërpre atyre Shpallja, e cila deri atëherë u erdhi,  
 gjithandej me dritë, nga Nexhdi dhe nga Jemeni.  
 Tek Mëshiruesi e drejtonte, çdonjërin që udhëzimin dëshironte,  
 shpëtonte nga mashtrimi dhe në rrugë të drejtë e ftonte.  
 Imam i tyre ishte, u priu rrugës së të vërtetës,  
 ishte mësues i ndershmërisë, që ua siguroi lumturinë e jetës.  
 Rrëshqitjet i fali, ndjesën e justifikimet i pranoi,  
 nëse bëhen bamirës, bujarinë e Allahut u premtoi.  
 Nëse hasnin në diçka, që nuk mund ta përballonin,  
 ai u sillte lehtësimin dhe nga vështirësia shpëtonin.

\* \* \*

*Derisa ashtu të lumtur, begatinë e Allahut po shijonin,  
vdekja e pashmangshme me shigjetë Nurin e qëlloi.  
Duke e falënderuar Allahun, u kthyen dhe duke e lavdëruar,  
ndërkaq, vajtimin për të, edhe melekët kishin filluar.  
Vendi i Haremit, por edhe vendet përreth tij janë shkretuar,  
sepse nuk është më drita e Shpalljes, me të cilën ishin mësuar.  
Çdo gjë ishte braktisur, përveç kabrit, i cili aty mbeti,  
po qante edhe guri, edhe druri nga humbja që i gjeti.*

\* \* \*

*Qani, qani, o sytë e mi, e për Resulin lotoni pa u ndalë,  
se unë nuk e di, nëse ndonjëherë këta lot kanë për t'u tharë.  
Dhe si të mos qaj dhe lot të tmerrshme të mos derdh,  
për Resulin, i cili me përfitime të mëdha njerëzimit i erdh?*

\* \* \*

*Për të, gjithçka që them unë, askush mos të më qortojë,  
sepse vetëm një i çmendur, mua mund të më fajësojë.  
Duke e lavdëruar atë, unë nuk do të ndalem në këtë jetë,  
andaj shpresoj, të jem me të përgjithmonë në xhenet.  
Shpresoj që në xhenet me Mustafanë do të shoqërohem,  
për ta arritur këtë, gjatë gjithë kësaj jete do të angazhohem.*

\* \* \*

Hassan b. Thabiti duke vajtuar për Pejgamberin a.s. ka recituar edhe këto vargje:

*Çfarë ka syri që nuk mbyllet, që nuk e zë gjumi,  
sikur është lënduar, e është prekur nga pezmatimi.  
Nga pikëllimi për të Drejtuarin, që dheu po e mbulon,  
mos u largo prej nesh, o më i miri, që aty po pushon!  
Me fytyrën time, unë do të mbroj ty nga pluhuri i mbuluar,  
ah sikur në varrezat Beki'el-Garkad para teje të kisha shkuar!*

\* \* \*

*A të qëndroj në mesin e tyre, pas teje, në Medinë si mjerë?  
më mirë për mua, sikur helmin e gjarprit të zi të kisha pirë!*

\* \* \*

*O Zot, të gjithë neve me Resulin na bashko,  
në xhenet, për inat të ziliqarit malicioz!*

\* \* \*

*Të pikëlluar jeni, o ju ensarë, dhe ju të afërmit e tij,  
që nga koha kur varri u bë vendndodhje e tij.  
Ju shtrëngimin e ndjeni, fytyra ju është errësuar,  
sikur në gjithë trupin, me antimon të jeni lyer.  
Ne e kemi lindur dhe varrin e tij në mes nesh e mbajmë,  
nimetet e shumta ndaj nesh, ne nuk ia mohojmë.  
Allahu me të na ka nderuar dhe përmes tij na ka udhëzuar,  
ndërsa ndihmësit e tij për këtë gjithmonë kanë dëshmuar.  
Salavat dërgojnë Allahu dhe engjëjt e Arshit përreth,  
edhe njerëzit e mirë, për më fisnikun, për ty o Ahmed!*

Ibni Is'haku thotë: "Hassan b. Thabiti duke vajtuar Pejgamberin a.s. ka thënë edhe këto vargje:

*Përkujtoju të varfërve, se e mira prej tyre është larguar,  
pasi Pejgamberi herët në agim, jetë ka ndërnuar.  
Devenë time, edhe shalën time, kush do ta dhurojë,  
por edhe familjen, kur nuk bie shi kush do të ma ushqejë?  
Kënd do të qortojmë, pa u frikësuar nga hakmarrja e tij,  
nëse gjuha, gjatë të folurit, pa qëllim do të na rrëshqasë?  
Ah çfarë fati, sikur atë ditë kur në varr e lëshuam,  
e varrosëm trupin e ndershëm e me dhë e mbuluam,  
Allahu asnjërin prej nesh pas tij mos të na lejonte,  
as femër as mashkull, pas tij që të jetonte<sup>220</sup>!*

Këtu përfundon redaktimi i Biografisë së Ibni Hishamit, e enjte, 01 ramazan 1374 h.

Falënderimi i takon Atij, i Cili mundëson realizimin e veprave të mira!

<sup>220</sup> Një numër shumë i vogël vargësh, rreth dhjetë sosh, nuk janë përkthyer. (Përkthyesi)



CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
"Св. Климент Охридски", Скопје

CIP - katalogu në publikim  
Biblioteka Kombëtare Universitare  
"Shën Kliment Ohridski", Shkup

28-312


HISHAM, Ibni  
Biografia e pejgamberit: sal-IAllahu alejhi ve sel-lem /  
Ibni Hisham; e përktheu nga arabishtja Miftar Ajdini.  
- Shkup: Logos-A, 2017. - 352 faq.; 24 cm.  
- (#Biblioteka #Mendimi islami)

Фусноти кон текстот / Fusnotat drejt tekstit

ISBN 978-9989-58-662-0

а) Мухамед/Muhamed (570-632) -  
Биографии/ Biografi  
COBISS.MK-ID 102634762

**www.logos-a.com**  
Copyright©Logos-A, 2017



LOGOS·A